



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/05  
Datë: 06.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 mars, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



***Zyra e Kryeministrit-Ured Premiera-Office of the Prime Minister***

***Sekretariati Koordinues i Qeverisë/ Koordinacioni Sekretariat Vlade/Government Coordination Secretariat***

---

## **Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative**

***Heqja e Barrierave Burokratike***

## Përmbajtja

<b>Lista e Shkurtesave .....</b>	<b>9</b>
<b>Hyrje .....</b>	<b>11</b>
<b>Kapitulli 1: Përkufizimi i Problemit.....</b>	<b>13</b>
1.1 Reforma e Administratës Publike dhe Mbështetja Buxhetore Sektoriale .....	13
1.2 Sfidat ekonomike të Kosovës .....	13
1.3 Papunësia e madhe .....	13
1.4 Niveli i lartë i ekonomisë joformale .....	14
1.5 Kostoja e lartë e jetesës .....	15
1.6 Barra rregullatore me të cilat ballafaqohen bizneset dhe investitorët .....	15
1.6.1 Analizë nga Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë .....	15
1.6.2 Analizë nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe RIINVEST .....	16
1.7 Sundimi i Ligjit dhe barra administrative .....	16
1.7.1 Niveli i barrës administrative në Kosovë .....	17
1.8 Promovimi i rritjes gjithëpërfshirëse dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë globale .....	17
1.9 Perspektiva ekonomike afatmesme.....	18
1.10 Përmirësimi i klimës së biznesit/investimeve: projektet e kaluara dhe aktuale.....	19
1.11 Krijimi i Regjistrimit të Legjislacionit Dytësor (Zyra Ligjore në Kuadër të ZKM-së) .....	19
1.12 Ligji për Licencat dhe Lejet (Zyra Ligjore në kuadër të ZKM-së).....	20
1.13 Zbatimi i Ligjit për Procedurat e Përgjithshme Administrative (Ministria e Administratës Publike) .....	20
1.14 Thjeshtimi i inspektimeve (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) .....	21
1.14.1 Inspektimet: Barra dhe bizneset .....	22
1.15 Sfidat afatmesme të zhvillimit të politikave dhe legjislacionit.....	22
1.16 Kosova në krahasim me vendet fqinje .....	23
1.16.1 IHD-të në krahasimin rajonal .....	23
1.16.2 Të bërit biznes .....	24
1.17 Kostot Administrative dhe Barra Administrative .....	25
1.17.1 Modeli i Kostimit Standard.....	26
1.17.2 Arritja e zvogëlimit të barrës administrative .....	27
1.17.3 Trajnimi për Trajnerë për Modelin e Kostimit Standard (TpT MKS – Sekretariati Koordinues i Qeverisë) .....	28
1.18 Pema e Problemit për Barrën Administrative .....	29
1.18.1 Shkaqet e problemit.....	30
1.18.2 Efektet e problemit .....	34

1.19 Politikat përkatëse dhe legjislacioni në lidhje me zvogëlimin e barrës administrative .....	38
1.20 Barra administrative: Palët e prekura të interesit .....	39
1.21 Zhvillimet e pritura të ardhshme - skenari bazë .....	40
<b>Kapitulli 2: Objektivat .....</b>	<b>41</b>
2.1 Strategjia për Rregullim më të mirë 2.0 për Kosovën 2017 – 2021 .....	41
2.1.1 Zhvillimi i Koncept Dokumentit për zvogëlimin e barrës administrative .....	41
2.1.2 Prezantimi i Modelit të Kostimit Standard .....	41
2.1.3 Thjeshtësimi, bashkimi ose heqja e të paktën 10% të licencave dhe lejeve .....	41
2.2 Angazhimet politike për nxitjen e rritjes ekonomike .....	42
2.2.1 Strategjitë ekzistuese që kanë për qëllim përmirësimin e ekonomisë së Kosovës .....	42
2.2.2 Zvogëlimi i barrës administrative lidhur me pozicionet e partive politike mbi rritjen ekonomike dhe zvogëlimin e barrës administrative .....	44
2.3 Integrimi Evropian dhe zvogëlimi i barrës administrative .....	48
2.3.1 Kontrata për Mbështetje Buxhetore Sektoriale për Reformën e Administratës Publike .....	50
2.4 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm .....	52
2.5 Përmbledhje e referencave aktuale për zvogëlimin e barrës administrative në kuadrin e politikave strategjike të Qeverisë .....	54
<b>Kapitulli 3: Opsionet .....</b>	<b>56</b>
3.1 Krahasimi Ndërkombëtar .....	56
3.1.1 Holanda .....	57
3.1.2 Bashkimi Evropian .....	74
3.1.3 Gjermania .....	75
3.1.4 Mbretëria e Bashkuar .....	82
3.1.5 Krahasimi ndërkombëtar: Pasqyrë Përmbledhëse .....	83
3.1.6 Krahasimi ndërkombëtar: mësimet kryesore .....	84
3.2 Parakushtet për një program të suksesshëm të zvogëlimit të barrës administrative .....	85
3.2.1 Zvogëlimi i Barrës Administrative në kuadër të kornizës së legjislacionit ekzistues primar .....	89
3.2.2 Futja e Zvogëlimit të Barrës Administrative në kornizën e politikave strategjike .....	91
3.3 Sfidat e pritshme sa i përket menaxhimit .....	92
3.3.1 Rregullimi i organizatave të QQ-së dhe të ministrive të linjës në mënyrë strukturore dhe ngritja e kapaciteteve .....	92
3.3.2 Rezervimi i buxhetit .....	94
3.3.3 Krijimi i matjes bazë (matjes së gjendjes fillestare) .....	95
Opsioni 1: Opsioni pa ndryshime .....	96
Opsioni 2: Matja bazë dhe një cak zvogëlimi prej 25%, për barrët administrative për kompanitë, që zbatohet	

për të gjithë legjislacionin dhe që do të zbatohet brenda 4 viteve .....	97
Opsioni 3: Përfundimi gradual i matjes bazë dhe fushëveprimi i përshtatur i cakut të zvogëlimit të barrës administrative për kompanitë brenda një periudhe kohore prej 8 vjetësh me qëllim zvogëlimin prej 30% ...	97
Opsioni 4: Zgjerimi i Opsionit 3 me një cak zvogëlimi prej 30% sa i përket barrës administrative për qytetarët .....	98
Opsioni 5: Zgjerimi i Opsionit 3 me një cak zvogëlimi prej 30% sa i përket barrës administrative për administratën dhe profesionistët e veçantë.....	98
Opsioni 6: kombinimi i Opsioneve 3, 4 dhe 5.....	99
<b>Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme të opsioneve .....</b>	<b>100</b>
4.1 Korniza ligjore aktuale në numrin e ligjeve dhe akteve nënligjore .....	100
4.2 Ndikimet ekonomike .....	101
4.3 Ndikimet shoqërore .....	105
4.4 Ndikimet mjedisore.....	106
4.4.1 Ndikimi mjedisor: parandalimi i emetimeve të gazrave serrë .....	106
4.4.2 Ndikimi mjedisor: konsumi i letrës.....	109
4.5 Ndikimi buxhetor: afatshkurtër dhe afatmesëm .....	110
4.5.1 Rritja e të ardhurave afatmesme buxhetore që rezultojn nga rritja ekonomike.....	110
4.5.2 Efekti mbi të ardhurat buxhetore si rezultat i reduktimit të tarifave për marrjen e licencave dhe lejeve .....	111
4.6 Ndikimet në të drejtat themelore .....	112
4.7 Vlerësimi i ndikimit gjinor .....	112
4.8 Përmbledhje e ndikimeve të pritshme.....	114
4.9 Analiza e ndjeshmërisë dhe sfidat me mbledhjen e të dhënave .....	115
<b>Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi .....</b>	<b>116</b>
5.1 Konsultimet e synuara dhe takimet me akterët .....	116
5.2 Gjetjet kryesore të procesit të konsultimit .....	120
<b>Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve .....</b>	<b>122</b>
6.1 Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme .....	126
6.1.1 Plani i Zbatimit për Opsionin 2: Matja e plotë bazë dhe caku i zvogëlimit të barrëve administrative për kompanitë prej 25%, i zbatueshëm për tërë legjislacionin dhe që duhet të zbatohet brenda 4 viteve. ....	128
6.1.2 Plani i Zbatimit për Opsionin 3: Përfundimi gradual i matjes bazë dhe fushëveprimi i përshtatur i cakut të zvogëlimit të barrëve administrative për kompanitë brenda një periudhe kohore prej 8 viteve me qëllim zvogëlimin prej 30%. .....	138
6.1.3 Plani i Zbatimit për Opsionin 4: Zgjerimi i Opsionit 3 me një cak zvogëlimi lidhur me barrët administrative për qytetarët.....	150
6.1.4 Plani i Zbatimit për Opsionin 5: Zgjerimi i Opsionit 3 me një cak zvogëlimi lidhur me barrët	

administrative për administratën .....	150
6.1.5 Plani i Zbatimit për Opsionin 6: kombinim i Opsioneve 3, 4 dhe 5 .....	150
6.2 Analiza shumëkritereshe.....	151
<b>Kapitulli 7: Konkluzioni dhe hapat e ardhshëm.....</b>	<b>155</b>
<b>Shtojca 1: Përmbledhje e anëtarëve të Grupit Punues për Koncept Dokumentin për Zvogëlimin e Barrës Administrative .....</b>	<b>156</b>
<b>Shtojca 2: Teksti i plotë nga Programi i Qeverisë 2017-2021 lidhur me zvogëlimin e barrës administrative .</b>	<b>158</b>
<b>Shtojca 3: Raporti i vitit 2016 nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë lidhur me rezultatet e konferencave me bizneset.....</b>	<b>159</b>
<b>Shtojca 4: Raporti i vitit 2017 nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë lidhur me rezultatet e konferencave me bizneset.....</b>	<b>161</b>
<b>Shtojca 5: Lëndët administrative të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura - VJETORI-2018</b>	<b>163</b>
<b>Shtojca 6: Përmbledhje e ministrive dhe agjencive rregullative përgjegjëse për legjislacionin që vendos Informata të Obligueshme ndaj kompanive .....</b>	<b>169</b>
<b>Shtojca 7: Ekstrakte nga raportet e BE-së të viteve 2014, 2015 dhe 2016 për Kosovën, veçanërisht duke iu referuar barrëve administrative dhe mjedisit të biznesit .....</b>	<b>172</b>
<b>Shtojca 8: Ekstrakt i barrëve administrative dhe temave të lidhura me mjedisin e biznesit nga Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) - nëntor, 2016.....</b>	<b>178</b>
<b>Shtojca 9: Raport nga vizita studimore në Belgjikë dhe në Holandë në maj 2018 .....</b>	<b>180</b>
<b>Shtojca 10: Raport nga trajnimi për e-Qeverisje në Estoni në qershor 2018 .....</b>	<b>189</b>
<b>Shtojca 11: Raporti i vizitës studimore në Gjermani.....</b>	<b>192</b>
<b>Shtojca 12: Formulari i vlerësimit për ndikimet ekonomike .....</b>	<b>221</b>
<b>Shtojca 13: Formulari i vlerësimit për ndikimet shoqërore.....</b>	<b>226</b>
<b>Shtojca 14: Formulari i vlerësimit për ndikimet mjedisore .....</b>	<b>230</b>
<b>Shtojca 15: Formulari i ndikimeve në të drejtat themelore .....</b>	<b>233</b>
<b>Shtojca 16: Rezultatet e detajuara të të bërit biznes për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor për vitet 2012 – 2018 .....</b>	<b>236</b>
<b>Shtojca 17: Përmbledhje e licencave dhe lejeve që duhet të thjeshtësohen, bashkohen ose hiqen në mënyrë që të përmbushet caku 10% siç përcaktohet në Kontratën e Mbështetjes Buxhetore Sektoriale.....</b>	<b>246</b>

## Lista e Figurave

Figura 1- Tabela Përmbledhëse e Koncept Dokumentit .....	11
Figura 2 - Programi për Reforma në Ekonomi Masa #11 .....	15
Figura 3 - KASH 2019-2021, parashikimi i pjesëmarrjes së komponentëve në rritjen e BPV-së .....	18
Figura 4 - Zvogëlimi i Barrës Administrative si program i përgjithshëm për rivlerësimin e kornizës ligjore.....	19
Figura 5 - IHD-të si përqindje e BPV-së (Banka Botërore) .....	23
Figura 6 - Renditja e të Bërit Biznes për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor për vitet 2012-2018.....	24
Figura 7 - Pikët e Kosovës në të Bërit Biznes të Bankës Botërore 2019 .....	25
Figura 8 - Prezantimi Grafik i Modelit të Kostimit Standard .....	26
Figura 9 - MKS dhe supozimet e pajtueshmërisë së plotë .....	27
Figura 10 - Vendosja e normës në legjislacionin kombëtar .....	28
Figura 11 - Pema e problemit që tregon shkaqet dhe efektet e barrës së panevojshme administrative.....	29
Figura 12 - Task Forca holandeze për tekste dhe dokumente të qarta.....	31
Figura 13 - Sigurimi i publikimit dhe konsolidimit konsistent të të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore dhe zvogëlimi i barrës administrative .....	32
Figura 14 - Fragment nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin e Zbatueshëm në Kosovë .....	33
Figura 15 - Barrët administrative si burim i rasteve gjyqësore për një mbingarkesë të sistemit gjyqësor .....	35
Figura 16 - Përshkrimi i politikave përkatëse ekzistuese dhe kornizës ligjore .....	38
Figura 17 - Palët e interesuara të lidhura me dhe/ose të prekura nga barrët administrative.....	39
Figura 18 - Katër treguesit për vlerësimin e progresit të arritur sipas Objektivit Specifik 1.1 nga Strategjia e Rregullimit më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021 .....	41
Figura 19 - Strategjitë që synojnë në mënyrë specifike përmirësimin e rritjes ekonomike, klimën e investimeve dhe të bërit binesit, si dhe krijimin e vendeve të punës .....	43
Figura 20 - Pozicionet e partive politike të përfaqësuara në Parlament në lidhje me rritjen ekonomike dhe zvogëlimin e barrës administrative gjatë zgjedhjeve të vitit 2017.....	44
Figura 21 - Pozicionet e partive politike të përfaqësuara në Parlament në lidhje me rritjen ekonomike dhe zvogëlimin e barrës administrative gjatë zgjedhjeve të vitit 2019.....	46
Figura 22 - Fragmente nga raportet e BE-së të viteve 2014, 2015, 2016, dhe 2018 për Kosovën dhe Agjendën për Reforma Evropiane 2016, duke i referuar veçanarisht barrëve administrative dhe mjedisit të të bërit biznes... ..	48
Figura 23 - Metodologjia për vlerësimin e zvogëlimit të barrës administrative për Treguesin 5.3 të Kontratës për Reformë Sektoriale për Reformë të Administratës Publike .....	51
Figura 24 - Zvogëlimi i barrës administrative kontribuon në një varg të OZhQ-ve siç paraqitet në tabelën më poshtë .....	52
Figura 25 - Përmbledhja dhe origjina e objektivave, masave dhe referencave të Qeverisë që (in-) direkt prekin zvogëlimin e barrës administrative .....	54
Figura 26 - Barra e matur dhe/ose e vlerësuar administrative për kompanitë në Holandë .....	58
Figura 27 - Qeveritë holandeze 2000-2018 dhe angazhimi i tyre në zvogëlimin e barrës administrative.....	59

Figura 28 - Numri i përgjithshëm i ligjeve primare dhe akteve nënligjore në Holandë në vitin 1980, 2004 dhe 2018 .....	60
Figura 29 - Çështjet kryesore nga propozimi i Qeverisë holandeze për zvogëlimin e barrëve administrative duke trajtuar si 'rrjedhën' ashtu dhe 'stokun' e legjislacionit .....	62
Figura 30 - Grupet e synuara të qytetarëve siç përcaktohen nga Qeveria Holandeze .....	66
Figura 31 - Ankesat më të zakonshme të qytetarëve holandez në lidhje me administratën në vitin 2007 .....	67
Figura 32 - Formularët, kuptueshmëria dhe shkalla e gabimeve .....	68
Figura 33 - Mënyrat e konsultimit të bizneseve në Holandë për zvogëlimin e barrës administrative .....	69
Figura 34 - Aktivitet e Actal 2000-2017 .....	71
Figura 35 - Llojet e kërkesave shtesë (gold plating) .....	73
Figura 36 - 13 fushat prioritare të mbuluara nga Programi i Veprimit për Zvogëlimin e Barrës Administrative në BE .....	74
Figura 37 - Metodot e përdorura nga Zyra Federale e Statistikave për përcaktimin e matjes bazë për barrët administrative .....	76
Figura 38 - Ligjet ombrellë për zvogëlimin e barrëve administrative .....	78
Figura 39 - Panelet e akterëve të organizuara në Gjermani .....	78
Figura 40 - Masat më të rëndësishme të zvogëlimit të barrëve administrative në Gjermani 2006 – 2012 .....	79
Figura 41 -Destatis si ofrues i shërbimit për matjet e MKS-së .....	79
Figura 42 - Vëzhgimet që rezultojnë nga matja bazë .....	80
Figura 43 - Zhvillimet në nivelet e barrëve administrative në Gjermani ndërmjet viteve 2012 dhe 2017 .....	80
Figura 44 - Ligji për Qasje Online në Gjermani .....	81
Figura 45 - Zhvillimi i barrëve administrative në Gjermani ndër vite .....	82
Figura 46 - Pasqyrim i zgjedhjeve të zbatimit për programet e zvogëlimit të barrës administrative .....	83
Figura 47 - Përmbledhje e parakushteve për zbatimin e suksesshëm të një programi për zvogëlimin e barrëve administrative .....	85
Figura 48 - Aktivitetet që duhen ndërmarrë në kuadër të programit të zvogëlimit të barrës administrative .....	91
Figura 49 - Ligjet në fushëveprimin e programit të zvogëlimit të barrës administrative sipas opsioneve të ndryshme .....	100
Figura 50 - Vlerësimi i përfitimeve ekonomike të zvogëlimit të barrës administrative .....	102
Figura 51 - Rënia e pritshme e zvogëlimit ekonomikisht të rëndësishëm të barrës administrative sipas skenarit për një periudhë 10-vjeçare .....	104
Figura 52 - Ndryshimet e pritshme në rritjen ekonomike sipas opsionit krahasuar me skenarin bazë .....	105
Figura 53 - Vlerësimi i distancës së udhëtuar me veturë bazuar në supozimin se një e treta e popullatës së rritur udhëton një herë në vit lidhur me barrët administrative në 'qendër' të komunës .....	107
Figura 54 - Konsumi i letrës nga të gjitha organet administrative për periudhën prej 3 viteve .....	109
Figura 55 - Konsideratat e ndikimit mjedisor për matjen bazë dhe vlerësimin e ndikimit të zvogëlimit të barrës .....	109
Figura 56 - Rritja e pritshme në të ardhurat e qeverisë si rezultat i rritjes ekonomike për çdo opsion në vit .....	111



Figura 57 - Buxheti, të ardhurat dhe përqindja e shpenzimeve në të ardhurat totale të Agjencisë për Produkte Medicinale të Kosovës.....	111
Figura 58 -Buxheti, të ardhurat dhe përqindja e shpenzimeve në të ardhurat totale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës.....	111
Figura 59 - Ekstrakt nga Nota Udhëzuese Kanadeze mbi fuqizimin ekonomik të grave në lidhje me proceset administrative .....	113
Figura 60 - Ndikimet kryesore të identifikuara për çdo kategori .....	114
Figura 61 - Përmbledhje e aktiviteteve të brendshme, të synuara dhe të konsultimit publik në vitet 2018 dhe 2019.....	116
Figura 62 - Objektivat specifike dhe aktivitetet e përbashkëta të integruara në Planin e Zbatimit për çdo opsion .....	122
Figura 63 - Plani i Zbatimit për Opsionin 2 .....	128
Figura 64 -Plani i Zbatimit për Opsionin 3 .....	138
Figura 65 -Proceset administrative që duhet të mbulohen përmes programit të zvogëlimit të barrës administrative .....	150
Figura 66 - Metoda e krahasimit: Analiza Shumëkriterëshe .....	152
Figura 67 - Problemet e identifikuara nga bizneset gjatë takimeve në konferencat rajonale .....	159
Figura 68 - Problemet e identifikuara nga bizneset gjatë konferencës.....	161

## Lista e Shkurtesave

<b>Koordinatorët e ZBA-së</b>	Koordinatorët për Zvogëlim të Barrës Administrative
<b>ShShAP</b>	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
<b>BRE</b>	UK Better Regulation Executive (Ekzekutivi i Mbretërisë së Bashkuar për Rregullim më të Mirë)
<b>SRM</b>	Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021
<b>CBA</b>	Analiza e kosto-përfitimeve
<b>KD</b>	Koncept Dokumenti
<b>DIEKP</b>	Departamenti i Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Politikave në kuadër të Ministrisë
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>EGA</b>	Akademia për e-Qeverisje e Estonisë
<b>ERA</b>	Agjenda e Reformave Evropiane
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>IHD</b>	Investimet e Huaja Direkte
<b>PVPQ</b>	Plani Vjetor i Punës i Qeverisë
<b>SKQ</b>	Sekretariati Koordinues i Qeverisë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës
<b>IFC</b>	Korporata Ndërkombëtare Financiare
<b>PHIP</b>	Planifikimi i Hershëm Indikativ i Punës
<b>IO</b>	Informatat e Obligueshme
<b>TI</b>	Teknologjia Informative
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>OEK</b>	Oda Ekonomike e Kosovës
<b>KIESA</b>	Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë
<b>IKAP</b>	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
<b>KPK</b>	Klubi i Prodhuesve të Kosovës
<b>DL</b>	Departamenti Ligjor në kuadër të Ministrisë
<b>LPPA</b>	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
<b>ZL</b>	Zyra Ligjore në kuadër të zyrës së Kryeministrit të Kosovës
<b>AShK</b>	Analiza Shumëkriterëshe
<b>MIE</b>	Ministria e Integritimit Evropian
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

<b>MFT</b>	Ministria e Financave dhe Transfereve
<b>MPBAP</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
<b>KASH</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
<b>MEPTINIS</b>	Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë, Investimeve Strategjike
<b>AKSHI</b>	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit e Shqipërisë
<b>KKZHE</b>	Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik
<b>NKR</b>	Nationaler Normenkontrollrat (Këshilli Kombëtar i Kontrollit Rregullator - Gjermani)
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillim Ekonomik
<b>ZQM</b>	Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>RAP</b>	Reforma e Administratës Publike
<b>ZKP</b>	Zyra për Komunikim me Publikun në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës
<b>PISA</b>	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve
<b>ZKSH</b>	Zyra e Kryeministrit të Shqipërisë
<b>K dhe Zh</b>	Kërkimi dhe Zhvillimi
<b>MBS</b>	Mbështetja Buxhetore Sektoriale
<b>MKS</b>	Modeli i Kostimit Standard
<b>OZhQ</b>	Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
<b>Sida</b>	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
<b>NVM</b>	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
<b>ZPS</b>	Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës
<b>AT</b>	Asistenca Teknike
<b>TpT</b>	Programi i Trajnimit për Trajnerë
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## Hyrje

Në figurën e mëposhtme është paraqitur një përmbledhje lidhur me organizatën përgjegjëse, personat kontaktues dhe pozitën e Koncept Dokumenteve në kuadër të kornizës së politikave strategjike.

Qeveria miratoi këtë Koncept Dokument (tutje 'KD') me qëllim që të tregojë përkushtimin e Kosovës për zvogëlimin e barrës administrative, në përputhje me detyrimet kontraktuale të dakorduara me Komisionin Evropian në Kontratën Sektoriale të Buxhetit. Ky KD përcakton qëllimin e përgjithshëm dhe qasjen e përgjithshme për krijimin e politikës për zvogëlimin e barrës administrative në Kosovë.

Politika për zvogëlimin e barrës do të bëhet pjesë e pandashme e vendimmarrjes së Qeverisë dhe procesi i zhvillimit të politikave përmes ngritjes së kapaciteteve dhe vlerësimit ex-ante të ndikimit (aktualisht të njohura si Koncept Dokumente) për të zhvilluar masat për zvogëlimin e barrës. Strategjia për Rregullim më të Mirë do të përditësohet dhe e njëjta do të pasqyrojë aktivitetet praktike dhe objektivat e ndërmjetëm për të arritur objektivin e zvogëlimit prej 30%. Në bashkëpunim me partnerët e zhvillimit, do të kërkohen fonde shtesë për programin e gjerë për zvogëlimin e barrës.

Figura 1- Tabela Përmbledhëse e Koncept Dokumentit

Titulli	Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative
<b>Organi Përgjegjës</b>	Zyra e Kryeministrit – Sekretariati Koordinues Qeveritar (drejtues) Zyra e Kryeministrit – Zyra Ligjore (bashkë drejtuese)
<b>Personat kontaktit</b>	Arben Krasniqi – Drejtor i SKQ-së Mentor Borovci – Drejtor i ZL-së
<b>PVPQ</b>	PVPQ 2019 (numri i aktivitetit specifik do të shtohet pas miratimit të PVPQ-së për 2019)
<b>Prioriteti strategjik</b>	Po, hartimi i këtij Koncept Dokumenti është paraqitur në Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021. Koncept Dokumenti ndërlidhet me një varg prioritetesh strategjike të Qeverisë, siç është Integrimi Evropian. Kjo është shpjeguar në detaje në 'Kapitullin 2: Objektivat'.
<b>Grupi Punues</b>	Grupi Punues përbehet prej anëtarëve që përfaqësojnë institucionet vijuese: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kabinetin e Kryeministrit</li> <li>• Kabinetin e Zëvendës Kryeministrit,</li> <li>• Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, ZKM</li> <li>• Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, ZKM</li> <li>• Zyrën Ligjore, ZKM</li> <li>• Zyrën për Planifikim Strategjik, ZKM</li> <li>• Zyrën për Komunikim me Publikun, ZKM</li> <li>• Zyrën për Buxhet dhe Financa, ZKM</li> <li>• Agjencinë e Statistikave të Kosovës, ZKM</li> <li>• Departamentin Ligjor, MTI (<i>tani MEPTINIS</i>)</li> <li>• Agjencinë për Promovim të Investimeve, MTI (<i>tani MEPTINIS</i>)</li> <li>• Departamentin Ligjor, MAP (<i>tani MPBAP</i>)</li> <li>• Departamentin Ligjor, MIE</li> <li>• Departamentin e Makro ekonomisë, MF (<i>tani MFT</i>)</li> <li>• Odën Ekonomike të Kosovës (OEK)</li> <li>• Anëtarët nga 'Projekti për Mbështetjen e Zhvillimit të Politikave' në kuadër të ZKM-së</li> </ul>

	Përmbledhja e plotë e anëtarëve është paraqitur në Shtojcën 1.
<b>Infomacione shtesë</b>	Miratimi i këtij Koncept Dokumenti është listuar si Treguesi 5.2 në 'Kontratën e Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike' dhe miratimi i saj është planifikuar për vitin 2019. Kontrata e reformës dhe Marrëveshja Financiare e lidhur me të ka hyrë në fuqi më datë 15 dhjetor 2017.

**Vëmendje:** Ju lutem keni parasysh se grupi punues është themeluar me Vendim në vitin 2018 dhe pjesa më e madhe e analizës, përfshirë shtojcat, janë hartuar gjatë viteve 2018, 2019. Andaj, në disa pjesë edhe emërtimi i Ministrive është ndryshe nga ai pas Vendimit të legjislaturës së VII të Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

## Kapitulli 1: Përkufizimi i Problemimit

Zhvillimi ekonomik i Kosovës varet nga një numër faktorësh. Ata janë të ndryshëm, duke filluar nga atraktiviteti i vendit për investime të huaja direkte (IHD) e deri tek zhvillimi i aftësive të fuqisë ekzistuese punëtore dhe arritjet arsimore të gjeneratave të ardhshme. E rëndësishë së veçantë është korniza e politikave dhe mjedisi ligjor në të cilin bizneset mund të zhvillohen dhe investojnë. Kësaj i referohemi edhe si klima e biznesit dhe/ose investimeve.

Një faktor i rëndësishëm që përcakton cilësinë e klimës së biznesit/investimeve është mënyra në të cilën zhvillohen politikat dhe rregulloret, si dhe cilësia e tyre. Ligjet e mira dhe aftësia për t'i zbatuar ato janë të rëndësishme thelbësore<sup>1</sup>.

Ky Koncept Dokument adreson në veçanti çështjen e përmirësimit të cilësisë së legjislacionit në lidhje me efikasitetin e zbatimit të kërkesave ligjore ekzistuese. Kjo përfshinë si cilësinë e dispozitave ligjore, që sigurojnë bazën për zbatimin e tyre, ashtu dhe aranzhimet e zbatimit si të tilla. Praktika më e mirë ndërkombëtare, e shpjeguar më në hollësi tutje në këtë dokument, është që të përmirësohet cilësia e legjislacionit për të nxitur rritjen ekonomike.

### 1.1 Reforma e Administratës Publike dhe Mbështetja Buxhetore Sektoriale

Ky Koncept Dokument bazohet në qasjet aktuale për zvogëlimin e barrës administrative dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve. Objektivat e Qeverisë janë përcaktuar në strategji të ndryshme, disa prej të cilave janë integruar në Kontratën e Mbështetjes Buxhetore Sektoriale që u nënshkrua me Komisionin Evropian. Ky KD nuk ndërhyn në strukturat aktuale të politikave, në përgjegjësitë e politikave dhe zgjedhjet e politikave. Ai krijon bazën për zhvillimin e një programi të gjerë për zvogëlimin e barrës administrative, i cili pritet të fillojë plotësisht që nga viti 2021 e më tej, pasi të skadojë kontrata e tanishme e MBS-së. Viti 2020 do të përdoret për të përgatitur strukturat menaxhuese të kërkuara për zbatimin e një programi ambicioz të zvogëlimit. Ky KD shpjegon se pse nevojitet një kohë e tillë për t'u përgatitur për një politikë gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e barrës administrative, meqë kapacitetet për një program të tillë duhet të zhvillohen, duhet të krijohet një matje bazë dhe procedurat e vendimmarrjes së administratës duhet të përafrohen me një program të tillë.

### 1.2 Sfidat ekonomike të Kosovës

Sfidat kryesore ekonomike të Kosovës janë papunësia e lartë - veçanërisht papunësia e të rinjve dhe aktiviteti i ulët ekonomik i grave; niveli i lartë i ekonomisë jo formale; kostoja e lartë e jetesës dhe barrës rregullatore. Zvogëlimi i barrës administrative do të adresonte këto sfida drejtpërdrejt duke kontribuar në rritjen ekonomike, zhvillimin e biznesit dhe krijimin e vendeve të punës.

### 1.3 Papunësia e madhe

Papunësia në Kosovë është më e larta në rajon - 26.5%<sup>2</sup>, dhe përafërsisht më shumë se tri herë më e lartë se mesatarja në BE<sup>3</sup>. Shifrat e papunësisë të viteve të fundit tregojnë një ndryshim të madh në shkallën e papunësisë - nga 33.1% sa ka qenë në vitin 2014, 32.9% në vitin 2015, 27.5% në vitin 2016 dhe 30.4% në vitin

<sup>1</sup> OECD (2014), "Krijimi i një mjedisi për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm", në Raportin e Bashkëpunimit Zhvillimor për vitin 2014: Mobilizimi i Resurseve për Zhvillim të Qëndrueshëm, Publikim i OECD-së, Paris, faqe 149.

<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës – Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 2018, faqe 12  
<http://ask.rks-gov.net/media/4103/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-tm1-2018.pdf>

<sup>3</sup> Komisioni Evropian - 2018 Komunikata për Politikën e BE-se për Zgjerimin, Shtojca II, faqe 2.  
[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417\\_strategy\\_paper\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417_strategy_paper_en.pdf).

2017 në 26.5% në tremujorin e parë të vitit 2018<sup>4</sup>. Nuk ka rritje të vazhdueshme të punësimit, që do të thotë se rritja ekonomike e Kosovës nuk përkthehet vazhdimisht në krijim të vendeve të punës<sup>5</sup>. Ndryshimi në shifrat e papunësisë është potencialisht një shenjë (1) që punëkërkuessit heqin dorë nga kërkimi për vende të punës, pasi që nuk presin të gjejnë punë, dhe (2) që njerëzit po largohen nga vendi për të gjetur punë jashtë vendit.

Niveli më i lartë i papunësisë është në mesin e grave, të rinjve dhe personave të pakualifikuar që duan të jenë ekonomikisht aktiv.

Nga 16.6% e grave që janë ekonomikisht aktive në Kosovë, niveli i papunësisë është 28.7%. Numri i ulët i grave ekonomikisht aktive mbetet një sfidë në vetvete<sup>6</sup>. Papunësia e të rinjve është 54% në përgjithësi, por arrin në 62.7% për gratë e reja<sup>7</sup>.

48.4% e qytetarëve ekonomikisht aktiv të paarsimuar janë të papunë, krahasuar me 35.1% të atyre me arsim fillor dhe 21% të atyre me arsim të mesëm të përgjithshëm<sup>8</sup>. Niveli i mosaktivitetit ekonomik është më i lartë në zonat rurale sesa në ato urbane<sup>9</sup>.

Në aspektin afatgjatë, niveli i papunësisë në Kosovë parashikohet të mos ulet ndjeshëm dhe pritet të ketë një trend prej rreth 24% deri në vitin 2020<sup>10</sup>.

Normat e larta të papunësisë në Kosovë janë, mes tjerash, si rezultat i një mjedisi të dobët biznesi dhe rregullator që nxit informalitetin. Kjo pengon rritjen e firmave dhe të produktivitetit të burimeve të kapitalit dhe të punës<sup>11</sup>.

## 1.4 Niveli i lartë i ekonomisë joformale

Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) 2019-2021 thekson sfidën me të cilën përballet Kosova në lidhje me sektorin informal<sup>12</sup>. Derisa ekonomia informale vlerësohet të jetë zvogëluar, ajo konsiderohet ende si një pengesë e madhe dhe e rëndësishme. Një studim i kohëve të fundit<sup>13</sup> vlerësoi madhësinë e ekonomisë informale (gri dhe të zezë) në vitin 2015 në 32% të BPV-së, e cila është dukshëm më e ulët se 43% e BPV-së e vlerësuar për vitin 2013 në një metodologji të krahasueshme<sup>14</sup>.

Efektet e shkaktuara nga kjo madhësi e konsiderueshme e ekonomisë informale kanë ndikime të qarta negative. Vlera e taksave të drejtpërdrejta të painkasuara u vlerësua në 107 milionë euro ose 1,8% të BPV-së. Ekonomia informale është identifikuar si një sfidë kryesore në Gjendjen e Konkurrencës, veçanërisht në lidhje me 'mbledhjen e tatimit'. Sektori informal gjithashtu nënkupton se punësimi nuk është pasqyruar plotësisht pasi informaliteti zvogëlon numrin e vendeve formale të punës.

Në vitet 2016 dhe 2017, rritja mesatare e të ardhurave tatimore tejkaloi rritjen nominale ekonomike dhe vjeljet neto pozitive nga ndryshimet e politikës tatimore, duke treguar një tkurrje të mëtejshme të hendekut tatimor. Megjithatë, kërkohen masa të mëtejshme për të rritur më tej mobilizimin e të ardhurave vendore dhe për të

<sup>4</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës – Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë për vitet nga 2014 deri në 2018. Në dispozicion në linkun: <http://ask.rks-gov.net/>

<sup>5</sup>Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore – Diagnostikimi i Punëve në Kosovë 2017, faqe 7

<sup>6</sup><http://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview#3>, e vizituar herën e fundit më 13 Gusht 2018.

<sup>7</sup>Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë, TM1 2018, faqe 12.

<sup>8</sup>Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë, TM1 2018, faqe 26.

<sup>9</sup>Diagnostikimi i vendeve të punës në Kosovë, faqe 31.

<sup>10</sup><https://tradingeconomics.com/kosovo/unemployment-rate/forecast>, e vizituar herën e fundit më 10 Gusht 2018.

<sup>11</sup>Diagnostikimi i vendeve të punës në Kosovë, faqe 2.

<sup>12</sup><https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4FC9C8D0-8ADF-4DD1-97B8-BB2DD36150C3.pdf>

<sup>13</sup>“Vlerësimi i shtrirjes së ekonomisë informale në Kosovë”, raport i projektit të financuar nga BE-ja “Mbështetja e mëtejshme për institucionet e Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm”, 9 nëntor 2017.

<sup>14</sup>Anketa mbi shtrirjen dhe parandalimin e ekonomisë së paligjshme dhe pastrimit të parave në Kosovë, raport i projektit të financuar nga BE-ja “Forcimi i kapacitetit të Kosovës për të luftuar pastrimin e parave dhe korrupsionin”, 2014.

siguruar kushte të barabarta për të gjithë përmes formalizimit të shtuar, duke përfshirë një administratë tatimore më të bazuar në performancë, e cila nxit pajtueshmërinë vullnetare dhe adreson mbizotërimin e borxheve të tepërta tatimore.

Figura 2 - Programi për Reforma në Ekonomi Masa #11

#### Masa #11: Zvogëlimi i Ekonomisë Joformale

Qëllimi i masës është përmirësimi i sundimit të ligjit dhe qeverisjes ekonomike në Kosovë si pengesë për rritjen ekonomike dhe gjenerimin e punësimit formal. Kjo masë është pjesë e masave më të gjera të politikave që qeveria e Kosovës po planifikon të ndërmarrë përmes Strategjisë kundër ekonomisë informale.

Zvogëlimi i ekonomisë informale është një masë kyçe e reformës e theksuar në PRE 2019-2021. Zvogëlimi i barrës administrative do të kontribuojë në zvogëlimin e ekonomisë informale siç tregohet në Masën #7 të Reformës në PRE, e cila përcakton miratimin e këtij Koncept Dokumenti për zvogëlimin e barrës administrative në vitin 2019 dhe fillimin e programit aktual të zvogëlimin në përputhje me caqet e përcaktuara në këtë Koncept Dokument. PRE 2019-2021 konfirmon kështu qëllimin për të vendosur programin e gjerë të zvogëlimin të barrës administrative pas periudhës aktuale kontraktuale për Programin e BE-së për Mbështetjen Buxhetore Sektoriale.

## 1.5 Kostoja e lartë e jetesës

Situata e bazuar në një analizë të kostos së jetesës, krahasuar me të ardhurat mesatare mujore në një vend tregon se Kosova është një nga vendet e pakta në zhvillim ku kostoja e jetesës është veçanërisht e lartë dhe ku fuqia blerëse është shumë e ulët<sup>15</sup>. Kjo e bën më të vështirë përmirësimin e jetesës së njerëzve që jetojnë në varfëri. Mënyrat kryesore për të përmirësuar gjendjen e popullit të Kosovës bazohen në një zhvillim më të madh ekonomik, i cili duhet të çojë në (1) më shumë vende pune dhe paga më të larta dhe (2) në përmirësimin e tregjeve për mallra dhe shërbime përmes rritjes së konkurrencës. Përmirësimi i klimës së biznesit / investimeve do të kontribuonte drejtpërdrejtë në këto dy zhvillime. Rrjedhimisht, përmirësimi i cilësisë dhe zbatimit të detyrimeve ligjore do të shtojë rritjen ekonomike dhe zhvillimin e biznesit.

## 1.6 Barra rregullatore me të cilat ballafaqohen bizneset dhe investitorët

Barra rregullatore janë një faktor i rëndësishëm që kompanitë e marrin në konsideratë kur vendosin që të investojnë apo jo në Kosovë.

### 1.6.1 Analizë nga Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë.

Në raportin e saj të vitit 2014 mbi 'Perceptimet e Investitorëve për Mjedisin e Biznesit të Kosovës', KIESA thekson se pothuajse të gjithë investitorët potencialë e konsiderojnë *Sundimin e Ligjit dhe Rregullimin*, si faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në marrjen e vendimit për lokacionin e investimeve të tyre (97%), ndërsa shumica e investitorëve aktualë poashtu e marrin në konsideratë të njëjtën kur shqyrtojnë investimet e mëtutjeshme (84%). Kur u pyetën se çfarë mund të bëjë Qeveria e Kosovës për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për ta bërë vendin më miqësor ndaj investitorëve, 100% e investitorëve aktualë dhe potencialë të anketuar janë pajtuar se është e një rëndësie thelbësore që të luftohet korrupsioni në mënyrë më efikase. Aspekti i dytë më i rëndësishëm që investitorët aktual preferonin të trajtohet ishte de-burokratizimi i përgjithshëm dhe heqja e burokracisë (shiritit të kuq), ku 74% e të anketuarve e konsideronin këtë si shumë të rëndësishme.<sup>16</sup>

<sup>15</sup> <https://www.laenderdaten.info/lebenshaltungskosten.php>, e vizituar herën e fundit më 31 Korrik 2018.

<sup>16</sup> <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/6E44ECB3-AD24-4F7A-8623-6240A226E484.pdf>.



Këto shifra nënvizojnë nocionin se cilësia e kuadrit ligjor dhe zbatimi i tij janë përcaktuese mbi atë nëse investimet do të bëhen në Kosovë, do të drejtohen diku tjetër ose nëse do të ketë investime fare.

KIESA gjithashtu ka organizuar në baza vjetore takime dhe konferenca me bizneset në Kosovë. Në raportet e saj lidhur me këto konferenca për vitin 2016 dhe 2017 (shih Shtojcat 3 dhe 4), barrët e shkaktuara nga licencat dhe lejet, si dhe procedurat e tjera administrative renditen si relevante në pengimin e zhvillimit të biznesit.

### 1.6.2 Analizë nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe RIINVEST

Në edicionin e katërt të raportit 'Trasimi i rrugës për biznes më të mirë në Kosovë' të vitit 2018, Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) thekson se çertifikimi, licencimi dhe standardizimi ende mbeten sfida për prodhuesit kosovarë. Përmirësimet në këtë fushë do t'u mundësonin kompanive të kenë qasje më të lehtë në tregun evropian dhe konkurrueshmëri më të mirë me produktet e tyre.

Për më tepër, licencat e eksportit dhe importit janë të një rëndësie të veçantë. Rreth 14 përqind e kompanive pjesëmarrëse në studimin e OEK-së, kryesisht prodhuese dhe të sektorit të shitjes me pakicë dhe shumica mikro ndërmarrje, përmendin këto licenca si problem.<sup>17</sup>

Në maj të vitit 2017, RIINVEST ka publikuar analizën e saj 'Klima e biznesit në Kosovë nga këndvështrimi i NVM-ve'. Kompanitë u anketuan në lidhje me pengesat më të rëndësishme që hasin gjatë zhvillimit të biznesit në Kosovë. Barrët administrative, të përcaktuara si 'procedura burokratike në të gjitha institucionet relevante', u dëshmuar të jenë një sfidë e madhe për kompanitë, duke u renditur në pozitën numër 7 nga 23 çështjet potenciale<sup>18</sup>. Ky faktor është matur për herë të parë dhe shumica e pikëve të listuara si më të rëndësishme nga kompanitë janë jashtë ndikimit të drejtpërdrejtë të Qeverisë (p.sh. tregu i vogël, krimi dhe vjedhjet dhe kostoja e financimit). Barrët administrative janë pra një nga disa sfidat me të cilat ballafaqohen bizneset, që qeveria mund të adresojë brenda një afati kohor relativisht të shkurtër.

## 1.7 Sundimi i Ligjit dhe barra administrative

Sundimi i mirëfilltë i ligjit është çelësi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik. Ai ndikon drejtpërdrejt në mjedisin e biznesit dhe klimën e investimeve, duke bërë që veprimet e qeverisë të jenë të parashikueshme, duke rritur llogaridhënien dhe sigurinë. Elementet kryesore të sundimit të mirëfilltë të ligjit janë: siguria ligjore, pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit dhe institucionet publike efektive dhe efikase.

Në kuadër të sundimit të ligjit, ligjet duhet të jenë:

- 1) të qasshme – publike dhe lehtësisht të qasshme,
- 2) të parashikueshme - të shkruara me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme për t'u mundësuar subjekteve të rregullojnë sjelljen e tyre në përputhje me të; dhe
- 3) të qëndrueshme dhe konsistente - ato duhet të ndryshohen vetëm përmes një debati dhe njoftimi publik, dhe duhet të përshtaten me rrethanat e ndryshuara të cilat nuk ndikojnë negativisht në pritjet legjitime të publikut.

Për më tepër, ligjet duhet të sigurojnë masa mbrojtëse kundër arbitraritetit dhe shpërdorimit të pushtetit, dhe të zbatojnë parimin e barazisë para ligjit dhe mos diskriminimit.

Siguria juridike ndikon pozitivisht në aplikimin dhe zbatimin e tij. Megjithatë, kjo nuk mund të sigurohet pa një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, i cili mundëson zgjidhjen transparente, me kohë dhe të parashikueshme

<sup>17</sup> <https://www.oek->

[kcc.org/uploads/files/2018/May/24/2017\\_PAVING\\_THE\\_WAY\\_FOR\\_BETTER\\_BUSINESS\\_IN\\_KOSOVO1527160828.pdf](https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2018/May/24/2017_PAVING_THE_WAY_FOR_BETTER_BUSINESS_IN_KOSOVO1527160828.pdf).

<sup>18</sup> RIINVEST, "Klima e biznesit në Kosovë nga këndvështrimi i NVM-ve, Maj 2017, faqe 33.

të mosmarrëveshjeve. Nevojiten gjithashtu institucione publike efektive dhe efikase për të fuqizuar bizneset në mënyrë që të kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik.<sup>19</sup>

Sundimi i ligjit është gjithashtu çelës për procesin e integritimit evropian. Kriteret e anëtarësimit në BE<sup>20</sup> theksojnë qartë se vendet candidate duhet të kenë institucione të qëndrueshme, që garantojnë sundimin e ligjit.<sup>21</sup> Raportet e fundit të Komisionit Evropian theksojnë sfidat e Kosovës në këtë aspekt.<sup>22</sup>

Zvogëlimi i barrës administrative lidhet drejtpërsëdrejti me përmirësimin e sundimit të ligjit, pasi rrit sigurinë ligjore përmes përmirësimit të cilësisë së ligjeve dhe akteve nënligjore; dhe pasi që kjo kontribuon në përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitet më të lartë të institucioneve publike përmes zbatimit më të mirë të kërkesave ligjore dhe procedurave administrative nëpërmjet të cilave ato zbatohen.

### 1.7.1 Niveli i barrës administrative në Kosovë

Aktualisht nuk ekziston ndonjë analizë e detajuar e nivelit të barrës administrative në Kosovë. Modeli i Kostimit Standard nuk është aplikuar në mënyrë sistematike për të matur barrën që shkaktohet nga Informatat e Obligueshme.

Nivelet e barrës administrative në vendet e Bashkimit Evropian ndryshojnë. Bazuar në shifrat e Holandës, barra administrative mund të jenë në nivelin prej 3.6% të BPV-së. Nuk është e mundur të vlerësohet nëse kjo përqindje vlen edhe për Kosovën.

Nga njëra anë, përshtypja është se procedurat dhe kërkesat ligjore janë shumë më të vështira për t'iu përmbajtur. Kjo do të jepte arsye për të supozuar se niveli i barrës administrative në Kosovë është më i lartë se 3.6% e PBB-së.

Nga ana tjetër, korniza ligjore në shtetet anëtare të BE-së është shumë më e zhvilluar dhe gjithëpërfshirëse. Këto korniza kanë integruar edhe të gjitha kërkesat e dala nga Acquis i BE-së. Kjo jep arsye për të supozuar se niveli i barrës administrative në Kosovë si përqindje e BPV-së është nën nivelin me të cilin Holanda u përball në fillim të programit të saj të zvogëlimit të barrës administrative.

## 1.8 Promovimi i rritjes gjithëpërfshirëse dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë globale

Vendet anëmbanë botës përmirësojnë dhe promovojnë ekonomitë e tyre për të nxitur ndërmarrësinë, zhvillimin e biznesit, investimet, inovacionin dhe rritjen gjithëpërfshirëse. Konkurrenca midis vendeve të ndryshme për të tërhequr investimet e huaja direkte, për të nxitur inovacionin brenda komunitetit të tyre të biznesit, për të zhvilluar një bazë të gjerë ekonomike për rritje e cila do të ishte në dobi të të gjithëve, ka qenë një trend i fortë ndërkombëtar për një kohë të gjatë<sup>23</sup>. OECD pranon në mënyrë të veçantë që *politikat kornizë* janë të rëndësishme kritike për dinamizmin e biznesit, për zhvillimin e kompanive të reja dhe të vogla dhe për krijimin e vendeve të punës. Këto politika synojnë të përmirësojnë mjedisin e biznesit dhe të nxisin marrjen e rrezikut dhe eksperimentimin ndërmarrës. Ato janë të rëndësishme kritike për dinamizmin e biznesit dhe për inkurajimin e potencialit për rritje të kompanive të reja dhe NVM-ve, veçanërisht në sektorët me rrezik të lartë, siç janë telekomunikacioni, kërkimi dhe zhvillimi shkencor (K dhe Zh) dhe shërbimet e TI-së. Fokusi është në kompanitë

<sup>19</sup> Pakti Global i Kombeve të Bashkuara, Seksioni - Nxitja e sundimit të ligjit për të mbrojtur qytetarët dhe bizneset <https://www.unglobalcompact.org/what-is-gc/our-work/governance/rule-law>, e vizituar për herë të fundit më 8 Janar 2019

<sup>20</sup> Kriteret e Kopenhagës

<sup>21</sup> Këshilli i Evropës në Kopenhagë, Konkluzionet e Presidencës, 1993, pika 7, A (iii).

<https://www.consilium.europa.eu/media/21225/72921.pdf>

<sup>22</sup> Ju lutem shihni Figura 14: Ekstraktet nga Raportet e BE-së të vitit 2014, 2015, 2016 dhe 2018 për Kosovën dhe Agjenda e Reformave Evropiane 2016, që i referohet në mënyrë specifike barrëve administrative dhe mjedisit biznesor.

<sup>23</sup> Shih, për shembull: OECD (2018), *Access to Justice for Business and Inclusive Growth in Latvia*, Botim i OECD-së, Paris.

më të vogla pasi ato zakonisht janë më të varura nga mjedisi i tyre i biznesit dhe janë më të cenueshme ndaj dështimeve të tregut, mosefikasitetit të politikave dhe mospërputhjeve<sup>24</sup>. Zvogëlimi i barrës administrative siguron kornizën për një politikë në nivel qeveritar - në përputhje me rekomandimet e OECD-së - që synon përmirësimin e mjedisit biznesor.

Në raportin e tij vjetor mbi NVM-të Evropiane, Komisioni Evropian ka theksuar se NVM-të po përballen me gjashtë probleme kryesore: (1) Gjetja e konsumatorëve; (2) Konkurrenca; (3) Qasja në financa; (4) Kostoja e prodhimit ose e punës; (5) Disponueshmëria e personelit të kualifikuar ose e menaxherëve me përvojë dhe (6) Rregullimi. Mes viteve 2013 dhe 2016, së paku 12% e NVM-ve kanë deklaruar se Rregullimi përmendet si çështje më urgjente<sup>25</sup>. Rregullimi në përgjithësi është çështja e tretë më e rëndësishme e përmendur.


Nga këta gjashtë faktorë të përmendur nga NVM-të Evropiane, Rregullimi është i vetmi faktor që është nën kontrollin e menjëhershëm të një qeverie. Me përjashtim të gjetjes së konsumatorëve, faktorët tjerë ndikohen nga politikat qeveritare, por ndikimi që mund të kenë politikat është shpesh në periudhë afatmesme dhe afatgjate. Adresimi i çështjes së Rregullimit siguron mbështetje për zhvillim ekonomik në periudhë afatshkurtër.

Hulumtimet në vendet tjera konfirmojnë analizat e kryera nga Komisioni Evropian dhe anketat kombëtare/rajonale mbi cilësinë e mjedisit të biznesit, si dhe pengesat më kryesore me të cilat përballen kompanitë. Për shembull, një anketë e biznesit e kryer nga Suomen Yrittäjät (Federata e Ndërmarrjeve Finlandeze) ka konfirmuar se 63% e NVM-ve Finlandeze do të prisnin të punësonin më shumë staf po të zvogëlohej konsiderueshëm barra rregullatore<sup>26</sup>.

## 1.9 Perspektiva ekonomike afatmesme

Rritja ekonomike në Kosovë pritet të vazhdojë të nxitet kryesisht nga konsumi privat dhe eksportet. Këta dy faktorë kanë nxitur rritjen edhe në vitet e fundit. Përveç kësaj, investimet publike dhe private pritet të luajnë një rol më të theksuar në rritjen e BPV-së. Për periudhën 2018-2021, rritja reale mesatare parashikohet të jetë 5.0%, duke filluar nga një vlerësim prej 4.6% për vitin 2018, 4.9% për vitin 2019, dhe duke tejkaluar normën prej 5.1% nga viti 2020 e tutje<sup>27</sup>. Për këtë Koncept Dokument, si bazë do të merret mesatarja e rritjes ekonomike prej 5%.

Figura 3 - KASH 2019-2021, parashikimi i pjesëmarrjes së komponentëve në rritjen e BPV-së



<sup>24</sup> OECD (2018), Mundësi për të gjithë: A Framework for Policy Action on Inclusive Growth, Botim i OECD-së, Paris, sidomos faqen 125.

<sup>25</sup> Komisioni Evropian (2017), Raporti Vjetor mbi NVM-të Evropiane 2016/2017, Fokusi në vetë-punësim – Rishikimi i Performancës së NVM-ve 2016/2017, faqe 23.

<sup>26</sup> <https://www.yrittajat.fi/suomen-yrittajat/tutkimukset/yrittajagallup-565023>, Uebfaqja është vizituar për herë të fundit më 23 Tetor 2018.

<sup>27</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021, faqe 23.

## 1.10 Përmirësimi i klimës së biznesit/investimeve: projektet e kaluara dhe aktuale

Janë realizuar disa projekte për përmirësimin e mjedisit rregullator ose janë ende në vazhdim e sipër. Këto janë paraqitur në seksionin më poshtë. Ato tregojnë se politika për zvogëlimin e barrës administrative duhet të marrë parasysh zhvillimet aktuale dhe strukturat e projekteve. Ato duhet të integrohen në mënyrë të efektshme në çdo program qeveritar të zvogëlimit të ngarkesës administrative. Për më tepër, një program i tillë do të siguronte një impuls të rëndësishëm politik i cili do të kontribuonte në zbatimin e suksesshëm të këtyre projekteve dhe në këtë mënyrë në arritjen e objektivave të Qeverisë. Është e rëndësishme të theksohet se projektet e të kaluarës dhe këto aktuale synojnë të ulin barrët për kompanitë, qytetarët dhe administratën. Ky është një faktor i rëndësishëm për krahasimin e opsioneve që paraqitet në Kapitullin 6.

## 1.11 Krijimi i Regjistrimit të Legjislacionit Dytësor (Zyra Ligjore në Kuadër të ZKM-së)

Në vitin 2010, Zyra Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit - me mbështetjen financiare të ofruar nga USAID-i - filloi me mbledhjen e gjithë legjislacionit dytësor të miratuar nga Qeveria dhe ministrat pas vitit 2000. Për shkak të numrit të madh të legjislacionit dytësor ( rreth 2000 akte) dhe duke pasur parasysh faktin se disa akte nënligjore janë nxjerrë në kohën kur nuk kishte ligje aktive që rregullonin fushat përkatëse, ishte e nevojshme të krijohej një regjistër që do të përfshinte të gjithë legjislacionin dytësor në fuqi. Gjatë analizës, legjislacioni dytësor (Rregulloret dhe Udhëzimet Administrative) që nuk ishin në pajtim me legjislacionin në fuqi, nuk janë përfshirë në Regjistër dhe prandaj pushuan së qeni të vlefshme.

Në vitin 2011, Qeveria nxori udhëzime për të shqyrtuar legjislacionin dytësor të miratuar nga Qeveria dhe ministrat. Gjatë këtij procesi, vëmendje e veçantë iu kushtua çështjeve të lidhura me treguesit e të Bërit Biznes të Bankës Botërore. Vëmendje e veçantë iu kushtua procedurave për regjistrimin e biznesit; licencave dhe lejeve; të drejtave pronësore dhe regjistrimit; qasjes në produktet dhe shërbimet financiare; taksave, investitorëve të huaj dhe mbylljes së një biznesi.

Shqyrtimi i legjislacionit dytësor është dizajnuar për t'iu përgjigjur tri pyetjeve që kanë të bëjnë me legjislacionin dytësor:

1. A është i nevojshëm?
2. A është i ligjshëm?
3. A është “miqësor” ndaj biznesit?

Çdo akt nënligjor që i ka kaluar këto tri pyetje ka mbetur në fuqi. Çdo akt që dështoi në dy pyetjet e para u shfuqizua. Ato akte që morën përgjigje pozitive për dy pyetjet e para, por nuk arritën të plotësonin pyetjen e tretë, iu dorëzuan Komisionit Qeveritar për shqyrtimin e akteve nënligjore.

Rezultati i shqyrtimit ishte se rreth 300 akte nënligjore janë shfuqizuar kur Qeveria e Republikës së Kosovës nxori Vendimin Nr. 08/35 të datës 01.09.2011, i cili më vonë është ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 06 / 81, të datës 27.06.2012. Aktualisht, me qëllim që legjislacioni dytësor të hyjë në fuqi, ai duhet të ngarkohet dhe të publikohet në Regjistrin e Legjislacionit Dytësor, i cili përditësohet rregullisht nga Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit<sup>28</sup>.

Figura 4 - Zvogëlimi i Barrës Administrative si program i përgjithshëm për rivlerësimin e kornizës ligjore

Duke pasur parasysh përvojën me këtë qasje që mund të përkufizohet si e krahasueshme me Gijotinën Rregullatore, Qeveria konsideron se kjo qasje nuk është më e nevojshme në Kosovë. Në vend të saj,

<sup>28</sup> Regjistri është në dispozicion këtu: <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/06/REGJISTR-I-AKTEVE-NENLIGJORE.-P%C3%ABrditesuar-m%C3%AB-11.06.2018.pdf>.

nevojitet qasje më efektive që adreson praktikata aktuale të zbatimit dhe Programi i Zvogëlimit të Barrës Administrative ofron qasje të këtillë të sofistikuar.

Programi i zvogëlimit të barrës i paraqitur në këtë Koncept Dokument do të shtjellojë gjithashtu ligjshmërinë e rregullave ekzistuese dhe zbatimin aktual ose mungesën e tyre. Të gjitha projektet dhe proceset që synojnë thjeshtëzimin duhet të futen nën ombrellën e këtij programi.

## 1.12 Ligji për Licencat dhe Lejet (Zyra Ligjore në kuadër të ZKM-së)

Kosova miratoi Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, i cili u publikua në Gazetën Zyrtare më 19 dhjetor 2013. Ligji përcakton parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet zvogëlimit të barrëve administrative. Bazuar në ligj, Qeveria ka nxjerrë Rregulloren nr. 06/2015 për Regjistrin Qendror për llojet e lejeve dhe licencave<sup>29</sup>.

Zyra Ligjore me mbështetje nga IFC - Banka Botërore, publikoi Regjistrin e Licencave dhe Lejeve. Botimi i vitit 2015 i regjistrit përmban 480 licenca dhe leje që janë lëshuar nga 24 institucione qendrore në 21 fusha të veprimtarisë ekonomike.

Më 21 nëntor 2018, ZKM me mbështetje nga IFC - Banka Botërore ka përditësuar regjistrin i cili është publikuar në faqen e internetit të ZKM-së. Është e kuptueshme që shifrat tregojnë se në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2018 numri i licencave është zvogëluar në 456. Licencat dhe lejet lëshohen nga 26 institucione qendrore në fushat e veprimtarisë ekonomike që përfshijnë lejet, licencat, certifikatat, autorizimet, regjistrimet dhe njohjet.

Në vazhden e këtij procesi, Zyra Ligjore e ZKM-së në bashkëpunim me IFC organizoi një konferencë ku u lansua versioni i përditësuar i Regjistrin Qendror të Lejeve dhe Licencave. Gjithashtu, janë ndërmarrë hapa në lidhje me një fushatë të ndërgjegjësimit për institucionet, qytetarët dhe bizneset në lidhje me ekzistencën e Regjistrin Qendror të Lejeve dhe Licencave dhe detyrimin e institucioneve, agjencive të pavarura dhe organeve të tjera për raportim në Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit për lejet e reja dhe ndryshimet në lejet dhe licencat ekzistuese, në përputhje me nenin 29 të ligjit nr. 04 / L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

Me qëllim të fillimit të procesit të zvogëlimit të barrës administrative, kontrata e MBS (SBS) me Komisionin Evropian përcakton qëllimin për të thjeshtuar, bashkuar ose shfuqizuar 10% të licencave dhe lejeve krahasuar me bazën (gjendjen fillestare) prej 480. Ky Koncept Dokument kontribuon në arritjen e këtij qëllimi pasi që përfshin një listë (shih Shtojcën 13) të licencave dhe lejeve që pritet të thjeshtohen, bashkohen ose shfuqizohen deri në vitin 2020.

## 1.13 Zbatimi i Ligjit për Procedurat e Përgjithshme Administrative (Ministria e Administratës Publike)

Ligji për Procedurat e Përgjithshme Administrative (LPPA) u miratua në qershor të vitit 2016 dhe hyri në fuqi një vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare, më 21 qershor 2017<sup>30</sup>. LPPA, parashikon zbatimin e parimeve për racionalizimin e procedurave administrative. Këto përfshijnë: Parimin e jo formalitetit dhe efikasitetit të procedurës administrative; Parimi i informimit dhe ndihmës aktive; Parimi i mospagimit të procedurës. Këto parime synojnë thjeshtësimin dhe përsheptimin e procedurave administrative, zvogëlimin e shpenzimeve të procedurave për të gjitha palët e interesuara, mbrojtjen efektive të interesit të qytetarëve dhe shoqërisë, krijimin e kushteve për pikën e vetme të kontaktit siç parashihet me ligj. Përveç kësaj, parimi "heshtja është

<sup>29</sup> Regjistri qendror për licencat dhe lejet: <https://lejelicenca.rks-gov.net/>

<sup>30</sup> Ligji Nr. 05 / L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>.

pëlqim" i parashikuar nga LPPA, i cili do të hyjë në fuqi në qershor të vitit 2019, do të aplikohet për shumicën e procedurave administrative, duke kontribuar më tej në procesin e racionalizimit.

LPPA lejon mundësinë për shmangie të domosdoshme nga rregullat e përgjithshme të procedurës administrative në fusha specifike me ligje të veçanta. Megjithatë, këto shmangie duhet të jenë në përputhje me parimet themelore të përshkruara në LPPA dhe nuk mund të ulin nivelin e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave ligjore të palëve, të dhëna nga LPPA.<sup>31</sup> Në këtë drejtim, ekziston nevoja për të harmonizuar ligjet specifike me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Si pjesë e Kontratës së Reformës Buxhetore Sektoriale me Bashkimin Evropian, është krijuar një tregues i veçantë për të siguruar harmonizimin e kornizës ligjore dhe procedurave ekzistuese administrative me ligjin. Treguesi përkatës MBS # 4 përcakton objektivat për 2018, 2019 dhe 2020 për harmonizimin e 15%, 30% dhe 60% të procedurave ekzistuese me LPPA<sup>32</sup>. Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për zbatimin e këtij treguesi<sup>33</sup>.

Në përputhje me angazhimin e planifikuar që harmonizimi prej 60% me LPPA i të gjitha procedurave administrative do të arrihet deri në vitin 2020, futja e objektivit të zvogëlimit të barrës administrative dhe programit përkatës të zbatimit, duhet të sigurojnë harmonizimin me këstin e fundit prej 40% të procedurave të nevojshme për zbatimin e LPPA-së pas vitit 2020. Ky 40% konsiderohet si një maksimum pasi mund të ndodhë që MPBAP siguron një normë të harmonizimit me LPPA-në mbi nivelin 60% të përcaktuar sipas MBS-së.

## 1.14 Thjeshtimi i inspektimeve (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë)

Inspektimet e qeverisë janë komponentë thelbësorë e një shteti modern rregullator. Inspektoratet janë organe të posaçme administrative të administratës shtetërore që kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e legjislacionit. Ato mund të konsiderohen si mekanizma kujdestarë që mbikëqyrin zbatimin e ligjit në praktikë. Për këtë qëllim, në Republikën e Kosovës janë themeluar një numër i inspektorateve të ndryshme, të cilat sigurojnë zbatimin e ligjeve në fushat që ato mbulojnë. Megjithatë, zbatimi i ligjeve në praktikë nuk është i lehtë. Zbatimi i ligjeve kërkon që institucionet të kenë një mandat të qartë, të jenë të organizuara mirë dhe përgjegjëse për punën që ato janë të detyruara ta kryejnë. Inspektimi i biznesit është një instrument i kërkuar për të siguruar përputhjen e bizneseve me kërkesat ligjore, siç janë: pagesa e plotë dhe me kohë e tatimeve, mbrojtja e mjedisit, shëndeti dhe siguria në punë, mbrojtja e të drejtave të konsumatorit dhe përputhshmëria me regjistrimin, certifikimin dhe standardet tjera të zbatueshme.

Nga perspektiva e reformës së të bërit biznes, procesi i inspektimit në Kosovë, si në shumicën e vendeve në zhvillim, shpesh konsiderohet si një pengesë për mjedisin e të bërit biznes. Procedurat e kryerjes së inspektimeve janë të rregulluara dobët dhe ndërmarrësit shpesh nuk kanë ide të qarta se cilat janë kompetencat e inspektorit gjatë kryerjes së një inspektimi dhe cilat janë përtej autoritetit të tij/saj. Mungesa e procedurave të qarta, të unifikuara dhe gjithëpërfshirëse i kanë lënë bizneset të hutuara dhe kanë bërë që ata të mos i mirëpresin inspektimet. Për më tepër, ndërmarrësit nuk janë në dijeni për obligimet dhe të drejtat e tyre, duke bërë që gjatë inspektimeve, inspektorët shpesh të veprojnë në mënyrë arbitrare dhe të marrin vendime dhe veprime të paligjshme, të keqpërdorin autoritetin e tyre, rrjedhimisht duke rezultuar në rritje të sjelljes jo të mirë dhe në pagesa jozyrtare. Këto të dhëna janë identifikuar në vlerësimet e shumta të bëra nga mekanizmat

<sup>31</sup> Neni 2 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 05 / L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

<sup>32</sup> Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II) 2014-2020, Shtojca IA Mbështetja Buxhetore e Marrëveshjes së Financimit për Programin e Veprimit për Kosovën për vitin 2016 - Pjesa II - Mbështetja Buxhetore Sektoriale, Kontrata e Reformave Sektoriale për Reformën e Administratës Publike, faqe 35.

<sup>33</sup> Po aty, faqe 36.



Zyra e Kryeministrit – Sekretariati Koordinues i Qeverisë: Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative – Heqja e Barrierave Burokratike ndërkombëtarë dhe lokalë, siç janë: Komisioni Evropian<sup>34</sup>, Banka Botërore<sup>35</sup>, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik<sup>36</sup>, Instituti GAP<sup>37</sup> ...etj.

Bazuar në të dhëna të tilla dhe domosdoshmërinë e reformave në këtë fushë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar procesin e reformës së përgjithshme të inspektimit duke diskutuar në nivel të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE)<sup>38</sup>, që më pas rezultoi me një Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës<sup>39</sup> për themelimin e Grupit Punues Ndërinstitucional, duke emëruar Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë si koordinator kryesor të këtij procesi që parasheh reforma organizative dhe rregullatore në fushën e inspektimeve. Ky proces reformimi u identifikua si një nga proceset më të rëndësishme qeveritare nga institucionet e Kosovës dhe u përfshi gjithashtu në të gjitha dokumentet strategjike.

#### **1.14.1 Inspektimet: Barra dhe bizneset**

Siç është theksuar në Koncept Dokumentin mbi inspektimet, arsyeja kryesore përse inspektimet rezultojnë të jenë barrë për bizneset, është për shkak të kohës së humbur dhe kostove të drejtpërdrejta. Në fakt, këto nuk janë arsyet më të rëndësishme, por janë më të lehtë për t'u identifikuar. Në një mënyrë, këto krijojnë bazë të mirë për identifikimin e barrëve të tjera (të cilat janë më të vështira për t'u identifikuar), siç janë: objektivat e përcaktuara keq, kërkesat e paqarta etj.

Të gjitha këto elemente kyçe e bëjnë sistemin e inspektimit jo vetëm barrë për bizneset, por një pengesë për politikën e investimeve dhe ndikojnë në (mos)krijimin e bizneseve të reja. Lloji i kostove të lidhura drejtpërdrejt me inspektimet dhe që paraqesin barrë për bizneset janë: koha e kërkuar për përgatitjen e tyre- kur inspektimet njoftohen paraprakisht - duke përfshirë kohën e kërkuar për të përgatitur dokumentacionin specifik; koha e shpenzuar nga stafi i biznesit ose menaxhmenti me inspektorët, gjatë së cilës kohë ata nuk mund të kryejnë detyra të tjera, dhe koha që nevojitet për aktivitete të tjera që dalin drejtpërdrejt nga procesi i inspektimit.

#### **1.15 Sfidat afatmesme të zhvillimit të politikave dhe legjislacionit**

Administrata përballet me një varg sfidash në lidhje me zhvillimin e politikave dhe legjislacionit në periudhën afatmesme. Për më tepër, duhet të adresohen mangësitë ekzistuese në kornizën ligjore, siç është mungesa e konsolidimit të teksteve ligjore dhe mangësitë në përkthime. Shtatë sfidat janë si më poshtë:

1. Vazhdimi i transpozimit të Acquis së BE-së;
2. Sigurimi i zbatimit të Acquis së BE-së dhe legjislacionit ekzistues;
3. Konsolidimi i kornizës ligjore ekzistuese;
4. Zbatimi i Ligjit për Procedurat e Përgjithshme Administrative;
5. Zbatimi i Ligjit për Licenca dhe Leje;
6. Zbatimi i Ligjit për Kundërvajtje;
7. Sigurimi i cilësisë së përkthimit në të gjitha gjuhët zyrtare dhe përmirësimi i përkthimit të akteve ligjore ekzistuese.

<sup>34</sup> Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën (ish Raporti i Progresit) për disa vite pasuese d.m.th. 2016, 2015, 2014, kanë identifikuar problemet e ndërlidhura me organe të ndryshme të inspektimit.

<sup>35</sup> Raportet specifike të inspektimit (2010 dhe azhurnuar në vitin 2012) të përgatitura nga firma konsulente "Jacobs & Associates" e angazhuar nga Banka Botërore.

<sup>36</sup> Raporti "Inspektoratet në Kosovë: organizimi dhe funksionimi" i publikuar në mars 2014 nga Instituti GAP - Prishtinë.

<sup>37</sup> Raporti "Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet inspektimeve të nivelit qendror dhe lokal" i publikuar në korrik 2015 nga Instituti GAP - Prishtinë.

<sup>38</sup> Takimi i dytë i KKZHE i mbajtur më 30 qershor 2015.

<sup>39</sup> Vendimi 05/138 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 22 mars 2017.

Është e qartë se këto sfida vënë kërkesa të konsiderueshme mbi administratën në lidhje me zhvillimin e politikave dhe sigurimin që korniza ligjore të jetë në përputhje me synimet e politikave. Zvogëlimi i barrës administrative do të siguronte një kërkesë shtesë që mund të shërbejë si një proces unifikues që lidh së bashku shtatë sfidat e paraqitura më lart. Fushëveprimi dhe shtrirja e zhvillimit të politikave dhe kërkesave të hartimit ligjor për administratën pritet që të shërbehen më së miri përmes një menaxhimi të unifikuar nën ZKM-në pasi që kjo pritet të ofrojë garancinë më të mirë për zbatimin e suksesshëm dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve.

## 1.16 Kosova në krahasim me vendet fqinje

Në rajon, Kosova krahasohet me vendet fqinje kur kompanitë (shumëkombëshe) përgatisin vendime për investime. Dy faktorë në veçanti luajnë rol në avantazhin e Kosovës: popullsia e saj e re dhe diaspora e saj e përkushtuar. Këto mund të ofrojnë avantazh konkurrues që mund të çojë në rritje të konsiderueshme ekonomike dhe krijim të vendeve të punës.

Pozicioni i Kosovës në rajon është paraqitur më poshtë duke u bazuar në dy faktorë: (1) fluksi hyrës i investimeve të huaja direkte (IHD) që përfaqësojnë atraktivitetin për investime të vendeve dhe besimin që investitorët kanë në një vend dhe (2) renditja në indeksin e Bankës Botërore të të bërit biznes që siguron mundësinë për të vlerësuar dhe krahasuar mjedisin rregullator në lidhje me atë se sa është korniza e tyre rregullatore miqësore ndaj biznesit.

### 1.16.1 IHD-të në krahasimin rajonal

Investimet e Huaja Direkte ndikojnë në rritjen ekonomike nëpërmjet transferimit të teknologjisë dhe "know-how". IHD-të gjithashtu ndikojnë në rritjen e konkurrencës dhe zhvillimin e bizneseve. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, rajoni i BP6 ka pasur një përqindje të konsiderueshme të IHD-ve në BPV-në e tyre gjatë viteve të fundit. Gjatë viteve 2004-2017, vendet e BP6 kanë shënuar një trend të ngjashëm të IHD-ve.

Figura 5 - IHD-të si përqindje e BPV-së (Banka Botërore)

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>Kosova</b>	1,5	3,6	9,1	12,5	9,4	7,1	8,4	8,0	4,5	5,3	2,7	5,3	3,6	4,6
<b>Shqipëria</b>	4,7	3,2	3,6	6,1	9,7	11,2	9,1	8,1	7,5	9,8	8,7	8,7	8,8	7,9
<b>Mali i Zi</b>	3,2	22,2	22,9	25,5	21,5	37,2	18,3	12,3	15,1	10,0	10,8	17,3	5,2	11,5
<b>Maqedonia Veriore</b>	5,4	2,3	6,2	8,8	6,2	2,8	3,2	4,8	3,5	3,7	0,5	3,0	5,1	3,8
<b>Bosnja dhe Hercegovina</b>	8,9	5,6	6,6	11,7	5,3	0,8	2,6	2,5	2,3	1,7	2,9	2,3	1,6	2,4
<b>Serbia</b>	3,9	6,0	13,9	11,0	8,2	6,9	4,3	10,6	3,1	4,5	4,5	6,3	6,1	6,9

Siç shihet në tabelë, mesatarja e IHD-ve si pjesë e BPV-së në BP6 është rreth 6.2%. Mali i Zi ka mesataren më të lartë me 11.5%, me nivelin më të lartë në 2007 me 25.5%. Bosnja dhe Hercegovina është vendi me nivelin më të ulët të IHD-ve si pjesë e BPV-së së saj. Ndërsa në anën tjetër, Republika e Kosovës, ka arritur nivelin më të lartë të IHD-ve gjatë vitit 2007 me 12.5%, ndërsa gjatë vitit 2017 IHD-të arritën në 4.6% të BPV-së, duke treguar kështu nivele më të larta të IHD-ve krahasuar me Maqedoninë dhe Bosnjën e Hercegovinën, ndërsa nivele më të ulëta të IHD-ve krahasuar me Malin e Zi, Shqipërinë dhe Serbinë.



Në vitin 2018, niveli i Investimeve të Huaja Direkte ka rënë pothuajse 10% në krahasim me vitin 2017. Një nder arsyt kryesore që shkaktuan këtë rënie konsiderohet të jetë barra administrative që kompanitë ballafaqohen gjatë operimit bizensor në Kosovë.<sup>40</sup>

### 1.16.2 Të bërit biznes

Banka Botërore publikon çdo vit indeksin e saj të të bërit biznes <sup>41</sup> . Indeksi paraqet tregues sasiore mbi rregulloret e biznesit dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë që mund të krahasohen me 190 ekonomi dhe me kalimin e kohës.

Të Bërit Biznes matë rregulloret që ndikojnë në 11 fusha të jetës së një biznesi: fillimi i një biznesi, trajtimi i lejeve të ndërtimit, marrja e energjisë elektrike, regjistrimi i pronës, marrja e kredive, mbrojtja e investitorëve të vegjël, pagesa e taksave, tregtimi ndërkufitar, zbatimi i kontratave, zgjidhja e paaftësisë së pagesës dhe rregullimi i tregut të punës<sup>42</sup>. Treguesit përdoren për të analizuar rezultatet ekonomike dhe për të identifikuar se cilat reforma të rregullimit të biznesit kanë funksionuar, ku dhe pse.

Metodologjia e të Bërit Biznes aplikon faktorë që përdoren ose janë me rëndësi edhe për matjen e barrës administrative, siç janë numri i procedurave, numri i dokumenteve të kërkuara dhe koha e nevojshme për të përfunduar procedurat. Kjo do të thotë se treguesit e Bankës Botërore gjithashtu mbulojnë - të paktën pjesërisht - informacionin që është mbuluar edhe në Modelin e Kostimit Standard i cili është shpjeguar në seksionin e radhës.

Pasqyra e mëposhtme paraqet rezultatet e të Bërit Biznes të vendeve të Ballkanit Perëndimor nga viti 2012 deri në vitin 2018. Kjo tregon që Kosova ka përparuar shumë gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, Maqedonia është një udhëheqës i qartë në rajon. Rezultatet e Serbisë dhe Malit të Zi janë të afërta me ato të Kosovës. Shqipëria është në renditjen ku Kosova ishte në vitin 2016, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina ka renditjen që Kosova kishte në vitin 2014.

Figura 6 - Renditja e të Bërit Biznes për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor për vitet 2012-2018

Vendi	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Maqedonia Veriore	23	25	30	12	10	11	10
Kosova	98	86	75	66	60	40	44
Mali i Zi	51	44	36	46	51	42	50
Serbia	86	93	91	59	47	43	48
Shqipëria	85	90	68	97	58	65	63
Bosnja & Hercegovina	126	131	107	79	81	86	89

Ndryshimet që Kosova ishte në gjendje të zbatojë tregojnë se reformat e fushave të lidhura me të bërit biznes kanë kontribuar në përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe investimeve. Sidoqoftë, sukcesi i këtyre reformave nuk është arsye për ta konsideruar procesin si të përfunduar. Vendet e tjera në rajon mund të arrijnë me lehtësi

<sup>40</sup> <https://www.koha.net/arberi/156863/tkurren-investimet-e-huaja-per-24-milione-euro>.

<sup>41</sup> Shihni gjithashtu: <http://www.doingbusiness.org/reports/global-reports/doing-business-2018>.

<sup>42</sup> Rregullorja e tregut të punës nuk u aplikua në renditjen e vitit 2018 për të Bërit Biznes.

Kosovën brenda pak vitesh dhe gjithashtu mund të tejkalojnë dhe mundin Kosovën në tërheqjen e IHD-ve, zhvillimin e biznesit, rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

Figura 7 - Pikët e Kosovës në të Bërit Biznes të Bankës Botërore 2019



### 1.17 Kostot Administrative dhe Barra Administrative<sup>43</sup>

Kostot administrative janë kostot me të cilat kompanitë ballafaqohen nga "detyrimet ligjore për të pasur ose vënë informacion në dispozicion të autoriteteve publike dhe / ose për palët e treta"<sup>44</sup>.

Këto kosto ndahen në Kosto të Zakonshme të Biznesit (KZB) dhe Barrë Administrative. KZB-të janë kostot që bën biznesi edhe nëse nuk do të kishte legjislacion në fuqi që e detyron atë ta bëjë këtë. Ky është informacion që është thelbësor për funksionimin e një biznesi, si për shembull informacioni që kompanitë e mëdha duhet të kenë për numrin e punonjësve dhe pagat e tyre. Barra administrative është kostoja që kompanitë duhet të bëjnë, sepse ato janë të detyruara me ligj, si për shembull dhënia e informacionit mbi pagat dhe tatimet për organet

<sup>43</sup> Prezantimi i shkurtër për këtë nën-seksion rrjedh nga Doracaku i Modelit të Kostimit Standard - Matja dhe Zvogëlimi i Barrës Administrative, i miratuar në nëntor 2018. Doracaku përmban të gjitha aspektet metodologjike për matjen efektive të barrëve administrative (ex post) dhe vlerësimin e reduktimeve të mundshme që arrihen përmes thjeshtimit të konsideruar të kërkesave ligjore ekzistuese (ex-ante). Doracaku është në dispozicion në internet: [http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/ZKM\\_SKQ\\_MKS\\_Doracaku\\_EN.pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/ZKM_SKQ_MKS_Doracaku_EN.pdf).

<sup>44</sup> Qeveria e Kosovës, Doracaku i modelit të kostimit standard - Matja dhe zvogëlimi i barrës administrative, faqe 8.

Zyra e Kryeministrit – Sekretariati Koordinues i Qeverisë: Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative – Heqja e Barrierave Burokratike përkatëse administrative.<sup>45</sup> Tarifat dhe taksat që duhet të paguheshin për procesimin e procedurave administrative e që nuk janë në përputhje me LPPA-në, në veçanti parimi i mospagimit të procedurës, konsiderohen gjithashtu si barrë administrative.


Ndërsa KZB-të janë pjesë e proceseve normale për zhvillimin dhe menaxhimin e bizneseve, barrët administrative ndikojnë direkt në mënyrat se si bizneset punojnë. Ato kërkojnë burime që bizneset përndryshe do t'i investonin në aktivitete të tjera, siç është zhvillimi i biznesit dhe rritja e shitjeve. Obligimet ligjore të cilat janë me cilësi të ulët dhe që zbatohen në mënyrë joefektive çojnë në shpenzime të panevojshme për kompanitë kur ato zbatojnë legjislacionin. Këto shpenzime pengojnë zhvillimin e biznesit dhe prandaj konsiderohen barrë administrative. Duke thjeshtuar legjislacionin dhe duke përmirësuar zbatimin e obligimeve ligjore, burimet e kompanisë lirohen dhe këto mund të investohen në aktivitete prodhuese.

### 1.17.1 Modeli i Kostimit Standard

Kostot administrative dhe barrët administrative llogariten përmes modelit të kostimit standard të njohur ndërkombëtarisht.

Modeli ndan Informatat e Obligueshme në aktivitete të standardizuara. Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e tyre mund të llogariten duke vlerësuar (1) pagën e personit që kryen detyrën; (2) kohën e nevojshme për përmbushjen e detyrës; (3) numrin e bizneseve që duhet të kryejnë detyrën; dhe (4) dhe sa herë në vit duhet të kryhet kjo detyrë.

Figura 8 - Prezantimi Grafik i Modelit të Kostimit Standard



Është thelbësore të kihet parasysh se MKS-ja është një mjet neutral i politikave. Modeli thjesht vlerëson kostot që lidhen me zbatimin e legjislacionit dhe në këtë mënyrë jep informacion të detajuar mbi efikasitetin e zbatimit të dispozitave dhe zgjedhjeve. MKS-ja nuk adreson nëse zgjedhjet janë të arsyetuara, nëse një politikë apo ligj është i nevojshëm ose nëse barrët e shkaktuara arsyetojnë përfitimet. Kjo është një çështje politike / shoqërore që nuk mund të përcaktohet vetëm në bazë të informacionit që modeli ofron.

<sup>45</sup> Po aty, faqe 11.

### 1.17.2 Arritja e zvogëlimit të barrës administrative

Pasi të identifikohen, barrët administrative mund të zvogëlohen në disa mënyra.

Ligji ose akti nënligjor mund të shfuqizohet nëse mendohet të mos jetë i dobishëm. Përvoja ndërkombëtare megjithatë tregon se kjo nuk ndodh shpesh.

Informatat e Obligueshme mund të shfuqizohen kur vlerësohet se nuk janë më të nevojshme ose kur janë të dyfishta. Disa obligime të tilla gjithashtu mund të shkrihen në të reja, potencialisht duke çuar në shkrirjen e akteve të ndryshme ligjore. Ajo që vlen për informatat e obligueshme, zbatohet gjithashtu edhe për aktivitetet individuale që duhet të kryhen.

Katër faktorët që përcaktojnë barrët administrative siç janë përcaktuar në MKS, sigurojnë rrugën më të rëndësishme për zvogëlimin e barrës administrative. Nëse detyrat nën-kontraktohen për shkak të kompleksitetit të rregullave, paga e personit që kryen detyrën mund të reduktohet nëpërmjet thjeshtimit që çon në përdorimin e burimeve të brendshme. Kur zvogëlohet koha e nevojshme për të përmbushur një detyrë, p.sh. përmes zgjidhjeve të qeverisjes elektronike, zvogëlohen edhe barrët gjithashtu. Numri i bizneseve që duhet të kryejnë detyrën mund të zvogëlohet duke shënjestruar më mirë detyrimet ligjore në përputhje me rreziqet e mundshme që paraqesin kompanitë. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, përmes zvogëlimit të shpeshtësisë në të cilën duhet dhënë informacioni, ulet numri i herëve që detyrat duhet të kryhen në vit.

Figura 9 - MKS dhe supozimet e pajtueshmërisë së plotë

Modeli i Kostimit Standard supozon pajtueshmërinë e plotë me legjislacionin në fuqi. Prandaj, gjithashtu supozon se legjislacioni zbatohet plotësisht nga organet përgjegjëse administrative.

Këto dy supozime nuk janë gjithmonë në përputhje me situatën aktuale në vend pasi që legjislacioni nuk aplikohet gjithmonë nga kompanitë apo qytetarët. Për më tepër, jo i gjithë legjislacioni zbatohet siç synohet nga organizatat përgjegjëse.

Nga këndvështrimi i barrëve administrative kjo situatë mund të çojë në dy situata të ndryshme.

Në njërën anë, legjislacioni që është aq i vështirë për t'u zbatuar, sa që edhe organet administrative përballen me sfida serioze, sigurisht do të impononte barrë të tepruar për kompanitë dhe qytetarët. Megjithatë, pasi është në fuqi, ai shkakton një dozë pasigurie meqë nuk dihet nëse dispozitat ligjore do të zbatohen së shpejti.

Nga ana tjetër, mungesa e zbatimit të duhur të kërkesave ligjore, në veçanti ato të përcaktuara në Acquis të BE-së, mund të shpie në një situatë ku kompanitë nuk mund të bëjnë biznes me homologët e tyre në Bashkimin Evropian ose duhet të kalojnë nëpër procedura shumë të vështira në mënyrë që të jenë në gjendje të kryejnë aktivitetet e tyre të biznesit me BE.

Për një program që synon zvogëlimin e barrës administrative, të dy situatat e ndryshme duhet të adresohen në metodologjinë për matjen e barrës aktuale dhe për të vlerësuar efektin e thjeshtimit.

Kur moszbatimi është rezultat i një situatë komplekse, matja do të supozonte zbatimin e plotë bazuar në pikëpamjet e ekspertëve dhe supozimet se si do të dukej procesi i zbatimit.

Zvogëlimet pastaj vlerësohen bazuar në ndryshimet e zbatimit teorik duke supozuar pajtueshmërinë e plotë.

Kur mungesa e një kornize ligjore pengon kompanitë dhe qytetarët në veprimtaritë e tyre në raport me Bashkimin Evropian, do të vlerësohet mënyra se si ato adresojnë vështirësitë aktuale përmes masave alternative. Në rast se aktivitete të caktuara nuk mund të kryhen fare, dispozitat ligjore që do të vendosen për të përmirësuar gjendjen nuk do të cilësohen si barrë administrative. Arsyeja është se ato janë parakushte të domosdoshme për zhvillimin e biznesit në Kosovë.

Për më tepër, supozimet e pajtueshmërisë së plotë nënkuptojnë gjithashtu që kompanitë dhe qytetarët po i ndjekin kërkesat e përgjithshme ligjore. Në sektorin e ushqimit, për shembull, pritjet që kompanitë të zbatojnë

plotësisht kërkesat e HACCP (analiza e rrezeve dhe pikave kritike të kontrollit) dhe të sigurojnë zbatimin e standardeve të higjienës të përcaktuara në legjislacion. Kur një kompani nuk arrin ta bëjë këtë, procedurat pasuese administrative që lidhen me mbylljen e përkohshme, inspektimet për të parë nëse mangësitë higjienike janë zgjidhur dhe procedurat për rihapjen e lokacionit të prekur nuk konsiderohen si barrë administrative.

Gjatë zbatimit të procesit për zhvillimin e matjes bazë do të zbatohet qasja e mëposhtme: në rast se një barrë administrative mund të identifikohet si arsyeja kryesore për informalitetin, do të llogaritet sikur të ishte zbatuar plotësisht. Zvogëlimi i mëtejshëm i kësaj barre mund të pritët, para së gjithash, që të rrisë formalitetin dhe rritjen formale ekonomike.

### 1.17.3 Trajnimi për Trajnerë për Modelin e Kostimit Standard (TpT MKS – Sekretariati Koordinues i Qeverisë)

Zyra e Kryeministrit dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike kanë përfunduar Programin e Trajnimit për Trajnerë (TpT) për përdorimin e Modelit të Kostimit Standard. TpT u organizua në bashkëpunim me Kryeministrinë e Shqipërisë dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) sipas marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë për bashkëpunim në fushën e Rregullimit më të Mirë<sup>46</sup>.

14 personat e certifikuar përmes këtij trajnimi janë angazhuar në trajnimin e shërbyesve civilë mbi MKS-në dhe në mënyrën në të cilën duhet të kryhen matjet e MKS-së. TpT për MKS pritët të përsëritet disa herë në mënyrë që administrata të mund të ndërtojë kapacitete të mjaftueshme për MKS-në gjatë zbatimit të programit të zvogëlimin të barrës administrative.

Organizimi i TpT-ve për MKS do të jetë aktiviteti kryesor që do të sigurojë kapacitetet për MKS. Plani është që shumica e stafit të përfshirë në menaxhimin e matjeve të nevojshme për zbatimin e programit për zvogëlimin e barrës administrative do duhet ta përfundojë këtë TpT si mjet për sigurimin e cilësisë.

Figura 10 - Vendosja e normës në legjislacionin kombëtar

TpT për MKS përqendrohet në zbatimin praktik të modelit për ligjet dhe aktet nënligjore. Gjatë diskutimit me pjesëmarrësit dhe gjatë studimit të rasteve, kuptohet më mirë dobia e modelit dhe sfidat e mundshme.

Modeli jep informacion që aktualisht nuk është në dispozicion në Kosovë. Ai siguron të dhënat që nevojiten për të menaxhuar në mënyrë efektive rrjedhën dhe përmbajtjen e legjislacionit. Zhvillimi i një baze sipas metodologjisë së MKS-së do t'i mundësonte Qeverisë që të adresojë në mënyrë efektive ofrimin e shërbimeve dhe thjeshtimin e procedurave administrative.

Një sfidë e rëndësishme është se legjislacioni shpesh nuk është i qartë sa duhet. Kjo lë vend për interpretim dhe mund të interpretohet ndryshe nga zyrtarë të ndryshëm publik. Për qytetarët dhe kompanitë kërkesat ligjore nuk janë të qarta. Si rrjedhojë, ata nuk mund të bazohen gjithmonë në dispozitat ligjore për të kuptuar se çfarë duhet të bëjnë dhe si është i strukturuar procesi administrativ.

Kjo mungesë e qartësisë normative paraqet një sfidë pasi që gjatë matjes bazë, analiza e dispozitave ligjore duhet të plotësohet me intervista me organet administrative lidhur me mënyrën se si i zbatojnë obligimet ligjore, të cilat nuk janë mjaft të qarta.

<sup>46</sup> Emri i plotë i kësaj marrëveshjeje është: MEMORANDUMI I MIRËKUPITIMIT NDËRMJET ZYRËS SË KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KRYEMINISTRISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR SHKËMBIMIN E PËRVOJAVE DHE BASHKËPUNIM NË ZBATIMIN E RREGULLIMIT MË TË MIRË DHE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT DHE PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKAVE TË ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE. Marrëveshja u nënshkrua gjatë takimit të përbashkët qeveritar midis Kosovës dhe Shqipërisë më 27 nëntor 2017.

Në të njëjtën kohë, mungesa e qartësisë normative siguron një shtytje shtesë të rëndësishme për zvogëlimin e barrës administrative. Rishikimi sistematik i të gjitha obligimeve ligjore i mundëson Qeverisë të përmirësojë cilësinë e gjithë legjislacionit dhe të vendosë kërkesa të qarta normative.

## 1.18 Pema e Problemit për Barrën Administrative

Pema e problemit paraqet shkaqet që krijojnë barrë administrative. Ajo gjithashtu paraqet efektet që kjo barrë ka në shoqëri, në veçanti në ekonomi.

Figura 11 - Pema e problemit që tregon shkaqet dhe efektet e barrës së panevojshme administrative

Efektet	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rritja ekonomike e penguar</li> <li>2. Mungesa e klimës së qëndrueshme për investime</li> <li>3. Numri i madh i rasteve në gjykatën administrative</li> <li>4. Zbatimi joefikas dhe joefektiv i politikave</li> <li>5. Shkallë më e ulët e regjistrimit të biznesit dhe formalizimit</li> <li>6. Ulje e të ardhurave tatimore</li> <li>7. Bizneset dhe punëtorët nuk kanë qasje në financa</li> <li>8. Nivel i ulët i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga administrata</li> <li>9. Kosto më të larta nga ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit</li> <li>10. Administrata bën shpenzime që do të mund të shpenzoheshin në mënyrë më efektive</li> </ol>
Problemi kryesor	Barra të panevojshme administrative
Shkaqet	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Procedurat që nuk nevojiten janë ende në fuqi</li> <li>2. Ligjet dhe aktet nënligjore kontradiktore</li> <li>3. Zbatimi jo i duhur / i paplotë i dispozitave ligjore</li> <li>4. Zbatimi joefikas i dispozitave ligjore</li> <li>5. Dyfishimi i obligimeve ligjore</li> <li>6. Informacioni i paqartë i dhënë në lidhje me obligimet ligjore</li> <li>7. Organizata joefikase funksionale që ofrojnë shërbime</li> <li>8. Stafit për ofrimin e shërbimeve nuk është plotësisht i informuar dhe i përgatitur për të kryer detyrën</li> <li>9. Kohë të gjata udhëtimi dhe pritjeje për shërbime</li> <li>10. Mungesa e vlerësimit të ndikimit në lidhje me efektet mbi kompanitë dhe qytetarët</li> <li>11. Legjislacioni jo i konsoliduar dhe as i publikuar plotësisht në internet në një regjistër qendror</li> <li>12. Obligimet ligjore dhe dispozitat e zbatimit të formuluar keq dhe të vështira për t'u kuptuar</li> <li>13. Digjitalizimi i pamjaftueshëm i shërbimeve dhe procedurave të Qeverisë</li> <li>14. Ligjet dhe aktet nënligjore nuk janë të përkthyer siç duhet</li> <li>15. Mungesa e një kornize ligjore të harmonizuar</li> <li>16. Mungesa e qendrave të integruara të shërbimit (pika shërbimi me një ndalesë - <i>one-stop-shops</i>)</li> </ol>

### **1.18.1 Shkaqet e problemit**

Pema e problemit paraqet një varg shkaqesh që kontribuojnë në krijimin e barrës administrative të panevojshme. Këto shpjegohen në terma të përgjithshme më poshtë.

#### **Shkaku 1: Procedurat që nuk nevojiten janë ende në fuqi**

Kur procedurat nuk shfuqizohen, madje edhe kur ato nuk janë më të nevojshme, vazhdojnë të zbatohen nga organet publike. Kompanitë dhe qytetarët ende duhet t'i respektojnë ato, edhe pse nuk ka vlerë të shtuar. E tërë kjo mund të cilësohet si barrë administrative si dhe humbje e burimeve qeveritare.

#### **Shkaku 2: Ligjet dhe aktet nënligjore kontradiktore**

Ligjet dhe aktet nënligjore që nuk janë të harmonizuara mund të paraqesin kërkesa kontradiktore. Këto e bëjnë të vështirë për organet administrative që t'i zbatojnë ato. Ato krijojnë pasiguri dhe barrë administrative meqë është e paqartë se cilat rregulla duhet të ndiqen. Arsyeja e mos-implementimit mund të përfshijë, ndër të tjera, mungesën e buxhetit të alokuar, fondet e alokuara në mënyrë të pamjaftueshme ose mungesën e aftësisë së organeve përgjegjëse administrative për t'i kthyer rregullat në praktikë të implementimit.

#### **Shkaku 3: Zbatimi jo i duhur / i paplotë i dispozitave ligjore**

Kur kërkesat ligjore janë në fuqi, por nuk zbatohen, kompanitë dhe qytetarët nuk mund të punojnë brenda një mjedisi të parashikueshëm ligjor. Pamundësia për të ditur se cilat kërkesa do të zbatohen, e bën të vështirë vlerësimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të investimeve. Investimet mund të bëhen më shumë për fitime afatshkurtra sesa afatgjata.

#### **Shkaku 4: Zbatimi joefikas i dispozitave ligjore**

Gjatë zbatimit të detyrimeve ligjore, nga organet administrative pritet të marrin vendime në bazë të njohurive më të mira që i ka në atë moment. Me kalimin e kohës, megjithatë, mund të dalin në pah metoda më të mira dhe njohuri të reja për zbatim. Kur ato nuk zbatohen për të përmirësuar praktikën e zbatimit, mënyra e duhur e zbatimit në të kaluarën, bëhet një proces joefikas në të tashmen.

#### **Shkaku 5: Dyfishimi i detyrimeve ligjore**

Të njëjtat detyrime mund të përsëriten në dy ose më shumë ligje ose akte nënligjore. Kur zbatimi i këtyre detyrimeve pastaj nuk koordinohet, ato mund të shpijnë në dy rrjedha identike të informacionit nga bizneset tek administrata. Përveç kësaj, të njëjtat obligime ligjore me momente të ndryshme të përmbushjes ofrojnë një dyfishim de-facto të panevojshëm të punës si për bizneset dhe qytetarët, ashtu edhe për organet administrative.

#### **Shkaku 6: Informacioni i paqartë i dhënë në lidhje me obligimet ligjore**

Kur zbatohen obligimet ligjore, është më e lehtë për kompanitë dhe qytetarët t'i respektojnë ato kur marrin informacionin e saktë dhe të plotë për mënyrën e përmbushjes së tyre. Kur kjo nuk ndodhë (p.sh. kur informacioni dhe kërkesat procedurale nuk janë në dispozicion online), nevojitet më shumë kohë për të mësuar se si të trajtohen detyrimet ligjore në praktikë.

Rëndësia e kësaj çështje rritet kur merren parasysh nivelet e analfabetizmit funksional në Kosovë. Ky lloj i analfabetizmit do të thotë që personat kanë shkathtësi leximi dhe shkrimi të cilat janë të pamjaftueshme “për të menaxhuar detyrat e përditshme të jetesës dhe të punësimit që kërkojnë shkathtësi leximi përtej nivelit bazë”<sup>47</sup>.

<sup>47</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/Functional\\_illiteracy](https://en.wikipedia.org/wiki/Functional_illiteracy); faqja është vizituar për herë të fundit më 27 shtator 2018.



Analfabetizmi funksional është një fenomen që prek shoqëritë e të gjitha llojeve dhe niveleve të zhvillimit. Për shembull, një studim i kryer nga Universiteti i Hamburgut, i vitit 2011, vlerëson se në Gjermani 7.5 milionë njerëz mund të konsiderohen analfabetë funksional<sup>48</sup>. Në Holandë, rreth 2.5 milionë persona i përkasin këtij grupi<sup>49</sup>. Siç tregohet në kutinë më poshtë, kjo ka tërhequr vëmendje të veçantë në sigurimin që tekstet e qeverisë janë lehtësisht të kuptueshme, gjë që do të thotë se procedurat do të jenë më të arritshme, qytetarët do të jenë më të aftë të kuptojnë dhe të gëzojnë të drejtat e tyre, ndërsa politikat dhe legjislacioni pritet të përmirësojnë nivelin e ndikimit që synojnë të kenë.

Figura 12 - Task Forca holandeze për tekste dhe dokumente të qarta

Në muajin tetor të vitit 2019, qeveria holandeze themeloi Task Forcë për promovimin e përdorimit të teksteve dhe dokumentacionit më të lehtë për t'u kuptuar<sup>50</sup>. Qëllimi i përgjithshëm është përmirësimi i komunikimit të bërë nga administrata në të gjitha nivelet. Anëtarët e Task Forcës, që pritet të jenë rreth 100 persona deri në vitin 2020, do të ofrojnë trajnime dhe mentorim për nëpunësit civilë. Deri në vitin 2019, objektivi i ndërmjetëm është përmirësimi i 100 teksteve më të lexuara. Këto përfshijnë letra, formularë, fletushka dhe tekste në internet.

Studimi i PISA 2015 - i publikuar në dhjetor 2016 - tregon se në Kosovë nxënësit e moshës 15 vjeç kanë pothuajse rezultatin më të ultë në aftësitë e leximit prej 72 shteteve të analizuara<sup>51</sup>. Bazuar në rezultatet e PISA, rreth 80% e nxënësve të moshës 15 vjeç mund të konsiderohen analfabetë funksional<sup>52</sup>. Statistikat zyrtare tregojnë se 9.9% e grave dhe 4.9% e burrave në Kosovë janë analfabetë<sup>53</sup>. Vlerësimet e analfabetizmit funksional për të gjithë popullsinë janë rreth 25%<sup>54</sup>.

Duke pasur parasysh prevalencën e analfabetizmit funksional, ofrimi i shërbimeve qeveritare duhet të marrë parasysh kapacitetet e atyre që (duhet) t'i kërkojnë këto shërbime. Nëse, për shembull, informacioni i dhënë është i paqartë ose paraqitet me shkrim me tekst që është vështirë të kuptohet, do të jetë i vështirë për t'u kuptuar dhe rrjedhimisht e vështirë për të përmbushur kërkesat ligjore. Një prezantim i qartë i kërkesave do të zvogëlonte barrën administrative, në veçanti për grupin që mund të konsiderohet analfabetë funksional. Megjithatë, është thelbësore të theksohet se të gjithë përfitojnë nga një prezantim i tillë i qartë.

### **Shkaku 7: Organizatat joefikase funksionale që ofrojnë shërbime**

Kompanitë dhe qytetarët varen nga administrata për shumë shërbime dhe procedura. Nëse ofrimi i shërbimeve është joefikas në nivelin praktik të zbatimit - p.sh. duhet të shkohet në zyra të ndryshme në vend të shërbimit nga një person - ata përballen me barrë administrative për shkak të mënyrës së zbatimit.

### **Shkaku 8: Staf i për ofrim të shërbimeve nuk është plotësisht i informuar dhe i përgatitur për detyrën e tij**

Personeli që zbaton legjislacionin duhet të jetë i informuar dhe i përgatitur për detyrën e tij. Kjo vlen si për aktivitetin kryesor, ashtu edhe për faktorët tjerë të cilët nga perspektiva e kompanisë ose qytetarit, janë të

<sup>48</sup> <https://www.dw.com/en/despite-wealth-germany-struggles-with-illiteracy/a-19536651>; Faqja e internetit është vizituar për herë të fundit më 27 shtator 2018.

<sup>49</sup> <https://www.volkskrant.nl/nieuws-achtergrond/rekenkamer-2-5-miljoen-laaggeletterden-in-nederland-beleid-niet-effectief~bc0f3108>; Faqja e internetit është vizituar për herë të fundit më 27 shtator 2018.

<sup>50</sup> <https://www.rijksoverheid.nl/actueel/nieuws/2019/10/23/extra-mensen-en-middelen-voor-begrijpelijke-taal>

<sup>51</sup> <https://www.oecd.org/pisa/pisa-2015-results-in-focus.pdf> dhe

<http://gpseducation.oecd.org/CountryProfile?primaryCountry=XKO&treshold=10&topic=PI>; Faqja e internetit është vizituar për herë të fundit më 27 shtator 2018.

<sup>52</sup> <https://prishtinainsight.com/functionally-illiterate-kosovo-perform-poorly-pisa>; Faqja e internetit është vizituar për herë të fundit më 27 shtator 2018.

<sup>53</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia, Ekonomitë Familjare dhe Regjistrimi i Banesave 2011, Shkalla e analfabetizmit në Kosovë 2009.

<sup>54</sup> <https://archive.koha.net/?id=&l=74705>; Faqja e internetit është vizituar për herë të fundit më 27 shtator 2018.



rëndësishme për funksionimin e një procesi (biznesi). Shërbyesit civilë që ndërveprojnë me kompanitë dhe qytetarët janë 'fytyra' e administratës. Ata përcaktojnë në një masë të madhe se si njerëzit i vlerësojnë shërbimet dhe si funksionon administrata. Kur personeli është i keq informuar dhe nuk është i përgatitur për detyrën e tij, kompanitë dhe qytetarët kanë vështirësi të kuptojnë informacionin që u nevojitet.

#### **Shkaku 9: Kohë të gjata udhëtimi dhe pritjeje për shërbime**

Kur bëjnë kërkesë për dokumente, leje apo shërbime, stafi i kompanive dhe qytetarët shpesh duhet të vijnë personalisht në zyrat e organit përgjegjës administrativ. Nevoja për të udhëtuar dhe pritja në radhë u merr kohë të konsiderueshme individëve, veçanërisht kur merret parasysh orari i punës.

#### **Shkaku 10: Mungesa e vlerësimit të ndikimit në lidhje me efektet mbi kompanitë dhe qytetarët**

Shumica e legjislacionit në fuqi në Kosovë është zhvilluar pa një vlerësim efektiv të ndikimit në mbështetje të zhvillimit të ligjit. Kjo është adresuar pjesërisht me futjen e sistemit për Koncept Dokumentet në vitin 2012 dhe përmirësimet e futura në sistem në vitin 2018 (duke përfshirë Modelin e Kostimit Standard). Megjithatë, këto përmirësime nuk adresuan mungesën e marrjes në konsideratë të efekteve që rrjedhin nga legjislacioni që është miratuar para se të prezantohej sistemi i KD-ve në vitin 2012 dhe përmirësimet që janë bërë në vitin 2018.

#### **Shkaku 11: Legjislacioni jo i konsoliduar dhe as i publikuar plotësisht në internet në një regjistër qendror**

Legjislacioni është ndryshuar shpesh, p.sh. për të siguruar përafrim me ligjet kornizë siç janë Ligji për Procedurat e Përgjithshme Administrative dhe Ligji për Licencat dhe Lejet. Ligjet bazë ndryshohen rregullisht, por nuk zhvillohet asnjë version i konsoliduar kur këto ndryshime miratohen zyrtarisht dhe hyjnë në fuqi. Për të kuptuar kërkesat ligjore që janë në fuqi, kompanitë dhe qytetarët duhet të krahasojnë një ligj me ligjet e ndryshme që e ndryshojnë dhe plotësojnë atë. Kjo kërkon kohë dhe është një proces që nganjëherë mund të ekzekutohet vetëm nga një profesionist ligjor. Kostot për punësimin e ekspertizës së jashtme mund të jenë të larta dhe konsiderohen si barrë administrative.

Figura 13 - Sigurimi i publikimit dhe konsolidimit konsistent të të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore dhe zvogëlimi i barrës administrative

Gazeta Zyrtare aktualisht i publikon të gjitha ligjet. Megjithatë, publikimi i akteve nënligjore nuk është ende i garantuar. Për më tepër, tekstet juridike nuk konsolidohen në mënyrë sistematike.<sup>55</sup>

Gazeta Zyrtare aktualisht është duke zhvilluar koncept dokumentin për adresimin e këtyre dy çështjeve. Ky KD duhet të marrë parasysh ndikimin në zvogëlimin e barrës administrative si rezultat i sigurimit të publikimit dhe konsolidimit konsistent të të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore.

#### **Shkaku 12: Detyrimet ligjore dhe dispozitat e zbatimit të formuluar keq dhe të vështira për t'u kuptuar**

Një parim i rëndësishëm i Sundimit të Ligjit është se ligji është i parashikueshëm. Kjo nënkupton se ligjet duhet të shkruhen në mënyrë të kuptueshme, të formuluar posaçërisht me saktësi dhe qartësi. Kjo ana tjetër duhet t'i mundësojë subjekteve juridike të gëzojnë të drejtat e tyre dhe të rregullojnë veprimet e tyre në përputhje me dispozitat ligjore.

Nëse ligji nuk është i parashikueshëm, qytetarët e posaçërisht të varfërit, do ta kenë më të vështirë, të kërkojnë informata për të drejtat e tyre. Kështu ata do ta kenë më të vështirë të kuptojnë të drejtat e tyre ligjore kur duan të aplikojnë për leje ose kur duan të themelojnë dhe drejtojnë një biznes. Për NVM-të kjo do të thotë, de facto, se ata përballen me kosto më të larta të rregullimit sesa kompanitë e mëdha.

Në kontekstin e Kosovës, legjislacioni që mbulon procedurat administrative në përgjithësi konsiderohet të jetë i fragmentuar dhe kundërtëhënës. Hulumtimet gjithashtu kanë theksuar mangësitë në përkthimin e legjislacionit

<sup>55</sup> Të dyja aspektet janë theksuar në Raportin Monitorues mbi parimet e Administratës Publike të OECD-së/SIGMA-s, nëntor 2017.

në gjuhët e komuniteteve, veçanërisht ato të pakicave. Kjo mund të ketë ndikim në të drejtat dhe aktivitetin ekonomik të tyre<sup>56</sup>. Në veçanti, grupet e cenushme, p.sh. personat me pak ose pa arsim, mund të ndodhë që të përballen me vështirësi për shkak të rregullave ligjore të paparashikueshme dhe procedurave që ndërtohen mbi to.

### **Shkaku 13: Digjitalizimi i pamjaftueshëm i shërbimeve dhe procedurave të Qeverisë**

Digjitalizimi i shërbimeve të Qeverisë mund t'ua lehtësojë qytetarëve dhe kompanive që të paraqesin informacionin dhe të plotësojnë një procedurë apo pjesë të saj. Përveç kësaj, krijimi i sistemeve online për caktim të termineve mund të ketë efekte të rëndësishme në zvogëlimin e kohës së pritjes. Për më tepër, ndërlidhshmëria ndërmjet bazave të të dhënave të administruara nga organe të ndryshme administrative mund të sigurojë bazën për shkëmbimin e informacionit ndërmjet zyrave përkatëse pa e detyruar qytetarin ose përfaqësuesin e kompanisë për të udhëtuar deri tek zyrat e ndryshme për të marrë dokumente që duhet të dorëzohen për një procedurë specifike.

### **Shkaku 14: Ligjet dhe aktet nënligjore nuk janë të përkthyer siç duhet**

Gabimet në përkthimin e ligjeve e bëjnë zbatimin e ligjit nga gjykatësit dhe gjykatat më sfidues, dhe e zvogëlojnë parashikueshmërinë në kornizën ligjore. Analiza e cilësisë gjuhësore të nëntë ligjeve e bërë nga OSBE-ja, ka identifikuar 162 dallime të vogla dhe 49 thelbësore ndërmjet versioneve në gjuhën shqipe dhe serbe<sup>57</sup>.

Dallimet e ligjeve dhe akteve nënligjore në dy gjuhët zyrtare, potencialisht mund të shpijnë në një nivel të ndryshëm të ofrimit të shërbimeve. Kur pjesët kryesore të procedurave dhe kërkesave procedurale nuk janë të formuluar në mënyrë identike, ato mund të zbatohen në mënyrë të ndryshme. Përveç kësaj, kjo gjithashtu mund të shpie në procedura dhe kërkesa të panevojshme dhe ankesa nga qytetarët dhe kompanitë. Këta faktorë të kombinuar nënkuptojnë se dy versionet gjuhësore të ligjeve të Kosovës nuk janë koherente dhe dallimet ndërmjet tyre krijojnë barrë administrative të panevojshme<sup>58</sup>.

### **Shkaku 15: Mungesa e një kornize ligjore të harmonizuar**

Sistemi ligjor në Kosovë karakterizohet nga katër grupe të ndryshme që kanë fuqi ligjore.

Së pari, ligjet dhe aktet nënligjore që janë zhvilluar që nga pavarësia. Së dyti, rregulloret e nxjerra nga UNMIK-u që janë të barabarta me Ligjet e Kosovës. Së treti, Ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara në periudhën pas 22 marsit 1989 dhe 12 dhjetorit 1999 që nuk janë diskriminuese<sup>59</sup>. Së katërti, ligjet në fuqi më 22 mars 1989 që nuk janë shfuqizuar.

Figura 14 - Fragment nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin e Zbatueshëm në Kosovë

#### **Neni 1 LIGJI NË FUQI**

##### **1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshinë:**

(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to; dhe

(b) Ligjin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

<sup>56</sup> Misioni i OSBE-së në Kosovë - Legjislacioni shumëgjuhësh në Kosovë dhe sfidat e tij, 2012, faqe 4 <https://www.osce.org/kosovo/87704>.

<sup>57</sup> Misioni i OSBE-së në Kosovë, 'Legjislacioni dygjuhësor në Kosovë', shtator 2018, faqe 12.

<sup>58</sup> Çështja e cilësisë së përkthimit të legjislacionit të Kosovës është adresuar në 'Koncept Dokumentin mbi Shërbimin e Përkthimit' të përgatitur nga Komisioneri për Gjuhët. Prandaj, ky KD nuk do të shqyrtojë me më shumë hollësi çështjen e përkthimit. Lidhja midis dallimeve në versionet gjuhësore dhe barrëve administrative që ato shkaktojnë shihet si e nënkuptuar dhe nuk ka nevojë për sqarime të mëtejshme.

<sup>59</sup> [http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99\\_24.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99_24.pdf).

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

1.2 Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

Këto grupe të ndryshme të ligjeve nënkuptojnë që korniza ligjore është e vështirë të navigohet pasi që ligjet dhe aktet nëligjore që nuk janë publikuar dhe që nuk janë të njohura për publikun e gjerë ende mund të jenë në fuqi. Kjo ka potencial të ndikojë negativisht në klimën e biznesit / investimeve pasi që zvogëlon sigurinë ligjore. Kjo rrezikon krijimin e barrës administrative kur analizohen kërkesat ligjore që zbatohen në praktikë dhe ajo se si të respektohet ligji.

#### ***Shkaku 16: Mungesa e qendrave të integruara të shërbimit (pika shërbimi me një ndalesë - one-stop-shops)***

Zyrat e organeve të ndryshme administrative që janë përgjegjëse për një procedurë administrative ose që ofrojnë informata thelbësore (siç janë dokumentet), janë të shpërndara nëpër qytete. Qytetarët dhe përfaqësuesit e kompanive që duhet të përmbushin obligimet ligjore duhet të shkojnë në zyra të ndryshme për të përfunduar një procedurë të lidhur me një Informatë të Obligueshme dhe kërkesat e të dhënave të kërkuara. Mungesa aktuale e afërsisë ndërmjet zyrave të ndryshme pritëse të organeve administrative gjithashtu e bën më të vështirë që këto organe të bashkëpunojnë për sa kohë që zgjidhjet e e-qeverisjes ende mbetet të zhvillohen.

#### ***1.18.2 Efektet e problemit***

Pema e problemit paraqet një sërë efektesh që janë rezultat i barrës së panevojshme administrative. Këto shpjegohen më poshtë në terma të përgjithshëm.

#### ***Efekti 1: Rritja ekonomike e penguar***

Barra administrative është shpenzim që kompanitë duhet t'a ndërmarrin për të qenë në pajtueshmëri me legjislacionin dhe për të përmbushur procedurat administrative. Për qytetarët, këto ngarkesa përfaqësojnë kohën dhe përpjekjet që u nevojiten atyre për të plotësuar kërkesat e parashtruara në legjislacion.

Përmbushja e barrës administrative nuk kontribuon drejtpërdrejt në krijimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve. Ato mund të jenë parakushte për këtë, por si të tilla ato nuk e rrisin drejtpërdrejt BPV-në. Më e rëndësishmja, për bizneset këto ngarkesa kanë efekt duke devijuar në të vërtetë fondet dhe burimet nga aktivitetet e nevojshme për të rritur ekonominë dhe për të rritur BPV-në.

Për qytetarët, barra administrative nënkupton se ata do të duhet të shpenzojnë kohë dhe burime për procedurat dhe burokracinë. Kjo kohë mund të shpenzohet edhe në mjete të tjera, p.sh. duke punuar në vend se t'iu duhet të marrin kohë të lirë, duke zhvilluar një biznes ose kaluar kohën me familjen dhe miqtë. Si e tillë, barra administrative është në kundërshtim me nocionin e përcaktuar në të drejtat themelore që lidhen me administrimin e duhur dhe qeverisjen e mirë.

Barra administrative ka një efekt negativ në nivelet e inovacionit, IHD-ve, konkurrencës, krijimit të vendeve të punës, zhvillimit të biznesit, importeve, eksporteve etj. Përmbledhja që përmban efektet specifike ekonomike mund të gjendet në 'Shtojcën 8: Forma e Vlerësimit për Ndikimet Ekonomike'.

## **Efekt 2: Mungesa e klimës së qëndrueshme për investime**

Ndryshimet në legjislacion dhe zbatimin i paqartë i kornizës ligjore ekzistuese nënkupton se është e vështirë të parashikohet se cilat procedura duhet të ndiqen dhe nëse situata mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt. Për shembull, kur administrata vendos të zbatojë dispozitat ekzistuese ligjore që nuk janë zbatuar më parë, situata për kompanitë ndryshon edhe pse kështu nuk kishte ndodhur kur ato filluan veprimtarinë e tyre. Në mënyrë të ngjashme, procedurat mund të zbatohen në mënyrë të ndryshme në momente të ndryshme edhe pse baza ligjore nuk ka ndryshuar. Kjo krijon një situatë në të cilën administrata është e paparashikueshme dhe e vështirë për të punuar me të.

## **Efekt 3: Numri i madh i rasteve në gjykatën administrative**

Kur korniza ligjore nuk zbatohet në mënyrë efektive dhe efikase, kjo mund të shpie në marrjen e vendimeve administrative ku personi / kompania nuk pajtohet me rezultatin përfundimtar. Në mënyrë të ngjashme, mund të pritët që zbatimin ose interpretimin e papërshtatshëm të kornizës ligjore të rezultojë në më shumë gabime dhe vendime të gabuara të marra nga organet administrative. Kjo logjikisht do të shpie në rritjen e numrit të rasteve të paraqitura në gjykatë për të apeluar vendimet e marra nga organet administrative.

*Figura 15 - Barrët administrative si burim i rasteve gjyqësore për një mbingarkesë të sistemit gjyqësor*

Raporte të ndryshme nga organizatat ndërkombëtare theksojnë sfidat në sistemin gjyqësor në lidhje me numrin e lartë dhe numrin e lëndëve të pazgjidhura që trajtohen nga gjykatat. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën thotë se "Në përgjithësi, ka progres të ngadalshëm në zbatimin e planit strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) 2014-2019, strategjisë së komunikimit 2014-2019 dhe strategjisë për reduktimin e lëndëve të pazgjidhura".

Në këtë drejtim, rekomandon nevojën për të vazhduar përpjekjet për të zvogëluar numrin e lëndëve të pazgjidhura, duke përfshirë mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përdorimi i të cilave duhet të financohet dhe promovohet siç duhet.<sup>60</sup>

Për më tepër në raport thuhet se "efikasiteti i gjyqësorit pengohet seriozisht nga mangësitë në legjislacionin penal. Shumë dispozita në Kodin e Procedurës Penale janë tepër të vështira dhe formaliste për të lejuar hetime të forta dhe të suksesshme dhe ndjekje penale". Perceptimi është se konflikti i legjislacionit është i pranishëm edhe në fusha të tjera përveç legjislacionit penal.

Procedurat e gjata të pa-arsyetueshme vazhdojnë të dëmtojnë mjetet efektive juridike në Kosovë, sipas një raporti të publikuar nga KIPRED. Në fund të vitit 2016, ishin 399,031 raste në pritje. Vëmendja që i kushtohet reduktimit të lëndëve të grumbulluara, i vë gjyqtarët në presion për të zgjidhur lëndët me shpejtësi, gjë që domosdoshmërisht e zvogëlon qëndrueshmërinë ligjore të dënimit. Përveç lëndëve të grumbulluara, ka një numër të madh vendimesh të pa ekzekutuara të gjykatave (të vlerësuara në rreth 117,000 në shtator 2017 nga Avokati i Popullit).<sup>61</sup>

Bazuar në Raportin Gjyqësor të Kosovës, numri i përgjithshëm i lëndëve në çështjet civile është 43366 prej të cilave 16040 janë lëndë të vjetra deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2018. Gjetjet e një raporti të Këshillit të Evropës mbi sistemin gjyqësor të Kosovës tregojnë se Kosova po merr një numër të vogël të lëndëve gjyqësore hyrëse dhe komerciale dhe një numër të vogël të lëndëve administrative në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit. Kjo mund t'i atribuohet mungesës së besimit të qytetarëve në gjyqësorin ose, për shembull,

<sup>60</sup> DOKUMENTI I PUNËS I STAFIT TË KOMISIONIT Raporti i Kosovës \* 2018: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>, faqe 13.

<sup>61</sup> KIPRED, Një sistem i shfrytëzuar pak: Gjendja e Kornizës së të Drejtave të Njeriut në Kosovë: [http://www.kipred.org/repository/docs/English\\_Version\\_283269.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/English_Version_283269.pdf), page 11-12.

ndihmës së pamjaftueshme ligjore.<sup>62</sup> Një tjetër gjetje ka të bëjë me gjykatat e shkallës së parë. Situata në sektorin administrativ është shumë problematike, pavarësisht numrit të ulët të lëndëve hyrëse. Shkalla shumë e ulët e spastrimit dhe koha e gjatë e mbajtjes tregojnë se Gjykata Themelore e Prishtinës përballet me vështirësi të rëndësishme në trajtimin e këtyre lëndëve. Në sektorin civil/komercial, situata ishte gjithashtu shqetësuese në vitin 2014. Koha e mbajtjes për këtë kategori të lëndëve në nivelin e shkallës së parë ishte më e larta e grupit.<sup>63</sup>

Sipas statistikave të marra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës<sup>64</sup>, nga gjykatat e Kosovës deri më tani janë trajtuar 8312 konteste administrative, prej të cilave 6093 ende nuk janë përfunduar. Bazuar në llojin e kontesteve, supozimi është se rreth 35% e të gjitha rasteve në mënyrë të qartë përfshijnë bizneset në konteste me administratën. Rastet më të shpeshta në të cilat përfshihen bizneset janë: gjobat; tatimet; dogana; regjistrimi i biznesit dhe pronës; transporti; tenderimi; licencat; lejet; mosveprimi administrativ dhe konfiskimi, likuidimi dhe kthimi i mallrave. Deri më tani gjykatat kanë trajtuar në mënyrë specifike 85 raste të licencave dhe 21 të lejeve. Statistikat e gjykatës, si dhe numri i madh i ankesave të trajtuara brenda administratës, tregojnë faktin se ndërveprimi i bizneseve me administratën është shumë i trazuar. Për më shumë informacion mbi statistikën, ju lutemi shihni Shtojcën 5.

#### **Efekt 4: Zbatimi joefikas dhe joefektiv i politikave**

Barra administrative e vendosur për qytetarët, kompanitë dhe administratën shpignë në një situatë në të cilën qëllimet e parapara të politikave dhe masave të politikave (në veçanti ligjeve dhe akteve nënligjore) nuk janë arritur plotësisht. Kjo ka efektin e pafavorshëm që krijimi i politikave të reja apo edhe rregullimi i atyre ekzistuese nuk prodhon ndryshimet e synuara pozitive për shoqërinë dhe ekonominë. Barra administrative mund të kontribuojë në një lidhje më të dobët midis formulimit të politikave dhe zbatimit të politikave. Rezultati është se politikën, ligjet dhe aktet nënligjore nuk i arrijnë qëllimet e përcaktuara në nivelin politik.

#### **Efekt 5: Norma e ulët e regjistrimit të biznesit dhe formalizimit**

Kur personat që synojnë të fillojnë një biznes përballen me vështirësi në regjistrimin si kompani dhe/ose kur presin që kostot operative për drejtimin e biznesit të jenë shumë të larta si rezultat i barrëve administrative, ata mund të bëjnë zgjedhjen e vetëdijshme që të mos formalizojnë aktivitetet e tyre biznesore fare ose të formalizojnë vetëm një pjesë të aktiviteteve të tyre të biznesit. Në vend të kësaj, ata supozojnë se qëndrimi jashtë kornizës ligjore - plotësisht apo pjesërisht - bart rreziqe që tejkalohen nga perspektiva e zhvillimit të një biznesi plotësisht brenda kornizës ligjore. Barra administrative në këtë mënyrë kontribuon në rritjen dhe/ose vazhdimin e sektorit ekonomik joformal.

Për më tepër, barra administrative mund të zvogëlojë edhe gatishmërinë për të filluar një biznes, duke çuar në një situatë ku do të ishin krijuar biznese nëse korniza rregullative do të ishte më miqësore për biznesin.

Pengesat me të cilat kompanitë përballen ose presin të përballen kanë një efekt negativ në punonjësit e tyre. Kur kompanitë nuk formalizojnë aktivitetet e tyre ose kur punësojnë një pjesë të stafit të tyre jashtë sektorit formal, as punonjësit nuk bien brenda kornizës ligjore. Të ardhurat e tyre nuk tatimohen, por në të njëjtën kohë nuk zbatohen as dispozitat e sigurimeve shoqërore, në veçanti kursimet për pension. Kjo kontribuon në problemet e mundshme më vonë në jetë si varfëria gjatë pleqërisë.

<sup>62</sup> Këshilli i Evropës – Mbështetja horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, Raporti - Raport i thelluar i vlerësimit të sistemit gjyqësor në Kosovë, janar 2018: <https://rm.coe.int/in-depth-assessment-report-of-the-judicial-system/16807828e6>, Rekomandimi Nr. 15;

<sup>63</sup> Po aty. Rekomandimi Nr. 16.

<sup>64</sup> Shih shtojca 5: Lëndët Administrative të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura - VJETORI-2018

### ***Efekti 6: Zvogëlimi i të ardhurave tatimore***

Efektet që barra administrative ka në regjistrimin dhe themelimin e biznesit frenojnë rritjen ekonomike. Kompanitë që operojnë në sektorin joformal mbesin jashtë sistemit tatimor. Për më tepër, shumë mundësi biznesi ndoshta nuk shfrytëzohen dhe shumë kompani nuk krijohen fare ose krijohen jashtë Kosovës. Kjo nënkupton se të ardhurat nga taksat e biznesit etj., janë më të ulëta se sa që mund të ishin. Pasoja është që Qeveria ka më pak fonde në dispozicion për të adresuar sfidat ekonomike dhe sociale që qytetarët do të dëshironin t'i shihnin të zgjidhura.

### ***Efekti 7: Bizneset dhe punëtorët që nuk kanë qasje në financa***

Kur bizneset mbesin në sektorin joformal ose kur mbajnë pjesë të aktiviteteve të tyre jashtë kornizës ligjore, mbikëqyrjet e tyre financiare nuk janë të plota. Kështu ata nuk raportojnë mjaftueshëm gjendjen e tyre financiare tek autoritetet tatimore, por edhe tek bankat dhe institucionet e tjera zyrtare huadhënëse.

Në mënyrë të ngjashme, punonjësit që punojnë në sektorin joformal nuk mund të ofrojnë një historik të dhënash për kredi hipotekare dhe kredi të tjera që mund t'iu nevojiten për investime të rëndësishme jetësore, si blerja e një shtëpie apo makine.

Kjo gjendje mund të çojë në kosto më të larta për kredi jashtë sektorit formal dhe mund të çojë në zgjedhje më të rrezikshme përkitazi me kreditë. Kjo, natyrisht, nëse mundësitë për të huazuar para janë në dispozicion. Mund të pritet që gjendja e tanishme nënkupton se kompanitë dhe punonjësit nuk bëjnë fare investime, edhe pse ato do të ishin të dobishme për rritjen e biznesit dhe përmirësimin e gjendjes personale.

### ***Efekti 8: Niveli i ulët i shërbimeve të ofruara nga administrata***

Autoritetet zbatuese siç janë ministritë, komunitat, agjencitë etj., do të hasin vështirësi në zbatimin e legjislacionit në praktikë kur ky legjislacion nuk është i zhvilluar mirë, jo konsistent me ligjet e tjera ose kur procesi i zbatimit dhe kërkesat nuk janë marrë parasysh gjatë fazave të zhvillimit të politikave dhe ligj-bërjes.

Në qoftë se zbatimi i kërkesave ligjore nuk mbështetet me udhëzime të qarta për personelin e zyrës pritëse dhe nëse nuk ka materiale të qarta informuese për qytetarët dhe përfaqësuesit e kompanive lidhur me obligimet e tyre, kërkesat procedurale dhe të drejtat, barra administrative do të krijohet shumë lehtë. Personeli i zyrës pritëse që nuk mund të shpjegojë në detaje kërkesat dhe njerëzit që nuk mund të përgatiten plotësisht për procedurën që ata presin të finalizojnë, janë dy shkaqe të rëndësishme përse nevojiten vizita shpesh në administratë për të krijuar një pasqyrë të qartë lidhur me detyrimet procedurale. Prandaj, duhet të investohet kohë e konsiderueshme para se të jetë e qartë se çfarë duhet të bëhet në të vërtetë.

### ***Efekti 9: Kosto më të larta nga legjislacioni që ndryshon shpesh***

Korniza ligjore ndryshohet rregullisht. Kjo do të thotë se kërkesat ligjore dhe praktikat zbatuese ndryshojnë gjithashtu në baza të shpeshta. Rezultati është mungesa e stabilitetit të kornizës ligjore. Kompanitë në këtë mënyrë duhet të rikonfirmojnë nëse janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Meqenëse kjo është një detyrë kërkuese e cila mund të jetë edhe e kushtueshme kur kjo punë duhet të bëhet nga ekspertë ligjorë të kontraktuar nga jashtë, kompanitë mund të mos jenë në dijeni për ndryshimet ligjore. Si rrjedhojë kompanitë ballafaqohen me këto ndryshime vetëm kur ato duhet të kalojnë sërish nëpër një procedurë të caktuar ose kur inspektorët janë duke inspektuar mjediset dhe administratën e tyre.

Legjislacioni që ndryshon shpesh kontribuon drejtpërdrejt në pasigurinë e investimeve. Kur nuk është e qartë se çfarë do të jetë gjendja e ardhshme dhe kur mund të pritet që gjendja të ndryshojë në të ardhmen e afërt, kompanitë do të kufizojnë investimet e tyre në ato që ofrojnë kthime afatshkurtra ose ato që janë absolutisht të nevojshme. Rezultati është një normë më e ulët e investimeve në përgjithësi.



**Efekt i 10: Administrata bën shpenzime që mund të shpenzohen në mënyrë më efektive**

Politikat joefikase, legjislacioni dhe zbatimi rezultojnë në shpenzime nga Buxheti i Kosovës që në të vërtetë janë të panevojshme dhe që mund të shpenzohen për çështje më të rëndësishme. Kur administrata bën gabime, humbet kohë duke i korrigjuar ato dhe në rastin më të keq këto gabime çojnë në raste gjyqësore.

Kur individëve ju duhet të pyesin nëpunësit e zyrës pritëse se cilat procedura duhet të ndjekin dhe çfarë lloj informacioni dhe dokumente duhet dorëzuar, këta nëpunës nuk mund të punojnë në mënyrë optimale dhe numri i klientëve që ata janë në gjendje të ndihmojnë në mënyrë efektive zvogëlohet. Në vend të ofrimit të shërbimit në përputhje me kërkesat ligjore, nëpunësit duhet t'i kushtojnë kohë shpjegimit të këtij shërbimi dhe kërkesave ligjore.

### 1.19 Politikat përkatëse dhe legjislacioni në lidhje me zvogëlimin e barrës administrative

Figura në vijim paraqet dokumentet përkatëse të politikave dhe legjislacionin që lidhen me zhvillimin e këtij KD dhe përgatitjen për programin për zvogëlimin e barrës administrative. Siç shihet në përmbledhje, i gjithë legjislacioni në fuqi në Kosovë shihet si potencialisht relevant. Analiza e çdo ligji dhe akti nënligjor në këtë fazë do të ishte joproportionale pasi që - siç do të tregojë edhe KD - kjo do të kërkonte burime të konsiderueshme. Bazuar në numrin faktik të ligjeve, ky KD prandaj bazohet në supozime lidhur me grupet që këto ligje prekin.

Figura 16 - Përshkrimi i politikave përkatëse ekzistuese dhe kornizës ligjore

Dokument i politikave, ligj ose akt nënligjor	Vegza për politikën ose dokumentin online të planifikimit ose për aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni (et) shtetërore përgjegjës (e) për zbatimin	Roli dhe detyrat e institucionit(ve)
Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021	<a href="http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/10/Strategjia-per-Rregullim-më-të-Mirë-2.0-për-Kosovën-Shqip.pdf">http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/10/Strategjia-per-Rregullim-më-të-Mirë-2.0-për-Kosovën-Shqip.pdf</a>	SKQ ZL	Zbatimi i strategjisë dhe planit të saj të veprimit; raportimin mbi zbatimin sipas kornizës së Reformës së Administratës Publike
Kontrata e Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike <sup>65</sup> , Treguesi 5	-	SKQ (5.1 dhe 5.2) ZL (5.1, 5.2 dhe 5.3) ZPS (5.1)	Sigurimi i zbatimit të Treguesit 5; raportimi për arritjet në kuadër të treguesit
Të gjitha ligjet primare dhe sekondare që vendosin obligime	Baza e të dhënave e Gazetës Zyrtare	Shumica e institucioneve qeveritare, shih Shtojcën 2	

<sup>65</sup> MIE është përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm të kontratës së reformës së buxhetit sektorial dhe marrëveshjen e ndërlidhur të financimit. Kjo tabelë specifikon në mënyrë specifike përgjegjësinë për treguesin 5 mbi zvogëlimin e barrës administrative.

të informimit për kompanitë			
Të gjitha ligjet primare dhe sekondare që vendosin obligime të informimit për qytetarët	Baza e të dhënave e Gazetës Zyrtare	Shumica e institucioneve qeveritare, shih Shtojcën 2	

## 1.20 Barra administrative: Palët e prekura të interesit

Barra administrative ndikon në shoqëri në masë të madhe. Siç është identifikuar në “pemën” e problemit, barra mund të shkaktojë shpenzime të panevojshme nga ana e administratës, ato ndikojnë negativisht në mundësitë dhe gatishmërinë për të filluar dhe për të rritur bizneset dhe kështu ngadalësojnë rritjen ekonomike. Kjo, nga ana tjetër, ndikon te qytetarët për shkak të mundësive të humbura për krijimin e vendeve të punës. Përveç kësaj, qytetarët që duhet të punojnë me procedura joefikase humbin kohë dhe duhet të bëjnë shpenzime, të cilat mund të shmangen.

Pasqyra e mëposhtme e tregon këtë në një formë të përmbledhur me fokus në bizneset dhe qytetarët.

Figura 17 - Palët e interesuara të lidhura me dhe/ose të prekura nga barrët administrative

Emri i palës së interesuar	Shkaku (et) me të cilin pala e interesuar është e lidhur	Efkti (et) me të cilin pala e interesuar është e lidhur	Mënyra në të cilat pala e interesuar është e lidhur me këto shkaqe ose efekte
Bizneset	Asnjë	Të gjitha efektet zbatohen për komunitetin e biznesit	Kompanitë duhet të përmbushin detyrimet ligjore; kur këto krijojnë barrë të panevojshme administrative, bizneset detyrohen të bëjnë shpenzime që nuk shtojnë vlerë; si rezultat, kompanitë investojnë më pak në zhvillimin e biznesit
Qytetarët	Asnjë	Të gjitha efektet zbatohen për qytetarët në përgjithësi	Qytetarët duhet të përmbushin detyrimet ligjore; kur këto krijojnë barrë të panevojshme administrative, qytetarët humbin kohën dhe detyrohen të bëjnë shpenzime që nuk shtojnë vlerë; rritja më e ulët ekonomike ndikon në



			mundësitë e punësimit për qytetarët, në veçanti të rinjtë
--	--	--	---

## 1.21 Zhvillimet e pritura të ardhshme - skenari bazë

Ndërkohë që nuk ka të dhëna sasiore në dispozicion për të treguar se si niveli i barrës administrative do të zhvillohej në të ardhmen, pritshmëria e përgjithshme është se ajo do të rritej në rast se nuk do të ndërmerrej ndonjë veprim i politikave. Shkaqet e ndryshme të renditura në Pemën e Problemit nuk do të adresoheshin, ndërsa madhësia e kornizës legjislative do të vazhdonte të rritej.

Ndërkohë që integrimi i Modelit të Kostimit Standard në Udhëzuesin dhe Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve promovon adresimin e barrës administrative në fazat e hershme të zhvillimit të masave të politikave, kjo nuk do të jetë e mjaftueshme për të mundësuar një zvogëlim efektiv të barrës administrative. KD-të zhvillohen për të siguruar një përgjigje të politikave nga ana e Qeverisë. Ndryshimet e mundshme legjislative janë vetëm një opsion në listën e mundësive që Qeveria ka në dispozicion. Ndryshimet e përgjithshme që mbetet të futen në të gjithë kornizën ligjore - veçanërisht detyrimet ligjore përkatëse për procedurat administrative, licencat, lejet dhe shkeljet e lehta - nënkuptojnë që shumica e legjislacionit ekzistues do të duhet të ndryshohet në të ardhmen e afërt. Kjo në vetvete do të krijojë barrë shtesë administrative.

Prandaj, supozimi i përgjithshëm është se barra administrative do të rritet dhe rrjedhimisht edhe pasojat negative do të rriten për nga relevanca. Kjo nënkupton që klima e investimeve dhe të bërit biznes në Kosovë do të përkeqësohet nëse nuk do të iniciohet një politikë efektive që synon zvogëlimin e barrës administrative.

## Kapitulli 2: Objektivat

Objektivat nga të cilat rrjedh ky Koncept Dokument janë thellësisht të përfshira në kornizën e politikave strategjike. Ky kapitull paraqet strategjitë, planet dhe nismat Qeveritare që janë më të rëndësishme në lidhje me zvogëlimin e barrës administrative.

### 2.1 Strategjia për Rregullim më të mirë 2.0 për Kosovën 2017 – 2021

Strategjia për Rregullim më të mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021 (SRM) përcakton objektivin për përmirësimin e sistemit rregullativ në Kosovë. Kjo është elaboruar tutje në Objektivin Specifik 1.1. 'REFORMAT E LEGJISLACIONIT EKZISTUES PRIMAR DHE DYTËSOR PËR TË RRITUR KONKURRENCËN'. Më poshtë janë paraqitur masat që lidhen me këtë objektiv specifik.

#### 2.1.1 Zhvillimi i Koncept Dokumentit për zvogëlimin e barrës administrative

Ky aktivitet është bartur nga Strategjia për Rregullim më të Mirë, që fillimisht është miratuar në vitin 2014. Në të, u njoftua synimi i zvogëlimit të barrëve administrative prej 20% deri në vitin 2020. Megjithatë, sfidat serioze të zbatimit dhe mungesa e përgatitjes për zbatimin e një objekti të tillë çoi në një stagnim në lëvizjen drejt një programi efektiv të zvogëlimit të barrës administrative. Prandaj Qeveria vendosi të rishqyrtojë mënyrën në të cilën duhet të zbatohet një objektivi i zvogëlimit të barrës administrative dhe vendosi të zhvillojë këtë Koncept Dokument si pjesë e përgatitjes për zbatimin e një objekti të zvogëlimit.

#### 2.1.2 Prezantimi i Modelit të Kostimit Standard

Modeli i Kostimit Standard është thelbësor për një zbatim efektiv dhe të matshëm të caktuar për zvogëlimin e barrës administrative. Prandaj SRM njoftoi prezantimin e këtij modeli në sistemin e zhvillimit të politikave, në veçanti për zhvillimin e Koncept Dokumenteve. Në vitin 2018 është përgatitur dhe aprovuar një manual për zbatimin e këtij modeli dhe MKS-ja pritet të përdoret për Koncept Dokumentet që adresojnë Informatat e Obligueshme për bizneset. Për më tepër, është përfunduar një program i Trajnimit të Trajnerëve për zbatimin e MKS-së.

#### 2.1.3 Thjeshtësimi, bashkimi ose heqja e të paktën 10% të licencave dhe lejeve

Objektivi që del nga kontrata e MBS-së për të thjeshtësuar, bashkuar ose hequr 10% të licencave dhe lejeve ekzistuese është integruar në SRM përmes përditësimit të miratuar në vitin 2018<sup>66</sup>. Më shumë informacion mbi këtë është dhënë në nën-seksionin mbi kontratën e MBS-së më poshtë në seksionin "Integrimi Evropian dhe zvogëlimi i barrës administrative".

*Figura 18 - Katër treguesit për vlerësimin e progresit të arritur sipas Objektivit Specifik 1.1 nga Strategjia e Rregullimit më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021*

1) Miratimi i Koncept Dokumentit deri në vitin 2019 mbi përfitimet dhe kostot e zbatimit të një programi të zvogëlimit të barrës së përgjithshme administrative, duke përfshirë një krahasim të dizajnit potencial të projekteve përfshirë edhe opsionet e paraqitura në Figurën 4, kërkesat kryesore lidhur me zvogëlimin e barrës administrative kundrejt një objekti të caktuar dhe një vlerësim i buxhetit për secilin opsion të dizajnit potencial të programit; ky Koncept Dokument do të përcaktojë gjithashtu procesin e thjeshtësimit, bashkimit ose heqjes së 10% të licencave dhe lejeve nga një minimum prej 480 sa ishin në vitin 2014.

2) Zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin e një programi për zvogëlimin e barrës administrative përmes trajnimeve të stafit përkatës në institucionet e QQ-së dhe ministritë e linjës: certifikimi i trajnerëve për

<sup>66</sup>Vendimi i Qeverisë Nr. 02/66 datë 18.09.2018 për Strategjinë e Rregullimit më të Mirë të Kosovës 2017 -2021.

trajnimet e MKS-së deri në vitin 2018; të paktën 5 trajnerë të certifikuar deri në vitin 2018; 20% e stafit përkatës në QQ dhe ministritë e linjës të trajnuar deri në vitin 2018; ky numër rritet në 90% deri në vitin 2021.

3) MKS përdoret gjatë procesit të zhvillimit të politikave në Koncept Dokumentet përkatëse të hartuara sipas udhëzimeve të reja, 30% deri në vitin 2018, 50% në vitin 2019, 100% deri në vitin 2021.

4) Thjeshtësimi, bashkimi ose heqja e të paktën 10% të licencave dhe lejeve deri në fund të vitit 2020 nga një minimum prej 480 sa ishin në vitin 2014.

## 2.2 Angazhimet politike për nxitjen e rritjes ekonomike

Përmirësimi i ekonomisë së Kosovës është një temë qendrore që mbështetet politikisht gjerësisht. Kjo është treguar në strategjitë që qeveritë e njëpasnjëshme kanë miratuar, në Planin e Qeverisë 2017-2021 dhe nga rëndësia që partitë politike në përgjithësi i kushtojnë kësaj teme. Zvogëlimi i barrës administrative është pra një çështje që pritet të jetë relevante për të gjitha palët e spektrit politik.

### 2.2.1 Strategjitë ekzistuese që kanë për qëllim përmirësimin e ekonomisë së Kosovës

Në kornizën e dokumenteve strategjike, krahas strategjive të tjera, janë hartuar dhe miratuar 17 strategji që në veçanti synojnë përmirësimin e performancës së ekonomisë së Kosovës dhe promovimin e rritjes gjithëpërfshirëse. Këto janë paraqitur në tabelën më poshtë. Objektivat e prioritizuara të formuluar në këto strategji reflektohen në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021 dhe në Programin e Reformës Ekonomike 2018-2021.

Nga këto 17 strategji, katër prej kanë skaduar në vitin 2018 të dhe gjashtë të tjera në vitet 2019/2020, nga të cilat disa janë përditësuar dhe disa janë në proces përditësimit. Kjo siguron mundësinë për të adresuar kornizën e politikave përmes së cilave mund të rritet zhvillimi ekonomik.

Megjithatë, varësisht nga zgjedhja përfundimtare politike lidhur me një program të zvogëlimit të barrës administrative që fillimisht ishte planifikuar të bëhet në vitin 2019, mund të pritet që një program i tillë të fillojë në mënyrë të mirëfilltë në vitin 2021. Viti 2020 do të përdorej si viti për t'u përgatitur në mënyrë efektive për zbatimin e politikës. Kjo shpjegohet më hollësisht në Kapitullin 4 mbi Opsionet dhe në veçanti në Kapitullin 6 në të cilin këto opsione krahasohen në bazë të planit të zbatimit të tyre.

Zvogëlimi i barrës administrative do të kontribuonte në objektivat e formuluar në 17 strategjitë e referuara nëpërmjet krijimit të një kornize rregullative më efikase dhe efektive të ndërtuar për të mbështetur aktivitetet e biznesit dhe në të cilën shërbimet qeveritare ofrohen me kostot më të vogla të mundshme. Strategjitë që do të duhej të përditësoheshin do të mund të merrnin parasysh në mënyrë të natyrshme objektivin për të zvogëluar barrët administrative që dalin nga detyrimet ligjore. Një numër i strategjive mund të ketë nevojë të rishikohen në nivel të objektivave ose në nivel të Planit të Veprimit. Përderisa kjo sigurisht që do të çojë në një rritje të nevojës për formulimin e politikave efektive dhe koherente, puna e pritur konsiderohet të jetë e menaxhueshme dhe merret parasysh në Planet e Zbatimit për secilin opion të politikës.

Figura 19 - Strategjitë që synojnë në mënyrë specifike përmirësimin e rritjes ekonomike, klimën e investimeve dhe të bërit biznesit, si dhe krijimin e vendeve të punës

Institucioni	#	Emri i Dokumentit Strategjik	Periodha mbuluar	e
<b>Ministria e Financave dhe Transfereve</b>  <i>(Në kohën e miratimit të strategjive: Ministria e Financave)</i>	1	Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare	2014-2018	
		Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare	2014-2018	
	2	Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike	2016-2020	
		Plani i veprimit i Strategjisë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike	2016-2019	
	3	Strategjia e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike jo	2015-2019	
		Plani i Veprimit i Strategjisë për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike	2015-2019	
<b>Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike</b>  <i>(Në kohën e miratimit të strategjive: Ministria e Zhvillimit Ekonomik)</i>	5	Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë	2011-2020	
	6	Programi për Zbatimin e Strategjisë Minerare	2018-2020	
	7	Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (PVKEE)	2010-2018	
	8	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës	2012-2025	
	9	Strategjia e Kosovës për TI	2014-2020	
	10	Plani i Tretë Afatmesëm Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë	2016-2018	
	11	Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës	2017-2026	
<b>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</b>  <i>(Në kohën e miratimit të strategjive: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale)</i>	12	Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të të Rinjëve	2018-2020	
	13	Strategjia Sektoriale e Punësimit dhe Mirëqenies Sociale	2018-2022	
<b>Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Transfereve</b>  <i>(Në kohën e miratimit të strategjive:)</i>	14	Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën	2013-2018	
		Plani i Veprimit i Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën	2013-2018	
	15	Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal	2015-2025	
		Plani i Veprimit i Strategjisë Sektoriale dhe Transportit Multimodal	2015-2025	

<i>Ministria e Diaporës dhe Investimeve Strategjike)</i>			
<b>Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal</b>	16	Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal	2019-2023
<b>Agjencia kundër Korrupsionit</b>	17	Strategjia Shtetërore kundër Korrupsionit	2018-2022
		Plani i Veprimit i Strategjisë Shtetërore kundër Korrupsionit	2018-2022

## 2.2.2 Zvogëlimi i barrës administrative lidhur me pozicionet e partive politike mbi rritjen ekonomike dhe zvogëlimin e barrës administrative

Rritja e zhvillimit ekonomik, përmirësimi i klimës së të bërit biznes dhe krijimi i një ambienti miqësor për investime janë synimet e përgjithshme politike që të gjitha palët kanë mbështetur në të kaluarën.

Tabela e mëposhtme radhitë, sipas partisë dhe rendit alfabetik, deklaratat publike të bëra nga udhëheqësit partiak gjatë fushatës së fundit zgjedhore. Duke pasur parasysh këtë mbështetje të përgjithshme të synimeve për t'i dhënë hov ekonomisë, zvogëlimi i barrës administrative mund të bëhet një shtyllë qendrore e politikave që kontribuon në zhvillimin e vendit që ka mbështetjen e plotë nga Parlamenti dhe nga qeveritë pasuese të ardhshme.

Figura 20 - Pozicionet e partive politike të përfaqësuara në Parlament në lidhje me rritjen ekonomike dhe zvogëlimin e barrës administrative gjatë zgjedhjeve të vitit 2017

<b>Partia politike dhe shkurtesa (radhitja sipas alfabetit)</b>	<b>Referenca ndaj rritjes ekonomike dhe zvogëlimin të barrës administrative nga manifestimet e partive gjatë zgjedhjeve<sup>67</sup></b>	<b>Deklaratat e rëndësishme të udhëheqësve të partisë për rritjen ekonomike dhe zvogëlimin e barrës administrative, dhe data e tyre</b>
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK	<a href="https://gazetablic.com/i-a-cfare-tha-ramush-haradinaj-sot-ne-hapjen-e-fushates-zgjedhore/">https://gazetablic.com/i-a-cfare-tha-ramush-haradinaj-sot-ne-hapjen-e-fushates-zgjedhore/</a>	<b>Ramush Haradinaj, kandidat për kryeministër nga koalicioni PDK-AAK-NISMA</b>  Kosova po na thërret të kemi ekonomi.  Të rrisim ekonominë e vendit. Të rrisim prodhimin vendor. Të investojmë tek të rinjtë tonë e tek gratë kosovare. Ta sjellim në Kosovë fuqinë e dijes dhe investuesin e diasporës.  Të investojmë te bizneset tona të vogla e të mesme. Të investojmë në bujqësi, të rrisim prodhimin e ushqimit, të hajmë ushqim të shëndoshë, nga toka jonë dhe duart tona...  Ta kthejmë Kosovën në fuqi ekonomike. Ta rrisim buxhetin pa ndalë.

<sup>67</sup> Faqet janë vizituar për here të fundit më 17 janar 2019.

<p>Aleanca Kosova e Re AKR</p>	<p><a href="https://zeri.info/zgjedhjet-2017/146310/pacolli-shpalos-programin-e-akr-se-permend-70-mije-vende-pune/">https://zeri.info/zgjedhjet-2017/146310/pacolli-shpalos-programin-e-akr-se-permend-70-mije-vende-pune/</a>  <a href="http://akr-ks.com/article/pacolli-enderren-e-heronjve-per-kosoven-e-lire-dhe-demokratike-ta-jetesojme-vepra/">http://akr-ks.com/article/pacolli-enderren-e-heronjve-per-kosoven-e-lire-dhe-demokratike-ta-jetesojme-vepra/</a></p>	<p><b>Behgjet Pacolli –në emër të koalicionit AKR-LDK-Alternativa</b></p> <p>“Zhvillimi ekonomik me rritje 8%, krijimi i vendeve të punës deri në 70 mijë, do të themelojmë agjencinë e pavarur të participimeve që të mos e shesim pronën tonë, do të ftojme investitorët që të fillojnë aktivitetet e tyre në fabrikat që nuk janë në funksion, jetësimin e menjëhershëm të tri zonave të lira ekonomike Gjakovën, Mitrovicën, Prizrenin”.</p> <p>“Baza e këtij koalicionit do të jetë rritja ekonomike mbi 8% dhe krijimi i mbi 70 mijë vendeve të reja të punës”</p>
<p>Partia Demokratike e Kosovës PDK</p>	<p><a href="http://www.pdk.info/sevice/post/10475/ekonomia-e-tregut">http://www.pdk.info/sevice/post/10475/ekonomia-e-tregut</a></p>	<p><b>Programi i PDK-së për ekonominë e tregut</b></p> <p>-PDK do të stimulojë, favorizojë dhe mundësojë krijimin e ndërmarrjeve duke bërë lehtësime dhe duke i zbutur masat administrative.</p> <p>- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme paraqet për ne prioritet absolut sepse, në këto ndërmarrje ndodhet potenciali më i madh i rritjes së rendimentit dhe krijimit të vendeve të punës.</p> <p>- PDK do ta orientojë shoqërinë drejt ekonomisë moderne dhe do të angazhohet kundër çdo ngulfatjeje të inovacioneve.</p>
<p>Lidhja Demokratike e Kosovës LDK</p>	<p><a href="https://www.botasot.info/ekonomi-lajme/711065/hoti-rritje-ekonomike-deri-ne-8/">https://www.botasot.info/ekonomi-lajme/711065/hoti-rritje-ekonomike-deri-ne-8/</a></p>	<p><b>Avdullah Hoti, kandidat për kryeministër nga koalicioni LDK-AKR-Alternativa</b></p> <p>“Presim rritja ekonomike të arrijë 7-8% duke e siguruar një platformë transparente...Do të funksionalizojmë pakon e dytë fiskale, do të ulim TVSh-në për akomodim, turizëm, do bëjmë listën e prodhimeve vendore që të kenë lirime...Kemi punuar në licencimin e disa zonave ekonomike..., të cilat do t'i funksionalizojnë krahas një kornize ligjore që iu mundëson bizneseve t'i përdorin ato për të zhvilluar biznesin. Këto zona do të jenë në dispozicion të grave...”, tha Hoti.</p>
<p>Vetëvendosje VV</p>	<p><a href="https://www.vetevendosje.org/">https://www.vetevendosje.org/</a></p>	<p><b>Albin Kurti, kandidat për kryeministër</b></p> <p>Fondi Sovran që do të krijohet, do ta ketë përgjegjësinë ekskluzive për investimet në rritjen e vlerës së Trepçës, KEK-ut, Korporatës së Thëngjillit, PTK-së. Brenda Fondit do të themelohet komponenti kreditues i cili do të financohet nga paratë publike, Fondi i privatizimit dhe shitja e letrave të borxhit, dhe që do të investojë në degë të caktuara të industrisë që krijojnë vende pune e zbusin bilancin tregtar duke u përqendruar në rritjen e eksporteve e zëvendësimin e importeve.</p>
<p>Nisma për Kosovën</p>	<p><a href="http://tesheshi.com/parafushata-zgjedhore-ne-kosove-njihuni-lumin-e-">http://tesheshi.com/parafushata-zgjedhore-ne-kosove-njihuni-lumin-e-</a></p>	<p><b>Fatmir Limaj, kryetar i partisë</b></p> <p>Fatmir Limaj, ka thënë se me partinë e tij NISMA në qeveri do të investohen mbi 400 milionë euro në bujqësi, si dhe çdo</p>

	<p><a href="http://lajmi.net/fatmir-limaj-nisma-do-ti-jep-mundesi-te-re-gjithe-kosoves/">premtimeve-ne-kerkim-te-pushtetit/ http://lajmi.net/fatmir-limaj-nisma-do-ti-jep-mundesi-te-re-gjithe-kosoves/</a></p>	<p>familje do ta ketë nga një të punësuar. Limaj, po ashtu ka premtuar fuqizimin ndërmarrësisë si dhe hapjen e shkollave profesionale.</p> <p>Limaj ka thënë se Nisma për Kosovën do të punojë për të gjithë qytetarët e Kosovës e jo vetëm për individët...Ai ka premtuar vende të reja të punës, zhvillim ekonomik dhe përkrahje ndaj bizneseve të vogla dhe të mesme.</p>
--	---	--

Figura 21 - Pozicionet e partive politike të përfaqësuara në Parlament në lidhje me rritjen ekonomike dhe zvogëlimin e barrës administrative gjatë zgjedhjeve të vitit 2019

<b>Partia politike dhe shkurtesa (radhitja sipas alfabetit)</b>	<b>Referenca ndaj rritjes ekonomike dhe zvogëlimin të barrës administrative nga manifestimet e partive gjatë zgjedhjeve<sup>[1]</sup></b>	<b>Deklaratat e rëndësishme të udhëheqësit të partisë për rritjen ekonomike dhe zvogëlimin e barrës administrative, dhe data e tyre</b>
<p>Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK</p>	<p><a href="https://insajderi.com/hulumtime/41-premtimet-e-pese-kandidateve-per-kryeminister-nuk-permendet-liberalizimi-i-vizave/">https://insajderi.com/hulumtime/41-premtimet-e-pese-kandidateve-per-kryeminister-nuk-permendet-liberalizimi-i-vizave/</a></p>	<p><b>Ramush Haradinaj, kandidat për kryeministër nga koalicioni AAK-PSD</b></p> <p>Ramush Haradinaj, tha se nëse sovran i beson edhe një mandat ai do ta rris pagën në sektorin publik 10% çdo vit. Po ashtu, ai tha se nëse qeverisë sërish, sektori privat do ta ketë në plan të parë. Me edhe një mandat në krye me të, Haradinaj tha se rritja ekonomike e Kosovës do të shkojë deri në 8%. Ai premtoi edhe buxhet të veçantë për gratë shtatzëna dhe lehonat.</p>
<p>Partia Demokratike e Kosovës PDK</p>	<p><a href="https://www.evropaelire.org/a/pdk-papunesia-zgjedhjet/30184861.html">https://www.evropaelire.org/a/pdk-papunesia-zgjedhjet/30184861.html</a></p>	<p><b>Programi i PDK-së për ekonominë</b></p> <p>Ulja e papunësisë deri në 15 për qind, është njëri nga premtimet e Partisë Demokratike të Kosovës. Anëtari i kësaj partie Memli Krasniqi, ka thënë se gjatë mandatit katërvjeçar, rritja ekonomike do të jetë rreth 8 për qind. Krasniqi ka folur edhe për shumë çështje të tjera që e presin qeverinë e ardhshme të Kosovës</p>
<p>Lidhja Demokratike e Kosovës LDK</p>	<p><a href="https://insajderi.com/hulumtime/41-premtimet-e-pese-kandidateve-per-kryeminister-nuk-permendet-liberalizimi-i-vizave/">https://insajderi.com/hulumtime/41-premtimet-e-pese-kandidateve-per-kryeminister-nuk-permendet-liberalizimi-i-vizave/</a></p>	<p><b>Vjosa Osmani, kandidate për kryeministër nga LDK</b></p> <p>Vjosa Osmani premtoi heqjen e barrierave për prodhuesit vendorë ndërkaj tha se politika nuk do të ketë dorë në biznese.</p>

<sup>[1]</sup> Faqet janë vizituar për here të fundit më 17 janar 2019.



		Osmani premtoi edhe bashkëpunim të ngushtë me ndërkombëtarët. E me të si kryeministre, rritja ekonomike tha se do të jetë 6% gjatë mandatit të parë.
NISMA-AKR-PD	<a href="https://reporteri.net/zgjedhjet-2019/premtimet-e-partive-ne-diten-e-pare-te-fushates-60-mije-vende-te-reja-pune-shtesa-te-femijeve-mbeshtetje-fermereve-lufte-korrupsionit/">https://reporteri.net/zgjedhjet-2019/premtimet-e-partive-ne-diten-e-pare-te-fushates-60-mije-vende-te-reja-pune-shtesa-te-femijeve-mbeshtetje-fermereve-lufte-korrupsionit/</a>	<p><b>Behxhet Pacolli, në emër të koalicionit NISMA-AKR-PD</b></p> <p>Kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli iu drejtua të pranishmëve me një mesazh pasi ishte jashtë vendit. Ai nder të tjerash tha se me qeverisjen NISMA-AKR-PD vendi do të ketë 8 % rritje ekonomike dhe 60 mijë vende të reja pune.</p> <p>“Pas 6 Tetorit ne do të sigurojmë qeveri të ndershme dhe me prosperitet. Buxheti i Kosovës do të jetë zhvillimor dhe jo vetëm për shpenzim. Synojmë të kemi rritje ekonomike prej 8% dhe mbi 60 mijë vende të reja pune në sektorin privat”, premtoi Pacolli.</p>
Vetëvendosje VV	<a href="https://kallxo.com/gjate/analize/ekipi-i-albin-kurtit-shpalos-planet-e-tij-qeverisese/">https://kallxo.com/gjate/analize/ekipi-i-albin-kurtit-shpalos-planet-e-tij-qeverisese/</a>	<p><b>Albin Kurti, kandidat për kryeministër</b></p> <p>“Luftimi i nepotizmit dhe ndalja e privatizimit të mëtejshëm është pjesë e planit”, tha udhëheqësi i Vetëvendosjes, i cili po ashtu premtoi se do të mbyllë Agjencinë Kosovare të Privatizimit, APK.</p> <p>Kurti njëkohësisht premtoi krijimin e një Banke Zhvillimore për të ndihmuar bizneset vendase, duke vënë theksin e tij tek kritikën ndaj normave të larta të interesit të ofruara nga bankat ekzistuese komerciale, të cilat, momentalisht, variojnë midis gjashtë dhe tetë përqind.</p> <p>“Me Bankën Zhvillimore synojmë të kemi norma të interesit në më pak se tre përqind,” tha ai, duke shtuar se bizneset e vogla dhe të mesme do të përfitonin më shumë nga një bankë e tillë.</p>

## 2.3 Integrimi Evropian dhe zvogëlimi i barrës administrative

Zvogëlimi i barrës administrative është një temë qendrore për Integrimin Evropian. Për shembull, Komisioni Evropian theksoi në raportin e tij të vitit 2018 për Kosovën nevojën për t'u 'përballur me luftën kundër ekonomisë joformale'<sup>68</sup> për të siguruar zbatimin efektiv të Acquis<sup>69</sup>. Për më tepër, në raport thuhet se ekziston nevoja për 'zvogëlimin e barrës administrative për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme'<sup>70</sup> përmes Vlerësimit të Ndikimit. Këto aspekte u ngritën gjithashtu në Raportet e BE-së për Kosovën të vitit 2014, 2015 dhe 2016.

Përderisa sistemi për zhvillimin e Koncept Dokumenteve është forcuar tutje me prezantimin e Testit të NVM-ve dhe Modelit të Kostimit Standard për të matur dhe zvogëluar barrët administrative<sup>71</sup>, këto masa adresojnë rrjedhën e legjisllacionit të ri. Ata nuk sigurojnë sistematikisht zvogëlimin e barrëve administrative që rrjedhin nga legjisllacioni ekzistues.

Kërkesat e vështira ligjore mund të jenë një arsye e rëndësishme pse bizneset në sektorin joformal zgjedhin të mos formalizojnë aktivitetet e tyre<sup>72</sup>. Një zvogëlim i barrëve administrative do të lehtësojë barrën për biznesin i cili, nga ana tjetër, do të siguronte një bazë më të mirë për kompanitë që të regjistroheshin formalisht. Prandaj, një program efektiv i zvogëlimit të barrës pritet të rezultojë në zvogëlimin e ekonomisë joformale dhe të kontribuojë për një ekonomi më të fortë.

*Figura 22 - Fragmente nga raportet e BE-së të viteve 2014, 2015, 2016, dhe 2018 për Kosovën dhe Agjendën për Reforma Evropiane 2016, duke i referuar veçanërisht barrëve administrative dhe mjedisit të të bërit biznes*

### Raporti për Kosovën - 2018

"Sa i përket harmonizimit me standardet Evropiane, Kosova është në një fazë të hershme. **Shtrirja legislative ka vazhduar në disa fusha, por zbatimi është i dobët. Në përgjithësi, Kosova duhet të përmirësojë kapacitetet e saj administrative dhe koordinimin, në të gjithë sektorët, për të siguruar zbatimin efektiv të Acquis.**"

Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet, në veçanti, **të përmirësojë parashikueshmërinë ligjore për qytetarët dhe bizneset** duke ndryshuar gradualisht ligjet e veçanta të identifikuar dhe rregulloret zbatuese që bien ndesh me Ligjin e ri mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe duke adresuar grumbullin e lëndëve të pazgjidhura administrative".

"Gjykata Themelore e Prishtinës **ka një numër të konsiderueshëm të lëndëve të pazgjidhura administrative**".

"**Qeveria promovon një administratë të orientuar nga përdoruesit, por mungesa e një vizioni, udhëheqje dhe koordinimi të qartë pengojnë përpjekjet për reforma.** Prandaj, shumë institucione kanë filluar të zbatojnë zgjidhjet e tyre vetanake jashtë instrumenteve qendrore të identifikimit elektronik (eID) që po zhvillohen. Instrumentet qendrore për të mbledhur informacione kthyes publike dhe biznesore mbi ofrimin e shërbimeve janë në një fazë të hershme të zhvillimit. Zgjidhjet teknike për interoperabilitet mbetet të zhvillohen. **Legjisllacioni për qasje të barabartë në shërbime ekziston, por zbatimi i tij është një sfidë, veçanërisht për personat me lëvizshmëri të zvogëluar. Ekziston legjisllacioni për qasje të barabartë në shërbime, por zbatimi i tij është një sfidë, veçanërisht për personat me lëvizshmëri të zvogëluar.**"

<sup>68</sup> Raporti për Kosovën \* 2018 në përcjellje të dokumentit Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, 2018. Komunikata për Politikën e Zgjerimit të BE-së, 17.4.2018, SWD (2018) 156 final, faqe 5.

<sup>69</sup> Po aty.

<sup>70</sup> Po aty, faqe 65.

<sup>71</sup> Vendimi i Qeverisë Nr. 20/20, datë 20.12.2017, mbi miratimin e Udhëzimeve për Hartimin e Koncept Dokumenteve dhe përdorimin e Testit të NVM-ve dhe MKS-së.

<sup>72</sup> Andrews, D., A. Caldera Sánchez and Å. Johansson (2011), "Towards a Better Understanding of the Informal Economy (Drejt një të kuptuari më të mirë të ekonomisë joformale)", Dokumentet e punës të Departamentit të Ekonomisë të OECD, Nr. 873, Botimi i OECD-së, Paris, <http://dx.doi.org/10.1787/5k9b1mf88x28-en>, faqe 28.

"Eksportet e shtuara të shërbimeve ndihmuan në ngushtimin e pabarazive të jashtme. Deficiti i llogarisë rrjedhëse u zvogëluar në 5.9% të BPV-së në vitin 2017, krahasuar me 9.1% të PBV-së në vitin 2016. Kjo ishte kryesisht rezultat i rritjes së fortë në eksportet e shërbimeve. Ndryshimet metodologjike në llogaritjen e aktivitetit ekonomik të diasporës periodikisht të kthyer në Kosovë mund të shpjegojnë një rregullim të tillë të fortë dhe rënien e konsumit privat të përmendur më lart. Deficiti tregtar i mallrave u rrit për 1 përqind në 38.9% të BPV-së. Remitenat, si një burim i rëndësishëm i të ardhurave për shumë ekonomi familjare të Kosovës, u rritën në 12% të BPV-së në vitin 2017. IHD-të neto u rritën në 3.9% të BPV-së krahasuar me 2.9% të BPV-së në vitin 2016). Flukset hyrëse të IHD-ve ishin edhe më të përqendruara në vitin 2017, duke pasur parasysh se pjesëmarrja e investimeve të huaja direkte në patundshmëri, ndërtimtari dhe sektorin financiar u rrit në 97.1%. Fluksi hyrës në sektorët e prodhimit ishte negativ. **Kjo pasqyron një mjedis të dobët biznesi dhe pak mundësi investimi "greenfield"**.

Një konsideratë e rëndësishme për këtë Koncept Dokument: Zonat ekonomike të identifikuar si sektorët kryesorë që shtyjnë eksportet dhe sektorët e karakterizuar nga niveli i lartë i joformalitetit mund të jenë fushat prioritare për zvogëlimin e barrës administrative. Kjo do të nxiste tutje rritjen ekonomike duke forcuar sektorët e fortë të eksportit dhe duke zvogëluar joformalitetin

**"Pavarësisht progresit në rregullat ligjore që rregullojnë bizneset, mbeten ende shumë pengesa.** Në vitin 2017 Kosova ishte një nga 10 reformatorët kryesorë sipas raportit të të Bërit Biznes të Bankës Botërore. Megjithatë, pengesat kryesore në të bërit biznes ende përfshijnë një administratë të dobët dhe jo llogaridhënëse, sundimin e dobët të ligjit, korrupsionin dhe një ekonomi shumë të përhapur joformale. Edhe pse joformaliteti mbetet i lartë, gjegjësisht rreth 30% e BPV-së, studimet e ndryshme tregojnë për rënien e tij të vazhdueshme në mes të vitit 2013 dhe 2015 për shkak të përmirësimit të efektivitetit të praktikave të administrimit tatimor.

Megjithatë, ekonomia e zezë u rrit në terma absolut. **Sektorët e ndërtimit dhe të tregtisë përjetuan humbjet më të mëdha në të ardhura për shkak të joformalitetit "**

**"Është shënuar ca progres duke prezantuar masa për përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes. Ekziston nevoja për të ndërtuar tutje kapacitetet administrative dhe për të siguruar një koordinim më të fortë ndër-ministror "**

### **Raporti për Kosovën – 2016**

"Ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset: Qeveria është e angazhuar për një administratë të orientuar drejt përdoruesit. Megjithatë, politikbërja koherente shpesh është dëmtuar nga mungesa e koordinimit dhe vizionit të përbashkët midis ministrive përgjegjëse. Zhvillimi i shërbimeve elektronike është i ngadalshëm për shkak të mungesës së një kornize të përshtatshme të interoperabilitetit".

"Në përputhje me udhëzimet e politikave të PRE-së dhe për të mbështetur rritjen afatgjatë, në vitet në vijim Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë **përmirësimit të procedurave të bankrotimit dhe falimentimit"**.

"Mjedis i të bërit biznes - Ka përparim në thjeshtësimin e regjistrimit të biznesit dhe procedurave të falimentimit. Themelimi i 29 zyrave të shërbimeve për qytetarë (*one stop shops*) ka zvogëluar kohën e nevojshme për të regjistruar një kompani në 3 ditë. Megjithatë regjistrimi online, ende nuk është zbatuar plotësisht."

"Kosova ka një nivel të përgatitjes për industrinë dhe politikën e NVM-ve. Është shënuar ca progres në këtë fushë, sidomos me krijimin e një skeme të garantimit të kredive për të mbështetur NVM-të. Siç është rekomanduar tashmë vitin e kaluar, Kosova duhet në veçanti:

- të ndjek rekomandimet nga vlerësimi i 'Akti i Biznesit të Vogël' të BE-së;
- të prezantojë vlerësimet e ndikimit rregullativ për të zvogëluar barrën administrative për NVM-të.

Zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit të Sektorit Privat të Kosovës 2013-2017 ka bërë progres të ngadaltë, ndërkohë që strategjia industriale ende mbetet të finalizohet. Të dyja duhet të përafrohen me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2020 të miratuar në janar të vitit 2016. Nuk ka pasur asnjë përcjellje të mëtëjshme që nga raporti i vitit të kaluar i vendit për vlerësimin e "Aktit të Biznesit të Vogël" të BE-së.

Parimi 'heshtja nënkupton pëlqim' për regjistrimin e biznesit dhe regjistrimin e kompanisë online ende nuk është prezantuar. Pengesat kryesore për zhvillimin e NVM-ve dhe rritjen e mëtëjshme mbeten qasja e kufizuar në financa, **zbatimi i dobët ligjor i kontratave dhe rregulloreve të biznesit, barrierat administrative,** konkurrenca e padrejtë nga sektori joformal, gjyqësori joefikas dhe korrupsioni "

"Harmonizimi me Direktivën Nr.2009/28/KE të burimeve të ripërtëritshme të energjisë është synuar me ndryshimet në ligjet për energjinë, energjinë elektrike dhe rregullatorin e energjisë të miratuar në qershor të vitit 2016. Ndërkohë që

plani i veprimit të energjisë së ripërtëritshme dhe të efikasitetit të energjisë të Kosovës për vitet 2013-2020 përcakton një përqindje shumë ambicioze prej 29.47% të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2020, tani duket se ka shumë pak gjasa që Kosova të përmbushë madje edhe objektivin e detyrueshëm prej 25%. Kjo është në veçanti për shkak të viteve të neglizhencës në sektor, **kornizës rregullative joefikase** (në veçanti procedurave të gjata administrative në dhënie dhe lejeve dhe licencave të ndryshme) dhe kapacitetit të dobët administrativ në menaxhimin e burimeve të ripërtëritshme.”

### **Raporti për Kosovën - 2015**

“Rekomandimi 8 i PRE-së: **“Të vazhdohet me përmirësimin e mjedisit afarist dhe të gjenden zgjidhje për rastet ende të pazgjidhura nëpër gjykata; të fuqizohen kapacitetet e sistemit gjyqësor dhe zhvillimi i bazave të të dhënave për kadastrën; të avancohen masat për trajtimin e joformalitetit në përputhje me strategjinë për **parandalimin e luftës kundër ekonomisë joformale, përfshirë këtu stimulimet për zvogëlimin e punës së padeklaruar. Të zvogëlohet barra administrative për biznesin** përmes implementimit të Strategjisë për Rregullim më të Mirë dhe Ligjit për Leje dhe Licenca.”**

“Kosova ka pak nivel përgatitjeje në industri dhe në NVM. Pak progres është shënuar në këtë fushë. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti të:

→ ndjekë rekomandimet e vlerësimit “Akti i Bizneseve të Vogla”

**“Përkundër përparimit të vogël që është bërë në rregullat ligjore që qeverisin afarizmin, implementimi i tyre ka mbetur i pamjaftueshëm. Kapaciteti shumë i dobët institucional për zbatimin ligjor, i kombinuar me korrupsionin e përhapur, ka vazhduar të vështirësojë mjedisin afarist. Sistemi gjyqësor vuan nga mundësia e dobët e qasjes, joefikasiteti, vonesat dhe një numër në rritje i rasteve të pazgjidhura (400 000 në korrik 2015).”**

### **Raporti për Kosovën - 2014**

“Korniza ligjore për kontabilitetin dhe auditimin e korporatave është e dobët; kjo ndikon në kapacitetin e kompanive për të marrë kredi si dhe ngadalëson zhvillimin e tregut financiar. Kosova ka nevojë të harmonizoj kërkesat që kanë të bëjnë me kontabilitetin dhe raportimin sipas standardeve ndërkombëtare.

Sa i përket blerjes së pasurive të patundshme, duke përfshirë edhe blerjen e tokës nga personat që nuk janë shtetas të Kosovës, korniza ligjore kushtetuese i mundëson të huajve të blejnë pasuri të patundshme. Megjithatë, dispozitat në ligjet sektoriale dhe praktikat administrative i parandalojnë ata nga ushtrimi i kësaj të drejte. **Identifikimi i këtyre pengesave nga ana e Kosovës është në vazhdim e sipër dhe heqja e tyre do të ndihmojë në rritjen e investimeve të huaja.”**

“Duhet ti jepet prioritet zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël. Ky zbatim ende është në një fazë të hershme. Konsultimi i komunitetit të biznesit gjatë hartimit të ligjeve, strategjive dhe vlerësimit të ndikimit është thelbësor. Mjedisi i biznesit në Kosovë mbetet sfidues.

Në përgjithësi, është bërë përparim i kufizuar në politikën industriale dhe të NVM-ve. Për të përmirësuar mjedisin e biznesit, Kosova duhet të përmirësojë kushtet për zbatimin e kontratave, **të reduktojë barrierat e panevojshme administrative**, të promovojë luftën kundër ekonomisë jo-formale dhe korrupsionit, dhe të zhvilloj një treg financiar.”

### **Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) – nëntor, 2016**

- Reduktimi i barrës rregullative ndaj kompanive, në veçanti përmes bërjes transparente të tarifave dhe procedurave të kërkuara për leje dhe licenca.
- Ndërmarrja e masave pasuese bazuar në rekomandimet e vlerësimit rreth ‘Aktit të Bizneseve të Vogla’
- Fokusi në përmirësimin e treguesve të raportit të 'Të Bërit Biznes' të Bankës Botërore
- Regjistrimi online i bizneseve është vënë në dispozicion

Segmente të plota të tekstit nga faqet e listuara jepen në Shtojcat 3 dhe 4.

### **2.3.1 Kontrata për Mbështetje Buxhetore Sektoriale për Reformën e Administratës Publike**

Kontrata për Mbështetje Buxhetore Sektoriale për Reformën e Administratës Publike dhe Marrëveshja Financiare e ndërlidhur ka hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2017. Sipas kësaj kontrate, zvogëlimi i barrës

administrative është një tregues specifik që ndahet në tri komponentë që priten të përmbushen në 2018, 2019 dhe 2020.

Treguesi 5.1 përcakton nevojën për rritjen e kapaciteteve në ZKM për menaxhimin e zvogëlimit të barrës administrative. Pa këto përshtatje, puna shtesë që del nga zvogëlimi i barrëve administrative nuk do të ishte e zbatueshme pasi që burimet ekzistuese njerëzore në zyrat përkatëse janë të pamjaftueshme.

Treguesi 5.2 përcakton kërkesën për të zhvilluar bazën për zvogëlimin efikas të barrës administrative përmes këtij Koncept Dokumenti. Ky KD siguron bazën për objektivin e formuluar sipas treguesit 5.3 dhe gjithashtu shqyrton mundësitë për të përfshirë zvogëlimin e barrës administrative si një qëllim qendror të politikave në kuadrin e politikës strategjike dhe, si rrjedhojë, edhe në proceset e punës për zhvillim të politikave dhe ligjëbërje.

Treguesi 5.3 përcakton synimin për thjeshtimin, bashkimin ose heqjen e 10% të të gjitha licencave dhe lejeve kundrejt gjendjes fillestare të vitit 2014. Thjeshtimi vlerësohet bazuar në një metodologji që rrjedh nga Modeli i Kostimit Standard, por përjashton nevojën për matjen e plotë të barrëve administrative.

*Figura 23 - Metodologjia për vlerësimin e zvogëlimit të barrës administrative për Treguesin 5.3 të Kontratës për Reformë Sektoriale për Reformë të Administratës Publike*

Zvogëlimi i barrës administrative do të matet në bazë të parimeve të mëposhtme:

- Heqja e një licence ose leje shënohet si thjeshtim; analiza të mëtijshme nuk janë të nevojshme.
- Bashkimi i licencave ose lejeve shënohet si thjeshtim kur format dhe/ose procesi i aplikimit janë të kombinuara; kjo duhet të vërtetohet duke treguar se baza ligjore është përshtatur dhe se bashkimi ka ndodhur.
- Thjeshtimi i licencave dhe lejeve individuale duhet të tregohet në bazë të Modelit të Kostimit Standard (MKS), i cili përdoret për matjen e barrës administrative. Meqenëse koha për analizë është e kufizuar, do të zbatohen katër variablat e MKS-së, por matja mund të përshtatet me nevojat reale për informata për të dëshmuar se licenca ose leja është thjeshtuar.

MKS-ja llogarit barrën administrative për licencat dhe lejet bazuar në katër faktorë: 1) kohën e nevojshme për të përfunduar procesin për aplikim për licencë ose leje; 2) nivelin e pagës të personit (personave) që kanë nevojë për të plotësuar kërkesën për licencë ose leje; 3) numrin e kompanive që kanë nevojë të aplikojnë për licencë; dhe 4) frekuencën në të cilën licenca ose lejet duhet të ripërtërihen.

Faktori (1), koha e nevojshme për të përfunduar procesin e aplikimit për një licencë ose leje, përcaktohet nga faktorë siç janë sasia e informatave që duhet të sigurohet (p.sh. dokumentet e certifikuara, kopjet e dokumenteve, etj.), gjatësia dhe kompleksiteti i formularëve që duhet të plotësohen, mënyra në të cilën dokumentet mund t'i dorëzohen autoriteteve (kopjet fizike kundrejt shkëmbimit elektronik) dhe koha e përpunimit e cila i duhet administratës për të miratuar licencën ose lejen. Një masë shënohet si thjeshtim kur kërkesat specifike janë eliminuar në atë mënyrë që koha e nevojshme për të aplikuar për një licencë ose leje janë zvogëluar.

Faktori (2), niveli i pagës i personit (personave) që duhet ta plotësojnë aplikacionin për licencë ose leje, rrjedh nga kompleksiteti i kërkesave të licencës dhe lejes dhe kërkesat ligjore. Faktori më i rëndësishëm përcaktues është nëse aplikimi për licencë ose leje kërkon përfshirjen e ekspertëve të jashtëm siç janë avokatët, kontabilistët dhe auditorët për detyra, të cilat nëse thjeshtohen, mund të ekzekutohen nga stafi i kompanisë. Një masë shënohet si thjeshtim kur dëshmohet se puna që normalisht kryhet nga ekspertë të jashtëm tani kryhet brenda kompanisë. Komuniteti i biznesit do të duhet të njohë në mënyrë specifike thjeshtimet që nuk pasqyrohen qartë në ndryshimet në kërkesat ligjore për licencat dhe lejet.

Faktori (3), numri i kompanive që duhet të aplikojnë për licencë ose leje përcaktohet nga fushëveprimi ligjor i një licence ose leje. Një masë shënohet si thjeshtim kur ky fushëveprim ligjor zvogëlohet, p.sh. duke i liruar kompanitë e klasave të madhësive të caktuara nga kërkesat ligjore ose duke zbatuar masa të tjera të përshtatshme për NVM-të.

Faktori (4), frekuenca në të cilën licenca ose lejet duhet të ripërtërihen, përcaktohet nga frekuenca e përcaktuar në ligje ose në akte nënligjore. Një masë shënohet si një thjeshtim kur periudha e vlefshmërisë së një licence ose leje zgjatet, pasi që kjo do të çojë në një frekuencë më të ulët për ripërtëritje dhe kështu në më pak procese të aplikimit përgjatë një periudhe të caktuar kohore.

Prezantimi i bazuar në MKS i të arriturave të thjeshtimit përfshin parimin e analizës proporcionale në procesin analitik për Koncept Dokumentin dhe raportimin mbi përmbushjen e caktuar. Nuk kërkohet ndonjë matje bazë e detajuar e barrës administrative për licencat dhe lejet.

## 2.4 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm

Në vitin 2015, të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara miratuan 'Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm'<sup>73</sup>. Kjo agjendë është e përpunuar në 17 Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ) që ofrojnë një plan global të përbashkët për paqen dhe prosperitetin. OZhQ-të janë një thirrje urgjente për veprim nga të gjitha vendet - të zhvilluara dhe në zhvillim - në një partneritet global. Ato e pranojnë se dhënia fund varfërisë dhe privimeve të tjera duhet të shkojnë krahas me strategjitë që përmirësojnë shëndetin dhe arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike - e të gjitha këto duke trajtuar njëkohësisht ndryshimet klimatike dhe punuar drejt ruajtjes së natyrës.

Kuvendi miratoi rezolutën e tij mbi Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm më 25 janar 2018<sup>74</sup>. Në këtë rezolutë, Kuvendi theksoi rëndësinë e zbatimit të OZhQ-ve për përmirësimin e ekonomisë dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Kosovës. Gjithashtu, theksoi rëndësinë e OZhQ-ve për zhvillimin e vendit dhe në këtë mënyrë i mbështeti plotësisht ato.

Figura 24 - Zvogëlimi i barrës administrative kontribuon në një varg të OZhQ-ve siç paraqitet në tabelën më poshtë

Objektivi për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ)	Synimet dhe treguesit e OZhQ-ve
OZhQ 8 Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës së denjë për të gjithë	<p>8.1 - Mbështetja e rritjes ekonomike për kokë banori në përputhje me rrethanat kombëtare dhe në veçanti, të paktën 7 për qind rritje vjetore të produktit vendor në vendet më pak të zhvilluara</p> <p>8.1.1 - Norma vjetore e rritjes së PBV-së reale për kokë banori</p> <p>8.3 - Promovimi i politikave të orientuara drejt zhvillimit që mbështesin aktivitetet produktive, krijimin e vendeve të denja të punës, ndërmarrësin, kreativitetin dhe inovacionin, dhe inkurajojnë formalizimin dhe rritjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, duke përfshirë qasjen në shërbimet financiare</p> <p>8.3.1 - Përqindja e punësimit joformal në punësimin në sektorin jobujqësor, sipas gjinisë</p> <p>8.6 - Deri në vitin 2020, duhet të ulet ndjeshëm përqindja e të rinjve që nuk kanë qasje në punësim, arsimim apo aftësim</p> <p>8.6.1 - Përqindja e të rinjve (të moshës 15-24 vjeçare) që nuk kanë qasje në arsim, punësim apo aftësim</p>
OZhQ 9 Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit	<p>9.b - Mbështetja e zhvillimit të teknologjisë vendore, hulumtimit dhe inovacionit në vendet në zhvillim, duke përfshirë sigurimin e një mjedisi të favorshëm politikash për, ndër të tjera, diversifikimin industrial dhe shtimin e vlerës në mallra.</p>

<sup>73</sup> <https://sustainabledevelopment.un.org>

<sup>74</sup> Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 06-R-001, e datës 25 janar 2018.



<p>gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit</p>	
<p>OZhQ 10 Zvogëlimi i pabarazisë brendapërbrenda vendeve dhe mes tyre</p>	<p>10.3 - Sigurimi i mundësive të barabarta dhe zvogëlimi i pabarazive të rezultateve, përmes eliminimit të ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimit të legjislacionit, politikave dhe veprimeve përkatëse në këtë drejtim</p> <p>10.3.1 - Përqindja e popullsisë që raporton se është ndjerë personalisht e diskriminuar ose e ngacmuar gjatë 12 muajve të kaluar në bazë të një arsytimi të diskriminimit të ndaluar sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut</p> <p>10.4 - Miratimi i politikave, veçanërisht politikave fiskale, të pagave dhe të mbrojtjes sociale, dhe arritja në mënyrë progresive e shkallës më të lartë të barazisë</p>
<p>OZhQ 16 Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet</p>	<p>16.3 - Nxitja e sundimit të ligjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë</p> <p>16.6 - Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet</p> <p>16.6.1 - Shpenzimet primare të qeverisë si përqindje e buxhetit të miratuar origjinal, sipas sektorëve (ose sipas kodeve buxhetore ose të ngjashme)</p> <p>16.6.2 - Përqindja e popullsisë së kënaqur me përvojën e tyre të fundit të shërbimeve publike</p> <p>16.7 - Sigurimi i vendimmarrjes së përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet</p> <p>16.7.2 - Përqindja e popullsisë që beson se vendimmarrja është gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme, sipas gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar dhe grupit të popullsisë</p> <p>16.10 - Të sigurohet qasja e publikut në informata dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare</p> <p>16.B - Promovimi dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave jodiskriminuese për zhvillim të qëndrueshëm</p> <p>16.B.1 - Përqindja e popullsisë që ka raportuar se është ndjerë personalisht e diskriminuar ose e ngacmuar gjatë 12 muajve të kaluar në bazë të një arsytimi të një diskriminimi të ndaluar sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut</p>
<p>OZhQ 17</p>	<p>17.14 - Rritja e koherencës së politikave për zhvillim të qëndrueshëm</p> <p>17.14.1 - Numri i vendeve me mekanizma ekzistues për të rritur koherencën e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm</p> <p>17.16 - Rritja e partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm, e plotësuar me partneritete shumëpalëshe që mobilizojnë dhe ndajnë njohuritë, ekspertizën, teknologjinë dhe burimet financiare për të mbështetur arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha vendet, veçanërisht në vendet në zhvillim.</p>



## 2.5 Përmbledhje e referencave aktuale për zvogëlimin e barrës administrative në kuadrin e politikave strategjike të Qeverisë

Figura më poshtë përmbledh objektivat strategjike dhe masat që Qeveria ka miratuar në dokumente të ndryshme të planifikimit dhe që lidhen drejtpërdrejt me zvogëlimin e barrës administrative.

Figura 25 - Përmbledhja dhe origjina e objektivave, masave dhe referencave të Qeverisë që (in-) direkt prekin zvogëlimin e barrës administrative

Objektivi	Origjina
<p><b>OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 1. SISTEMI RREGULLATIV LEHTËSUES</b></p> <p>Objektivi Specifik 1.1. ‘REFORMAT E LEGJISLACIONIT EKZISTUES PRIMAR DHE SEKONNDAR PËR TË RRITUR KONKURRUESHMËRINË’</p>	Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021 dhe Plani i saj mbështetës i Veprimit
<p>Lista e objektivave të Zyrës së Kryeministrit</p> <p>5. Zhvillimi i një sistemi rregullativ lehtësues për bizneset dhe qytetarët</p>	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021
<p>Masa 8. Përmirësimi i mëtutjeshëm i ofrimit të shërbimeve për bizneset dhe qytetarë</p> <p>Masa 9. Zvogëlimi i pengesave administrative për licencat dhe lejet</p>	<p>Udhërrëfyese për SKZH 2016-2021</p> <p>Shtylla e dytë: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit</p>
<p>Reformat strukturore – Fusha IV. Mjedisi i biznesit dhe reduktimi i ekonomisë informale</p> <p>Masa #8: Miratimi i politikave të bazuara në dëshmi dhe zvogëlimi i barrës administrative</p> <p>Qëllimi i masës është të prezantojë vlerësimin ex-ante të politikave, të thjeshtojë legjislacionin dhe sistemin rregullator, duke përfshirë zvogëlimin e barrës administrative për bizneset në bazë të miratimit të këtij koncept dokumenti.</p>	<p>PRE – 2018-2021</p> <p>Përmbledhje e reformës makro ekonomike</p>
<p>Reduktimi i barrës rregullative ndaj bizneseve, në veçanti përmes bërjes transparente të tarifave dhe procedurave të kërkuara për leje dhe licenca.</p> <p>Ndërmarrja e masave pasuese bazuar në rekomandimet e vlerësimit rreth “Aktit të Bizneseve të Vogla”</p> <p>Fokusi në përmirësimin e treguesve të raportit të 'Të Bërit Biznes' të Bankës Botërore</p> <p>Regjistrimi online i bizneseve është vënë në dispozicion</p>	ERA
<p>Racionalizimi i shpenzimeve operative dhe krijimi i hapësirës për rritjen e financimit dhe efektivitetit të institucioneve gjyqësore, shëndetësore dhe arsimore</p> <p>Përmirësimi i efektivitetit të shpenzimeve sociale dhe subvencioneve bujqësore përmes targetimit më të mire dhe mundësive të testimit në</p>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021

kuadër të shpenzimeve aktuale. Mobilizimi i të hyrave duke zgjeruar bazën tatimore në vend të rritjes së normave tatimore statutores.

Thjeshtimi i tarifave administrative dhe zvogëlimi i barrës rregullative.

## Kapitulli 3: Opsionet

Opsionet që ekzistojnë për zbatimin e një programi për zvogëlimin e barrës administrative janë të shumfishta. Të dhënat që duhet të mbështesin vendimin/vendimarrjen për këtë program janë: përfitimet që pritet të sjell sa i përket rritjes ekonomike; efektet që një kornizë e përmirësuar ligjore dhe zbatuese pritet të ketë; realizueshmëria në mënyrë efektive e zbatimit të programit të zvogëlimit të barrës administrative; dhe kapacitetet njerëzore, organizative dhe financiare që kërkohen për të arritur këtë qëllim.

Me qëllim të përcaktimit të përfitimeve dhe kërkesave të një programi të zvogëlimit të barrës administrative, mësimet e nxjerra në juridiksione të tjera japin kontribut të çmuar në lidhje me mundësitë, sfidat dhe konsideratat që duhet të merren parasysh për analizën dhe duhet të pasqyrohen në planin e zbatimit. Prandaj, para se të prezantohen opsionet dhe ndikimet e tyre, paraqitet informacion nga vende tjera për të treguar se si janë zbatuar programet e zvogëlimit të barrës administrative në të kaluarën dhe cilat çështje janë relevante.

Zvogëlimi i barrës administrative është një politikë që është zbatuar me sukses nga një numër vendesh. OECD, për shembull, analizoi politikën rregullatore të 39 shteteve dhe raportoi mbi këtë në vitin 2018. Prej tyre, 31 kanë kryer një rishikim të madh të legjislacionit të tyre të bazuar në parime dhe 26 kanë kryer regjistrime publike në të cilat konsultuan qytetarët dhe kompanitë për mënyrën e përmirësimit të legjislacionit<sup>75</sup>.

Përvoja nga një numër vendesh është paraqitur më poshtë. Procesi nëpër të cilin kanë kaluar këto vende ofron informatë të rëndësishme për këtë Koncept Dokument. Së pari, janë paraqitur përvojat nga BE dhe disa nga shtetet anëtare të saj (seksioni "3.1 Krahasimi Ndërkombëtar"). Së dyti, aktivitetet në lidhje me zvogëlimin e barrës administrative dhe thjeshtimin legjislativ të zbatuar nga disa vende të Ballkanit Perëndimor do të prezantohen për të pozicionuar situatën e Kosovës në kontekstin rajonal (seksioni '3.2 Kontrolli i Konkurrencës Rregullatore').

### 3.1 Krahasimi Ndërkombëtar

Përshkrimi i mëposhtëm i përpjekjeve për të zvogëluar barrën administrative ofron një pasqyrë të disa vendeve dhe Bashkimit Evropian që kanë miratuar politika të suksesshme të zvogëlimit të barrës administrative.

Përshkrimi fillon me paraqitjen e politikës së zvogëlimit të barrës administrative në Holandë, për faktin se Holanda ka qenë nxitëse për përpjekjet ndërkombëtare për të rritur efikasitetin e legjislacionit nëpërmjet matjeve të bazuara në Modelin e Kostimit Standard dhe procesin e zvogëlimit transparent dhe të verifikueshëm të barrës administrative bazuar në atë model. Holanda konsiderohet se ofron një referencë veçanërisht të mirë pasi tregon se zvogëlimi i barrës administrative mund të menaxhohet me qeveri që ndërrohen vazhdimisht, dëshmitare e të cilave ka qenë edhe Kosova në të kaluarën e afërt. Për më tepër, përvoja e Holandës siguron një pasqyrë të mirë të zhvillimeve në fushëveprimin e zvogëlimit të barrës administrative, si një politikë e centralizuar në nivel të qeverisë.

Ky prezantim i shembullit holandez është plotësuar me karakteristika specifike relevante të programeve të zvogëlimit të barrës administrative të Bashkimit Evropian, Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Këto programe janë paraqitur qëllimisht me më pak detaje në krahasim me përvojën holandeze. Kjo është justifikuar pasi që këto programe kanë rrjedhë nga qasja holandeze në lidhje me zvogëlimin e barrës administrative. Programet e zvogëlimit të barrës së këtyre vendeve janë prezantuar për të nxjerrë në pah zgjedhjet kryesore të menaxhimit që janë bërë lidhur me zvogëlimin e barrës administrative. Përveç kësaj, ato kanë zbatuar qasje të

<sup>75</sup> Perspektiva e Politikave Rregullatore e OECD-së 2018, Grupi i të dhënave mbi Treguesit e Politikave dhe Qeverisjes Rregullatore (iREG); [https://qdd.oecd.org/subject.aspx?Subject=GOV\\_REG](https://qdd.oecd.org/subject.aspx?Subject=GOV_REG) (uebfaqja e vizituar për herë të fundit dhe grupi i të dhënave u konsultua më 18 tetor 2018).

ndryshme në lidhje me menaxhimin e barrës administrative në periudhën afatmesme. Këto të dhëna mund të shërbejnë si një informatë shumë e dobishme lidhur me atë se si fokusi në zvogëlimin e barrës administrative mund të zhvillohet sapo të krijohet një politikë efektive zvogëlimi.

Në përgjithësi, analiza e krahasimit ndërkombëtar përqendrohet në çështjet që janë relevante për vendimin mbi zbatimin e programit të zvogëlimit të barrës në Kosovë. Por, nuk është një analizë e plotë e të gjitha aspekteve të programeve të zvogëlimit të barrës që janë paraqitur. Fokusi vendoset qëllimisht në menaxhimin e programeve për zvogëlimin e barrës administrative, çështjet kryesore që dolën në pah gjatë zbatimit dhe përfitimet e përgjithshme shoqërore që një program i tillë mund të pritët të sjellë. Nuk paraqiten shembuj specifikë të masave që synojnë të zvogëlojnë barrën administrative pasi ato nuk janë relevante për opsionet e elaboruara në këtë Koncept Dokument.

Natyrisht, situata në Holandë, institucionet e BE-së, Gjermani dhe Britani të Madhe dallon shumë nga situata në Kosovë. Kjo duhet të merret parasysh gjatë aplikimit të supozimeve të bazuara në përvojat nga administratat e vendeve të tjera në administratën e Kosovës. Gjithashtu, situata ekonomike nuk mund të krahasohet pasi që vendet krahasuese të gjitha kanë ekonomi të zhvilluara dhe janë vende me të ardhura të larta, ndërkohë që Kosova ende po zhvillon ekonominë e saj, është në fazën e tranzicionit dhe karakterizohet nga të ardhura të ulëta të popullsisë.

### **3.1.1 Holanda**

Ky seksion do të paraqesë analizën e trendit të përgjithshëm të zhvillimit të politikës për zvogëlimin e barrës administrative në Holandë. Në vitin 2008, Grupi i Bankës Botërore deklaroi se programi holandez i reformës rregullatore ishte lider botëror.<sup>76</sup> Duke pasur parasysh këtë status dhe frymëzimin pasues që përvoja holandeze i ofroi vendeve të tjera që kanë ndjekur qasje të ngjashme të zvogëlimit të barrës, rasti holandez analizohet më në hollësi se sa programet e vendeve tjera.

Meqenëse politika për zvogëlimin e barrës administrative në Holandë ka përfshirë një periudhë prej dy dekadave dhe pasi ka parë një zgjerim të konsiderueshëm të përdorimit të Modelit të Kostimit Standard nga kompanitë e deri tek qytetarët, profesionistët që punojnë në sektorin (gjysmë) publik dhe duke përfshirë barrën brenda administratës, prezantimi më poshtë përqendrohet në momentet kyçe dhe zhvillimin.

#### *Zvogëlimi i barrës administrative për biznese në Holandë 2000-2018*

Procesi i zvogëlimit të barrës u karakterizua nga një shkallë shumë e lartë transparence. U bazua në një vetëvlerësim kritik dhe të ndershëm nga administrata mbi vlerën e shtuar të Informatave të Obligueshme, proceseve të punës dhe dispozitave të zbatimit. Dy dekadat që Holanda investoi në zvogëlimin e barrës administrative, panë një zvogëlim të ndjeshëm të barrës administrative për bizneset nga 16.3 miliardë euro në vit në vitin 2004 në 6.029 miliardë në vitin 2017 siç tregohet në figurën më poshtë.

<sup>76</sup> Shqyrtimi i Programit të reduktimit të barrës administrative të Holandës, Grupi i Bankës Botërore, shkurt 2007: <http://www.doingbusiness.org/reports/thematic-reports/review-of-the-dutch-administrative-burden-reduction-programme>

Viti referues	Matja dhe/ose vlerësimi	Niveli i barrës administrative
2000	Të dyja, matja dhe vlerësimi	7.49 miliard Euro <sup>77</sup>
2002	Matjet e përfunduara pjesërisht	8.258 miliard Euro <sup>78</sup>
2003	Barrët e matura plotësisht	16.3 miliard Euro <sup>79</sup>
2005	Matja e përditësuar bazë/pikënisje	15 miliard Euro <sup>80</sup>
2005	Matja e përditësuar bazë	14.7 miliard Euro <sup>81</sup>
2007	Matja bazë	8.810 miliard Euro <sup>82</sup>
2009	Matja e përditësuar bazë	7.873 miliard Euro <sup>83</sup>
2010	Matja e përditësuar bazë	7.5 miliard Euro <sup>84</sup>
2011	Matja e përditësuar bazë	7.417 miliard Euro <sup>85</sup>
2017	Matja e përditësuar bazë	6.029 miliard Euro <sup>86</sup>

Shifrat tregojnë një rritje të madhe në fillim deri në vitin 2003 dhe një rënie graduale, por të qëndrueshme më pas. Fillimisht, niveli i barrës administrative ishte nënvlerësuar ndjeshëm. Megjithatë, pasi ishte përcaktuar shkalla e vërtetë e barrës administrative dhe ishin ngritur strukturat efektive të menaxhimit, një politikë e qëndrueshme për të ulur nivelin e barrës ka dhënë rezultate mbresëlënëse.

Shifrat nuk përfshijnë arritjet e zvogëlimit të barrës që janë arritur për qytetarët dhe brenda sektorit publik.

#### *Mbështetja e vazhdueshme politike e pavarur nga përbërja e Qeverisë*

Holanda pa një numër relativisht të lartë të qeverive që erdhën në pushtet në mes viteve 1998 dhe 2012. Përbërja e qeverisë holandeze gjithashtu ndryshoi dhe asnjë parti nuk ishte vazhdimisht në qeveri gjatë kësaj periudhe. Siç tregon figura e mësipërme, kjo nuk ka pasur ndonjë ndikim në përpjekjet që Holanda shfaqti në politikën e zvogëlimit të barrës.

Arsyeja për suksesin e politikës qëndron në faktin se qëllimi për t'ua lehtësuar jetën bizneseve mori përkrahje të plotë nga spektri politik në Holandë. Zvogëlimi i barrës administrative mbeti prioritet kryesor i qeverisë edhe me ndryshimin e koalicioneve qeveritare sepse të gjitha partitë kishin përqafuar nocionin e përmirësimit të ofrimit

<sup>77</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 24 036, Nr 160, Brief van de Ministers van Economische Zaken en van Justitie, 15 maj 2000.

<sup>78</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 24 036, Nr 255, Brief van de Ministers van Economische Zaken en van Justitie, 7 maj 2002.

<sup>79</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 59, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 11 mars 2005.

<sup>80</sup> Po aty.

<sup>81</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 94, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 3 tetor 2005.

<sup>82</sup> Voortgangsrapportage Regeldruk Bedrijven, nëntor 2008. Kjo është shifra pas korigjimeve teknike që janë bërë pasi shifra fillestare prej 9,014 miliardë eurosh ishte raportuar në Parlamentin holandez në maj të vitit 2008.

<sup>83</sup> Beknopte rapportage voortgangs reductie Administratieve Lasten bedrijven, 1 shtator 2009.

<sup>84</sup> Eindrapportage Regeldruk Bedrijven, prill 2010.

<sup>85</sup> Programma Regeldruk Bedrijven 2011 – 2015.

<sup>86</sup> Goed geregeld - Een verantwoorde vermindering van regeldruk 2012-2017, 12 maj 2017.

Zyra e Kryeministrit – Sekretariati Koordinues i Qeverisë: Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative – Heqja e Barrierave Burokratike të shërbimeve nga administrata dhe rritjen e efikasitetit të legjislacionit dhe mënyrës së zbatimit të tij. Si i tillë, natyrisht do të renditej si një pikë kyçe në programet qeveritare gjatë një periudhe që zgjati dy dekada.

Figura 27 - Qeveritë holandeze 2000-2018 dhe angazhimi i tyre në zvogëlimin e barrës administrative

Qeveria	Periudha e qeverisjes	Partitë e koalicionit	Objektivi i zvogëlimit	Organizata kryesore për zbatim
<b>Kok II</b>	1998-2002	PvdA, VVD, D66	25% për kompanitë <sup>87</sup>	Ministria për Çështje Ekonomike
<b>Balkenende I</b>	2002-2003	CDA, LPF, VVD	25% për kompanitë, qytetarët dhe shkollat <sup>88</sup>	Ministria për Çështje Ekonomike
<b>Balkenende II</b>	2003-2006	CDA, VVD, D66	25% për kompanitë dhe qytetarët <sup>89</sup>	Ministria e Financave
<b>Balkenende III</b>	2006-2007	CDA, VVD		
<b>Balkenende IV</b>	2007-2010	CDA, PvdA, CU	25% për kompanitë në nivel kombëtar dhe 25% zvogëlim të barrës administrative në nivel rajonal dhe lokal për kompanitë dhe qytetarët <sup>90</sup>	Ministria e Financave
<b>Rutte I</b>	2010-2012	VVD, CDA	10% në vitin 2011 dhe 2012; më pas 5% në vit për kompanitë dhe qytetarët <sup>91</sup>	Ministria për Çështje Ekonomike
<b>Rutte II</b>	2012-2017	VVD, PvdA	Zvogëlimi strukturor i barrës rregullatore për kompanitë, qytetarët dhe profesionistët për 2.5 miliardë euro deri në vitin 2017 <sup>92</sup>	Ministria për Çështje Ekonomike
<b>Rutte III</b>	2017-tbd	VVD, CDA, D66, CU	Asnjë objektivi i ri, por fokusimi në mbajtjen e barrëve të ulëta dhe prezantimin e testit për NVM-të <sup>93</sup>	Ministria për Çështje Ekonomike

Zbatimi i programit u karakterizua nga përdorimi i vazhdueshëm i Modelit të Kostimit Standard; përfshirja e barrës së bizneseve, qytetarëve, profesionistëve që punojnë brenda administratës (si zyrtarët politik, infermierët dhe punëtorët e rinjë) dhe vet administratës; studime të hollësishme për të analizuar kërkesat ligjore dhe mundësitë e thjeshtimit në sektorë të veçantë; dhe analizë të gjerë në lidhje me ndryshimet thelbësore të sistemit. Programi u zbatua në një periudhë që zgjati dy dekada edhe pse përbërja e Qeverisë ndryshoi disa herë dhe zgjedhjet u mbajtën në intervale të shpeshta. Kjo u bë e mundur pasi që të gjitha partitë politike ranë dakord për qëllimin e përgjithshëm për të reduktuar burokracinë dhe për të përmirësuar shërbimet përmes vendosjes

<sup>87</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 24 036, Nr 148, Brief van de Ministers van Economische Zaken en van Justitie, 11 shkurt 2000.

<sup>88</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 28 375, Nr 5, Kabinetsformatie 2002, 3 korrik 2002.

<sup>89</sup> Meedoen - meer werk - minder regels, HOOFDLIJNENAKKOORD VOOR HET KABINET CDA, VVD, D66, 16 maj 2003.

<sup>90</sup> Coalitieakkoord tussen de Tweede Kamerfracties van CDA, PvdA en ChristenUnie, 7 shkurt 2007.

<sup>91</sup> Vrijheid en verantwoordelijkheid – Regeerakkoord, VVD-CDA.

<sup>92</sup> Bruggen slaan - Regeerakkoord VVD – PvdA, 29 tetor 2012.

<sup>93</sup> Vertrouwen in de toekomst - Regeerakkoord 2017 – 2021 - VVD, CDA, D66 en ChristenUnie, 10 tetor 2017.

së objektivave konkret për zvogëlimin e barrës. Infrastruktura e kërkuar e menaxhimit ishte e mishëruar fort brenda administratës.

### Numri i akteve ligjore në Holandë

Deri në fund të vitit 2004, një raport mbi madhësinë e kornizës legislative në Holandë vuri në pah rëndësinë e krijimit të një politike për të trajtuar stokun e legjislacionit.<sup>94</sup> Ajo tregoi ngarkesën e punës më të cilën administrata e Holandës përballet gjatë zbatimit të programit për zvogëlimin e barrës. Konkluzioni i përgjithshëm ishte se një numër i përgjithshëm prej 12.192 ligjesh dhe akteve nënligjore ishin në fuqi atë vit. Që nga viti 1980, numri i ligjeve primare ishte rritur nga 1.100 në 1.800.

Ndërsa këta numra siguruan një të kuptuar të përgjithshëm të kuadrit ligjor, ata nuk e përcaktuan në vetvete se sa e rëndë dhe komplekse ishte kjo kornizë. Gjatësia e ligjeve - e matur në numrin e neneve - dhe çështjet që ato rregullojnë, natyrisht, nuk rrjedhin vetëm nga numri i përgjithshëm.

12.192 ligjet dhe aktet nënligjore përbënin gjithsej 140.000 nene, një ligj përmbante mesatarisht 26 nene. Kjo mesatare për një rregullore të qeverisë dhe një rregull ministror ishte 12.5, përkatësisht 7. Në këtë mesatare fshihet ndryshimi i madh në gjatësinë e ligjeve për ministri.

Figura më poshtë tregon trendin e përgjithshëm të numrit të ligjeve dhe akteve nënligjore në Holandë. Këto shifra tregojnë një rregullim të dukshëm në të gjithë stokun e legjislacionit, ku numri i akteve nënligjore ka shënuar rënie të ndjeshme midis viteve 2004 dhe 2018. Sidoqoftë, nuk ka të dhëna për numrin e neneve që përmbajnë këto ligje dhe këto akte nënligjore.

Figura 28 - Numri i përgjithshëm i ligjeve primare dhe akteve nënligjore në Holandë në vitin 1980, 2004 dhe 2018

	1980	2004	2018 <sup>95</sup>
<b>Ligjet primare</b>	1.100	1.800	2.011 <sup>96</sup>
<b>Rregulloret e kabinetit (aktet nënligjore)</b>	-	2.675	2.138 <sup>97</sup>
<b>Rregullat ministrore (Aktet nënligjore)</b>	-	7.717	5.624
Gjithsej	-	<b>12.192</b>	<b>9.773</b>

Numri i përgjithshëm i ligjeve dhe akteve nënligjore u zvogëluar për afro 2.500 në periudhën 2004 - 2018. Arsytet që fshihen pas kësaj rënieje mund të ndërlidhen në mënyrë tentative me programin e zvogëlimit të barrës administrative të qeverive të njëpasnjëshme holandeze. Programi i inkurajoi ministritë të thjeshtësonin kuadrin ligjor të tyre i cili qoi në një proces të bashkimit të legjislacionit, për shembull në rastet kur sistemet e lejeve u bashkuan. Përveç kësaj, ministritë punuan së bashku për të krijuar një bazë të re ligjore për të arritur zvogëlime thelbësore që shkaktuan bashkimin e akteve ligjore. Megjithatë, ende nuk është bërë një analizë e hollësishme mbi shkakësinë e lidhjes midis programit të zvogëlimit të barrës administrative dhe numrit të akteve ligjore.

<sup>94</sup> Çdo rregull vlen, ligjet, rregulloret e kabinetit qeveritar dhe rregullat ministrore në Holandë, tetor 2004.

<sup>95</sup> Të dhënat mbi numrin e ligjeve primare dhe akteve nënligjore janë mbledhur përmes uebfaqes "wetten.overheid.nl/zoeken". Uebfaqja u vizitua më 9 mars 2018.

<sup>96</sup> Numri i përgjithshëm i ligjeve për Kosovën ishte 435 sipas raportit të Qeverisë për 'Ligjet e publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës', 12.03.2018.

<sup>97</sup> Numri i akteve nënligjore që janë në fuqi në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 2,500. Raporti mbi "Regjistrin e Legjislacionit Sekondar në Fuqi të miratuar nga Qeveria dhe Ministrat" përmban 509 faqe me një mesatare prej 5 akteve nënligjore të renditura për faqe. Aktet nënligjore nuk kanë numra dhe nuk janë numëruar individualisht si pjesë e analizës për këtë Koncept Dokument.



Numri i ligjeve dhe akteve nënligjore nxjerr shumë mirë në pah një çështje të veçantë. Menaxhimi i kuadrit ligjor të Holandës dhe procesi i shqyrtimit të këtij kuadri mbi mundësitë për zvogëlimin e barrës administrative ishte një detyrë e konsiderueshme. Në praktikë, shumica e këtyre akteve ligjore u analizuan për të shqyrtuar mundësitë e tyre për të reduktuar barrën administrative; është bërë hulumtim mbi efektin e këtyre zvogëlimeve potenciale; janë konsultuar akterët e përfshirë dhe janë zhvilluar dhe miratuar ndryshimet nëpërmjet proceseve standarde të hartimit të ligjeve.

Për më tepër, krijimi i një baze të dhënash që përmban të gjitha nenet dhe të siguruarit që shifrat e detajuara të mblidhen për llogaritje përmes Modelit të Kostimit Standard, paraqitën kërkesa të konsiderueshme shtesë për menaxhimin dhe organizimin me qëllim të arritjes së objektivit të zvogëlimit prej 25% për barrën administrative. Kjo nënkuptonte një përfshirje të plotë të të gjitha niveleve të Qeverisë: nga Qeveria e deri tek Parlamenti; ministritë e linjës e deri tek komunat; dhe nga Statistikat e Holandës tek organizatat e zbatimit/inspektimit.

Ngarkesa e punës ishte e konsiderueshme. Investimet e bëra në programin për zvogëlimin e barrës administrative ishin të qarta me një numër të madh të njerëzve që punonin në këtë temë dhe buxhetin e ndarë për kërkim dhe përmirësimin e praktikave zbatuese për kërkesat ligjore. Për fat të keq, shifrat specifike nuk janë të disponueshme, por duke pasur parasysh numrin e madh të personave të përfshirë, është e qartë se ato duhet të kenë qenë të konsiderueshme.

Se këto investime ja kanë vlejtur, tregohet në faktin se Holanda arriti një nivel zvogëlimi të barrës përtej objektivit fillestar të zvogëlimit për barrën administrative për biznese. Siç shpjegohet më poshtë, politika e zvogëlimit të barrës administrative përfshiu jo vetëm kompanitë, por edhe qytetarët, profesionistët që punojnë në sektorin (gjysmë) publik dhe shkëmbimin e informacionit midis qeverisë kombëtare dhe nivelit rajonal dhe lokal. Holanda është një shembull i mirë që menaxhimi efektiv afatgjatë i stokut dhe rrjedhjes së legjislacionit jep përfitime të konsiderueshme për shoqërinë në aspektin ekonomik dhe social.

### *Fazat e hershme në zvogëlimin e barrës administrative në Holandë*

Përpjekjet për të zvogëluar barrën administrative në Holandë janë bërë që nga viti 1990. Dy raporte, të zhvilluara nga Komisioni mbi Barrën Administrative, veçohen për nga rëndësia. Raporti i përkohshëm 'Trajtimi i një mal dokumentesh' ('*Tackling the paper mountain*') i datës 25 nëntor 1999 dhe raporti përfundimtar 'Rregullat pa barrë' i datës 25 nëntor 1999<sup>98</sup>. Raportet u përqendruan në urgjencën e zvogëlimit të barrës administrative, mjetet e mundshme për të arritur zvogëlime të tilla të barrës dhe mënyrën në të cilën Qeveria holandeze mund të menaxhonte një program efektiv të zvogëlimit të barrës. Vlerësimi fillestar i shumës së përgjithshme të barrës administrative pritej të ishte 16.5 miliardë guilderë holandezë<sup>99</sup>. Në atë kohë, kjo ishte e barabartë me 7.49 miliardë euro<sup>100</sup>.

Në fillim të vitit 2000, qeveria holandeze prezantoi skicën e iniciativës së saj të politikave për të zvogëluar barrën administrative duke vendosur një synim të zvogëlimit neto prej 25%<sup>101</sup>. Zvogëlimi i barrës administrative u prezantua si një proces i vazhdueshëm, ku fokusi qendror ishte një ndërgjegjësim i përmirësuar i të gjithë akterëve të përfshirë - brenda dhe jashtë administratës - në lidhje me efektet e legjislacionit dhe barrës

<sup>98</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 24 036, Nr 148, Brief van de Ministers van Economische Zaken en van Justitie. Emrat janë përkthyer nga gjuha holandeze. 'Komisioni për Barrën Administrative' është përkthimi i 'Commissie Administratieve Lasten'. 'Trajtimi i një "mal" me dokumente' është përkthimi i 'De papierberg te lijf'. 'Rregullat pa barrë' është përkthimi i 'Regels zonder overlast'.

<sup>99</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 24 036, Nr 160, Brief van de Ministers van Economische Zaken en van Justitie, 15 maj 2000.

<sup>100</sup> Konvertimi nga guilderë holandez në euro është bërë në shkallën e konvertimit të përdorur për futjen e euros sipas të cilës 2.20371 guilderë holandezë është e barabartë me 1 euro.

<sup>101</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 24 036, Nr 148, Brief van de Ministers van Economische Zaken en van Justitie, 11 shkurt 2000.

administrative në veçanti. Këto barra u vlerësuan të kenë një efekt negativ në konkurrueshmërinë ndërkombëtare të Holandës dhe se zvogëlojnë pranimin shoqëror të masave të marra nga Qeveria. Argumentohej se zvogëlimi i barrës çonte në përmirësimin e klimës së biznesit dhe në përmirësimin e cilësisë së administratës publike. Për të adresuar në mënyrë efektive barrën administrative, qeveria holandeze përcaktoi qasjen e saj që trajton si 'rrjedhën' ashtu edhe 'stokun' e legjislacionit.

Figura 29 - Çështjet kryesore nga propozimi i Qeverisë holandeze për zvogëlimin e barrëve administrative duke trajtuar si 'rrjedhën' ashtu dhe 'stokun' e legjislacionit

<p>Zvogëlimi i barrës administrative duke adresuar rrjedhën e legjislacionit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Parandalimi i krijimit të barrëve të reja administrative,</li> <li>- Fokusimi gjatë zhvillimit të politikave dhe procesit ligjvënës në opsionet me më së paku ngarkesë me qëllim të arritjes së një ndryshimi rrënjësor kulturor brenda administratës publike,</li> <li>- Krijimi i mbikëqyrjes së pavarur për tërë procesin e hartimit të ligjeve (të gjitha propozimet për ligjet primare dhe sekondare) dhe shqyrtimi i planeve ministrore dhe raporteve për zvogëlimin e barrës administrative (kjo detyrë do të kryhej nga Acta<sup>102</sup>),</li> <li>- Përdorimi i paneleve të kompanive gjatë procesit ligjvënës për të vlerësuar opsionet me më së paku ngarkesë</li> </ul>
<p>Zvogëlimi i barrës administrative duke adresuar stokun e legjislacionit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Matja e barrës administrative të shkaktuara nga i gjithë stoku i legjislacionit ekzistues (përgjegjësia u takonte ministrive individuale të linjës të cilat duhej të matnin barrën administrative që vinte nga legjislacioni për të cilin ishin përgjegjëse).</li> <li>- Shpallja e një metodologjie uniforme të matjes për barrën administrative (Modeli i Kostimit Standard do të bëhej metodologjia uniforme e matjes dhe do të miratohej në 2003<sup>103</sup>)</li> <li>- E gjithë barra administrative duhej të rishikoheshin lidhur me potencialin e saj të zvogëlimit dhe potenciali i pritshëm i zvogëlimit të barrës duhej të kuantifikohej;</li> <li>- Rritja e përdorimit të zgjidhjeve të TI-së për zvogëlimin e barrës administrative nëpërmjet (1) përmirësimit të shkëmbimit të informacionit digjital ndërmjet kompanive dhe administratës; (2) përmirësimit të ofrimit të shërbimeve nga administrata duke siguruar që kompanitë të marrin të gjitha informatat për të cilat ato kanë nevojë; dhe (3) rritjes së shkëmbimit të informatave brenda administratës dhe përdorimi i shumëfishtë i të dhënave të njëjta.</li> </ul>
<p>Menaxhimi i politikës së zvogëlimit të barrës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitorimi dhe transparenca në bazë të planeve ministrore të detajuara të veprimit për zvogëlimin e barrës administrative dhe raportimi vjetor kundrejt këtyre planeve në Parlament lidhur me arritjet faktike (fillimisht, zvogëlimet e planifikuara të barrës dhe raportet mbi zbatimin pritej të paraqiteshin në maj të çdo viti),</li> <li>- Çdo ministri ka qenë e detyruar të raportojë mbi përpjekjet për zvogëlimin e barrës brenda domenit të ministrisë dhe Ministria për Çështje Ekonomike ishte e ngarkuar të raportojë për programin në tërësi,</li> </ul>

<sup>102</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 24 036, Nr 160, Brief van de Ministers van Economische Zaken en van Justitie, 15 maj 2000.

<sup>103</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 24 036, Nr 1, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 9 prill 2004.

- Secila ministri ka qenë e detyruar të krijojë një pikë kontakti për zvogëlimin e barrës administrative; stafi në këto pika kontakti ka qenë përgjegjës për menaxhimin e politikës së zvogëlimit të barrës në lidhje me rrjedhën dhe stokun në nivel të ministrisë; ai ofronte mbështetje për udhëheqjen politike të ministrisë dhe siguronte raportim efektiv në Parlament; dhe siguronte se janë zhvilluar kapacitetet brenda ministrisë mbi çështje që shtriheshin nga të kryerit e matjeve të MKS në të siguruarit që ministria të veprojë në përputhje me kërkesat e reja për procesin e hartimit të politikave dhe të legjislacionit.

Zbatimi i politikës së zvogëlimit të barrës administrative filloi menjëherë pas shpalljes në fillim të vitit 2000. Deri në maj të vitit 2000<sup>104</sup>, ministrinë raportuan në raportet e tyre ministore mbi domenet legjislative që ata do të matnin dhe mbi atë se kur pritej të përfundoheshin këto matje. Qasja ishte fleksibile dhe e përshtatur për kapacitetet, mundësitë dhe nevojat e ministrive. Qeveria holandeze njoftoi se ndërkohë që po zbatoheshin politika e zvogëlimit, mbulimi i matjeve do të zgjerohej. Barra administrative për gjithnjë e më shumë ligje dhe akte nënligjore do të matej. Qeveria holandeze gjithashtu njoftoi në mënyrë të qartë se matja ishte një mjet thelbësor për zvogëlimin e barrës administrative. Megjithatë, shumica e përgjithshme e këtyre barrëve ishte e një rëndësie të rendit të dytë në krahasim me fokusin e vërtetë të programit: mundësitë faktike për të zvogëluar barrën dhe për të rritur efikasitetin e legjislacionit. Barra administrative u konsideruan si një problem që duhej të rregullohej mirë në të ardhmen. Në përgjithësi, dy masa janë parë si kanalet kryesore për zvogëlimin e barrës administrative: (1) përshtatja e dispozitave ligjore dhe (2) përmirësimi i zbatimit de facto të detyrimeve ligjore ekzistuese.

Në planet e tyre për zvogëlimin e barrës administrative, ministrinë e linjës kanë raportuar mbi katër aspekte. Së pari, ato treguan se cilat mundësi të zvogëlimit i konsideronin të realizueshme në afat të shkurtër. Fokusi ishte në barrët e rëndësishme administrative që rezultonin nga frekuenca e lartë e Informatave të Obligueshme, numri i madh i kompanive të prekura dhe perspektiva e zgjidhjeve të TI të thjeshta dhe të lehta për t'u zbatuar. Së dyti, i është kushtuar vëmendje barrës administrative që shkaktonin një nivel të lartë irritimi brenda komunitetit të biznesit. Këto barrë janë identifikuar nëpërmjet konsultimeve. Së treti, zvogëlimet e barrës që do të kërkonin përfshirjen e më shumë se një ministrie duhej të identifikoheshin dhe duhej të përgatitej baza për zbatimin e zvogëlimit të barrës përmes një projekti të përbashkët midis ministrive dhe ministrave. Së katërti, projektet ekzistuese që kishin lidhje me ose që kishin për qëllim arritjen e zvogëlimeve të barrës administrative duhej të sillleshin nën ombrellën e ofruar nga politika e zvogëlimit të barrës administrative.

Kjo qasje siguroi që Qeveria të grumbullonte të gjitha informatat që ishin në dispozicion mbi mundësitë për të zvogëluar barrën administrative përmes një regjistrimi të detajuar të masave që ishin tashmë në proces dhe masave që mund të zbatoheshin në të ardhmen e afërt. Për më tepër, ajo identifikoi masat e zvogëlimit për të cilat nevojitej koordinim ndërministror, dhe projektin e TI për të cilin do të duhej të ndahej buxhet i mjaftueshëm.

U shpërfaq kompleksiteti i zbatimit të zvogëlimit të barrës administrative në mënyrë efektive, ndërkohë që hulumtimet dhe njohuritë u zhvilluan kur politika u zbatua dhe u zhvillua tutje. Një diskutim rreth rolit të barrëve administrative çoi në një sqarim nga Qeveria holandeze, në veçanti në vitin 2002<sup>105</sup>. Rezultati i diskutimit ishte

<sup>104</sup>Po aty.

<sup>105</sup>Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 24 036, Nr 255, Brief van de Ministers van Economische Zaken en van Justitie, The Hague, 7 maj 2002

pak a shumë se barrierat administrative duhet të shmangen kur është e mundur dhe se fokusi duhet të jetë në efikasitetin e zbatimit të legjislacionit. Barrët shtesë administrative si të tilla nuk mund të shmangeshin, sidomos kur merret parasysh obligimi për të zbatuar legjislacionin e ri që ka origjinën në Bashkimin Evropian. Barra administrative justifikohet kur arrinë një qëllim shoqëror, por duhet të mbahet në nivelin minimal të nevojshëm. Për të siguruar këtë, roli i mbikëqyrësit të pavarur Actal u theksua si thelbësor në arritjen e këtij qëllimi në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Pak vite pas fillimit të politikës së zvogëlimit të barrës administrative, raportimi mbi programin e zvogëlimit të barrës administrative ndryshoi. Prej vitit 2003 e tutje, pjesa kryesore e këtij raportimi u integrua në ciklin buxhetor vjetor. Planet dhe arritjet u integruan në procesin e buxhetimit si një shtojcë e propozimit të buxhetit. Ministrinë e linjës duhej të raportonin mbi arritjet në zvogëlimin e barrës administrative në raportet e tyre vjetore. Qeveria gjithashtu filloi të publikojë përditësime periodike në maj të çdo viti<sup>106</sup>.

### *Shtyja e vitit 2004*

Viti 2004 shënoi një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si Holanda trajtoi barrën administrative. Kjo ndikoi në fushëveprimin e politikave, që u zgjerua për të përfshirë qytetarët, profesionistët që punojnë me sektorin (gjysmë-) publik dhe kërkesat e raportimit nga niveli kombëtar i qeverisë e deri tek ai rajonal dhe lokal. Si i tillë, zvogëlimi i barrës administrative u shndërrua në shtyllë qendrore të Reformës së Administratës Publike dhe nxiti një rishikim thelbësor të proceseve të lidhura me informacionin, të përdorura nga administrata dhe, si i tillë, filloi procesin që ri-vlerësonte dhe ri-definonte rolin dhe funksionin e administratës në shoqëri.

Gjithashtu, kjo çoi drejt një rishikimi thelbësor të strukturës së nevojshme për menaxhimin e politikës për zvogëlimin e barrës administrative dhe duke forcuar ndjeshëm procesin.

### *Forcimi i politikave për zvogëlimin e barrës për bizneset*

Politika për zvogëlimin e barrës administrative u zhvillua më tutje. Në fillim të vitit 2004, Byroja holandeze për analizën e politikave ekonomike botoi një raport që tregoi ndikimin e mundshëm të zvogëlimit të barrës administrative për 25%<sup>107</sup>. Ndikimi kryesor i pritur ekonomik ishte një rritje e BPV-së prej 1.5%. Kjo rritje do të rezultonte nga rritja e produktivitetit të punës për 1,7%; konkurrenca e përmirësuar e ekonomisë holandeze dhe bizneseve të saja; dhe fleksibilitet i rritur i kompanive, për t'iu përshtatur kushteve të ndryshueshme ekonomike. Këto shifra u konfirmuan nga Qeveria holandeze në raportin e saj për Parlamentin, në të cilin ritheksoi angazhimin e saj për një objektiv të rishikuar të zvogëlimit të barrëve administrative prej 25%<sup>108</sup>.

Në vitin 2004, shifrat në lidhje me nivelin e barrës administrative u rishikuan më tutje, pasi kishte përfunduar matja e plotë e të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore. Barrët e përgjithshme administrative janë përlogaritur të jenë 16.3 miliardë euro në vit<sup>109</sup>, ekuivalenti i kostos prej 3.6% të BPV-së. Matja e plotë gjithashtu tregoi se legjislacioni evropian lidhej me rreth 40% të këtyre barrëve si rezultat i krijimit të një shtate të barabartë në nivel evropian në sferën ekonomike. Për më tepër, koordinimi i programit të zvogëlimit të barrës administrative u transferua në Ministrinë e Financave, ndërsa Ministria për Çështje Ekonomike fokusoi përpjekjet e saj në përdorimin e zgjidhjeve të TI-së me qëllim të zvogëlimit të barrës administrative<sup>110</sup>. Kjo forcoi lidhjen me ciklin buxhetor dhe u hartuan udhëzime specifike për të siguruar që të gjitha ministrinë të ishin të informuara dhe të

<sup>106</sup> Po aty.

<sup>107</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 1, Bijlage bij Kamerstuk 29515 nr. 1, CPB-notitie Economische effecten van een verlaging van de administratieve lasten, 7 prill 2004.

<sup>108</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 1, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 9 prill 2004.

<sup>109</sup> Raporti fillestar nga viti 2004 i Qeverisë përcaktoi nivelin e barrës administrative në 16.4 miliardë në vit. Kjo shifër u rregullua në maj të vitit 2005 në EUR 16.3 miliardë në vit. Shih gjithashtu: Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 59, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 11 mars 2005.

<sup>110</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 10, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 27 maj 2004.

afta për të punuar me kërkesat e reja <sup>111</sup>. Ministria e Financave dhe Transfereve krijoi gjithashtu Njësinë Ndërmitore të Projekteve për Barrë Administrative e cila më vonë u riemërua si Grupi i Reformës Rregullatore <sup>112</sup>. Kjo drejtori përbëhej nga specialistë nga vetë MFT, e kombinuar me ekspertë për zvogëlimin e barrës administrative dhe të politikave nga ministritë e linjës, legjislacioni i të cilave shkaktoi sasinë më të madhe të barrës administrative në Holandë. Kjo përbërje mbledhi së bashku ekspertizën e politikave me ekspertizën e nevojshme për menaxhimin e programit të zvogëlimit të barrës administrative.

Të kuptuarit se qasja e mëparshme ndaj zvogëlimit të barrës administrative nuk ishte në përputhje me premtimet dhe pritjet politike/shoqërore, ka bindur qeverinë holandeze për të futur rigorozitet dhe energji të re në programin e saj të zvogëlimit të barrës. Planet e zvogëlimit të ministrive u përditësuan. Kufijtë për ministri për barrë administrative u prezantuan në vitin 2005. Këta kufij ishin kufij neto, që nënkuptonte se ministritë, përveç sigurimit që synimi i reduktimit prej 25% do të arrihej për stokun e legjislacionit, gjithashtu duhej të kompensojnë çdo rritje të barrës që rezultonte nga legjislacioni i ri. Qeveria holandeze i raportoi në detaje Parlamentit për masat e planifikuara të zvogëlimit të barrës. Në këtë fazë, ajo përcaktoi standardin e raportimit për propozime që do të zvogëlonin barrën me më shumë se EUR 1 milion. Shumë nga këto propozime ishin përgatitur përmes të ashtuquajturave "Komitete të Përziera" në të cilat ministritë e linjës bashkëpunonin ngushtë me përfaqësuesit e biznesit për identifikimin e mundësive të zvogëlimit. Këto komitete do të ofronin një këshillë zyrtare për ministrat mbi masat e mundshme për të zvogëluar barrën administrative <sup>113</sup>. Kjo këshillë u publikua në internet dhe përgjithësisht u dërgua edhe në Parlament për informim. Prandaj, ministrat dhe ministritë e tyre të linjës shpeshherë raportuan në mënyrë të detajuar mbi mënyrën në të cilën ata kanë marrë sugjerimet nga këto komitete dhe i kanë dërguar në Parlament <sup>114</sup>.

#### *2004: Komunitet dhe barrët administrative*

Analiza e origjinës së barrëve administrative ishte shkak që Qeveria holandeze të vlerësojë se si bizneset u prekën nga informatat e obligueshme ligjore në nivel lokal. Rezultati i një analize të detajuar tregoi se komunitet luajtën një rol qendror në rreth EUR 1.4 miliardë në barrë administrative. Pjesa më e madhe e kësaj shume ishte rezultat i rolit që komunitet kishin në zbatimin e legjislacionit kombëtar. Vetëm rreth EUR 200 milionë barrë administrative në vit ishin rezultat i informatave të obligueshme të zhvilluara vetëm në nivel lokal. Pavarësisht kontributit të komunitet në totalin e barrëve administrative në Holandë, përpjekje specifike janë zhvilluar për t'i trajtuar problemet në zbatimin e legjislacionit, si p.sh. shkurtimi i kohës procedurale të nevojshme për përpunimin e lejeve dhe shkurtimin e kohës së pritjes për shërbimet e ofruara nga komunitet <sup>115</sup>.

#### *2004: Barra administrative për qytetarët*

Gjatë vitit 2004, Ministria për Punë të Brendshme dhe Marrëdhënie të Mbretërisë plotësoi politikën për zvogëlimin e barrës administrative për kompanitë me një politikë të zvogëlimit të barrës që synon thjeshtimin e jetës së qytetarëve. Ajo paraqiti planet e saj në Parlamentin Holandez në qershor të atij viti dhe e ndërlihi politikën me synimin e përgjithshëm për modernizimin e Administratës Publike <sup>116</sup>. U themelua Komisioni, që

<sup>111</sup> Shih gjithashtu: [http://www.rijksbegroting.nl/archief-minfin/2004/default242a.html%3FCMS\\_ITEM=73E1C24091964853BDE7A5C12DE64386X1X61397X45?CMS\\_ITEM=73E1C24091964853BDE7A5C12DE64386X1X61397X45](http://www.rijksbegroting.nl/archief-minfin/2004/default242a.html%3FCMS_ITEM=73E1C24091964853BDE7A5C12DE64386X1X61397X45?CMS_ITEM=73E1C24091964853BDE7A5C12DE64386X1X61397X45) (faqja e internetit është konsultuar më 9 mars 2018)

<sup>112</sup> Emri i përkthyer nga emri original në gjuhën holandeze: Interdepartementale projectdirectie administratieve lasten and Regiegroep Regeldruk.

<sup>113</sup> Raporti i mëposhtëm është një shembull i një këshille të tillë: Lasten in Balans, Eindrapport van de gemengde commissie Administratieve Lastenvermindering, Advies aan de minister van Landbouw, Natuur en Voedselkwaliteit, mars 2004.

<sup>114</sup> Shih, për shembull, Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 34, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 21 September 2004; and Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 38, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 28 shtator 2004.

<sup>115</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 36, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 24 shtator 2004.

<sup>116</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29 362, Nr 136, Modernisering van de overheid, 16 maj 2008.

duhej të analizonte mundësitë për të zvogëluar barrën për qytetarët<sup>117</sup>. Në vitin 2005, matja bazë për qytetarët iu prezantua publikut. Qytetarët holandezë, siç ishte llogaritur, shpenzojnë 112 milionë orë dhe rreth 1.3 miliardë euro nga xhepi për të përmbushur Informatat e Obligueshme të përcaktuara në aktet ligjore<sup>118</sup>. Përderisa barrët mesatare administrative për qytetarë nuk ishin veçanërisht të larta në 10 orë në vit dhe 100 euro në shpenzime nga xhepi, analiza veçoi grupe specifike të synuara. Këto janë të radhitura në pasqyrën e mëposhtme. Kjo qasje tregoi se barra administrative për grupe specifike ka qenë dukshëm më e lartë se sa për të tjerët. Me rëndësi të veçantë ishte fakti se veçanërisht grupet për të cilat ishin ngritur struktura mbështetëse për t'i ndihmuar, kishin barrë administrative shumë më të lartë sesa mendohej më parë.

Politika për zvogëlimin e barrës administrative për qytetarët i ishte nënshtruar gjithashtu një objektiv i zvogëlimi prej 25%. Megjithatë, zvogëlimi i përgjithshëm i arritur deri në vitin 2008 ishte 17% dhe 21% respektivisht, për shumën totale të orëve dhe shpenzimeve nga xhepi. Arsyet për mos arritjen e objektivit u shpjeguan dhe u shqyrtua programi që do të zbatohet<sup>119</sup>.

Figura 30 - Grupet e synuara të qytetarëve siç përcaktohen nga Qeveria Holandeze

<p>Profilet e vitit 2007:</p> <p>Familja Verstappen: profili i përgjithshëm i një familjeje mesatare holandeze</p> <p>Bart, 9 vjeç: profili i një familjeje me një fëmijë të sëmurë nga sëmundje kronike</p> <p>Thea, 80 vjeç: profili i një personi të moshuar</p> <p>Maria, 31 vjeç: profili i një nëne beqare me një fëmijë</p> <p>Henk, 46 vjeç: profili i një vullnetari aktiv<sup>120</sup></p> <p>Në vitin 2008, këto profile u përmirësuan dhe u përcaktuan barra administrative për grupin e synuar për të treguar dallimet që ekzistonin mes tyre (shifra e paraqitur më poshtë është e rrumbullakësuar)<sup>121</sup>.</p> <p>Familja Andriessen, familje mesatare me dy fëmijë: 24 orë në barrë administrative</p> <p>Agnieska, nënë beqare e varur nga përfitimet sociale: 96 orë në barrë administrative</p> <p>Michel, baba beqar me diabet: 51 orë në barrë administrative</p> <p>Ad, person i papunë: 69 orë në barrë administrative</p> <p>Sophie, adoleshent me hendikep: 107 orë në barrë administrative</p> <p>Bert, i moshuar me dementia: 21 orë në barrë administrative</p> <p>Gerda, e moshuar aktive: 42 orë në barrë administrative</p> <p>Jan, vullnetar: 88 orë në barrë administrative</p> <p>Maarten, jeton në Holandë, punon në Belgjikë: 33 orë në barrë administrative</p> <p>Bjorn, emigrant: 37 orë në barrë administrative</p> <p>Constanza, studente e huaj: 16 orë në barrë administrative</p>
---

<sup>117</sup> Instellingsbesluit Algemene Commissie Administratieve Lasten Burgers, 17 November 2004, Staatscourant, 22 nëntor 2004 (data e botimit), nr. 225 / f. 8.

<sup>118</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29 362, Nr 35, Modernisering van de overheid, 23 maj 2005.

<sup>119</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29 362, Nr 17, Modernisering van de overheid, 1 qershor 2004.

<sup>120</sup> Ministria e punëve të brendshme dhe marrëdhënieve të mbretërisë hartoi broshurën 'Passie onder (regel)druk' se si komunat mund të jenë më shumë në shërbim të vullnetarëve, që u publikua në nëntor 2007.

<sup>121</sup> NEDERLAND REGELLAND - op weg naar merkbare verbeteringen voor burgers, broshura është publikuar nga Ministria e punëve të brendshme dhe marrëdhënieve të mbretërisë, qershor 2008.



Kërkimet mbi mënyrën në të cilën Shtetet Anëtare të BE-së adresuan barrën administrative për qytetarët konfirmuan vëmendjen politike që i ishte dhënë temës në të gjithë kontinentin <sup>122</sup>. Ato treguan se barrët administrative për qytetarët shpesh u adresuan përmes projekteve që synonin zvogëlimin e burokracisë në përgjithësi; projekteve që fokusoheshin në digjitalizimin e shërbimeve qeveritare; dhe përpjekjeve për rritjen e efikasitetit të qeverisë. Për më tepër, dallimet thelbësore u gjetën në nivelin e barrës administrative të shkaktuara nga legjislacioni që synonte të arrinte rezultatet e njëjta, si lëshimi i pasaportave dhe paraqitja e deklaratave tatimore. Përderisa një pjesë e këtyre dallimeve kishin të bënin me mënyrën në të cilën vendet vlerësonin barrën administrative (cilësore kundrejt sasiore), ato gjithashtu treguan dallimet thelbësore midis vendeve lidhur me zgjedhjet e politikës kombëtare në lidhje me zbatimin dhe përdorimin e TI.

Në vitin 2007, qeveria holandeze paraqiti politikën e saj të përditësuar për zvogëlimin e barrës administrative për qytetarët dhe paraqiti ndryshime të konsiderueshme. Zvogëlimi i barrës administrative për qytetarët lidhej drejtpërdrejt me përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga administrata<sup>123</sup>. Përveç kësaj dhe në përputhje me zhvillimet e politikave në lidhje me zvogëlimin e barrëve administrative për kompanitë, fokusi u përshtat në mënyrë që të marrë parasysh perceptimin e qytetarëve për masat e zvogëlimit të barrës. Për të arritur këtë, bashkëpunimi me nivelin komunal u forcua pasi që komunat janë shumë të rëndësishme si ofrues të shërbimeve për qytetarët dhe kompanitë në Holandë.

Një cak i zvogëlimit administrativ në nivel kombëtar nuk u riprezantua në vitin 2007, duke shënuar një ndryshim të konsiderueshëm të politikave krahasuar me fokusin e vazhdueshëm në caqet e zvogëlimit të barrës administrative për kompanitë. Megjithatë, një cak i zvogëlimit të barrës vazhdoi të dominonte në përpjekjet për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve, por këtë herë aplikohet për barrën e shkaktuar nga komunat, duke përfshirë rolet e tyre në zbatimin e politikave kombëtare. Përveç kësaj, pengesat specifike u identifikuan si veçanërisht të rënda për qytetarët dhe kompanitë. Këto duhej të adresoheshin në mënyrë efektive nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë të nivelit kombëtar dhe atij lokal.

Figura 31 - Ankesat më të zakonshme të qytetarëve holandez në lidhje me administratën në vitin 2007

- 1) Obligimi për të dhënë informacionin e njëjtë disa herë
- 2) Koha e pritjes (në sportel, në telefon, koha e shpenzuar duke pritur një vendim)
- 3) Plotësimi i formularëve
- 4) Pjesë teksti që është e vështirë të kuptohet
- 5) Vështirësi për të kontaktuar personin/organizatën e duhur
- 6) Gabimet e bëra nga administrata që është vështirë të korrigjohen
- 7) Dërgimi nga një zyre në tjetrën pa ofruar ndonjë zgjidhje
- 8) Mungesa e mirëkuptimit nga shërbyesit civil
- 9) Humbja e kohës për shkak të aktiviteteve pa ndonjë vlerë të shtuar

Nëntë ankesat më të zakonshme kanë qenë bazë e masave për përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Zgjidhjet e bëra ishin një përzierje e të qenit miqësorë me klientin përmes një sistemi të gradimit: në linjë me metodologjinë për zvogëlimin e barrës administrative, prezantimi i masave si (1) zvogëlimi i frekuencës së

<sup>122</sup> Zvogëlimi i barrëve administrative për qytetarët - Një pasqyrë evropiane; hulumtim i kontraktuar nga Ministria e punëve të brendshme dhe marrëdhënieve të mbretërisë; studim i kryer nga PWC-Netherlands dhe i publikuar më 14 maj 2007.

<sup>123</sup> Broshura 'Betere dienstverlening aan burgers met minder administratieve lasten', e datës 21 shtator 2007 e lëshuar nga Ministria e punëve të brendshme dhe marrëdhënieve të mbretërisë.



Informatave të Obligueshme për qytetarët siç është kontrollimi teknik i veturave dhe (2) krijimi i proceseve të IT-së për para-plotësimin e formularëve për aplikimin e përfitimeve pensionale; dhe rishikimi i formularëve që përdoren nga administrata<sup>124</sup>.

Figura 32 - Formularët, kuptueshmëria dhe shkalla e gabimeve

Formularët janë lidhja ndërmjet administratës dhe legjislacionit në njërin anë dhe ndërmjet qytetarëve dhe kompanive në anën tjetër. Gabimet e bëra gjatë plotësimit të formularëve shkaktojnë probleme të shumta. Qytetarët dhe kompanitë duhet të dorëzojnë formularë shumë herë dhe nuk i marrin shpejtë reagimet dhe vendimet që presin; administrata duhet të analizojë dhe të kthejë formularët derisa të plotësohen në mënyrë të saktë.

Studimet tregojnë se formularët që shqyrtohen dhe bëhen më të kuptueshëm mund të rezultojnë me zvogëlim të gabimeve për 50%<sup>125</sup>. Kjo, nga ana tjetër, është e dobishme si për qytetarët e kompanitë ashtu edhe për administratën. Meqenëse formularët janë thelbësorë në proceset vendimmarrëse të administratës, një shkallë më e ulët e gabimeve do të siguronte vendimmarrje më mbarëvajtëse.

#### 2004: Barra administrative për organet administrative dhe profesionistët në sektorin (gjysmë-) publik

Fokusi i politikës për zvogëlimin e barrës administrative gradualisht është zgjeruar. Për shembull, Ministria e Arsimit, Kulturës dhe Shkencës e Holandës ka bërë një studim mbi barrën e perceptuar dhe barrën e vërtetë administrative në sektorin e arsimit. Rezultatet janë publikuar në fillim të vitit 2004<sup>126</sup>. Kjo temë në vazhdimësi kishte përkrahje substanciale politike pasi që pyetja se si administrata rregullon vetveten dhe si kjo kontribuon në qëllimet e përgjithshme vazhdonte të ishte e rëndësishme<sup>127</sup>.

Në vitin 2007, u krijua programi për adresimin e barrës administrative për profesionistët – siç janë zyrtarët policor, mësimdhënësit, infermierët dhe punonjësit për çështje të të rinjve. Në vend të vendosjes së një caku të zvogëlimit, qëllimi i politikës ishte që të adresohen në mënyrë të konsiderueshme Informatat e Obligueshme me të cilat ballafaqohen këta profesionistë. Forca shtytëse e kësaj ishte të sigurohet se ata ishin në gjendje të kalonin më shumë kohë në punën e tyre faktike në vend që të plotësonin formularët. Përveç kësaj, qeveria holandeze përcaktoi si synim adresimin e pesë procedurave më të vështira<sup>128</sup>. Këto qëllime u plotësuan me tre qëllime sekondare: (1) për të qartësuar vlerën e shtuar të detyrimeve specifike; (2) për të rritur besimin që u jepet profesionistëve në sektorin publik; dhe (3) për të shkëmbyer qasjet dhe praktikën e mira në lidhje me përmbushjen e detyrimeve specifike<sup>129</sup>. Në vitin 2008, qeveria holandeze paraqiti një pasqyrë të detajuar në të cilën tregoi se cilat janë barrët administrative me të cilat duhet të merren profesionistë që punojnë në shërbimin publik. Ajo gjithashtu vëri në dukje çështjet me të cilat ballafaqohen këta profesionistë, siç janë sistemet e TI-së që nuk ishin të ndërveprueshme, dyfishimi i kërkesave për regjistrim dhe mungesa tjera të efikasitetit<sup>130</sup>.

Barra administrative e shkaktuara nga kërkesat për raportim të cilat duhet të përmbushen nga komunat dhe provincat në Holandë, i ishin nënshtruar një caku të zvogëlimit prej 25% në vitin 2007. Rrjedha e informatave financiare u caktua që të thjeshtësohej ndjeshëm. Sasia e informacionit të kërkuar gjatë vlerësimeve të përkohshme, raporteve të monitorimit dhe detyrimeve të tjera mbi zbatimin e politikës pritej të zvogëlohej me

<sup>124</sup> Voortgang vermindering regeldruk burgers, professionals en overheden, 16 maj 2008.

<sup>125</sup> Po aty.

<sup>126</sup> Regeldruk voor OCW-instellingen. Een onderzoek in de sectoren PO, BVE, OWB, WO en podiumkunsten; hulultim i kontraktuar nga Ministria e arsimit, kulturës dhe shkencës; studim i kryer nga ECORYS-NEI dhe i publikuar më 2 shkurt 2004.

<sup>127</sup> <https://www.trouw.nl/home/bezwijk-het-onderwijs-onder-de-regeldruk-~afc45dae/>

<sup>128</sup> Broshura 'Betere dienstverlening aan burgers met minder administratieve lasten', e datës 21 shtator 2007, e lëshuar nga Ministria e punëve të brendshme dhe marrëdhënieve të mbretërisë.

<sup>129</sup> Administratieve Lastenvermindering voor Professionals in de (semi-)Publieke Sector - Doelstellingen en aanpak, Ministria e punëve të brendshme dhe marrëdhënieve të mbretërisë, dhjetor 2007.

<sup>130</sup> NEDERLAND REGELLAND - naar merkbare administratieve lastenvermindering voor professionals, broshura e publikuar nga Ministria e punëve të brendshme dhe marrëdhënieve të mbretërisë, janar 2009.

25%<sup>131</sup>. Për zbatimin e caktuar të zvogëlimit të barrës, është bërë një matje bazë e barrës administrative sipas viteve. Kjo përfshinte edhe barrët e shkaktuara nga rregullat e zhvilluara nga komunat në përputhje me autonominë e tyre dhe barra e shkaktuar si rezultat i zbatimit në nivel komunal të legjislacionit të zhvilluar në nivel kombëtar. Barra është llogaritur të jetë 101 milionë euro për kompanitë. Për qytetarët, barrët arritën në 10.6 milion orë dhe 23 milionë euro shpenzime të parave të xhepit<sup>132</sup>.

Diskutimi mbi barrën administrative dhe vlerën e shtuar të obligimeve specifike të informacionit vazhdon. Spitalet në Holandë, për shembull, ngritën çështjen e markave dhe etiketave të cilësisë që janë zhvilluar gjatë viteve të fundit. Përderisa kontribuuan në rritjen e vetëdijes dhe arritën përmirësime të rëndësishme në kujdesin ndaj pacientit, ato konsiderohet se kanë arritur qëllimin e synuar. Si të tilla, ato nuk janë më të nevojshme në formën aktuale. Ato mund të ndryshohen ose të hiqen<sup>133</sup>. Në maj 2018, qeveria holandeze bëri publik planin veprimit për të eliminuar burokracinë e panevojshme nga sektori i shëndetësisë.<sup>134</sup> Qasja e përkushtuar në thjeshtimin e barrëve administrative në sektorin e kujdesit psikiatrik rezultoi në ulje të ngarkesës prej rreth një ore në ditë, duke liruar kohë për detyrën kryesore të psikiatërve, kujdestarëve dhe profesionistëve të tjerë në këtë fushë<sup>135</sup>.

### *Konsultimi gjatë zbatimit të programit për zvogëlimin e barrës administrative*

Konsultimi ishte pjesë përbërëse e politikës për zvogëlimin e barrës administrative. Gjatë matjeve të kryera me anë të intervistave me biznese, respondentët gjithmonë janë pyetur nëse shohin mundësi për thjeshtimin e procesit të ofrimit të informatave për administratën<sup>136</sup>.

Në vitin 2003, qeveria holandeze krijoi një linjë të përkohshme të shërbimit përmes telefonit për të marrë komente kthyes nga bizneset në lidhje me rregullat që janë kundërtënëse. Rezultatet e këtij procesi të mbledhjes së komenteve kthyes u raportuan në fillim të vitit 2005<sup>137</sup>.

*Figura 33 - Mënyrat e konsultimit të bizneseve në Holandë për zvogëlimin e barrës administrative*

Vizita e kompanive
Intervistat gjatë procesit të matjeve
Komitetet e përziera për identifikimin e masave për zvogëlimin e barrës administrative
Kompanitë model, që ofruan bazën për testimin e masave për zvogëlimin e barrës administrative
Platformat në internet për paraqitjen e ankesave dhe sugjerimeve
Komitetet e nivelit të lartë që raportojnë për çështjet specifike

Gjatë tetorit të vitit 2003, bizneset identifikuan rreth 800 pengesa. Çështjet me të cilat ballafaqoheshin kompanitë në punën e tyre të përditshme vunë në dukje se megjithatë numri i vërtetë i kontradiktave ligjore ishte mjaft i ultë pasi që vetëm 8 çështje mund të gjurmohen se lidhen qartë me kontradikta të tilla. Në shumicën

<sup>131</sup> Broshura 'Betere dienstverlening aan burgers met minder administratieve lasten', e datës 21 shtator 2007 e lëshuar nga Ministria e punëve të brendshme dhe marrëdhënieve të mbretërisë.

<sup>132</sup> 'Nulmeting AL Gemeentelijke Regelgeving 2007, Onderzoek naar de Administratieve lasten van de gemeentelijke regelgeving voor Bedrijven en Burgers', matjet e kryera nga SIRA consulting, 1 shtator 2008.

<sup>133</sup> <https://www.ad.nl/rotterdam/ziekenhuizen-in-rotterdam-willen-af-van-vele-keurmerken~a7c8a377>, e vizituar më 13 mars 2018.

<sup>134</sup> [https://www.rijksoverheid.nl/actueel/nieuws/2018/05/23/kabinet-minder-papier-meer-zorg?utm\\_source=e-mailnieuwsbrief&utm\\_medium=email&utm\\_campaign=Regeringsnieuws](https://www.rijksoverheid.nl/actueel/nieuws/2018/05/23/kabinet-minder-papier-meer-zorg?utm_source=e-mailnieuwsbrief&utm_medium=email&utm_campaign=Regeringsnieuws), vizituar për here të fundit më 23 maj 2018.

<sup>135</sup> <https://amp-nos-nl.cdn.ampproject.org/c/s/amp.nos.nl/artikel/2306246-minder-administratie-levert-in-psihiatrie-bijna-uur-per-dag-op.html>

<sup>136</sup> Shih për shembull Kapitullin 5 në 'Nulmeting AL Gemeentelijke Regelgeving 2007, Onderzoek naar de Administratieve lasten van de gemeentelijke regelgeving voor Bedrijven en Burgers', matjet e kryera nga SIRA consulting, 1 shtator 2008.

<sup>137</sup> and Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 49, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 17 janar 2005.

e rasteve, kontradiktat e perceptuara nuk rrjedhin nga korniza ligjore si e tillë, por nga mënyra se si zbatoheshin dispozitat ligjore. Shumica e çështjeve të ngritura nga kompanitë kishin të bënin me dallimet në interpretimin e legjislacionit nga autoritete të ndryshme zbatuese; mungesën e dukshme të logjikës së rregullave në krahasim me situatën reale në të cilën operojnë bizneset; dhe mungesën e koordinimit ndërmjet autoriteteve zbatuese sa i përket proceseve të tyre përkatëse vendimmarrëse dhe harmonizimit të pozicioneve të tyre me njëratjetrën.

Pjesa më e madhe e 800 rasteve janë adresuar dhe trajtuar në mënyrë efektive gjatë vitit 2004. Në kohën kur qeveria raportoi për progresin e arritur në vitin 2005 vetëm 8 çështje kishin mbetur të hapura nga 800 të identifikuar në fillim.

Përvojat e fituara gjatë ciklit të marrjes së komenteve kthyese nga kompanitë, çuan në zhvillimin e një sekretariati të përhershëm për adresimin e çështjeve të ngritura nga kompanitë.

Në vitin 2006, qeveria holandeze raportoi për zhvillimet e mëtejme<sup>138</sup>. Numri i çështjeve të reja të ngritura nga kompanitë u zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme, dhe kjo gjë u interpretua si shenjë që tregonte si kishte zvogëlim edhe të sfidave të përditshme me të cilat ballafaqohen kompanitë e që kanë të bëjnë me legjislacionin. Përveç kësaj, janë zhvilluar profile të sektorëve për të iu ofruar bizneseve një pasqyrë të qartë të kërkesave ligjore ekzistuese të cilave duhet t'i përmbahen<sup>139</sup>.

Janë zhvilluar profilet e standardizuar për të ashtuquajturat kompani model në shtatë sektorë. Ato janë industria kimike; sektori i hotelerisë; hortikultura në serra; industria metalike; artet interpretuese; agjencitë e punës së përkohshme; dhe spitalet. Kompanitë model janë përdorur si pika referuese të legjislacionit dhe kanë vënë në pah gjithsej 300 pengesa të cilat më pas janë adresuar. Përfaqësuesit nga bizneset dhe organizatat e biznesit janë përfshirë për së afërmi në këtë proces<sup>140</sup>.

Për më tepër, qeveria holandeze ka themeluar disa komitete të cilat, gjatë kohës së zbatimit të politikës për zvogëlim të barrës administrative, kanë analizuar pengesat më të rëndësishme dhe rregullat më të vështira. Këto komitete – siç është Komiteti Stevens<sup>141</sup>, Bordi Hulumtues për Ndërmarrje mbi Barrën Rregullatore<sup>142</sup>, Komiteti Wientjes<sup>143</sup>, Komiteti Elverding<sup>144</sup> – prezantuan sugjerimet praktike për mënyrën e zvogëlimit të barrës administrative. Kontributet kryesore të këtyre komisioneve ishin sigurimi i komenteve kthyese nga bizneset; lidhja e realitetit të bizneseve me përpjekjet për zvogëlim të barrës; sigurimi i përkrahjes politike për çështjet e konsideruara më të rëndësishme nga bizneset; dhe komunikimi – jo direkt – i programit për zvogëlim të barrës tek akterët relevant të biznesit.

### *Mbikëqyrja e pavarur për zvogëlimin e barrës administrative*

Politika holandeze për zvogëlimin e barrës administrative është verifikuar në mënyrë të pavarur nga dy organe. I pari ishte mbikëqyrësi i pavarur Actal. I dyti ishte Gjykata holandeze e auditimit<sup>145</sup>.

<sup>138</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 143, Annex 3, Voortgangsrapportage Strijdige Regels, 22 maj 2006

<sup>139</sup> Aktualisht, Qeveria holandeze ofron informacione të hollësishme për kompanitë përmes faqes së internetit 'www.ondernemersplein.nl'. Kjo faqe e internetit është një kulminacion i iniciativave të tjera, siç janë 'www.bedrijvenloket.nl' dhe 'www.antwoordvoorbedrijven.nl'.

<sup>140</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 94, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 3 tetor 2005.

<sup>141</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 29515, Nr 143, Kabinetsplan aanpak administratieve lasten, 22 maj 2006.

<sup>142</sup> Ondernemersklankbord Regeldruk, MinEZ 2005, Check ook de brief 'De Ondernemer Centraal' van 2006

<sup>143</sup> Programma Regeldruk Bedrijven 2011 – 2015. The Committee is formally known as the 'Commissie Regeldruk Bedrijven'.

<sup>144</sup> Adviesrapport Weg Belemmeringen, Adviezen van de Commissie Fundamentele Verkenning Transportbelemmeringen, 11 qershor 2008.

<sup>145</sup> Përkthim i emrit të organizatës nga gjuha holandeze: Algemene Rekenkamer.

### *Mbikëqyrja nga Actal: 2000-2017*

Actal ishte mbikëqyrësi i pavarur, i cili mbikëqyri politikat e zvogëlimit të barrës administrative në Holandë<sup>146</sup>. Ky institucion ka qenë i përfshirë plotësisht në politikat dhe proceset e hartimit të ligjeve që u zhvilluan posaçërisht për menaxhimin dhe zbatimin e politikës për zvogëlimin e barrës administrative. Qëllimi kryesor ishte të sigurohej që administrata holandeze, pra, nëpunësit civilë që hartojnë politika dhe ligje, të marrin parasysh efektet e rregullimit dhe në veçanti kostot e shkaktuara nga rregullimi.

Actal ishte aktiv në periudhën prej vitit 2000 deri në vitin 2017. Mandati i tij ndryshoi në mënyrë domethënëse, së bashku me emrin e tij. Që nga data 1 qershor 2017, është duke vazhduar me emrin Bordi këshillues holandez për barrët rregullatore<sup>147</sup>.

Mandati i Actal u zhvillua dhe u zgjerua me zhvillimin e politikave për zvogëlimin e barrës administrative dhe u zgjerua për të përfshirë jo vetëm bizneset, por edhe qytetarët, profesionistët që punojnë në sektorin (gjysmë-) publik dhe shkëmbimin e informacioneve midis niveleve të ndryshme të administratës publike.

Në fillimet e veta, në vitin 2000, mandati i Actal ishte të shqyrtojë propozimet ligjore të hartuara nga ministritë e linjës. Duhej të identifikonte mundësitë për të thjeshtuar më tej ndryshimet e propozuara dhe të sugjeronte opsione më pak të rënda, kur identifikonte këto. Actal kishte mandat të jepte mendim zyrtar, por jo të detyrueshëm, në lidhje me aktet ligjore të propozuara.

Në vitin 2004, mandati i tij u zgjerua. Nga ai moment, Actal-it gjithashtu iu lejua të analizojë kornizën ligjore ekzistuese, në mënyrë që të propozojë masat për të zvogëluar barrën administrative për bizneset. Në vitin 2005, fushëveprimi i punës së tij vazhdoi të përfshinte barrën administrative për qytetarët. Në vitin 2008, mandati u zgjerua për të mbuluar kostot e pajtueshmërisë në përgjithësi, kostot që lidhen me inspektimet, barrët që lidhen me aplikimin për subvencione. Gjithashtu, me kërkesën e administratës rajonale dhe lokale, Actal mund të ofronte opinione edhe për veprimtarinë e tyre. Që nga viti 2012, Actal ka zhvilluar 'auditime të barrës rregullatore' dhe ka ofruar sugjerime për të përmirësuar menaxhimin e proceseve për zvogëlimin e barrës rregullatore dhe si të sigurohet se zhvillimi i politikave dhe i ligjit dhe procesi i zbatimit të mbesin në përputhje me nevojat dhe mundësitë e atyre që janë duke u rregulluar.

Funksionimi i Actal-it u vlerësua disa herë. Mandati i tij ishte gjithashtu i përkohshëm, pasi që Qeveria holandeze e ka caktuar mandatin e tij për një numër specifik të viteve. Vlerësimi tregoi përsëri se kontributi i Actal përmes funksionit të tij të jashtëm mbikëqyrës, ishte thelbësor për suksesin e politikave për zvogëlimin e barrëve administrative në Holandë. Qeveri të ndryshme holandeze vlerësuan kontributin e Actal-it, duke vendosur për të zgjatur ekzistencën e tij dhe duke e zgjeruar mandatin e tij. Në sferën ndërkombëtare, modeli i Actal-it ishte transferuar në proceset e politikave dhe ligjërbërjes, për shembull, në Bashkimin Evropian përmes Bordit të shqyrtimit rregullator dhe në Gjermani përmes Normenkontrollrat.

*Figura 34 - Aktivitet e Actal 2000-2017*

- Shqyrtimi i të gjitha propozimeve ligjore për barrën administrative nga viti 2000 e tutje
- Shqyrtimi i të gjitha propozimeve ligjore për barrën rregullatore nga viti 2008 e tutje
- Shqyrtimi i të gjithë raporteve të matjeve
- Shqyrtimi i raporteve Qeveritare dhe ministrore për zbatimin real të caqeve të zvogëlimit të barrëve administrative
- Shqyrtimi i raporteve Qeveritare dhe ministrore për planet për të arritur caqet e zvogëlimit të barrëve administrative

<sup>146</sup> Prezantimi i funksioneve të Actal, i nxjerrë nga broshura 'Naar betere regels – Lessen uit 17 jaar Actal' të publikuar nga Actal në vitin 2017.

<sup>147</sup> Shih gjithashtu: <https://www.atr-regeldruk.nl/english/about-atr>, e vizituar për herë të fundit më 19 mars 2018.

- Ofrimi i sugjerimeve konkrete se si të zvogëlohen barrët administrative
- Ofrimi i këshillës strategjike për arritjen e zvogëlimit në barrët rregullatore
- Kryerja e 'auditimeve të barrës rregullatore' nga viti 2012 e tutje, për të vlerësuar deri në ç' masë ka zhvilluar administrata vetëdije të qëndrueshme në lidhje me barrën rregullatore.

### *Mbikëqyrja nga Gjykata e Auditimit*

Gjykata holandeze e Auditimit publikoi raportin e saj për arritjet e Qeverisë holandeze në qershor të vitit 2006<sup>148</sup>. Ky raport mbuloi vitet 2003 dhe 2004. Analiza u fokusua në pyetjen se a i ka mbajtur Qeveria holandeze premtimet që i ka dhënë Parlamentit. Gjithashtu, ajo analizoi se si kompanitë e kanë vlerësuar zvogëlimin e arritur të barrës.

Përfundimi i përgjithshëm ka qenë se Qeveria holandeze kishte zbatuar atë që kishte premtuar. Proceset e menaxhimit dhe të tjera shoqëruese brenda administratës ishin themeluar dhe funksionalizuar mirë duke mundësuar kështu arritjen e caktuar për zvogëlim të barrës. Masat e propozuara për zvogëlim të barrës administrative në përgjithësi ishin llogaritur në mënyrë të saktë sipas Modelit të Kostimit Standard. Pas kontrollimit të të gjitha masave të zvogëlimit nga viti 2003 dhe 2004 auditorët gjetën vetëm pak gabime në llogaritje.

Raporti i auditorit theksoi një aspekt të rëndësishëm, që lidhet me zvogëlimin e barrës administrative. Kompanitë të cilat pritet të përfitojnë nga thjeshtimi i legjislacionit jo domosdoshmërisht e perceptojnë zvogëlimin e barrës në të njëjtën mënyrë se si administrata pret që ato të ndodhin. Katër arsye kontribuojnë në këtë: (1) kur Informatat e Obligueshme thjeshtohen ose hiqen krejtësisht, kompanitë mund të mos i kenë zbatuar ato në mënyrë të plotë as më parë; kjo ndikon në perceptimin e zvogëlimit të arritur<sup>149</sup>; (2) disa aktivitete administrative vazhdojnë edhe pasi të jetë larguar detyrimi ligjor, por kjo është – natyrisht – zgjedhje e kompanisë ose një zgjedhje e një sektori të industrisë specifike (p.sh. për të respektuar disa standarde dhe raportimin përkatës); (3) Nevojitet kohë që kompanitë të shfrytëzojnë mundësitë e reja të ofruara përmes zvogëlimit të barrëve administrative, pasi që mund të jetë vështirë të ndryshohen zakonet e vjetra; dhe (4) zvogëlimi i barrëve administrative çon në ndryshime ligjore dhe ndryshime në zbatim; kjo nënkupton që kompanitë gjithashtu duhet të përshtaten me situatën e re dhe kjo situatë shkakton kosto të njëhershme të përshtatjes/rregullimit.

### *Komunikimi si shtyllë shtesë e Programit për zvogëlimin e barrës*

Në reagimin e saj ndaj raportit të Gjykatës së Auditimit, Qeveria holandeze shpjegoi se do të vështrojë më për së afërmi perceptimin nga ana e bizneseve dhe do t'i kushtojë më shumë vëmendje mënyrës në të cilën bizneset reagojnë ndaj zvogëlimit të barrës dhe si komunikohen këto zvogëlime. Me prezantimin e programit të zvogëlimit të barrës për periudhën 2007-2011, Gjykata e Auditimeve konstatoi se sugjerimet e saj ishin marrë parasysh, veçanërisht në lidhje me përqendrimin në përmirësimin e komunikimit në lidhje me programin e zvogëlimit të barrës administrative dhe masave individuale të zvogëlimit<sup>150</sup>. Për këtë qëllim, Qeveria holandeze zhvilloi 'Monitorin e Përvojave për zvogëlimin e barrës administrative'<sup>151</sup> për të cilin ishte përgjegjës Shërbimi i

<sup>148</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 30605, Nr 2, Reductie administratieve lasten voor het bedrijfsleven, 15 qershor 2006.

<sup>149</sup> Është me rëndësi të theksohet se moszbatimi ose vetëm pajtueshmëria e pjeshme me detyrimet e informimit nuk duhet domosdoshmërisht të jetë një veprim i qëllimshëm. Rregulla mjaft ndërlikuara që janë të vështira për t'u kuptuar, kërkesat e raportimit të gjerë, në të cilat duhet të sigurohen shumë të dhëna dhe arsye të tjera mund ta vështirësojnë pajtueshmërinë me DI-të. Përveç kësaj, sa më të hollësishme kërkesat nga administrata, aq më të mëdha janë gjasat që të bëhen gabime.

<sup>150</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 30605, Nr 4, Reductie administratieve lasten voor het bedrijfsleven, 27 mars 2008.

<sup>151</sup> Belevingsmonitor Regeldruk 2008, hulumtim i kontraktuar nga Shërbimi për informim public për Ministrinë e Financave; hulumtim i kryer nga Stratus marktonderzoek b.v. dhe i publikuar më 7 maj 2008.

informimit publik i Qeverisë holandeze. Monitori trajtoi çështje që variojnë nga pikëpamjet e sipërmarrësve dhe stafit të kompanive lidhur me kërkesat rregullatore të përgjithshme dhe vlerën e tyre të shtuar, deri tek çështje të tilla si dallimet në përvoja midis kompanive sipas sektorit dhe madhësisë. Kjo gjë u përsërit në vitin 2009<sup>152</sup> dhe në vitin 2010<sup>153</sup>. Gjithashtu, është plotësuar me hulumtime specifike për sektorin<sup>154</sup>.

### *Zvogëlimi i barrës administrative dhe zbatimi i Acquis së BE-së*

Si një shtet anëtarë i BE-së, Holanda është e detyruar të zbatojë legjislacionin e BE-së. Kjo ka ngritur çështje mbi atë se si zbatohet ligji i BE-së dhe nëse legjislacioni plotësohet me masa shtesë (topped up). Në nivel të BE-së, ky proces shpesh referohet si prarimi me flori (*gold plating*), që nënkupton vendosjen e kërkesave shtesë mbi ato që janë përcaktuar nga Direktivat e BE-së<sup>155</sup>.

Pozicioni i Qeverisë holandeze është se të gjitha kërkesat shtesë (*gold plating*) duhet të shmangen, përveç nëse ka arsye të qarta kombëtare për të shkuar përtej kërkesave të përcaktuara në të drejtën e BE-së<sup>156</sup>.

Figura 35 - Llojet e kërkesave shtesë (*gold plating*)

Kërkesat shtesë (*gold plating*) të së drejtës së BE-së ndodhin kur:

- 1) Legjislacioni evropian përcakton standardet minimale dhe këto standarde bëhen më strikte në legjislacionin kombëtar
- 2) Legjislacioni evropian ofron mundësi për të përdorur përjashtime, por ato nuk transpozohen në legjislacionin kombëtar
- 3) Legjislacioni evropian përcakton fushëveprim të qartë të detyrimeve por ky fushëveprim zgjerohet gjatë transpozimit
- 4) Legjislacioni kombëtar ka ekzistuar para se të zhvillohej legjislacioni i BE-së dhe standardet kombëtare janë më strikte se standardet minimale të BE-së
- 5) Standardet e BE-së nuk janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe krahasimi me shtete tjera tregon se është përzgjedhur një qasje që ka mundur të jetë më pak strikte
- 6) Legjislacioni i BE-së është zbatuar para afatit të caktuar për zbatim

Tre rastet e para referohen si kërkesa shtesë (*gold plating*) 'ex-post'. Rasti i katërt referohet si kërkesë shtesë 'ex-ante'. Rasti i pestë është një situatë e 'ndërmjetme' pasi që pyetja nëse kërkesa shtesë ka ndodhur apo jo mund të gjejë përgjigje vetëm pas një analize të thellë. Rasti i gjashtë referohet si kërkesë shtesë e përkohshme.

### *Nga barra administrative tek barra rregullatore*

Programi për zvogëlimin e barrës administrative për kompanitë u zgjerua shpejt për të përfshirë qytetarët, profesionistët që punojnë në sektorin (gjysmë-) publik si dhe administratë. Përveç këtyre barrëve, Qeveria holandeze filloi të shikonte edhe shpenzime të tjera të shkaktuara nga legjislacioni.

Në vitin 2005, Ministria për Çështje Ekonomike filloi pilotime për të matur kostot substanciale<sup>157</sup> të rregullimit<sup>158</sup>. Qeveria holandeze themeloi një objektiv zvogëlimi prej 15% për këto kosto për periudhën 2007-2011. Qasja u fokusua në fushat e mëposhtme specifike të politikave: Mjedis, Bujqësi dhe Natyrë; Transport; Punësim; Kujdes shëndetësor; Hotelieri, Shërbime, Ushqim; Financa. Kostot e përgjithshme për këto sektorë janë llogaritur të jenë 1.8 miliardë Euro në vit. Përveç kësaj, Qeveria holandeze krijoi një objektiv zvogëlimi prej 25% për kostot

<sup>152</sup> Belevingsmonitor Regeldruk 2009, hulumtim i kontraktuar nga Ministria e Financave; hulumtim i kryer nga Stratus marktonderzoek b.v. dhe i publikuar më 15 qershor 2009.

<sup>153</sup> Belevingsmonitor Regeldruk 2010, hulumtim i kontraktuar nga Ministria e Financave; hulumtim i kryer nga Stratus marktonderzoek b.v. dhe i botuar më 23 mars 2010.

<sup>154</sup> Eenmeting ervaren regeldruk in de jeugdsector – Eindrapportage onderzoeksresultaten, hulumtim i kontraktuar nga Ministria e shëndetit, mirëqenies dhe sportit, hulumtim i kryer nga Capgemini Consulting, maj 2011.

<sup>155</sup> Rregulloret e BE-së zbatohen drejtpërdrejt dhe për këtë arsye nuk mund të jenë *gold plated*.

<sup>156</sup> Kabinetsreactie resultaten tweede inventarisatie 'nationale koppen' op Europese regels, 2 nëntor 2007.

<sup>157</sup> E përkthyer nga shprehja në gjuhën holandeze: nalevingskosten.

<sup>158</sup> Tweede Kamer der Staten-Generaal, Kamerstuk 30605, Nr 2, Reductie administratieve lasten voor het bedrijfsleven, 15 qershor 2006.



që lidhen me inspektimet dhe krijoi procesin e thjeshtimit për të siguruar që të gjitha programet e subvencionimit në barrët administrative ishin të ulëta<sup>159</sup>.

Nga viti 2012 e tutje, politikat për zvogëlimin e llojeve të ndryshme të barrës u integruan në një objektiv të vetëm të zvogëlimit prej 2,5 miliardë euro brenda katër vjetëve. Kjo përfshinte barrën administrative për kompanitë, qytetarët dhe profesionistët që punojnë në sektorin (gjysmë-) publik, si dhe kostot e pajtueshmërisë në përgjithësi.

### 3.1.2 Bashkimi Evropian

Bashkimi Evropian filloi programin e vet për zvogëlim të barrës administrative në vitin 2007 dhe përfundoi atë në vitin 2012. Përderisa Holanda ka përfshirë tërë legjislacionin në programin e saj, BE ka zgjedhur të përqendrohet në 13 fusha me prioritet që ose ishin përgjegjëse për një pjesë të konsiderueshme të të gjitha barrëve administrative ose fusha të politikave që konsideroheshin veçanërisht të rëndësishme nga këndvështrimi i bizneseve.

Figura 36 - 13 fushat prioritare të mbuluara nga Programi i Veprimit për Zvogëlimin e Barrës Administrative në BE

- Bujqësia dhe Subvencionet Bujqësore
- Llogaritë vjetore/ Ligji i kompanive
- Politika e kohezionit
- Mjedisi
- Shërbimet financiare
- Peshkataria
- Siguria e ushqimit
- Legjislacioni farmaceutik
- Prokurimi publik
- Statistikat
- Tatimet dhe Doganat
- Transporti
- Mjedisi i punës / Marrëdhëniet e punësimit

Brenda këtyre 13 fushave prioritare, fillimisht u përzgjedhën 42 akte ligjore për matje. Në vitin 2009, ky numër u zgjerua në 72 akte ligjore<sup>160</sup>. Politika është udhëhequr nga një cak i zvogëlimit prej 25% për legjislacionin që mbulohej nga programi dhe funksiononte bazuar në supozimin se aktet ligjore të përzgjedhura përfaqësonin rreth 80% të të gjithë barrës administrative të shkaktuara nga Acquis-i i BE-së.

Matja e barrës administrative tregoi se ligjet e përzgjedhura rezultojnë në gati 124 miliardë Euro barrë administrative në vit për të gjitha kompanitë që janë aktive në BE. Komisioni Evropian kishte zhvilluar propozime që kishin potencial për të zvogëluar barrën administrative për rreth 41 miliardë Euro, por jo të gjitha prej tyre janë miratuar si ligje zyrtare të BE-së. Deri në vitin 2012, shumica e propozimeve për zvogëlim – në vlerë prej 30.8 miliardë Euro në zvogëlim të barrës administrative – ishin miratuar zyrtarisht nga Parlamenti Evropian dhe nga Këshilli i Bashkimit Evropian. Kjo nënkuptoi se ishte arritur caku i zvogëlimit prej 25% dhe që përqindja e synuar e zvogëlimit të barrës ishte tejkaluar.

Programi për zvogëlimin e barrës administrative është përkrahur nga shtetet anëtare të BE-së përmes Grupit të Nivelit të Lartë të Ekspertëve Kombëtar për Rregullim më të mirë dhe Pikave të Vetme të Kontaktit. Përveç kësaj, mbikëqyrja e pavarur e matjeve dhe mundësive për zvogëlim është bërë nga Grupi i Nivelit të Lartë të Akterëve

<sup>159</sup> Voortgangsrapportage Regeldruk Bedrijven, maj 2009.

<sup>160</sup> 'Programi i Veprimit për Zvogëlimin e Barrëve Administrative në BE – Përmeshja e premtimeve', Komisioni Evropian, 2010.



Zyra e Kryeministrit – Sekretariati Koordinues i Qeverisë: Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative – Heqja e Barrierave Burokratike të Pavarur mbi Barrët Administrative. Ky grup u themelua në vitin 2007 dhe ofroi, për shembull, këshilla për zbatimin e programit dhe aplikimin e MKS-së.

Fillimisht, përgjegjësia e menaxhimit të programit për zvogëlim të barrës administrative i takoi Komisionerit për Ndërmarrje dhe Industri. Kjo përfshinte përgjegjësitë për metodologjinë e MKS-së, menaxhimin e procesit të matjes dhe raportimin në lidhje me masat e zvogëlimit.

Me përmbylljen e suksesshme të programit të zvogëlimit, Komisioni Evropian integroi qëllimin për zvogëlim të mëtejshëm të barrës administrative në politikën e tij të përgjithshme për Rregullim më të Mirë. Modeli i Kostimit Standard u integrua në procesin e zhvillimit të politikave përmes Udhëzuesit dhe Pakos së veglave për Rregullim më të Mirë<sup>161</sup>. Kjo do të thotë se përdorimi i MKS-së është pjesë e procesit të vlerësimit ex-ante si dhe të proceseve të vlerësimit ex-post<sup>162</sup>.

Për më tepër, Komisioni Evropian vazhdoi programin për zvogëlim të barrës administrative përmes iniciativës së programit për Zvogëlimin e Barrës Administrative Plus (ZBA+). Kjo iniciativë u përqendrua në zbatimin e zvogëlimit të barrës administrative përmes zgjidhjeve zbatuese të bëra nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe shkëmbimit të praktikave më të mira të zbatimit<sup>163</sup>.

Përveç kësaj, Komisioni Evropian krijoi Programin e Përshtatshmërisë dhe Performancës së Rregullatorit (REFIT) në vitin 2015<sup>164</sup>. Arsyeshmëria prapa programit REFIT është thjeshtimi i të drejtës së BE-së dhe rritja e efikasitetit duke zvogëluar kostot që shkakton legjislacioni. Kjo duhet të arrihet pa penguar objektivat e politikave. Programi bazohet në vlerësimin për mbledhje të dëshmimeve në lidhje me propozimet për thjeshtim dhe në konsultime dhe përfshirje të gjerë të shteteve anëtare të BE-së dhe palëve të interesit.

### 3.1.3 Gjermania<sup>165</sup>

Programi i zvogëlimit të barrës në Gjermani adreson barrët që legjislacioni shkakton për kompanitë, qytetarët dhe administratën publike. Pikë e fokusit fillimisht ishin barrët administrative, por është zgjeruar për t'i përfshirë kostot e pajtueshmërisë.

Pas periudhës fillestare përgatitore prej rreth dy vitesh gjatë së cilës qasja holandeze në lidhje me zvogëlimin e barrës administrative u mor si model kryesor për zhvillimin e qasjes gjermane, qeveria federale e Gjermanisë inicioi programin e saj administrativ për zvogëlimin e barrës në vitin 2006.

<sup>161</sup> [https://ec.europa.eu/info/law/law-making-process/planning-and-proposing-law/better-regulation-why-and-how/better-regulation-guidelines-and-toolbox\\_en](https://ec.europa.eu/info/law/law-making-process/planning-and-proposing-law/better-regulation-why-and-how/better-regulation-guidelines-and-toolbox_en), uebfaqja është vizituar për herë të fundit më 30 prill 2018.

<sup>162</sup> Shih gjithashtu *European Commission Tool #60 Modeli i Kostos Standarde për llogaritjen e shpenzimeve administrative*: [https://ec.europa.eu/info/files/better-regulation-toolbox-60\\_en](https://ec.europa.eu/info/files/better-regulation-toolbox-60_en).

<sup>163</sup> 'Programi i Përshtatshmërisë dhe Performancës së Rregullatorit (REFIT): Gjendja aktuale dhe perspektiva', Komisioni Evropian, 2014.

<sup>164</sup> [https://ec.europa.eu/info/law/law-making-process/evaluating-and-improving-existing-laws/refit-making-eu-law-simpler-and-less-costly/refit-platform\\_en](https://ec.europa.eu/info/law/law-making-process/evaluating-and-improving-existing-laws/refit-making-eu-law-simpler-and-less-costly/refit-platform_en), uebfaqja është vizituar për herë të fundit më 30 prill 2018.

<sup>165</sup> Përshkrimi i programit të zvogëlimit të barrës administrative në Gjermani bazohet kryesisht në analizën e dokumentit në vijim: 'Bessere Rechtsetzung 2016:

Mehr Zeit für das Wesentliche', Bericht der Bundesregierung 2016 për § 7 të Gesetzes zur Einsetzung eines Nationalen Normenkontrollrates, Kancelaria Federale e Gjermanisë, maj 2017. Kur përshkrimi nuk i referohet këtij dokumenti, burimet shtesë janë referuar qartë në fusnotat shtesë.

Për më tepër, prezantimet e ofruara nga përfaqësuesit e qeverisë gjermane dhe administrata e saj gjatë vizitës studimore të mbështetur nga HCDF-ja reflektohen gjithashtu në këtë përshkrim të politikës gjermane për uljen e barrës administrative.

*Fillimi i programit të zvogëlimit në Gjermani dhe procesi i matjes*

Në muajin prill të vitit 2006, qeveria federale Gjermane miratoi vendimin për fillimin e programit të zvogëlimit<sup>166</sup>.

Në vendimin e saj, qeveria federale përcaktoi përfitimet e zvogëlimit të barrës administrative në lidhje me krijimin e bazës më të mirë për rritjen ekonomike dhe rritjen e pranimit dhe besimit në politikat dhe legjislacionin e miratuar dhe zbatuar nga ana e qeverisë.

Vendimi ka paraparë (1) bazën për rolin e Këshillit Kombëtar të Kontrollit Rregullator (NRCC); (2) prezantoi Modelin e Kostimit Standard si metodologji e kërkuar për identifikimin dhe matjen e kostove administrative; (3) përcaktoi pozitën e re të koordinatorit për zvogëlimin e barrës administrative; (4) e ngarkoi Komitetin e Sekretarëve të Përgjithshëm me koordinimin e zbatimit të programit; (5) themeloi Zyrën për Zvogëlimin e Barrës Administrative në Kancelarinë Federale me rreth dhjetë anëtarë të stafit; (6) tregoi përgjegjësinë e ministrive për zhvillimin e matjes bazë në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Zyrës Federale të Statistikave; dhe (7) përcaktoi kërkesën për të përdorur MKS-në gjatë procesit të zhvillimit të politikave të reja dhe propozimeve legjislative.

Vendimet e qeverisë ofruan themelin për zhvillimin e Ligjit mbi Themelimin e Këshillit Kombëtar të Kontrollit Rregullator në gusht të vitit 2006, i cili u përditësua në vitin 2011<sup>167</sup>. Ky ligj formalizoi dhe rrjedhimisht e forcoi në masë të madhe bazën për zvogëlimin e barrës administrative duke përcaktuar rolet e institucioneve kryesore si: Zyra e Kancelarit Federal, Këshilli Kombëtar i Kontrollit Rregullator, Zyra Federale e Statistikave dhe kërkesat e përcaktuara për vetë Qeverinë Federale. Për më tepër, i njëjti siguroi bazën ligjore për zbatimin e Modelit të Kostimit Standard dhe përcaktoi fushëveprimin e politikës për adresimin e barrëve administrative (dhe nga viti 2011 edhe kostot e pajtueshmërisë) për të mbuluar ndërmarrjet, qytetarët dhe administratën.

Të gjitha këto marrëveshje janë bërë për të siguruar që Gjermania do të mund të arrinte rezultate në raport me synimin për zvogëlimin e barrëve administrative prej 25%.

Pas vendimit të muajit prill, Zyra Federale e Statistikave përfundoi manualin metodologjik për zbatimin e Modelit të Kostimit Standard në muajin gusht. Ky manual shërbeu si bazë për zhvillimin e matjes bazë dhe futjen e MKS-së në procesin e zhvillimit të politikave dhe procesin e ligjërjes.

Në fund të vitit 2006 janë përfunduar trajnimet për stafin përkatës në ministritë e linjës lidhur me aplikimin e Modelit të Kostimit Standard. Gjatë kësaj kohe u identifikuan të gjitha informatat e obligueshme në legjislacionin federal. Stafi në ministritë e linjës ishte përgjegjës për këtë detyrë pasi ata kishin ekspertizë në lidhje me politikat dhe legjislacionin për të cilin ministria e tyre ishte përgjegjëse.

Procesi i matjes që përfundimisht siguroi bazën filloi në janar të vitit 2007 me testimin e metodave të grumbullimit të të dhënave. Deri në verën e vitit 2007 ishin matur informatat më të rënda të obligueshme. Procesi i matjes përfundoi në verën e vitit 2008. Rezultatet e procesit të matjes u prezantuan në dhjetor të atij viti.

*Figura 37 - Metodatat e përdorura nga Zyra Federale e Statistikave për përcaktimin e matjes bazë për barrët administrative*

Metoda e grumbullimit të të dhënave	% e të gjithë IO-ve të matura bazuar në të	Konteksti, historiku dhe dobia e metodës së grumbullimit të të dhënave
Intervistat në terren	1%	Për shkak të madhësisë së vendit, matja bazë gjermane nuk zhvilloi numër të madh të intervistave sy më sy pasi diçka e tillë do të ishte disproporcionale sa i

<sup>166</sup> Kabinettschluss vom 25. prill 2006 'Programm Bürokratieabbau und bessere Rechtsetzung':

<https://www.bundesregierung.de/resource/blob/975232/444356/d6e11886e90972808ebf6948131e07d8/2010-09-17-kabinettschluss-april-2006-data.pdf?download=1>

<sup>167</sup> <http://www.gesetze-im-internet.de/nkrg/NKRG.pdf>.

		përket kostove dhe kërkon shumë kohë. Intervistat në terren u mbajtën për IO-të shumë kërkuese dhe konsiderohen veçanërisht të dobishme për vlerësimin e proceseve të organizatave që duhet të jenë në pajtueshmëri me një numër të madh të informatave të obligueshme.
Intervistat telefonike	14%	Intervistat telefonike ishin mjet i dobishëm për marrjen e informatave nga kompanitë në mënyrë efikase. Kjo qasje doli të jetë e rëndësishme veçanërisht në rastet kur IO-të nuk ishin shumë komplekse në strukturë dhe zbatim.
Panelet e ekspertëve	25%	Panelet e ekspertëve me përfaqësues të bizneseve, ishin të dobishme për përcaktimin e vlerës bazë për procedura dhe kërkesa më komplekse. Ato dëshmuuan se ishin metodë efektive dhe eficiente në marrjen e informatave të kërkuara.
Simulimet	23%	Simulimet ishin praktike për IO-të dhe kërkesat e të dhënave me natyrë jo komplekse. Simulimet mund të zhvilloheshin bazuar në informatat e marra përmes metodologjive të tjera që ofruan informata për matjen bazë.
Intervistat e ekspertëve	19%	Intervistat e ekspertëve ishin të dobishme për marrjen e informatave të hollësishme në lidhje me proceset komplekse dhe IO-të dhe të njëjtat siguruan mundësinë për të zhvilluar diskutime të thella me numër të kufizuar njerëzish.
Intervistat e bazuara në dokumente	18%	Pyetësorët ishin mënyrë e dobishme për të fituar njohuri mbi proceset me të cilat mund të lidhjet pyetësi. Për shembull, informatat e nevojshme për plotësimin e aplikacioneve të caktuara mund të grumbulloheshin përmes pyetësorit i cili të anketuarve iu kërkuar ta plotësonin si pjesë e procesit të aplikimit.
Studimet	1%	Studimet ishin mjet i dobishëm për analizën e IO-të shumë komplekse dhe po ashtu për të mundësuar identifikimin e masave të zvogëlimit që do të ishin të mundshme vetëm përmes grupit kompleks të ndryshimeve në zbatim dhe atyre ligjore.

Në përgjithësi, procesi i matjes zgjati nga gushti i vitit 2006 deri në përfundimin e rezultateve në dhjetor të vitit 2008<sup>168</sup>. Kjo është periudhë kohore prej gati 2 vjet e gjysmë. Zgjedhja për ta fokusuar pjesën e parë të procesit të matjes obligimet më të rënda për informim ofroi moment të mirë për paraqitjen e rezultateve konkrete në mënyrë relativisht të shpejtë dhe për fillimin e punës në masa për zvogëlimin e barrëve të shkaktuara si pasojë e këtyre IO-ve.

Që nga vendimi në prill të vitit 2006, qasja për zvogëlimin e barrëve administrative është ngulitur më tej në proceset e vendimmarrjes dhe strukturat e qeverisë federale të Gjermanisë. Në veçanti, qasja fillestare në kuadër të së cilës programi për zvogëlimin e barrëve administrative mund të karakterizohet më shumë si projekt i ndryshuar për të siguruar përfshirjen e plotë të politikës së zvogëlimit në strukturat formale të Qeverisë. Diçka e tillë është veçanërisht e dukshme me rastin e krijimit të pozitës së Ministrit të Shtetit dhe Koordinatorit për Burokracinë e Zvogëlimit dhe Rregullimit më të Mirë.<sup>169</sup>

#### *Menaxhimi i zvogëlimit të barrëve administrative: detyrat dhe përgjegjësitë institucionale*

Organizimi i politikës për zvogëlimin e barrëve administrative dhe kostove të pajtueshmërisë në Gjermani mbulon si nivelin politik ashtu edhe atë administrativ/teknik.

Roli i Ministrit të Shtetit për Zvogëlim të Burokracisë dhe Rregullim më të Mirë është ta sigurojë zbatimin e qëllimit politik për zvogëlimin e burokracisë duke koordinuar këtë politikë në nivel të qeverisë dhe t'i ruajë

<sup>168</sup> Sekuencimi i hapave në procesin e matjes ishte siguruar gjatë prezantimit të përfaqësuesit të Zyrës Statistikore Federale të Gjermanisë si pjesë e vizitës studimore të mbështetur nga HCDF-ja.

<sup>169</sup> <https://www.bundesregierung.de/breg-de/themen/die-staatsminister-444562>.

Zyra e Kryeministrit – Sekretariati Koordinues i Qeverisë: Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative – Heqja e Barrierave Burokratike marrëdhëniet me parlamentin sa i përket kësaj çështje. Ministri i Shtetit mbështetet nga Njësia për Rregullim më të Mirë në kuadër të Zyrës së Kancelarit Federal.

Figura 38 - Ligjet ombrellë për zvogëlimin e barrëve administrative

Qeveria Federale Gjermane deri më tani ka përgatitur tri ligje nën emrin “Bürokratieentlastungsgesetz” (Ligji për Zvogëlimin e Burokracisë - LRB)<sup>170</sup>, të cilat synojnë t’i zvogëlojnë barrët administrative. Këto ligje janë të shënuara me numra, prandaj LRB III erdhi pas LRB I dhe LRB II.

Këto ligje janë ligje ombrellë përmes të cilave një sërë ligjesh të tjera ndryshohen gjatë me rastin e një procedure legjislative. Kjo praktikë zvogëlon kohën dhe ngarkesën procedurale të nevojshme për miratimin e ndryshimeve të drejtpërdrejta ligjore. Shpeshherë, vetëm disa nene të ligjeve duhet të ndryshohen për të arritur zvogëlime të konsiderueshme të barrëve administrative.

Ligjet po ashtu ofrojnë përfitim shtesë duke siguruar moment të rëndësishëm komunikimi pasi përqendrimi mund të jetë plotësisht në qëllimin kryesor të ligjit i cili është zvogëlimi i barrëve administrative.

Ligjet ombrellë të krahasueshme me ato të zhvilluara dhe të miratuara në Gjermani nuk do të ishin praktike në rastin e Kosovës në këtë kohë. Gjermania ka krijuar proces funksional për konsolidimin e legjislacionit. Në anën tjetër, Kosova për momentin nuk posedon proces të tillë dhe zhvillimi/miratimi i ligjeve ombrellë do të kërkonte shumë sa i përket implementimit.

Njësia për Rregullim më të Mirë në kuadër të Kancelarisë Federale është përgjegjëse për menaxhimin e drejtimit të përgjithshëm të programit të zvogëlimit, inicimin e ideve të reja për propozime të mundshme të zvogëlimit dhe për të siguruar që publiku informohet në mënyrë efektive. Nëpërmjet mbështetjes që i ofron Ministrit të Shtetit për Zvogëlim të Burokracisë dhe Rregullim më të Mirë, ajo posedon mjetet për të siguruar menaxhim efektiv ditor për programin e zvogëlimit si dhe për adresimin e pengesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të cilat mund të lindin gjatë zbatimit të programit.

Figura 39 - Panelet e akterëve të organizuara në Gjermani

Roli i Njesisë për Rregullim më të Mirë në kuadër të Kancelarisë Federale shfaqet përmes aktiviteteve të tilla si organizimi i dhjetë punëtorive me pjesëmarrje të akterëve dhe me qëllim të identifikimit të pengesave të cilat janë veçanërisht relevante për to dhe të përcaktimit të mundësive për zvogëlimin e barrëve administrative. Gjatë këtyre punëtorive, një gamë e gjerë e akterëve relevant – përveç akterëve të prekur – siç janë akterët relevantë të politikave dhe ato ligjorë nga ministritë e linjës, agjencitë përmbareuese dhe organizatat përfaqësuese, janë përfshirë në diskutime.

Pas qasjes holandeze për zvogëlimin efektiv të barrëve administrative, Qeveria Federale themeloi organin për mbikëqyrje të pavarur të programit të zvogëlimit të barrëve. Normenkontrollrat (Këshilli Kombëtar i Rregullatorit të Kontrollit – NRCC) kishte për qëllim të kryente funksione të mbikëqyrjes të ngjashme me Actal. Që nga themelimi i saj, NRCC-ja ka shqyrtuar më shumë se 4800 propozime rregullatore<sup>171</sup> (si ligje ashtu edhe akte nënligjore). Për më tepër, NRCC-ja inicion debate mbi atë se si të zhvillohen më tej propozimet dhe qasjet për zvogëlimin e barrëve administrative. Dy shembuj të kësaj pune janë Monitorimi për Administrimin Digjital<sup>172</sup> përmes të cilit synohet fuqizimi i përpjekjeve për përmirësimin e digjitalizimit dhe raporti i tij “Së pari përmbajtja, pastaj paragrafët ligjorë”<sup>173</sup> përmes të cilit synohet të iniciohet shqyrtimi themelor i procesit të zhvillimit të

<sup>170</sup> [https://www.bmwi.de/Navigation/DE/Themen/themen.html?cl2Categories\\_LeadKeyword=buerokratieabbau](https://www.bmwi.de/Navigation/DE/Themen/themen.html?cl2Categories_LeadKeyword=buerokratieabbau)

<sup>171</sup> Ky numër është kombinim i 3900 propozimeve që NRCC-ja i shqyrtoi nga fillimi i saj deri në vitin 2016 dhe ngarkesa mesatare e punës e më shumë se 300 propozimeve në vit pas kësaj.

<sup>172</sup> <https://www.normenkontrollrat.bund.de/resource/blob/72494/1604240/59e2e82ce93c139966cabe9b33d37330/2019-04-30-monitor-digitale-verwaltung-2-data.pdf?download=1>

<sup>173</sup> <https://www.normenkontrollrat.bund.de/resource/blob/300864/1681244/594995cfe4ee756736d58a8b889954b7/2019-10-22-nkr-gutachten-data.pdf>

politikave dhe atij të ligjbërjes në Gjermani, ku Vlerësimi i Ndikimit realizohet para fillimit të procesit të hartimit ligjor.

Figura 40 - Masat më të rëndësishme të zvogëlimit të barrëve administrative në Gjermani 2006 – 2012

Viti	Masa	Kosto
2006	Thjeshtimi i faturave për shuma të vogla (Akti i Taksave mbi Shitjet) dhe masa të tjera	EUR 600 milionë
2008	Thjeshtimi i dëshmisë së kthimit dhe riciklimit të paketimit të shitjes (Urdhëresa e Paketimit) dhe masa të tjera	EUR 186 milionë
2009	Thjeshtimi i rregullave të kontabilitetit me theks të veçantë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (Akti i Modernizimit të Ligjit të Kontabilitetit) dhe masa të tjera	EUR 2,5 miliardë
2010	Futja e formularit elektronik të tatimit mbi të ardhurat (Akti i Taksave Vjetore 2008) dhe masa të tjera	EUR 278 milionë
2011	Thjeshtimi i faturimit elektronik (Akti i Thjeshtimit të Taksave 2011) dhe masa të tjera	EUR 4,1 miliardë
2012	Heqja e tarifës së konsultës mjekësore (ndryshimi në Kodin Social gjerman vëllimi 5) dhe masa të tjera	330 milionë euro

Zyra Federale e Statistikave Destatis ishte përgjegjëse për zhvillimin e matjes bazë dhe e njëjta ka përditësuar këtë matje qysh atëherë me qëllim të ruajtjes së relevancës së saj dhe të sigurimit të pasqyrës së hollësishme të zhvillimit aktual të barrave administrative në Gjermani. Matja e plotë e të gjithë legjislacionit federal përfshiu më shumë se 9500 obligime për informim. Barrët administrative që rezultojnë nga legjislacioni federal arritën në EUR 49 miliardë për vit, shumë kjo e barasvlershme me 2.1% të BPV-së së Gjermanisë në atë kohë. Në vitin 2011, objektivi i zvogëlimit u arrit dhe barrët administrative ishin zvogëluar në mënyrë strukturore për EUR 12 miliardë në vit.

Figura 41 -Destatis si ofrues i shërbimit për matjet e MKS-së

Në kuadër të Destatis, një numër i konsiderueshëm njerëzish angazhohen në matjet ex-ante dhe vlerësimet ex-post si pjesë e politikës “Një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet” (One-In-On-Out). Detyrat ndryshojnë nga sigurimi i uniformitetit metodologjik, zhvillimit dhe përmirësimit të mëtutjeshëm të metodologjisë për matjen e kostove të pajtueshmërisë, realizimi i matjeve ex-ante për të gjitha propozimet legjislative dhe realizimi i vlerësimit ex-post të propozimeve të cilat ndikojnë në nivelin e kostove të pajtueshmërisë me më shumë se 1 milion euro për vit. Numri i përgjithshëm i personave të përfshirë në këto procese në Destatis është rreth 100.

Kjo siguron që Destatis, së pari, mund të operojë si ofrues i brendshëm i shërbimeve për ministritë e linjës. Në një numër të konsiderueshëm të rasteve (rreth gjysmës së rasteve), Destatis kryen matjet e kostos së pajtueshmërisë për ministritë e linjës. Ministritë e linjës i kryejnë llogaritjet e mbetura vetëm ose në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarët e Destatis.

Burimet njerëzore të disponueshme po ashtu sigurojnë që, së dyti, vlerësimi ex-post të bëhet në mënyrë të pavarur nga ministritë e linjës. Destatis ngarkohet me këtë punë dhe duhet ta zhvillojë pa përfshirjen e ministrisë përgjegjëse. Kjo mënyrë e punës siguron kontrollin dhe balancet e nevojshme për të siguruar që matjet janë të cilësishme së lartë dhe që niveli i vendimmarrjes informohet siç duhet.

Shifrat bazë janë në dispozicion të publikut në internet përmes aplikacionit WebSKM<sup>174</sup>. Kjo nënkupton që çdo person i interesuar mund t'i qaset informatave dhe t'i shohë barrët aktuale të shkaktuara nga legjislacioni në fuqi. Baza e të dhënave po ashtu ofron informata mbi nivelin e barrëve administrative në vitet e kaluara, duke shërbyer kështu si mjet që tregon se si politika e zvogëlimit të barrëve administrative është zhvilluar me kalimin e kohës.

Figura 42 - Vëzhgimet që rezultojnë nga matja bazë

Legjislacioni i dy ministrive siguroi pjesën më të lartë të barrëve administrative për kompanitë. Këto ishin Ministria e Financave (43%) dhe Ministria e Drejtësisë (24%).

Dhjetë obligimet më të rënda për informim shkaktuan 56% të të gjitha barrëve administrative.

Njëqind obligimet më të rënda për informim shkaktuan 90% të të gjitha barrëve administrative.

Këto ishin IO-të që u aplikuan për (pothuajse) të gjitha bizneset, siç janë ligji tatimor, sigurimet shoqërore, etj.

Gjermania nuk ka analizuar barrët e vetme më të larta administrative nga këndvështrimi i kompanisë, p.sh. cila leje i impononte sistemit barrët më të mëdha.

### *Nga ulja e barrës administrative në “Një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet” (“One-In-One-Out”) dhe kostot e pajtueshmërisë*

Përderisa qeveritë holandeze vendosën të krijojnë objektiva të njëpasnjëshme për zvogëlimin e barrëve administrative, Qeveria Federale e Gjermanisë vendosi për qasjen e sigurimit që barrët administrative nuk tejkalojnë nivelin e muajit janar të vitit 2012. Për të siguruar ruajtjen e këtij niveli, ministrinë në Gjermani duhet t'i vlerësojnë barrët e pritshme administrative për secilin propozim legjislativ.

Destatis krijoi Indeksin e Kostos së Burokracisë i cili është paraqitur në figurën në vijim. Indeksi siguron përditësim të përmuajshëm të barrëve administrative në Gjermani që nga muaji janar i vitit 2012. I njëjti bazohet në barrët totale administrative me të cilat përballen kompanitë pasi ato duhet t'i respektojnë obligimet për informim çdo vit.

Niveli i barrës administrative në muajin janar të vitit 2012 është përcaktuar në 100. Qëllimi i qeverisë është të sigurojë që trendi afatgjatë të jetë mbajtja e barrëve administrative në ose nën atë nivel. Vlerat nën 100 tregojnë se barrët janë nën nivelin e vitit 2012. Siç tregon figura në vijim, ky qëllim është arritur që nga mesi i vitit 2015 e tutje. Barrët administrative shënuan rritje të vogël ndërmjet vitit 2012 dhe gjysmës së parë të vitit 2015, por nga qershori i vitit 2015, niveli i ngarkesës është mbajtur nën nivelin e muajit janar të vitit 2012.

Figura 43 - Zhvillimet në nivelet e barrëve administrative në Gjermani ndërmjet viteve 2012 dhe 2017<sup>175</sup>

<sup>174</sup> <https://www-skm.destatis.de/webskm/online>

<sup>175</sup> Burimi: [https://www.destatis.de/DE/Themen/Staat/Buerokratiekosten/Buerokratiekostenindex/buerokratiekostenindex\\_.html](https://www.destatis.de/DE/Themen/Staat/Buerokratiekosten/Buerokratiekostenindex/buerokratiekostenindex_.html), faqja e internetit vizituar për herë të fundit më 30 tetor 2019

## Bürokratiekosten

# Bürokratiekostenindex

**Bürokratiekostenindex; Januar 2012 = 100**

Jahr	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Januar	100,00	100,28	100,32	100,02	99,10	98,99	99,19	99,49
Februar	.	100,29	100,33	100,02	99,10	98,97	99,19	99,49
März	.	100,25	100,33	100,23	99,01	98,97	99,11	99,50
April	.	100,26	100,33	100,22	99,08	98,94	99,11	99,52
Mai	100,27	100,30	100,31	100,22	99,07	98,94	99,13	99,52
Juni	100,30	100,30	100,40	98,99	98,97	99,16	99,13	99,57
Juli	100,24	100,32	100,40	99,00	98,98	99,21	99,12	99,57
August	100,25	100,33	100,41	98,72	98,71	99,18	99,15	99,70
September	100,21	100,32	100,35	98,70	98,71	99,03	99,24	98,45
Oktober	100,23	100,32	100,36	98,79	98,73	99,17	99,24	...
November	100,25	100,31	100,08	99,10	98,72	99,17	99,01	...
Dezember	100,27	100,31	100,13	99,10	99,00	99,11	99,49	...

. = Zahlenwert unbekannt oder geheim zu halten.  
... = Angabe fällt später an.

**Stand** 25. Oktober 2019

Në vitin 2013 u prezantua kërkesa për të vlerësuar çdo propozim legjislativ brenda disa viteve pas miratimit. Kjo kërkesë vlen për të gjitha propozimet që pritet të ndikojnë në nivelet e ngarkesës me të paktën 1 milion Euro në vit dhe siguron cilësinë e shifrave të përdorura për Indeksin e Kostos së Burokracisë.

Në vitin 2015, Qeveria Federale përcaktoi parimin “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet” (“one in – one out”). Kur propozimet legjislative krijojnë barrë shtesë administrative, këto duhet të kompensohen duke zvogëluar barrët administrative diku tjetër. Përrjashtimet e vetme nga ky rregull janë propozimet legjislative të cilat vijnë nga zbatimi i kërkesave të përcaktuara në nivel të BE-së ose nivel ndërkombëtar, masat emergjente dhe rritjet që kufizohen në kohë në maksimum prej një viti<sup>176</sup>. Për më tepër, “anketat e ngjarjeve të jetës” u prezantuan për të vlerësuar se si qytetarët dhe kompanitë i perceptojnë barrët administrative në jetën e tyre të përditshme.

Ndërmjet viteve 2012 dhe 2016, Qeveria Federale zbatoi më shumë se 100 projekte individuale që synonin posaçërisht zvogëlimin e barrëve administrative. Në vitin 2016, ajo gjithashtu prezantoi Testin e NVM-ve për të siguruar që zhvillimi i politikave në Gjermani do të merrte më shumë në konsideratë situatën specifike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

*Figura 44 - Ligji për Qasje Online në Gjermani*

<sup>176</sup> [https://www.bundesregierung.de/Content/DE/Artikel/Buerokratieabbau/Anlagen/15-03-25-one-in-one-out.pdf?\\_blob=publicationFile&v=6](https://www.bundesregierung.de/Content/DE/Artikel/Buerokratieabbau/Anlagen/15-03-25-one-in-one-out.pdf?_blob=publicationFile&v=6), faqja e internetit e vizituar për herë të fundit më 30 prill 2018



Digjitalizimi siguroi shtytë të rëndësishme për zvogëlimin e barrëve administrative në Gjermani. Qëllimi i Ligjit për Qasje Online <sup>177</sup> është digjitalizimi i rreth 600 procedurave. Parimet udhëzuese gjatë këtij procesi bazohen në qasjen e përqendruar ndaj përdoruesit me rastin e zhvillimit të zgjidhjeve të TI-së, përmirësimi i qasshmërisë së administratës përtej orëve zyrtare punës dhe të siguruarit që përvoja e klientit udhëzon zhvillimin e zgjidhjeve të TI-së.

### Zhvillimi i barrëve administrative në Gjermani nga viti 2006 deri në 2019

Programi i zvogëlimit të barrëve administrative të kombinuara me politikën “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet” (“One-in-One-Out”) shihen në të dhënat që publikon Destatis. Këto pasqyrohen në figurën në vijim.

Figura 45 - Zhvillimi i barrëve administrative në Gjermani ndër vite<sup>178</sup>

#### Entwicklung des Bürokratiekostenindex seit der Bestandsmessung

Januar 2012 = 100 Stand: 1. Juli 2019




Figura tregon se politika e zvogëlimit të barrëve administrative karakterizohet nga disa momente gjatë të cilave mund të vërehen rënie mbresëlënëse në këto barra. Kjo lidhet me faktin se disa informata të obligueshme shkaktojnë shumicën e barrëve administrative. Thjeshtimi i tyre, kur është substancial, do të ketë ndikim të konsiderueshëm pozitiv në nivelin e përgjithshëm të barrëve. Për më tepër, pasqyra e barrëve administrative tregon se masave për zvogëlimin e tyre u nevojitet kohë për t'u përgatitur dhe që, nga këndvështrimi politik, ato shpesh kombinohen në pako që do të shkaktojnë zvogëlime të konsiderueshme si të tilla.

### 3.1.4 Mbretëria e Bashkuar<sup>179</sup>

Mbretëria e Bashkuar zbatoi programin e saj për zvogëlim të barrës administrative në periudhën 2005-2010. Programi ishte i bazuar në një cak të zvogëlimit prej 25% dhe në një matje të plotë të të gjitha barrëve

<sup>177</sup> <https://www.bmi.bund.de/DE/themen/moderne-verwaltung/verwaltungsmodernisierung/onlinezugangsgesetz/onlinezugangsgesetz-artikel.html>

<sup>178</sup> *Weniger Bürokratie, bessere Gesetze — Praxis mitdenken, Ergebnisse spürbar machen, Fortschritte einfordern*, JAHRESBERICHT 2019 des Nationalen Normenkontrollrates, faqe 19.

<sup>179</sup> Përshkrimi i programit të zvogëlimit të barrës administrative në MB bazohet kryesisht në analizën e dokumentit në vijim: ‘Planet për thjeshtësim 2005-2010, Raporti final’, Departamenti për Biznes, Inovacion & Shkathtësi/Ekzekutivi për Rregullim më të Mirë, Korrik 2010.

Kur përshkrimi nuk i referohet këtij dokumenti, burimet shtesë janë referuar qartë në fusnota shtesë.

Zyra e Kryeministrit – Sekretariati Koordinues i Qeverisë: Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative – Heqja e Barrierave Burokratike administrative. Matja tregoi se totali i këtyre barrëve ishte 13.16 miliardë Funta në vit. Deri në fund të programit, kjo barrë u zvogëluar për 26.63%.

Menaxhimi në baza ditore ishte vendosur në Ekzekutivin e Rregullimit më të Mirë i cili në fillim ishte vendosur në Zyrën e Kabinetit. Në vitin 2007, u transferua në Departamentin për Biznes, Energji dhe Strategji Industriale (BEIS)<sup>180</sup>. Politikisht, pronësia e objektivit të zvogëlimit ishte inkorporuar brenda Qeverisë, po ashtu me Kryeministrin që mori përgjegjësi personale<sup>181</sup>.

Programi për zvogëlim të barrës administrative u vendos thellësisht në procesin e zhvillimit të politikave dhe të ligjeve. Në vitin 2006, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar prezantoi 'Propozimin për Reforma Legjislative dhe Rregullatore'<sup>182</sup>. Ky propozim paraqiti mjetet përmes të cilave Qeveria do të mund të përshpejtonte propozimet për zvogëlim të barrës administrative dhe të ndryshonte/shfuqizonte legjislacionin e vjetruar apo të panevojshëm.

Mbikëqyrja e programit për zvogëlim të barrës është bërë nga Paneli i Jashtëm për Validim (*External Validation Panel/EVP*). Ky panel u krijua pasi një sërë akterësh të jashtëm sugjeruan se supozimet e zvogëlimit të barrës administrative duhet të testoheshin nga përfaqësues të komunitetit të biznesit. Paneli gjithashtu luajti një rol të rëndësishëm në komunikimin e masave për zvogëlim të barrës tek bizneset.

Si vazhdim i programit për zvogëlim të barrës administrative, në vitin 2011 Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar prezantoi rregullin 'one in – one out' (një shtohet-një largohet) dhe e përfshiu atë në programin e Qeverisë për vitin 2010<sup>183</sup>. Ky rregull u zgjerua më tej në 'one in – two out' ('një shtohet - dy largohen')<sup>184</sup> në vitin 2013 dhe, në vitin 2016, në 'një shtohet - tre largohen'<sup>185</sup>. Qëllimi i këtyre rregullave ishte të kontribuonin në uljen e mëtejshme të shpenzimeve rregullatore që rezultojnë nga kërkesat që bizneset duhet të përmbushin në baza vjetore. Këto shpenzime përfshinin barrën administrative, por mbulonin të gjitha shpenzimet që shkaktoheshin nga legjislacioni dhe nuk merrnin parasysh përfitimet që do të sillnin propozimet. Përsjashtime nga detyrimi për të kompensuar kostot e shkaktuara nga rregullat e reja përbëjnë kërkesat ligjore që rrjedhin nga e drejta e BE-së, marrëveshjet ndërkombëtare dhe legjislacioni që nuk ka ndikim në organizatat biznesore ose të shoqërisë civile.

### 3.1.5 Krahasimi ndërkombëtar: Pasqyrë Përmbledhëse

Tabela më poshtë jep një pasqyrë të zgjedhjeve të zbatimit të bëra për programe të ndryshme që synojnë zvogëlimin e barrës administrative.

Figura 46 - Pasqyrim i zgjedhjeve të zbatimit për programet e zvogëlimit të barrës administrative

Aspekti i zvogëlimit të barrës	Bashkimi Evropian	Holanda	Gjermania	Mbretëria e Bashkuar
Organi koordinues	Sekretariati i Përgjithshëm (politika për zvogëlim të barrës administrative është iniciuar nga <i>DG Enterprise</i> )	Grupi për Reforma Rregullatore në	Njësia për Rregullim më të Mirë në Kancelarinë Federale	Ekzekutivi për Rregullim më të Mirë në kuadër të departamentit për Biznes, Energji dhe Industri

<sup>180</sup> Emri i këtij Departamenti në vitin 2007 ishte Departamenti i Biznesit, Ndërmarrjeve dhe Reformës Rregullatore (BERR).

<sup>181</sup> <https://www.independent.co.uk/news/business/news/blair-pledges-to-slash-red-tape-by-quarter-by-2010-428151.html>, uebfaqja është vizituar për herë të fundit më 30 prill 2018.

<sup>182</sup> <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2006/51/contents>, uebfaqja është vizituar për herë të fundit më 30 prill 2018.

<sup>183</sup> 'Koalicioni: programi ynë për qeverinë', Zyra e Kabinetit, 2010.

<sup>184</sup> <https://www.gov.uk/government/collections/one-in-two-out-statement-of-new-regulation>, uebfaqja është vizituar për herë të fundit më 30 prill 2018.

<sup>185</sup> <https://www.gov.uk/government/news/government-going-further-to-cut-red-tape-by-10-billion>, uebfaqja është vizituar për herë të fundit më 30 prill 2018.

		kuadër të Ministrisë së Financave <sup>186</sup>		(fillimisht në Zyrën e Kryeministrit)
Caku i zvogëlimit	25%	25% (caktim i caqeve të shumta)	25%	25%
Arritja e zvogëlimit	Po	Po	Po	Po
Korniza kohore	2007 - 2012	2000 - 2017	2007 - 2011	2005 - 2010
Fushëveprimi i matjes	72 akte ligjore	I tërë legjislacioni	I tërë legjislacioni	I tërë legjislacioni
Matja bazë e ekzekutimit të MKS-së	Kontraktues i jashtëm	Kontraktues i jashtëm	Zyra Federale për Statistika ( <i>Destatis</i> )	Kontraktues i jashtëm
Përgjegjës për propozimet për zvogëlim	Drejtoritë e Përgjithshme të Politikave	Ministritë e linjës	Ministritë e linjës	Ministritë e linjës
Mbikëqyrja e jashtme	Grupi i Nivelit të Lartë për Barrët Administrative	Actal	Normenkontrollrat	Paneli i Jashtëm për Validim

### 3.1.6 Krahasimi ndërkombëtar: mësimet kryesore

Analiza më lartë paraqet aspektet kryesore të programeve të politikave që synojnë zvogëlimin e barrës administrative dhe, në faza të mëvonshme, edhe kostot e përputhshmërisë. Mësimet kryesore të nxjerra nga programe të ndryshme të zvogëlimit janë si vijon:

1. Përkushtimi politik afatgjatë çon në përmirësime të konsiderueshme në cilësinë e legjislacionit, në efikasitetin e zbatimit dhe në cilësinë e ofrimit të shërbimeve,
2. Zvogëlime të konsiderueshme të barrës administrative mund të arrihen në çdo shtet dhe caku i zvogëlimit prej 25% është dëshmuar të jetë i arritshëm në çdo shtet që ka filluar aplikimin e politikës,
3. Fokusimi i vazhdueshëm në zvogëlimin e barrës administrative dhe përmirësimi i zbatimit të legjislacionit mund të çojë në zvogëlime të barrës administrative që tejkalojnë cakun prej 25%,
4. Programet për zvogëlim të barrës administrative duhet të përgatiten mirë dhe të integrohen fuqishëm në proceset e punës të administratës,
5. Matja bazë siguroi një shtysë të rëndësishme politike për barrët administrative pasi që tregoi koston ekonomike të këtyre barrëve të shprehura si përqindje e BPV-së,
6. Qendra e Qeverisë duhet të koordinojë dhe të tregojë udhëheqje në menaxhimin e programeve për zvogëlim të barrës administrative,
7. Ministritë e linjës duhet të zbatojnë një politikë të zvogëlimit të barrës administrative pasi që ato duhet të shqyrtojnë legjislacionin në kuadër të fushës së tyre, të përgatisin propozime për të ndryshuar legjislacionin dhe duhet të sigurojnë zbatimin e dispozitave ligjore të përmirësuara,

<sup>186</sup> Siç tregon analiza e paraqitur më lartë për Holandën, përgjegjësia për programin e zvogëlimit të barrës administrative është kaluar tek Ministria për Çështje Ekonomike pasi që politika për zvogëlim të barrës është integruar në mënyrë efektive në proceset e punës të administratës holandeze.

8. Qeveritë që ndryshojnë rregullisht mund të vazhdojnë synimin për zvogëlim të barrës administrative dhe të sigurojnë zbatim të vazhdueshëm të programit për zvogëlim të barrës administrative,
9. Përqendrimi në zvogëlimin e barrës administrative për biznese mund të zgjerohet për të përfshirë edhe qytetarët, profesionistët specifik që punojnë në administratë dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet niveleve të ndryshme të administratës,
10. Mbikëqyrja e pavarur siguron kontribut të rëndësishëm në arritjen e zvogëlimin të barrëve administrative, duke siguruar cilësi në zbatimin e programit dhe duke forcuar lidhjet mes administratës dhe shoqërisë (p.sh. duke përfshirë përfaqësues të bizneseve, OJQ etj.).

### 3.2 Parakushtet për një program të suksesshëm të zvogëlimin të barrës administrative

Hulumtimi mbi praktikën ndërkombëtare lidhur me programet e zvogëlimin të barrëve administrative tregon se një sërë parakushtesh duhet të përmbushen nëse pritet që këto programe të zbatohen me sukses. Këto parakushte vlejné për çdo opion të paraqitur më poshtë, me përjashtim të 'Opsionit 1: Opsioni pa ndryshime'.

Supozimi për analizën në këtë koncept dokument është që të gjitha parakushtet janë njësoj të rëndësishme dhe kërkuese për çdo opion të paraqitur që ndryshon status quo-në. Natyrisht, mund të argumentohet se opsioni më kërkues, Opsioni 2, i cili po merret parasysh, do të kërkonte më shumë burime në vit në krahasim me Opsionin 3. Megjithatë, kërkesat për Opsionin 3 do të ishin më të ulëta në vit, por do të zbatoheshin për një periudhë më të gjatë kohore. Bazuar në këtë, kërkesa e përgjithshme e secilit opion në aspektin e menaxhimit, burimeve, buxhetit etj. supozohet të jetë e njëjtë. Kjo konsiderohet në proporcion me nivelin e kërkuar të analizës dhe vë në fokus realizueshmërinë e zbatimit të suksesshëm të një programi për zvogëlimin e barrës administrative. Ky konsiderohet të jetë aspekti më i rëndësishëm për krahasimin e opsioneve.

Parakushtet e paraqitura nuk janë përpunuar në detaje për secilin opion pasi kjo nuk pritet t'i ofrojë analizës vlerë të mjaftueshme shtesë. Ndryshimet e vogla në të cilat këto parakushte duhet të trajtohen në opsione nuk ofrojnë material të mjaftueshëm për të zgjedhur ndërmjet opsioneve. Në vend të kësaj, parakushtet dhe mënyra se si trajtohen janë paraqitur në kapitullin 7 vetëm për opsionin e preferuar dhe të integruar në planin e zbatimit për këtë koncept dokument.

Figura 47 - Përmbledhje e parakushteve për zbatimin e suksesshëm të një programi për zvogëlimin e barrëve administrative

Parakushti për zbatimin e suksesshëm të një programi për zvogëlimin e barrës administrative	Shpjegimi
1. Integrimi i plotë i zvogëlimin të barrës administrative në procesin e zhvillimit të politikave dhe të hartimit të ligjeve	Për t'a zvogëluar sistematikisht barrën administrative, çdo politikë dhe të gjitha masat e politikave (duke përfshirë ligjet dhe aktet nënligjore) duhet të synojnë zvogëlimin ose të paktën minimizimin e barrës administrative. Kjo do të thotë që proceset për hartimin e koncept dokumenteve, strategjive, ligjeve dhe akteve nënligjore duhet të përshtaten. Zvogëlimi i barrës administrative duhet të integrohet plotësisht në këto procese. Kjo nënkupton gjithashtu përfshirjen e zvogëlimin të barrës administrative si një aspekt kyç për projektet e Asistencës Teknike që zbatohen në bashkëpunim me partnerët zhvillimorë dhe që përqendrohen në zhvillimin e politikave dhe të ligj bërjes. Për ta zbatuar këtë proces në mënyrë efektive, organi koordinues përgjegjës për programin e zvogëlimin të barrës administrative duhet të përfshihet në koordinimin që zhvillohet me komunitetin e donatorëve për të siguruar që dizajni i projektit të jetë i harmonizuar për të mbështetur programin e zvogëlimin të barrës.

<p>2. Objektivi i zvogëlimit që synon të gjithë ose të paktën legjislacionin më të rëndësishëm që prek bizneset</p>	<p>Objektivi i zvogëlimit të barrës administrative duhet t'i mbulojë të gjitha informatat e rëndësishme të obligueshme që vlejnë për bizneset. Përvoja nga shtetet anëtare të BE-së tregon se trajtimi i të gjithë legjislacionit ishte mënyra e preferuar për të siguruar zvogëlim efektiv të barrës administrative. Duke pasur parasysh sfidat e zbatimit të programit për zvogëlimin e barrës administrative, objektivi konkret duhet të përcaktohet nëpërmjet një vendimi të Qeverisë të marrë në vitin 2 me një përshtatje potenciale që do të planifikohet në vitin 5. Këto dy aktivitete integrohen në Planet e Zbatimit të opsioneve me përjashtim të opsionit 'pa ndryshime'.</p>
<p>3. Përcaktimi i bazës/gjendjes fillestare përmes matjes</p>	<p>Qasja standarde e shteteve që zbatuan programin për zvogëlim të barrës ka qenë që së pari të krijonin një matje bazë përmes së cilës u identifikuan të gjitha informatat e obligueshme dhe u përcaktuan barrët administrative. Kjo matje siguroi bazën e të dhënave kundër së cilës mund të vlerësoheshin masat e zvogëlimit dhe të jepnin bazën për përcaktimin e përfitimeve ekonomike që do të sillte një objektiv zvogëlimi për barrën administrative. Matja e barrës administrative rrit ndërgjegjësimin brenda administratës lidhur me shtrirjen dhe fushëveprimin e këtyre barrëve dhe mbështet një ndryshim pozitiv të kulturës në të cilën hartimi i politikave dhe i ligjeve është i ndjeshëm ndaj efekteve që priten të ndodhin në shoqëri.</p> <p>Matja bazë gjithashtu do të sigurojë një përmirësim të drejtpërdrejtë për zhvillimin e politikave meqenëse barra administrative është e dhëna thelbësore për krahasimin e opsioneve të bazuara në Analizën e kosto-përfitimit dhe Analizën e kosto-efektivitetit.</p> <p>Për të vlerësuar në mënyrë efektive trendin e zvogëlimit të barrës administrative, vlerat e vendosura në matjet bazë lidhur me numrin e kompanive të prekura nuk do të përditësohen gjatë zbatimit të objektivit të zvogëlimit të barrës administrative. Numri i subjekteve duhet të mbahet në të njëjtin nivel krahasuar me vitin bazë për të siguruar krahasimin e duhur. Përmbushja e objektivit duhet të jetë e pavarur nga zhvillimet ekonomike që çojnë në një zvogëlim të rritjes së numrit të subjekteve të rregulluara.</p>
<p>4. Angazhimi politik afatgjatë</p>	<p>Zvogëlimi i barrës administrative është një proces afatgjatë. Ka të bëjë me ndryshimin e kornizës ligjore dhe përmirësimin e hartimit të politikave dhe të ligjeve të reja. Projektet individuale për zvogëlimin e barrës administrative mund të zgjasin disa vite, veçanërisht kur përfshijnë ndryshime komplekse ligjore dhe zhvillimin e zgjidhjeve softuerike. Për t'i zvogëluar me sukses barrët administrative, kjo politikë duhet të bartet si prioritet nga një qeveri në tjetrën. Prandaj, si e tillë duhet të integrohet plotësisht në kornizën e prioriteteve politike të Qeverisë dhe të Kuvendit. Në praktikë, kjo do të thotë se qëllimi për të zvogëluar barrën administrative është vazhdimisht referencë në çdo program të Qeverisë pavarësisht nga shpeshtësia e zgjedhjeve. Objektivi i zvogëlimit të barrës administrative mund të përcaktohet përmes një vendimi të Qeverisë në koordinim me Zëvendës Kryeministrin dhe Zëvendës Ministrat në ministritë përgjegjëse për koordinimin politik të programit të zvogëlimit.</p>
<p>5. Baza e fortë ligjore</p>	<p>Përvojat e vendeve të tjera tregojnë se baza për zvogëlimin e barrëve administrative është ose politike (në Holandë dhe në BE) ose një kombinim i mbështetjes së fortë politike e mbështetur në bazën ligjore për zbatimin e zvogëlimit të barrës administrative (në Danimarkë dhe në Mbretërinë e Bashkuar). Për Kosovën, shembulli nga Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar konsiderohet të jetë shembulli më i mirë,</p>

	meqë qasja ligjore pritet të përshtatet më mirë me kulturën administrative në Kosovë dhe është gjithashtu një manifestim i angazhimit politik afatgjatë.
6. Planifikimi realist dhe monitorimi për së afërmi që nga hartimi i ndryshimeve ligjore e deri tek zbatimi i tyre	Çdo program për zvogëlimin e barrës administrative çon në një rritje të konsiderueshme të aktiviteteve brenda administratës. Ligjet dhe aktet nënligjore duhet të rregullohen dhe pastaj të zbatohen. Kjo do të thotë që e gjithë administrata, në një moment të caktuar, është e mundur të përfshihet në zvogëlimin e barrës administrative. Politika ka të bëjë me ofrimin e përfitimeve të prekshme ekonomike përmes legjislacionit më efikas. Kjo e fundit varet po aq shumë nga cilësia e legjislacionit dhe nga kushtet e përcaktuara në detyrimet ligjore si p.sh. në zbatimin real të këtyre detyrimeve përmes formularëve, zgjidhjeve softuerike etj.
7. Shpërndarja, rekrutimi dhe trajnimi i stafit brenda QQ-së dhe ministrive të linjës në fillim të programit	Menaxhimi i zvogëlimit të barrës administrative është proces që kërkon shumë burime. Institucionet e QQ-së, veçanërisht ZKM-ja dhe MFT-ja, duhet të jenë në gjendje të menaxhojnë rrjedhën e punës dhe të sigurojnë që masat e zvogëlimit mund të zbatohen. Përveç kësaj, ministrinë e linjës dhe organet e tjera administrative do të duhet t'i përshtaten një rritjeje të aktiviteteve, nga analiza e politikave, në hartimin e ligjeve, e pastaj tek zbatimi. Personeli shtesë i kërkuar duhet të transferohet ose të rekrutohet rishtazi. Stafi duhet të trajnohet dhe të mbështetet në mënyrë që të zbatojë në mënyrë efektive politikën e zvogëlimit të barrës administrative.
8. Kërkohej kontrolli i pavaruri cilësisë	Kontrolli i pavarur i cilësisë siguron verifikim neutral të arritjeve në aspektin e zvogëlimit. Përfshirja e bizneseve në hartimin dhe zbatimin e politikës për zvogëlimin e barrës administrative gjithashtu siguron një shtysë për reformat duke ofruar sugjerime për zvogëlimin e barrës administrative.
9. Programi i trajnimit për zvogëlimin e barrës administrative lidhur me aranzhimet e reja të punës, MKS-në dhe proceset e raportimit gjatë zbatimit të programit	Meqenëse zvogëlimi i barrës administrative është politikë afatgjate, atëherë lind nevoja që të sigurohet informimi i personave të përfshirë në politikë. Stafi do të ndryshojë gjatë një periudhe të zgjatur, që nënkupton se anëtarët e rinj të stafit duhet të trajnohen dhe të përgatiten për detyrat e tyre lidhur me zvogëlimin e barrës administrative. Meqenëse zvogëlimi i barrës administrative prek aspektin e zbatimit të detyrimeve ligjore në mënyrë më efikase, rezultati është që të gjithë ata që janë të përfshirë në zinxhirin e zbatimit të këtyre detyrimeve në një moment të caktuar duhet të përfshihen në trajnime, prezantime dhe të ngjashme.
10. Konsultimi si pjesë përbërëse e programit të zvogëlimit	Konsultimi me biznesin dhe akterët tjerë është proces jetik për të arritur zvogëlimin e barrëve administrative. Bizneset mund të japin të dhëna se cilat lloj ndryshimesh do t'i mirëprisnin dhe si do t'i thjeshtësonin proceset e punës për ta. Ajo që është më e rëndësishme, për t'i kryer matjet bazuar në MKS, parakusht është përfshirja e drejtpërdrejtë nga bizneset dhe qytetarët. Përmes konsultimeve të synuara dhe, duke ndjekur shembujt e shumë vendeve të BE-së <sup>187</sup> , faqet e internetit që kanë për qëllim marrjen e sugjerimeve për zvogëlimin e barrës administrative, përfituesit e programit të zvogëlimit mund të japin sugjerime të dobishme për përmirësimin e efikasitetit të zbatimit të legjislacionit.
11. Komunikimi duhet të jetë pjesë përbërëse që nga fillimi	Zvogëlimi i barrëve administrative çon në shumë ndryshime. Këto ndikojnë në biznesin pasi synimi është që të lehtësohet përputhshmëria me legjislacionin. Ato gjithashtu ndikojnë në stafin brenda administratës pasi zyrtarët duhet të vlerësojnë mundësitë për zvogëlimin e barrës, të përgatisin bazën ligjore dhe të zbatojnë kornizën e përmirësuar ligjore. Synimet e përgjithshme të politikës duhet të bëhen të

<sup>187</sup> Luksemburgu: [www.vosidees.lu](http://www.vosidees.lu); BE: [https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say\\_en](https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say_en) (, faqet e internetit për herë të fundit u vizituan më 18 tetor 2018)



	<p>qarta dhe të komunikohen vazhdimisht pasi ato ofrojnë bazën strategjike për politikën. Përveç kësaj, efektet e pritshme nga masat individuale duhet të komunikohen brenda administratave dhe me përfituesit e veçantë të procedurave dhe detyrimeve të thjeshtësuara. Ndryshimet do të çojnë në nevojën për të kuptuar kornizën e përmirësuar, dhe një qasje proaktive e komunikimit që mbështet zvogëlimin e barrëve administrative do t'ua lehtësojë të gjithë atyre që janë të përfshirë që t'i shohin përfitimet dhe ta kuptojnë kornizën e përmirësuar. Megjithatë, për të siguruar një program të suksesshëm për inpute të hollësishme dhe sugjerime të dobishme nga akterët, Qeveria duhet të investojë në shtrirje dhe komunikim aktiv, p.sh. përmes kampanjave dhe takimeve me komunitetin. Për më tepër, ajo duhet të garantojë që parashtresat trajtohen në mënyrë efektive dhe që të anketuarve t'u ofrohet shpejt qartësi nëse dhe si do të trajtohen më tutje idetë e tyre.</p>
12. Përdorimi i sondazheve të perceptimit	<p>Sondazhet e perceptimit që synojnë qytetarët dhe kompanitë dhe që përmbajnë pyetje në lidhje me barrët më të rënda dhe më të bezdisshme administrative japin informacion të dobishëm mbi politikat sa i përket masave që duhet të konsiderohen si prioritet për zvogëlimin e barrës administrative. Mbretëria e Bashkuar dhe Holanda, për shembull, kanë zbatuar sondazhe të tilla dhe i përdorin për të rregulluar dhe përmirësuar ofrimin e shërbimeve<sup>188</sup>.</p>
13. Monitorimi i rezultateve të programit për zvogëlimin e barrës administrative	<p>Vendosja e një objektivi për zvogëlimin e barrës administrative është zotim i madh i çdo Qeverie. Përfitimet ekonomike janë të dukshme. Megjithatë, me qëllim që të sigurohen përfitimet, programi duhet të menaxhohet dhe monitorohet veçanërisht për të parë nëse përparon në drejtimin e synuar dhe në shpejtësinë e pritshme (afatet kohore) si është përcaktuar nga politika.</p>
14. Bashkëpunimi mes Qeverisë dhe Kuvendit	<p>Ndryshime ligjore do të nevojiten për t'i zvogëluar barrët administrative. Qeveria do t'i përgatisë këto propozime dhe është në mandatin e Kuvendit t'i miratojë ato. Kur ndryshimet janë politikisht jo kontraverse, procesi i miratimit duhet të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur, megjithatë duke lejuar një kontroll dhe mbikëqyrje efektive parlamentare. Qeveria dhe Kuvendi duhet të bien dakord mbi mënyrën më të mirë të bashkëpunimit për zvogëlimin e barrës administrative në mënyrë që të sigurohet që përfitimet e zvogëlimin të arrihen sa më shpejt të jetë e mundur. Në fund të fundit, pas miratimit të ligjeve, edhe më tutje nevojitet zbatimi i vërtetë i kornizës së përmirësuar ligjore në mënyrë që dispozitat ligjore të shndërrohen në procedura dhe kërkesa të thjeshtësuara për bizneset dhe qytetarët.</p>
15. Vlerësimi i programit për zvogëlimin e barrëve administrative	<p>Programi që synon zvogëlimin e barrës administrative duhet të vlerësohet në mënyrë të pavarur për të verifikuar përparimin e arritur dhe për të siguruar arritjen e qëllimeve të programit. Vlerësimet e tilla mund të kryhen nga kompanitë individuale ose nga një Auditor Kombëtar. Dispozitat për këtë duhet të planifikohen që nga fillimi.</p>
16. Sigurimi i fondeve të mjaftueshme për plotësimin e kërkesave të stafit shtesë për zbatimin e programit të zvogëlimin të barrës	<p>Për ta zbatuar në mënyrë sistematike zvogëlimin e barrës administrative dhe për të shqyrtuar të gjithë legjislacionin, institucionet e QQ-së dhe ministritë e linjës duhet t'i kenë në dispozicion burimet e nevojshme (njerëzore). Burimet shtesë që nevojiten për t'i bërë ballë ngarkesës së shtuar të punës që rezultojnë nga rritja e numrit të ndryshimeve legjislative dhe zbatimi i tyre duhet të integrohen në mënyrë strukturore dhe të mbështeten nga stafi i kualifikuar në numër të mjaftueshëm.</p>

<sup>188</sup> <https://www.gov.uk/government/publications/business-regulation-business-perceptions-survey-2018> & <https://www.vngrealisatie.nl/producten/ondernemerspeiling> (, faqet e internetit për herë të fundit u vizituan më 10 tetor 2018)



<p>17. Sigurimi i fondeve të mjaftueshme për zbatimin e masave për zvogëlimin e barrëve administrative</p>	<p>Duhet të zbatohen masa individuale për të zvogëluar barrën administrative. Shpesh do të nevojitet buxhet për ta bërë këtë. Derisa mund të ketë nevojë për kërkesa strukturore të buxhetit, p.sh. në lidhje me zgjidhjet softuerike të qeverisjes elektronike, do të krijohen edhe kosto të njëhershme (<i>one-off</i>) si p.sh. për ridizajnimin e formularëve dhe të materialit informativ. Në mënyrë që të zbatohen masat e zvogëlimit në mënyrë më efektive, duhet të krijohet një fond i veçantë në kryeministri i dedikuar për arritjen e synimit për zvogëlimin e barrës administrative, fond nga i cili do të mund të mbuloheshin masat individuale të njëhershme ose rritjet e përkohshme në shpenzime, ose përmes së cilit do të mund të ofrohej financim i ndërmjetëm (bridge financing) para se masat të financohen nga Buxheti Vjetor i Kosovës. Në mënyrë potenciale, partnerëve zhvillimorë mund t'u kërkohej që të kontribuojnë në këtë fond.</p>
<p>18. Harmonizimi i kornizës së politikave strategjike me prioritetin kryesor të politikave për t'i zvogëluar sistematikisht barrët administrative</p>	<p>Zvogëlimi i barrëve administrative do të ishte një prioritet i përgjithshëm i qeverisë. Do të duhej të integrohej në të gjithë kornizën e politikave strategjike dhe rrjedhimisht në të gjitha dokumentet strategjike. Për ta arritur këtë, të gjitha strategjitë sektoriale (të paktën ato që kanë një dimension të zhvillimit ekonomik) duhet të përditësohen dhe të harmonizohen me qëllim të zvogëlimit të barrëve administrative.</p>
<p>19. Përfundimi i transpozimit të ardhshëm dhe zbatimit të Acquis-it të BE-së nga objektivi i zvogëlimit të barrëve administrative</p>	<p>Zbatimi i Acquis-it të BE-së do të kontribuojë në zhvillimin dhe zgjerimin e kornizës ligjore në Kosovë. Gjithashtu, mund të pritet që numri i Informatave të Obligueshme të rritet pasi ato pasqyrohen në legjislacionin e BE-së dhe Kosova do të detyrohet t'i zbatojë. Barrët administrative që rrjedhin nga procesi i harmonizimit me BE-në dhe rruga e integritit evropian të Kosovës duhet të përjashtohen nga objektivi i zvogëlimit. Në të njëjtën kohë, barrët administrative që rrjedhin nga Acquis-i i BE-së duhet të mbahen sa më të ulëta që është e mundur, për shembull duke kufizuar transpozimin vetëm në kërkesat ligjore (duke mos marrë parasysh elementet që nuk janë të detyrueshme, të paraqitura në direktivat e BE-së), duke zgjedhur kohën e zbatimit të Acquis-it të BE-së duke pasur parasysh barrët e shkaktuara për qytetarët, kompanitë dhe administratën dhe duke siguruar zgjidhje softuerike, si pjesë e procesit të zbatimit të Acquis-it të BE-së.</p>

### 3.2.1 Zvogëlimi i Barrës Administrative në kuadër të kornizës së legjislacionit ekzistues primar

Zvogëlimi i barrëve administrative është një proces afatgjatë. Analiza e përvojave të programeve të ndryshme të tilla ka treguar që menaxhimi dhe organizimi efektiv janë thelbësore për të prodhuar rezultate në dobi të qytetarëve dhe kompanive.

Treguesi 5 i Kontratës së BE-së për Mbështetje Buxhetore Sektoriale (SBS) në kuadër të Marrëveshjes financiare me Baskimin Evropian për IPA 2016, pjesa e dytë, përcakton rolin e zyreve në vazhdim në kuadër të procesit të zvogëlimit të barrës administrative:

➤ Sekretariati Koordinues i Qeverisë (SKQ): Sipas Strategjisë për Rregullim më të Mirë, SKQ udhëheq procesin e integritit të Modelit të Kostimit Standard i cili është thelbësor për matjen e ngarkesave administrative dhe për të dëshmuar se ngarkesat janë ulur në mënyrë efektive. Për të arritur zvogëlim të theksueshëm të barrës administrative përmes thjeshtimit të lejeve dhe licencave, SKQ do të duhet të përmbushë këto detyra shtesë: 1) futjen e Modelit Standard të Kostos në sistemin e zhvillimit të politikave; kjo do të bëjë të mundur që ndryshimet e ardhshme të ngarkesave administrative të maten siç duhet; 2) të vendoset vetë si Qendër e Ekspertizës për matjen dhe zvogëlimin e ngarkesave administrative; 3) të trajnojnë stafin e ministrive

të linjës për aplikimin e MKS-së; 4) të sigurojë zhvillimin e propozimeve administrative për uljen e barrës për leje dhe licenca; 5) të integrojnë këto propozime dhe monitorojnë përparimin e tyre përmes Planit Vjetor të Punës të Qeverisë; 6) të sigurojnë miratimin e masave që zvogëlojnë ngarkesat duke thjeshtuar lejet dhe licencat; 7) të raportojnë për të gjitha masat që janë marrë për të zvogëluar ngarkesat duke thjeshtuar lejet dhe licencat; 8) të sigurojnë që ministritë e linjës të integrojnë uljen e barrës administrative përtej fushës së lejeve dhe licencave.

➤ Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS): nga pikëpamja strategjike e politikave, përmbajtja e dokumenteve të politikave duhet të harmonizohet me qëllimin për të zvogëluar ngarkesat duke thjeshtuar lejet dhe licencat. ZPS do të duhet të përmbushë këto detyra shtesë: 1) të sigurojë që përmbajtja e strategjive të zhvilluara rishtazi është në përputhje me qëllimin për të zvogëluar ngarkesat duke thjeshtuar lejet dhe licencat; 2) të rishikojë përmbajtjen e politikave të dokumenteve strategjike ekzistuese në mënyrë që të përafrohen këto me kërkesën për të zvogëluar ngarkesat duke thjeshtuar lejet dhe licencat; 3) të integrojnë uljen e barrës administrative në kornizën strategjike të prioritetëve qeveritare, siç përcaktohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe dokumentet e tjera strategjike; 4) të sigurojë që ulja e barrës administrative duke thjeshtuar lejet dhe licencat është integruar në kornizën e politikave strategjike të ministrive.

➤ Zyra Ligjore (ZL): me qëllim që të zvogëlohen ngarkesat duke thjeshtuar lejet dhe licencat dhe lejet, rregullat aktuale duhet ndryshuar. Kërkesat për leje dhe licenca përcaktohen në ligje dhe akte nënligjore. Këto duhet të rregullohen përmes procesit legjislativ. ZL do të duhet të përmbushë këto detyra shtesë: 1) të mbështesë ministritë në zhvillimin e propozimeve për leje dhe licenca të bazuara në analiza; 2) të sigurojë kontrollin e cilësisë për propozimet që çojnë në zvogëlimin e ngarkesës administrative duke thjeshtuar lejet dhe licencat; 3) të mbështesin analizën ligjore për të identifikuar lejet dhe licencat që mund të thjeshtohen; 4) të koordinojë aktivitetet legjislative për thjeshtimin e lejeve dhe licencave përmes Programit Legjislativ, 5) të sigurojë integrimin e uljes së barrës administrative në procesin e vlerësimit të legjislacionit.

Institucionet për zhvillimin e një programi për zvogëlimin e barrëve administrative për Kosovën pritet të jenë të nevojshme për të siguruar qartësinë e kërkuar dhe angazhimin afatgjatë për të zvogëluar barrën administrative.

Fillimisht, ishte konsideruar hartimin e një Ligji për Zvogëlimin e Barrëve Administrative do që do të ndjekë – në një masë të madhe – qasjen gjermane. Një ligj i tillë do të përcaktonte kërkesa të qarta të raportimit, strukturave të menaxhimit dhe objektivave për zvogëlimin e barrës administrative. Për më tepër, një ligj i tillë do të mund të rregullonte kontributin e institucioneve të pavarura dhe komunave në programin e zvogëlimit të barrës administrative. Mbi këtë bazë u realizua edhe vizita studimore në Gjermani pasi që ky vend e ka të rregulluar procesin e zvogëlimit të barrës administrative përmes kornizës ligjore (shih shtojcën 11: Raprti i Vizitës Studimore në Gjermani).

Megjithatë, në fund u vendos që krijimi i procesit për zvogëlimin e barrës administrative përmes ligjit si bazë ligjore, në këtë fazë ishte i parakohshëm duke pasur parasysh gamën e gjerë të reformave që janë iniciuar dhe nivelin e ulët në përgjithësi të zbatimit të këtyre reformave për shkak të mungesës së kapaciteteve. Aktualisht, zvogëlimi i barrës administrative pritet të bëhet në kuadër të dispozitave ekzistuese të akteve ligjore primare dhe do të mbështetet me vendime të veçanta të Qeverisë për hapat kryesorë në proces.

Përfshirja e komunave dhe institucioneve të pavarura do të bëhet përmes stimujve pozitivë, zhvillimit të kapaciteteve dhe analizave para zbatimit të masave.

Në përputhje me sugjerimet e Zyrës Ligjore të ZKM-së, Rregullorja e Punës së Qeverisë do të ndryshohet në mënyrë që të vendoset korniza rregullatore për programin e zvogëlimit të barrës administrative.

Roli i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë në koordinimin e politikës së zvogëlimit të barrës administrative, zhvillimin e kapaciteteve për administratën dhe institucionet e përfshira, vendosjen dhe menaxhimin e matjes bazë, zhvillimin e mëtutjeshëm të materialeve udhëzuese për matjet në bazë të Modelit të Kostimit Standard

(përfshirë përcaktimin e vlerës monetare të ngarkesave administrative për qytetarët me qëllim krahasimin e tyre me masat për zvogëlimin e barrës për kompanitë dhe administratën), zhvillimin e kapaciteteve që lidhen me aplikimin e Modelit të Kostimit Standard dhe aspektet e tjera që lidhen me menaxhimin e programit të zvogëlimit të ngarkesës administrative do të përcaktohen në Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe dokumentet udhëzuese që duhet të hartohen ose azhurnohen.

Andaj, Rregullorja e Punës së Qeverisë do të përcaktojë obligimin për të zbatuar Modelin e Kostimit Standard gjatë zhvillimit dhe hartimit të politikave që kanë nddikim në kompani, qytetarë dhe administratë; vendos detyrimin për të matur barrën administrative të të gjitha akteve ligjore para miratimit të tyre nga Qeveria dhe për të matur ato të akteve ligjore të miratuara në situata emergjente brenda katër muajve nga miratimi; dhe verifikimin e masave të zvogëlimit të barrës me vlerë mbi 500.000 euro tre vjet pas miratimit të masës përkatëse. Nëse pranë këtyre kërkesave, aspekte shtesë në nivelin e kërkesave ligjore duhet të rregullohen, ZKM do të hartojë propozime dhe arsytetime për vendimmarrje të mëtejshme.

### 3.2.2 Futja e Zvogëlimit të Barrës Administrative në kornizën e politikave strategjike

Strategjia për Rregullim më të Mirë<sup>189</sup> do të duhet të përditësohet. Kjo do të sigurojë që programi i zvogëlimit të barrës administrative të përcaktohet zyrtarisht si prioritet kyç i politikave strategjike të vendit.

Strategjia do të duhet t'i përkthejë veprimet e kërkuara të përcaktuara në këtë Koncept Dokument në hapat praktikë dhe një Plan Veprimi shumëvjeçar që do të tregojë se si do të zbatohet programi për t'i zvogëluar barrët administrative.

Plani i Zbatimit i paraqitur më poshtë në këtë KD përcakton aktivitetet që duhet të kryhen dhe për këtë arsye strategjia do të duhet t'i integrojë këto si dhe t'i detajojë tutje. Për më tepër, periudha kohore e strategjisë duhet të përfshijë përfundimin e programit të zvogëlimit të barrëve dhe kështu të mbulojë edhe vitin pas të cilit synohet të arrihet synimi i zvogëlimit dhe në të cilin duhet të bëhet vlerësimi përfundimtar.

Për më tepër, strategjia duhet të përcaktojë procesin e konsultimit dhe komunikimit, caqe të qarta për trajnimin e nëpunësve civilë, organizimin e punëtorive dhe çështje të tjera të cilat mund të parashikohen vetëm në përgjithësi në këtë fazë dhe të cilat do të duhet të përcaktohen në baza të rregullta gjatë zbatimit të programit të zvogëlimit të barrës administrative

Përditësimi i strategjisë do të shërbejë gjithashtu si moment i rëndësishëm sa i përket komunikimit, si nga brenda ashtu edhe me palët e jashtme në lidhje me pritshmëritë për zbatimin e programit të zvogëlimit. Zhvillimi i strategjisë do të krijojë gjithashtu mundësi për diskutime me partnerët zhvillimorë në lidhje me kontributet e mundshme në program dhe integrimin e zotimeve të tyre në parashikimet financiare për zbatimin e strategjisë.

Figura 48 - Aktivitetet që duhen ndërmarrë në kuadër të programit të zvogëlimit të barrës administrative

- Organizimi i ngjarjeve të informimit dhe orientimit strategjik për të gjitha partitë në Parlament
- Kryerja e matjeve bazë bazuar në parimin e transparencës së plotë dhe publikimi i të gjitha të dhënave online për të gjitha kërkesat për informacion.
- Inicimi i një procesi gjithëpërfshirës të zhvillimit të kapaciteteve për matjet përmes MKS në nivel qendror dhe lokal, përfshirë vendosjen e objektivave të qarta të trajnimit.
- Vlerësimi i efektivitetit të përpjekjeve të qeverisë për të zvogëluar barrën administrative për qytetarët e kompanive dhe administratën.
- Zhvillimi i Anketës së Ngjarjeve Jetësore, në përputhje me qasjen gjermane të paraqitur në [amtlich-einfach.de](http://amtlich-einfach.de)

<sup>189</sup> The Government is currently considering to merge the Strategy on Improving Policy Planning and Coordination and the Better Regulation Strategy. In case this decision is formalized, the administrative burden reduction programme must be reflected in the merged strategy.

- Zhvillimi i disa debateve dhe punëtorive për identifikimin e problemeve dhe pengesave, së bashku me akterët e prekur.
- Zhvillimi i monitoruesit legjislativ bazuar në Monitoruesin Gjerman të BE-së për NVM-të dhe detyrimet e ardhshme të dala nga procesi i Integritimit Evropian për të informuar bizneset dhe qytetarët në mënyrë më efektive sa i përket mundësive dhe detyrimeve të tyre në të ardhmen.
- Përpunimi i qasjes së Konsultimit dhe Komunikimit në mënyrë më të detajuar dhe përgatitja e qasjes të vazhdueshme për komunikimin e politikave, p.sh. prezantimi i arritjeve dhe promovimi i komenteve nga ana e palëve të interesit përmes publikimit të filmave të shkurtër dhe infografikëve në mediat sociale.
- Prioritizimi i fushave dhe shfrytëzimi i mundësive për përmirësimin aktiv të renditjes së Kosovës në vlerësime ndërkombëtare.
- Të sigurohet që programi i zvogëlimit të barrës administrative kontribuon në përmirësimin e pikëve të Kosovës në raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore dhe Parimet e Administratës Publike të SIGMA-s.

### 3.3 Sfidat e pritshme sa i përket menaxhimit

Sfidat e ndryshme të menaxhimit tashmë mund të identifikohen paraprakisht. Ato vihen në dukje këtu meqë përbëjnë rreziqe ekzistenciale, dhe nëse nuk trajtohen siç duhet, mund të çojnë në dështimin e programit për zvogëlimin e barrëve administrative ose mund të krijojnë vonesa të konsiderueshme. Ato rrjedhin veçanërisht nga parakushtet e domosdoshme për zvogëlimin efektiv të barrëve administrative, të paraqitura më sipër. Ato theksohen këtu duke pasur parasysh rëndësinë e tyre qendrore.

Është me rëndësi të theksohet se këto sfida duhet të trajtohen në mënyrë të efektshme nëse pritet të fillojë një proces i zvogëlimit të barrëve administrative. Kjo reflektohet edhe në Planin e Zbatimit pasi angazhimi në një objektiv të zvogëlimit të barrëve administrative duhet të mbështetet nga strukturat e duhura organizative dhe drejtuese siç tregohet në shembujt e vendeve që kanë zbatuar me sukses programe të tilla. Përveç kësaj, meqë Qeveria synon të angazhohet me partnerët zhvillimorë për mbështetjen e programit për zvogëlimin e barrëve administrative përmes mbështetjes teknike dhe buxhetore, një hapësirë kohore duhet të rezervohet edhe për diskutimet dhe negociatat që do t'i paraprijnë miratimit zyrtar të një mbështetjeje të tillë. Kjo do të thotë që një politikë për t'i zvogëluar në mënyrë efektive barrët administrative do të kërkojë kohë për t'u përgatitur për zbatimin e saj. Kjo natyrisht është në përputhje me nevojat që lindin kur një qeveri përcakton një politikë themelore të re dhe ka nevojë që t'i krijojë strukturat e nevojshme dhe që t'i ngritë kapacitetet e nevojshme për zbatimin e politikës në përputhje me objektivat e përcaktuar nëpërmjet saj.

Mënyra në të cilën do të adresohen këto sfida në praktikë do të duhet të paraqitet në Strategjinë e përditësuar për Rregullim më të Mirë, objektivat e saj dhe, veçanërisht, Planin e saj të Veprimit.

Sekretariati Koordinues i Qeverisë është organizata udhëheqëse e cila do të zbatojë politikën për zvogëlimin e barrëve administrative. Kësisoj, Qeveria ia ngarkon përgjegjësinë Drejtorit të SKQ-së sa i përket aprovimit të rregullimeve jomateriale, përcaktimit të fitimeve të bëra nga eficientia dhe zhvillimit të kursimeve në kosto përderisa këto ndryshime nuk e pengojnë zbatimin efektiv të KD-së dhe arritjen e objektivit të caktuar të zvogëlimit. Të gjitha rregullimet materiale të programit duhet miratuar nga ana e Qeverisë në kohën e miratimit të Ligjit për Barrët Administrative dhe/ose miratimit të Strategjisë për Rregullim më të Mirë.

#### 3.3.1 Rregullimi i organizatave të QQ-së dhe të ministrive të linjës në mënyrë strukturore dhe ngritja e kapaciteteve

Për të menaxhuar në mënyrë efektive zvogëlimin e barrëve administrative, institucionet e QQ-së dhe ministrinë e linjës duhet të përgatiten dhe të rregullohen në mënyrë organizative, pasi cilësia e zbatimit të përgjithshëm të programit për zvogëlimin e barrëve administrative do të varet nga mënyra në të cilën institucionet përgjegjëse

do të jenë në gjendje t'i zbatojnë detyrat e tyre. Brenda kornizës së institucioneve të QQ-së, ZKM-ja (ku shumica e rritjes së stafit i alokohet Sekretariatit Koordinues të Qeverisë) dhe MFT-ja (sidomos Departamenti për Buxhet brenda asaj ministrie) do të luajnë një rol jetik në menaxhimin e programit për zvogëlimin e barrëve administrative dhe respektivisht në sigurimin e buxhetit të mjaftueshëm. Kjo është sfidë në aspektin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe sfidë në aspektin praktik lidhur me rekrutimin e stafit dhe përgatitjen e hapësirës së zyrës pasi këto procese kërkojnë kohë.

Kjo sfidë ishte paraparë tashmë gjatë zhvillimit të Programit të Qeverisë 2017-2021. Aty Qeveria tregon nevojën për një riorganizim profesional të ZKM-së, që pritet të përfshijë aspekte që sigurojnë zhvillimin e politikave më miqësore për bizneset dhe qytetarët<sup>190</sup>.

### *Sigurimi i stafit të mjaftueshëm dhe strukturave të menaxhimit*

Në kuadër të ZKM-së, Sekretariati Koordinues i Qeverisë është organizata udhëheqëse për zbatimin e Strategjisë për Rregullim më të Mirë dhe për zhvillimin e këtij koncept dokumenti. Gjithashtu, ai është mandatuar nga Qeveria që t'i zbatojë të gjitha zgjedhjet e mëtejshme të politikave në lidhje me zvogëlimin e barrëve administrative. Prezantimi i një programi për zvogëlimin e barrëve administrative, i vendosur përballë një objektivit specifik, do të çojë në një rritje të konsiderueshme të nevojës për të planifikuar, monitoruar dhe mundësuar zvogëlimin e barrëve administrative.

Roli shtesë i SKQ-së por edhe i ZPS-së dhe ZL-së në lidhje me zbatimin e programit të zvogëlimit të barrës administrativ do të përcaktohet në Rregulloren e Punës së Qeverisë. Për këtë, gjatë rishikimit të Strategjisë për Rregullim më të Mirë do të vlerësohet nevoja për staf shtesë që do të duhej të rekrutohen në ZKM në afatin kohor 2021-2023. Niveli përgjegjës menaxherial do të vlerësojë organizimin më të mirë organizativ për koordinimin e uljes së barrës administrative brenda sekretariatit.

Si pjesë e vlerësimit të programit të zvogëlimit të barrës administrative, kërkesat e përgjithshme të personelit për zbatimin e programit do të verifikohen në një fazë të mëvonshme. Në këtë fazë, asnjë ndryshim tjetër nuk parashikohet përmes këtij Koncept-Dokumenti.

### *Sigurimi i stafit të mjaftueshëm dhe strukturave të menaxhimit në nivelin e ministrive të linjës*

Derisa institucionet e QQ-së do të menaxhonin programin e përgjithshëm për zvogëlimin e barrës administrative dhe do të mbështesnin analizën që lidhet me zvogëlimin e barrës administrative si dhe masat individuale, ministrinë e linjës do të duhet të zbatojnë programin në praktikë. Ato do të duhet të kryejnë analizën, t'i përgatisin ndryshimet në kornizën ligjore dhe të sigurojnë zbatimin e masave specifike për zvogëlimin e barrës administrative.

Është e pritshme që një pjesë e kërkesave që rrjedhin nga një program për zvogëlimin e barrës administrative të mbulohet nga burimet ekzistuese që ministrinë e linjës i kanë në dispozicion. Megjithatë, çdo ministri duhet të caktojë një zyrtar përgjegjës për koordinimin e procesit të zvogëlimit të barrës administrative që do t'i raportonte drejtpërdrejtë Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë. Në varësi të fushës së politikave të ministrisë, koordinatorët brenda ministrive që kanë një kornizë të konsiderueshme ligjore nën përgjegjësinë e tyre mund të kenë nevojë për mbështetje nga një divizion për zvogëlimin e barrëve administrative.

Për më tepër, ministrinë përgjegjëse për një kornizë të konsiderueshme ligjore mund të kenë nevojë të caktojë një Zëvendësministër që është veçanërisht përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve që lidhen me zvogëlimin e barrës administrative të asaj ministrie, duke përfshirë koordinimin politik dhe procesin e buxhetimit.

<sup>190</sup>Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, faqe 15.

Në këtë fazë, megjithatë, nuk parashikohen ndryshime thelbësore të stafit në ministritë e linjës. Kjo do të rishikohet në një fazë të mëvonshme kur do të vlerësohet efektiviteti i programit të zvogëlimit të barrës administrative.

### *Sigurimi i zhvillimit të kapaciteteve*

Çështja e plotësimit të stafit duhet të trajtohet për të qenë në gjendje të zbatohet në mënyrë efektive një program për zvogëlimin e barrës administrative. Megjithatë, numri i stafit nuk do të jetë i mjaftueshëm pasi anëtarëve të rinj të stafit (të rekrutuar rishtazi dhe/ose të transferuar nga pozitat ekzistuese) edhe ashtu do t'u nevojitet kohë për t'i krijuar proceset e punës dhe strukturat organizative për të zbatuar praktikisht programin e zvogëlimit. Prandaj, ndryshimet e stafit duhet të zbatohen gradualisht në përputhje me një plan të paracaktuar të rekrutimit. Fillimisht duhet të rekrutohet një grup i vogël i zyrtarëve të nivelit të lartë për t'i hapur rrugën rekrutimit të stafit të nivelit më të ulët në një fazë të mëvonshme.

Përveç kësaj, stafi në ministritë e linjës, në veçanti menaxhmenti i lartë dhe i mesëm si dhe koordinatorët për ZBA (Zvogëlimin e Barrës Administrative) do të duhej të informoheshin dhe trajnoheshin sa i përket zvogëlimit të barrës administrative. E njëjta gjë do vrente edhe për stafin në departamentet kyçe, siç janë Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Departamentet Ligjore, Zyrat e Komunikimit dhe Departamentet e Politikave që do të përfshihen shumë në zvogëlimin e barrës administrative. E njëjta vlen edhe për stafin në institucione të pavarura dhe komuna.

Për më tepër, stafi i ri ka shumë gjasa të ketë nevojë për trajnim, dhe kapacitetet e tyre personale duhet të zhvillohen më tej. Kjo duhet të trajtohet në një program trajnimi efektiv dhe mundësisht nëpërmjet shkëmbimeve me vendet që kanë zbatuar me sukses programe për zvogëlimin e barrës administrative dhe që ende janë duke punuar për zvogëlimin e barrës administrative. Kjo ka mundësi të trajtohet nëpërmjet mbështetjes nga partnerët zhvillimorë.

### *Themelimi i një organi të pavarur mbikëqyrës*

Mbikëqyrja e pavarur e programit për zvogëlimin e barrës administrative është aplikuar në të gjitha rastet që janë analizuar. Mbikëqyrja e tillë e pavarur planifikohet të vendoset edhe në Kosovë sapo të krijohen kapacitetet në nivel të QQ-së. Struktura dhe roli i këtij organi duhet të përcaktohen në ligj dhe të integrohen në proceset e punës të administratës dhe mundësisht edhe në proceset e punës së Kuvendit. Kjo do të thotë se Qeveria dhe Kuvendi do të duhej ta përditësojnë Rregulloren e tyre të Punës dhe se një ligj specifik për themelimin e këtij organi të pavarur mbikëqyrës ose një ndryshim në një ligj ekzistues është i nevojshëm për të krijuar këtë organ dhe për ta përcaktuar mandatin e tij.

Si duhet të duket një organ i tillë, si duhet të strukturohet, cila duhet të jetë përbërja e bordit dhe/ose menaxhmentit dhe si duhet të plotësohet me staf janë çështje që ky koncept dokument nuk do t'i trajtojë në detaje. Një përshkrim i hollësishëm do të bëhet në një fazë të mëvonshme dhe krijimi i një organizate të tillë ka mundësi të mbështetet nga një partner zhvillimor. Themelimi i një organi të pavarur mbikëqyrës do të bazohet në një koncept dokument/vlerësim të ndikimit që do të vlerësojë nëse themelimi i një organi të tillë do të siguronte një shtysë të rëndësishme për politikën e Qeverisë për zvogëlimin e barrës administrative. Puna në këtë KD pritet të fillojë në vitin e tretë ose të katërt pas fillimit të programit për zvogëlimin e barrës administrative.

### **3.3.2 Rezervimi i buxhetit**

Buxheti është i nevojshëm për të zbatuar një program për zvogëlimin e barrës administrative. Kërkesat e stafit duhet të mbulohen nga buxheti i Kosovës.



Të gjitha masat për zvogëlimin e barrës administrative që kërkojnë financim shtesë duhet të integrohen në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dhe zbatimi i tyre duhet të prioritizohet. Përgatitja e Buxhetit Vjetor duhet t'i marrë parasysh nevojat buxhetore për t'i zbatuar masat për zvogëlimin e barrës administrative.

Nuk është e mundur të parashikohet siç duhet nevoja e pritshme buxhetore për zbatimin e të gjitha masave që do të rrjedhin nga një program për zvogëlimin e barrës administrative. Përderisa disa masa do të zbatohen në mënyrë neutrale sa i përket buxhetit, masat e tjera do të kërkojnë rritje të ndjeshme të shpenzimeve. Si pjesë e përgatitjes së programit për zvogëlimin e barrës administrative, Qeveria do të shqyrtojë mundësi të tilla si p.sh. një Kontratë e Mbështetjes Buxhetore Sektoriale për Zvogëlimin e Barrës Administrative me Bashkimin Evropian. Përveç kësaj, mundësi bashkëpunimi do të kërkohen me partnerët zhvillimorë për të rezervuar mbështetjen buxhetore për zbatimin e programit për zvogëlimin e barrës administrative.

Në këtë fazë, pritja është që rreth 2.000.000 euro në vit nevojiten për rritjen e stafit, zhvillimin e kapaciteteve dhe hulumtime shtesë që do të çojnë në zhvillimin e masave për zvogëlimin e barrës administrative. Këto kosto pritet të mbulohen pjesërisht përmes buxhetit, përmes mbështetjeve buxhetore dhe asistencës teknike. Prezantimi i detajuar i këtyre kostove do të bëhet në Strategjinë për Rregullim më të Mirë.

### **3.3.3 Krijimi i matjes bazë (matjes së gjendjes fillestare)**

Disa vende kanë aplikuar një matje të gjendjes fillestare kur kanë monitoruar përparimin e arritur në lidhje me zvogëlimin e barrës administrative. Gjendja fillestare siguroi një pasqyrë të përqindjes së BPV-së që përfaqësonin barrët administrative. Gjendja fillestare gjithashtu siguroi informacionin e nevojshëm për të vlerësuar kontributin në programin e zvogëlimit të masave individuale të zhvilluara dhe të miratuara nga Qeveria/Kuvendi.

Praktika e zakonshme ishte krijimi i matjes bazë (matjes së gjendjes fillestare) qysh në fillim të procesit. Në përgjithësi, matja e shtrirjes së plotë të barrës administrative në një vend mori mesatarisht një vit dhe kërkoi burime të konsiderueshme buxhetore. Procesi i matjes më së shpeshti ishte kryer nga konsulencat e jashtme.

Sfida është që kompanitë në Kosovë kanë pak përvojë apo nuk kanë fare përvojë në matjen e barrëve administrative. Si rezultat, zhvillimi i matjes së gjendjes fillestare për të gjithë legjislacionin do të ishte një detyrë që do duhej të zbatohet nga kompanitë që vijnë nga vendet e BE-së. Kjo automatikisht dhe në mënyrë të konsiderueshme do t'i shtonte kostot e programit për zvogëlimin e barrës administrative por do t'ia mundësonte Kosovës të ndiqte praktikën e zhvilluar në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo do të siguronte një cak të qartë për zvogëlimin e barrës administrative dhe të gjitha ndryshimet pasuese në aktet ligjore do të mund të referoheshin duke u krahasuar me gjendjen fillestare.

Në mënyrë alternative, matja e gjendjes fillestare do të mund të zhvillohet gradualisht. Në fillim, baza e të dhënave do të përmbante të gjithë legjislacionin përkatës dhe do t'i identifikonte të gjitha Informatat e Obligueshme. Gjatë zbatimit të programit për zvogëlimin e barrës administrative, analiza e politikave përmes hartimit të koncept dokumenteve dhe vlerësimeve do të siguronte informacionin e nevojshëm për t'i vlerësuar barrët administrative të vërteta. Ky proces do të ndante procesin e matjes në pjesë më të vogla të ndërlidhura të cilat do ta lehtësonin kryerjen e matjes. Megjithatë, kjo qasje do ta vështirësonte vendosjen e një objekti të zvogëlimit të bazuar në një përqindje të zvogëlimit të barrës administrative. Objekti i zvogëlimit do të duhej të lidhej me numrin e ligjeve të rishikuara ku informacioni për matjen dhe zvogëlimin pasues për secilën masë të zvogëlimit do të siguronte informacionin për nivelin e zvogëlimit të barrës administrative.

Bazuar në supozimin se numri i përgjithshëm i ligjeve është 435<sup>191</sup> dhe se 50% e këtyre ligjeve rregullojnë aktivitetet e biznesit, matja e gjendjes fillestare të barrës administrative do duhej të mbulonte rreth 220 ligje

<sup>191</sup>Shih gjithashtu Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/LawInForceList.aspx>



dhe aktet e tyre nënligjore. Një objektiv zvogëlimi që përfshin edhe qytetarët dhe administratën do të nënkuptonte që e gjithë korniza ligjore do të duhet të rishikohet.

Matja bazë do të përmbajë të gjitha procedurat administrative. Kështu ajo mund të zëvendësojë bazën e të dhënave të licencave dhe lejeve. Kjo bazë e të dhënave do të shfuqizohet pas përfundimit të matjes bazë.

Për më tepër, vendosja e matjes bazë do të varet nga publikimi i plotë i të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore në një bazë qendrore të të dhënave dhe online. Gazeta Zyrtare është organizata e cila siguron publikimin e lartpërmendur. Pasi kjo të sigurohet, atëherë mund të shfuqizohet pasqyra e akteve nënligjore. Kjo do të modernizojë administratën si dhe do të zvogëlojë burokracinë e panevojshme pasi eliminon detyrat që aktualisht kryhen disa herë në nivele të ndryshme.

## Opsioni 1: Opsioni pa ndryshime

Opsioni 1 është opsioni për të mos futur ndryshime. Ky opsion shërben si referencë për opsionet tjera të prezantuara në këtë kapitull. Opsioni pa ndryshime është një opsion standard në një vlerësim ndikimi. Koncept dokumentet në Kosovë janë ekuivalenti i analizës së politikës ex-ante që në arenën ndërkombëtare njihet si vlerësimi i ndikimit.

Ekziston zgjidhja për të mbajtur situatën ashtu siç është dhe për të hequr dorë nga përfitimet dhe kostot që do të sillte për Kosovën zvogëlimi i barrëve administrative. Ndryshimet organizative në administratë, detyrat shtesë dhe rritja e kërkesës për punë nuk do të ndodhnin. Gjithashtu nuk do të ndodhnin as përmirësimet në rritjen ekonomike, as përmirësimi i klimës së biznesit/investimeve, mbështetja ndaj sundimit të ligjit dhe as përmirësimi i cilësisë së zbatimit të legjislacionit. Për më tepër, nuk do të materializohen as përfitimet e përgjithshme nga një kornizë më gjithëpërfshirëse dhe më e konsoliduar ligjore që është sjellë në linjë me Acquis-in e BE-së dhe që zbatohet në mënyrë efektive. Përveç kësaj, zbatimi i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative pritet të vazhdojë, duke përfshirë edhe zbatimin e parimit të mospagimit të procedurës. Kapitulli 4 përcakton ndikimet e zgjidhjes për të mos ndryshuar qasjen aktuale të politikës, në veçanti ndikimet buxhetore.

Ky opsion mund të zgjidhet nëse (1) vlerësimi i përgjithshëm politik është që aktualisht - p.sh. për shkak të prioritizimit të çështjeve të tjera – ndjekja e një politike që synon zbatimin e zvogëlimin të barrëve administrative si një politikë qendrore e qeverisë për një periudhë të zgjatur kohore nuk është e dëshirueshme (duke përfshirë kështu disa mandate qeveritare që ka të ngjarë të përbëhen nga parti të ndryshme politike); (2) konsultimi i palëve të interesuara tregon se këto palë nuk e shohin të arsyeshme që fokusi i Qeverisë të drejtohet në prioritetin strategjik për të zvogëluar barrët administrative për një periudhë të konsiderueshme kohore me rezultatin e kornizës ligjore më efikase dhe të zbatuar më mirë.

Opsioni pa ndryshime siguron gjithashtu të dhëna për Skenarin Bazë. Zvogëlimi i barrës administrative pritet të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe të sjellë një sërë përfitimesh jo të prekshme që lidhen me fusha të tilla si të drejtat themelore. Pa një program që synon zvogëlimin e barrës administrative, rritja ekonomike do të zhvillohej siç parashikohet nga Ministria e Financave pasi që nuk do të ndodhte shtytja e rritjes ekonomike që pritet se do të sillte zvogëlimi i barrës administrative.

## **Opsioni 2: Matja bazë dhe një cak zvogëlimi prej 25%, për barrët administrative për kompanitë, që zbatohet për të gjithë legjislacionin dhe që do të zbatohet brenda 4 viteve**

Opsioni i dytë ndjek praktikën e zbatuar nga shtetet anëtare evropiane. Kjo praktikë ishte të krijohet një matje bazë dhe të vendosej caku i zvogëlimit për një periudhë prej katër vjetësh, që përputhet me kohëzgjatjen standarde të një mandati qeveritar.

Ky opsion do të nënkuptonte që strukturat organizative do të vendoseshin brenda një afati shumë të shkurtër kohor dhe se matja bazë për të gjithë legjislacionin lidhur me biznesin do të përfundonte brenda një viti. Ndryshimet e kërkuara ligjore do duhej të miratoheshin brenda dy vitesh të fillimit të programit, me qëllim që të lejohet zhvillimi dhe miratimi i akteve nënligjore. Të gjitha ndryshimet në kornizën ligjore që kanë për qëllim zvogëlimin e barrëve administrative do të duhej të zbatoheshin në praktikë deri në fund të periudhës 4 vjeçare.

Përveç kësaj, zbatimi i parimit të mospagimit në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, specifikisht përcaktimi i procedurave që duhet të jenë falas dhe ato që duhet të pasqyrojnë koston mesatare të nevojshme për të bërë një procedim administrativ, do të zbatohet gradualisht për të siguruar stabilitet financiar.

## **Opsioni 3: Përfundimi gradual i matjes bazë dhe fushëveprimi i përshtatur i cakut të zvogëlimit të barrës administrative për kompanitë brenda një periudhe kohore prej 8 vjetësh me qëllim zvogëlimin prej 30%**

Përvoja nga vende të ndryshme ka treguar se programet e zvogëlimit të barrës administrative normalisht zbatohen nga qeveritë pasuese. Programet vazhdojnë me një cak të ri zvogëlimi; ndiqen nga programe për të zvogëluar më tej barrën administrative; ose nga politikat që synojnë mbajtjen e barrës administrative në një nivel konstant, duke siguruar kështu që çdo rritje të kompensohet nga uljet diku tjetër.

Opsioni 3 merr parasysh një zbatim gradual të cakut të zvogëlimit të barrës administrative. Meqenëse korniza kohore për zbatimin e cakut të zvogëlimit është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme nga 4 në 8 vjet, caku i zvogëlimit është përcaktuar pak më i lartë, gjegjësisht 30%. Është e mundur të përshtatet ky cak që të përcaktohet edhe më lart, por gjatë fazës aktuale të analizës, zgjidhja është që të aplikohet një qasje e kujdesshme në caktimin e cakut të zvogëlimit.

Përveç kësaj, zbatimi i parimit të mospagimit në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, specifikisht përcaktimi i procedurave që duhet të jenë falas dhe ato që duhet të pasqyrojnë koston mesatare të nevojshme për të bërë një procedim administrativ, do të zbatohet gradualisht për të siguruar stabilitet financiar.

Gjatë një periudhe prej rreth 4 vjetësh, matja bazë duhet të përfundojë teksa masat e zvogëlimit të barrës administrative zhvillohen dhe miratohen në ndërkohë. Çdo masë e zvogëlimit të barrës do të mbështetej me një matje të barrës administrative me qëllim që të përcillet drejtimi i përgjithshëm i nivelit të barrës administrative.

Matjet e barrës administrative do të integroheshin si një element i detyrueshëm i proceseve ekzistuese të zhvillimit të politikave, për shembull, si pjesë e analizës së kryer për zhvillimin e Koncept Dokumenteve dhe Vlerësimeve. Çdo propozim ligjor do të duhej të tregonte se cilat do të ishin efektet mbi barrën administrative.

Matja bazë e barrës administrative do të fillohej me matjen e ligjeve dhe akteve nënligjore që mund të pritët të jenë veçanërisht të rënda për bizneset. Një matje e tillë specifike duhet të përfundojë brenda 18 muajve pas fillimit të programit të zvogëlimit. Ky opsion kombinon kështu përvojat nga Bashkimi Evropian ku programi i zvogëlimit të barrëve administrative ka synuar akte të veçanta ligjore, të cilat ishin veçanërisht të rënda dhe nga përvojat e shteteve anëtare evropiane që kanë matur barrët administrative që rrjedhin nga i gjithë legjislacioni.

Prioritizimi i matjes në rend të parë mund të synojë fusha specifike relevante si legjislacionin tatimor dhe ligje të tjera që prekin të gjitha bizneset; ligjet dhe aktet nënligjore që përcaktojnë Informatat e Obligueshme që përdoren për ndërtimin e treguesve të Bankës Botërore në lidhje me të Bërit Biznes; dhe legjislacioni që rregullon sektorët e veçantë ekonomik për të cilët zvogëlimi i barrës administrative konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm pasi rritja në këta sektorë pritet të jetë me rëndësi të veçantë në lidhje me krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik.

#### **Opsioni 4: Zgjerimi i Opsionit 3 me një cak zvogëlimi prej 30% sa i përket barrës administrative për qytetarët**

Opsioni 4 përfshin mundësinë e zgjerimit të cakut të zvogëlimit të barrës administrative nga kompanitë për të përfshirë barrën me të cilët ballafaqohen edhe qytetarët. Ndërsa strukturat e menaxhimit do të mbeteshin të njëjta, kërkesa për punë që një zgjerim i tillë do të vendoste në administratën do të rritej ndjeshëm.

Opsioni për të trajtuar barrën administrative për qytetarët konsiderohet të jetë i zbatueshëm në kombinim me Opsionin 3. Programi i zvogëlimit të barrës do të kishte fushëveprim më të gjerë dhe më shumë staf profesional do të duhej të përfshihej, por struktura e përgjithshme nuk do të kishte nevojë të përshtatej/rregullohej. Objektivi i zvogëlimit të barrës administrative me të cilat përballen qytetarët është vendosur në 30%, ashtu si dhe objektivi i zvogëlimit i formuluar për bizneset. Krahasuar me vendosjen e objektivit vetëm për bizneset, kërkesa për punë që një zgjerim i tillë do të vendoste në administratën do të rritej ndjeshëm pasi që më shumë ligje dhe akte nënligjore do të duhej të përfshiheshin në program.

Përveç kësaj, zbatimi i parimit të mospagimit në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, specifikisht përcaktimi i procedurave që duhet të jenë falas dhe ato që duhet të pasqyrojnë koston mesatare të nevojshme për të bërë një procedim administrativ, do të zbatohet gradualisht për të siguruar stabilitet financiar.

Kombinimi i një objektivit të zvogëlimit për kompanitë dhe qytetarët nën Opsionin 2 konsiderohet të jetë jo i zbatueshëm duke pasur parasysh afatin e shkurtër kohor për reformën.

#### **Opsioni 5: Zgjerimi i Opsionit 3 me një cak zvogëlimi prej 30% sa i përket barrës administrative për administratën dhe profesionistët e veçantë**

Opsioni 5 përfshin mundësinë për të zgjeruar cakun e zvogëlimit të barrës administrative nga kompanitë për të përfshirë edhe barrën me të cilat përballen organet qeveritare dhe profesionistët e veçantë. Kjo do të rriste kërkesën në strukturat e menaxhimit pasi që ato do të duhej të merrnin parasysh marrëdhëniet midis niveleve qendrore dhe lokale të qeverisjes. Në praktikë, kjo nënkupton që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të duhej të përfshihej në programin e zvogëlimit të barrës administrative. Organizata të veçanta, si Policia e Kosovës, Zjarrfikësit dhe organizata të tjera do të duhej të përfshiheshin në program kur përfaqësojnë profesionistë që janë përzgjedhur për zvogëlimin e barrës administrative në lidhje me kërkesat për dokumente që ata duhet t'i përmbushin. Krahasuar me vendosjen e objektivit vetëm për kompanitë, kërkesa e punës që një zgjerim i tillë do të vendoste në administratën do të rritej ndjeshëm pasi që më shumë ligje dhe akte nënligjore duhej të përfshiheshin në program.

Opsioni për të adresuar barrën administrative për institucionet qeveritare konsiderohet të jetë i zbatueshëm në kombinim me Opsionin 3. Programi i zvogëlimit të barrës do të kishte fushëveprim më të gjerë dhe më shumë organizata dhe njerëz do të duhej të përfshiheshin. Struktura e përgjithshme do të duhej të përshtatej pak, pasi që MAPL-ja do të duhej të përfshihej në programin e zvogëlimit.

Përveç kësaj, zbatimi i parimit të mospagimit në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, specifikisht përcaktimi i procedurave që duhet të jenë falas dhe ato që duhet të pasqyrojnë koston mesatare të nevojshme për të bërë një procedim administrativ, do të zbatohet gradualisht për të siguruar stabilitet financiar. .

Kombinimi i një caku të zvogëlimit për kompanitë dhe komunat sipas Opsionit 2 konsiderohet të jetë jo i zbatueshëm duke pasur parasysh afatin e shkurtër kohor për reformën.

## **Opsioni 6: kombinimi i Opsioneve 3, 4 dhe 5**

Opsioni 6 parashtron mundësinë për të trajtuar zvogëlimin e barrës administrative për kompanitë, qytetarët dhe administratën nën një program. Shtetet anëtare të BE-së të gjitha ishin të prirura të trajtonin këto tri lloje të barrëve administrative pasi nuk ka rëndësi se ku krijohet joefikasiteti në kornizën ligjore dhe në zbatimin e saj. Konkluzioni politik në çdo shtet anëtar të BE-së të analizuar për këtë Koncept Dokument ishte që barrët e panevojshme nuk duhet të tolerohen, pavarësisht nëse ato zbatohen për kompanitë, qytetarët apo administratën.

Opsioni për të adresuar barrën administrative për kompanitë, qytetarët dhe organet qeveritare konsiderohet të jetë një opsion i zbatueshëm. Programi i zvogëlimit të barrës do të kishte fushëveprim më të gjerë dhe më shumë institucione dhe njerëz do të duhej të përfshiheshin. Struktura e përgjithshme do të duhej të përshtatej pak, pasi që MAPL-ja do të duhej të përfshihej në programin e zvogëlimit.

Përveç kësaj, zbatimi i parimit të mospagimit në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, specifikisht përcaktimi i procedurave që duhet të jenë falas dhe ato që duhet të pasqyrojnë koston mesatare të nevojshme për të bërë një procedim administrativ, do të zbatohet gradualisht për të siguruar stabilitet financiar.

Kombinimi i një objekti të zvogëlimit për kompanitë dhe komunat sipas Opsionit 1 konsiderohet të jetë jo i zbatueshëm duke pasur parasysh afatin e shkurtër kohor për reformën.

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme të opsioneve

Opsionet e paraqitura në kapitullin e mëparshëm ndryshojnë në dy aspekte kryesore: (1) kohëzgjatja e programit për të cilin Opsioni 2 ofron kornizën më të shkurtër kohore; (2) fushëveprimi i qasjes dhe poashtu caku i zvogëlimit të mundshëm të barrës me Opsionin 6 që ofron fushëveprimin më të gjerë dhe arritjet e zvogëlimit. Këta dy faktorë përcaktojnë efektet që priten të ndodhin dhe mënyrën në të cilën ata kanë mundësi të tregojnë veten. Këto janë pasqyruar në nënseksionet e ndryshme të këtij kapitulli.

### 4.1 Korniza ligjore aktuale në numrin e ligjeve dhe akteve nënligjore

Në mënyrë që të formësohen opsionet e ndryshme dhe rëndësia e tyre, tabela më poshtë tregon numrin e përgjithshëm të ligjeve që pritet të analizohen dhe rishikohen sipas gjashtë opsioneve të ndryshme në shqyrtim. Këta numra lidhen drejtpërdrejt me përfitimet e pritura në kuptimin ekonomik dhe kostot që duhet të bëhen për të zbatuar në mënyrë efektive politikën e zvogëlimit të barrës administrative.

Numri i ligjeve të përdorura për pasqyrën e mëposhtme vlerësohet të jetë 471, bazuar në të dhënat e publikuara në Gazetën Zyrtare<sup>192</sup>. Në vitin 2018, rreth 190 ligje janë shqyrtuar për të krahasuar përputhshmërinë e tyre me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, meqë ato përmbajnë procedura administrative që duhej shqyrtuar.

Numri i akteve nënligjore pritet të jetë rreth 2500<sup>193</sup>. Megjithatë, meqenëse lista nuk përditësohet rregullisht, numri i akteve nënligjore mund të jetë shumë më i lartë. Përveç kësaj, përmbledhja nuk përfshin udhëzimet administrative të cilat gjithashtu mund të jenë relevante pasi që ato gjithashtu mund të vendosin barra administrative ose të përdoren për të dhënë më shumë detaje mbi Informatat e Obligueshme që përcaktohen me anë të kërkesave ligjore.

Figura 49 - Ligjet në fushëveprimin e programit të zvogëlimit të barrës administrative sipas opsioneve të ndryshme

Opsioni	Ligjet dhe aktet nënligjore që mbulohen nga programi për zvogëlimin e barrës administrative
Opsioni 1: Opsioni “asnjë ndryshim”	0
Opsioni 2: Matja e plotë bazë dhe caku për 25% zvogëlim të barrëve administrative për kompanitë e aplikueshme në gjithë legjislacionin dhe që do të zbatohen brenda 4 viteve	220 ligje (50% e të gjitha ligjeve) 1250 akte nënligjore (50% e të gjitha akteve nënligjore)
Opsioni 3: Përfundimi gradual i matjes bazë dhe fushëveprimi i përshtatur i cakut të zvogëlimit të barrëve administrative për kompanitë brenda një periudhe kohore prej 8 viteve me qëllim zvogëlimin prej 30%	220 ligje (50% e të gjitha ligjeve) 1250 akte nënligjore (50% e të gjitha akteve nënligjore)
Opsioni 4: Zgjerimi i Opsionit 3 me një cak të zvogëlimit prej 30% sa i përket barrëve administrative për qytetarët	330 ligje (75% e të gjitha ligjeve) 1875 akte nënligjore (75% e të gjitha akteve nënligjore)

<sup>192</sup> Gazeta Zyrtare, ligjet në fuqi: <https://gzk.rks-gov.net/LawInForceList.aspx> (qasur më 5 mars 2020)

<sup>193</sup> Raporti mbi "Regjistrin e Legjislacionit Sekondar në fuqi të miratuar nga Qeveria dhe Ministrat" përmban 509 faqe me një mesatare prej 5 akteve nënligjore të renditura për faqe. Aktet nënligjore nuk numërohen dhe nuk janë numëruar individualisht si pjesë e analizës për këtë koncept dokument.

Opsioni 5: Zgjerimi i Opsionit 3 me cak të zvogëlimit prej 30% sa i përket barrëve administrative për administratën dhe profesionistët specifikë	330 ligje (75% e të gjitha ligjeve) 1875 akte nënligjore (75% e të gjitha akteve nënligjore)
Opsioni 6: kombinimi i opsioneve 3, 4 dhe 5	Të gjitha 471 ligjet Të gjitha 2500 aktet nënligjore

Tabela e mësipërme tregon se, pavarësisht nga opsioni i zgjedhur për zvogëlimin e barrës administrative, administrata do të duhet të përballojë një sasi të konsiderueshme të punës në analizimin dhe rishikimin e kornizës ligjore ekzistuese. Kjo, nga ana tjetër, do të rezultojë në rritjen e agjendës legislative dhe numrit të ligjeve që do t'i paraqiten Kuvendit. Për më tepër, të gjitha organet qeveritare të përfshira në zbatimin e legjislacionit do të duhej të përshtatin procedurat e tyre dhe proceset e punës.

## 4.2 Ndikimet ekonomike

Përfitimi më i rëndësishëm sasior që shkaktohet nga zvogëlimi i barrëve administrative kundrejt caktimit për zvogëlim prej 25% është rritja ekonomike. Kjo rritje është rezultat i efekteve të drejtpërdrejta ekonomike që kanë barrët administrative. Siç tregon shtojca 8, efektet ekonomike të një zvogëlimi të konsiderueshëm të barrës administrative lidhen me krijimin e vendeve të punës, krijimin e bizneseve, ndryshimin e flukseve të importit dhe eksportit, rritjen e investimeve (veçanërisht nga diaspora) dhe rritjen e IHD-ve, inovacionit dhe kërkimit. Zvogëlimi i barrës administrative është i një rëndësie të veçantë për NVM-të pasi ato ndikohen në mënyrë joproportionale nga këto barra<sup>194</sup>. Kjo gjetje është konfirmuar nga BE-ja<sup>195</sup> si dhe OECD-ja<sup>196</sup>. Sidoqoftë, nuk është kryer ndonjë test specifik i NVM-ve për këtë koncept dokumenti pasi që analiza nuk adreson barrët administrative për NVM-të në fusha specifike të politikave.

Efektet pozitive që zvogëlimi substancial i barrëve administrative pritet të ofrojë mund të përkthehen në rritje të BPV-së. Në vitin 2004 hulumtimi më i mirë në dispozicion mbi efektet e zvogëlimit të barrës administrative në ekonomi sigurohet nga Holanda ku niveli i barrëve administrative është vlerësuar në 3,6% të BPV-së në fillim të programit të Holandës për zvogëlimin e barrës administrative. Ndikimi kryesor i pritur ekonomik nga zvogëlimi i barrëve administrative prej 25% ishte rritja e BPV-së prej 1,5%. Kjo shifër është përdorur si bazë për vlerësimin e ndikimeve makroekonomike në BPV edhe pse krahasimi me Holandën mund të mos jetë një përfaqësim i duhur (shih gjithashtu figurën më poshtë).

Ky ndikim makroekonomik për objektivin prej 25% zvogëlim të barrës administrative është rivlerësuar në një dokument shkencor në vitin 2014<sup>197</sup>. Në analizë është konstatuar që ndikimi mesatar i objektivit të tillë të zvogëlimit në BE ishte rritja e njëhershme e BPV-së me 1.62%. Kjo rritje ka rezultuar në nivel më të lartë të qëndrueshëm të BPV-së.

Në këtë dokument gjithashtu është treguar që një normë shumë e lartë e rritjes deri në 3,65% të BPV-së është brenda diapazonit të mundësive. Megjithatë, pasi që një rritje e tillë ishte e lidhur vetëm me një vend (ndërsa të

<sup>194</sup> Komisioni Evropian, "Think Small First" - "Akti për Bizneset e Vogla" për Evropën, COM(2008) 394 final, Bruksel, 25 qershor 2008, faqe 7.

<sup>195</sup> European Commission, "Think Small First" - A "Small Business Act" for Europe, COM(2008) 394 final, Brussels, 25 June 2008, page 7.

<sup>196</sup> OECD (2019), OECD SME and Entrepreneurship Outlook 2019, Publikim i OECD, Paris, faqet 17, 19, 70, 93, 94 dhe më tej.

<sup>197</sup> Poel, K. dhe të tjerët, 'Administrative Simplification and Economic Growth: A Cross Country Empirical Study', Journal of Business Administration Research Vëll. 3, Nr. 1; 2014.

Zyra e Kryeministrit – Sekretariati Koordinues i Qeverisë: Koncept Dokumenti për Zvogëlimin e Barrës Administrative – Heqja e Barrierave Burokratike tjerat me luhatje më shumë në rritje prej rreth 2.5%), atëherë do të përdoret rritja mesatare e BPV-së së BE-së si rezultat i zbatimit të suksesshëm të objektivit për zvogëlim prej 25%.

Figura 50 - Vlerësimi i përfitimeve ekonomike të zvogëlimit të barrës administrative

Rritja prej 1,5% e BPV-së që rezultoi nga caku i zvogëlimit prej 25% për barrët administrative ishte një shifër që drejtoi programin e zvogëlimit të barrës administrative të administratave të njëpasnjëshme holandeze. Rritja prej 1.62% e BPV-së është konfirmuar pasi një varg i vendeve të BE-së zbatuan politikat për zvogëlimin e barrës administrative.

Shifra e fundit përdoret në këtë Koncept Dokument për analizën e kostos dhe përfitimeve të politikës së sugjeruar për zvogëlimin e barrës.

Kjo pritet të arsyetohet pasi që shifra prej 1,5% ndërlidhet me përfitimet ekonomike për një ekonomi të zhvilluar. BPV-ja e Holandës në vitin 2017 arriti në mbi 737 miliardë euro, që ishte 115 herë më e madhe se ajo e Kosovës<sup>198</sup>. BPV-ja holandeze për person në të njëjtin vit ishte më shumë se 12 herë më e lartë se në Kosovë<sup>199</sup>.

Këto dallime themelore midis Kosovës dhe Holandës e bëjnë të pamundur që rritja prej 1,5% të mund të transferohet nga gjendja ekonomike holandeze në kushtet aktuale ekonomike të Kosovës.

Mesatarja e BE-së prej 1.62% pasqyron më mirë efektet e mundshme në Kosovë pasi që kjo përfshinë një varg të gjerë të vendeve, përfshirë numrin e konsiderueshëm të vendeve që akoma janë në tranzicion drejt një ekonomie të tregut.

Pritet që zvogëlimi i barrës administrative mund të ketë një efekt pozitiv që në thelb tejkalon vlerësimet holandeze. Prandaj, rritja e BPV-së prej 3.65%, përderisa nuk përdoret për vlerësimin e përfitimeve që mund t'i sjellë zvogëlimi i barrës administrative, prapë do të përdoret për të paraqitur ndikimin e mundshëm maksimal të politikës për zvogëlimin e barrës administrative.

Përdorimi i shifrës më të lartë për rritjen e mundshme të BPV-së është brenda mundësive pasi që efekti i zvogëlimit të barrës administrative në zvogëlimin e ekonomisë joformale nuk paraqitet në ndikimin e parashikuar të BPV-së. Deri më tani, dëshmitë kualitative tregojnë që një efekt i tillë mund të pritet. Për shembull, ekonomia joformale e Bullgarisë është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të një varg ndërhyrjesh në politika, si luftimi i drejtpërdrejt i jorformalitetit, zvogëlimi i barrës administrative dhe të tjera<sup>200</sup>. Megjithatë, pasi që asnjë e dhënë sasiore që do të mund të ofronte një indikacion sasior të efektit të ekzekutimit të barrës administrative në formalizim nuk është gjetur, ky efekt nuk merret parasysh gjatë analizës për këtë Koncept Dokument. Lidhja ndërmjet nivelit të barrës administrative dhe qëllimit për zvogëlimin e sektorit joformal është konfirmuar nga Banka Botërore<sup>201</sup>.

Kontributi në rritjen ekonomike përcaktohet nga shuma e barrës administrative të zvogëluar. Hulumtimi në dispozicion ka përcaktuar efektin e rritjes së BPV-së për një cak prej 25% të zvogëlimit, por jo për një cak më të lartë. Përveç kësaj, nuk ka literaturë në dispozicion për efektet ekonomike të një caku për zvogëlimin e barrës administrative për qytetarët ose administratën.

<sup>198</sup> [http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=nama\\_10\\_gdp&lang=en](http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=nama_10_gdp&lang=en) (faqja e internetit së fundi është vizituar më 22 tetor 2018).

<sup>199</sup> <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?end=2017&start=2017> (faqja e internetit së fundi është vizituar më 22 tetor 2018).

<sup>200</sup> <https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2017/bulgaria-fall-in-share-of-informal-economy>, së fundi e vizituar më 26 korrik 2019.

<sup>201</sup> World Bank Policy Research Working Paper, Leibfritz W., 'Undeclared Economic Activity in Central and Eastern Europe – How Taxes Contribute and How Countries Respond to the Problem', maj 2010.



Mund të pritët që zvogëlimi i barrës për qytetarët do të ketë një ndikim pozitiv ekonomik meqenëse disa procedura, si marrja e lejeve dhe licencave të ndërtimit, kanë çuar në rritjen e shpenzimeve për qytetarët. Duke shpenzuar më pak kohë për marrjen e shërbimeve qeveritare do të thotë që qytetarët mund t'ia kushtojnë kohën e tyre çështjeve që kanë më shumë rëndësi për ta dhe kjo përfshin edhe mundësinë për të punuar në ndonjë biznes si dhe të fillojnë ose drejtojnë ndonjë biznes.

Zvogëlimi i barrëve administrative brenda administratës mund të ketë efektin që rritja e efikasitetit të administratës siguron një kthim më të mirë të shpenzimeve buxhetore aktuale. Kjo do të parandalonte nevojën për të rritur taksat dhe mund të sigurojë hapësirën fiskale të nevojshme për investime shtesë ekonomike nga Qeveria.

Në këtë mënyrë, niveli i zvogëlimit të barrës administrative për qytetarët dhe administratën duhet të përkthehet në një përfitim ekonomik që lidhet mirë me përfitimet ekonomike që mund të priten si rezultat i zvogëlimit të barrës administrative për kompanitë.

Nuk është e mundur të përcaktohet me shumë siguri se cili do të ishte kontributi i rëndësishëm ekonomik i një caku të zvogëlimit prej 30% për qytetarët dhe/ose administratën pasi asnjë hulumtim i tillë nuk është bërë deri më tani. Prandaj, analiza dhe parashikimet e ndikimeve duhet të bazohen në supozime.

Këto supozime janë vendosur në mënyrë konservatore në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i mbivlerësimit të kontributit ekonomikisht të rëndësishëm dhe kështu niveli i përfitimeve të pritura ndikon në cilësinë e analizës. Për zvogëlimin e barrëve administrative për qytetarët dhe administratën që arrin cakun e zvogëlimit prej 30%, pritët të jetë e barabartë me një zvogëlim shtesë dhe ekonomikisht të rëndësishëm të barrëve prej 5% në fund të programit të zvogëlimit sipas opsioneve 4, 5 dhe 6. Efekti pritët të përhapet në mënyrë të barabartë përgjatë viteve, gjë që rezulton në zvogëlimin shtesë të barrës prej 0,83, siç paraqitet më poshtë për Opsionet 4 dhe 5. Për Opsionin 6 kjo shumë është dyfishuar pasi që përfshin zvogëlimin e barrës për qytetarët si dhe administratën.

Figura 51 - Rënia e pritshme e zvogëlimit ekonomikisht të rëndësishëm të barrës administrative sipas skenarit për një periudhë 10-vjeçare

Viti	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5	Opsioni 6
1	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim
2	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim
3	Asnjë ndryshim	-10%	-5%	-5,83%	-5,83%	-6,66%
4	Asnjë ndryshim	-25%	-10%	-11,66%	-11,66%	-13,32%
5	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	-15%	-17,49%	-17,49%	-19,98%
6	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	-20%	-23,32%	-23,32%	-26,64%
7	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	-25%	-29,15%	-29,15%	-33,3%
8	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	-30%	-35%	-35%	-40%
9	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	Asnjë ndryshim i mëtejshëm
10	Asnjë ndryshim	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	Asnjë ndryshim i mëtejshëm	Asnjë ndryshim i mëtejshëm

KASH-i 2019-2021 përcakton pritjen se rritja ekonomike në Kosovë do të jetë mesatarisht 5%. Ky nivel i rritjes ekonomike të parashikuar siguron skenarin bazë për 'Opsioni 1: Asnjë ndryshim'. Bazuar në supozimin se caku i zvogëlimit prej 25% për barrët administrative për kompanitë kontribuon në rritje të përgjithshme kumulative të pritur të BPV-së prej 1.62 % brenda dy viteve pas zbatimit të masave individuale të zvogëlimit të barrës, perspektiva e rritjes ekonomike do të ndryshojë siç paraqitet në tabelën më poshtë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, një zvogëlim prej 5% i barrës administrative është i barabartë me rritjen e BPV-së prej 0.3%. Në mënyrë të njejtë të arsyetimit, zvogëlimi 0,83% me shifrat e përdorura për të vlerësuar zvogëlimin e barrës administrative ekonomikisht relevante në lidhje me qytetarët dhe administratën supozohet të jetë i barabartë me rritjen e BPV-së prej 0,05%.

Është me rëndësi të theksohet se perspektiva e rritjes ekonomike për vitet pas përfundimit të caktimit të zvogëlimit të barrës administrative është relative me bazën më të lartë krahasuar me bazën e përdorur në skenarin bazë. Kjo reflektohet në vlerësimin e ndikimeve pozitive të buxhetit që mund të priten bazuar në këto parashikime të rritjes.

Deri më tani dëshmitë nuk janë bindëse lidhur me çështjen nëse zvogëlimi strukturor i barrës administrative gjithashtu ndryshon bazat e rritjes ekonomike në atë masë sa që perspektivat e rritjes mund të përshtaten në periudhën afatmesme deri në ato afatgjata. Analiza e ndikimit nuk adreson këtë ndikim të mundshëm në këtë fazë. Në rast se dalin dëshmi të qarta që tregojnë se ekziston një korrelacion midis zvogëlimit të barrës administrative dhe rritjes së potencialit për rritje ekonomike, kjo do të integrohet në analizë.

KASH-i 2019-2021 përcakton pritjen se rritja ekonomike në Kosovë do të jetë mesatarisht 5%. Ky nivel i rritjes ekonomike të parashikuar siguron skenarin bazë për 'Opsioni 1: Asnjë ndryshim'. Bazuar në supozimin se caku i

zvogëlimin prej 25% për barrët administrative për kompanitë kontribuon në rritje të përgjithshme kumulative të pritur të BPV-së prej 1.62 % brenda dy viteve pas zbatimit të masave individuale të zvogëlimin të barrës, perspektiva e rritjes ekonomike do të ndryshojë siç paraqitet në tabelën më poshtë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, një zvogëlim prej 5% i barrës administrative është i barabartë me rritjen e BPV-së prej 0.3%. Në mënyrë të njejtë të arsyetimit, zvogëlimi 0,83% me shifrat e përdorura për të vlerësuar zvogëlimin e barrës administrative ekonomikisht relevante në lidhje me qytetarët dhe administratën supozohet të jetë i barabartë me rritjen e BPV-së prej 0,05%.

Është me rëndësi të theksohet se perspektiva e rritjes ekonomike për vitet pas përfundimit të caktimit të zvogëlimin të barrës administrative është relative me bazën më të lartë krahasuar me bazën e përdorur në skenarin bazë. Kjo reflektohet në vlerësimin e ndikimeve pozitive të buxhetit që mund të priten bazuar në këto parashikime të rritjes.

Deri më tani dëshmitë nuk janë bindëse lidhur me çështjen nëse zvogëlimi strukturor i barrës administrative gjithashtu ndryshon bazat e rritjes ekonomike në atë masë sa që perspektivat e rritjes mund të përshtaten në periudhën afatmesme deri në ato afatgjata. Analiza e ndikimit nuk adreson këtë ndikim të mundshëm në këtë fazë. Në rast se dalin dëshmi të qarta që tregojnë se ekziston një korrelacion midis zvogëlimin të barrës administrative dhe rritjes së potencialit për rritje ekonomike, kjo do të integrohet në analizë.

Figura 52 - Ndryshimet e pritshme në rritjen ekonomike sipas opsionit krahasuar me skenarin bazë

Viti	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5	Opsioni 6
1	5%	5%	5%	5%	5%	5%
2	5%	5%	5%	5%	5%	5%
3	5%	5%	5%	5%	5%	5%
4	5%	5%	5%	5%	5%	5%
5	5%	5,65%	5,32%	5,38%	5,38%	5,43%
6	5%	5,97%	5,32%	5,38%	5,38%	5,43%
7	5%	5%	5,32%	5,38%	5,38%	5,43%
8	5%	5%	5,32%	5,38%	5,38%	5,43%
9	5%	5%	5,32%	5,38%	5,38%	5,43%
10	5%	5%	5,32%	5,38%	5,38%	5,43%

### 4.3 Ndikimet shoqërore

Siç tregon shtojca 9, ndikimet e zvogëlimin të barrës administrative në sferën shoqërore lidhen kryesisht me krijimin e vendeve të punës që do të kontribuojnë në zvogëlimin e varfërisë. Përveç kësaj, përmes përmirësimeve në zbatimin e legjisllacionit dhe potencialisht rritjes së përdorimit të mjeteve të TI-së për zbatimin e legjisllacionit, mund të pritet një efekt pozitiv sa i përket zvogëlimin të korrupsionit.

Megjithatë, këto ndikime shoqërore që rezultojnë nga zvogëlimi i barrës administrative nuk mund të përcaktohen në sasi. Nuk ka informata specifike kombëtare që do të mundësonin këtë. Përveç kësaj, kërkimet ndërkombëtare ekzistuese dhe informacione të tjera në lidhje me efektet shoqërore të zvogëlimin të barrës administrative nuk adresojnë këto çështje deri në atë masë sa që informacioni mund të përdoret për të forcuar

analizat për këtë koncept dokument. Prandaj, meqë nuk është i mundshëm përcaktimi sasiore i ndikimeve shoqërore, ato do të vlerësohen veçmas në secilën nga opsionet e shqyrtuara në terma cilësorë. Kjo adresohet në kapitullin 6 dhe në veçanti në nënkaptullin që përcakton Analizën Shumëkriterëshe.

## 4.4 Ndikimet mjedisore

Përveç ndikimeve ekonomike dhe shoqërore, është e rëndësishme të merret parasysh ndikimi i mundshëm mjedisor i zvogëlimit të barrës administrative. Një analizë e tillë është e rëndësishme, veçanërisht në ditët e sotme, pasi që ndërgjegjësimi ndaj aspektit mjedisor po bëhet gjithnjë e më i theksuar.

Siç tregon shtojca 10, zvogëlimi i barrës administrative çon në disa ndikime në fushën e mjedisit. Për më tepër, kur legjislacioni është më i lehtë për t'u zbatuar, mund të pritët që të zbatohet më shumë në praktikë. Kompanitë që lëvizin nga sektori joformal dhe regjistrojnë aktivitetet e tyre të biznesit mund të pritët të jenë më shumë në pajtueshmëri me kornizën e përgjithshme ligjore, duke përfshirë legjislacionin që mbulon mbrojtjen e mjedisit. Megjithatë, në këtë moment nuk mund të bëhen parashikime të hollësishme në këtë drejtim.

Analiza aktuale e ndikimit në mjedis përqendrohet në dy aspekte kryesore të cilat vlerësohen në terma të përgjithshëm: parandalimi i emetimeve të gazrave serrë dhe përdorimi i letrës.

### 4.4.1 Ndikimi mjedisor: parandalimi i emetimeve të gazrave serrë

Megjithëse informacioni në këtë fazë ende nuk është në një nivel të tillë për të bërë parashikime të hollësishme rreth ndikimeve mjedisore, disa aspekte mund të paraqiten në bazë të supozimeve të arsyeshme.

Përderisa në mënyrë sasiore objektivi i zvogëlimit është përcaktuar për secilin opsion, nuk është ende e sigurt se cilat ligje dhe akte nënligjore do të bashkohen, thjeshtohen apo revokohen dhe se si do të duken masat e zvogëlimit të barrës në terma konkretë. Varësisht se cilat kërkesa ligjore do të preken, proceset dhe industritë e ndryshme mund të ndikohen dhe rrjedhimisht rezultati në mjedis ende nuk mund të definohet pasi që është shumë specifik për rastin.

Megjithatë, një mënyrë kryesore në të cilën ndikimet mjedisore mund të rezultojnë nga një program për zvogëlimin e barrës administrative është përmes nevojës së zvogëluar për të udhëtuar për qytetarët dhe kompanitë kur përmbushen Informatat e Obligueshme.

Përderisa për një grup të caktuar individësh/kompanish distanca deri tek organet publike është mjaft e kufizuar dhe udhëtimi mund të bëhet në këmbë, për shumicën e individëve/kompanive distancat janë të konsiderueshme dhe transporti duhet të bëhet me anë të automjeteve.

Një numër i reduktuar i udhëtimeve, madje edhe eliminimi i udhëtimeve të tilla, shkakton reduktim të gazrave serrë. Ky reduktim ndoshta nuk mund do të shfaqet në mënyrë të drejtpërdrejtë si domethënës në baza ditore ose individuale/shoqërore, por kur merret parasysh në nivel të shoqërisë dhe ekonomisë në baza vjetore, ndikimi pritët të jetë i lartë.

Zvogëlimi i gazrave serrë është një efekt që pritët të ndodhë pavarësisht se cilat kërkesa ligjore dhe rregullore do të adresohen përmes programit të zvogëlimit të barrës administrative. Është e arsyeshme të pritët që një politikë që synon thjeshtimin e të gjitha procedurave do të ndikojë në nevojën për udhëtime.

Për të vlerësuar ndikimin e përgjithshëm në këtë fazë, mund të përcaktohet një sistem parametrik. Ekzistojnë 38 komuna, të cilat janë paraqitur në tabelën më poshtë me popullatat dhe sipërfaqet përkatëse.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis, zbatohen supozimet e mëposhtme:

1. komunat<sup>202</sup> janë formuar si qarqe, me fushën e qarkut që korrespondon me sipërfaqen reale të tyre
2. dendësia e popullsisë shpërndahet në mënyrë të barabartë nëpër komuna, ku për secilin qytetar në cilëndo vendndodhje brenda qarkut ekziston një qytetar tjetër simetrik në qendër të qarkut
3. “qendra” ku pritet të jenë organet administrative supozohet të jenë në pikën qendrore të komunës.

Këto supozime japin të dhëna që tregojnë distancën mesatare që duhet të udhëtohet për çdo qytetar dhe kthimi prapa në "qendër" kur përmbushen Informatat e Obligueshme.

Kjo bashkohet me të dhënat e popullsisë që tregon se numri i personave mbi 18 vjeç është rreth 60% e të gjithë popullsisë. Kjo përqindje është uniforme në të gjitha komunat dhe supozimi aktiv është se vetëm të rriturit do të udhëtojnë për të përmbushur Informatat e Obligueshme.

Për më tepër, mund të pritet që disa individë preferojnë të ecin drejt "qendrës", ndërsa të tjerët do të arrijnë aty me anë të automjetit. Për momentin, supozohet se vetëm 1/3 e popullsisë që udhëton për Informatat e Obligueshme do të udhëtojë me veturë. Përveç kësaj, rruga drejt "qendrës" është përcaktuar aktualisht si një vijë e drejtë. Kjo është e nevojshme për t'i bërë llogaritjet më të lehta, edhe pse ky supozim është një nënvlerësim i qartë i distancës së udhëtuar. Ndikimet mjedisore mund të pritet të jenë shumë më të mëdha se ato të supozuara aktualisht.

Figura 53 - Vlerësimi i distancës së udhëtuar me veturë bazuar në supozimin se një e treta e popullatës së rritur udhëton një herë në vit lidhur me barrët administrative në 'qendër' të komunës

Komuna	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Popullata	Radiusi	Distanca totale e udhëtuar me veturë
Deçan	293,97	40.019,00	9,67	76.649,17
Dragash	433,85	33.997,00	11,75	79.104,31
Ferizaj	344,61	108.610,00	10,47	225.228,58
Fushë Kosovë	84,09	34.827,00	5,17	35.676,15
Gjakovë	586,62	95.556,00	13,66	258.539,05
Gjilan	391,84	90.178,00	11,17	199.408,99
Glogoc	275,63	58.531,00	9,37	108.552,28
Graçanicë	122,41	10.675,00	6,24	13.193,68
Han i Elezit	83,11	9.403,00	5,14	9.575,97
Istog	454,36	39.289,00	12,03	93.553,66
Junik	77,85	6.084,00	4,98	5.996,64
Kaçanik	211,28	33.409,00	8,20	54.247,84
Kamenicë	416,61	36.085,00	11,52	82.277,54
Klinë	309,02	38.496,00	9,92	75.595,97

<sup>202</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/Municipalities\\_of\\_Kosovo](https://en.wikipedia.org/wiki/Municipalities_of_Kosovo)

Kllokot	23,39	2.556,00	2,73	1.380,91
Leposaviq	539,05	13.773,00	13,10	35.721,76
Lipjan	338,41	57.605,00	10,38	118.378,14
Malishevë	306,42	54.613,00	9,88	106.793,38
Mamushë	10,94	5.507,00	1,87	2.034,76
Mitrovicë e Jugut	329,35	71.909,00	10,24	145.781,30
Mitrovicë e Veriut	6,38	12.326,00	1,43	3.477,94
Novobërdë	203,98	6.729,00	8,06	10.735,79
Obiliq	104,84	21.549,00	5,78	4.647,93
Partesh	28,67	1.787,00	3,02	1.068,88
Pejë	602,63	96.450,00	13,85	264.494,93
Podujevë	632,59	88.499,00	14,19	248.650,46
Prishtinë	523,13	198.897,00	12,90	508.186,11
Prizren	626,86	177.781,00	14,13	497.233,49
Rahovec	275,90	56.208,00	9,37	104.295,06
Ranillug	77,62	3.866,00	4,97	3.804,86
Skënderaj	374,37	50.858,00	10,92	109.925,78
Suharekë	361,04	59.722,00	10,72	126.765,70
Shtërpçë	247,70	6.949,00	8,88	12.217,30
Shtime	134,42	27.324,00	6,54	35.388,81
Viti	269,69	46.987,00	9,27	86.198,54
Vushtri	344,85	69.870,00	10,48	144.942,45
Zubin Potok	334,38	6.616,00	10,32	13.514,67
Zveçan	123,01	7.481,00	6,26	9.268,72
TOTALI	10.905,25	1.780.021,00	58,92	20.765.035,85

Tabela e mësipërme tregon se është e arsyeshme të pritet që eliminimi i detyrimit të popullatës së rritur për të udhëtuar një herë në qendër të qytetit do të zvogëlojë kërkesën e udhëtimit me veturë për 20,765 milionë km. Meqenëse programi i zvogëlimit të barrës administrative parasheh thjeshtimin e një game të gjerë të Informatave të Obligueshme dhe praktikave administrative, ndikimi në mjedis nëpërmjet reduktimit të emetimeve të gazrave serrë mund të jetë substancial.

#### 4.4.2 Ndikimi mjedisor: konsumi i letrës

Një ndikim shtesë mjedisor mund të pritet nëpërmjet zvogëlimit të përdorimit të letrës. Zvogëlimi mund të pritet të ndodhë për shkak të zbatimit të strukturave të TI-së dhe/ose eliminimit/zvogëlimit/bashkimit të Informatave të Obligueshme dhe aktiviteteve administrative.

Tabela më poshtë tregon konsumin e letrës në të gjitha organet administrative - duke përfshirë qeverisjen qendrore dhe lokale - për periudhën prej 3 viteve. Inputi është i ndarë në 6 lote, ku secili lot përfaqëson organet administrative të njëjës nga gjashtë rajonet kryesore në Kosovë (Loti 1: Prishtinë, Loti 2: Pejë, Loti 3: Prizren, Loti 4: Ferizaj, Loti 5: Gjilan, dhe Loti 6: Mitrovicë). Ky informacion bazohet në informacionet në dispozicion lidhur me prokurimin publik<sup>203</sup>. Nga të gjitha lotet, Prishtina ka një nivel më të lartë të konsumit të letrës meqë përfshin edhe institucionet e qeverisë qendrore.

Figura 54 - Konsumi i letrës nga të gjitha organet administrative për periudhën prej 3 viteve

	<b>A4 (80g/m2)</b>	<b>A4 (100g/m2)</b>	<b>A3 (80 g/m2)</b>	<b>A4 (160g/m2)</b>	<b>TOTALI</b>
<i>Prishtinë</i>	43.288.500,00	890.000,00	1.228.000,00	178.000,00	45.584.500,00
<i>Pejë</i>	29.993.000,00	143.000,00	1.226.000,00	360.500,00	31.722.500,00
<i>Prizren</i>	34.904.000,00	76.000,00	365.000,00	55.000,00	35.400.000,00
<i>Ferizaj</i>	14.950.500,00	96.000,00	463.000,00	187.000,00	15.696.500,00
<i>Gjilan</i>	14.839.000,00	198.000,00	268.000,00	18.000,00	15.323.000,00
<i>Mitrovicë</i>	18.005.000,00	385.500,00	1.018.000,00	449.500,00	19.858.000,00
	<b>155.980.000,00</b>	<b>1.788.500,00</b>	<b>4.568.000,00</b>	<b>1.248.000,00</b>	<b>163.584.500,00</b>

Numri i përlogaritur i letrës së konsumuar gjatë një periudhe trevjeçare është rreth 163.584.500 fletë. Bazuar në të dhënat e prokurimit, ky numër mund të jetë deri në 30% ende më i lartë, pasi që rregullat e prokurimit e lejojnë një rritje të tillë të vlerës së kontratës. Në baza vjetore, konsumi i letrës është rreth 54,5 milionë fletë.

Duke supozuar se zvogëlimi i barrës administrative do të zvogëlojë konsumin e letrës për 40%, kursimi i përgjithshëm do të jetë 21,8 milionë fletë në vit. Duke qenë se 10.000 fletë të letrës janë të barabarta me një pemë, 2.180 pemë në vit do të kurseheshin në qoftë se të gjitha letrat nuk përfshijnë burimet e ricikluara.

Figura 55 - Konsideratat e ndikimit mjedisor për matjen bazë dhe vlerësimin e ndikimit të zvogëlimit të barrës

Koha dhe shpenzimet nga xhepi për karburante për udhëtime për shkak të kërkesës së përcaktuar në Informatat e Obligueshme dhe të përcaktuara në aktivitetet administrative duhet të merren parasysh gjatë matjes së barrëve administrative.

Përveç kësaj, me qëllim të vlerësimit të ndikimit në përdorimin e letrës, duhet të shtohet numri i faqeve për çdo procedurë në mënyrë që të bëhen parashikimet e duhura për zvogëlimin e konsumit të letrës që do të materializohet.

Për këtë qëllim, forma e matjes së barrëve administrative do të duhet të rregullohet në mënyrë që të inkorporojë këtë informacion për aktivitetin administrativ.

<sup>203</sup> <https://agp.rks->

[gov.net/Uploads/Documents/Kontrate%20Kornize%20per%20Furnizim%20me%20Leter%20per%20Kopje%20Lot%20 uyqcpaign.pdf](https://agp.rks.gov.net/Uploads/Documents/Kontrate%20Kornize%20per%20Furnizim%20me%20Leter%20per%20Kopje%20Lot%20 uyqcpaign.pdf)



## 4.5 Ndikimi buxhetor: afatshkurtër dhe afatmesëm

Opsionet e shqyrtuara në këtë Koncept Dokument kanë ndikime shumë të ndryshme në buxhet. Këto janë të përcaktuara në këtë nënkapitull.

### 4.5.1 Rritja e të ardhurave afatmesme buxhetore që rezultojnë nga rritja ekonomike

Zvogëlimi i barrës administrative pritet të çojë në rritjen ekonomike. Kjo rritje është rezultat i rritjes së aktivitetit të biznesit, krijimit të bizneseve, inovacionit dhe investimeve. Gjithashtu, pritet që të çojë në rritjen e numrit të vendeve të punës.

Rritja e aktivitetit të biznesit dhe më shumë vende pune krijojnë një bazë tatimore më të gjerë dhe më të thellë dhe kjo, nga ana tjetër, do të rrisë të ardhurat tatimore që do të grumbullohen.

Ndryshimet në rritjen ekonomike të parashikuara më sipër janë një reflektim i aktivitetit shtesë të biznesit që zvogëlimi i barrës administrative pritet të sjellë në bazë të hulumtimeve ndërkombëtare në këtë fushë. Kjo rritje ekonomike rezultojnë në një bazë tatimore më të gjerë dhe më të thellë për grumbullimin e tatimeve që ndryshojnë nga tatimet shtesë të biznesit, kontributet e punësimit dhe të ardhurat në rritje të TVSH-së. Tabela më poshtë tregon të ardhurat shtesë të pritura buxhetore që mund të pritet të ofrojnë barrët administrative. Këto të ardhura shtesë janë bazë për analizën makroekonomike të kosto-përfitimit për të krahasuar opsionet e paraqitura më poshtë.

#### Tatimet dhe ngarkesat e ndikuara

Analiza e ndikimit të secilit opsion në të ardhurat e qeverisë mbulon vetëm të ardhurat që lidhen drejtpërdrejt me rritjen e aktivitetit të biznesit. Këto përfshijnë katër tatimet në vijim:

- TVSH (kufitare dhe vendore)
- Tatimi mbi të ardhurat e korporatave
- Tatimi mbi të ardhurat personale
- Detyrimi doganor dhe akciza

Rritja e të ardhurave nga burimet e mësipërme gjatë viteve 2015-2018 ishte luhatur për shkak të faktorëve që janë të ndryshëm nga rritja e BPV-së. Rritja maksimale e të ardhurave gjatë kësaj periudhe ka ndodhur në vitin 2015 (21,80%), ndërsa BPV-ja ka shënuar një rritje prej 4,31%.

Meqenëse këto ndryshime vjetore nuk mund të parashikohen, parashikimi i përdorur në këtë Koncept Dokument bazohet në supozimin se rritja e të ardhurave tatimore është në përputhje me rritjen e BPV-së. Prandaj, trendi i mbledhjes së të ardhurave është përshtatur për të eliminuar faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në rritjen e të ardhurave.

Kombinimi i trendit të grumbullimit të të ardhurave (i përshtatur) dhe rritja e BPV-së për 2015-2018 dhe parashikimet për 2019-2021 të Ministrisë së Financave përdoren si bazë për një parashikim të rritjes konservative të BPV-së për 10 vitet e ardhshme.

Aplikimi i parashikimit të rritjes të BPV-së në parashikimin e të ardhurave rezultoi me një skenar të gjendjes fillestare (Opsioni 1) për të cilin nuk krijohet asnjë e ardhur shtesë buxhetore meqenëse opsioni nënkupton të mos fillohet me një program për zvogëlimin e barrës administrative. Përlllogaritjet e rritjes së BPV-së ofrojnë bazë për parashikimin e mbledhjes së të ardhurave për periudhën 10-vjeçare për secilin opsion përveç Opsionit 1. Diferenca midis parashikimit të mbledhjes së të ardhurave për çdo opsion me skenar të gjendjes fillestare (Opsioni 1) rezultojnë me rritjen e të ardhurave neto të paraqitura në figurën më poshtë.

Figura 56 - Rritja e pritshme në të ardhurat e qeverisë si rezultat i rritjes ekonomike për çdo opsion në vit

Viti	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5	Opsioni 6
1	-	-	-	-	-	-
2	-	-	-	-	-	-
3	-	-	-	-	-	-
4	-	-	-	-	-	-
5	-	€14 mil.	€7 mil.	€8 mil.	€8 mil.	€9 mil.
6	-	€36 mil.	€14 mil.	€17 mil.	€17 mil.	€19 mil.
7	-	€38 mil.	€23 mil.	€27 mil.	€27 mil.	€31 mil.
8	-	€40 mil.	€32 mil.	€38 mil.	€38 mil.	€43 mil.
9	-	€42 mil.	€43 mil.	€50 mil.	€50 mil.	€57 mil.
10	-	€45 mil.	€54 mil.	€63 mil.	€63 mil.	€72 mil.

#### 4.5.2 Efekti mbi të ardhurat buxhetore si rezultat i reduktimit të tarifave për marrjen e licencave dhe lejeve

Futja e LPPA-së dhe Parimit të Mospagimit të Procedurës nënkuptojnë se tarifatat për shërbimet e ofruara nga organet administrative duhet të mbulojnë kostot e vërteta të ofrimit të atij shërbimi.

Në planin afatshkurtër dhe në planin afatmesëm, kjo ulje e tarifave do të ofrojë një sfidë pasi të ardhurat e administratës do të bien. Kjo humbje e të ardhurave duhet të planifikohet dhe adresohet në mënyrë efektive në kombinim me zbatimin e programit të zvogëlimin të barrës administrative. Kjo do të zvogëlojë rrezikun e humbjes së konsiderueshme të të ardhurave që nuk kompensohen dhe kështu do të çonte në një deficit më të lartë buxhetor. Futja e Parimit të Mospagimit të Procedurës nuk duhet të rrezikojë stabilitetin financiar të Kosovës në asnjë mënyrë, e as nuk duhet të ndikojë në aftësinë financiare të Qeverisë për të adresuar çështje relevante për zhvillimin e vendit.

Ndikimi që zbatimi i Parimit të Mospagimit të Procedurës (sipas LPPA-së) pritet të sjellë është shumë i rëndësishëm.

Në dy tabelat e mëposhtme, buxheti, të ardhurat dhe përqindja e përgjithshme e shpenzimeve të këtyre të ardhurave janë paraqitur për Agjencinë për Produkte Medicinale të Kosovës dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës.

Figura 57 - Buxheti, të ardhurat dhe përqindja e shpenzimeve në të ardhurat totale të Agjencisë për Produkte Medicinale të Kosovës

Agjencia për Produkte Medicinale e Kosovës	2015	2016	2017	2018
Buxheti vjetor	1.201	1.358	1.101	1.133
Të hyrat	1.558	2.775	2.188	1.942
Përqindja e shpenzimeve në të hyrat totale	77,04%	48,94%	50,32%	58,34%

Figura 58 - Buxheti, të ardhurat dhe përqindja e shpenzimeve në të ardhurat totale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës

<b>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>
Buxheti Vjetor	2.233	1.732	1.724	2.187
Të hyrat	5.577	5.704	5.817	5.748
Përqindja e shpenzimeve në të ardhurat totale	30,89%	30,36%	30,50%	38,05%

Të dy shembujt tregojnë se të ardhurat buxhetore të krijuara nga dy agjencitë janë dukshëm më të larta se kostot aktuale të funksionimit. Kjo nënkupton që tarifatat e vendosura janë 40% deri 70% më të larta. Ky vlerësim është shumë i përgjithshëm pasi nuk përfshin analizën në lidhje me proceset aktuale për të cilat tarifatat paguhen.

Duke u bazuar në këta dy shembuj, supozimi i tanishëm i punës është një program gjithëpërfshirës për zvogëlimin e barrës administrative do të jenë në gjendje të kompensojnë një humbje të tillë të të ardhurave.

#### 4.6 Ndikimet në të drejtat themelore

Siç tregon Shtojca 11, barra administrative ka ndikim në fushën e të drejtave themelore. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve qeveritare dhe rritja e qartësisë dhe rrjedhimisht transparenca e këtyre proceseve pritet të përmirësojë trajtimin e barabartë para ligjit. Për më tepër, kjo do të çojë në një cilësi më të lartë të administratës dhe sigurimin e shërbimeve në përgjithësi. Gjithashtu, korniza e përmirësuar ligjore pritet të kontribuojë në forcimin e sundimit të ligjit.

Megjithatë, këto ndikime në të drejtat themelore që rezultojnë nga zvogëlimi i barrës administrative nuk mund të përcaktohen. Nuk ka informata specifike kombëtare që do të mundësonin këtë. Përveç kësaj, hulumtimi ekzistues ndërkombëtar dhe informacione të tjera lidhur me ndikimet në të drejtat themelore si rezultat i zvogëlimin të barrës administrative nuk i adresojnë këto çështje në atë masë sa që informacioni mund të përdoret për të forcuar analizën për këtë koncept dokument. Prandaj, megjëse nuk është e mundur të përcaktimi i ndikimeve mbi të drejtat themelore, ato do të vlerësohen veçmas në secilën nga opsionet e shqyrtuara në mënyrë cilësore. Kjo është adresuar në Kapitullin 6 dhe në veçanti në nënkaptullin që përcakton Analizën Shumëkriterëshe.

#### 4.7 Vlerësimi i ndikimit gjinor

Në këtë fazë të zhvillimit të Koncept Dokumentit është e paqartë nëse barrët administrative i prekin gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme në Kosovë. Prandaj nuk mund të parashikohet nëse zvogëlimi i barrës administrative do të çojë në ndikimet specifike që kanë të bëjnë me gjininë.

Dëshmitë bazuar në përvojën personale të një numri të caktuar të profesionistëve të konsultuar dhe të përfshirë në zhvillimin e këtij dokumenti, thonë se ofrimi i shërbimeve dhe procedurat administrative nuk janë veçanërisht më të vështira për gratë sesa për burrat gjatë ndërveprimit të tyre me administratën.

Përveç kësaj, Agjencia për Barazi Gjinore tregoi se ka të ngjarë që procedurat e përgjithshme administrative nuk priten të kenë një efekt të konsiderueshëm të gratë në Kosovë në krahasim me burrat. Çështja kryesore në Kosovë është e lidhur me trashëgiminë dhe mundësinë për të dëshmuar se një grua zotëron kolateralin e nevojshëm për të hapur një biznes. Mungesa e qartësisë, kohës së pritjes etj. - në këtë fazë të analizës - pritet të

ndikojnë në gra dhe burra në mënyra të ngjashme. Paralajmërimi duhet të sigurohet pasi që nuk ka literaturë të qartë për këtë temë dhe hulumtuesit nuk e kanë shqyrtuar këtë çështje në detaje në Kosovë.

Globalisht, mbështetja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave lidhet me mjedisin që mundëson biznesin, në të cilin zvogëlimi i barrës administrative do të japë një kontribut pozitiv, siç paraqitet në figurën më poshtë.

Mirëpo duke qenë se zvogëlimi i barrës administrative pritet të ketë ndikime pozitive në sferën shoqërore dhe ekonomike që ndërlidhen kryesisht me rritje ekonomike, hapjen e vendeve të reja të punës dhe zvogëlimin e varfërisë, ky program ka potencial të përmirësojë pozitën shoqërore dhe ekonomike të grave në shoqërinë Kosovare. Me zvogëlimin e kohës për procedura të caktuara administrative, rritet mundësia e grave që krahas obligimeve të mveshura nga rolet gjinore, do të kenë kohë zhvillimin e veprimtarive ekonomike. Veçanërisht gratë e zonave rurale të cilave ju nevojitet edhe më shumë kohë për të kryer procedura të caktuara administrative, do të kenë më shumë mundësi për të hapur biznese dhe për të përmirësuar veprimtarinë ekonomike.

Përveç kësaj, gjatë këtij programi, një numër i konsiderueshëm i ligjeve dhe akteve nënligjore, që kanë ndikim të ndryshëm tek gratë dhe burrat, do të rishikohet dhe masa të duhura duhet të ndërmerren për të adresuar nevojat e grupeve të ndryshme gjinore. Përmes procesit të zvogëlimit të barrës administrative, zbatimi i të gjitha politikave dhe masave zbatuese do të analizohet nga këndvështrimi i barrëve të cilat u krijohen qytetarëve dhe kompanive. Meqenëse vendimet të cilat do të çojnë në propozime për zvogëlimin e barrës administrative do të konsultohen me publikun, vitet në vijim paraqesin mundësi unike për rivlerësimin e kornizës legislative edhe nga aspekti i barazisë gjinore.

Figura 59 - Ekstrakt nga Nota Udhëzuese Kanadeze mbi fuqizimin ekonomik të grave në lidhje me proceset administrative

Nota Udhëzuese Kanadeze mbi fuqizimin ekonomik të grave<sup>204</sup>

#### Kapitulli 5.1.3. Mjedisi që mundëson biznesin

Rregulloret dhe shërbimet qeveritare mund të mos arrijnë të adresojnë nevojat e bizneseve të udhëhequra nga gratë, duke dekurajuar lëvizjen nga sistemi informal në atë formal dhe duke kufizuar krijimin e punësimit dhe produktivitetin. Për shembull, kufizimet më të mëdha kohore dhe të lëvizshmërisë nënkuptojnë që gratë do të kenë më shumë vështirësi në përfundimin e proceseve të rrepta të regjistrimit. Gratë gjithashtu kanë më shumë gjasa të përballen me diskriminimin (si p.sh. të anashkalohen gjatë pritjes në radhë ose t'u kërkohet ryshfet) dhe ngacmimet kur bashkëveprojnë me burokracinë për licencim dhe leje. Duke pranuar se pjesa më e madhe e vendeve të punës në vendet në zhvillim janë informale, sigurimi që mjediset që mundësojnë biznesin u përgjigjen bizneseve të udhëhequra nga gratë dhe nga burrat inkurajon nivele më të larta të formalitetit dhe mbështet rritjen e biznesit.

Për të bërë mjediset e biznesit më efikas dhe të përgjegjshëm për bizneset e udhëhequra nga gratë dhe nga burrat, programimi mund të funksionojë për:

- zvogëlimin e anshmërisë gjinore në proceset e nevojshme për fillimin dhe zgjerimin e një biznesi, duke përfshirë regjistrimin formal, licencimin dhe lejimin;
- rritjen e aftësisë së grave për të operuar një biznes, duke përfshirë administrimin e barrëve administrative dhe taksave; dhe
- përmirësimin e qasjes së grave në proceset e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve komerciale dhe përmirësimin e reagimit të drejtësisë komerciale ndaj bizneseve të udhëhequra nga gratë, duke përfshirë sektorin informal.

<sup>204</sup> Shih gjithashtu: [http://international.gc.ca/world-monde/issues\\_development-enjeux\\_developpement/priorities-priorites/women-femmes.aspx?lang=eng#a5\\_1\\_1](http://international.gc.ca/world-monde/issues_development-enjeux_developpement/priorities-priorites/women-femmes.aspx?lang=eng#a5_1_1), faqja e internetit është vizituar së fundmi më 22 shkurt 2018.

Megjithatë nuk mund të përjashtohet perceptimi dhe paragjykimi i përgjithshëm për rolin e grave në raport me burrat si dhe fakti se si janë të rregulluara rolet e burrave dhe grave rreth punëve të shtëpisë, kujdesit dhe edukimit të fëmijëve, se mënyra të caktuara të zbatimit të procedurave janë më të vështira për gratë. Procedura si e tillë nuk është më e vështirë, por mund të jetë orari i punës apo pamundësia për të nisur dhe/ose përfunduar shërbimet dhe procedurat administrative në formë elektronike.

Duhet theksuar se aspekti gjinor do të analizohet në përputhje me Mjetin 8 të “Udhëzuesit dhe Doracakut për Zhvillimin e Koncept Dokumenteve” pasi të përgatiten masat konkrete për zvogëlimin e barrës administrative përmes zhvillimit të programit për zvogëlimin e barrës administrative

## 4.8 Përmbledhje e ndikimeve të pritshme

Analiza tregon ndikimet kryesore që pritet të sjellë një program i zvogëlimit të barrës administrative.

Figura 60 - Ndikimet kryesore të identifikuara për çdo kategori

Kategoritë e ndikimit	Ndikimet relevante të identifikuara
<b>Ndikimet ekonomike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e BPV-së</li> <li>• Përmirësimi i bizneseve/klimës së investimeve</li> <li>• Krijimi i vendeve të punës</li> <li>• Krijimi i bizneseve</li> <li>• Përmirësimi i bilancit të importit dhe eksportit</li> <li>• Rritja e investimeve (në veçanti nga diaspora) dhe e IHD-ve (Investimet e Huaja Direkte)</li> <li>• Më shumë inovacione dhe hulumtime</li> </ul>
<b>Ndikimet sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i vendeve të punës</li> <li>• Zvogëlimi i varfërisë</li> </ul>
<b>Ndikimet mjedisore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk pritet ndonjë ndikim i veçantë</li> </ul>
<b>Ndikimet në të drejtat themelore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve qeveritare</li> <li>• Rritja e qartësisë dhe rrjedhimisht transparencës së shërbimeve qeveritare</li> <li>• Përmirësimi i trajtimit të barabartë para ligjit</li> <li>• Cilësia më e lartë e administratës dhe e ofrimit të shërbimeve në përgjithësi</li> <li>• Forcimi i sundimit të ligjit</li> </ul>
<b>Ndikimet gjinore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pritet përmirësim ekonomik dhe shoqëror i pozitës së grave në Kosovë</li> <li>• Duhet theksuar se aspekti gjinor do të analizohet në përputhje me Mjetin 8 të “Udhëzuesit dhe Doracakut për Zhvillimin e Koncept Dokumenteve” pasi të përgatiten propozimet për zvogëlimin e barrës administrative</li> </ul>

<b>Ndikimet në barazinë sociale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Efektet pozitive në personat që konsiderohen të jenë analfabetë funksionalë duke i përshtatur informacionet e qeverisë më shumë për nevojat e tyre, duke çuar në një ofrim më të mirë të shërbimeve dhe gëzimin e të drejtave</li> </ul>
<b>Ndikimet në rini</b>	Rritja e shanseve për të rinjtë për shkak të rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës. Pritet që veçanërisht të rinjtë të përfitojnë nga krijimi i vendeve të punës. Për shkak të natyrës së përgjithshme të programit të zvogëlimit të barrës administrative nuk u zbatua Vlerësimi i Ndikimit të Rinjtë.
<b>Ndikimet e barrës administrative</b>	Zvogëlimi i përgjithshëm i barrës administrative është qëllimi kryesor i politikës së propozuar në këtë Koncept Dokument
<b>Ndikimi në NMV</b>	Ndikimet do të jenë veçanërisht pozitive për NVM-të pasi ato përbëjnë shumicën dërrmuese të bizneseve në Kosovë; hulumtimet ndërkombëtare gjithashtu konfirmojnë se Informatat e Obligueshme janë gjithashtu relativisht më të vështira dhe të rënda për NVM-të meqë nuk kanë shkallën e përfitimeve që kanë kompanitë e mëdha; prandaj, NMV-të pritët të përfitojnë nga zvogëlimi i barrës administrative në veçanti. Për shkak të natyrës së përgjithshme të programit të zvogëlimit të barrës administrative nuk u zbatua Testi i NVM-ve.
<b>Ndikimi buxhetor</b>	I përshkruar më lart në përgjithësi dhe do të përcaktohet tutje përmes zhvillimit të Strategjisë për Rregullim më të Mirë.

#### 4.9 Analiza e ndjeshmërisë dhe sfidat me mbledhjen e të dhënave

Të dhënat e përdorura për analizën ekonomike rrjedhin nga përvoja ndërkombëtare me zvogëlimin e barrës administrative. Vlerësimet e nivelit të barrëve administrative në Kosovë supozohet të jenë në përputhje me përvojën e shteteve anëtare të BE-së. Megjithatë, situata në shtetet anëtare të BE-së është thellësisht e ndryshme në krahasim me situatën në Kosovë. Kjo vlen në lidhje me madhësinë e kornizës ligjore, nivelin e harmonizimit me Acquis e BE-së dhe nivelin e zbatimit të kornizës ligjore dhe rrjedhimisht numrit të Informative të Obligueshme të imponuara për bizneset, qytetarët dhe organet administrative.

Rreziku mund të jetë që niveli i barrëve administrative të mbivlerësohet ose të nënvlerësohet. Bazuar në të dhënat aktuale, nuk është e mundur të bëhen vlerësime përfundimtare të situatës. Pamja konkrete e nivelit të barrëve administrative pritët të bëhet e qartë vetëm gjatë zbatimit të programit. Përvoja në Holandë tregon se barrët administrative mund të nënvlerësohen lehtë, kështu që shtrirja e problemit me të vërtetë mund të duket të jetë shumë më e madhe nga ç'pritët aktualisht.

Përveç kësaj, nuk ishte e mundur të përcaktohej se deri në çfarë mase zvogëlimi i barrës administrative për qytetarët dhe administratën mund të etiketohej si dhënie e një kontributi relevant ekonomik. Supozimi se për të dy rastet kontributi është një e pesta e kontributit të drejtpërdrejtë të ofruar nga zvogëlimi i barrës administrative për kompanitë mund të jetë tejet i pasaktë dhe mund të mbivlerësohet dhe nënvlerësohet në këtë fazë.

Supozimet që mbështesin analizën do t'i prezantohen akterëve të ndryshëm dhe do të paraqiten gjatë konsultimit publik në internet.

## Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Një politikë e gjerë qeveritare që synon zvogëlimin e barrës administrative do të ketë ndikime të thella në funksionimin e administratës dhe mënyrën në të cilën zbatohen politikat dhe legjislacioni. Shpenzimet paraprake janë mjaft të qarta, pasi këto mund të përcaktohen në aspektin e stafit shtesë, investimet e nevojshme për të zbatuar masat e zvogëlimit të barrës dhe humbjen e të ardhurave që rrjedh nga një reduktim i licencave dhe tarifave si rezultat i zbatimit të LPPA-së.

Në të njëjtën kohë, zvogëlimi i barrës administrative ka një varg efektshë pozitive që sillen nga një klimë më e mirë investimi deri tek procedura më të qarta qeveritare dhe nga përmirësimi i bazës për "Sundimin e Ligjit" deri tek përmirësimi i të drejtave themelore. Për më tepër, zvogëlimi i barrës administrative do të kontribuonte drejtpërdrejt në procesin e integritimit evropian të Kosovës dhe kontribuon në arritjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Duke pasur parasysh këto dhe ndikime të tjera të thella, ky koncept dokument është konsultuar gjerësisht.

Rezultatet e aktiviteteve të konsultimit pasqyrohen në nënkapitujt e renditur më poshtë.

Qasja e konsultimeve ishte përshkruar Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2.0 2017 - 2021 për Kosovën. Kjo strategji përcaktoi, për shembull, synimin për të kryer katër aktivitete konsultuese të synuara për të vlerësuar pikëpamjet e bizneseve lidhur me barrët administrative. Siç shihet në pasqyrë, ky numër i takimeve u tejkalua pasi që katër nga këto takime u mbajtën në vitin 2018 dhe ato vazhduan në vitin 2019

### 5.1 Konsultimet e synuara dhe takimet me akterët

Figura më poshtë tregon takimet kryesore të mbajtura për zhvillimin e Koncept Dokumentit. Përmbledhja përmban takimet që janë mbajtur midis organeve përkatëse administrative dhe takimet e organizuara me akterët e jashtëm.

Figura 61 - Përmbledhje e aktiviteteve të brendshme, të synuara dhe të konsultimit publik në vitet 2018 dhe 2019

<p>Procesi i konsultimit synon të identifikojë mbështetjen për zvogëlimin e barrës administrative, të marrë shembuj konkretë se si barrët administrative ndikojnë negativisht në bizneset dhe të identifikojnë qasjen më të mirë të mundshme për zvogëlimin sistematik të barrës administrative</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, kolona për buxhet duhet të fshihet.]</li> <li>- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, titulli i kolonës 'Afati indikativ' duhet të ndryshohet në 'Kohëzgjatja'.]</li> </ul>					
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Personi/organizata përgjegjëse
<b>Vlerësimi i nevojës për Vlerësimin e Ndikimit Gjikor</b>	Agjencia për Barazi Gjinore	Diskutimi i aspekteve gjinore të zvogëlimit të barrës administrative dhe përcaktimi i nevojës për	Kontakt i drejtpërdrejtë	26 shkurt 2018	Mirlinda Lushtaku – Sekretariati Koordinues i Qeverisë



		Vlerësimin e Ndikimit Gjnjor			
<b>Testi i konkurrueshmërisë rregullative: Shqipëria</b>	Kabineti i Zëvendëskryeministrit të Shqipërisë; Zyra e Kryeministrit të Shqipërisë; Agjencia Kombëtare Shqiptare për Shoqërinë e Informacionit	Prezantimi i programit të Qeverisë së Shqipërisë për zvogëlimin e barrës administrative; prezantim nga AKSHShI mbi shërbimet e TI-së në Shqipëri	Kontakt i drejtpërdrejtë	30-31 gusht 2018	Arjeta Sahiti dhe Arife Gashi – Sekretariati Koordinues i Qeverisë
<b>Konsultimi i synuar me bizneset në sektorin e përpunimit të ushqimit</b>	Takimi me përfaqësuesin nga “Meka Mish”	Takimi për të diskutuar për barrët administrative me të cilat ballafaqohet organizata	Kontakt i drejtpërdrejtë	7 shtator 2018	Vjosa Hoxha – Sekretariati Koordinues i Qeverisë
<b>Konsultimi i synuar me bizneset në sektorin e përpunimit të ushqimit</b>	Takimi me përfaqësuesin nga veraria “Stonecastle”	Përgatitja e vizitës së kompanisë nga Grupi Punues	Kontakt i drejtpërdrejtë	13 shtator 2018	Vjosa Hoxha – Sekretariati Koordinues i Qeverisë
<b>Konsultimi i synuar me bizneset në sektorin e përpunimit të ushqimit</b>	Takimi me përfaqësuesin nga veraria “Stonecastle”	Takimi i Grupit Punues për të diskutuar për barrët administrative me të cilat ballafaqohet kompania	Kontakt i drejtpërdrejtë	3 tetor 2018	Arben Krasniqi – Drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë
<b>Pjesëmarrja në takimin për Strategjinë për Rregullim më të Mirë</b>	Shtetet anëtare të BE-së	Analizimi i përvojave nga shtetet anëtare të BE-së me zvogëlimin e barrës administrative dhe zbatimin e	Kontakt i drejtpërdrejtë	11 – 12 tetor 2018	Arben Krasniqi – Drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë

		programeve të zvogëlimit			
<b>Përcaktimi i shtrirjes së mundshme të programit për zvogëlimin e barrës administrative</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Diskutimi për rolin e pushtetit lokal në zvogëlimin e barrëve administrative	Kontakt i drejtpërdrejtë	24 tetor 2018	Arjeta Sahiti – Sekretariati Koordinues i Qeverisë
<b>Konsultimet e synuara në sektorin e hotelerisë, ushqimit dhe kujdesit ndaj kafshëve</b>	Takim me përfaqësues të “Four Paws International”	Takimi për të diskutuar për barrët administrative me të cilat ballafaqohet organizata	Kontakt i drejtpërdrejtë	5 dhjetor 2018	Vjosa Hoxha – Sekretariati Koordinues i Qeverisë
<b>Konsultime të synuara në lidhje me sektorin e prodhimit</b>	Takimi me Klubin e Prodhuesve të Kosovës	Takimi për të diskutuar për barrët administrative me të cilat përballen prodhuesit në Kosovë, bashkëpunimi në përgatitjen e takimit publik	Kontakt i drejtpërdrejtë	20 dhjetor 2018	Arben Krasniqi – Drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë
<b>Vedat Sagonjeva</b>	Anëtar	Ushtrues detyre i drejtorit	Zyra për Planifikim Strategjik, ZKM
<b>Ismet Cakiqi</b>	Anëtar	Koordinator	Zyra për Komunikim me Publikun, ZKM
<b>Shaban Ademi</b>	Anëtar	Ushtrues detyre i drejtorit	Zyra për Buxhet dhe Financa, ZKM
<b>Ibrahim Rrustemi</b>	Anëtar	Drejtor	Agjencia e Statistikave të Kosovës, ZKM
<b>Rexhep Bllaca</b>	Anëtar	Drejtor	Departamenti Ligjor, MTI
<b>Muhamet Hashani</b>	Anëtar	Zyrtar i lartë	Agjencia për Promovimin e Investimeve, MTI
<b>Naser Shamolli</b>	Anëtar	Drejtor	Departamenti Ligjor, MAP
<b>Alba Boshnjaku</b>	Anëtare	Zyrtare ligjore	Departamenti Ligjor, MIE
<b>Nida Krasniqi</b>	Anëtare	Zyrtare e lartë	Departamenti i Makros, MF
<b>Parim Bajrami</b>	Anëtar	Sekretar i Përgjithshëm	Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)

<b>Erik Akse</b>	Mbështetje teknike	Udhëheqës i ekipit - projekti Sida	Mbështetje e projektit për zhvillimin e politikave në kuadër të ZKM-së
<b>Jeton Oruçi</b>	Mbështetje teknike	Ekspert ligjor - projekti Sida	Mbështetje e projektit për zhvillimin e politikave në kuadër të ZKM-së
<b>Alban Kaçiu</b>	Mbështetje teknike	Specialist për kostimin dhe vlerësimin e ndikimit ekonomik - projekti Sida	Mbështetje e projektit për zhvillimin e politikave në kuadër të ZKM-së
<b>Jorinda Gacaferi</b>	Mbështetje teknike	Asistente e projektit - projekti Sida	Mbështetje e projektit për zhvillimin e politikave në kuadër të ZKM-së

## Shtojca 2: Teksti i plotë nga Programi i Qeverisë 2017-2021 lidhur me zvogëlimin e barrës administrative

### Skica e objektivave të Zyrës së Kryeministrit

#### 5. ZHVILLIMI I NJË SISTEMI RREGULLATIV LEHTËSUES PËR BIZNESET DHE QYTETARËT

Qeveria gjatë mandatit të saj zotohet në vendosjen e një sistemi rregullativ lehtësues për bizneset dhe qytetarët. Në këtë aspekt, aranzhimet e ndryshme të politikbërjes janë të nevojshme për të siguruar që legjislacioni i zhvilluar dhe i propozuar në kuvend të jetë i bazuar në dëshmi. Si rrjedhim, prioritet i qeverisë është rishikimi i procesit të zhvillimit të politikave për të siguruar se veglat e dhura të analizimit të propozim-politikave janë të vendosura dhe përdoren me rastin e propozimeve të reja. Fokus i veçantë do t'i kushtohet përdorimit të mjeteve që sigurojnë zhvillim të politikave miqësore për bizneset që ndër të tjerash janë si në vijim: Testi i NVM-ve, Modeli i Kostimit Standard dhe Testi i Konkurrueshmërisë Rregullative.

Qeveria e vetëdijshme se ngarkesat administrative dhe zbatimi joefikas i legjislacionit rëndojnë një ekonomi e cila synon rritjen. Gjithashtu, duke qenë të vetëdijshëm se këto ngarkesa reflektohen me shërbime joefikase për kompanitë të cilat ngarkohen me procedura administrative. Veçanërisht, ulja e ngarkesave administrative është e rëndësishme për secilin qytetarë të Kosovës dhe Qeveria zotohet që gjatë mandatit të saj t'i kushtoj kujdes që legjislacioni i propozuar është efektiv dhe efikas për zbatim nga bizneset.

Veç kësaj, Qeveria zotohet që të vendos bazat e bashkëpunimit të mirëfilltë me Kuvendin për të shikuar mundësitë e inicimit të një programi të përgjithshëm për thjeshtimin e procedurave administrative ku përfshirja e të gjitha palëve të interesuara do të bëhet përmes një Grupi të Nivelit të Lartë për ngarkesa administrative.

Kështu, Qeveria do të zotohet në zvogëlimin e numrit të licencave dhe lejeve për të siguruar zbatim më efektiv dhe efikas të kërkesave rregullative. Kjo do të bëhet në konsultim me të gjitha palët dhe duke u bazuar në diskutimet me komunitetin e biznesit.

Çdo Qeveri është e vetëdijshme që programet e tyre dhe strategjitë zbatohet përmes Planeve të Punës. Si rrjedhim, për të siguruar se prioritetet e Qeverisë zbatohen do të vendoset përfshirja e zbatimit të Planit Indikativ Shumëvjeçar të Punës së Qeverisë ku do të paraqiten të gjitha aktivitetet e planifikuara. Një plan i tillë mundëson monitorim të zbatimit të prioriteteve të Qeverisë.

Qeveria zotohet të forcojë komunikimin me publikun dhe ndërlidhjen me Prioritete të Qeverisë. Si rrjedhim, vendimet e rëndësishme do të komunikohen në mënyrë efektive që të arrijnë audiencën e pikësnyar. Për këtë qëllim synim i qeverisë është që përmes procesit të zhvillimit të Koncept Dokumentit për Përmirësimin e Komunikimit të Politikave të paraqes përmirësimet e nevojshme dhe fillimin e zbatimit të tyre.

Rregullorja e Punës së Qeverisë e miratuar në vitin 2011 do të rishikohet duke u bërë me fleksibilitet të arsyeshëm për përgatitjen e vendimeve nga Qeveria. Ndër të tjerash, rregullorja e rishikuar do të përmbajë edhe aspekte të Vlerësimit të Ndikimit që ka rëndësi kyçe në zhvillimin e politikave miqësore për bizneset. Kështu që synohet përditësimi i kësaj rregulloreje e cila siguron fleksibilitet për shumëllojshmërinë e vendimeve e Qeverisë.


Zbatimi i prioriteteve të lartpërmendura mund të bëhet vetëm përmes një riorganizim profesional të ZKM-së. Prandaj, Qeveria zotohet që riorganizimi i tillë të përfshijë aspekte të cilat sigurojnë zhvillimin e politikave më miqësore për bizneset dhe qytetarët

### Shtojca 3: Raporti i vitit 2016 nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë lidhur me rezultatet e konferencave me bizneset

Gjatë vitit 2016, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka realizuar 9 konferenca në Kosovë, 6 në nivel rajonal dhe 2 në nivel komunal. Gjatë këtyre konferencave, bizneset janë informuar rreth planeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me zhvillimin e sektorit privat dhe janë mbajtur diskutime lidhur me barrierat ndaj bizneseve.

Grafiku i mëposhtëm paraqet problemet e referuara gjatë konferencave, që hasen nga bizneset kryesisht nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Figura 67 - Problemet e identifikuar nga bizneset gjatë takimeve në konferencat rajonale



Në vazhdim janë paraqitur barrierat/pengesat më të mëdha për zhvillimin e bizneseve që rezultojnë nga këto konferenca me biznese të mbajtura në 6 rajone të Kosovës dhe në 3 komuna:

- Energjia elektrike;
- Konkurrenca e padrejtë;

- Taksa e akcizës për pije joalkoolike;
- Lënda e parë e përdorur për blloqet e argjilës jo e përfshirë në listën e produkteve të përjashtuara nga MF.

Probleme të tjera të hasura nga më pak se 3% e bizneseve janë: Investimet në pajisjet e energjisë elektrike (KEDS/KESDO kërkon pronësi të pajisjeve funksionale pa asnjë kompensim), normat e larta tatimore për pëlqimin për lidhjen në rrjetin e energjisë elektrike, çmimi i lartë për mirëmbajtjen e arkave fiskale, mospërjashtimi i makinerisë nga detyrimet doganore, makineria që duhet të shtohet në linjën e prodhimit, taksa prej 3% në produktet bujqësore, TVSH-ja për grantet, markat tregtare të mbrojtura në Kosovë nuk njihen jashtë vendit, numri i madh i licencave, si dhe procedura dhe kostot për rilicencim janë të njëjta me licencimin etj.

Shumë ndërmarrje prodhuese morën pjesë në konferencë dhe kanë listuar energjinë elektrike si problemin kryesor. Në përgjithësi, problemet kryesore të hasura nga bizneset në lidhje me energjinë elektrike janë:

- Ndërprerjet e energjisë elektrike;
- Maksigrafi (Treguesi i Kërkesës Maksimale);
- Çmimi i energjisë elektrike, gjegjësisht dallimi në mes të sezonit të dimrit dhe të verës;
- Linja e dobët e furnizimit me energji elektrike;
- Normat e larta tatimore për pëlqimin për lidhje me rrjetin e energjisë elektrike;
- Investimet në pajisjet e energjisë elektrike, KEDS kërkon pronësinë e pajisjeve pa asnjë kompensim etj.

#### **Rekomandimet:**

Sipas analizës, në vazhdim janë dhënë rekomandimet për t'i mbështetur NMVM-të në realizimin e aktiviteteve të tyre:

- Të konsiderohet dhe të investohet në konsolidimin e linjave të furnizimit me energji elektrike dhe, aty ku është e mundur, të krijohen linja të ndara për furnizim me energji elektrike për bizneset;
- Të largohet maksigrafi për bizneset prodhuese;
- Të eliminohen tarifat sezonale (verë-dimër);
- Të luftohet ekonomia informale duke ofruar masa zbutëse për bizneset që të fillojnë një biznes ose të dalin nga një biznes; ne rekomandojmë që të gjithë ndërmarrësit e gatshëm që të fillojnë një biznes të jenë të lirë nga të gjitha taksat dhe tarifat për të paktën 6 deri në 12 muaj;
- Të zhvillohet një plan i veprimit kundër konkurrencës së padrejtë;
- Të punohet në përfundimin e pakos fiskale dhe të parashikohet përjashtimi nga tatimi i lëndëve të para për pijet joalkoolike, i lëndëve të para për produktet tjera si argjila e përdorur për prodhimin e blloqeve, për pajisjet shoqëruese në linjat e prodhimit etj.
- Të konsiderohen taksat tjera që ndikojnë në koston e produkteve siç është rasti i taksës 3% për produktet bujqësore.
- Të konsiderohet mundësia e përjashtimit të tatimit për grantet.
- Të zvogëlohet numri i licencave.




## Shtojca 4: Raporti i vitit 2017 nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë lidhur me rezultatet e konferencave me bizneset

### REZULTATET NGA KONFERENCAT E REALIZUARA ME BIZNESET

Gjatë vitit 2017, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka realizuar gjashtë (6) konferenca në Kosovë, pesë (5) në nivel rajonal (në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj) dhe një (1) në komunën e Istogut. Gjatë këtyre konferencave, bizneset janë njoftuar rreth planeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zhvillimin e sektorit privat dhe janë mbajtur diskutime lidhur me barrierat ndaj bizneseve.

Më poshtë është paraqitur diagrami i problemeve me të cilat përballen bizneset, kryesisht ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, probleme që janë deklaruar gjatë këtyre konferencave.

Figura 68 - Problemet e identifikuara nga bizneset gjatë konferencës



Në vijim janë dhënë barrierat më serioze ndaj zhvillimit të bizneseve, që janë identifikuar nga gjashtë konferencat me biznese:

- Energjia elektrike, gjegjësisht ndërprerjet e paparalajmëruara, maxigrafi elektrik (Treguesi i Kërkesës Maksimale) dhe voltazhi i pamjaftueshëm.
- Dogana, pagesa e detyrimeve doganore për pajisjet ndihmëse për makineritë prodhuese, tatimi mbi lëndën e parë etj.
- ATK, adresimi i humbjeve dhe (mos-)fiskalizimi i kompanive, si dhe norma e shkallëzuar e TVSH-së, siç është 8% për ujin që vjen përmes sistemit të furnizimit me ujë dhe 18% për ujin në shishe.
- Subvencionet, mungesa e subvencioneve për prodhuesit.
- Eksporti, mbështetja për prodhuesit vendorë për të marrë pjesë në ngjarjet jashtë vendit.
- Licencat, licencimi dhe rilicencimi që shpenzojnë kohë dhe që kushtojnë shumë.
- Përpunimi i drurit, mbjellja dhe zëvendësimi i tyre me farëra të reja.
- Rastet gjyqësore, vonesat e rasteve në gjykata që marrin shumë kohë.
- Arsimimi jo i duhur, mungesa e shkollave profesionale.
- Problemet me përmbarues, përmbaruesit mbledhin taksat për të cilat kanë të drejtë dhe nuk merren shumë me rastet e marra përsipër.
- Importi, produktet e gatshme që importohen në Kosovë vijnë me çmim më të ulët sesa lënda e parë që importojmë nga vendet tjera.

#### **Rekomandimet:**

Sipas analizës, në vazhdim janë dhënë rekomandime për t'i mbështetur NMVM-të në realizimin e aktiviteteve të tyre:

- Të konsiderohet dhe të investohet në konsolidimin e linjave të furnizimit të energjisë elektrike dhe, aty ku është e mundur, të krijohen linja të ndara për furnizim me energji elektrike për bizneset;
- Të hiqet maksigrafi për bizneset prodhuese;
- Të vendosen taksa për këto produkte të importuara në Kosovë në një çmim më të ulët sesa lënda e parë në vend;
- Të hiqen detyrimet doganore për pajisjet ndihmëse për makinerinë prodhuese;
- Të ndihmohen financiarisht (të paktën 50%) ndërmarrjet e eksportit për ekspozimin e produkteve jashtë vendit;
- Të ushtrohet presion në gjykata për zgjidhjen e rasteve për periudhë më të shkurtër kohore;
- Të zhvillohet një plan i veprimit kundër konkurrencës së padrejtë;
- Të zvogëlohet numri i licencave.

## Shtojca 5: Lëndët administrative të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura - VJETORI-2018

Lëndët administrative të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura

VJETORI-2018

Emërtimi i Gjykatës Themelore - Degës: Prishtinë

Llojet e kontesteve		Lëndë të pazgjidhura në fillim	Lëndë të pranuar	Gjithsej lëndë në punë	Numri i lëndëve të zgjidhura sipas mënyrës së zgjidhjes										Gjithsej (kol.4+kol.5+kol.6+kol.7+kol.8+kol.9+kol.10+kol.11+kol.12)	Lëndë të pazgjidhura në fund
					Me Aktgjykim Gjykses				Me marrëveshje gjyqësore	Me hedhje poshtë të padisë	Me tërheqjen e padisë	Ndërrpritet procedura	Është zgjidhur në mënyrë tjetër			
					Në bazë të pranimit	Në bazë të mungesës	Në bazë të shqyrtimit kryesor									
							Aprovohet padia	Refuzohet padia								
a	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	
1	Gjobë	34	308	342	0	0	88	94	0	43	48	16	7	296	46	
2	Tatim	731	190	921	0	0	75	79	0	9	17	10	1	191	730	
3	Objekt	5	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5	

4	Pronësi	214	40	254	0	0	8	16	0	3	0	3	0	30	224
5	Kadastër	470	127	597	0	0	16	17	0	10	12	5	0	60	537
6	Regjistrim prone	6	0	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
7	Banesë	75	0	75	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	75
8	Blerje akcizma	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
9	Shpronësim	65	5	70	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	70
10	Punë	561	311	872	0	0	54	71	0	4	20	3	1	153	719
11	Mbyllja e zyrës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	Rrugë	56	0	56	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	56
13	Me aftësi të kufizuara	372	455	827	0	0	156	181	12	39	56	26	13	483	344
14	Pension invalidor	130	170	300	0	0	12	19	0	2	0	3	0	36	264
15	Borxh	15	0	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	15
16	Tender	245	60	305	0	0	13	15	0	0	0	0	0	28	277
17	Vlerësim i ligjshmërisë	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
18	Licencë	80	5	85	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	85
19	Pension	118	53	171	0	0	26	33	8	8	17	8	0	100	71
20	Heshtje administrative	158	115	273	0	0	17	14	0	8	10	7	4	60	213
21	Leje	21	0	21	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	21
22	Specializim	9	0	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9
23	Lokal	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
24	Pronë e patundshme	6	0	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
25	Barna të konfiskuara	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1

26	Leje ndërtimi	10	0	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10
27	Uzarpim	6	0	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
28	Tatim në pronë	213	85	298	0	0	16	27	9	13	10	9	0	84	214
29	Leje pune	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
30	Kompensim pronësie	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
31	Ndërtim	10	0	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10
32	Siguria në punë	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
33	Mësimdhënës	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
34	Patundshmëri	20	0	20	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20
35	Eksproprijim	11	0	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	11
36	Push.fungjyqtar	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
37	Masa disiplinore	7	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7
38	Ndihma sociale	272	13	285	0	0	22	24	0	9	5	11	3	74	211
39	Shtetësia	180	44	224	0	0	13	8	5	3	10	5	9	53	171
40	Polic e sigurimeve	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
41	Kompensim page	51	5	56	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	56
42	Patentë shoferi	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
43	Masë e përkohshme	17	10	27	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	27
44	KEK	18	35	53	0	0	4	3	0	0	0	0	0	7	46
45	Shfrytëzim energjie	19	0	19	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	19
46	Kompensim dëmi	99	20	119	0	0	4	5	0	0	0	0	0	9	110
47	Anulim vendimi	104	180	284	0	0	41	25	6	17	34	2	7	132	152

48	Emërim i gjyqtarit	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
49	Leje qëndrimi	10	0	10	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	9
50	Konkurse	44	70	114	0	0	7	10	0	2	0	3	0	22	92
51	Dogana	189	461	650	0	0	128	116	1	23	18	13	7	306	344
52	Nisje relacioni	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
53	Objekt ndërtimi	21	0	21	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	21
54	Brezi rrugor	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
55	Ndërtim banesash	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
56	Taksë	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
57	Dekspropoim	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
58	Shtetësi-azil	36	35	71	0	0	13	8	0	3	0	0	0	24	47
59	Monument kulturor	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
60	Kërkesë administrative	21	0	21	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	21
61	Regjistrim	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
62	Dëm	5	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
63	Shkelje disiplinore	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
64	Operim taksie	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
65	Kontratë	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
66	Pagese shpenzimesh	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
67	Kyçje në rrugë	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
68	Leje urbane	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
69	Shkelje e kodit të etikës	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4

70	Noter-anulim vendimi	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
71	Regjistrim biznesi	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
72	Barazim i të hyrave	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
73	Kërkim	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
74	Shfrytëzim	1	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0
75	Vonesa dërgimi	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
76	Grada akademike	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
77	Qëndrim	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
78	Financiare	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
79	Likuidim i mallit	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
80	Konfiskim i mjetit	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
81	Shitje e aksioneve	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
82	Ndihmë	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
83	Ndërrim i emrit	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
84	Sende	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
85	Naftë	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
86	Përkujdesje e fëmijëve	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
87	Libri amë	7	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7
88	Kthim i automjetit	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
89	Invalid i luftës	54	119	173	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	173
90	Mosnjohje e gradës	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
91	Anulim njoftimi	1	15	16	0	0	0	5	0	4	2	3	2	16	0

92	Viti i lindjes	37	10	47	0	0	3	3	0	4	3	0	0	13	34
93	Gurthyes	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
94	Ndalim mase	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
95	Bursë	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
96	Ndërtim varrezash	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
97	Linja e transportit	5	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
98	Siguri	20	0	20	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20
99	Lejim i shfrytëzimit të tokës	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
100	Kthimi i mallit	5	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
101	Vlerësim i pronës	6	0	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
102	Akomodim i personave të riatdhesuar	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
103	Shfrytëzim i tokës	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
104	Kundërvajtje doganore	0	35	35	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	35
105	Të tjera	355	32	387	4	0	7	6	1	5	0	1	16	40	347
Gjithsej		5304	3008	8312	4	0	723	780	42	209	262	128	71	2219	6093



## Shtojca 6: Përmbledhje e ministrive dhe agjencive rregullative përgjegjëse për legjislacionin që vendos Informata të Obligueshme ndaj kompanive

Spektori NACE	Institucioni përgjegjës
<b>Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>Minierat dhe guroret</b>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (me përjashtim të AKRB-së)
<b>Industria përpunuese</b>	Ministria e Financave Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale Ministria e Zhvillimit Ekonomik Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (me përjashtim të AKRB-së) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë Ministria e Punëve të Brendshme Komisioni i Pavarur i Mediave
<b>Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar</b>	Ministria e Financave; Zyra e Rregullatorit të Energjisë; Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Komisioni i Pavarur i Mediave
<b>Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e rehabilitimit</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (me përjashtim të AKRB-së) Zyra e Rregullatorit të Ujërave dhe Ujërave të Zeza
<b>Ndërtimi</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Punëve të Brendshme;

<b>Tregtia me shumicë dhe pakicë</b>	<p>Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale</p> <p>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;</p> <p>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (me përjashtim të AKRB-së)</p> <p>Ministria e Financave</p> <p>Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale</p> <p>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor</p> <p>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë</p> <p>Komisioni i Pavarur i Mediave</p>
<b>Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit</b>	<p>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (me përjashtim të AKRB-së)</p> <p>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor</p> <p>Komisioni i Pavarur i Mediave</p>
<b>Transporti dhe magazinimi</b>	<p>Ministria e Infrastrukturës</p> <p>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</p> <p>Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës</p> <p>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor</p> <p>Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë</p> <p>Komisioni i Pavarur i Mediave</p>
<b>Informimi dhe komunikimi</b>	<p>Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare</p> <p>Komisioni i Pavarur i Mediave</p> <p>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</p>
<b>Aktivitetet financiare dhe të sigurimit</b>	<p>Ministria e Financave</p> <p>Banka Qendrore</p>
<b>Aktivitete të pasurisë së patundshme</b>	<p>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor</p>
<b>Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike</b>	<p>Ministria e Drejtësisë</p>

	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (me përjashtim të AKRB-së)
	Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale
<b>Aktivitetet administrative dhe të shërbimit mbështetës</b>	Ministria e Drejtësisë; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (me përjashtim të AKRB-së)
<b>Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>Arsimi</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
<b>Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe punës sociale</b>	Ministria e Drejtësisë Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
<b>Art, argëtim dhe rekreacion</b>	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>Aktivitete tjera të shërbimit</b>	Asnjë, vetëm të përgjithshme

## **Shtojca 7: Ekstrakte nga raportet e BE-së të viteve 2014, 2015 dhe 2016 për Kosovën, veçanërisht duke iu referuar barrëve administrative dhe mjedisit të biznesit**

### *Raporti për Kosovën – 2018*

Faqe 5: Sa i përket përafrimit me standardet evropiane, Kosova është në një fazë të hershme. Përafrimi legjislativ ka vazhduar në disa fusha, por implementimi është i dobët. Pak përparim është arritur në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, prokurimit publik dhe konkurrencës, bashkë me përmirësimin e mjedisit afarist. Në fushën e tatimit dhe doganës, pak progres është bërë edhe në vjeljen e të ardhurave dhe thjeshtimin e procedurave administrative, por Kosova duhet të përforcojë veprimet e veta në luftimin e ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal. Sektori i energjisë vazhdon të përballet me sfida serioze. Asnjë lloj progresi nuk është arritur në adresimin e çështjeve mjedisore. Përgjithësisht, Kosova duhet të përmirësojë kapacitetet dhe bashkërendimin e saj administrativ, në të gjithë sektorët, për të siguruar zbatim efektiv të acquis.

Faqe 10: Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

të përmirësojë parashikueshmërinë juridike për qytetarë dhe biznese duke ndryshuar e plotësuar gradualisht ligjet speciale të identifikuar dhe aktet zbatuese që janë në kundërtënie me Ligjin e ri për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe të adresojë çështjet e prapambetura administrative.

Faqe 12: Kosova duhet të miratojë një ligj të ri për kontestet administrative për të përforcuar të drejtën e qytetarëve për drejtësi administrative. Gjykata Themelore e Prishtinës ka ngarkesë substanciale të rasteve të prapambetura administrative, të cilat duhen adresuar vazhdimisht.

Qeveria promovon administratën e orientuar kah shfrytëzuesi, por mungesa e vizionit të qartë, lidhshimit dhe bashkërendimit pengojnë përpjekjet reformuese. Shumë institucione kanë filluar të implementojnë zgjidhje vetanake jashtë mjeteve qendrore të identifikimit elektronik (eID) që po zhvillohen. Veglat qendrore për mbledhjen e informatave nga publiku dhe bizneset janë në fazë të hershme të zhvillimit. Zgjidhjet teknike për interoperabilitet nuk janë të zhvilluara ende. Legjislacioni për qasje të barabartë në shërbime ekziston, por zbatimi i tij është sfidues, sidomos kur bëhet fjalë për personat me lëvizshmëri të kufizuar.

Thjeshtimi i procedurave administrative ka ecur përpara me hyrjen në fuqi të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në qershor të vitit 2017. Qeveria ka krijuar një inventar të ligjeve që përmbajnë procedura të posaçme administrative. Këto ligje tash duhen ndryshuar për të hequr kundërtënie me ligjin e ri. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të informuar dhe edukuar administratën dhe publikun në Kosovë për detyrimet dhe të drejtat sipas ligjit të ri.

Faqe 39: Eksportet e rritura të shërbimeve kanë ndihmuar në ngushtimin e deficiteve të jashtme. Deficiti i llogarive rrjedhëse është tkurrur në 5.9% të BPV-së më 2017, krahasuar me 9.1% të BPV-së më 2016. Kjo kryesisht ka ardhur për shkak të rritjes së fortë të eksportimit të shërbimeve. Ndryshimet metodologjike në llogaritjet e veprimtarisë ekonomike të diasporës së Kosovës që kthehet kohë pas kohe do të mund të shpjegojnë një ndryshim kaq të madh dhe rënie të konsumit privat që janë përmendur më sipër. Deficiti tregtar i mallrave është rritur me 1 pikë përqindjeje në 38.9 % të BPV-së. Dërgesat nga diaspora, një burim i rëndësishëm i të ardhurave për shumë familje të Kosovës, janë rritur në 12% të BPV-së më 2017. IHD-të neto janë rritur me 3.9% të BPV-së, krahasuar me 2.9 % të BPV-së më 2016. Rrjedhat hyrëse të IHD-ve kanë qenë edhe më të koncentruara më 2017, duke marrë parasysh hiset e pronës së paluajtshme, ndërtimit dhe sektorit financiar, IHD-të janë rritur

në 97.1%. Rrjedhat hyrëse në sektorët prodhues ka qenë negative. Kjo reflekton një mjedis të dobët afarist dhe pak mundësi investimi “parësore” (greenfield).

Page 41: Është arritur progres i konsiderueshëm në përmirësimin e ambientit afarist. Është vendosur një sistem elektronik për raportimin dhe pagesën e TVSH-së dhe kontributeve sociale, duke lehtësuar pagesat tatimore për biznese. Periudha kohore që është dashur për eksportim, si dhe kostoja e përputhshmërisë rregullative për të mundësuar eksportin, u zbutën për shkak të një sistemi menaxhues të dhënash automatike doganore më të mirë, harmonizimit të proceseve të zhdoganimit, si dhe implementimit të korridorit transit Shqipëri-Kosovë. Fillimi i biznesit është bërë më i lehtë duke iu falënderuar një sistemi elektronik të regjistrimit të bizneseve, si dhe thjeshtësimit të procesit të regjistrimit të punëtorëve. Qasja në kredi është bërë më e lehtë me miratimin e rregullave të qarta prioritare në procedurat e bankrotimit për kreditorë të siguruar. Zgjidhja e paaftësisë së pagesës është bërë më e lehtë me vendosjen e kornizës ligjore për paaftësinë e pagesës së korporatave. Ligji i ri për Shoqëritë Tregtare do të thjeshtojë edhe më shumë procedurat e regjistrimit të bizneseve, si dhe të sjellë ndryshime në qeverisjen korporative.

Përkundër përparimit në rregulla ligjore për bizneset, mbesin ende shumë pengesa. Më 2017, Kosova ishte njëra prej 10 reformatoreve më të mëdha sipas Raportit të Bankës Botërore të të Bërit Biznes (Doing Business). Megjithatë, barrierat kryesore ndaj biznesit vazhdojnë të jenë administrata e dobët dhe jollogaridhëne, sundimi i dobët i ligjit, korrupsioni dhe ekonomia joformale mjaft e përhapur. Edhe pse informaliteti mbetet i lartë, rreth 30% e BPV-së, studime të ndryshme theksojnë rënien e vazhdueshme të tij ndërmjet viteve 2013 dhe 2015, për shkak të efektshmërisë së rritur të praktikave të administratës tatimore. Megjithatë, ekonomia e zezë është rritur në terma absolutë. Sektori i ndërtimit dhe ai tregtar kanë pësuar humbjet më të mëdha në të ardhura për shkak të informalitetit. Sistemi gjyqësor vuan nga qasshmëria e dobët, joefikasiteti dhe vonesat. Shumë pak përparim është shënuar në zvogëlimin e masës së rasteve të pazgjidhura në gjykata.

Page 53: Kosova ka përgatitje mesatare në fushën e doganave. Ka pasur pak përparim, sidomos në implementimin e deklarimeve pa letër dhe thjeshtimin e procedurave administrative.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të përafrojë më tutje legjislacionin doganor, duke përfshirë kodin doganor dhe të akcizës, me Kodin doganor të BE-së dhe *acquis* për akcizën;
- të përshkallëzojë bashkërendimin ndërmjet Doganës së Kosovës, agjencive për zbatimin e ligjit dhe institucioneve tjera relevante në luftimin e ekonomisë joformale dhe mashtrimeve doganore.

Page 65: Politika e ndërmarrjeve dhe ajo industriale

Kosova është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë. Pak progres është arritur duke marrë masa për përmirësimin e ambientit afarist. Ekziston nevoja për të zhvilluar më tutje kapacitetin administrativ dhe për të përforcuar bashkërendimin ndërministror.

Rekomandimet nga raporti i vitit 2016 nuk janë zbatuar plotësisht. Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të zbatojë vlerësimet e ndikimit rregullativ për të zvogëluar ngarkesën administrative mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- të vazhdojë implementimin e rekomandimeve të dhëna në vlerësimin “Small Business Act” (SBA) të BE-së;
- të sigurojë përafrimin e Ligjit për Zonat Ekonomike me *acquis*.

## *Raporti për Kosovën – 2016*

Page 12: “Ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset: Qeveria është e angazhuar për një administratë të orientuar drejt përdoruesit. Megjithatë, politikbërja koherente shpesh është dëmtuar nga mungesa e koordinimit dhe vizionit të përbashkët midis ministrive përgjegjëse. Zhvillimi i shërbimeve elektronike është i ngadalshëm për shkak të mungesës së një kornize të përshtatshme të ndërveprimit. Legjislacioni mbi qasjen e barabartë në shërbime ekziston mirëpo aplikimi i tij mbetet një sfidë, sidomos për personat me nevoja të veçanta. Progres i mirë është arritur me thjeshtimin e procedurave administrative në saje të miratimit të ligjit të ri mbi procedurat e përgjithshme administrative. Megjithatë zbatimi i ligjit kërkon një inventar paralel të procedurave speciale administrative, të cilat duhet ose të hiqen ose të vihen në përputhje me ligjin.”

Page 34: “Në përputhje me udhëzimet e politikave ERP dhe në mënyrë që të mbështetesë rritjen afatgjatë në vitet e ardhshme Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- sigurimit të qëndrueshmërisë fiskale, sidomos duke krijuar një organ të pavarur fiskal dhe duke forcuar planifikimet e pavarura;
- përmirësimit të efikasitetit të shpenzimeve kapitale, veçanërisht nëpërmjet përmirësimeve në përgatitjen e projekteve dhe kapacitetet menaxhuese në nivel qendror dhe lokal;
- përmirësimit të procedurave të falimentimit dhe paaftësisë paguese.”

Page 37: “Mjedisi i biznesit - Janë bërë disa përparime në thjeshtimin e procedurave të regjistrimit të biznesit dhe të falimentimit. Krijimi i 29 kompanive të cilat ofrojnë shërbime të shumëfishta ka zvogëluar në tri ditë kohën e nevojshme për të regjistruar një kompani. Megjithatë regjistrimi online i paralajmëruar nuk është zbatuar plotësisht. Pengesat kryesore përfshijnë administratën e dobët dhe të papërgjegjshme, infrastrukturën e pazhvilluar (sidomos furnizimin jo të besueshëm të energjisë elektrike), sundimin e dobët të ligjit, korrupsioni, ekonominë e përhapur joformale dhe rezultatet e dobëta të arsimit. Kishte një rritje prej 4.6% të numrit të ndërmarrjeve të sapoformuara, kryesisht në sektorin e bujqësisë. Një ligj i miratuar së fundmi për falimentimin pritet të përmirësojë daljen në treg dhe të përshpejtojë pagesat për kreditorët.

Pavarësisht përparimit të bërë në rregullat ligjore që rregullojnë bizneset, ato ende nuk zbatohen sa duhet. Kapaciteti shumë i dobët institucional për të zbatuar ligjin, i kombinuar me korrupsionin e përhapur, vazhdon të ndikojë negativisht në mjedisin e biznesit. Sistemi gjyqësor vuan nga qasja e dobët, joefikasitetit dhe vonesat. Pak progres është shënuar në zgjidhjen e rasteve të grumbulluara në gjykata (400 000 në korrik 2015). Ndryshimet e miratuara në ligjin për procedurat e zbatimit duhet të kontribuojnë në efikasitetin e rasteve komerciale dhe në përmirësimin e zbatimit të kontratave dhe grumbullimeve. Puna e mëtejshme është e nevojshme për rishikimin e kodit civil mbi paditë dhe praktikat e biznesit dhe zhvillimin e bazës së të dhënave mbi pronat (kadastrin).”

Page 44: “Në fushën e shërbimeve financiare, Banka Qendrore ka vazhduar rishikimin e legjislacionit ekzistues të shërbimeve financiare. Tregu i shërbimeve financiare dhe mbikëqyrja e sektorit të sigurimeve janë ende në një fazë të hershme të zhvillimit. Qasja e standardizuar për rrezikun e kredisë, treguesit bazë dhe qasja e standardizuar për rrezikun operacional, sipas Shtyllës I të standardeve të Basel II janë në fuqi. Kërkesa ligjore për raportin e kapitalit bazë është 12%, por raporti aktual është rreth 16%. Kërkesat e kapitalit për rrezikun e tregut në përputhje me qasjen e standardizuar dhe harmonizimin e përkufizimit të kapitalit me Basel III ende duhet të paraqiten. Transparenca në sektorin e sigurimeve duhet të përmirësohet duke publikuar raporte vjetore, duke përmirësuar besueshmërinë e auditimeve të pasqyrave financiare të kualifikuara, dhe duke aplikuar standardet më të rrepta për dhënien e licencave të kompanive të reja.”

**Faqe 54:** “Kosova ka nivel të përgatitjes në politikën e industrisë dhe NVM-ve. Janë bërë disa përparime në këtë fushë, sidomos me krijimin e një skeme të garantimit të kredive për t’i mbështetur NVM-të. Siç është rekomanduar vitin e kaluar, Kosova duhet që në veçanti:

→ të ndjek rekomandimet nga vlerësimi i ' Aktit të bizneseve të vogla' të BE-së;

→ t’i paraqes vlerësimet rregullative të ndikimit për të zvogëluar barrën administrative të NVM-vë

Për sa i përket politikës industriale dhe NVM-ve, implementimi i strategjisë zhvillimore të sektorit privat në Kosovë 2013-2017 po ecën ngadalë, ndërkohë që strategjia industriale duhet ende të finalizohet. Të dyja këto duhet të jenë një linjë me strategjinë e zhvillimit kombëtar 2016-2020 të miratuar në janar të vitit 2016. Nuk ka pasur asnjë raport pasues për vlerësimin e “Aktit të bizneseve të vogla ' të BE-së që nga raporti i vendit i vitit të kaluar. Rekomandimet siç janë, zgjerimi i mbledhjes së statistikave të NVM-ve, komunikimi dhe koordinimi ndërmjet agjencisë Kosovare për Investime dhe Mbështetje të Ndërmarrjeve (KIESA) dhe ministritë përkatëse, nuk kanë pasur asnjë përmirësim. Në mars të vitit 2016, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me mbështetjen e disa donatorëve ka krijuar një skemë të garantimit të kredive, e cila do të sigurojë mbulimin e pjesëshëm të kërkesave indirekte në portofolet e huave të NVM-ve, të bankave pjesëmarrëse në skemë.

Mungesa e vlerësimit të ndikimit rregullativ, përfshirë testet e NVM-ve, mbeten një faktor kyç në barrën administrative, duke ndikuar tek NVM-të, ndërsa dështimi për t’i monitoruar dhe për t’i bërë me kohë strategjitë kohore dhe planet e veprimit e kufizojnë aftësinë e Kosovës për të arritur progres real. Kapaciteti i KIESA-së duhet të rritet në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë misionin dhe objektivat e saj. Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet profesionalizimit të institucionit dhe aplikimit të procedurave të punësimit në bazë të meritave. Prioritet duhet t’i jepet zhvillimit të një strategjie promovuese të eksportit dhe programit përkujdesës për investimet e huaja. Parimi ‘heshtja-është-pajtim’ për regjistrimin e biznesit dhe regjistrimit online të kompanisë ende nuk është futur. Pengesat kryesore për zhvillimin e NVM-ve dhe rritje të mëtejshme, mbesin qasja e kufizuar në financa, zbatimi i dobët i kontratave dhe rregullave të biznesit, pengesat administrative, konkurrenca e padrejtë nga sektori joformal, gjyqësori joefikas dhe korrupsioni.”

**Faqe 60:** “Ka pasur shumë pak progres në sektorin e energjisë së ripërtëritshme. Harmonizimi me direktivën për burimet e rinovueshme të vitit 2009 ka qenë në shënjestër të ndryshimeve në ligjet për energjinë dhe rregullatorin e energjisë, të miratuar në qershor të vitit 2016. Ndërsa plani veprues 2013-2020 për rinovueshmërinë dhe efikasitetin e energjisë në Kosovë, parashikon një pjesë shumë ambicioze të ripërtëritjes me 29.47% deri në vitin 2020, tashmë ka shumë pak gjasa që Kosova të mund ta plotësoj edhe objektivin e detyrueshëm prej 25%. Kjo në veçanti ka ndodhur për shkak të neglizhencës së këtij sektori që i është bërë me vite, për shkak të mos efikasitetit të kuadrit rregullator (veçanërisht procedurat e zgjatura administrative në dhënien e lejeve dhe licencave të ndryshme) dhe kapacitetit të dobët administrativ në menaxhimin e ripërtëritjes.”

### *Raporti për Kosovën – 2015*

**Faqe 36:** “Rekomandimi 8 i PRE-së: "Të vazhdohet me përmirësimin e mjedisit afarist dhe të gjenden zgjidhje për rastet ende të pazgjidhura nëpër gjykata; të fuqizohen kapacitetet e sistemit gjyqësor dhe zhvillimi i bazave të të dhënave për kadastrën; të avancohen masat për trajtimin e joformalitetit në përputhje me strategjinë për parandalimin e luftës kundër ekonomisë joformale, përfshirë këtu stimulimet për zvogëlimin e punës së padeklaruar. Të zvogëlohet barra administrative për biznesin përmes implementimit të Strategjisë për Rregullim më të Mirë dhe Ligjit për Leje dhe Licenca. Të zhvillohen masat për të ofruar mbështetje për NMV-të dhe për të zgjeruar qasjen e tyre në financa. Luftimi i korrupsionit dhe përpjekjet për përmirësimin e prokurimit publik,

përmes zgjerimit të kapaciteteve administrative, rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të Bordit për Rishikim Publik, dhe implementimit të prokurimit qendror."

**Faqe 47:** "Kosova ka pak nivel përgatitjeje në industri dhe në NVM. Pak progres është shënuar në këtë fushë. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti të:

→ ndjekë rekomandimet e vlerësimit "Akti i Bizneseve të Vogla";

→ paraqesë vlerësimet për ndikimin e rregullatorit për zvogëlimin e barrës administrative të NVM-të

Sa i përket politikës industriale dhe NVM-ve, zbatimi i strategjisë së Kosovës për zhvillimin e sektorit privat 2013-2017 dhe "Akti i Bizneseve të Vogla" i BE-së po avancojnë ngadalë. Komunikimi në mes të ministrive dhe agjencive ekzekutive duhet të përmirësohet. Për të zvogëluar barrën administrative në NVM, qeveria duhet të paraqesë vlerësimet e ndikimit rregullativ. Strategjitë dhe planet e verimit në këtë fushë duhet të zbatohen me kohë dhe të monitorohen. Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve dhe Investimeve në Kosovë është funksionale, mirëpo ende nuk e ka personelin e plotë, prandaj edhe ndikimi i saj është ende i kufizuar. Edhe pse regjistrimi i plotë i kompanive online nuk është paraqitur ende, procesi për regjistrimin e bizneseve dhe kompanive individuale është i shpejtë (1-3 ditë). Megjithatë, pengesat kryesore në zhvillimin e NVM-ve dhe në rritjen e mëtejshme ekonomike janë qasja në financa, zbatimi i dobët ligjor i kontratave dhe rregulloreve afariste, barrierat administrative, konkurrenca jo e drejtë nga sektori joformal, gjyqësori joefikas dhe korrupsioni."

**Faqe 34:** "Pak përparim është bërë në thjeshtimin e regjistrimit të bizneseve, mirëpo procedurat e paaftësisë së pagesës ende paraqesin një pengesë. Krijimi i zyrave për shërbim të qytetarëve në vitin 2014 ka reduktuar kohën e nevojshme për regjistrimin e kompanive deri në 3 ditë. Megjithatë, regjistrimi online nuk është implementuar ende plotësisht. Pengesa të shumta për hyrje në treg mbeten: administrata e dobët dhe e papërgjegjshme, qasja e pamjaftueshme në financa; një infrastrukturë e pazhvilluar mirë (veçanërisht në furnizimin me energji elektrike); mungesa e sundimit të ligjit."

**Faqe 35:** "Përkundër përparimit të vogël që është bërë në rregullat ligjore që qeverisin afarizmin, implementimi i tyre ka mbetur i pamjaftueshëm. Kapaciteti shumë i dobët institucional për zbatimin ligjor, i kombinuar me korrupsionin e përhapur, ka vazhduar të vështirësojë mjedisin afarist. Sistemi gjyqësor vuan nga mundësia e dobët e qasjes, joefikasiteti, vonesat dhe një numër në rritje i rasteve të pazgjithura (400 000 në korrik 2015). Emërimet e ndikuara politikisht të gjykatësve dhe prokurorëve kufizojnë pavarësinë e gjyqësorit. Kërkohej më shumë punë në rishikimin e Kodit Civil për proceset gjyqësore afariste dhe për praktikën afariste si dhe për zhvillimin e bazave të të dhënave të regjistrimit (kadastrit), në përputhshmëri me Rekomandimin 8 të PRE-së."

**Faqe 40:** "Lidhur me ligjin për kompanitë, disa masa administrative janë aprovuar në korrik 2015, duke siguruar kështu bazën për zvogëlimin e taksave për regjistrimin e bizneseve. Ligji që përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve ka mbetur të aprovohet."

### *Raporti për Kosovën – 2014*

**Faqe 32:** "Sa i përket ligjit për korporatat, në dhjetor të vitit 2013, Kosova ka miratuar ligjin për investimet e huaja që mundëson trajtim të barabartë në mes të investitorëve të huaj dhe vendas dhe nuk ka diskriminim ndaj investitorëve të huaj në bazë të shtetësisë, prejardhjes, vendbanimit dhe vendit të themelimit të biznesit apo vendit të kontrollit. Regjistrimi i biznesit është thjeshtuar edhe më tej. Korniza ligjore për kontabilitetin dhe auditimin e korporatave është e dobët; kjo ndikon në kapacitetin e kompanive për të marrë kredi si dhe ngadalëson zhvillimin e tregut financiar. Kosova ka nevojë të harmonizoj kërkesat që kanë të bëjnë me kontabilitetin dhe raportimin sipas standardeve ndërkombëtare."



Në Kosovë, lëvizjet e kapitalit janë liberalizuar në masë të madhe. Rregulloret për mbikëqyrjen e institucioneve mikro-financiare janë miratuar në shtator të vitit 2013. Këto rregullore adresojnë boshllëqet në kornizën legjislative. Numri i bankave me pronësi të huaj në tregun bankar të Kosovës ka mbetur i njëjtë, me nëntë banka të huaja që kontrollojnë pothuajse 90% të sektorit bankar të Kosovës. Sa i përket blerjes së pasurive të patundshme, duke përfshirë edhe blerjen e tokës nga personat që nuk janë shtetas të Kosovës, korniza ligjore kushtetuese i mundëson të huajve të blejnë pasuri të patundshme. Megjithatë, dispozitat në ligjet sektoriale dhe praktikat administrative i parandalojnë ata nga ushtrimi i kësaj të drejte. Identifikimi i këtyre pengesave nga ana e Kosovës është në vazhdim e sipër dhe heqja e tyre do të ndihmojë në rritjen e investimeve të huaja.”

Faqe 39: “Sa i përket politikës industriale dhe NVM-ve, Kosova ka vazhduar thjeshtësimin e legjislacionit të saj. Në janar të vitit 2014, ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Investimet e Huaja. Disa aspekte të mjedisit të biznesit janë përmirësuar gjatë viteve të fundit, në veçanti procedurat për krijimin e kompanive të reja. Regjistrimi përmes internetit i kompanive mundësohet në 28 qendra për shërbim të qytetarë. Regjistrimi i plotë i kompanive përmes internetit ende nuk është themeluar.

Duhet ti jepet prioritet zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël. Ky zbatim ende është në një fazë të hershme. Duhet të sigurohet dhe monitorohet zbatimi i strategjisë për zhvillim të sektorit privat (2013-17) dhe planit të veprimit (2013-15). Konsultimi i komunitetit të biznesit gjatë hartimit të ligjeve, strategjive dhe vlerësimit të ndikimit është thelbësor. Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovës dhe Agjencia për Mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme është shkrire në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë. Mjedisi i biznesit në Kosovë mbetet sfidues. Pengesat kryesore për zhvillimin dhe rritjen e mëtejshme të NVM-ve janë qasja në financa, zbatimi i dobët i kontratave dhe rregullores së biznesit, konkurrenca dhe gjyqësori i dobët, si dhe ekonomia e madhe jo-formale dhe korrupsioni.

Në përgjithësi, është bërë përparim i kufizuar në politikën industriale dhe të NVM-ve. Për të përmirësuar mjedisin e biznesit, Kosova duhet të përmirësojë kushtet për zbatimin e kontratave, të reduktojë barrierat e panevojshme administrative, të promovojë luftën kundër ekonomisë jo-formale dhe korrupsionit, dhe të zhvilloj një treg financiar. Qeveria duhet të paraqes një vlerësim rregullativ të ndikimit. Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillim të NVM-ve duhet të bazohet në periudha të qarta kohore, zbatimi i të cilave duhet të sigurohet dhe monitorohet.”

## **Shtojca 8: Ekstrakt i barrëve administrative dhe temave të lidhura me mjedisin e biznesit nga Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) - nëntor, 2016**

Ligjet specifike të mbetura për t'u miratuar, lidhur me barrën administrative dhe mjedisin e biznesit:

- Ligji për Shoqëritë Tregtare;
- Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;
- Ligji për Inspektimet e Përgjithshme;
- Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.
- Masat e tjera relevante (nuk ka informacion nëse ndonjë nga këto masa janë zbatuar tashmë):
- Zbatimi i vendimit të qeverisë së marsit 2016 për futjen e prokurimit elektronik të detyrueshëm, së bashku me afatet kohore të cekura.
- Forcimin e kapaciteteve të Departamentit për Çështje Ekonomike dhe Divizionit për Çështje Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës, përfshirë fushat e tatimeve dhe doganave, me qëllim të zvogëlimin të rasteve të grumbulluara
- Krijimin e një programi për shërbime dhe përkujdesje të mëtutjeshme të investitorëve për investitorët potencial dhe një mekanizëm të ankimimit të investitorëve që ka kompetenca të mjaftueshme për të ofruar shërbime të tilla.
- Reduktimin e barrës rregullative për kompanitë, veçanërisht duke i bërë transparente tarifat dhe procedurat e nevojshme për të marrë leje dhe licenca.
- Vënien në fuqi të ndryshimeve legjislative për të përmirësuar menaxhimin, bashkërendimin dhe zbatimin e mbikëqyrjes së tregut;
- Harmonizimin e legjislacionit, përmirësimin e kapaciteteve të organeve të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, dhe sigurimin që të fillojnë të zbatojnë mandatet e tyre
- Ndërmarrjen e masave pasuese bazuar në rekomandimet e të vlerësimit të “Aktit të biznesit të vogël”
- Miratimin e masave konkrete për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë
- Vënien në fuqi të programeve dhe instrumenteve të eksportit për t'u ndihmuar NVM-ve që të integrohen në zinxhirët e vlerave globale për të mbështetur ndërkombëtarizimin e tyre.
- Miratimin e masave për të thelluar dhe zgjeruar ndërmjetësimin financiar, me qëllim të rritjes së qasjes në financa për NVM-të.
- Zbatimin e të gjitha “masave të buta” të lidhjeve të mbetura dhe reformave përkatëse të politikave mbi transportin dhe energjinë.
- Përmirësimi i renditjes për zgjidhjen e paaftësisë paguese nëpërmjet zbatimit efikas të kornizës ligjore për falimentimin;
- Përqendrimin në përmirësimin e treguesve të Bankës Botërore së “të bërit biznes”
- Regjistrimi online i bizneseve është vënë në dispozicion;
- Regjistri Qendror Online për Licenca dhe Leje është përditësuar më tej, përfshirë tarifat dhe procedurat e kërkuara për marrjen e lejeve dhe ngarkimi i formularëve të aplikimit në bazën e të dhënave;
- Avancimi dhe përditësimi i rregullt i uebfaqes, për tu përdorur si një platformë informuese online për bizneset, përfshirë këtu dhe infrastrukturën e cilësisë
- 10 punëtori, të organizuara me qëllim të informimit të bizneseve sa i përket infrastrukturës së cilësisë dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni specifik vertikal, përfshirë këtu dhe promovimin e uebfaqes si platformë informuese
- 1.500 standarde, të miratuara me fokus në zonën e harmonizuar
- Laboratorët metrologjik ekzistues, të furnizuar me pajisje;

- Bizneset, të mbështetura për të rritur konformitetin e produktit të tyre (certifikimi i produktit) dhe ndërkombëtarizimin e tyre.

## **Shtojca 9: Raport nga vizita studimore në Belgjikë dhe në Holandë në maj 2018**

Në vijim paraqesim raportin përmbledhës nga vizita studimore e kryer në Bruksel/Belgjikë dhe në Hagë/Holandë.

Vizita u mbështet nga projekti "Mbështetje për Zyrën e Kryeministrit dhe ministrat për zhvillimin e politikave dhe koordinimin" sipas marrëveshjes me Ambasadën e Suedisë, respektivisht SIDA (Agiencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar) nënshkruar më 15 dhjetor 2015 me nr. 3508, dhe e cila zbatohet nga Ndërmarrja Ndërkombëtare e Administratës Publike. Kjo vizitë është paraparë në kuadër të aktiviteteve të këtij viti, me qëllim të shkëmbimit të përvojave me vendet e zhvilluara.

Vizita u krye me qëllim të fitimit të përvojave në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit nga institucionet kryesore të Komisionit Evropian si dhe zvogëlimin e barrës administrative nga institucionet e ndryshme të BE-së dhe ato të Holandës, të cilat në një mënyrë janë iniciatore dhe nxitëse të këtij procesi të BE-së.

Një total prej 19 zyrtarëve ishin pjesë e delegacionit, kryesuar nga Zyra e Kryeministrit (përfaqësues nga Kabineti i Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministri, SKQ, ZPS, ZL, ZKP, ZBF dhe përfaqësues nga ekipi i projektit SIDA/PAI).

Raporti paraqet një përmbledhje të takimeve në institucionet ku janë mbajtur takimet dhe agjenda e takimeve dhe prezantimet e institucioneve para delegacionit të Kosovës janë në shtojcat e këtij raporti.

### **Përmbledhje e diskutimeve gjatë takimeve të mbajtura në kuadër të vizitës studimore në Bruksel dhe në Hagë, maj 2018.**

#### **Dita e parë më 22.05.2018**

##### **Takim me Ambasadën e Kosovës në Bruksel**

Temat e diskutuara në takimin me Ambasadën ishin mbështetja e BE-së për Kosovën dhe përgjegjësitë e Kosovës në Bruksel, duke mbuluar 4 zona: Belgjikën, Luksemburgun, BE-në dhe NATO-n.

Ambasadori theksoi se lidhur me të gjitha çështjet, nuk ka asnjë takim që organizohet nga këto vende ku ne nuk jemi të ftuar. Ne jemi në marrëdhënie miqësore me Belgjikën dhe kemi marrë mbështetje të madhe nga Belgjika për anëtarësim në Interpol dhe UNESCO. Për më tepër, një nga misionet tona është të inkurajojmë investimet e huaja.

Bashkimi Evropian ka një agjendë të ngjeshur, ku Ballkani Perëndimor është një nga vendet më të rëndësishme, ndërsa BE mbetet akteri kryesor.

Sa i përket liberalizimit të vizave, ky proces tashmë është në fazën përfundimtare ku shtohet dinamika e punës dhe çdo javë shkëmbehen statistikat lidhur me këtë çështje. Deri më tani, dialogu me Serbinë është zhvilluar në nivel teknik dhe politik, ndërsa në vitet e fundit po zhvillohet në nivelin e presidentëve dhe secili Shtet Anëtar dëshiron të dijë se çfarë ka ndodhur me dialogun.

Përmes NATO-s, puna e shkëmbimit të letrave ndërmjet NATO-s dhe FSK-së është intensifikuar.

Një nga çështjet kyçe është gjithashtu koordinimi i drejtë i proceseve që ndodhin, ku është sfiduese për të mbajtur persona të përshtatshëm për të gjitha proceset.

Sekretariati Koordinues i Qeverisë prezantoi qëllimin e vizitës studimore dhe temat që do të diskutohen në takimet që do të mbahen gjatë javës.

Gjithashtu u prezantua përkrahja e projektit për zhvillimin e politikave, që mbështet ZKM-në dhe i cili do të zgjasë deri në vitin 2020. Përmes kësaj mbështetjeje, Udhëzimi është projektuar për hartimin e politikave shumë të afërta me Bashkimin Evropian, të cilat në zvogëlimin e barrës administrative kanë ndikime të ndryshme politike, ekonomike, mjedisore, sociale, etj. Lidhur me këtë, u theksua se seancat e trajnimit për këtë Udhëzim kanë filluar dhe do të vazhdojnë me 20 grupe deri në fund të vitit.

Gjatë kësaj vizite, qëllimi ynë është që këtu të kemi një pamje edhe nga institucionet e tjera lidhur me barrën administrative, ku kemi formuar një grup punues për të hartuar një politikë të zvogëlimit të barrëve administrative dhe duke prezantuar këto përvoja në propozimin tonë dhe të gjitha praktikat më të mira që mund të jenë mbështetëse në këtë drejtim.

Ambasadori gjithashtu vuri në dukje se RAP është një nga shtyllat që BE sheh në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve tona dhe ngritjen e kapaciteteve në Integrimin Evropian. Ekzistojnë dy programe mbështetëse të RAP dhe MFP, ku të dy janë aktualisht në rrezik. Një tjetër element i përmendur nga Bashkimi Evropian, i cili gjithashtu është një rekomandim i vazhdueshëm, merret me politizimin e pozicioneve të larta drejtuese.

Drejtori për Qeverisje të Mirë, në kuadër të ZKM-së, vuri në dukje se përmes ndihmës së projektit do të mbështetet gjatë procesit të konsultimit, ku të gjitha ministritë duhet të konsultohen me dokumentet e tyre, ndërsa një sfidë paraqitet kur ka propozime që kanë nevojë për një miratim urgjent nga ana e Qeverisë.

### **Prezantimi i Ciklit të Politikave të BE-së**

Prezantimi u bë nga Joost Mulder dhe Erik Akse. Procesi i përgjithshëm i politikëbërjes së BE-së dhe vlerësimi i ndikimit u prezantuan nga fillimi deri në fund të procesit.

Cikli i ri i politikave në Bashkimin Evropian fillon me planifikimin e politikave, ku fillon një hartim më pas dhe pasohet nga ligji dhe pastaj nga zbatimi dhe përfundon me vlerësimin.

Procesi i legjislacionit në Komisionin Evropian fillon me konsultimet publike, ku një draft i parë përgatitet në konsultim me drejtoritë, dhe pastaj hartohet propozimi legjislativ. Nga kjo, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së në të njëjtën kohë punojnë në këtë projekt dhe shtojnë ndryshimet e tyre. Në fund zhvillohen diskutime trepalëshe, Parlamenti voton, Këshilli miraton, publikohet në gazetën zyrtare, dhe pastaj shtetet anëtare transpozojnë këtë politikë në ligjet e tyre kombëtare. Vlerësimi i ndikimit zhvillohet në fazën fillestare dhe gjatë përgatitjes së draftit fillestar, si një alternativë mund të bëhet gjatë fazës së tranzicionit në Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Bashkimit Evropian ose pas negociatave trepalëshe, por më në fund bëhet e detyrueshme pasi të transpozohet në legjislacionin e Shteteve Anëtare.

Kosova në përgjithësi dhe ZKM në veçanti, në krahasim me vendet e tjera, është e qartë se ka mungesë të stafit, ndërsa në të kundërt, Sekretariati i BE-së dhe vendet e tjera kanë staf të mjaftueshëm për të gjitha proceset.

### **Takimi i dytë**

#### **Takim në Shërbimin Kërkimor të Parlamentit Evropian**

Temat e diskutuara ishin: Cikli i politikave të BE-së nga perspektiva e Parlamentit Evropian - nga Ex-ante në Ex-post, përvoja e Parlamentit Evropian në lidhje me rregullimin më të mirë, vlerësimin e ndikimit dhe zvogëlimin e barrës administrative, koordinimin me institucionet e tjera dhe Specifikimet e Vlerësimeve të Ndikimit në kontekstin e BE-së.

Irmgard Anglmayer theksoi se është një program ekzekutiv dhe ne mirëpresim interesimin tuaj në agjendën e rregullimit më të mirë për të parë se si është rregulluar në BE.

Agjenda Evropiane bazohet në hartimin e politikave në kontekstin e krijimit të legjislacionit, ku elementet kryesore në agjendën e rregullimit më të mirë të BE-së janë:

- llogaridhënia dhe transparenca
- përfshirja e palëve të interesuara
- vlerësimi i ndikimit dhe vlerësimi ex-post, dhe
- rregullimi minimal i ngarkesës/barrës

Në kuadër të vlerësimit të ndikimit të BE-së, tri institucionet me funksion kryesor janë: Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian.

Parlamenti Evropian është një vend politik i përbërë nga 751 anëtarë, 8 grupe politike, 22 komitete dhe nënkomitete. Është një institucion kompleks ku ka krah politik dhe staf administrativ.

Cikli ex-ante në vlerësimin e ndikimit zhvillohet në këtë mënyrë:

- përkufizimi i problemit
- cilësia e të dhënave dhe hulumtimeve
- opsionet
- koherenca
- konsultimi paraprak

Ndërsa vlerësimi i ndikimit ex-post në BE ndihmon komisionet parlamentare në vlerësimin ex-post, duke siguruar që: propozimi do të ketë një vlerësim të shkurtër të zbatimit në praktikë për procesin e legjislacionit ekzistues të BE-së.

### Diskutimet

Vlerësimi i ndikimit të Komisionit është një vlerësim me rëndësi të madhe, por shumë kompleks duke pasur parasysh se paratë që shpenzuara nga ne janë të tatimpaguesve dhe çdo propozim duhet të publikohet dhe të jetë në dispozicion të publikut.

Ne jemi staf civil dhe ata janë politikanë, por ne do të sigurohemi që t'i dorëzojmë parlamentit një dokument të duhur me të dhëna të plota dhe më pas varet nga komisioni që të vendosë në lidhje me propozimin në fjalë.

### **Takimi i tretë në Konfederatën e Ndërmarrjeve Suedeze në lidhje me përvojën e tyre mbi Vlerësimin e ndikimit: perspektivat e jashtme**

Jens Hedstrom - Drejtor Ndërkombëtar, Shef i Zyrës së Brukselit

Temat që u diskutuan në takim ishin: vlerësimi i ndikimit nga perspektiva e palëve të interesuara dhe përvoja me platformën REFIT.

Pas prezantimit të delegacioneve, prezantuesi na informoi për punën e tyre të përditshme. Konfederata e Ndërmarrjeve Suedeze është Federata më e madhe dhe më me influencë e biznesit në vendet skandinave dhe ka rreth 60.000 biznese që mbulojnë rreth 1,7 milion njerëz. 95% e kompanive në Suedi janë NVM dhe 75% janë anëtarë të kësaj konfederate. Misioni i tyre është përmirësimi i mjedisit të biznesit në Suedi, si dhe në BE.

Rregullimi më i mirë në BE bazohet në: rregullat e reja, rregullat ekzistuese dhe mënyrën e zbatimit të këtyre rregullave. Kur kemi të bëjmë me një rregull apo propozim të ri, e quajmë vlerësim të ndikimit. Një rregull ose

propozim i ri duhet të kalojë vlerësimin e ndikimit, konsultimet dhe këshillin rregullator. Gjithashtu u theksua se në Bashkimin Evropian, vlerësimi i ndikimit është shumë më mirë i rregulluar se në Suedi dhe kjo është për shkak të procesit të konsultimit, sepse nëse nuk kalon nëpër këtë proces, është shumë e vështirë për të ecur përpara.

Sfida më e madhe është gjetja e nivelit të duhur të rregullimit adekuat dhe të dihet se cila pjesë e politikës mund ta rregullojë çështjen. Shpesh shfaqet nevoja të sigurohet se rregullimi përdoret vetëm kur është i nevojshëm, dhe duke thjeshtuar ose shfuqizuar rregulloret e panevojshme. Në fillim të viteve të mëparshme, afati për kalimin e një propozimi ishte deri në 6 vjet dhe tani është më e lehtë të përgatitet dhe të kalojë një rregull të ri.

REFIT në vendin tonë ka filluar të zbatohet dy vjet më parë, që nënkupton rishikimin e të gjithë legjislacionit ekzistues. Prezantuesi na rekomandoi që nëse jemi në fazën e eliminimit të pengesave atëherë duhet të zbatohet platforma REFIT dhe do të marrim praktikën më të mira nga përvojat e vendeve të tjera.

### Diskutimet

Gjatë diskutimeve u theksua se jo të gjitha legjislacionet e BE-së dhe të vendeve tjera mund të jenë të përshtatshme për vendin përkatës dhe gjithashtu rekomandohet që nëse duhet të bëhet programi për eliminimin e barrës administrative, atëherë duhet të jetë prioritet i qeverisë, në mënyrë që të vazhdohet më tutje.

### **Dita e dytë, 23 maj**

#### **Takimi i parë**

#### **Prezantim i përvojave të VN: Matja e barrëve administrative në nivel të BE-së**

Prezantimi u bë nga IOANA Condrat - zyrtare në Sekretarinë e Përgjithshme të Komisionit Evropian. Temat që u diskutuan ishin: Përvoja e BE-së në modelin e kosto standarde dhe implementimin e MKS-së në drejtim të përmirësimit të zhvillimit të politikave.

Prezantuesja në fillim të takimit shpjegoi se çfarë nënkupton platforma REFIT, e cila ka filluar të zbatohet nga Komisioni. Në këtë drejtim, platforma REFIT synon të krijojë një proces sistematik për të rishikuar rregulloret e BE-së në mënyrë që të identifikojë nismat për të ndërmarrë veprime në thjeshtimin dhe zvogëlimin e barrëve të panevojshme administrative për të mundësuar realizimin e zbatimit të politikave.

Më tej, prezantuesja shpjegoi se si platforma REFIT u zbatua gjatë viteve, duke filluar nga viti 2015.

Gjithashtu prezantimi vijues ishte për MKS-në e BE-së, duke përfshirë formulën:  $kosto\ administrative = \sum P \times Q$

- P (Çmimi = tarifa dhe koha)
- Q (Sasia = numri i bizneseve dhe frekuenca)

Qëllimi kryesor i MKS-së së BE-së është të ndihmojë në identifikimin e detyrimeve të cilat kanë kosto sipas legjislacionit të BE-së dhe zvogëlimit të kostove të përcaktuara nga MKS dhe efektet e tij në nivel kombëtar, duke përfshirë bizneset, sektorët privatë dhe publikë.

Prezantuesja shpjegoi gjithashtu një metodologji të re për identifikimin e barrës rregullative brenda një sektori që fillimisht ishte ndarë në 5 sektorë. Qasja e bazuar në kosto ndaj barrës rregullative është një instrument i ri në identifikimin e barrës së panevojshme të shkaktuar nga legjislacioni dhe rregulloret. Ajo është zhvilluar me qëllim të rritjes së përfitimit të biznesit duke eliminuar barrët rregullative problematike. Ky manual i metodologjisë është autorizuar nga Ministria e Çështjeve Ekonomike e Holandës.

### **Takim në Sekretarinë e Përgjithshme të Komisionit Evropian - Vlerësimi i Ndikimit dhe Konsultimi**

Tema e diskutuar në këtë takim ka të bëjë me menaxhimin e procesit të konsultimit për vlerësimin e ndikimit nga Komisioni Evropian nga prezantuesi Rudi Boogert.

Prezantuesi bëri prezantim online në lidhje me platformën e konsultimit në mënyrën se si funksionon. Kjo platformë është funksionale në të gjitha gjuhët e Bashkimit Evropian dhe kushdo mund të shohë propozimet dhe të japë komente. Secili dokument konsultohet që nga fillimi me palët e interesuara, sepse secili propozim duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit. Për çdo propozim, platforma përmban të gjitha informacionet për afatin kohor, qëllimin, çfarë do të arrihet, çfarë ndihmon procesin e konsultimit dhe informacione të tjera të hollësishme.

Prezantuesi theksoi se ata duhet të ndjekin progresin e propozimit nga fillimi deri në fund, të gjitha komentet duhet të përmbledhen dhe propozimi i dorëzohet Komisionit Evropian.

Është një sfidë e madhe të monitorohet një propozim gjatë ciklit, të kontrollohet në cilën fazë është, kur është bërë konsultimi, nëse ka pasur komente etj., por z. Boogert theksoi se po punohet për të avancuar platformën dhe për t'ia lehtësuar publikut që të komentojë. Të gjitha raportet e konsultimit publikohen pasi të përgatiten.

Konsultimet publike janë avancuar në sajë të pakos udhëzuese që është miratuar nga Komisioni Evropian në vitin 2015.

### **Takimi i tretë - Takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Evropian dhe Bordin Rregullativ të Komisionit**

Temat e diskutuara ishin Vlerësimi i Ndikimit: menaxhimi i procesit brenda Komisionit dhe Kontrollit të Cilësisë; zhvillimi i Udhëzimeve dhe Udhëzimeve të Rregullimit më të Mirë të Komisionit Evropian; ngritja e kapaciteteve për Komisionin si organizatë; ngritja e kapaciteteve për zyrtarët e Komisionit për të ndërmarrë Vlerësimin e Ndikimit; procesi i kontrollit të cilësisë të vlerësimit të ndikimit; sfidat dhe praktikat më të mira.

### **Rregullim më i Mirë: Puna e Bordit për Rishikimin Rregullativ të Vlerësimit dhe Evaluimit të Ndikimit nga Komisioni Evropian**

Didier Herbert, Drejtor në Sekretariatit e Përgjithshëm të Komisionit Evropian anëtar i Bordit Rregullativ Shqyrtues të Komisionit për Evaluimin dhe Vlerësimin e Ndikimit, prezantoi punën e bërë në këto dy departamente.

Para se Bashkimi Evropian të ndërmerr hapa, Vlerësimet e Ndikimit të Komisionit kontrollohen për efektet e mundshme të nismave të reja:

- Ekonomike
- Sociale
- Mjedisore

Në maj të vitit 2015, u miratua Pako e Rregullimit më të Mirë të BE-së, me qëllim të:

- Transparencës më të madhe lidhur me vendimmarrjen;
- Konsultimeve më të gjera me publikun;
- Vlerësimit të përmirësuar të ndikimit;
- Qasjes së re në rishikimin e legjislacionit ekzistues së BE-së.



Më pas, ka pasur një Marrëveshje ndërinstitucionale për krijimin e politikave më të mira. Hapat e rregullimit më të mirë janë:

- Planifikimi dhe Programimi;
- Vlerësimi i ndikimit;
- Konsultimi me akterët kryesorë;
- Vlerësimi dhe kontrolli nëse ndërhyrja është e nevojshme.

Bordi i Shqyrtimit Rregullativ, i përbërë nga anëtarë të jashtëm dhe të brendshëm, me një mandat 3-vjeçar dhe pamundësinë e rizgjedhjes, konsideron Vlerësim të Ndikimit, kryesisht faktet e dhëna në politikë dhe referencat, dhe jo vetëm premtimin verbal.

Prezantuesi theksoi se jo të gjitha propozimet kanë nevojë për vlerësim. Kur bëhet një vlerësim dhe i dorëzohet Bordit, propozimi nuk mund të kthehet për konsultim apo diçka tjetër.

Sipas Herbert, ajo që pritet të arrihet vitin e ardhshëm është që fillimisht të forcohet vlerësimi i ndikimit, të përcaktohen treguesit dhe të shpjegohet saktësisht se çfarë do të arrihet me propozimin përkatës. Ekziston një njësi e veçantë e përbërë nga 10 njerëz që përgatisin dhe rishikojnë udhëzimet, dhe ky departament siguron që propozimi të rishikohet mirë para se të dorëzohet në bord. Bordi është i pavarur dhe mund të marrë çdo vendim.

Bordi pranon vlerësimin e ndikimit për ta rishikuar propozimin 4 javë më parë, pastaj disa pyetje kyçe lidhur me raportin që do të kërkohet gjatë takimit me drejtorin e njësisë përkatëse, i cili do të mbrojë propozimin e tij.

Çdo drejtori ka angazhuar konsulentë të cilët gjithashtu janë të përfshirë në rishikimin e vlerësimit të ndikimit.

**25.05.2018**

### **Takim në Këshillin e Çështjeve Publike me z. Andreas Baneth**

#### **Tema: Përvoja me VN: Perspektiva të jashtme...**

Këshilli i Çështjeve Publike nuk ka interes të prezantojë organizatën si të tillë, por të llojë për interesat e organizatave të tjera. Nuk është një kompani që organizon trajnime, por lehtëson dialogun dhe bashkon kompani të ndryshme rreth temave të ndryshme në mënyrë që të ndikojë në politika. Këshilli avokon për qëllimin e krijimit të opinioneve mbi çështje të ndryshme publike.

Regjistrimi i organizatave nuk është i detyrueshëm, por në kohën kur ato regjistrohen mund të vijnë lehtë në bashkëpunim dhe të marrin pjesë në aktivitetet e Komisionit Evropian. Pas prezantimit u prezantua një grafik i raportit të ndikimit të mundshëm dhe avancimit/zbatimit/progresit të çështjes, ku nga fillimi i diskutimit të çështjes deri te zbatimi, ndikimi gradualisht bie duke u fokusuar në grupe të ndryshme në faza të caktuara.

Diskutimi u përqendrua në atë se çfarë mënyra mund të përdoren për t'i bërë kompanitë të punojnë së bashku duke organizuar struktura të ndryshme.

### **Takim në Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerim**

Në takimin me z. David Cullen, Udhëheqës i Njesisë për Kosovën në Komisionin Evropian, pjesëmarrës ishin dhe zyrtarë të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme për Politikën e Fqinjësisë Evropiane dhe Zgjerimin të Komisionit Evropian. Në këtë takim kemi diskutuar çështje shumë të rëndësishme në lidhje me administratën publike, ciklin e politikëbërjes, duke përfshirë rregullimin më të mirë dhe planifikimin strategjik.

Kjo ishte një mundësi e mirë për të informuar zyrtarët e Komisionit Evropian lidhur me punën e mirë të kryer nga institucionet në këto drejtime dhe pikat e angazhimit të cilat ne së bashku i kemi identifikuar dhe të cilat do t'i adresojmë urgjentisht në ditët dhe javët e ardhshme, e që do të ketë një ndikim pozitiv jo vetëm në përcaktimin e hapave të ardhshëm drejt përmbushjes së detyrimeve tona që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Procesi i Liberalizimit të Vizave dhe mbështetja e drejtpërdrejtë financiare, por gjithashtu do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve përmes ngritjes së cilësisë së politikave publike dhe drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në takim u prezantuan të arriturat e administratës në Kosovë, si dhe u diskutuan edhe përgatitjet për takimin e radhës të Grupit Special për Reformën e Administratës Publike.

### **28.05.2018 – Vizitë në Hagë**

#### **Takimi i parë me ambasadorin z. Burim Qorri në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Holandë**

Delegacioni u informua nga Ambasada lidhur me institucionet në Holandë të cilat i vizituam gjatë ditës si dhe në lidhje me organizatat ndërkombëtare ku qëllimi kryesor i përfaqësuesve të Kosovës është anëtarësimi në këto organizata.

Institucionet shprehën mirënjohjen për delegacionin tonë, i cili ishte në koordinim të plotë me Ambasadën tonë në Holandë dhe njëkohësisht i ftuan të gjitha institucionet tona të ndjekin praktika të tilla gjatë vizitës në këtë vend.

#### **Takimi i dytë në Ministrinë e Çështjeve Ekonomike dhe Politikave Klimatike - Njësia e Rregullimit më të Mirë, me z. Marco Commandeur, znj. Nicole Goossens dhe z. Kees van der Steen**

Tema: Përvoja e njësisë në kuadër të zvogëlimit të barrës administrative

Në këtë ministri, prezantuesit dhanë prezantime për punën e tyre që ka të bëjë me zvogëlimin e barrës administrative. Sa i përket çështjes së rregullimit më të mirë dhe veçanërisht zvogëlimit të barrës administrative, kjo ministri ka rolin koordinues. Sipas informacionit të tyre, çdo ministri është përgjegjëse për të zvogëluar barrën administrative.

Gjatë takimit, ata prezantuan rëndësinë e zvogëlimit të barrës rregullatore në politikat e qeverisë lidhur me barrën administrative në nivel kombëtar, lokal dhe të BE-së. Më konkretisht, kjo ndikon drejtpërdrejt në kostot e kompanive dhe kërkon shumë kohë, duke rezultuar në më pak kohë për të bërë biznes, më pak hapësirë për sipërmarrjen e lirë, pengim të inovacionit dhe më pak rritje ekonomike. Për më tepër, shkakton reputacion të keq për Qeverinë duke mos gjetur mbështetjen e nevojshme nga shërbimet publike.

Zvogëlimi i kostove të biznesit ndikon në rritjen ekonomike dhe konkurrencën e ndershme. Ndërsa efektet makroekonomike kanë rënë në 25% në zvogëlimin e barrës administrative, e cila është e barabartë me 1,3% të BPV-së.

Agjenda për të ardhmen nuk parashikon kufizime sasiore, pasi për periudhën e ardhshme fokusi kryesor do të jetë në aspektin cilësor lidhur me këtë fushë. Sa i përket aspektit ministror, janë parashikuar programe të reja të dedikuara për këtë çështje, të cilat do të kenë qëllime specifike dhe të përgjegjshme.

Rregullat e reja që përdoren aktualisht janë: Korniza e Vlerësimit të Politikave dhe Legjislacionit, Testimi i Ndikimit në Biznes (efektet), Udhëzues mbi Rregulloren, Konsultimet publike, Konsultime Transparente Efektive dhe Bordi i Pavarur Këshillimor mbi Rregullimin (ATR).

Instrumentet për ekzaminimin e akteve ekzistuese: janë të përqendruara në ciklin e zhvillimit të biznesit si dhe përdoren qasje të ndryshme specifike dhe shërbime të avancuara digjitale.

### **Rregullim më i mirë brenda BE-së**

Lidhur me prioritetet e përgjithshme të Holandës në nivel të BE-së, fokusi është në transparencën më të madhe të efekteve të vlerësimit të ndikimit dhe REFIT. Gjithashtu, synohet që vlerësimi i ndikimit të kryhet nga të gjitha institucionet kryesore të BE-së.

### **Rregullim më i mirë në nivel lokal**

Niveli lokal përfshin 380 komuna. Ky nivel është shumë i rëndësishëm për një rregullim më të mirë, duke qenë se ky nivel është në kontakt të drejtpërdrejtë me bizneset dhe qytetarët. Për këtë qëllim, ne si institucione të nivelit qendror jemi të përqendruar në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira me nivelin lokal.

### **Shërbimet digjitale**

Këto shërbime janë të dobishme, të cilat përdoren nga kompanitë dhe publiku, ku raporte dhe informacione të ndryshme janë në dispozicion për këtë çështje.

Institucionet përgjegjëse janë Ministria e Çështjeve Ekonomike, ministritë e linjës të cilat kanë menaxher të programit dhe njësitë përkatëse. Njësia për Rregullim më të Mirë në Ministrinë e Çështjeve Ekonomike përbëhet nga 10 anëtarë të stafit dhe Bordi Këshillimor mbi Barrën Rregullative.

### **Takimi i tretë u mbajt në Parlamentin Holandez**

Takimi u mbajt me dy deputetë holandezë, znj. Anne Mulder, e cila përfaqësoi partinë e Kryeministrit të Holandës dhe znj. Rensle Leijten, nga opozita, duke përfaqësuar Partinë Socialiste.

Duke pasur parasysh se ato janë anëtarë të partive politike të qeverisë dhe opozitës, morëm përshtypje dhe mendime të gjera për Kosovën dhe integrimin e saj evropian dhe euroatlantik që ato mbështesin, pavarësisht nga fakti se janë dy parti të ndryshme. Gjithashtu, biseda jonë me deputetët holandezë ishte shumë miqësore, shumë e hapur dhe e sinqertë, prandaj ne adresuam nevojë tonë dhe agjendën e reformave për të lëvizur drejt këtyre synimeve.

Ne shfrytëzuam rastin të ndajmë opinionet tona për përmbushjen e kushteve të procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën dhe kërkua ndihmën dhe mbështetjen e tyre që ky proces të përfundojë sa më shpejtë.

### **Takimi i katërt me z. Rudi Van Zijp i mbajtur në Bordin Këshillimor Holandez mbi Barrën Rregullative**

#### **Tema: Rishikim i pavarur i procesit të zvogëlimit të barrës administrative**

Qëllimi kryesor i këtij institucioni është përmirësimi i cilësisë së legjislacionit, ku sipas z. Zijp, përmirësimi i cilësisë varet nga këshilla e pavarur e ofruar nga ky bord. Sa i përket historisë, Holanda fillimisht ka matur barrën administrative të legjislacionit ekzistues duke mos u fokusuar në legjislacionin e ri. Si rezultat, komuniteti i biznesit e ka quajtur këtë veprim si "Holanda po pastron dyshtemenë, përderisa rubineti është ende duke rrjedhur". Aktualisht qasja e kompensimit përdoret për legjislacionin e ri, ku ka dy lloje të kompensimit: kompensimi specifik ku ministria e propozuar për çdo legjislacion të ri të barrës duhet të shikojë brenda ministrisë për të zvogëluar barrën në mënyrë që efekti të jetë 0. Ndërsa kompensimi total është kur në një sektor ka një rritje të zvogëlimit të barrës administrative të bërë në një sektor tjetër kështu që efekti të jetë 0.

Në mënyrë që një institucion i tillë i pavarur të funksionojë me sukses, mbështetja politike është e domosdoshme dhe është e rëndësishme që mbështetja të integrohet në një program më të gjerë për ta bërë qeverinë më efektive dhe më efikase.

## Shtojca 10: Raport nga trajnimi për e-Qeverisje në Estoni në qershor 2018

**Tallin (Estoni), 25-29 qershor 2018**

**Programi:** Praktikat më të mira ndërkombëtare; e-Qeverisja dhe të kuptuarit e ndikimit të saj për jetën tonë

**Pjesëmarrës:** Delegacionet nga Kosova dhe Shqipëria

Takimet u mbajtën në zyrat e Akademisë së e-Qeverisjes, Zyrës së Kryeministrit, Ministrit të Financave, Ministrit të Drejtësisë etj.

Takimi i parë u mbajt në Akademinë e e-Qeverisjes, ku znj. Annela Kiirats, Drejtoreshë Programi për Trajnimet e E-Qeverisjes, paraqiti një përmbledhje të rendit të ditës dhe foli për historikun e zhvillimit, strukturën organizative dhe bashkëpunimin që ky institucion ka me vendet e tjera.

Takimi i radhës gjithashtu u mbajt në Akademinë e e-Qeverisjes, ku delegacionet u pritën nga Arvo Ott, Drejtor Ekzekutiv dhe Kryetar i Bordit Drejtues të Akademisë, i cili i informoi ata për misionin jofitimprurës të Akademisë dhe për donatorët, siç janë: UNDP, Fondacionet e Shoqërisë së Hapur, SIDA Suedeze, Komisioni Evropian dhe Qeveria Estoneze. Aktualisht, Akademia përbëhet nga stafi lokal përkatës dhe gjithsej rreth 100 ekspertë të jashtëm. Disa nga arritjet e Akademisë përfshijnë: bashkëpunimi me mbi 90 vende të ndryshme dhe përafërsisht rreth 4000 pjesëmarrës të cilët kanë ndjekur trajnimet përkatëse. Akademia organizon trajnime në nivel qendror dhe lokal në fusha të tilla si: e-Demokracia dhe e-Pjesëmarrja, interoperabiliteti, siguria kibernetike etj.

Gjatë takimit u përmendën edhe roli i koordinimit të e-Qeverisjes, parimet dhe zbatimi i politikave. Shembull konkret: si rezultat i përdorimit efektiv të nënshkrimit elektronik, një javë pune në vit ose 2% e BPV-së - efekti ekonomik - kursethet. Politika/strategjia e e-Qeverisë bazohet në procesin e organizimit, kornizën ligjore, kornizën fiskale dhe projektet e arkitekturës teknike. Katalogu i interoperabilitetit përfshin: 600 lloje të sistemeve të informacionit, 2500 lloje të shërbimeve, etj.

Çështjet më sfiduese në procesin e aplikimit të nënshkrimit elektronik konsiderohen organizimi dhe planifikimi. Meqenëse efektet shihen 3-6 vjet pas aplikimit, politika nuk ishte e gatshme ta shtyjë përpara këtë çështje. Sidoqoftë, sektori i biznesit dhe sektori bankar në Estoni kanë mbështetur fuqimisht zbatimin e e-Qeverisjes. Në kuadër të këtij prezantimi, një prezantim i shkurtër u bë edhe nga përfaqësuesi i Shqipërisë dhe Kosovës për gjendjen aktuale të shërbimeve elektronike të ofruara nga institucionet kryesore përgjegjëse.

Në takimin e tretë, znj. Annela Kiirats, Drejtoreshë e Programit për Trajnimet e E-Qeverisjes, foli për çështjet organizative dhe ligjore të themelimit, administrimit dhe përdorimit të shërbimeve elektronike. Vlen të theksohet prezantimi që tregoi interoperabilitetin e sistemeve të ndryshme me përdoruesit dhe strategjinë që është përdorur nga viti 1997 deri në vitin 2010 për "krijimin e qytetarëve të digjitalizuar" - fokusi kryesor ishte në të mësuarit, pajisjet teknologjike dhe ndikimin e teknologjisë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve.

Takimi i ardhshëm u përqendrua në historikun, kornizën ligjore, kornizën institucionale dhe komunikimin X-road si dhe në besueshmërinë në shërbime, mënyrat e aplikimit për shërbime, llojet e dokumenteve për shërbime etj. Çelësi i suksesit u konsiderua: 1. interoperabiliteti, 2. aftësitë, 3. identiteti i vetëm digjital, etj.

Prezantuesi na informoi për platformën X-Road, e cila konsiderohet të jetë shtylla kurrizore e e-Estonisë. Element thelbësor i X-road është se i lejon bazat e të dhënave të ndryshme të sektorit publik dhe privat të vendit të lidhen dhe të funksionojnë në harmoni.

Mjedisi i Estonisë për e-zgjidhjet përfshin një gamë të plotë shërbimesh për publikun e gjerë dhe pasi që secili shërbim ka bazat e veta të të dhënave, të gjithë përdorin X-Road. Për të siguruar transferimin e sigurt, të gjitha

të dhënat që dalin nga X-Road nënshkruhen dhe kodohen në mënyrë digjitale dhe të gjitha të dhënat hyrëse janë të legalizuara dhe të regjistruara.

Vlen të theksohet se 99% të shërbimeve shtetërore ofrohen në internet. 52.000 organizata janë shfrytëzues të shërbimeve x-Road, që mundëson kursimin e 800 viteve kohë pune duke përdorur shërbimet elektronike (<https://e-estonia.com/solutions/interoperability-services/x-road/>).

Në fillim të takimit, z. Janek Rozov, Shef i Departamentit të Zhvillimit të Shërbimeve të Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Çështjeve Ekonomike dhe Komunikimeve, tha se Estonia është një vend modest në aspektin e shtrirjes së saj përtej kufijve, me një popullsi prej 1,3 milionësh dhe një sektor TIK-u që përbën 7% të BPV-së. Detyrat e ministrisë në e-Qeverisje dhe specifikimet e politikëbërjes në fushën e e-Shërbimeve publike janë shpjeguar duke iu referuar afateve kohore dhe arritjeve në aspektin e e-Qeverisjes/digjitalizimit të shërbimeve që nga viti 2000 – e-Tatimi në pikat kufitare dhe m-parkingu deri më 2017 – hapja e llogarive bankare në internet dhe raportimi në vitin 2018.

Ata kanë arritur të ofrojnë 99% të shërbimeve shtetërore në internet, të ofrojnë rreth 2000 shërbime, të themelojnë rreth 900 baza të të dhënave dhe të ekzekutojnë rreth 500 milionë transaksione në vit.

Në kuadër të avancimit/transformimit të shërbimeve digjitale, ata kanë arritur të ofrojnë disa nga shërbimet vetëm me anë të interoperabilitetit të sistemit të të dhënave dhe shërbimeve, pa pasur nevojë fare për aplikim.

Siç shihet, projektet e financuara duhet të jenë të lidhura me objektivat e strategjisë përkatëse dhe të zbatohen nga kompanitë private, të specializuara në këtë fushë. VNR ka kontribuar në zvogëlimin e një numri të madh të kërkesave për financimin e projektit. Për shembull, në vitin 2014, nga numri i përgjithshëm prej 300 projektsh në fazën fillestare të aplikimit për financim, për shkak të mungesës së analizës së duhur dhe mospajtueshmërisë me kërkesat tjera të vendosura nga VNR, janë kualifikuar vetëm 14 prej tyre. Gjithashtu, është theksuar se ekziston një nevojë e përhershme për zhvillimin e aftësive në fushën e e-Qeverisjes. E-Qeverisja kërkon: asistencë teknike, parime themelore, legjislacion dhe organizim që gjithashtu mundëson e-TË ARDHMEN.

Vazhdimi i trajnimit rreth e-Qeverisjes (26.06.2018) – Gjatë trajnimit në Talin në kuadër të trajnimit të e-Qeverisjes, delegacionet e Kosovës dhe Shqipërisë kanë vizituar Zyrën e Qeverisë (Kancelarin e Shtetit /Zyrën e Kryeministrit). Shefi i Sekretariatit të Qeverisë, Aivar Rahno, shpjegoi në detaje si të operohen dhe si të përdoren sistemet digjitale në proceset e vendimmarrjes së Qeverisë.

Përvoja e Estonisë tregon se e-Qeverisja ka rritur eficiencën e punës së Qeverisë, duke përfshirë organizimin e takimeve, koordinimin dhe vendimmarrjen e Qeverisë.

Praktika e mirë duke përdorur pajisjet digjitale ka shkurtuar kohën e takimeve për deri në 30 minuta. Të gjitha vendimet e Qeverisë nënshkruhen në mënyrë digjitale, pa pasur nevojë që Kryeministri të jetë i pranishëm fizikisht në zyrë.

Gjatë konsultimeve publike, të gjithë akterët të cilët bëjnë komente mbi politikat përkatëse mund të identifikohen përmes Identitetit digjital, që e posedon secili qytetar i Republikës së Estonisë.

Sistemet e informacionit që mbështesin Qeverinë e Estonisë në vendimmarrje janë: e-Kabineti; e-Konsultimet; shkëmbimi i të dhënave përmes X-Road; Qendra për shkëmbimin (elektronik) të dokumenteve; Sistemi i informacionit i Parlamentit për akte ligjore; identiteti digjital; Kartela e identitetit (ID) dhe infrastruktura e nënshkrimit digjital; e-Gazeta dhe faqja e internetit të Qeverisë.

Identiteti digjital ka disa përparësi, siç janë siguria e dokumenteve, shpejtësia dhe kostoja e ulët. Pra, sa i përket digjitalizimit, posedimi i pajisjeve digjitale nuk është e vetmja gjë e rëndësishme, përveç kësaj, duhet të

ndryshohen shumë praktika, duke përfshirë arkivat digjitale, mbrojtjen e të dhënave, të drejtat e përdoruesit dhe edukimin e qytetarëve për një shoqëri digjitale. Në mënyrë që e-Qeverisja të funksionojë siç duhet, sistemet e informacionit duhet të jenë të ndërveprueshme dhe të thjeshta.

Katrin Nyman Metcalf, Udhëheqëse e Hulumtimeve në EGA, informoi pjesëmarrësit mbi parimet e kornizës ligjore të Estonisë mbi shoqërinë e informacionit dhe të drejtën për informacion. Rezultatet kryesore nga prezantimi i znj. Metcalf ishin: në e-Qeverisje nuk ka nevojë për legjislacion të specializuar; mbrojtja e të dhënave personale është thelbësore dhe identifikimi elektronik duhet të rregullohet me lig.

Gjatë vizitës në Ministrinë e Drejtësisë u prezantua ndikimi i vlerësimit në procesin e hartimit të legjislacionit. Hartimi i legjislacionit paraprihet nga konsultimet e akterëve, që sigurojnë përfshirjen publike nga një fazë e hershme e procesit legjislativ. Cikli legjislativ përfshin pesë hapa: qëllimin e legjislacionit, koncept dokumentin, projektligjin + memorandumun shpjegues, hyrjen në fuqi të ligjit dhe vlerësimin ex-post.

Modeli i Kostimit Standard përdoret për të zvogëluar barrën administrative, gjë që mundëson që barra administrative të matet në procesin legjislativ. Estonia nuk ka shumë përvojë në përdorimin e Modelit të Kostimit Standard.

## Shtojca 11: Raporti i vizitës studimore në Gjermani

### VIZITA STUDIMORE NË GJERMANI PROGRAMI PËR ZVOGLËLIMIN E BARRËVE ADMINISTRATIVE

#### Informata të historikut:

Në vitin 2017, Qeveria themeloi Grupin e Punës për zhvillimin e Koncept dokumentit për zvogëlimin e barrëve administrative i cili synon krijimin e një programi të gjerë për zvogëlimin e barrës administrative dhe modernizimin e kornizës ligjore. Deri më tani, analiza mbështetet kryesisht në shembullin e Holandës, që është vendi i parë që fillon një politikë të suksesshme të zvogëlimit të barrëve administrative të udhëhequr nga një cak zvogëlimi dhe arritje të matshme bazuar në Modelin e Kostimit Standard. Përveç Holandës, Gjermania është një tjetër pararendëse e kësaj politike në Bashkimin Evropian, qasja e së cilës ndryshon dukshëm nga zbatimi i politikës së zvogëlimit të barrëve administrative të zbatuar nga holandezët. Gjermania zhvilloi një bazë ligjore për politikën e zvogëlimit dhe e menaxhoi matjen e barrëve së brendshmi me Zyrën Federale të Statistikave (Destatis). Prandaj, duke marrë parasysh rëndësinë dhe kompleksitetin e çështjes, u organizua një vizitë studimore në Gjermani për grupin punues përgjegjës. Vizita u zhvillua në Berlin nga 20 deri më 26 tetor 2019 dhe u përkrah financiarisht nga projekti i Luksemburgut për zhvillim, që operon në kuadër të Ministrisë së Integritimit Evropian në Kosovë. Agjenda e vizitës studimore dhe lista e pjesëmarrësve janë bashkangjitur në shtojcat II dhe III të këtij raporti.

---

#### RAPORTI

##### Dita e parë - 21 tetor 2019

Në ditën e parë të vizitës studimore në Gjermani, grupi nga Kosova u takua me zyrtarë të Zyrës Federale të Statistikave të Gjermanisë dhe me zyrtarë të Parlamentit Federal të Gjermanisë. Takimi i parë u përqendrua në matjen bazë të barrëve rregullatore, ndërsa takimi i dytë u përqendrua në koordinimin midis Parlamentit dhe Qeverisë për programin e barrëve administrative. Pikat kryesore të diskutimit dhe aspektet përkatëse janë paraqitur në tekstin më poshtë.

Takimi i parë (dita e parë): Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë

Tema: *Matja bazë - matja dhe zvogëlimi i barrëve rregullatorë*



Zyra Federale e Statistikave e Gjermanisë është institucion kombëtar i themeluar në vitin 1950 si autoritet më i lartë federal. Ministria e Punëve të Brendshme është organi përgjegjës për *mbikëqyrjen e saj administrative*, ndërsa *mbikëqyrja funksionale* kryhet nga ministrinë përkatëse në varësi të temave statistikore. Misioni i tyre është të ofrojnë dhe të shpërndajnë statistika të ndryshme për çështje sociale, ekonomike dhe ekologjike. Ato kanë 2.300 anëtarë stafi.

### **Përmbledhje historike dhe organizative e programit**

Programi për zvogëlimin e barrës administrative ka filluar në vitin 2006/07 dhe ishte marrë një vendim politik për iniciimin e programit. Pas marrjes së vendimit u krijua Këshilli Kombëtar për Kontroll Rregullator, i cili është përgjegjës për kontrollimin e vlerësimit të ndikimit rregullator nga ministrinë e linjës.

Brenda 1 viti e gjysmë, Destatis arriti të realizojë një matje bazë të barrës administrative për kompanitë dhe deri në vitin 2012, Qeveria Federale arriti objektivin prej 25% zvogëlim të barrëve administrative. Pas arritjes së objektivit, një tjetër çështje me rëndësi ka qenë monitorimi i zhvillimit të barrës administrative, prandaj ata prezantuan Indeksin e Kostos së Burokracisë (*Bureaucracy Cost Index*) dhe rregullën “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (*One In, One Out*)”, të cilat do të diskutohen më poshtë.

Edhe pasi që qeveria arriti objektivin për zvogëlim prej 25%, qytetarët dhe bizneset vazhduan të theksonin që barrët ishin problem; prandaj, qeveria vendosi që të prezantojë një projekt të ri të titulluar anketat mbi ngjarjet jetësore (*Life events surveys*). Ideja ishte që të kuptohen më tej barrët administrative me të cilat përballen njerëzit, por nga perspektiva praktike. Anketa kryesisht realizohet nëpërmjet intervistave përmes telefonit (5 deri në 6 mijë qytetarë dhe 1,5 mijë biznese). Anketa realizohet çdo 2 vjet dhe rezultatet e saj publikohen online.

### **Inicimi i programit**

Qeveria e vitit 2006 kishte politikë të përshtatshme për bizneset; prandaj, ajo inicioi zvogëlimin e barrës rregullatore si pako nxitëse pa pagesë për ekonominë. Metodologjia themelore e përdorur për llogaritjen e kostove ishte Modeli i Kostimit Standard, i cili përdoret në vendet e BE-së.

### **Këshilli Kombëtar për Kontroll Rregullator**

*Akti për themelimin e Këshillit Kombëtar për Kontroll Rregullator* përcakton bazën ligjore për themelimin e këtij autoriteti të pavarur. Akti përcakton rolin, funksionin, detyrat dhe metodat në bazë të të cilave operon Këshilli Kombëtar për Kontroll Rregullator (NRCC). Ai është organ i pavarur, nuk përfaqëson interesa politike dhe është i autorizuar për kontrollimin dhe monitorimin e Qeverisë Federale. Ai bashkëpunon me shtetet federale dhe komunat, shoqatat, institutet kërkimore etj. NRCC ka rreth 15 punonjës.

### **Zyra Federale e Statistikave**

Përveç NRCC, Zyra Federale e Statistikave (Destatis) ka rol kyç në këtë proces. Fokusi kryesor i punës së saj është rregullimi më i mirë dhe zvogëlimi i barrës administrative, ndërsa rreth 100 anëtarë të stafit punojnë për këtë qëllim. Shumica e stafit përbëhet nga persona që veçse kanë qenë duke punuar me statistika dhe rrjedhimisht i kanë pasur njohuritë dhe përvojën e nevojshme për matjen bazë. Ata janë përgjegjës edhe për realizimin e matjes ex-post dhe pasi që është proces shumë sfidues, nevojiten shumë persona që puna të kryhet me sukses.

Sa i përket strukturës organizative, Destatis ka një seksion që është përgjegjës për çështjet themelore, metodologjinë dhe TI-në, një seksion përgjegjës për vlerësimin e ndikimit, analizimin e të dhënave dhe rezultatet dhe dy seksione përgjegjëse për matjen e kohës dhe kostove.

Destatis është përgjegjëse për:

- Llogaritjen dhe publikimin e indeksit të kostove administrative;
- Realizimin e vlerësimit ex-ante të kostove të pajtueshmërisë dhe mbështetjen e Qeverisë Federale;
- Ofrimin e aplikacioneve të TI-së ku publikohen të gjitha rezultatet lidhur me barrën administrative dhe publiku mund të kontrollojë se çfarë barre administrative krijon secili ligj. Një nga aplikacionet e zhvilluara është ERBEX, aplikacion në Excel që është i përshtatshëm për llogaritje të barrëve të pajtueshmërisë nga përdoruesit. Programi përdoret nga ministritë e linjës pasi që shumica e tyre nuk kanë punuar me statistika.

### **Matja bazë**

Detyra e parë kryesore në procesin e zvogëlimin të barrës administrative është realizimi i matjes bazë. Në Gjermani, matja bazë është bërë vetëm për kostot administrative që prekin bizneset. Deri më tani nuk ka pasur matje bazë për kostot e pajtueshmërisë për qytetarët apo administratën publike.

- Prill 2006 – Pika fillestare – Vendimi i marrë nga Këshilli i Ministrave (Kabineti) për iniciimin e programit
- Gusht 2006 – Hartimi i manualit për metodologjinë
- Fundi i vitit 2006 – Trajnimi i ministrive të linjës për identifikimin e informatave të obligueshme. Janë identifikuar rreth 9500 informata të obligueshme. Edhe pse nuk ka pasur kontroll sistematik, informatat e ofruara nga ministritë janë monitoruar nga akterët, si shoqatat e biznesit;
- Fillimi i vitit 2007 – Filloi mbledhja e të dhënave për obligimeve që krijojnë më së shumti barrë (100 anëtarë të stafit u angazhuan për mbledhjen e të dhënave pasi që është proces shumë sfidues) dhe obligimet që krijojnë sasi të madhe të barrëve administrative janë matur së pari;
- Dhjetor 2008 – Është finalizuar publikimi i rezultateve.

Pasi që ideja ka qenë që të maten kostot e barrëve administrative në nivel kombëtar, ata nuk kanë përfshirë obligimet që rrjedhin nga Rregulloret e BE-së, ndërsa sa i përket direktivave, ata kanë përfshirë vetëm ato për të cilat Qeveria Federale e nivelit kombëtar është përgjegjëse.

Të dhënat janë mbledhur nga bizneset kryesisht nëpërmjet simulimeve, intervistave përmes telefonit dhe pyetësorëve. Nganjëherë mund të jetë e vështirë të kuptohet perspektiva e bizneseve duke kërkuar nga ato që të plotësojnë më shumë pyetësorë, pasi që mund të perceptohet nga bizneset si një barrë tjetër; prandaj, intervistat përmes telefonit dhe simulimet kanë qenë shumë të dobishme. Është e rëndësishme të maten obligimet që krijojnë shumë barra nëpërmjet intervistave, ndërsa simulimi mund të përdoret për obligimet që nuk krijojnë shumë barra.

Përparësia kryesore e përfshirjes së Agjencisë së Statistikave në proces është fakti që ajo ka informacione të cilësisë së lartë për tarifatat. Për simulimet kanë krijuar tabelën e shpenzimit të kohës, me parametra për vlerësimin e kohës. Aktivitetet janë grupuar dhe variablat kohore janë ndarë në të lehta, të moderuara dhe komplekse.

Për shembull, në lidhje me “kohën” ata janë munduar që të pyesin sa më shumë kompani që është e mundur se sa kohë u nevojitet që t’i përmbushin të gjitha informatat e obligueshme. Megjithatë, nëse janë 9500 informata të obligueshme, nuk ka kohë për kontaktimin e kompanive për të gjitha këto informata të obligueshme. Prandaj janë realizuar simulime, panele me ekspertë, intervista me ekspertë, intervista në letër dhe intervista në telefon për të kuptuar se sa kohë kalojnë në përmbushjen e të gjitha informatave të obligueshme. Tani ata nuk i përdorin intervistat në letër dhe, në bazë të përvojës së tyre, mënyra më efikase për mbledhjen e të dhënave janë intervistat me telefon.

#### *Rezultatet e përgjithshme:*

Numri i përgjithshëm i obligimeve të matura ishte 9519, që ka krijuar barrë të përgjithshme administrative prej 49,3 miliardë euro. Ministrinë që kanë qenë përgjegjëse për krijimin e shumicës së barrëve administrative ishin Ministria e Financave (43%) dhe Ministria e Drejtësisë (24%), ndërsa Ministria e Mjedisit pothuajse nuk krijon barra administrative (3% e të gjitha barrëve).

Arritja e objektivit të zvogëlimit prej 25% nënkupton që prej 49,3 miliardë euro në vitin 2006, barrët administrative janë zvogëluar për 12,3 miliardë euro; prandaj, në vitin 2012 barra ka qenë 37,0 miliardë euro. Është e vështirë të përcaktohet se cili nivel paraqet shumë barrë administrative; prandaj, caktimi i objektivit prej 25% ka qenë kryesisht vendim politik.

## **Kostot e pajtueshmërisë**

Këshilli Kombëtar për Kontroll Rregullator kontrollon kuptueshmërinë dhe metodologjinë e vlerësimit ex-ante të *kostove të pajtueshmërisë* së rregulloreve të reja që prekin në veçanti qytetarët, sektorin e biznesit dhe administratën publike.

Fillimisht janë fokusuar vetëm në biznese; megjithatë, nga viti 2011, ata filluan të fokusoheshin edhe në kostot administrative me të cilat përballen qytetarët dhe administrata publike. Është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet kostove të burokracisë dhe kostove të pajtueshmërisë.

Kostot e pajtueshmërisë mund të rrjedhin nga *obligimet substanciale* (p.sh. instalimi i një filtri) apo nga *informatat e obligueshme* (p.sh. certifikata e instalimit të filtrit). Megjithatë, kostot që krijohen nga efektet makroekonomike, siç janë efektet në konkurrencë, rritje ekonomike dhe vendime për investime, tatime, kontribute në sigurimin social, përfitimet e një rregulloreje, etj., nuk përfshihen në koston e pajtueshmërisë.

### *Vlerësimi i kostove të pajtueshmërisë*

Hapi i parë për vlerësimin e kostove të pajtueshmërisë është identifikimi i obligimeve për të gjithë të adresuarit. Pas identifikimit të obligimeve, është e rëndësishme të identifikohet ndryshimi në kostot e pajtueshmërisë dhe për këtë nevojiten: numri i rasteve, kostot vjetore të pajtueshmërisë për rast, kostot e përshtatjes së njëhershme dhe ndryshimi i përgjithshëm në kostot e pajtueshmërisë. Hapi final është prezantimi i rezultateve të përgjithshme.

## **Cikli i monitorimit**

Në mënyrë që kostot e pajtueshmërisë të jenë gjithmonë të ulëta, është e rëndësishme të kemi një proces sistematik të monitorimit.

→ *Faza e parë*: Propozimi për rregullore të re

→ *Faza e dytë*: Aprovimi i konsultimit nga ministritë tjera

→ *Faza e tretë*: Vlerësimi ex-ante i kostove të pajtueshmërisë që kryesisht realizohet nga ministritë e linjës, por mbështetet nga Agjencia e Statistikave

- Gjatë kësaj faze, DESTATIS ofron këshilla profesionale, vlerësim ex-ante të pjesshëm dhe të plotë të kostove të pajtueshmërisë dhe mbështetje të TI-së. Ata gjithashtu janë përgjegjës për regjistrimet e reja në bazën e të dhënave WebSKM, ku vendosin numrat që janë në draftin final. Në gjysmën e rasteve, ministritë e linjës kërkojnë nga DESTATIS që të realizojë vlerësim ex-ante të plotë. Në 30% të rasteve, ministritë e linjës realizojnë vetë vlerësimet e ndikimit.

- Përveç kësaj, NRCC gjatë kësaj faze shqyrton nëse llogaritjet janë të besueshme dhe jep një deklaratë.

→ *Faza e katërt*: Drafti ligjor aprovohet në kabinet dhe dërgohet te Parlamenti.

→ *Vlerësimi*: Zakonisht, vlerësimi ex-post bëhet dy vite pas hyrjes në fuqi të legjislacionit. Në vlerësim theksohet lidhja ndërmjet qëllimit, kostove reale dhe përfitimeve nga rregullimet legjislative. Projekte shtesë, si “anketa mbi ngjarjet jetësore (life events survey)”, zbatohen për t’iu ofruar bizneseve dhe qytetarëve shërbime më të mira.

### **Indeksi i Kostos së Burokracisë**

Destatis krijon *Indeksin e Kostos së Burokracisë* (BKI), i cili tregon se si ndryshojnë barrët administrative që rrjedhin nga informatat e obligueshme, që përmbushen nga ndryshimet e bizneseve nëpërmjet rregullimeve të reja legjislative.

$$\text{BKI} = \text{Barra aktuale} / \text{Baza (llogaritur në vitin 2012)} \times 100$$

### **Rregulla “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (One In – One Out)”**

Rregulla “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (one in, one out)” është program politik që ka për qëllim t’i mbajë kostot të ulëta. Sipas kësaj rregulle, kur qeveria vendos një obligim të ri, duhet ta shfuqizojë një ekzistues.

Destatis llogaritë numrin e obligimeve që aprovohen në mënyrë që Qeveria të ketë informacione se sa obligime duhet t’i shfuqizojë. Destatis dërgon katër herë në vit një tabelë në Excel te ministritë e linjës me llogaritjet e obligimeve që aprovohen dhe atyre që shfuqizohen. Kancelaria Federale është përgjegjëse që t’i raportojë Parlamentit në baza vjetore për programin “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (one in, one out)”.

Disa nga përfundimet kryesore që duhet të nxirren janë:

- Matja bazë ka prezantuar një analizë sistematike dhe të bazuar në dëshmi të barrës rregullatore në Gjermani
- Kostot e pajtueshmërisë zgjerojnë fushëveprimin e analizës
- Mostrat e vogla mjaftojnë për vlerësimin e barrëve
- Caqet sasiore rritin presionin në ministri
- Koordinimi i institucionalizuar dhe vullneti politik janë thelbësorë

**Takimi i dytë (dita e parë): Parlamenti Federal i Gjermanisë**

**Tema: Bashkëpunimi dhe koordinimi me Qeverinë lidhur me programin për zvogëlimin e barrës administrative**

Takimi i dytë i ditës është mbajtur në Parlamentin Federal të Gjermanisë. Pas prezantimit të pjesëmarrësve, z. Hadamek bëri një përmbledhje të ngarkesës me punë gjatë një jave të zakonshme në parlament dhe ndarjen e kompetencave dhe punës lidhur me procesin e politikëbërjes.

Në Gjermani, të gjitha politikat kryesore duhet të krijohen në bazë të së drejtës parlamentare. Nga perspektiva e parlamentit, ligjvënja nënkupton vendosjen mbi ligjet, por jo hartimin e tyre. Parlamenti monitoron procesin e ligjvënies dhe të gjitha grupet politike kanë qasje në projektligje në fazën e tyre fillestare. Në këtë mënyrë grupet politike nga Parlamenti mund të monitorojnë grupet punuese të ministrive të linjës.

Në Gjermani, qëllimi kryesor është që të ketë një parlament të fortë të qeverisur nga partitë politike, e jo nga nëpunësit civilë. Në këtë drejtim, procesi i hartimit të Agjendës kërkon një konsensus midis të gjitha grupeve politike brenda Parlamentit. Pasi të jetë caktuar agjenda në mënyrë unanime brenda këtij grupi, parlamenti (pasi të ketë zgjedhur kancelarin) do t'ia përcjellë agjendën Qeverisë, përfshirë ministrive, të cilët më pas janë përgjegjës të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e agjendës.

Ministritë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe akteve ligjore, të cilat më pas dërgohen në parlament për të votuar. Grupet parlamentare nuk bëjnë ndryshime të mëdha në projektligje. Për shkak të kohës dhe burimeve të kufizuara, parlamenti nuk kontrollon dyfish të gjitha dokumentet analitike që ata marrin; megjithatë, ata kanë tendencë të dëgjojnë publikun. Një shqyrtim më i detajuar bëhet në dhomën e dytë, ku ata kanë rreth dy muaj e gjysmë kohë për të lexuar dhe diskutuar mbi një version përfundimtar të projektligjit. Në këtë fazë, partitë politike e dinë që është shansi i tyre i fundit për të ngritur çfarëdo çështje të rëndësishme dhe për të ndikuar në të.

Për shkak të parimit të "një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (one in – one out)", ndryshimet e brendshme mund të jenë me shumë ndikim. Prandaj, ndryshimet kryesore hartohen në ministri. Qeveria duhet të deklarojë nëse një projektligj i ri prezanton barra të reja dhe pastaj komitetet diskutojnë nëse kjo duhet të shkojë përpara apo jo, por administrata që punon në Parlament nuk mund të bëjë asgjë në lidhje me të, përveç se të paralajmërojë grupet politike. Parimet e ligjvënies së mirë detyrojnë Qeverinë ta informojë Parlamentin për kostot e pajtueshmërisë që krijojnë projektligjet e reja.

Përveç procesit të ligjvënies dhe koordinimit, dr. Hadamek foli edhe për buxhetin, për të cilin nevojitet një proces i veçantë i ligjvënies. Qeveria ka të drejtën e iniciativës dhe Parlamenti ka të drejtë të ndryshojë draftin. Komisioni i buxhetit është një organ shumë i fortë i cili ka grupe punuese (të përbëra nga përfaqësues të të gjitha grupeve politike) për secilën ministri dhe ato kanë gjithashtu kompetenca për të ndaluar Qeverinë që të përdorë burimet në buxhet.

Kur diskutoni për buxhetin, shpenzimi i tepërt dhe shpenzimi më i ulët janë dy çështje kryesore. Ka ministri që shpenzojnë më tepër dhe disa që shpenzojnë më pak. Nëse një ministri nuk mund t'i shpenzojë fondet që i janë alokuar, do të thotë që diçka nuk po shkon siç është planifikuar, ose pritjet janë shumë të larta ose administrata

është shumë e dobët për të zbatuar qëllimet. Burimet e mbetura nuk ndahen automatikisht për vitin e ardhshëm fiskal. Ndërkohë, për tejkalimin e shpenzimeve, Qeveria duhet të sjellë një ligj të ri që zgjeron buxhetin dhe procedura është e njëjtë si për ligjin e përgjithshëm të buxhetit.

---

### Dita e dytë – 22 tetor 2019

Gjatë ditës së dytë të vizitës studimore u mbajt një konferencë në Zyrën e Kancelarit Federal të Gjermanisë. Pikat kryesore të diskutimit dhe aspektet përkatëse janë paraqitur në tekstin më poshtë. Me rëndësi të veçantë ishin kontributet e kancelares federale dr. Angela Merkel dhe kryetarit të Këshillit Kombëtar për Kontroll Rregullator, dr. Johannes Ludewig.

Konferenca (dita e dytë): Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë

Tema: *Raporti i Këshillit Kombëtar për Kontroll Rregullator*

Folësit: kancelarja federale dr. Angela Merkel dhe kryetari i Këshillit Kombëtar për Kontroll Rregullator dr.

Johannes Ludewig

*Fjalimi hyrës nga dr. Johannes Ludewig, kryetar i Këshillit Kombëtar për Kontroll Rregullator (NRCC)*

NRCC organizon konferenca vjetore mbi rregullimin më të mirë dhe zvogëlimin e pengesave burokratike (red tape). Çdo vit, Kancelarja Federale është e pranishme dhe tregon mbështetjen e saj personale dhe politike përmes pjesëmarrjes së saj.

Rregullimi më i mirë është të dini se çfarë vendimesh merr një qeveri pasi tregon ndikimet e pritura. Kjo siguron një transparencë shumë të vlefshme dhe përcaktimi i rreptë i kostove do të thotë që këto mund të kontrollohen në mënyrë efektive. Pas zvogëlimit fillestar të barrës administrative për 25%, Qeveria Federale gjithashtu ka kursyer rreth 2 miliardë euro në kostot e pajtueshmërisë që nga viti 2015. Sidoqoftë, edhe pse disa masa njihen gjerësisht si sukseset nga kompanitë, ka ende shembuj që kompanitë janë të mbingarkuara nga kërkesat dhe detyrimet burokratike.

Gjermania ka krijuar një sistem funksional ex-ante të vlerësimit të ndikimit me një zgjedhje të qartë për të përqendruar përpjekjet e kuantifikimit në anën e kostos. Procesi i vlerësimit ex-post është vendosur zyrtarisht, por nuk jep cilësinë uniforme të nivelit të lartë që duhet të japë. Duhet të përmirësohet në mënyrë që të sjellë procesin në nivelin e cilësisë së vlerësimit të ndikimit ex-ante.

Konsultimi i palëve të interesit për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe masave të politikave duhet të zgjerohet. Grupet konsultative - Laboratorët digjitalë (Digitallabore) - të krijuar për zbatimin e Ligjit për Qasje në Nternet (Onlinezugangsgesetz) se si të zbatohen kërkesat janë shumë të suksesshme dhe të vlerësuara. Kjo

qasje duhet të zbatohet edhe në fusha të tjera, në veçanti për tema komplekse. Koha e investuar në përgatitje është kohë e shpenzuar mirë pasi rrit cilësinë, pranimin dhe besimin në vendimet e Qeverisë.

NRCC po avokon gjithashtu mbi një ndryshim të të menduarit në Gjermani, të cilit i referohet si “së pari përmbajtja, pastaj teksti ligjor” (Erst der Inhalt, dann die Paragraphen). Sipas sistemit aktual, ministritë e linjës zhvillojnë së pari tekstet ligjore dhe më pas vlerësojnë ndikimet e këtij teksti. NRCC përpiqet për një sistem në të cilin bëhet analiza para fillimit të procesit të hartimit ligjor.

*Fjalimi kryesor nga dr. Angela Merkel, kancelare federale e Republikës Federale të Gjermanisë*

Fjalimi u karakterizua nga një kuptim i hollësishëm i politikës për të zvogëluar dhe përmbajtur barrët rregullatore, përfshirë çështjet metodologjike.

Kancelarja ngriti çështjen politike gjithnjë të pranishme në lidhje me ekuilibrin midis numrit të ligjeve, rregullave dhe procedurave nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, cilat nga këto janë ende të nevojshme me kalimin e kohës dhe si mund të përmirësohet më tej zbatimi i tyre. Politika për të zvogëluar barrët dhe kostot ka nevojë për përqendrim dhe vëmendje afatgjate dhe, në bazë të atij kushti, çon në rezultate mbresëlënëse dhe të dobishme.

Politika gjermane për t'i zvogëluar barrët administrative dhe kostot e pajtueshmërisë bazohet në bazën që qëllimet e politikës nuk debatohen. Këto merren si fakt pasi ato u vendosën në mënyrë politike dhe vetëm me anë të asaj mënyre mund të ndryshohen përsëri. Thënë kështu, kostot për të arritur këto qëllime, megjithatë, duhet të vlerësohen në mënyrë kritike në mënyrë që ato të mbeten proporcionale dhe të sigurojnë që shoqëria (qytetarët, kompanitë dhe administrata) të mos shpenzojë burime të vlefshme.

Zvogëlimi i barrëve administrative nuk është gjithmonë i lehtë. Ka shumë akterë të përfshirë, duke filluar nga BE-ja e der në nivelin Federal të Gjermanisë dhe nga Leander (niveli rajonal) deri tek komunat. Është pothuajse gjithmonë dikush që do ta konsiderojë të domosdoshme mbrojtjen e rregullave ekzistuese. Këto aspekte duhet të adresohen në mënyrë efektive dhe me respekt.

Kuptimi njerëzor duhet të udhëheqë mënyrën e zbatimit të politikave dhe legjislacionit. Proceset e zbatimit dhe procedurat administrative nuk duhet të zyrtarizohen tej mase. Shërbimet duhet të jenë të orientuara nga përdoruesi dhe të lehta për t'u përdorur nga përdoruesit. Formularët duhet të jenë të lehtë për t'u kuptuar dhe të lehtë për t'u plotësuar. Administrata duhet të jetë e arritshme dhe jo vetëm gjatë orarit zyrtar të punës. Këto aspekte janë ngulitur plotësisht në procesin e digjitalizimit.

Qeveria gjermane ka treguar rëndësinë e qëllimeve të zvogëlimin të barrës administrative përmes ngjarjeve, të tilla si punëtoritë tematike që u organizuan në vetë Kancelarinë Federale. Këto u mbajtën për të zhvilluar



propozime të reja për zvogëlim së bashku me palët e interesit dhe qytetarët/organizatat e prekura. Pas dy iniciativave të mëparshme përgjatë kësaj linje, Qeveria ka përgatitur ligjin e tretë për zvogëlimin e burokracinë, i cili aktualisht është duke u proceduar përmes Parlamentit.

*Diskutime në panel:*

1. Mbyllja e hendekut të realitetit: Çfarë do të thotë zvogëlimi i burokracisë për qytetarët dhe kompanitë?
2. Vendorsja e përmbajtjes së pari - Drejt një kulture të re legislative?

Burokracia në formën e rregullave, procedurave dhe kërkesave është e nevojshme pasi që është një element thelbësor i sundimit të ligjit, mundëson konkurrencën e duhur, është baza për çdo ofrim të shërbimeve dhe zvogëlon korrupsionin. Burokracia e panevojshme dhe e paefektshme qëndron në vështirësitë me të cilat përballen njerëzit kur merren me procedura joefektive dhe joefikase. Kjo ndodh veçanërisht kur nuk kuptohet vlera e shtuar e punës që kryhet.

Burokracia, siç perceptohet nga qytetarët dhe kompanitë, është një koncept më i gjerë në krahasim me aspektet që politika e zvogëlimit mbulon në të vërtetë. Përderisa nevojitet një përqendrim, një program që synon të zvogëlojë barrët duhet të lidhet me përvojat e kompanive dhe qytetarëve.

Komunikimi është absolutisht thelbësor për një program të tillë. Administrata duhet të tregojë se çfarë është bërë në të vërtetë në praktikë. Qeveria duhet të sqarojë se çfarë po punon dhe duhet të konsultohet me grupet përkatëse të synuara (veçanërisht ato që preken nga procedurat dhe ato që i zbatojnë ato drejtpërdrejt) dhe të diskutojë me to mbi mundësitë dhe kufizimet.

Zvogëlimi i barrëve administrative është një përgjegjësi që kërkon vëmendje të vazhdueshme. Prandaj, duhet të përfshihet plotësisht në procesin e vendimmarrjes standarde për politikën dhe legjislacionin.

Meqenëse të gjitha nivelet e qeverisjes janë relevante, të gjitha duhet të përfshihen: niveli kombëtar dhe ai lokal, inspektimet, agjencitë etj. Zvogëlimi i burokracisë duhet të konsiderohet si një investim në shoqëri, veçanërisht kur lidhet me digjitalizimin. Ministrat dhe menaxhmenti i lartë i ministrive duhet ta bëjnë zvogëlimin e barrëve administrative prioritet kryesor për veten e tyre. Procesi është intensiv sa i përket burimeve, si dhe për sa i përket orarit të personelit dhe buxhetit. Ia vlen kur është i suksesshëm. Është e rëndësishme të mos e teproni me politikën. Numrat që paraqiten duhet të komunikojnë historikun e vërtetë.

Shumë procedura dhe kërkesa të vogla dhe të kuptueshme mund të çojnë lehtë në një labirint të detyrimeve që është i vështirë për të naviguar në të. Meqenëse këto procedura dhe kërkesa zbatohen nga një sërë

institucionesh të ndryshme, është e rëndësishme të sigurohet koordinim dhe mbështetje në nivelin më të lartë të qeverisë.

Gjermania ka përjetuar një dallim të konsiderueshëm midis komunave të mëdha dhe të vogla (më të vogla) dhe aftësive përkatëse të tyre për të zbatuar dispozitat ligjore në mënyrë efektive dhe efikase. Kontributi nga një zyrtar nga Mbretëria e Bashkuar dhe pasqyrë në mësimet kryesore të nxjerra me politikën e rregullimit më të mirë. Dallimi profesional midis hartimit të politikave dhe hartimit ligjor është shumë i rëndësishëm. Qasja e përgjithshme në Mbretërinë e Bashkuar është që në fillim të provoni gjithçka tjetër përveç legjislacionit, p.sh. fushatat e informacionit publik dhe stimujt tatimorë.

Regjimet parandaluese shkaktojnë shumë barra pasi ato bazohen në shumë informacione që duhet të ndahen me administratën në mënyrë që të vlerësojnë nëse pajtueshmëria është me të vërtetë e mjaftueshme.

Për nga natyra, tekstit ligjor nuk janë të lehta për t'u kuptuar. Administrata e Mbretërisë së Bashkuar vendos një përqendrim të rëndësishëm në shpjegimin e kërkesave ligjore në mënyrë që qytetarët dhe kompanitë të mund të kuptojnë lehtësisht se çfarë pritet të bëjnë.

Digjitalizimit iu desh kohë e gjatë që të arrijë. Qasja fillestare nga viti 2001 duhet të rishikohet në mënyrë të konsiderueshme disa vjet më vonë. Menaxhimi dhe koordinimi efektiv në nivel qendror është thelbësor për suksesin e digjitalizimit të shërbimeve dhe proceseve qeveritare.

Inovacioni në politikë publike shpërblehet. Në të ashtuquajturin Laboratori për Politika, ekipe të vogla janë duke provuar mënyra inovative për të zhvilluar dhe zbatuar politika.

Vlerësimi ex-post deri më tani nuk është zhvilluar shumë mirë si praktikë. Vlerësimi është një strukturë e rëndësishme ndërtimi e ciklit të politikave që duhet të planifikohet gjatë vlerësimit ex-ante të ndikimit, në mënyrë që të jeni në gjendje të mbledhni prova të vlefshme gjatë procesit të zbatimit dhe kohës së zbatimit. Njëpunësit civilë britanikë kalojnë një ditë në një kompani çdo vit dhe shohin anën tjetër të politikave dhe legjislacionit. Kjo vlerësohet shumë nga bizneset.

---

### [Dita e tretë – 23 tetor 2019](#)

Në ditën e tretë të vizitës, delegacioni nga Kosova u takua me përfaqësuesit e Zyrës Federale të Kancelarëve dhe të Këshillit Kombëtar për Kontroll Rregullator. Pikat kryesore të diskutimit dhe aspektet përkatëse paraqiten në tekstin më poshtë.

*Takimi i parë (dita e tretë): Zyra Federale e Kancelarëve  
Tema: Menaxhimi i Programit për Zvogëlimin e Barrës Administrative nga Zyra Federale e Kancelarëve*

Në Gjermani, administrata publike organizohet nga parimi i vetadministrimit. Historia e rregullimit më të mirë filloi në vitin 1984, ku ministrat vendosën të krijojnë një listë kontrolli dhe të përdorin ekonominë e sjelljes. Lista kontrolluese u shtyp në një letër blu për ta dalluar nga të gjitha letrat e tjera të bardha në tavolinë, në mënyrë që njerëzit ta vërejnë më lehtë atë. Qeveria Federale në vitin 1985 rikonfirmoi rëndësinë e listës kontrolluese dhe pesë vjet më vonë qeveria vendosi që ata kanë identifikuar një nevojë të qartë për trajnim.

Që nga ajo kohë, projektligjet në Gjermani përmbajnë një përmbledhje ekzekutive shumë të strukturuar (maksimum 2 faqe, me strukturën e mëposhtme: përkufizimi i problemit, qëllimet, zgjidhjet, alternativat, kostot); një letër zyrtare e Kancelarit; teksti ligjor (rreth 10 faqe) i cili pasohet nga një memorandum shpjegues (rreth 40 faqe), që përmban një pjesë të përgjithshme dhe një pjesë të veçantë që tregon arsyetimin për secilin rend të ndryshimit që është paraqitur në tekstin ligjor). Kjo strukturë është e zbatueshme edhe sot, në të gjitha dokumentet zyrtare. Sidoqoftë, këto dokumente nuk përmbanin asnjë numër, andaj listat kontrolluese nuk ishin gjithmonë efektive. Prandaj, ata ndryshuan modelin. Letra blu nuk përdoret më dhe përmbledhja ekzekutive përmban numra dhe llogaritje të cilat më pas përfshihen në raportin vjetor. Përfitimi politik i këtyre numrave është se nëse numrat janë të drejtë, ata do të tregojnë një storie, dhe nëse këta numra tregojnë një storie, njerëzit e tjerë do të jenë në gjendje t'i ndjekin ata.

Në mënyrë që të prodhojnë këta numra ata përdorin Modelin e Kostimit Standard (MKS). Faktori i suksesit i MKS është të fillojë me një rast të vetëm efektiv dhe të kuptojë se çfarë po ndodh në jetën reale. Ministrinë e linjës llogaritit kostot e pajtueshmërisë duke iu referuar ngjarjeve në jetën reale. Sipas tyre, MKS nuk duhet të përdoret si një mjet i marketingut, por një mjet i cili ndihmon për të kuptuar se çfarë po ndodh në jetën reale. Për ta arritur këtë, administratës i duhet një element i menaxhimit të cilësisë.

Përveç tabelës standarde në Udhëzime, zyrtarët që llogaritit kostot e pajtueshmërisë duhet të arrijnë dhe të shkojnë atje ku njerëzit jetojnë për të kuptuar se çfarë ndodh dhe si po ndikon barra tek ata. Ata duhet të lënë zyrat e tyre dhe të dalin atje (kjo mund të lidhet me planifikuesit urban të cilët, përpara se të hartojnë një plan për një zonë të caktuar, shkojnë në atë zonë në mënyrë që të mund të kenë një përvojë personale).

Menaxhues i cilësisë në Gjermani është Këshilli i Pavarur Kombëtar për Kontroll Rregullator (NRCC). Dhjetë anëtarë emërohen nga Qeveria Federale dhe më pas emërohen nga Presidenti Federal për një mandat prej pesë vitesh. Të emëruarit zakonisht janë ekspertë dhe shkencëtarë me përvojë në çështjet legislative. NRCC shqyrton çdo propozim ligjor, nëse kostot e informacionit dhe pajtueshmërisë dhe pjesët e tjera të memorandumit shpjegues janë gjithëpërfshirëse. Ata kanë mandat ligjor për t'u konsultuar gjatë konsultimeve ndërministrorë, përpara konsultimit publik. Fuqia e tyre qëndron në dhënien e një deklaratë, e cila është një pjesë shtesë në

dokumentin zyrtar të projektligjit bashkangjitur në fund. NRCC i raporton Kancelares çdo vit dhe raporti i përcillet Parlamentit.

Në rast se kanë ndonjë koment/deklaratë kritike, ata nuk kanë të drejtën e vetos ndaj Qeverisë, por në situata të tilla Qeveria duhet të japë një deklaratë mbi këtë pikëpamje kritike dhe bazuar në përvojën e tyre, kjo është një metodë shumë efektive. NRCC duhet të përfshihet në një fazë shumë të hershme të hartimit ligjor. Ata duhet të përgatisin deklaratën përfundimtare brenda afatit të kërkuar për konsultime ndërministrore.

Sa i përket Vlerësimeve të Ndikimit Rregullator (VNRr), nëpunësit civilë mund të kenë përshtypjen se akteri ose konsulenca e jashtme duhet të bëjnë llogaritjet dhe vlerësimin. Sidoqoftë, pasi që dokumenti zyrtar ka të bëjë me të kuptuarit e procesit dhe jo vetëm rreth numrave, Zyra e Kancelarit dëshiron që njerëzit që punojnë brenda ministrive të kryejnë vetë VNRr dhe, nëse është e nevojshme, kjo mund të bëhet me mbështetjen e Zyrës Federale të Statistikave.

Për të ndryshuar qëndrimin e njerëzve, krahas kërkesës zyrtare (e cila në vitet '80-'90 ishte vërtetuar se nuk ishte efektive), ata mbajtën shumë trajnime, patën shumë diskutime për rëndësinë e vlerësimeve të ndikimit, ofruan mbështetje teknike dhe ekzistonte një element i presionit politik. Elementi i presionit politik hyn në lojë pasi në fund e gjithë Qeveria duhet të vendosë nëse një projektligj do të dërgohet në Parlament dhe nëse të gjithë ministrat nuk janë të kënaqur, Qeveria nuk do ta miratojë atë. Dy ministri që kanë të drejta të vetos janë Ministria e Financave dhe Ministria e Çështjeve Gjinore.

Thelbi i ndryshimit të sjelljes është mentaliteti i njerëzve. Nëpunësit civilë ndryshojnë të ardhmen, kështu që ata duhet të kuptojnë se cili do të jetë efekti i ligjit në jetën reale.

*Zyra Federale e Statistikave* ka një rol kryesor në këtë proces pasi që konsiderohet se ofron *Shërbime qendrore për Rregullim më të Mirë*, të tilla si:

- Baza e të dhënave publike për matjen e programit të Qeverisë (detyrim ligjor)
- Monitorimi i brendshëm
- Validimi empirik i kostove të pajtueshmërisë
- Mbështetja e ministrive sipas kërkesës: vlerësimi ex ante dhe ex post
- Anketa mbi ngjarjet jetësore
- Metodologjia

*Pyetje:* Nëse Parlamenti ndryshon projektligjin dhe ato ndryshime pritet të shkaktojnë kosto të pajtueshmërisë, a bën ministria sponsorizuese e linjës një llogaritje shtesë mbi efektin e ndryshimeve, a reagon NRCC menjëherë apo i lihet në dorë vlerësimin ex post?

*Përgjigje:* Mund të ndodhin të gjitha. Puna kryesore për një projektligj ndodh në takimet e komisioneve, ku Qeveria ulet në tryezë me anëtarët e parlamentit. Sidoqoftë, ata nuk mund të ndikojnë në parlamentarët të cilët nuk përqendrohen shumë në kostot e pajtueshmërisë (Parlamenti Francez ka rishqyrtuar rolin e tij edhe në Rregullimin më të Mirë dhe në Parlamentin e BE-së). NRCC ka mandatin të mbështesë Parlamentin me kërkesë, kështu që ata mund të ftohen të ulen në tryezë dhe të nxjerrin një deklaratë përfundimtare për projektligjet.

#### *Vlerësimet e ndikimit*

Vlerësimet e ndikimit reflektojnë deri në 40 aspekte të një propozimi ligjor. Kostot e pajtueshmërisë janë një çështje që duhet adresuar në propozimet ligjore krahas p.sh. ndikimeve shoqërore, qëndrueshmërisë, barazisë gjinore, efekteve në shëndetin publik (shtëpiak) etj.

## **SHEMBUJË**

### *1. Pakoja ligjore për forcimin e familjeve*

Reforma e shtesave të fëmijëve për familjet me të ardhura të ulëta:

- Rritja nga një maksimum prej 170 euro në 185 euro
- Dhënia fikse për 6 muaj
- Lirimi nga tarifat e kopshtit të fëmijëve
- Shuma më e lartë e lirit për të ardhurat vetanake dhe mirëmbajtjen
- 1,2 milionë fëmijë të tjerë do të jenë të kualifikueshëm
- Shtesat e fëmijëve tani të mundësuar në vend të rritjes së të ardhurave për jetesë

Reforma e qasjes së përmirësuar në arsim dhe pjesëmarrje për familjet me përfitime ose me të ardhura të ulëta:

- Rritja në pakon shkollore për fillestarë
- Vakte falas gjatë kohës së drekës
- Bileta falas për transport publik
- Më shumë mbështetje për të nxënësit falas

Efektet në kostot e pajtueshmërisë duhet të përshkruhen në të gjitha drejtimet:

- Për 90.000 ose më shumë njerëz që aktualisht marrin shtesa për fëmijë, ky projektligj do të thotë **reduktim** në kostot e pajtueshmërisë prej rreth 120.000 orë në vit

- Për 473.000 fëmijë të parashikuar **shitesë** që do të kenë të drejtë që nga viti 2020 dhe përafërsisht 190.000 familje të tyre supozohet se kostot e pajtueshmërisë do të jenë përafërsisht 570.000 orë në vit.

Pra, e para tregon se ka një zvogëlim të barrës administrative, megjithëse numri i përfituesve do të rritet që nënkupton se edhe barra në fund do të rritet. Në këtë rast ata nuk po flasin për euro pasi që vendosën të mos monetarizojnë kohën e qytetarëve.

Në Gjermani ata shmangin kryerjen e analizës kosto-përfitim sepse besojnë se filozofia e analizës kosto-përfitim do t'iu çojë në drejtim të gabuar për shkak të një paragjykimi të fortë të orientuar në përfitime. Ata shpjegojnë kostot dhe përfitimet, por nuk i përziejnë ato së bashku.

## 2. Futja e pagës minimale në Gjermani në vitin 2014

Vlerësimi i kostove të pajtueshmërisë në vitin 2014 ishte shumë i lartë; megjithatë, ata prapë e miratuan ligjin sepse partnerët e koalicionit ishin të vendosur për t'u dhënë të gjithëve të ardhura të favorshme.

Për ta vënë ligjin në funksion ishte i domosdoshëm një mekanizëm zbatimi dhe ky mekanizëm ishte policia financiare që lufton punën e paligjshme. Sidoqoftë, pasi u miratua ligji, kompanitë filluan të ankohen për barrën administrative.

Problemi ishte se policia e armatosur dhe në uniformë filluan hetimet për të ardhurat dhe ata shfaqeshin në dyqane gjatë orarit të punës. Kjo shkaktoi parehati në mes klientëve dhe pronarëve. Kështu që, Qeveria kuptoi se mekanizmi përmbaues që ata kishin zgjedhur po shkaktonte barrë administrative.

Mësimi kryesor që u nxjerr nga kjo ishte se për të marrë si duhet kostot e llogaritjes, Qeveria duhet të ketë një vizion të qartë se çfarë do të ndodhë në praktikë. Pra, ata duhet të flasin me ata të cilët bëjnë zbatimin dhe me ata të cilët bëjnë biznes.

Për të pasur një vizion më të qartë mbi çështjen dhe për të kuptuar efektet që një ligj ose politikë e caktuar do të ketë në jetën reale, ata gjithashtu kryejnë projekte thjeshtësimi. Për ta është e rëndësishme të kenë një qasje sistematike dhe të qëndrojnë kuriozë në mënyrë që të kuptojnë se çfarë ndodh kur pjesa e legjislacionit takohet me realitetin. Kështu që, ata zhvilluan anketën mbi “*ngjarjet jetësore*” sepse përvojat e njerëzve përcaktohen nga ngjarjet jetësore. Për të bërë pyetjet e duhura, ju duhet të kuptoni udhëtimin e përdoruesit (p.sh. dikush që po fillon një punë të re do të ketë kontaktin e parë me sigurimin shëndetësor dhe zyrën e kryetarit të komunës).

Libri i rekomanduar: *Intertwined – Peter Morville*

Takimi i dytë (dita e tretë): Këshilli Kombëtar për Kontroll Rregullator  
Tema: *Roli dhe vlera e shtuar e ekzaminimit të pavarur*

### **Elementet dhe aspektet e pavarësisë së NRCC**

Anëtarët e bordit punojnë mbi baza honorari, kështu që ata marrin një lloj shume të njëhershme. Ata emërohen nga Kreu i Shtetit për pesë vjet dhe kanë të drejtë të rizgjidhen. Anëtarët kanë një përvojë të gjerë profesionale në administratë, drejtësi, sektor biznesi, shkencë, etj.

Ligji përcakton mandatin, detyrat dhe detyrimet e tij, gjë që është unike në Evropë (në vendet e tjera zakonisht është në legjislacionin sekondar) dhe siguron lirinë nga ndërhyrjet politike. NRCC ka sekretariatit e tij të përbërë nga 15 anëtarë dhe buxhetin e vet. Opinionet e tyre publikohen kur dërgohen në Parlament, së bashku me propozimin legjislativ.

Sekretariati përgatit pothuajse gjithçka dhe paraqet draft deklaratën tek anëtari përgjegjës i bordit për projektligjin ose draft politikën përkatëse. Pasi të marrin miratimin nga anëtari përgjegjës i bordit, Sekretariati informon të gjithë bordin, të cilët pastaj diskutojnë opinionet e tyre në takimet e bordit (të mbajtura çdo dy javë). Njëmbëdhjetë persona nga Sekretariati janë të përfshirë në ekzaminimin e projektligjeve dhe hartimin e opinionëve. Ata pranojnë rreth 300 propozime në vit dhe lëshojnë opinione të plota për 1/3 e propozimeve që arrijnë standardin prej 1 milion euro. Për propozimet e tjera, opinionet mund të jenë vetëm disa fjali që konfirmojnë se propozimi nuk shkakton ndonjë kosto të madhe, megjithatë ata ende duhet të kalojnë nëpër procesin e konsultimit me anëtarin përgjegjës të bordit dhe gjithë bordin.

### **Fushëveprimi i Vlerësimeve të Ndikimit dhe Mandati i NRCC**

Rregullorja e përbashkët e Qeverisë kërkon një pamje relativisht të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të ndikimeve. NRCC është organ i pavarur këshillimor i Qeverisë dhe organ ekzaminues në fushën e zvogëlimit të burokracisë dhe rregullimit më të mirë. Krahasuar me organet e tjera ekzaminuese, NRCC ka fushëveprim shumë të ngushtë, duke u përqendruar vetëm në efektet e drejtpërdrejta të projektligjeve në kostot e pajtueshmërisë.

NRCC ekzaminon kostot e pajtueshmërisë dhe mund të rishikojë aspekte të tjera të tilla si:

- Paraqitja gjithëpërfshirëse e objektivave dhe domosdoshmëria e rregullores;
- Konsideratat lidhur me zgjidhje të tjera të mundshme, data efektive, afate kohore etj.

### **Funksioni i NRCC në procesin legjislativ**

- *Faza e parë:* Ministria përgjegjëse e linjës përgatit një draft propozim dhe NRCC menjëherë mund të japë një këshillë.

- *Faza e dytë:* Ministritë përgatisin vlerësim ex ante dhe kryejnë konsultime ndërministrorë me palët përkatëse të interesit. NRCC mund të ekzaminojë dhe këshillojë. Ministritë përgatisin vlerësimin e ndikimit, gjithashtu edhe për legjislacionin sekondar.
- *Faza e tretë:* Pasi të dërgohet propozimi legjislativ në Kabinet (Këshillin e Ministrave), NRCC harton opinionin e tij, i cili më pas publikohet si pako me propozimin dhe dokumentet e tjera mbështetëse.
- *Faza e katërt:* Propozimi legjislativ i dërgohet Parlamentit Federal, përfshirë opinionin e NRCC. NRCC mund të ofrojë këshilla ose të kryejë vlerësim të sjelljes me kërkesë të Parlamentit.
- *Faza e pestë:* 2 vjet pasi të miratohet ligji, Zyra Federale e Statistikave (Destatis) mund të kryejë ekzaminimin e shifrave dhe pas 3-5 vjetëve të miratimit të ligjit, ata kryejnë vlerësimin ex post. NRCC nuk ka mandat për ekzaminim e vlerësimeve ex-post, megjithatë, në shumicën e rasteve ata i ekzaminojnë ato, por nuk japin opinione zyrtare.

Sa i përket strukturës së opinionit të tyre, NRCC së pari i rendit kostot e pajtueshmërisë për qytetarët, bizneset, administratën publike dhe nëse ka prezantim të duhur të rregullës “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (One In, One Out)” dhe pastaj e krijojnë bazën e opinionit.

#### **Synimi i zvogëlimit prej 25% në lidhje me bizneset**

NRCC u prezantua për të shqyrtuar barrën administrative sepse qeveria vendosi synimin për zvogëlim prej 25%. Fillimisht, ata kishin një matje fillestare për të gjitha detyrimet ligjore për bizneset dhe synimi i zvogëlimit u arrit në vitin 2012.

#### **Zhvillimi i indeksit të kostos së burokracisë që nga matja fillestare**

<b>Viti</b>	<b>Matja</b>	<b>Kosto</b>
2006	Thjeshtimi i faturave për shuma të vogla (Akti i Tatimit në Shitje) dhe masave të tjera	600 milionë euro
2008	Thjeshtimi i dëshmisë së kthimit dhe riciklimit të paketimit të shitjes (urdhëresa e paketimit) dhe masave të tjera	186 milionë euro
2009	Thjeshtimi i rregullave të kontabilitetit, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (akti i modernizimit të ligjit të kontabilitetit) dhe masave të tjera	2,5 miliardë euro



2010	Futja e formularit elektronik të tatimit mbi të ardhurat (Akti i tatimeve vjetore 2018) dhe masave të tjera	278 milionë euro
2011	Thjeshtimi i faturimit elektronik (Akti i thjeshtimit të tatimeve 2011) dhe masave të tjera	4,1 miliardë euro
2012	Heqja e tarifës së konsultës mjekësore (Ndryshimi në Kodin Social të Gjermanisë Vëll.5) dhe masave të tjera	330 milionë euro
2015	Rritja e pragjeve për kontabilitetin e dyfishtë dhe pasqyrës financiare (Akti i Parë i Ndhmës së Burokracisë, 2015) dhe masave të tjera	744 milionë euro

Në vitin 2012 u arrit synimi i zvogëlimit dhe që atëherë u mbajt një nivel i ulët i saj.

### **Si të përmirësohet zvogëlimi i burokracisë: Digjitalizimi**

Digjitalizimi luan një rol të rëndësishëm për NRCC. Modernizimi i Regjistrave duhet të bëhet vetëm një herë dhe ata përdorin një thënie – “as qytetarët dhe as bizneset nuk duhet të mundohen për të marrë informacionin, ai duhet të vijë vetë”. Digjitalizimi mund të kontribuojë ndjeshëm në uljen e kostove.

### **Kostot e pajtueshmërisë dhe mënyra e kontrollimit të tyre**

Përveç transparencës, NRCC rekomandoi që Qeveria të tregohet më e kujdesshme kur fusin kostot e pajtueshmërisë. Kështu lindi ideja e rregullit “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (One In, One Out)”.

Grupi kryesor i synuar ishin bizneset. Mbretëria e Bashkuar tashmë kishte iniciuar parimin “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (One In, One Out)”. Legjislacioni i BE-së ishte lënë jashtë këtij rregulli.

### **Shmangia e barrëve të panevojshme të futura nga Legjislacioni i BE: Procedura ex ante e BE**

Megjithëse në Gjermani legjislacioni i BE nuk ishte përfshirë gjatë procesit të zvogëlimit të barrës administrative, ata krijuan një procedurë ex ante të BE-së, e cila tregon vlerën e kostove të pajtueshmërisë që do të shkaktojë akti i BE-së.

Së pari, një draft propozim i Komisionit të BE-së dhe Vlerësimi i Ndikimit të tij i dërgohen Qeverisë Federale të Gjermanisë. Pastaj, Qeveria ka të drejtë të kërkojë nga ministritë e saj të linjë më shumë informata dhe nëse kostot vjetore të pajtueshmërisë së këtij draft propozimi tejkalojnë 35 milion € në të gjithë BE-në, Gjermania duhet të kryejë një vlerësim të detyrueshëm të ndikimit të kostos se si draft propozimi do të ndikojë në Gjermani. Ky vlerësim i ndikimit të Qeverisë Federale i dërgohet NRCC, Kancelarisë Federale dhe Ministrisë Federale të

Ekonomisë. NRCC lëshon opinionin e tij dhe ia dërgon Qeverisë Federale. Ky mekanizëm forcon pozitën e Gjermanisë në Këshillin e BE-së.

### **Sigurimi që legjislacioni ekzistues është i përshtatshëm për qëllimin: Vlerësimi ex-post**

Kriteret kryesore për të kryer një vlerësim ex-post është një prag prej 1 milion € kostosh të përsëritura të pajtueshmërisë. Institucionet duhet të kenë një qasje sistematike dhe të kryejnë vlerësimin ex-post pasi të kalojnë 3 deri në 5 vjet nga miratimi i ligjit. Vlerësimi vlerëson efektivitetin e ligjit dhe i pari është bërë në vitin 2018. NRCC nuk ka mandat të ekzaminojë vlerësimet ex-post; megjithatë, në shumicën e rasteve ata i ekzaminojnë ato, por nuk japin opinione zyrtare.

### **Rekomandimet e NRCC për një Rregullim më të Mirë të përmirësuar**

*Rekomandimi 1:* NRCC i ka rekomanduar Qeverisë që të fusë një pilot projekt ku do të llogarit përfitimet e akteve ligjore. Pritet të jetë shumë e vështirë pasi është sfiduese për të matur dhe monetizuar përfitimet. Projekti duhet të përfshijë një mbulim gjithëpërfshirës të ndikimeve. Qeveria ende nuk ka vendosur për të.

*Rekomandimi 2:* NRCC ka rekomanduar një ndryshim të kulturës legjislative në Gjermani. Ata rekomandojnë të rimendohet legjislacioni: “së pari përmbajtja, pastaj teksti ligjor”. Kjo do të thotë që përpara se të hartohet ndonjë draft propozim, duhet të bëhet një vlerësim i ndikimit ku ata identifikojnë problemin dhe propozojnë zgjidhje. Sistemi që ata po rekomandojnë është shumë i ngjashëm me atë që po zbaton Kosova, ku koncept dokumentet bëhen para se të hartohet ndonjë projektligj.

### **Rregulla “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (One In, One Out)”**

Ministritë caktojnë një status për secilin propozim, nëse “aprovohet” ose “shfuqizohet”. Në fund të vitit, bëhet një ekuilibër për të parë nëse ka pasur më shumë “aprovime” apo “shfuqizime”, apo nëse kanë qenë të ekuilibruar.

Ka raste kur një ministri paraqet më shumë “aprovime” dhe nuk mund ta ekuilibrojë atë. Pra nëse nuk arrijnë të zgjidhin vetë, i drejtohen Qeverisë dhe ndonjë institucion tjetër e ekuilibron atë duke paraqitur të njëjtën sasi me “shfuqizimet”.

---

### **[Dita e katërt – 24 tetor 2019](#)**

Në ditën e katërt të vizitës, delegacioni nga Kosova u takua me përfaqësuesit e Ministrisë Federale për Çështje Ekonomike dhe Energji. Pikat kryesore të diskutimit dhe aspektet përkatëse janë paraqitur në tekstin më poshtë.

**[Takimi i parë \(dita e katërt\): Ministria Federale për Çështje Ekonomike dhe Energji](#)**

*Tema: Përvoja e ministrive të linjës në procesin e zvogëlimit të barrës administrative dhe roli i Gjermanisë në politikën rregullatore të BE-së*

**Sistemi monitorues për ndërmarrje të vogla dhe të mesme**

NVM-të janë forca kryesore drejtuese e ekonomisë gjermane. Ato përbëjnë 99% të të gjitha firmave, 35% të prodhimit ekonomik dhe 60% të vendeve të punës. Programi i zvogëlimit të barrës administrative në Gjermani nuk ka përfshirë detyrimet që dalin nga Rregulloret e BE-së dhe duke pasur parasysh që NVM-të ndikohen nga legjislacioni i BE-së, Qeveria Federale ka krijuar një sistem të Monitorimit për NVM-të për iniciativat e BE-së.

NVM-të duhet të informohen për iniciativat e reja në nivel të BE-së dhe duhet të sigurohet një platformë për të paraqitur interesin dhe mendimet e tyre gjatë fazës së hartimit të politikave.

*Si funksionon Monitorimi i NVM-ve:*

Në bazë të sugjerimit të emrit, Monitorimi i NVM-ve në mënyrë të vazhdueshme monitoron progresin e iniciativave konsultative dhe legjislative të Komisionit të BE-së lidhur me NVM-të.

Monitorimi i NVM-ve është ueb portal gjithëpërfshirës që:

- *Informon* NVM-të për legjislacionin evropian në fazë të hershme,
- *Drejton* ato përmes shumëllojshmërisë së informacioneve në internet, dhe
- *Ndihmon* ato për t'u përfshirë dhe pjesëmarrje aktive në një proces miqësor të politikë-bërjes për NVM-të në të gjitha fazat: nga *fillimi* i një iniciative → *tek vendimi politik* → *deri tek zbatimi* i tyre.

Për NVM-të është e rëndësishme të dini se cilat informacione janë relevante për to, cilat dokumente u nevojiten, ku t'i gjeni ato, çfarë përfundimesh të nxirrni, etj. Monitorimi i NVM-ve në këtë drejtim *rrit ndërgjegjësimin e hershëm* duke theksuar legjislacionin relevant të NVM-ve në të gjitha fushat e politikave, duke dhënë informacione të përditësuara dhe duke tërhequr vëmendjen e kompanive për çështjet e BE-së.

Monitorimi i NVM-ve bazohet në Programin Vjetor të Punës të Komisionit të botuar në fund të çdo viti.

- Së bashku me rreth 20 shoqata të NVM-ve përkatëse, *Ministria analizon dhe vlerëson nismat e planifikuara rregullatore* lidhur me rëndësinë e tyre për NVM-të.
- Ministria pastaj *përmbledh rezultatet* e këtij vlerësimi dhe harton një *listë monitorimi*, element thelbësor i Monitorimit të NVM-ve.
- Në këtë listë monitorimi, projektet me *rëndësi të madhe për NVM-të* janë shënuar me një sinjal paralajmërues për të tërhequr vëmendjen e hershme në mes të NVM-ve.
- Monitorimi i NVM-ve është *vënë në dispozicion* dhe përditësohet vazhdimisht nga Ministria në ueb-faqen e saj [www.eu-mittelstandsmonitor.de](http://www.eu-mittelstandsmonitor.de)

Komisioni i BE-së publikon iniciativat e tij dhe fton palët e interesit të kontribuojnë në politikën e BE-së dhe procesin e ligjvënies duke dhënë komente kthyesë. Megjithatë ueb-faqja e tyre rezultoi të ofrojë *informacione shumë të kufizuara për NVM-të*. Nuk ka ndërlidhje me projektet përkatëse në Programin e Punës të Komisionit, iniciativat përkatëse të NVM-ve nuk janë të ndara me iniciativa të tjera dhe nuk ka asnjë tregues të rëndësisë së NVM-ve. Pra, NVM-të mund *vetëm rastësisht* të identifikojnë projekte që janë të rëndësishme për to.

*Përvoja e fituar me Monitorimin e NVM-ve:*

Monitorimi i NVM-ve është një *element i rëndësishëm* nën titullin “Evropë” në uebfaqen e ministrisë. Plotëson *politikën gjermane të NVM-ve* dhe mbështet interesat e tyre në nivelin e BE-së. Sistemi ka marrë *reagime pozitive* nga ndërmarrjet dhe shoqatat e biznesit pasi që lejon *opsione të përshtatshme për NVM-të* që nga fillimi.

Monitorimi i NVM-ve do të përmirësohet më tej në bashkëpunim me shoqatat dhe pritet të bëhet një mjet jashtëzakonisht i dobishëm për sigurimin e NVM-ve dhe shoqatave me qasje në informacione kyçe mbi legjislacionin e BE-së. Sistemi ka përmirësuar ndjeshëm lobimin gjerman në Bruksel dhe ai ka përforcuar pozicionin e tij. Për më tepër, OECD e konsideron Monitorimin e NVM-ve gjermane si një nga praktikatat më të mira për të mbështetur NVM-të.

Pjesëmarrja e Gjermanisë në konsultimet publike të BE-së është shumë e lartë së bashku me vendet e tjera nordike si Danimarka dhe Holanda.

Gjatë diskutimeve lindi ideja që një mjet si ky mund të përdoret në Kosovë për të informuar bizneset për detyrimet përkatëse të BE-së që ndikojnë ato (referencë e bërë në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës).

### **Vlerësimet ex-ante të ndikimeve dhe rregullimi më i mirë**

Komisioni Evropian kryen vlerësimet e ndikimit për propozimet legjislative; megjithatë, ata nuk arrijnë të japin vlerësimet e ndikimit për 1/3 e të gjitha propozimeve të rëndësishme. Kur një propozim legjislativ i dërgohet Këshillit të BE-së, Gjermania informon ministritë përkatëse, të cilat pastaj kanë dy javë kohë për të kontrolluar nëse Komisioni ka kryer vlerësim të ndikimit, dhe nëse jo, ata do t'u kërkojnë që ta bëjnë këtë. Nëse Komisioni ka kryer vlerësimin, atëherë ministritë përkatëse do të kontrollojnë cilësinë e tij.

Këshilli Kombëtar për Kontroll Rregullator është gjithashtu i njohur si Këshilli për Rregullim më të mirë. Ata nuk mund të zëvendësojnë politikën, por ata informojnë politikën. Rregullimi më i mirë për Gjermaninë nënkupton efikasitetin, kështu që ata mund të çlirojnë burime dhe të mundësojnë të bëjnë gjërat më mirë dhe të bëjnë gjëra më të mira.

Gjermania po lobon për të përmirësuar vlerësimet e ndikimit dhe për një test të detyrueshëm të NVM-ve. Në mënyrë që rregulla “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (one in-one out)” të zbatohet suksesshëm në nivel të BE-së, duhet të keni kuantifikim, dhe për të pasur kuantifikim duhet të keni vlerësime të ndikimit me cilësi të lartë.

Për Gjermaninë raporti i “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (one in-one out)” është 3 me 1. Megjithatë, pasi që rregullat e BE-së janë të përjashtuara nga rregulli, raporti bie në 2 në 1. Disa raporte të OECD thonë se rregulla “një obligim aprovohet, një tjetër shfuqizohet (one in-one out)” mund të zbatohet vetëm në vendet e zhvilluara, pasi ato kanë strukturë institucionale. Por sidoqoftë, pasi që rregulla është ndryshues i lojës dhe nxit përmirësimin, Gjermania beson se ajo funksionon edhe në vendet në zhvillim.

#### *Legjislacioni që i reziston të ardhmes dhe është i përshtatshëm për inovacionin*

Gjatë procesit të hartimit të ligjit, është e rëndësishme të kontrollohet se çfarë nënkupton ligji për inovacionin. Nuk ka ndonjë lidhje të qartë midis rregullimit dhe inovacionit. Rregullimi mund ose të nxisë ose të pengojë inovacionin.

Në mënyrë që të kemi ligje më të mira, institucionet gjermane ndajnë pjesën e rezistimit ndaj të ardhmes nga pjesa e të qenit i përshtatshëm për inovacionin. Rezistenca ndaj të ardhmes nënkupton atë që mund të bëjmë që legjislacioni të përmbushë qëllimin e tij, ndërkohë që i përshtatshëm për inovacion nënkupton atë që mund të bëjmë që legjislacioni të nxisë inovacionin. Ekzistojnë mjete të ndryshme që mund të përdoren për këtë qëllim, të tilla si: klauzolat eksperimentale për të dhënë hapësirë për fleksibilitet dhe për t'i dhënë bizneseve ajrin për të marrë frymë dhe për inovacione; klauzolat e sensorëve për të përcaktuar afatet, në mënyrë që të rishikohet ligji; dhe të ketë një legjislacion të bazuar në rezultate.

---

#### **Dita e pestë – 25 tetor 2019**

Në ditën e pestë të vizitës, delegacioni nga Kosova takoi Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Gjermani z. Beqë Cufaj dhe përfaqësuesin e Shoqatës së Odave të Tregtisë dhe Industrisë së Gjermanisë.

#### **Takimi i parë (dita e pestë): Ambasada e Republikës së Kosovës në Gjermani Tema: Bashkëpunimi i ardhshëm ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë**

Ambasada e Republikës së Kosovës në Gjermani mirëpriti delegacionin e Kosovës në ambientet e saj, ku diskutuan për qëllimin e vizitës studimore dhe marrëdhëniet bilaterale mes Kosovës dhe Gjermanisë.

Drejtori i Sekretariatit të Koordinimit Qeveritar, në emër të grupit, foli për qëllimin e vizitës studimore në Gjermani, kryesisht duke u fokusuar në rëndësinë e rregullimit më të mirë dhe programin e zvogëlimit të barrës administrative.

Më pas, ambasadori dha një pasqyrë të aktiviteteve kryesore të Ambasadës dhe Konsullatave të tjera që ndodhen në Frankfurt, Shtutgart dhe Mynih. Në Gjermani jetojnë më shumë se 400.000 qytetarë të Kosovës dhe në mënyrë që të sigurohet mbështetje dhe shërbime në mënyrë efektive, ambasadori beson se atyre u duhen më shumë kapacitete njerëzore.

Disa nga çështjet kryesore të diskutuara ishin:

- Statistikat zyrtare në Gjermani lidhur me numrin e qytetarëve të Kosovës që jetojnë në Gjermani, qytetarët gjermanë me prejardhje nga Kosova, apo qytetarët me kombësi të dyfishtë (kosovare dhe gjermane) nuk korrespondojnë me realitetin. Numrat e paraqitur në letër janë shumë më të ulët në krahasim me numrin e njerëzve që faktikisht jetojnë në Gjermani. Prandaj, Ambasada e Kosovës po lobon që statistikat të përditësohen;
- Gjermania ende nuk i pranon patentat e shoferit të lëshuara nga institucionet e Kosovës. Ky problem ndikon negativisht një numër të madh të njerëzve nga Kosova të shpërngulur në Gjermani. Ambasada ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në institucionet përkatëse dhe tani i takon homologëve gjermanë të ndërmarrin hapat e nevojshëm që kjo çështje të zgjidhet.
- Parku inovativ në Kosovë i menaxhuar nga GIZ etj.

Gjatë këtij takimi u diskutua se si Ambasada mund të përfshihet në programin e zvogëlimit të barrës administrative dhe u dakordua që raporti i vizitës studimore të ndahet me ta.

**Takimi i dytë (dita e pestë): Shoqata e Odave Gjermane të Tregtisë dhe Industrisë**  
**Tema: Barrët administrative nga këndvështrimi biznesor**

Shoqata e Odave Gjermane të Tregtisë dhe Industrisë (DIHK) është një organizatë akterësh për ata që duhet të jenë në përputhshmëri me rregulloren. Është organi kryesor për 79 Oda të Tregtisë dhe Industrisë, DhTI (IHK) në Gjermani. Të gjitha kompanive gjermane të regjistruara në Gjermani, me përjashtim të bizneseve artizanale, profesioneve të lira dhe fermave, u kërkohet me ligj të anëtarësohen në një odë. Kështu, DIHK-ja flet për më shumë se tre milion sipërmarrës. Krahas kompanive të mëdha, këtu përfshihen edhe shitës me pakicë dhe bujtinarë. Kjo i jep shoqatës ndikim të konsiderueshëm politik. Shoqata nuk përfaqëson ndonjë grup specifik të korporatave por të gjitha ndërmarrjet tregtare në Gjermani. Ndërmarrjeve u kërkohet të paguajnë një tarifë anëtarësimi, shuma e së cilës varet nga forca ekonomike e secilës ndërmarrje. Ato synojnë fuqizimin e vendndodhjes së biznesit dhe përmirësimin e kushteve kornizë për kompanitë: pavarësisht nëse kjo përfshin,

për shembull, infrastrukturë më të mirë transporti, barra më të ulëta tatimore ose çështje të subvencioneve rajonale dhe zhvillimit urban – Odat e Tregtisë dhe Industrisë janë partnerë kompetent dhe këshilltar i ekonomisë rajonale. DIHK-ja avokon për vendimmarrësit politikë në Berlin dhe Bruksel, e cila është në përputhshmëri me interesat e përgjithshme të ekonomisë industriale: më pak burokraci, ligj më i thjeshtë dhe më transparent tatimor, si dhe fuqizim i konkurrencës së Gjermanisë si vend biznesi.

	<b>Pagesa e tatimeve</b>	<b>Niveli</b>	<b>110</b>	<b>128</b>	<b>135</b>	<b>151</b>		<b>154</b>	<b>133</b>	<b>137</b>
	<i>Pagesat</i>	<i># në vit</i>	40	44	40	45		45	34	33
	<i>Koha</i>	<i>Orë në vit</i>	422	407	407	407		420	411	411
	<i>Norma e përgjithshme tatimore</i>	<i>% e fitimit</i>	25	24,1	25,5	23,3		23,3	22,6	23,7

	<b>Tregtimi përtej kufijve</b>		<b>108</b>	<b>103</b>	<b>107</b>	<b>104</b>	<b>28</b>	<b>36</b>	<b>37</b>
	<i>Dokumentet për të eksportuar</i>	#	5	8	8	8			
	<i>Koha për të eksportuar</i>	Ditë	15	15	16	16			
	<i>Dokumentet për të importuar</i>	#	9	9	8	8			
	<i>Koha për të importuar</i>	Ditë	16	13	13	13			
	<b><i>Koha për të eksportuar</i></b>								
	<i>Pajtueshmëria dokumentacion</i> në	Orë					4	4	4
	<i>Pajtueshmëria kufitare</i>	Orë					5	5	5
	<b><i>Kosto e eksportit</i></b>								
	<i>Pajtueshmëria dokumentacion</i> në	US\$					67	92	92
	<i>Pajtueshmëria kufitare</i>	US\$					106	106	106
	<b><i>Koha për të importuar</i></b>								
	<i>Pajtueshmëria dokumentacion</i> në	Orë					8	8	8
	<i>Pajtueshmëria kufitare</i>	Orë					6	6	6
	<b><i>Kosto e importit</i></b>								
	<i>Pajtueshmëria dokumentacion</i> në	US\$					57	97	97
	<i>Pajtueshmëria kufitare</i>	US\$					87	109	109
	<b>Zbatimi i kontratave</b>	<b>Niveli</b>	<b>125</b>	<b>120</b>	<b>115</b>	<b>95</b>	<b>66</b>	<b>64</b>	<b>71</b>
	<i>Procedurat</i>	#	37	37	37	37			
	<i>Koha</i>	Ditë	595	595	595	595	595	595	595
	<b>Zgjidhja e paftësisë paguese</b>	<b>Niveli</b>	<b>80</b>	<b>83</b>	<b>77</b>	<b>34</b>	<b>38</b>	<b>41</b>	<b>40</b>
	<i>Koha</i>	Vite	3,3	3,3	3,3	3,3	3,3	3,3	3,3
	<i>Kosto</i>	% e pasurive	9	9	9	9	9	9	9
<b>Serbia</b>	<b>I përgjithshëm</b>	<b>Niveli</b>	<b>92</b>	<b>86</b>	<b>93</b>	<b>91</b>	<b>59</b>	<b>47</b>	<b>43</b>
	<b>Nisja e një biznesi</b>	<b>Niveli</b>	<b>92</b>	<b>42</b>	<b>45</b>	<b>66</b>	<b>65</b>	<b>47</b>	<b>32</b>
	<i>Procedurat</i>	#	7	6	6	6	6	5	5
	<i>Koha</i>	Ditë	13	12	11,5	12	12	7	5,5
	<b>Marrja e lejeve të ndërtimit</b>	<b>Niveli</b>	<b>175</b>	<b>179</b>	<b>182</b>	<b>186</b>	<b>139</b>	<b>36</b>	<b>10</b>

	<i>Procedurat</i>	#	19	18	18	16	18	12	11
	<i>Koha</i>	<i>Ditë</i>	279	269	269	264	272	156	110
	<b>Marrja e energjisë elektrike</b>	<b>Niveli</b>	<b>79</b>	<b>76</b>	<b>85</b>	<b>84</b>	<b>63</b>	<b>92</b>	<b>96</b>
	<i>Procedurat</i>	#	4	4	4	4	4	5	5
	<i>Koha (Ditët)</i>	<i>Ditë</i>	131	131	131	131	131	125	125
	<b>Regjistrimi i pronës</b>	<b>Niveli</b>	<b>39</b>	<b>41</b>	<b>44</b>	<b>72</b>	<b>73</b>	<b>56</b>	<b>57</b>
	<i>Procedurat</i>	#	6	6	6	6	6	6	6
	<i>Koha</i>	<i>Ditë</i>	11	11	11	54	54	21	21
	<b>Marrja e kredisë</b>	<b>Niveli</b>	<b>24</b>	<b>40</b>	<b>42</b>	<b>52</b>	<b>59</b>	<b>44</b>	<b>55</b>
	<b>Mbrojtja e investitorëve (investitorët e pakicave nga viti 2016)</b>	<b>Niveli</b>	<b>79</b>	<b>82</b>	<b>80</b>	<b>32</b>	<b>81</b>	<b>70</b>	<b>76</b>
	<b>Pagesa e tatimeve</b>	<b>Niveli</b>	<b>143</b>	<b>149</b>	<b>161</b>	<b>165</b>	<b>143</b>	<b>78</b>	<b>82</b>
	<i>Pagesat</i>	<i># në vit</i>	66	66	66	67	42	33	33
	<i>Koha</i>	<i>Orë në vit</i>	279	279	279	279	244,3	225	225,5
	<i>Norma e përgjithshme tatimore</i>	<i>% e fitimit</i>	34	34	36,8	38,6	39,7	39,7	39,7
	<b>Tregtimi përtej kufijve</b>		<b>79</b>	<b>94</b>	<b>98</b>	<b>96</b>	<b>23</b>	<b>23</b>	<b>23</b>
	<i>Dokumentet për të eksportuar</i>	#	6	7	6	6			
	<i>Koha për të eksportuar</i>	<i>Ditë</i>	12	12	12	12			
	<i>Dokumentet për të importuar</i>	#	6	7	7	7			
	<i>Koha për të importuar</i>	<i>Ditë</i>	14	14	15	15			
	<b><i>Koha për të eksportuar</i></b>								
	<i>Pajtueshmëria në dokumente</i>	<i>Orë</i>					2	2	2
	<i>Pajtueshmëria kufitare</i>	<i>Orë</i>					4	4	4
	<b><i>Kosto e eksportit</i></b>								
	<i>Pajtueshmëria në dokumente</i>	<i>US\$</i>					66	35	35
	<i>Pajtueshmëria kufitare</i>	<i>US\$</i>					47	47	47
	<b><i>Koha për të importuar</i></b>								
	<i>Pajtueshmëria në dokumente</i>	<i>Orë</i>					3	3	3
	<i>Pajtueshmëria kufitare</i>	<i>Orë</i>					3	4	4

	<b>Kosto e importit</b>								
	<i>Pajtueshmëria në dokumente</i>	<i>US\$</i>					71	35	35
	<i>Pajtueshmëria kufitare</i>	<i>US\$</i>					52	52	52
	<b>Zbatimi i kontratave</b>	<b>Niveli</b>	<b>104</b>	<b>103</b>	<b>116</b>	<b>96</b>	<b>73</b>	<b>61</b>	<b>60</b>
	<i>Procedurat</i>	<i>#</i>	36	36	36	36			
	<i>Koha</i>	<i>Ditë</i>	635	635	635	635	635	635	635
	<b>Zgjidhja e paaftësisë paguese</b>	<b>Niveli</b>	<b>113</b>	<b>103</b>	<b>103</b>	<b>48</b>	<b>50</b>	<b>47</b>	<b>48</b>
	<i>Koha</i>	<i>Vite</i>	2,7	2	2	2	2	2	2
	<i>Kosto</i>	<i>% e pasurive</i>	23	20	20	20	20	20	20

## **Shtojca 17: Përmbledhje e licencave dhe lejeve që duhet të thjeshtësohen, bashkohen ose hiqen në mënyrë që të përmbushet caku 10% siç përcaktohet në Kontratën e Mbështetjes Buxhetore Sektoriale**

### ***PËRMBLEDHJE E RAPORTIT PËR THJESHTËSIMIN E LEJEVE DHE LICENCAVE NË MTI***

#### **1. Numri total i rekomandimeve dhe numri i lejimeve që preken nga rekomandimet**

Gjatë analizës që i ka paraprirë përgatitjes së Raportit për MTI janë identifikuar gjithsej 60 lejime që administrohen nga MTI.

Në Raportin për MTI janë dhënë 3 rekomandime të përgjithshme. Këto rekomandime nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në 60 lejimet që administrohen nga MTI, por kanë për qëllim azhurnimit e pjesës së regjistrit të lejeve dhe licencave që listohen lejimet e MTI (së bashku me raport janë dorëzuar 60 formularë të azhurnuar për përfshirjen e të dhënave të reja në regjistrin e lejeve dhe licencave, duke përfshirë 20 formularë për lejime të reja që janë identifikuar gjatë përgatitjes së Raportit për MTI, pasi që aktualisht në regjistrin e lejeve dhe licencave janë të listuara vetëm 40 lejime) si dhe përmirësimin e procesit të monitorimit nga vetë MTI të zbatimit të ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave.

Në Raportin për MTI janë dhënë 24 rekomandime specifike. Rekomandimet specifike potencialisht mund të ndikojnë në një formë apo tjetrën në 50 lejime<sup>211</sup> që administrohen nga MTI.

#### **2. Numri i lejimeve që mund të bashkohen (edhe proceduralisht) dhe ato që eliminohen nga rekomandimet:**

Në Raportin për MTI është rekomanduar eliminimi i 3 lejimeve në sektorin e duhanit. Njëri nga këto lejime aktualisht administrohet nga MTI dhe është rekomanduar që të eliminohet tërësisht (shih lejinin me shifrën referuese DTR-3 në raport). Dy lejimet tjera që propozohet të eliminohen aktualisht administrohen nga MBPZHR dhe AVUK dhe në Raportin për MTI është propozuar eliminimi i këtyre lejimeve dhe bartja e disa nga kërkesave që vlerësohen si të nevojshme nga DTR, MBPZHR dhe AVUK në kuadër të DTR, që mund të shërbejë si One-Stop-Shop për të gjitha licencat në sektorin e duhanit.

Në Raportin për MTI gjithashtu është rekomanduar vlerësimi i 20 lejimeve në sektorin e naftës që aktualisht administrohen nga DRRTN dhe shqyrtimi i mundësisë së bashkimit të procedurës së aplikimit për këto lejime. Ky shqyrtim pritet të bëhet nga DRRTN në të ardhmen e afërt dhe deri në kryerjen e këtij shqyrtimi nuk është e mundshme që të parashikohet me saktësi numri i këtyre lejimeve që mund të bashkohen.

#### **3. Numri i lejimeve që mund të thjeshtohen duke ndryshuar vetëm udhëzimet administrative dhe numri i lejimeve që mund të thjeshtohen vetëm duke ndryshuar ligjet;**

2 lejime që aktualisht nuk administrohen nga MTI por nga MBPZHR dhe AVUK (shih rekomandimin Nr. 4 në Raportin e MTI) mund të eliminohen vetëm përmes ndryshimit të 2 ligjeve në fuqi.

50 lejime që aktualisht administrohen nga MTI potencialisht mund të thjeshtësohen në një formë apo tjetrën përmes a) ndryshimit të akteve nënligjore ekzistuese, b) përmes ndryshimit të vendimeve administrative

<sup>211</sup> Në këtë numër (50) janë përfshirë edhe lejimet që është rekomanduar të eliminohen apo të bashkohen sic është shpjeguar në pikën 2.

ekzistuese. c) ndryshimit të projektligjeve të sponsoruara nga MTI që janë aktualisht në proces d) hartimit ose rishikimit të draft akteve nënligjore që kërkohen nga ligjet në fuqi por që ende nuk janë miratuar.

**Statusi i implementimit të rekomandimeve sipas informatave ekzistuese:**

Aktualisht, në bazë të informacionit në dispozicion, nga gjithsej 24 rekomandime specifike të dhëna në Raportin për Thjeshtësimin e Lejeve dhe Licencave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (Raporti për MTI) janë **implementuar plotësisht 2 rekomandime** (Rekomandimi Nr. 4 dhe Rekomandimi Nr. 13) dhe janë **implementuar pjesërisht 2 rekomandime** (Rekomandimi Nr. 5 dhe Rekomandimi Nr. 12).

Me implementimin e këtyre rekomandimeve deri më tani janë thjeshtësuar 3 lejime (me shifrat DI-1, DI-2 dhe DKTMS-1)

**4. Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore te cilat duhet te ndryshohen me qellim te zbatimit te rekomandimeve:**

Shih tabelën me poshtë

Ligjet në fuqi që duhen ndryshuar		Aktet nënligjore në fuqi që duhen ndryshuar		Vendimet administrative që duhen ndryshuar <sup>212</sup>		Projektligjet që duhen rishikuar		Projekt aktet nënligjore që duhen hartuar ose rishikuar	
1	Ligji Nr. 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit (Neni 17) <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2783">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2783</a>	1	U.A. (MTI) Nr. 04/2016 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kritereve për Subjektet që Merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të Tij <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12340">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12340</a>	1	Vendimi i Ministrit të MTI Nr. 53 të datës 29.10.2018	1	Projektligji për Turizmin	1	Draft U.A për Autorizimin e Subjekteve për Riparimin dhe Përgatitjen e Mjeteve Matëse për Verifikim
2	Ligjit Nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit (Neni 11) <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2779">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2779</a>	2	U.A. (MF) Nr. 4/2012 për Lëshimin e Licencës, për Pagesën e Taksës së Akcizës dhe Shumës së Taksës Administrative <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8194#">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8194#</a>	2	Vendimi i Ministrit të MTI Nr. 12 i datës 9 Janar 2018	2	Projektligji për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme në Kosovë	2	Draft U.A për Përcaktimin e Procedurave për Miratimin e Tipit për Mjetet Matëse Ligjërish të Kontrolluara
		3	Rregullore (QRK) Nr. 17/2012 për Caktimin e Lartësisë së Pagesës së Shërbimeve dhe Kontrolleve Zyrtare të AVUK me ndryshime dhe plotësime <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8383">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8383</a>	3	Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK për miratimin e formularëve për regjistrim të bizneseve	3	Projektligji për Zonat Ekonomike	3	Draft U.A. për Mënyrën dhe Procedurat e Regjistrimit të Prodhuesve dhe Importuesve të Mjeteve Matëse
		4	U.A. (QRK) Nr. 12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388</a>						
		5	U.A. (MTI) Nr. 16/2010 për Caktimin e Lartësisë së Taksave për Licencimin e Subjekteve nga Sektori i Naftës dhe Derivateve të Naftës <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7936">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7936</a>						
		6	U.A. (MTI) Nr. 07/2018 për Përcaktimin e Procedurës së Licencimit për Subjektet që Ushtrjnë Veprimtari në Sektorin e						

<sup>212</sup> 2 vendimet e para në këtë shtyllë tashmë janë ndryshuar nga Ministri i MTI, duke i implementuar kështu rekomandimet e dhëna në raport.



		Naftës <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17763">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17763</a>				
	7	U.A. (MTI) Nr. 06/2018 për Përfaqësues të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale ( <a href="https://kipa.rks-gov.net/desk/inc/media/19BC701B-0CDA-4030-A904-67142A27EA18.pdf">https://kipa.rks-gov.net/desk/inc/media/19BC701B-0CDA-4030-A904-67142A27EA18.pdf</a> )				
	8	U.A. (MTI) Nr. 11/2018 për Përcaktimin e Taksave për Shërbimet e Ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426</a>				
	9	U.A. (MTI) Nr. 05/2018 për Lartësinë dhe Procedurën e Pagesës për Shërbimet në Metrologji <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16522">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16522</a>				
	10	U.A. (MTI) Nr. 12/2013 për Formën e Shenjës së Pastërtisë, Ekzaminimit të Punimeve nga Metalet e Çmuara dhe Formën e Shenjës së Harmonizimit ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2869">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2869</a> )				

## **PËRMBLEDHJE E RAPORTIT PËR THJESHTËSIMIN E LEJIMEVE NË MMPH**

### **1. Numri total i rekomandimeve dhe numri i lejimeve që preken nga rekomandimet:**

Në kuadër të zhvillimit të hulumtimit dh analizës që i ka paraprirë përgatitjes së Raportit për MMPH janë identifikuar gjithsej 47 lejime që administrohen nga MMPH.

Në Raportin për MMPH janë dhënë 3 rekomandime të përgjithshme. Këto rekomandime nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në 47 lejimet që administrohen nga MMPH, por kanë për qëllim azhurnimin e pjesës së regjistrimit të lejeve dhe licencave në kaudër të MMPH-së si dhe përmirësimin e procesit të zbatimit dhe monitorimit nga vetë MMPH të zbatimit të ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave.

Në Raportin për MMPH janë dhënë gjithsej 18 rekomandime specifike. Rekomandimet specifike ndikojnë në një formë apo tjetër të thjeshtimit të 31 lejime që administrohen nga MMPH.

Numri i lejimeve që mund të bashkohen (edhe proceduralisht) dhe ato që eliminohen nga rekomandimet:

### **2. Numri i lejimeve që mund të bashkohen (edhe proceduralisht) dhe ato që eliminohen nga rekomandimet:**

Në Raportin për MMPH është rekomanduar bashkimi i 12 lejimeve dhe eliminimi i 8 lejimeve. Në këtë kuadër përfshihet bashkimi e Licencës për Menaxhimin e Mbeturinave me Lejen Mjedisore, bashkimi i Lejes për zbatimin e hulumtimeve shkencore në natyrë, Lejes për hulumtime dhe vizita arsimore në rezervatin strikt dhe Lejes për aktivitetet në objektin speleologjik në një leje të perbashkët me emertim “Leje për hulumtime shkencore,” bashkimi i Lejes për grumbullimin e bimëve të egra të mbrojtura me lejen me Lejen për grumbullimin e kërpudhave dhe pjesëve të tyre në një leje të perbashkët me emertim “Leje për grumbullimin e bimëve të egra të mbrojtura, kërpudhave dhe pjesëve të tyre, bashkimi i Lejes për import/eksport të llojeve të egra të bimëve me Lejen për eksport, import për qëllime shkencore të disa llojeve të shtazëve, kërpudhave dhe bimëve strikte të mbrojtura me emertim “Leje për import/eksport të llojeve të egra të bimëve dhe të disa llojeve të shtazëve, kërpudhave dhe bimëve strikte të mbrojtura,” si dhe bashkimi i Lejes për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim me Lejen për mbajtjen në internim të llojeve të shtazëve të egra vendore ose të huaja për qëllim shfaqjeje për publikun në kopshte zoologjike, akuariume, terrariume ose në hapësira të ngjashme dhe Lejes për mbajtje në internim, kultivim, shitje dhe blerje të llojeve të shtazëve të egra strikte të mbrojtura me emertim “Leje për mbajtjen në internim të shtazëve të egra”

Nga lejimet e paraqitura më lartë me bashkimin e tyre ndodh eliminimi i 7 lejimeve. Në numrin total të lejimeve që do të eliminohen përfshihet edhe eliminimi i pëlqimit për menaxhimin me të mirat e natyrës në zonat shkëmbore duke e ngritur numrin total të lejimeve që do të elimohen në 8.

### **3. Numri i lejimeve që mund të thjeshtohen duke ndryshuar vetëm udhëzimet administrative dhe numri lejimeve që mund të thjeshtohen vetëm duke ndryshuar ligjet;**

Numri i lejimeve që mund të thjeshtohen duke ndryshuar vetëm udhëzimet administrative është 9 ku përfshihet eliminimi i taksës së licencës për menaxhimin e mbeturinave, eliminimi i taksës për lejen për eksport, lejen për import dhe lejen për tranzit të mbeturinave, zvoglimi i taksës për autorizim mjedisor, reduktimi i lartësisë së taksave administrative për pëlqim ujor dhe leje ujore sipas kostos së shërbimeve të procedurës dhe eliminimi i taksës për kushte ujore, eliminimi i kërkesës për vërtetim të kopjes së ID ose Certifikatës së Biznesit (vetëm për personat juridik) dhe i certifikatës së numrit fiskal për lejen ujore dhe pëlqimin ujor, shkurtimi i afatit për dhëniën e licencës për gjeodetë dhe licencës për kompani gjeodete si dhe reduktimi i taksave për licencimin e kompanive gjeodete dhe gjeodetëve.

Numri i lejimeve që mund të thjeshtësohen vetëm duke ndryshuar ligjet është 10 ku përfshihet eliminimi i taksës për lejen për import, eksport dhe transit të kimikateve të rrezikshme, eliminimi i taksës për lejen për importin e qeseve plastike, eliminimi i pëlqimit për menaxhimin me të mirat e natyrës në zonat shkëmbore, bashkimi i Lejes për zbatimin e hulumtimeve shkencore në natyrë, Lejes për hulumtime dhe vizita arsimore në rezervatin strikt dhe Lejes për aktivitetet në objektin speleologjik në një leje të perbashkët me emertim “Leje për hulumtime shkencore,” shkurtimi i afateve për shqyrtimin dhe vendosjen në kërkesat – aplikacionet e dorëzuara për 1) Licencën për menaxhimin e mbeturinave, 2) Lejen për eksport të mbeturinave, 3) Lejen për import të mbeturinave, dhe 4) Lejen për tranzit të mbeturinave,.

Ndërsa numri i lejimeve që mund të thjeshtësohen vetëm duke ndryshuar ligjet dhe udhëzimet administrative bashkë është 9 ku përfshihet bashkimi i Licencës për Menaxhimin e Mbeturinave me Lejen Mjedisore, bashkimi i Lejes për grumbullimin e bimëve të egra të mbrojtura me Lejen për grumbullimin e kërpudhave dhe pjesëve të tyre në një leje të perbashkët me emertim “Leje për grumbullimin e bimëve të egra të mbrojtura, kërpudhave dhe pjesëve të tyre, bashkimi i Lejes për import/eksport të llojeve të egra të bimëve me Lejen për eksport, import për qëllime shkencore të disa llojeve të shtazëve, kërpudhave dhe bimëve strikte të mbrojtura me emertim “Leje për import/eksport të llojeve të egra të bimëve dhe të disa llojeve të shtazëve, kërpudhave dhe bimëve strikte të mbrojtura,” bashkimi i Le

jes për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim me Lejen për mbajtjen në internim të llojeve të shtazëve të egra vendore ose të huaja për qëllim shfaqjeje për publikun në kopshte zoologjike, akvariume, terrariume ose në hapësira të ngjashme dhe Lejes për mbajtje në internim, kultivim, shitje dhe blerje të llojeve të shtazëve të egra strikte të mbrojtura me emertim “Leje për mbajtjen në internim të shtazëve të egra.”

#### **4. Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat duhet të ndryshohen me qëllim të zbatimit të rekomandimeve:**

Shih tabelën me poshtë.

Ligjet në fuqi që duhen ndryshuar		Aktet nënligjore në fuqi që duhen ndryshuar		Vendimet administrative që duhen ndryshuar		Projekt aktet nënligjore që duhen hartuar ose rishikuar	
1	Ligji për Mbeturina ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2829">https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2829</a> )	1	U.A. (MMPH) Nr. 04/2016 për Lejen Mjedisore ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14821">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14821</a> )	1	Vendimi aktual i MMPH-së i taksës prej 3.08 EUR per m2 për certifikatën e legaliimit, lejen e legalizimit për përfundim të ndërtimit	1	Draft U.A për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve
2	Ligjit 04/L-197 për Kimikate ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9370">https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9370</a> )	2	UA MMPH Nr. 09-2014 Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10259">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10259</a> )	2	Vendimi aktual i AKK-së për taksat për licencimin e kompanive gjeodete dhe gjeodetëve		
3	Ligji 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716</a> )	3	UA MMPH Nr. 02/2019 për Eksport, Import dhe Tranzit të Mbeturinave ( <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21124">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21124</a> )				
		4	UA 03-2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve dhe Licencave, Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me Legjislacionin e Natyrës ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12803">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12803</a> )				
		5	UA MMPH Nr.03 /2018 për Procedurat për Leje Ujore ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17824">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17824</a> )				
		6	UA Për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9767">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9767</a> ).				

## **PËRMBLEDHJE E RAPORTIT PËR THJESHTËSIMIN E LEJEVE DHE LICENCAVE NË MBPZHR**

### **1. Numri total i rekomandimeve dhe numri i lejimeve që preken nga rekomandimet:**

Gjatë analizës ligjore janë identifikuar gjithsej 84 lejime që administrohen nga MBPZHR. Në raport janë dhënë gjithsej 35 rekomandime specifike e që prekin gjithsej 82 lejime.

### **2. Numri i lejimeve që mund të bashkohen (edhe proceduralisht) dhe ato që eliminohen nga rekomandimet:**

Në Raportin për MBPZHR është rekomanduar që të bashkohen gjithësej 33 lejime të cilat janë kryesisht në Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë (DPBT) dhe gjithashtu është rekomanduar që të elimonhen katër lejime, dy prej të cilave janë në Departamentin i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike (DSHKT) dhe nga një në Agjencionin Pyjor të Koosvës dhe një në DPBT.

### **3. Numri i lejimeve që mund të thjeshtohen duke ndryshuar vetëm udhëzimet administrative dhe numri i lejimeve që mund të thjeshtohen vetëm duke ndryshuar ligjet;**

Janë gjithsej pesë lejime të cilat mund të thjeshtohen vetëm duke ndryshuar dhe plotësuar Ligje, janë dy lejimet në kuadër të DSHKT, një në DPBT dhe dy tjera në kuadër të Departamentit të Pyltariisë.

Ndërsa janë gjithsej 45 lejime të cilat mund të thejshohen duke ndryshuar dhe plotësuar aktet nënligjore në fuqi ose duke hartuar të reja;

### **4. Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat duhet të ndryshohen me qëllim të zbatimit të rekomandimeve:**

Ligjet në fuqi që duhen ndryshuar		Aktet nënligjore në fuqi që duhen ndryshuar		Projektligjet që duhen rishikuar		Projekt aktet nënligjore që duhen hartuar ose rishikuar	
1	Ligji nr. 04/l-074 për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural - <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2805#">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2805#</a>	1	Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) 07/2015 për formën, përmbajtjen dhe procedurat e dhënies së provimit profesional dhe certifikatës për këshilltarë për bujqësi dhe zhvillim rural dhe zhvillim rural. <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15089">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15089</a>	1	Projektligji për Pyjet e Kosovës	1	Draft-Udhëzim Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.
2	Ligji nr.03/l-042 i produkteve për mbrojtjen e bimëve - <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2604">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2604</a>	2	Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) 08/2015 për formën, përmbajtjen dhe procedurat e dhënies së licencës për personin juridik për ofrimin e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural. <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15091">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15091</a>				
3	Ligji nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566</a>	3	Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) nr. 02/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2009 për autorizimin për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve. <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7863">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7863</a>				
		4	Rregullorja Nr. 17/2012 për caktimin e lartesisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8383">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8383</a>				

	5	<p>Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2007 për Licencimin e subjekteve afarist që kryejnë veprimtari të grumbullimit, deponimit dhe tregtimit të lëkurave me prejardhje nga kafshët e gjalla.</p> <p><a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7479">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7479</a></p>			
	6	<p>Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2005 për licencimin e ambulancave, stacioneve, dhe klinikave veterinare.</p> <p><a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7314">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7314</a></p>			
	7	<p>Udhëzimi Administrativ ma-nr. 05/2007 për përcaktimin e kushteve të tregjeve të kafshëve.</p> <p><a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7457">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7457</a></p>			
	8	<p>Administrativ nr. 08/2009 për caktimin e taksës për regjistrimin e subjekteve, testim të varieteteve për vlerën kultivuese prodhuese dhe shtypjen e etiketave për farëra të drithërave.</p> <p><a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7704">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7704</a></p>			
	9	<p>Udhëzimi Administrativ Nr 12/2005 për caktimin e çmimeve, taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore-drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale teknike.</p> <p><a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7288">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7288</a></p>			



***Raport për Thjeshtësimin e Lejeve dhe Licencave Ministria  
e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural***

***Projekti i IFC për Përmirësimin e Klimës së Investimeve në Kosovë II***



## SHKURTESAT

APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës
DPBT	Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë
DSHK&T	Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike
DP	Departamenti i Pyltariisë
DVV	Departamenti i Vreshtariisë dhe Verëtarisë
IFC	Korporata Ndërkombëtare Financiare, pjesë e Grupit të Bankës Botërore
Lejim	Njoftim, Regjistrim, Leje ose Licencë Profesionale
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
Regjistri	Regjistri Qëndror i Lejeve dhe Licencave

## 1. HYRJE

Sistemi i lejeve dhe licencave në kuptim të përgjithshëm konsiderohet korniza ligjore nëpërmes së cilës një qeveri identifikon dhe rregullon veprimtarinë individuale. Për të arsyetuar këtë rregullim, veprimtaria ekonomike duhet të paraqesë kërcënim ndaj shëndetit, sigurisë publike dhe mjedisit që logjikisht do të arsyetonte kërkesat apo kushtëzimet e propozuara.

Në praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare, roli mbikëqyrës i qeverisë dhe zyrtarëve të saj në administrimin e sistemit të lejimeve rritet proporcionalisht me rrezikun e paraqitur në shoqëri. Për shembull, leja i lëshohet një subjekti ekonomik i cili konsiderohet i kualifikuar për të ndërmarrë një veprimtari të kategorizuar me rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik, sigurinë dhe mjedisin dhe që nuk është e rregulluar me licencë profesionale. Këto kualifikime mund të jenë matje subjektive të kapacitetit të subjektit ekonomik për të kryer veprimtarinë dhe prandaj mund të përfshijë një pushtet diskrecional vendimmarrës nga ana e zyrtarit qeveritar.

Për çdo akt ligjor që vendos një kërkesë për leje a licencë ndaj veprimtarisë ekonomike private duhet të sigurohet se kërkesa është:

- E nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike;
- Minimalisht rënduese për akterët ekonomik; dhe
- Jo në kundërshtim me politikën publike.

Qeveria e Republikës së Kosovës me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (MSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ARE) ka marrë obligime të shumta në raport me integrimin e saj në Bashkimin Evropian. Sipas ARE-s, Republika e Kosovës duhet të përmirësojë mjedisin biznesor përmes “reduktimit të barrës rregullative ndaj firmave dhe në veçanti përmes bërjes transparente të tarifave dhe procedurave të kërkuara për leje dhe licenca”.<sup>213</sup>

Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA-së (PKZMSA)<sup>214</sup> dhe ARE përcaktojnë reduktimin e barrës rregullative për kompanitë, veçanërisht duke i bërë transparente tarifën dhe procedurat e nevojshme për të marrë leje dhe licenca. Në kuadër të reduktimit të barrës administrative, një proces ky që ka filluar dhe po vazhdon, thjeshtimi i këtyre lejimeve është njëri nga kushtet e integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, që si rrjedhojë sjell lehtësime dhe reforma në klimën e investimeve vendore dhe të jashtme.

Ky raport ka për qëllim që të ofrojë një pasqyrë të plotë të funksionimit të lejimeve në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit (AUV). Raporti identifikon të gjitha lejimet ekzistuese, zbatimin e tyre dhe ofron rekomandime për përmirësimin e administrimit të tyre.

Metodologjia e zbatuar në mbledhjen, përpunimin dhe shkrimin e këtij raporti është metodologji standarde që përdoret rregullisht nga Korporata Ndërkombëtare Financiare, pjesë e Grupit të Bankës Botërore. Fillimisht janë identifikuar të gjitha lejimet të cilat figurojnë në Regjistrin Qëndror të Lejeve dhe Licencave (Regjistri) që

<sup>213</sup> Dialogu i Nivelit të Lartë Kosovë, Agjenda për Reforma Evropiane, [http://mei-ks.net/repository/docs/20170929090420\\_erafinalsq.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/20170929090420_erafinalsq.pdf) fq. 17

<sup>214</sup> Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së StabilizimitAsociimit, <https://mapl.rks-gov.net/ep-content/uploads/2017/06/PKZMSA-20172021shq.pdf>

administrohen nga MBPZHR dhe AUV. Njëkohësisht, është identifikuar baza ligjore, përkatësisht ligjet dhe aktet nënligjore, me të cilat rregullohen lejitimet e administruara nga MBPZHR-ja dhe AUV-i. Pas identifikimit të tyre, me qëllim që të kuptohet se si zbatohen ato në praktikë janë mbajtur takime dhe diskutime të shumta me zyrtarë të ministrisë dhe agjencioneve të ndërlidhura. Po ashtu, janë zhvilluar edhe takime me përfaqësues të sektorit privat për të parë ndikimin e lejitimeve në punën e tyre. Në fazën e fundit, informacionet e mbledhura sëbashku me analizën ligjore janë përmbledhur në këtë raport. Raporti është i organizuar në tre kapituj dhe dy shtojca. Kapitulli i parë është hyrje në raport, kapitulli i dytë i është kushtuar Regjistrimit Regjistrimit për shkak të rëndësisë së tij në administrimin e lejitimeve dhe kapitulli i tretë përmban analizën ligjore të lejitimeve për secilin departament dhe agjencion. Raporti shoqërohet me rekomandime të përgjithshme dhe rekomandime specifike për MBPZHR-në dhe AUV-në, të paraqitura në formë të shtojcave. Pas leximit, raporti mund të plotësohet sipas sugjerimeve të autoriteteve të përfshira.

## **2. REGJISTRI QËNDROR**

Një mekanizëm i rëndësishëm në fushën e administrimit dhe transparencës së lejitimeve, është Regjistri i cili është databazë e të gjitha lejitimeve. Ai është publik dhe i qasshëm online pa pagesë. Sipas, MSA-së dhe ARE-s, përditësimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e Regjistrimit është obligim i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në mënyrë që lejet dhe licencat të kenë efekt juridik, ato duhet të figurojnë në Regjistër. Gjatë hulumtimit, është identifikuar që Regjistri në masë të madhe përmban informacionet e duhura për lejitime e administruara nga MBPZHR dhe AUV. Mirëpo, ka raste kur mungojnë informatat për lejitime të caktuara të cilat sipas ligjit do të duhej të ishin të përfshira në Regjistër. Për shembull, në dis raste mungon lloji i lejes, emri i autoritetit përkatës, procedurat dhe kushtet e përfitimit të lejeve dhe licencave, formulari i aplikimit për çdo lejim dhe udhëzuesi i shërbimit të tij, afati për përgjigje, afati dhe organi për ankesë etj.

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, dërgimi dhe përditësimi i të dhënave në Regjistër është obligim ligjor i udhëheqësve të institucioneve përkatëse. Për të shpjeguar më mire lejitimet, në këtë raport secilit lejim i është caktuar një kod identifikues. Qëllimi i kodit identifikues është lehtësimi i monitorimit të lejitimeve. Do të preferohej që edhe MBPZHR-ja dhe AUV-ja të përdorte kode të tilla me qëllim të lehtësimit të monitorimit.

## **3. ANALIZA LIGJORE E LEJIMEVE TË MBPZHR DHE AUV**

Kjo pjesë e raportit paraqet analizën ligjore të lejitimeve që janë në kompetencë të MBPZHR-së dhe AUV-së, përkatësisht në fushën e bujqësisë, pylltarisë, zhvillimit rural dhe ushqimit dhe veterinarisë. Analiza ligjore është bërë dhe është paraqitur bazuar në departamentet e Ministrisë në fjalë (varësisht nga fushat që mbulojnë) dhe agjencive të ndërlidhura. Secila analizë ligjore e lejitimeve mbështetet me rekomandime dhe afate konkrete për zbatimin e tyre, të cilat janë të përshkruara në shtojcat e këtij raporti.

### **3.1 DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE KËSHILLUESE DHE TEKNIKE**

Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike (DSHKT) në MBPZHR është përgjegjës për lëshimin e dy lejitimeve, përkatësisht Licencës për këshilltarë bujqësorë dhe zhvillim rural DSHKT-1 dhe Licencën për personat juridik për ofrimin e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të ndërlidhura me shfrytëzimin e fondeve publike dhe ndërkombëtare DSHKT-2. Këto dy lejitime rregullohen me Ligjin për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,<sup>215</sup> Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) 07/2015 për formën, përmbajtjen dhe

<sup>215</sup> Ligji nr. 04/l-074 për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2805#>

procedurat e dhënies së provimit profesional dhe certifikatës për këshilltarë për bujqësi dhe zhvillim rural<sup>216</sup> dhe Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) 08/2015 për formën, përmbajtjen dhe procedurat e dhënies së licencës për personin juridik për ofrimin e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.<sup>217</sup> Të dy lejimet janë të përcaktuara shprehimisht me nenet 17 dhe 18 të Ligjit për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Gjithashtu me dy udhëzimet administrative (udhëzimet e lartëpërmendura) janë përcaktuar format, përmbajtja dhe procedurat e dhënies së provimit profesional dhe dhënies së certifikatës për persona fizik, përkatësisht licencës për personat juridik.

Gjatë takimeve të zhvilluara me përfaqësues të sektorit privat dhe inxhinierë të bujqësisë, nga ta është ngritur çështja e obligimit të këshilltarëve për zhvillim rural sipas lejimit DSHKT-1 që të certifikohen nga MBPZHR-ja. Përfaqësuesit e sektorit privat kanë theksuar se është e nevojshme që të ketë trajnime profesionale të vazhdueshme për këshillim për zhvillim rural dhe bujqësi. Mirëpo, ata kanë vënë në pikëpyetje nevojën për certifikimin e tyre, meqë ata kanë të kryer Fakultetin e Bujqësisë. Për më tepër, pagesa për këtë lejim është 50 euro dhe me kohëzgjatje prej pesë vitesh.

Sa i përket licensimit të personave juridik sipas lejimit DSHKT-2, kjo është procedurë që në fakt nuk parasheh ndonjë kriter për të plotësuar; mjafton që në MBPZHR të dorëzohen kontratat e dy këshilltarëve të certifikuar nga vetë kjo Ministri së bashku me dokumentet e kompanisë.<sup>218</sup> Pagesa për këtë lejim është 200 euro me kohëzgjatje prej pesë vitesh ndërsa vazhdimi i kësaj licence kushton 150 euro dhe vlen edhe për pesë vite të tjera.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, një leje mund të kërkohet nga një autoritet kompetent për një veprimtari që paraqet një rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin, që nuk është i rregulluar nga një licencë profesionale. Duke marrë parasysh se lejimet DSHKT-1 dhe DSHKT-2 nuk paraqesin as rrezik të mesëm e as të lartë për shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin, ofrimi i shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të ndërlidhura me shfrytëzimin e fondeve publike dhe ndërkombëtare duhet të ofrohet nga individë dhe kompani, pa pasur nevojë të pajisen me licencë dhe certifikatë shtesë. Të gjitha kompanitë që operojnë në Republikën e Kosovës duhet të regjistrohen në ARBK, andaj të njëjtat nuk do të duhej të obligoheshin që të pajisen me licencë të veçantë shtesë për ofrim të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të ndërlidhura me shfrytëzimin e fondeve publike ndërkombëtare. Për më tepër, certifikimi i këshilltarëve, përkatësisht licencimi i kompanive, mund të përbëjë pengesë për ta në shfrytëzimin e fondeve publike dhe ndërkombëtare, meqë mund të iu paraqitet si pengesë mospajsa e certifikatës dhe licencës në fjalë në momentin që publikohet ftesa për aplikim/tenderi si dhe mungesa e informatës për kompanitë konsulente që kanë nevojë për licencë shtesë nga ana e Ministrisë. Për këto arsye, rekomandohet që në të ardhmën ministria të shqyrtojë mundësinë e eliminimit të lejimeve DSHKT-1 dhe DSHKT-2.

Gjatë hulumtimit, është vërejtuar që Regjistri i Personave juridik të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural dhe Regjistri i këshilltarëve të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural nuk janë të

<sup>216</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) 07/2015 për formën, përmbajtjen dhe procedurat e dhënies së provimit profesional dhe certifikatës për këshilltarë për bujqësi dhe zhvillim rural - <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15089>

<sup>217</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) 08/2015 për formën, përmbajtjen dhe procedurat e dhënies së licencës për personin juridik për ofrimin e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural; <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15091>

<sup>218</sup> Ligji nr. 04/l-074 për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, neni 18

publikuara në faqen e internetit të MBPZHR-së. Rekomandohet që deri në marrjen e vendimit rreth eliminimit të lejimeve DSHKT-1 dhe DSHKT-2, këta regjistra të publikohen në faqen e saj në internet.

Nr. Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike (DSHK&T)	
DSHKT-1	Certifikatë për këshilltarë dhe zhvillim rural
DSHKT-2	Licenca për personat juridik për ofrimin e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të ndërlidhura me shfrytëzimin e fondeve publike dhe ndërkombëtare

## 2 DEPARTAMENTI I POLITIKAVE BUJQËSORE DHE TREGTISË

Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë (DPBT) në MBPZHR është përgjegjës për lëshimin e katërdhjetë e tetë (48) lejimeve që kanë të bëjnë me, ndër të tjera, zbatimin e standardeve në mbrojtjen e bimëve dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve bimore dhe dëmtuesëve karantinorë. Aspekte të tjera, të rregulluara më këto lejime, janë regjistrimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve, plehrave artificiale dhe varieteteve për kultura bujqësore, për licencimin e subjekteve për agroinputet bujqësore etj. Baza ligjore për përcaktimin e këtyre lejimeve është e gjërë, të listuara në tabelën e mëposhtme. Po ashtu, më poshtë është paraqitur edhe lista e të gjitha lejimeve që menaxhohen nga DPBT-ja.

Është e rëndësishme të theksohet se kjo pjesë e raportit paraqet pjesën më thelbësore dhe komplekse të kësaj analize ligjore. Gjatë shkrimit të këtij raporti, është treguar kujdes i veçantë në paraqitjen e rekomandimeve për shkak se është marrë në konsideratë fakti që shumica e lejimeve në kuader të DPBT-së përmbajnë rrezik të mesëm ose të lartë për shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin.

Ky departament ka një numër tejet të madh të lejimeve të cilat janë barrë e madhe si për departamentin që administron këto lejime ashtu edhe për sektorin privat, përkatësisht aplikuesit. Nga takimet e mbajtura me sektorin privat, është kuptuar se aplikimi për të gjitha këto lejime iu merr shumë kohë. Sipas tyre, ata vazhdimisht janë nën presion që t'i vazhdojnë lejet meqë iu skadon afati. Për shembull, posa të pajisen me një licencë, ndodhë që t'i skadojë afati licencës tjetër dhe kështu ata detyrohen që të aplikojnë për vazhdimin e licencës tjetër. Për më tepër, ata rrezikojnë që të gjobiten për mosvazhdimin e licencave nga ana e AUV që monitoron implementimin në teren, gjë që e rëndon sektorin privat. Njëri nga përfaqësuesit e bizneseve, ka deklaruar që është detyruar të caktojë një zyrtar që është përgjegjës për kontrollimin dhe vazhdimin e afatit të licencave, në mënyrë që të operojë në pajtim me kërkesat për lejime.

Gjatë takimeve me sektorin privat dhe udhëheqësin e departamentit është përmendur fakti që ka praktika kur një përfaqësues i sektorit privat ka aplikuar njëkohësisht për disa lloje të licencave. Për shembull, një kompani aplikon në mënyrë të ndarë për licencë për tregtim, importim, prodhim, të materialit fidanor, në vend se të aplikonte për një licencë të vetme që do ta lejonte atë të tregëtojë, importojë, prodhojë material fidanor në rast se ka nevojë.

Në vijim janë analizuar të gjitha lejimet e këtij departamenti dhe janë ofruar rekomandime konkrete. Një ndër rekomandimet kryesore në këtë departament është bashkimi i disa procedurave me njëra tjetrën. Bashkimi është i nevojshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjnë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për shembull, ndodhë që e njëjta kompani që tregton, mund edhe të importojë, ekspertojë apo edhe të prodhojë fidane. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të

paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.

Rrjedhimisht, propozohen ndryshimet e mëposhtme në lejime të cilat administrohen nga DPBT-ja:

### **1. Mbrojtjen e bimëve**

Në kategorinë prodhimtari bimore, janë identifikuar njëmbëdhjetë lejime që kanë të bëjnë me mbrojtjen e bimëve. Baza ligjore për leje për persona përgjegjës në barnatore bujqësore DPBT-1 është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) nr. 02/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2009 për autorizimin për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve. Ky udhëzim nuk bazohet në ndonjë ligj që parasheh lëshimin e një lejimi të tillë. Përkatësisht, me Ligjin për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve nuk kërkohet shprehimisht që të lëshohet leja për persona përgjegjës në barnatore bujqësore DPBT-1. Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, lejimet mund të parashihen vetëm me ligj, pasi që të përcaktohet shkalla e rrezikshmërisë së shëndetit publik, sigurisë publike dhe mjedisit. Pra, fakti që ky lejim është përcaktuar vetëm me udhëzim administrativ, pa u bazuar në Ligjin për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve, është në kundërshtim me Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Për këtë arsye, propozohet që të inicohet plotësim ndryshimi i Ligjit për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve, ashtu që të krijohet baza ligjore për lejimin DPBT-1. Ky lejim nuk duhet të eliminohet për shkak se ekziston shkallë e rrezikshmërisë e sigurisë publike, shëndetit publik dhe mjedisit.

Po ashtu, përveç problemit me bazë ligjore i shpjeguar me lartë, lista e dokumenteve për të aplikuar për këtë lejim është tejet e gjatë. Përkatësisht, kërkohen dokumentet në vijim: kërkesa për leje (origjinale), certifikata e biznesit dhe informata mbi biznesin (origjinale), procesverbali nga inspektorati fitosanitar për gjendjen e depos (kopje e vërtetuar), diploma për përgatitjen profesionale (fakulteti i bujqësisë, kopje e vërtetuar), pëlqimin për objektin nga kuvendi komunal (origjinal) dhe fletëpagesën e taksës (origjinale) dhe kontrata, në rast se pronari i firmës nuk është inxhinier i bujqësisë (kopje e vërtetuar). Kërkesa për kopje të vërtetuar, për dokumente origjinale është kosto financiare shtesë për palët, por mbi të gjitha është shpenzim i kohës për t'i siguruar këto dokumente nga institucione të ndryshme.

Duke pasur parasysh që ndryshimi i bazës ligjore kërkon kohë, rekomandohet që në ndërkohë për lejimin DPBT-1 të thjeshtësohet procedura e aplikimit, duke ndryshuar Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) nr. 02/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2009 për autorizimin për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve. Për shembull, MBPZHR mund të mos i kërkojë palës që certifikatën e biznesit dhe informatat për biznesin t'i sjellë në origjinal nga ARBK-ja por vetë zyrtari përgjegjës për lëshimin e DPBT-1 brenda ministrisë mund ta verifikojë online (ekzistimin e kompanisë) në faqen e internetit të ARBK-së. Tutje, nuk duhet të kërkohet kopje e vërtetuar apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike, sic është rasti me procesverbalin nga inspektorati fitosanitar, diplomën për përgatitjen profesionale nga Fakulteti i Bujqësisë, pëlqimin për objektin nga kuvendi komunal dhe kontratën në rast se pronari i firmës nuk është inxhinier i bujqësisë. Sa i përket vlefshmërisë së lejimit DPBT-1, i cili vlen për dy vite, rekomandohet që ky afat të zgjatet në pesë vite. Zgjatja e vlefshmërisë së këtij lejimi do të kursente kohë për biznesin dhe po ashtu do të ulte koston e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për lejimin DPBT-1.

Situata sa i përket lejimit leje e përkohshme për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim (DDD) DPBT-2, ky lejim bazohet në Ligji nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve<sup>219</sup>. MBPZHR është në fazë të planifikimit dhe përgatitjes së

<sup>219</sup> Ligji nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2863>

nxjerrjes së aktit nënligjor për DPBT-2. Lidhur me vlefshmërinë së lejitimit DBPT-2, i cili është vetëm gjashtë muaj, rekomandohet që ky afat të zgjatet në pesë vite. Zgjatja e vlefshmërisë së këtij lejimi do të kursente kohë për biznesin dhe po ashtu do të ulte koston e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për lejitimin DBPT-2. Afati i shkurtër i vlefshmërisë së DDD-së mund të jetë ngarkesë edhe për vetë zyrtarët e MBPZHR-së sepse iu duhet të kontrollojnë secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën apo jo.

## **2. Prodhimtaria blegtoriale**

Në kategorinë prodhimtaria blegtoriale janë identifikuar gjithsejt tetë lejime. Prej tyre, vetëm dy janë funksionale, përkatësisht Licenca për zhvillimin e aktiviteteve të akuakultures DPBT-13 dhe Licenca për importues të materialit riprodhues DPBT-18. Lejimet tjera, përkatësisht Aprovimi për importuesit e materialit biologjik për reproduksion DPBT-12, Certifikimi i bletorëve për prodhimin e luzmave të bletëve dhe amave DPBT-14, Licenca për objektet për përpunimin, ruajtjen e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit DPBT-15, Licenca për teknik të veterinarisë për mbarështim artificial DPBT-16, Licenca për fermer të veterinarisë për mbarështim artificial DPBT-17 dhe Licenca për krerë meshkuj për riprodhim natyral të kafshëve DPBT-19 nuk aplikohen sepse janë në pritje të nxjerrjes së akteve nënligjore. Rekomandohet që këto lejime të mos figurojnë në Regjistër, meqë të njëjtat nuk zbatohen në praktikë.

## **3. Prodhimtaria bimore**

Në kategorinë prodhimtari bimore, janë identifikuar gjithsejt 26 lejime . Prej tyre, pesë lejime kanë të bëjnë me fara, 16 lejime kanë të bëjnë me fidane dhe pesë më plehëra artificiale. Më poshtë është paraqitur analiza e secilës prej këtyre lejimeve.

### **3.1. Fara**

Lidhur me fara lëshohen këto lejime: Licenca për import të fares DPBT-20, Licencë për tregtues të fares DPBT-21, Licenca për prodhues të fares DPBT-22, Licenca për përpunues të fares DPBT-23 dhe Licenca për paketues të fares DPBT-24. Rekomandohet që të bëhet bashkimi i të gjitha këtyre lejimeve në një licencë të vetme meqenëse këto lejime kanë qëllim të njëjtë, kanë bazë të njëjtë ligjore, kanë kosto të njëjtë (prej 100 euro për lejim dhe 90 euro për vazhdim të saj), kanë të bëjë me të njëjtin produkt për të aplikuar për këto lejime si dhe kërkohen dokumente të njëjta të aplikimit. Ekzistimi i pesë lejimeve të ndryshme për fara është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe kanë shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim.

### **3.2. Fidane**

Sa i përket **fidaneve** janë identifikuar 16 lejime. Rekomandimi kryesor për këto lejime është bashkimi i tyre. Bashkimi do të ishte e arsyeshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjnë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.

Shumica e lejimeve të listuara më poshtë vlen për një vit, me disa perjashtime. Rekomandohet që ky afat të zgjatet në pesë vite. Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejimeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejime. Po



ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.

Në mënyrë të veçantë, bazuar në arsyetimet e lartpërmendura rekomandohet që:

Të bëhet bashkimi i Licencës për tregtimin e materialit fidanor të pemëve DPBT-25, Licencës për importimin e materialit fidanor të pemëve DPBT-26, Licencës për eksportues të materialit fidanor të pemëve DPBT-27 dhe Licencës për prodhues të materialit fidanor të pemëve DPBT-28. Vlefshmëria e këtyre lejimeve është një vit dhe rekomandohet që vlefshmëria e tyre të zgjatet pesë vite

Të bëhet bashkimi i Licencës për tregtimin e materialit fidanor të hardhisë DPBT-29, Licencës për importues të materialit fidanor të hardhisë DPBT-30, Licencës për prodhues të materialit fidanor të hardhisë së rrushit DPBT-31 dhe Licencës për eksportimin e materialit fidanor të hardhisë së rrushit DPBT-32. Vlefshmëria e këtyre lejimeve është një vit dhe rekomandohet që vlefshmëria e tyre të zgjatet pesë vite.

Të bëhet bashkimi i Licencës për tregtimin e materialit fidanor të bimëve dekorative DPBT-33, Licencës për importimin e materialit fidanor të bimëve dekorative DPBT-34, Licencës për eksportues të materialit fidanor të bimëve dekorative DPBT-35 dhe Licencës për prodhues të materialit fidanor të bimëve dekorative DPBT-36. Vlefshmëria e këtyre lejimeve është një vit, me përjashtim të lejimit DPBT-33 që është tre vjet, dhe rekomandohet që vlefshmëria e tyre të zgjatet pesë vite.

Të bëhet bashkimi i Licencës për tregtimin e materialit fidanor të perimeve DPBT-37, Licencës për importimin e materialit fidanor të perimeve DPBT-38, Licencës për eksportues të materialit fidanor të perimeve DPBT-39 dhe Licencës për prodhues të materialit fidanor të perimeve DPBT-40. Vlefshmëria për këto lejime është një vit, me përjashtim të lejimit DPBT-38 që është tre vjet dhe rekomandohet që vlefshmëria e tyre të zgjatet pesë vite.

### ***3.3. Plehra artificiale***

Në kategorinë prodhimtari bimore, janë identifikuar pesë lejime që kanë të bëjnë me plehra artificiale. Rekomandohet bashkimi i Licencës për importim të plehrave artificiale DPBT-42, Licencës për tregtimin e plehrave artificiale DPBT-43, Licencimit të prodhuesve të plehrave artificiale DPBT-44 dhe Licencës për ripaketus të plehrave artificiale DPBT-45. Bashkimi është i nevojshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.

Vlefshmëria për këto lejime është tre vjet dhe rekomandohet që vlefshmëria e tyre të zgjatet pesë vite. Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejimeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejime. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.

### ***3.4. Duhani***

Në kategorinë prodhimtari bimore, janë identifikuar tri lejime që kanë të bëjnë me duhanin. Propozohet që të bashkohen në një lejim të vetëm Licenca për grumbullues industrial të duhanit DPBT-46 dhe Licenca për përpunues industrial të duhanit dhe produkteve të tij DPBT-47. Bashkimi është i nevojshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme



gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë. Taksa për lejimin DPBT-47 është 1,000 euro (në Regjistër gabimisht figuron si 10,000 euro) dhe rekomandohet që të rishikohet ashtu që të mos tejkalohet shuma e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin ministrisë për të administruar lejimin siq është theksuar në ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

Table 1: Lista e ligjeve/akteve nënligjore

Nr	Emri i Ligjit dhe Udhëzimeve Administrative
1.	Ligji nr. 04/L-191 për Blegtorinë <sup>220</sup> <ul style="list-style-type: none"> <li>Udhëzimi Administrativ nr.16/2013 per riprodhimin e kafsheve te fermes<sup>221</sup></li> </ul>
2.	<u>Ligji nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve</u> <sup>222</sup> <ul style="list-style-type: none"> <li>Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) - nr. 05/2017 për ripaketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve<sup>223</sup></li> <li>Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) – nr. 02/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2009 për autorizimin për certifikimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve<sup>224</sup></li> </ul>
3.	Ligji nr. 2003/10 ligji për Plehrat Artificiale <sup>225</sup> <ul style="list-style-type: none"> <li>Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) - nr. 04/2016 për licencimin e prodhuesve dhe ripaketuesve të plehrave artificiale<sup>226</sup></li> </ul>
4.	<u>Ligji nr. 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit</u> <sup>227</sup> <ul style="list-style-type: none"> <li><u>Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) nr. 3/2015 për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe mënyrën e dhënies së licencës për grumbullimin, përpunimin industrial të duhanit dhe produkteve të tij</u><sup>228</sup></li> </ul>
5.	<u>Ligji nr. 02/L-85 për Peshkatori dhe Akuakulturë</u> <sup>229</sup> <ul style="list-style-type: none"> <li><u>Udhëzim Administrativ (MBPZHR) nr. 9/2008 për licencimin e aktiviteteve të akuakulturës</u><sup>230</sup></li> </ul>
6.	<u>Ligji nr. 02/L-111 për Bletari</u> <sup>231</sup> <ul style="list-style-type: none"> <li><u>Udhëzimi Administrativ nr.16/2013 per riprodhimin e kafshëve të fermës</u><sup>232</sup></li> </ul>

<sup>220</sup> Ligji nr. 04/L-191 për Blegtorinë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8813>

<sup>221</sup> Udhëzim Administrativ nr.16/2013 per riprodhimin e kafsheve te fermes - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10097>

<sup>222</sup> Ligji nr.03/L-042 i produkteve për mbrojtjen e bimëve - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2604>

<sup>223</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - nr. 05/2017 për ripaketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15171>

<sup>224</sup> Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) – nr. 02/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2009 për autorizimin për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7863>

<sup>225</sup> Ligji nr. 2003/10 ligji për plehrat artificiale - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2466>

<sup>226</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - nr. 04/2016 për licencimin e prodhuesve dhe ripaketuesve të plehrave artificiale - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15160>

<sup>227</sup> Ligji nr. 04/L-041 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2783>

<sup>228</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) nr. 3/2015 për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe mënyrën e dhënies së licencës për grumbullimin, përpunimin industrial të duhanit dhe produkteve të tij - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15056>

<sup>229</sup> Ligji nr. 02/L-85 për peshkatori dhe akuakulturë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2507>

<sup>230</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) nr. 9/2008 për licencimin e aktiviteteve të akuakulturës -

<sup>231</sup> Ligji nr. 02/L-111 për bletari - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7588>

<sup>232</sup> Udhëzim Administrativ nr.16/2013 per riprodhimin e kafsheve te fermes - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10097>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Udhëzimi Administrativ nr. 04/2009 për caktimin e taksës për licencimin e subjekteve që merren me import dhe tregtim të plehrave artificiale</u><sup>233</sup></li> </ul>
7.	<p><u>Ligji nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat</u><sup>234</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 për caktimin e taksës për regjistrimin e subjekteve, testim të varieteteve për vlerën kultivuese prodhuese dhe shtypjen e etiketave për farëra të drithërave</u><sup>235</sup></li> </ul>
8.	<p><u>Ligji nr. 2004/13 për Materialin Fidanor</u><sup>236</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Udhëzimi Administrativ ma-nr. 04/2007 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ ma-nr.14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</u><sup>237</sup></li> <li>• <u>Udhëzimi Administrativ ma-nr. 14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</u><sup>238</sup></li> <li>• <u>Udhëzimi Administrativ nr. 04/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ ma-nr.04/2007 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</u><sup>239</sup></li> <li>• <u>Udhëzimi Administrativ nr. 04/2009 për caktimin e taksës për licencimin e subjekteve që merren me import dhe tregtim të plehrave artificiale</u><sup>240</sup></li> </ul>
9.	<p><u>Ligji nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve</u><sup>241</sup></p>

Lista e lejimeve:

Nr.	Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë (DPBT)
1.	<u>MBROJTJA E BIMEVE</u>
DPBT-1	Leje për persona përgjegjës në barnatore bujqësore

<sup>233</sup> Udhëzim Administrativ nr. 04/2009 për caktimin e taksës për licencimin e subjekteve që merren me import dhe tregtim të plehrave artificiale - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7689>

<sup>234</sup> Ligji nr. 2003/5 i Kosovës për farërat - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2430>

<sup>235</sup> Udhëzim Administrativ nr. 08/2009 për caktimin e taksës për regjistrimin e subjekteve, testim të varieteteve për vlerën kultivuese prodhuese dhe shtypjen e etiketave për farëra të drithërave - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7704>

<sup>236</sup> Ligji nr. 2004/13 për materialin fidanor - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2491>

<sup>237</sup> Udhëzim Administrativ ma-nr. 04/2007 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ ma- nr.14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7461>

<sup>238</sup> Udhëzim Administrativ ma-nr. 14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7243>

<sup>239</sup> Udhëzim Administrativ nr. 04/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ ma-nr.04/2007 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7995>

<sup>240</sup> Udhëzim Administrativ nr. 04/2009 për caktimin e taksës për licencimin e subjekteve që merren me import dhe tregtim të plehrave artificiale - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7689>

<sup>241</sup> Ligji nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2863>

DPBT-2	Leje e përkohshme për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim – DDD
DPBT-3	Leje për vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve që janë të autorizuar në vendet anëtare të Bashkimit Evropian
DPBT-4	Certifikatë për autorizim të produktit për mbrojtjen e bimëve
DPBT-5	Leje e vecantë për produktet e mbrojtjes së bimëve
DPBT-6	Leje e vecantë për përdorim të produkteve për mbrojtjen e bimëve në sasi të vogla
DPBT-7	Leje për hulumtim shkencor për produktet për mbrojtjen e bimëve
DPBT-8	Certifikimi i pajisjeve që përdoren për aplikimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve
DPBT-9	Autorizim i përkohshëm (të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve)
DPBT-10	Regjistrimi për ripaketim të produkteve për mbrojtjen e bimëve
DPBT-11	Leje për shfrytëzim vetanak për produktet për mbrojtjen e bimëve
<b>2.</b>	<b><u>PRODHIMTARIA BLEGTORALE</u></b>
DPBT-12	Aprovim për importuesit e materialit biologjik për reproduksion
DPBT-13	Licencë për zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës
DPBT-14	Certifikimi i bletorëve për prodhimin e luzmave të bletëve dhe amave
DPBT-15	Licencë për objektet për përpunimin, ruajtjen e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit
DPBT-16	Licencë për teknik të veterinarisë për mbarështim artificial
DPBT-17	Licencë për fermer të veterinarisë për mbarështim artificial
DPBT-18	Licencë për importues të materialit riprodhues
DPBT-19	Licencë për krerë meshkuj për riprodhim natyral të kafshëve
<b>3.</b>	<b><u>PRODHIMTARIA BIMORE</u></b>
<b>3.1</b>	<b><u>FARAT</u></b>
DPBT-20	Licencë për import të fares
DPBT-21	Licencë për tregtues të fares
DPBT-22	Licencë për prodhues të fares
DPBT-23	Licencë për përpunues të fares
DPBT-24	Licencë për paketues të fares
<b>3.2</b>	<b><u>FIDANET</u></b>

DPBT-25	Licencë për tregtimin e materialit fidanor të pemëve
DPBT-26	Licencë për importimin e materialit fidanor të pemëve
DPBT-27	Licencë për eksportues të materialit fidanor të pemëve
DPBT-28	Licencë për prodhues të materialit fidanor të pemëve
DPBT-29	Licencë për tregtimin e materialit fidanor të hardhisë
DPBT-30	Licencë për importues të materialit fidanor të hardhisë
DPBT-31	Licencë për prodhues të materialit fidanor të hardhisë së rrushit
DPBT-32	Licencë për eksportimin e materialit fidanor të hardhisë së rrushit
DPBT-33	Licencë për tregtimin e materialit fidanor të bimëve dekorative
DPBT-34	Licencë për importimin e materialit fidanor të bimëve dekorative
DPBT-35	Licencë për eksportues të materialit fidanor të bimëve dekorative
DPBT-36	Licencë për prodhues të materialit fidanor të bimëve dekorative
DPBT-37	Licencë për tregtimin e materialit fidanor të perimeve
DPBT-38	Licencë për importimin e materialit fidanor të perimeve
DPBT-39	Licencë për eksportues të materialit fidanor të perimeve
DPBT-40	Licencë për prodhues të materialit fidanor të perimeve
<b>3.3</b>	<b><u>PLEHRAT ARTIFICIALE</u></b>
DPBT-41	Certifikatë për regjistrimin e plehrave artificiale
DPBT-42	Licencë për importim të plehrave artificiale
DPBT-43	Licencë për tregtimin e plehrave artificiale
DPBT-44	Licencimi i prodhuesve të plehrave artificiale
DPBT-45	Licencë për ripaketus të plehrave artificiale
<b>3.4</b>	<b><u>DUHANI</u></b>
DPBT-46	Licencë për grumbullues industrial të duhanit
DPBT-47	Licencë për përpunues industrial të duhanit dhe produkteve të tij
DPBT-48	Licencë për ngastrat e verifikuara nga inspektorët fitosanitarë ku prodhohet duhani

### 3.3 DEPARTAMENTI I VRESHTARISË DHE VERËTARISË

Departamenti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë (DVV) është departament në kuadër të MBPZHR dhe është përgjegjës për lëshimin e gjashtë lejimeve që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me kualitetin e verës, kultivimin e verëve, përpunimin e rrushit, eksportimin, importimin dhe qarkullimin e verës, rakisë dhe prodhimeve të tjera frutore. Këto lejime janë të rregulluara me Ligjin Nr.02/L-8 për Verërat,<sup>242</sup> Ligjin Nr.04/L-019 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr,02/L-08 për Verërat,<sup>243</sup> Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2013 për caktimin e lartësisë së kompensimit material për shërbimet e kryera në lëmin e vreshtarisë dhe verëtarisë të ofruara nga enti i vreshtarisë dhe verëtarisë, Udhëzimin Administrativ nr. 11/2009 për caktimin e kritereve për importin, eksportin dhe tregtinë e brendshme të verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera, Udhëzimin Administrativ nr. 06/2013 për regjistrim të kultivuesve të rrushit, prodhues dhe përpunues të verëve dhe prodhimeve tjera nga rrushi e vera dhe Udhëzimin Administrativ nr. 11/2006 për caktimin e kritereve për marrjen e mostrave dhe vlerësimin e verëve.

Nga gjashtë lejimet e administruara nga DVV-ja, vetëm tre prej tyre gjenden në Regjistrin Qëndror, përkatësisht Certifikata e prejardhjes së kualitetit DVV-1 (që njihet ndryshe si leja për plasim në treg), Licenca për kultivues, prodhues dhe përpunues të verëve dhe prodhimeve të tjera nga rrushi e vera DVV-2 dhe Licenca për qarkullues të verës për qarkullim në tregun e brendshëm DVV-5. Lejimet të cilat nuk figurojnë në Regjistrin Qëndror Licencë janë Licenca për eksportim të verës dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera DVV-3, Licenca për importim të verës dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera DVV-4 dhe Licencë për destilator DVV-6.

Gjatë analizës dhe diskutimeve me përfaqësues të DVV-së dhe biznesit është identifikuar nevoja që disa lejime të cilat administrohen nga DVV-ja të bashkohen. Përkatësisht, propozohet që të bashkohen këto lejime në një lejim të veçantë: Licenca për kultivues, prodhues dhe përpunues të verëve dhe prodhimeve të tjera nga rrushi e vera DVV-2, Licenca për eksportim të verës dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera DVV-3, Licenca për importim të verës dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera DVV-4 dhe Licenca për qarkullues të verës për qarkullim në tregun e brendshëm DVV-5. Bashkimi mund të jetë i arsyeshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjnë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.

Një aspekt tjetër i identifikuar gjatë analizës ligjore ka të bëjë me kohëzgjatjen e lejimeve. Për shembull, vlefshmëria e lejimeve të lëshuara nga DVV-ja varion nga një vit, në tre vjet etj. Rekomandohet që ky afat i vlefshmërisë të zgjatet në pesë vite. Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejimeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejime. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.

Një praktikë e identifikuar gjatë analizës është kërkesa nga DVV-ja që bizneset të cilat aplikojnë për lejime të caktuara të paraqesin dokumente të shumta. DVV-ja kërkon, ndër të tjera, nga operatorët dokumente origjinale apo kopje të vërtetuara. Për shembull, për Licencën për kultivues, prodhues dhe përpunues të verëve dhe prodhimeve të tjera nga rrushi e vera DVV-2, ndër të tjera kërkohet kopje e vërtetuar e certifikatës së biznesit dhe informata mbi biznesin, kopje e vërtetuar e diplomës profesionale dhe origjinali i procesverbalit fitosanitar.

<sup>242</sup>Ligjin Nr.02/L-8 për Verërat dhe, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2438>

<sup>243</sup>Ligjin Nr.04/L-019 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr,02/L-08 për Verërat <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2759>

Kopjet e tyre kërkohen të vërtetuara nga ARBK-ja. DVV-ja mund të mos i kërkojë palës që certifikatën e biznesit dhe informatat për biznesin t'i sjellë në origjinal nga ARBK-ja por vetë zyrtari/ja përgjegjës/e për lëshimin e lejimit brenda ministrisë mund ta verifikojë online në faqen e internetit të ARBK-së. Tutje, nuk duhet të kërkohet kopje e vërtetuar apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike. Në mënyrë që të përshpejtohet procedura e aplikimit dhe pajisjes me lejime, rekomandohet që MBPZHR të koordinohet me institucionet tjera siç është ARBK-ja.

### **3.4 DEPARTAMENTI I PYLLTARISË**

Departamenti i Pylltarisë (DP) në MBPZHR aktualisht i ka në regjistër katër lejime që kanë të bëjnë me kryerjen e punimeve pyjore, me përpunuesit e produkteve drunore dhe gjuetinë për qëllime shkencore.

Gjatë analizës së Udhëzimeve Administrative (03/2008 dhe 23/2008) dhe diskutimeve me përfaqësues të DP-së i propozohet DP që të plotësoj forumlarët adekuat dhe të shtojë në regjistër këto lejime të cilat janë pjesë e këtyre UA:

1. Licencë për pyllëzime, prodhimin e fidaneve. grumbullimin dhe trajtimin e farërave pyjore, punimet përgatitore dhe mbjellje fidanesh;
2. Licencë për kultivimin e pyjeve;
3. Licencë për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve: prerje, tërheqje dhe transport;
4. Licencë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e urave dhe rrugëve pyjore;
5. Licencë për grumbullimin dhe vjeljen qëndrueshme të produkteve drunore dhe jo drunore, florës, bimëve mjeksore dhe tanifere;
6. Licencë për ushtrimin e veprimtarive në gjueti dhe ekoturizëm;
7. Licencë për mbrojtje nga sëmundjet, dëmtuesit, zjarret dhe erozioni;
8. Licencë për hartimin e planit zhvillimor të pylltarisë;
9. Licencë për hartimin e projekteve për kultivimin e pyjeve;
10. Licencë për hartimin e projekteve për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe tokave pyjore;
11. Licencë për hartimin e projekteve të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhese;
12. Licencë për projektimin e urave dhe rrugëve pyjore;
13. Licencë për analizimin e gjendjes fitopatologjike, entomologjike dhe mbrojtjen nga zjarret në pyje;
14. Licencë për planifikimin dhe menaxhimin e shfrytëzimit të tokave pyjore;
15. Licencë për hulumtimin e rezervave gjenetike dhe biodiversitetin pyjor;
16. Licencë për hartimin e planeve të menaxhimit (programeve) për kafshë të egra dhe ekoturizëm;
17. Licencë për hartimin e planeve për kultivimin, grumbullimin dhe shfrytëzimin e produkteve pyjore jodrunore;

Baza ligjore për përcaktimin e këtyre lejimeve përfshinë Ligjin për Pyjet e Kosovës,<sup>244</sup> Ligjin për Gjuetinë<sup>245</sup>, Udhëzimin Administrativ nr. 03/2008 për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e licencave për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore<sup>246</sup>, Udhëzimin Administrativ nr. 23/2008 për licencimin e subjekteve juridike për planifikime dhe projektme në fushën e pylltarisë<sup>247</sup> dhe Udhëzimin Administrativ nr. 11/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr 23/2008 për licencimin e subjekteve juridike për planifikime dhe projektme në fushën e pylltarisë<sup>248</sup>, Udhëzim Administrativ 15/2006 për Standardet dhe kushtet për Licencimin e përpunuesve të produkteve drunore<sup>249</sup>.

Me 27 Maj 2019, Ministrja e MBPZHR i ka nënshkruar edhe tre ndryshim plotësime të Udhëzimeve Administrative të cilat ndërildhen direkt me këtë proces, Udhëzimin Administrativ nr. 15/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr 15/2006 për Standardet dhe kushtet për Licencimin e përpunuesve të produkteve drunore. Udhëzimin Administrativ nr. 14/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr 23/2008 për licencimin e subjekteve juridike për planifikime dhe projektme në fushën e pylltarisë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr 03/2008 për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e licencave për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore.

Me ndryshimet e bëra janë propozuar ndryshime në tarifa dhe gjoha dhe gjithashtu është zgatur afati i licencave nga tre në pesë vite. Udhëzimet e reja Administrative akoma nuk janë publikuar në faqën zyrtare në MBPZHR dhe ne Gazetën Zyrtare prandaj të njëjtat nuk konsiderohen që kanë hyrë në fuqi akoma.

Më poshtë është paraqitur lista e lejimeve që menaxhohen nga DP-ja.

Licenca për kryerjen e punimeve pyjore për subjektet vendore DP-1 dhe Licenca për kryerjen e punimeve pyjore për subjektet e huaja DP-2 janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2008 për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e licencave për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore. Departamenti i Pylltarisë nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për lëshimin e këtyre dy licencave, pasi që licensimi i subjekteve vendore dhe të huaja për kryerjen e punimeve pyjore nuk parashihet shprehimisht me Ligjin për Pyjet e Kosovës. Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, lejimet mund të parashihen vetëm me ligj, pasi që të përcaktohet shkalla e rrezikshmërisë së shëndetit publik, sigurisë publike dhe mjedisit. Pra, fakti që këto lejime janë përcaktuar vetëm me Udhëzim Administrativ, pa u bazuar në Ligjin për Pyjet e Kosovës, janë në kundërshtim me Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Për këtë arsye, rekomandohet që të inicohet plotësim ndryshimi i Ligjit për Pyjet e Kosovës, ashtu që të krijohet baza ligjore për lejimin DP-1 dhe DP-2. Këto lejime duhet të bashkohen, siç arsyetohet më poshtë, por mos të eliminohen për shkak se ekziston shkallë e mesme ose e lartë e sigurisë publike, shëndetit publik dhe mjedisit.

<sup>244</sup> Ligji nr. 2003/3 për pyjet e kosovës - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566>

<sup>245</sup> Ligji nr. 02/l-53 për gjuetinë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2433>

<sup>246</sup> Udhëzimin Administrativ nr. 03/2008 për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e licencave për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7563>

<sup>247</sup> Udhëzimin Administrativ nr. 23/2008 për licencimin e subjekteve juridike për planifikime dhe projektme në fushën e pylltarisë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7599>

<sup>248</sup> Udhëzim Administrativ nr. 11/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr 23/2008 për licencimin e subjekteve juridike për planifikime dhe projektme në fushën e pylltarisë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10043>

<sup>249</sup> Udhëzim Administrativ 15/2006 për Standardet dhe kushtet për Licencimin e përpunuesve të produkteve drunore - <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7413>

Gjatë analizës dhe diskutimeve me përfaqësues të biznesit është identifikuar nevoja që – derisa të bëhen ndryshimet e nevojshme në Ligjin për Pyjet e Kosovës – të bashkohen në një licencë të vetme Licenca për kryerjen e punimeve pyjore për subjektet vendore DP-1 dhe Licenca për kryerjen e punimeve pyjore për subjektet e huaja DP-2. Bashkimi është i nevojshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjnë me të njëjtën veprimtari dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë. Për më tepër, bashkimi i tyre është i nevojshëm sepse as ARBK-ja nuk bën dallim në veprimtarinë e bizneseve vendore apo të huaja.

Sipas informatave të mbledhura, vetëm aplikimi për lejimet DP-1 dhe DP-2 kushton 20 euro, marrja e këtyre lejimeve kushton 300 euro dhe ripërtrirja, e cila duhet të bëhet çdo tri vjet, kushton 150 euro. Në fakt, ekziston një shpërputhje në mes të informacioneve për këtë tarifë në Regjistrin Qëndror (200 euro) dhe në Udhëzimin Administrativ 23/2008 (300 euro). Pagesa për aplikim (prej 20 euro) mund të eliminohet ndërsa lidhur me tarifën prej 300 euro Departamenti i Pylltarisë duhet të sigurohet që nuk kalon shumën e nevojshme të ministrisë për të mbuluar shpenzimet që i dalin Departamentit të Pylltarisë për ta administruar lejimin (ashtu siç parashihet me nenin 18 të Ligjit për Sistmin e Lejeve dhe Licencave).

Sa i përket lejes për gjueti për qëllime shkencore DP-3, pagesa për aplikim (prej 20 euro) duhet të largohet. Departamenti i Pylltarisë duhet të sigurohet që tarifa prej 300 euro për leje dhe 200 për ripërtrirje të lejes DP-2 nuk kalon shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin këtij departamenti për ta administruar lejimin (ashtu siç parashihet me nenin 18 të Ligjit për Sistmin e Lejeve dhe Licencave).

Nr.	Departamenti i Pylltarisë (DP)
DP-1	Licencë për kryerjen e punimeve pyjore – subjektet vendore
DP-2	Licencë për kryerjen e punimeve pyjore – subjektet e huaja
DP-3	Licencë për përpunues të produkteve drunore (sharra)
DP-4	Leje gjuetie për qëllime shkencore

### 3.5 AGJENCIA E PYJEVE TË KOSOVËS

Agjencia e Pyjeve të Kosovës (APK) është përgjegjëse për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore publike dhe pyjeve në Parqet Nacionale në Kosovë dhe funksionon në kuadër të MBPZHR-së. Aktualisht APK-ja është përgjegjëse për lëshimin e nëntë “lejimeve” që kanë të bëjnë me, ndër të tjera, prerjet në pyjet private, shfrytëzimin e produkteve pyjore, shfrytëzimin e tokës pyjore etj. Baza ligjore për administrimin e lejimeve është Ligji për Pyjet e Kosovës<sup>250</sup> dhe Udhëzimi

<sup>250</sup> Ligji nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566>



Administrativ – Nr 12/2005 për caktimin e çmimeve - taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore- drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale – teknike.<sup>251</sup>

Vlen të sqarohet se në Regjistrin Qëndror, tek seksioni për APK-në, figurojnë nëntë “lejime”. Edhe pse këto nëntë “lejime” figurojnë në Regjistër, pas analizes ligjore dhe takimeve me drejtoratin qëndror të inspeksionit për pylltari dhe gjueti është konkluduar që nëntë “lejimet” e listuara si leje dhe licenca kanë natyrë kontraktuale. Për shembull, Leja për shfrytëzimin e tokës pyjore me qira për ndërtimin e objekteve të përkohshme në tokat pyjore APK-5 në fakt është kontratë e qirasë e cila lidhet në mes të MBPZHR-së dhe subjekteve private dhe si e tillë bazuar në Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave nuk mund të kualifikohet si lejim. Për këtë arsye rekomandohet që Licenca për shfrytëzimin e produkteve pyjore jo-drunore (Leje për shfrytëzimin e tokës – për gurore) APK-3, Licenca për shfrytëzimin e produkteve pyjore jo drunore (Leje për shfrytëzimin e tokës pyjore meqera për destinim në bujqësi) APK-4, Leja për shfrytëzimin e tokës pyjore me qira për ndërtimin e objekteve të përkohshme në tokat pyjore APK-5, Leja për shfrytëzimin e tokës pyjore për kullotjen e gjedhëve, viçave, deleve, qengjave, kuajve, gomarëve dhe derrave APK-6, Leja për kotarët dhe bylmetorët APK-7, Leja për depo pranë rrugës në tokat pyjore APK-8, Leja për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore për gëlqerore APK-9, Leja për shfrytëzimin e tokës për mullinj APK-10 dhe Leja për shfrytëzimin e tokës për shtëpi bjeshkatarësh APK-11, të largohen nga Regjistri pasi që nuk kualifikohen si lejime por janë të natyrës kontraktuale. MBPZHR dhe APK duhet që këto procedura të cilat hiqen nga Regjistri të njejtat të jenë publike në faqën zyrtare.

Dy lejime tjera, të cilat mund të kualifikohen si lejime, përkatësisht Vërtetimi për mosinteresim të blerjes së tokës pyjore në pronësi private APK-1 dhe Leja për prerje në pyjet private APK-2, nuk figurojnë fare në Regjistrin Qëndror. Për më tepër, njëra nga këto, përkatësisht Vërtetimi për mosinteresim të blerjes së tokës pyjore në pronësi private APK-1 nuk parashihet shprehimisht në Ligjin për Pyjet e Kosovës për më tepër nuk parashihet që APK të pajisë qytetarët me vërtetime të tilla dhe rrjedhimisht Vërtetimi për mosinteresim të blerjes së tokës pyjore në pronësi private APK-1 sipas Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave nuk mund të kualifikohet si lejim. Më tej, sygjerohet të rishikohet eliminimi i këtij lejimi për shkak se nuk paraqet rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin. Gjithashtu vlen të ceket se që nga koha kur ky lejim ka filluar të zbatohet, në asnjë rast nuk ka rezultuar në praktikë që MBPZHR ose APK të ketë blerë ndonjë tokë pyjore në pronësi private. Ndërsa, sa i përket Lejës për prerje në pyjet private APK-2, ky lejim duhet të shtohet në Regjistër meqë aktualisht nuk figuron aty.

Nr.	Agjencioni Pyjor i Kosovës (APK)
APK-1	Vërtetim për mosinteresim të blerjes së tokës pyjore në pronësi private
APK-2	Leje për prerje në pyjet private (dru zjarri, dru teknike)
APK-3	Licencë për shfrytëzimin e produkteve pyjore jo-drunore (Leje për shfrytëzimin e tokës – për gurore)
APK-4	Licencë për shfrytëzimin e produkteve pyjore jo drunore (Leje për shfrytëzimin e tokës pyjore meqera për destinim në bujqësi)
APK-5	Leje për shfrytëzimin e tokës pyjore me qira për ndërtimin e objekteve të përkohshme në tokat pyjore

<sup>251</sup> Udhëzim Administrativ Nr 12/2005 për caktimin e çmimeve, taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore- drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale teknike, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7288>

<b>APK-6</b>	Leje për shfrytëzimin e tokës pyjore për kullotjen e gjedhëve, viçave, deleve, qengjave, kuajve, gomarëve dhe derrave
<b>APK-7</b>	Leje për kotarët dhe bylmetorët
<b>APK-8</b>	Leje për depo pranë rrugës në tokat pyjore
<b>APK-9</b>	Leje për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore për gëlqerore
<b>APK-10</b>	Leje për shfrytëzimin e tokës për mullinj
<b>APK-11</b>	Leje për shfrytëzimin e tokës për shtëpi bjeshkatarësh

### 3.6 AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË – AUV

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUV) është autoriteti më i lartë për ushqim dhe veterinar i cili është përgjegjës që të mbrojë jetën dhe shëndetin e njerëzve. AUV është Agjenci Ekzekutive, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe ka në përgjegjësi 15 lejime që, ndër të tjera, kanë të bëjnë me importin e duhanit, licencimin e objekteve afariste veterinarë, tregjeve të kafshëve, importin e produkteve me origjinë shtazore etj. Këto lejime janë të rregulluara me Ligjin nr. 04/L-041 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit,<sup>252</sup> Ligjin nr. 04/l-120 për mbrojtjen e bimëve,<sup>253</sup> Ligjin nr.2004/21 për Veterinarinë,<sup>254</sup> Ligjin nr.03/l-016 për Ushqimin<sup>255</sup>, Ligjin nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës<sup>256</sup>, Ligjin nr. 04/l -190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale<sup>257</sup> dhe me Rregulloren (QRK) nr. 19/2014,<sup>258</sup> Rregulloren nr. 17/2012,<sup>259</sup> Rregulloren (QRK) Nr.05/2015,<sup>260</sup> Udhëzimin Administrativ Nr. 13/2007<sup>261</sup>, Udhëzim Administrativ Nr. 22/2005,<sup>262</sup> Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2007,<sup>263</sup> Udhëzimin administrativ Nr. 18/2005,<sup>264</sup> Udhëzimin

<sup>252</sup> Ligjin nr. 04/L-041 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit,

<sup>253</sup> Ligji nr. 04/l-120 për mbrojtjen e bimëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2863>

<sup>254</sup> Ligji nr.2004/21 për veterinarinë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2476>

<sup>255</sup> Ligji nr.03/l-016 për ushqimin - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2626>

<sup>256</sup> Ligjin nr. 2003/22 për Inspektoratin sanitar të Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2489>

<sup>257</sup> Ligjin nr. 04/l -190 për produkte dhe pajisje medicinale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9437>

<sup>258</sup> Rregullorja (QRK) nr. 19/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 17/2012 për caktimin e lartësisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10492>

<sup>259</sup> Rregullore nr. 17/2012 për caktimin e lartësisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8383>

<sup>260</sup> Rregullore (QRK) Nr.05/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 17/2012 për caktimin e lartësisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10868>

<sup>261</sup> Udhëzim Administrativ Nr. 13/2007 për licencimin e subjekteve afarist që kryejnë veprimtari të grumbullimit, deponimit dhe tregtimit të lëkurave me prejardhje nga kafshët e gjalla

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7479#>

<sup>262</sup> Udhëzim Administrativ Nr. 22/2005 për licencimin e ambulancave, stacioneve, dhe klinikave veterinarë - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7314#>

<sup>263</sup> Udhëzim Administrativ Nr. 05/2007 për përcaktimin e kushteve të tregjeve të kafshëve - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7457#>

<sup>264</sup> Udhëzim administrativ Nr. 18/2005 për kontrollin veterinar të importimit, kalimit transit të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore me origjinë shtazore, të kafshëve të gjalla dhe të materialit për mbarështimin e kafshëve <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7297>

Administrativ Nr. 18/2005,<sup>265</sup> Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2005 për caktimin e kushteve për licencimin e subjekteve afarist që kryejnë veprimtari të qarkullimit, importimit të produkteve mjekësore veterinarë dhe pajisjeve mjekësore veterinarë me shumicë dhe pakicë, Rregulloren (QRK) nr.18./2016,<sup>266</sup> Rregulloren (QRK) nr.11/2011,<sup>267</sup> dhe Rregulloren (QRK) nr.12/ 2011<sup>268</sup> për përcaktimin e rregullave specifike të higjienës së ushqimit me prejardhje shtazore. Lejimet e administruara nga AUV kanë të bëjmë me ushqim dhe veterinarë dhe paraqesin rrezik të lartë dhe të mesëm në shëndetin publik, sigurinë publike dhe mjedisin. Për këtë arsye, të gjeturat dhe rekomandimet në këtë seksion janë analizuar dhe paraqitur me kujdes të shtuar.

Pas analizës ligjore të lejimeve të administruara nga AUV-së është identifikuar nevoja që disa lejime të cilat administrohen nga AUV-ja të bashkohen. Përkatësisht, rekomandohet që të bashkohen këto lejime në një lejim të veçantë: Licenca për qarkullues të produkteve mjekësore veterinarë me shumicë AUV-13 dhe Licenca për qarkullues të produkteve mjekësore veterinarë me pakicë AUV-14. Bashkimi është i arsyeshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.

Në bazë të diskutimeve më përfaqësues të AUV-së dhe të analizës ligjore rekomandohet që të rishikohen dokumentet që kërkohen për aplikim për lejime në mënyrë që të thjeshtësohet aplikimi dhe kohëzgjatja e lejimeve. Për shembull, kërkesa e AUV në disa lejime për kopje të vërtetuar të dokumenteve origjinale të lëshuara nga institucionet publike është kosto financiare shtesë për palët si dhe është shpenzim i kohës për t'i siguruar këto dokumente nga institucione të ndryshme. Në parim, nuk duhet të kërkohet kopje e vërtetuar apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike. Po ashtu, AUV mund të mos i kërkojë palës që certifikatën e biznesit dhe informatat për biznesin t'i sjellë në origjinal nga ARBK-ja por vetë zyrtari përgjegjës për lëshimin e lejimeve. AUV-së mund ta verifikojë online në faqen e internetit të ARBK-së.

Poashtu, duhet të diskutohet mundësia e rishikimit të lejimeve që mbulojnë fushë të njëjtë dhe që lëshohen nga dy autoritete publike, përkatësisht AUV, DPTB (MPBZHR) dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Një shembull konkret ka të bëjë me lejimet që lëshohen për grumbullimin e duhanit dhe për importimin e tij. Po ashtu, AUV duhet të sigurohet që tarifat për lejime nuk kalojnë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin AUV-së për të administruar ato lejime (ashtu siç parashihet me nenin 18 të Ligjit për Sistmin e Lejeve dhe Licencave).

Nr.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)
AUV-1	Leje për importin e duhanit

<sup>265</sup> Udhëzim Administrativ Nr. 18/2005 për kontrollin veterinar të importimit, kalimit transit të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore me origjinë shtazore, të kafshëve të gjalla dhe të materialit për mbarështimin e kafshëve <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7297>

<sup>266</sup> Rregullore (QRK) nr.18./2016 për regjistrimin dhe aprovimin e operatorëve të biznesit me ushqim <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15072>

<sup>267</sup> Rregullore (QRK) nr.11/2011 për higjienën e prodhimeve ushqimore - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10545>

<sup>268</sup> Rregullore (QRK) nr.12/ 2011 për përcaktimin e rregullave specifike të higjienës së ushqimit me prejardhje shtazore <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10548>

<b>AUV-2</b>	Licencimi i subjekteve afariste për grumbullimin dhe tregtimin e leshit të deleve
<b>AUV-3</b>	Licencimi i objekteve afariste veterinare
<b>AUV-4</b>	Leje importi për ushqim për kafshë, kafshë të gjalla dhe materialit për mbarështim
<b>AUV-5</b>	Licencimi i tregjeve të kafshëve
<b>AUV-6</b>	Aprovimi i objekteve të operatorëve të biznesit me ushqim me prejardhje shtazore
<b>AUV-7</b>	Regjistrimi i objekteve të operatorëve të biznesit me ushqim me prejardhje shtazore
<b>AUV-8</b>	Leje importi për produkte me origjinë shtazore
<b>AUV-9</b>	Licencë për objekte afariste për grumbullimin, tregtimin dhe eksportin e lëkurave me prejardhje nga kafshët e gjalla
<b>AUV-10</b>	Pëlqimi Sanitar për ndërmarrjet publike, prodhuese, institutet, objektet shëndetësore dhe objektet universitare
<b>AUV-11</b>	Pëlqim sanitar për depot për produkte medicinale, paisje medicinale, fabrikat farmaceutike
<b>AUV-12</b>	Leje për eks-humimet
<b>AUV-13</b>	Licencë për qarkullues të produkteve mjekësore veterinare me shumicë
<b>AUV-14</b>	Licencë për qarkullues të produkteve mjeksore veterinare me pakicë
<b>AUV-15</b>	Licenca për importimin e produkteve mjekësore veterinare - certifikata e distribuimit

## Shtojca 1 – Tabela e Rekomandimeve të Përgjithshme për MBPZHR

Gjatë përgatitjes së analizës ligjore të lejimeve të MPBZHR dhe AUV është identifikuar një listë e rekomandimeve të përgjithshme dhe rekomandimeve specifike të cilat janë të përshkruara më poshtë.

REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME	
1.	<b>Rishikimi i rregullt i të gjitha lejimeve</b> – rekomandohet që MBPZHR dhe AUV të rishikojë në tërësi të gjitha lejimet ekzistuese ashtu që të sigurohen që lejimet të jenë të bazuar në ligj, meqë lejimet duhet të parashihen me ligj. Gjatë rishikimit të bazës ligjore së lejimeve, rekomandohet që MBPZHR dhe AUV të rishikojë njëkohësisht procedurat e aplikimit për lejime, ashtu që të thjeshtësojë aplikimin atëherë kur është e mundur.
2.	<b>Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve</b> – rekomandohet që zyrtarët përgjegjës për lejime në MBPZHR dhe AUV të informohen për obligimet që rrjedhin nga Ligji për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Në mënyrë që të evitohet në tërësi mundësia e ngarkesës së panevojshme e sektorit privat me lejime, është e nevojshme që të ngriten kapacitetet e zyrtarëve përgjegjës lidhur me kërkesat e Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Poashtu, rekomandohet që MBPZHR dhe AUV të monitorojë rregullisht zbatimin e këtij ligji.
3.	<b>Përditësimi i Regjistrisë Qëndrore për Leje dhe Licenca</b> – rekomandohet që zyrtarët përgjegjës të bëjnë përditësimin e Regjistrisë në baza të rregullta. Një gjë e tillë është nevojshme në mënyrë që qytetarët dhe sidomos sektori privat të jenë të njoftuar në vazhdimësi për të gjitha ndryshimet që kanë të bëjnë me lejime.
4.	<b>Koordinimi me institucione të tjera –</b> <u>MBPZHR, AUV dhe ARBK</u> Gjatë hulumtimit dhe analizës ligjore është kuptuar që bizneset të cilat aplikojnë për lejime janë të obliguara që të paraqesin kopjen e certifikatës së biznesit (ka raste kur kërkohen edhe informatat e biznesit) në ministri dhe në agjencionin përkatës, në mënyrë që të dëshmojnë që janë të regjistruara në ARBK. Rekomandohet që MBPZHR dhe AUV të shfrytëzojnë databazën e ARBK-së duke e përdorë atë drejtëpërsëdrejti online, ashtu që bizneset që aplikojnë për lejime të mos detyrohen të ofrojnë kopje të certifikatës dhe informatave të biznesit për secilin aplikim për lejime. Një gjë e tillë do të kursente kohën e përfaqësuesve të bizneseve dhe do të shkurtonte kohën për aplikim për lejime. <u>MBPZHR, AUV dhe MBP(ARC)</u> Gjatë hulumtimit dhe analizës ligjore është kuptuar që përfaqësuesit e autorizuar të bizneseve të cilat aplikojnë për lejime janë të obliguara që të paraqesin kopjen e leternjoftimit në mënyrë që të identifikohen para MBPZHR-së dhe AUV-së. Rekomandohet që MBPZHR dhe AUV të shfrytëzojnë databazën e Agjencionit për Regjistrim Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ashtu që përfaqësuesit e autorizuar të bizneseve që aplikojnë për lejime të mos detyrohen të ofrojnë kopje të leternjoftimit për secilin aplikim për lejime. Një gjë e tillë do të kursente kohën e përfaqësuesve të bizneseve dhe do të shkurtonte kohën për aplikim për lejime.

Shtojca 2 – Tabela e Rekomandimeve Specifike për MBPZHR

Afatet për zbatimin e rekomandimeve

	Afatshkurtër 6 muaj (nëntor 2019)
	Afatmesëm 9 muaj (shkurt 2020)
	Afatgjatë 18 muaj(fundi i vitit 2020)

DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE KËSHILLUESE DHE TEKNIKE (DSHK&T)					
Nr.	Kodi	Titulli i lejit	Arsyeshmëria	Rekomandimi	Çfarë duhet të ndryshojë për zbatimin e rekomandimeve
1	DSHKT-1	Certifikatë për këshilltarë dhe zhvillim rural	<p>Ky lejim duhet të eliminohet për shkak se nuk paraqet rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin.</p> <p>Ky lejim poashtu i sjellë kosto shtesë ministrisë, sepse për të lëshuar këtë lejim MBPZHR shpenzon mjete nga buxheti duke kontraktuar një kompani të jashtme e cila bën përgatitjen e këshilltarëve për bujqësi dhe zhvillim rural.</p>	Të eliminohet.	<p>Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji Nr. 04/L-075 për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural - (Neni 17)</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) 07/2015 për formën, përmbajtjen dhe procedurat e dhënies së provimit profesional dhe certifikatës për këshilltarë për bujqësi dhe zhvillim rural dhe zhvillim rural</p>
2	DSHKT-2	Licenca për personat juridik për ofrimin e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të ndërlidhura me shfrytëzimin e fondeve publike dhe ndërkombëtare	Ky lejim duhet të eliminohet për shkak se nuk paraqet rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin.	Të eliminohet.	<p>Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji Nr. 04/L-075 për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim rural (Neni 18)</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) 08/2015</p>

					për formën, përmbajtjen dhe procedurat e dhënies së licencës për personin juridik për ofrimin e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural
--	--	--	--	--	---

DEPARTAMENTI I POLITIKAVE BUJQËSORE DHE TREGËTISË (DPBT)					
	Nr.Kodi	Titulli i lejit	Arsyeshmëria	Rekomandimet	Çfarë duhet të ndryshojë për zbatimin e rekomandimeve
1.	DPBT-1	Leje për persona përgjegjës në barnatore bujqësore	<p>Ky lejim është përcaktuar vetëm me udhëzim administrativ, pa u bazuar në Ligjin për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve dhe është në kundërshtim me Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.</p> <p>Duke pasur parasysh që ndryshimi i bazës ligjore kërkon kohë, rekomandohet që në ndërkohë për lejimin DPBT-1 të thjeshtësohet procedura e aplikimit, duke ndryshuar Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) nr. 02/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2009 për autorizimin për</p>	<p>Të krijohet baza ligjore për këtë lejim.</p> <p>Të thjeshtësohet procedura e aplikimit (derisa të krijohet baza ligjore).</p> <p>Të zgjatet afati i vlefshmërisë në pesë vjet.</p>	<p>Të ndryshohet dhe plotësohet Ligjin për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve</p> <p>Të ndryshohet Udhëzimi administrativ nr. 02/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ nr.09/2009 autorizimi për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve</p>
2.					

			certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve		
3.	DPBT-2	Leje e përkohshme për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim	Zgjatja e vlefshmërisë së këtij lejimi do të kursente kohë për biznesin dhe po ashtu do të ulte koston e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për lejimin DBPT-2. Afati i shkurtër i vlefshmërisë së DDD-së është barrë e madhe edhe për vetë zyrtarët e MBPZHR-së sepse iu duhet të kontrollojnë secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën apo jo.	Nxjerrja e Udhëzimit Administrativ Qeveritar sipas Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Ligji për Veterinarinë;  (Grupi punues për draftimin e këtij Udhëzimi Administrativ duhet të përbehet nga MBPZHR, MSH, MMPH, AUV dhe ZL-ZKM)	Nxjerrja e udhëzimit administrativ qeveritar sipas Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Ligji për Veterinarinë;
4.	DPBT-12	Aprovim për importuesit e materialit biologjik për reproduksion	Rekomandohet që të draftohet Udhëzimi i ri Administrativ për ripordhimin e kafëshve  Zgjatja e vlefshmërisë së këtij lejimi do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen	Të draftohet Udhëzimi i ri Administrativ për ripordhimin e kafëshve  Të zgjatet afati i vlefshmërisë në pesë vjet;  Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të ndryshohet Udhëzimi administrativ nr. 25/2008 për ripordhimin e kafëshve  Të diskutohet edhe një here ky lejim pasi që ndërlihet edhe me programin e mbarështimit të MBPZHR.



			e dokumenteve për aplikim për këto lejime. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar çdo dy vite secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.		
5.	DPBT-14	Certifikimi i bletorëve për prodhimin e luzmave të bletëve dhe amave	Nuk zbatohen në praktikë sepse mungon Udhëzimi Administrativ i paraparë sipas Ligjit për Bletari (Nenit 19).	Të hartohet akti nënligjor	Të draftohet udhëzimi administrativ.
6.	DPBT-15	Licencë për objektet për përpunimin, ruajtjen e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit	Nuk zbatohen në praktikë sepse mungon Udhëzimi Administrativ i paraparë sipas Ligjit për Bletari (Nenit 39).	Të hartohet akti nënligjor	Të draftohet udhëzimi administrativ.
7.	DPBT-16	Licencë për teknik të veterinarisë për mbarështim artificial	Nuk zbatohen në praktikë sepse mungon Udhëzimi Administrativ i paraparë sipas Ligjit për Veterinarinë (Nenit 32).	Të hartohet akti nënligjor	Të draftohet udhëzimi administrativ.
8.	DPBT-17	Licencë për fermer të veterinës për mbarështim artificial	Mungon baza ligjore. Askund në Ligjin për	Të eliminohet	Të largohet nga Regjistri Qëndror.

			Veterinarinë nuk përmendet Licencimi i fermereve për mbarështim artificial.		
9.	DPBT-19	Licencë për krerë meshkuj për riprodhim natyral të kafshëve	Nuk zbatohen në praktikë sepse mungon baza ligjore dhe nuk është draftuar Programi i aprovuar i mbarështimit.	Të hartohet Programi i Aprovuar për Mbarështim  Të hartohet akti nënligjor në përputhje me Nenin 42 paragrafit 3 të Ligjit për Blegtori	Të draftohet udhëzimi administrativ.
10	DPBT-20 DPBT-21 DPBT-22 DPBT-23 DPBT-24	Licencë për import të fares Licencë për tregtues të farës Licencë për prodhues të fares Licencë për përpunues të fares Licencë për paketues të fares	Bashkimi duhet të bëhet për shkak se këto lejime kanë qëllim të njëjtë, kanë bazë të njëjtë ligjore, kanë kosto të njëjtë prej 100 euro për lejim dhe 90 euro për vazhdim të saj, kanë të bëjnë me të njëjtin produkt, për të aplikuar për këto lejime vlejné procedurë e njëjtë dhe kërkohen dokumente të njëjta të aplikimit. Ekzistimi i pesë lejimeve të ndryshme për fara është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe kanë shpenzime tjera të nevojshme gjatë	Të bashkohen në një licencë të vetme	Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 për caktimin e taksës për regjistrimin e subjekteve, testim të varieteteve për vlerën kultivuese prodhuese dhe shtypjen e etiketave për farëra të drithërave.

			përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim.		
11	<p>DPBT-25 DPBT-26 DPBT-27 DBPT-28</p>	<p>Licencë për tregtimin e materialit fidanor të pemëve</p> <p>Licencë për importimin e materialit fidanor të pemëve</p> <p>Licencë për eksportues e materialit fidanor të pemëve</p> <p>Licencë për prodhues të materialit fidanor të pemëve</p>	<p>Bashkimi është i nevojshëm sepse lejetet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjnë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejetet vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.</p> <p>Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejetet. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së</p>	<p>Të bashkohen në një licencë të vetme.</p> <p>Të zgjatet afati i vlefshmërisë në pesë vjet.</p> <p>Të draftohet udhëzim i ri administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p>	<p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 04/2007 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ ma-nr.14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 04/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ ma-nr.04/2007 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p> <p>Të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p>

			<p>afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.</p> <p>Rekomandohet që të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor, meqë është ky udhëzim administrativ është ndryshuar disa here dhe mban emër të gjatë.</p>		
12	<p>DPBT-29</p> <p>DPBT-30</p> <p>DPBT-31</p> <p>DPBT-32</p>	<p>Licencë për tregtimin e materialit fidanor të hardhisë</p> <p>Licencë për importues të materialit fidanor të hardhisë</p> <p>Licencë për eksportimin e materialit fidanor të hardhisë</p> <p>Licencë për prodhues të materialit fidanor të hardhisë së rrushit</p>	<p>Bashkimi është i nevojshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim</p>	<p>Të bashkohen në një licencë të vetme.</p> <p>Të zgjatet afati i vlefshmërisë në pesë vjet.</p> <p>Të draftohet udhëzim i ri administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p>	<p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p> <p>Udhëzim Administrativ ma-nr. 04/2007 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ ma- nr.14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit,</p>

		<p>dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.</p> <p>Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejimeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejime. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.</p> <p>Rekomandohet që të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor, meqë ky udhëzim administrative është ndryshuar disa here dhe mban emër të gjatë.</p>		<p>eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 04/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ ma-nr.04/2007 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p> <p>Të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p>
--	--	--	--	--

13	<p>DPBT-33</p> <p>DPBT-34</p> <p>DPBT-35</p> <p>DPBT-36</p>	<p>Licencë për tregtimin e materialit fidanor të bimëve dekorative</p> <p>Licencë për importimin e materialit fidanor të bimëve dekorative</p> <p>Licencë për eksportues të materialit fidanor të bimëve dekorative</p> <p>Licencë për prodhues të materialit fidanor të bimëve dekorative</p>	<p>Bashkimi është i nevojshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.</p> <p>Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejimeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejime. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga</p>	<p>Të bashkohen në një licencë të vetme.</p> <p>Të zgjatet afati i vlefshmërisë në pesë vjet.</p> <p>Të draftohet udhëzim i ri administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p>	<p>Të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 04/2007 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ ma-nr.14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 04/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ ma-nr.04/2007 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p>

			<p>obligimi për të kontrolluar çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.</p> <p>Rekomandohet që të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor, meqë është ky udhëzim administrative është ndryshuar disa here dhe mban emër të gjatë.</p>		
14	<p>DPBT-37</p> <p>DPBT-38</p> <p>DPBT-39</p> <p>DPBT-40</p>	<p>Licencë për tregtimin e materialit fidanor të perimeve</p> <p>Licencë për importimin e materialit fidanor të perimeve</p> <p>Licencë për eksportues të materialit fidanor të perimeve</p> <p>Licencë për prodhues të materialit fidanor të perimeve</p>	<p>Bashkimi është i nevojshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së</p>	<p>Të bashkohen në një licencë të vetme.</p> <p>Të zgjatet afati i vlefshmërisë në pesë vjet.</p> <p>Të draftohet udhëzim i ri administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p>	<p>Të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 04/2007 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ ma-nr.14/2004 për regjistrimin,</p>

			<p>dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.</p> <p>Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejimeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejime. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.</p> <p>Rekomandohet që të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor, meqë është ky udhëzim administrative është ndryshuar disa here dhe mban emër të gjatë.</p>		<p>licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 04/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ ma-nr.04/2007 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p>
--	--	--	--	--	--



15	<p>DPBT-42</p> <p>DPBT-43</p> <p>DPBT-44</p> <p>DPBT-45</p>	<p>Licencë për importim të plehrave artificiale</p> <p>Licencë për tregtimin e plehrave artificiale</p> <p>Licencimi i prodhuesve të plehrave artificiale</p> <p>Licencë për ripaketus të plehrave artificiale</p>	<p>Bashkimi është i nevojshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejime vlejné procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.</p> <p>Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejimeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkarkohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejime. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar</p>	<p>Të bashkohen në një licencë të vetme.</p> <p>Të zgjatet afati i vlefshmërisë në pesë vjet.</p> <p>Të draftohet udhëzim i ri administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p>	<p>Të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 04/2007 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ ma-nr.14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor</p> <p>Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 04/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ ma-nr.04/2007 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.</p>
----	---	--	--	--	---

			<p>çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.</p> <p>Rekomandohet që të draftohet Udhëzimi Administrativ për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor, meqë është ky udhëzim administrative është ndryshuar disa here dhe mban emër të gjatë.</p>		
16	<p>DPBT-46</p> <p>DPBT-47</p>	<p>Licencë për grumbullues industrial të duhanit</p> <p>Licencë për përpunues industrial të duhanit dhe produkteve të tij</p>	<p>Bashkimi është i nevojshëm sepse lejetimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejetime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejetimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë</p>	<p>Të bashkohen në një licencë të vetme.</p> <p>Të përditësohet Regjistri Qëndror meqë taksa për këtë lejetim gabimisht figuron 10,000 euro në vend të 1,000 euro.</p>	<p>Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ (mbpzhr) nr. 3/2015 për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe mënyrën e dhënies së licencës për grumbullimin, përpunimin industrial të duhanit dhe produkteve të tij</p> <p>Të përditësohet Regjistri Qëndror</p>

			përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.		
--	--	--	---	--	--

DEPARTAMENTI I VRESHTARISË DHE VERËTARISË					
	Nr.Kodi	Titulli i lejit	Arsyeshmëria	Rekomandime	Çfarë duhet të ndryshojë për zbatimin e rekomandimeve
	DVV-2	Licencë për kultivues, prodhues dhe përpunues të verërave dhe prodhimeve të tjera nga rrushi e vera	Bashkimi është i nevojshëm sepse lejetimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejetime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejetimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.	Të bashkohen në një licencë të vetme.  Të zgjatet afati i vlefshmërisë në pesë vjet.  Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ nr. 06/2013 për regjistrim të kultivuesve të rrushit, prodhues dhe përpunues të verërave dhe prodhimeve tjera nga rrushi e vera.  Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ nr. 11/2009 për caktimin e kriterëve për importin, eksportin dhe tregtinë e brendshme të verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera.
	DVV-3	Licencë për eksportim të verës dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera			
	DVV-4	Licencë për importim të verës dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera			
	DVV-5	Licencë për qarkullues të verës për qarkullim në tregun e brendshëm			

		<p>Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejimeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejime. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.</p> <p>MBPZHR kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese. Ministria</p> <p>nuk duhet të kërkohet kopje e vërtetuar apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.</p>		
--	--	---	--	--

DEPARTAMENTI I VRESHTARISË DHE VERËTARISË

	Nr.Kodi	Titulli i lejit	Arsyeshmëria	Rekomandime	Çfarë duhet të ndryshojë për zbatimin e rekomandimeve
	DVV-2	Licencë për kultivues, prodhues dhe përpunues të verërave dhe prodhimeve të tjera nga rrushi e vera	<p>Bashkimi është i nevojshëm sepse lejetet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejet vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.</p> <p>Zgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejeve do të kursente kohë për bizneset dhe do të ulte koston financiare dhe kohore e cila shkaktohet për përgatitjen e dokumenteve për aplikim për këto lejet. Po ashtu, zgjatja e vlefshmërisë së</p>	Të bashkohen në një licencë të vetme.	<p>Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ nr. 06/2013 për regjistrim të kultivuesve të rrushit, prodhues dhe përpunues të verërave dhe prodhimeve tjera nga rrushi e vera.</p> <p>Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ nr. 11/2009 për caktimin e kriterëve për importin, eksportin dhe tregtinë e brendshme të verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera.</p>
	DVV-3	Licencë për eksportim të verës dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera		Të zgjatet afati i vlefshmërisë në pesë vjet.	
	DVV-4	Licencë për importim të verës dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera		Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	
	DVV-5	Licencë për qarkullues të verës për qarkullim në tregun e brendshëm			

			<p>afatit do të shkarkonte zyrtarët e ministrisë nga obligimi për të kontrolluar çdo vit secilin operator nëse e kanë vazhduar licensën.</p> <p>MBPZHR kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese. Ministria</p> <p>nuk duhet të kërkohet kopje e vërtetuar apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.</p>		
--	--	--	---	--	--

AGJENCIONI PYJOR I KOSOVËS (APK)					
	Nr.Kodi	Titulli i lejimit	Arsyeshmëria	Rekomandime	Çfarë duhet të ndryshojë për zbatimin e rekomandimeve

DEPARTAMENTI I PYLLTARISË (DP)					
	Nr.Kodi	Titulli i lejimit	Arsyeshmëria	Rekomandime	Çfarë duhet të ndryshojë për zbatimin e rekomandimeve
	DP-1 DP-2	Licencë për kryerjen e punimeve pyjore – subjektet vendore  Licencë për kryerjen e punimeve pyjore – subjektet e huaja	Ky lejim është përcaktuar vetëm me udhëzim administrativ, pa u bazuar në Ligjin për Pyjet e Kosovës dhe është në kundërshtim me Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.	Të krijohet baza ligjore për këtë lejim.	Të ndryshohet dhe të plotësohet Ligji për Pyjet e Kosovës
	APK-1	Vërtetim për mosinteresim të blerjes së tokës pyjore në pronësi private	Vërtetimi për mosinteresim të blerjes së tokës pyjore në pronësi private APK-1 nuk ka bazë ligjore.  Ligji për Pyjet e Kosovës nuk parashihet që APK të pajisë qytetarët me vërtetime të tilla dhe i njëjti, sipas Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave nuk mund të kualifikohet si lejim.	Të eliminohet.	Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr 12/2005 për caktimin e çmimeve, taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore- drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale teknike.
	APK-3	Licencë për shfrytëzimin e produkteve pyjore jo-drunore (Leje për shfrytëzimin e tokës – për gurore)	Të gjitha këto procedura kanë karakter kontraktual dhe sipas Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave nuk	Të largohen nga Regjistri.	Të përditësohet Regjistri.

		<p>Bashkimi është i nevojshëm sepse lejimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtën veprimtari dhe për të aplikuar për ato lejime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Ekzistimi i këtyre lejimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë. Për më tepër, bashkimi i tyre është i nevojshëm sepse as ARBK-ja nuk bën dallim në veprimtarinë e bizneseve vendore apo të huaja.</p> <p>Sipas informatave të mbledhura, vetëm aplikimi për lejimet DP-1 dhe DP-2 kushton 20 euro, marrja e këtyre lejimeve kushton</p>	<p>Të bashkohen lejimet në një licencë të vetme (derisa të krijohet baza ligjore).</p> <p>Të thjeshtësohet procedura e aplikimit (derisa të krijohet baza ligjore).</p> <p>Të draftohet udhëzim i ri administrativ për licencimin e subjekteve juridike për planifikime dhe projektme në fushën e pylltarisë.</p>	<p>Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ nr. 23/2008 për licencimin e subjekteve juridike për planifikime dhe projektme në fushën e pylltarisë</p> <p>Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ nr. 11/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr 23/2008 për licencimin e subjekteve juridike për planifikime dhe projektme në fushën e pylltarisë</p>
--	--	---	---	--



			<p>300 euro dhe ripërtirja, e cila duhet të bëhet çdo tri vjet, kushton 150 euro. Pagesa për aplikim (prej 20 euro) duhet të largohet ndërsa lidhur me tarifën prej 300 euro</p> <p>Departamenti i Pylltarisë duhet të sigurohet që nuk kalon shumën e nevojshme të ministrisë për të mbuluar shpenzimet për administrimin e këtyre lejimeve.</p> <p>Rekomandohet që të draftohet Udhëzimi i ri Administrativ për licencimin e subjekteve juridike për planifikime dhe projektme në fushën e pylltarisë, meqë ky udhëzim administrativ është ndryshuar disa here dhe mban emër të gjatë.</p>		
	DP-3	Licencë për përpunues të produkteve drunore (sharra)	<p>Pagesa për aplikim (prej 20 euro) duhet të largohet. Departamenti i Pylltarisë duhet të sigurohet që tarifa prej 300 euro për leje dhe 200 për ripërtirje të lejes</p>	Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2019 për plotësimin e Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2006 për standardet dhe kushtet për licencimin e përpunuesve të produkteve drunore.

			DP-2 nuk kalon shumë e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin këtij departamenti për ta administruar lejimin (ashtu siç parashihet me nenin 18 të Ligjit për Sistmin e Lejeve dhe Licencave).		
	DP-5	Licencë për pyllëzime, prodhimin e fidaneve. grumbullimin dhe trajtimin e farërave pyjore, punimet përgatitore dhe mbjellje fidanesh;	të gjitha këto lejime nuk janë në regjistër;		Të plotësohen formularët dhe të përfshihen në regjistër qendror;
		Licencë për kultivimin e pyjeve;			
		Licencë për shfrytëzimin e qendrushëm të pyjeve: prerje, tërheqje dhe transport;			
	DP-6	Licencë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e urave dhe rrugëve pyjore;			
		Licencë për grumbullimin dhe vjeljen qëndrushme të produkteve drunore dhe jo drunore, florës, bimëve mjeksore dhe tanifere;			
	DP-7	Licencë për ushtrimin e veprimtarive në gjueti dhe ekoturizëm;			
		Licencë për mbrojtje nga sëmundjet, dëmtuesit, zjarret dhe erozioni;			

	<p>DP-8</p>	<p>Licencë për hartimin e planit zhvillimore të pylltarisë;</p> <p>Licencë për hartimin e projekteve për kultivimin e pyejeve;</p> <p>Licencë për hartimin e projekteve për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyejeve dhe tokave pyjore;</p>			
	<p>DP-9</p>	<p>Licencë për hartimin e projekteve të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhese;</p> <p>Licencë për projektimin e urave dhe rrugëve pyjore;</p> <p>Licencë për analizimin e gjendjes fitopatologjike, entomologjike dhe mbrojtjen nga zjarret në pyje;</p>			
	<p>DP-10</p>	<p>Licencë për planifikimin dhe menaxhimin e shfrytëzimit të tokave pyjore;</p> <p>Licencë për hulumtimin e rezervave gjenetike dhe biodiversitetin pyjor;</p> <p>Licencë për hartimin e planeve të menaxhimit (programeve) për kafshë të egra dhe ekoturizëm;</p>			
	<p>DP-11</p>	<p>Licencë për hartimin e planeve për kultivimin, grumbullimin dhe shfrytëzimin e produkteve pyjore jodrunore;</p>			

	DP-12				
	DP-13				
	DP-14				
	DP-15				

	DP-16			
	DP-17			
	DP-18			
	DP-19			

	DP-20				
	DP-21				
	APK-4	Licencë për shfrytëzimin e produkteve pyjore jo drunore (Leje për shfrytëzimin e tokës pyjore meqera për destinim në bujqësi)	mund të kualifikohet si lejime.		

	Leje për shfrytëzimin e tokës pyjore me qira për ndërtimin e objekteve të përkohshme në tokat pyjore			
APK-5	Leje për shfrytëzimin e tokës pyjore për kullotjen e gjedhëve, viçave, deleve, qengjave, kuajve, gomarëve dhe derrave			
APK-6	Leje për kotarët dhe bylmetorët			
APK-7	Leje për depo pranë rrugës në tokat pyjore			
APK-8	Leje për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore për gëlqerore			
APK-9	Leje për shfrytëzimin e tokës për mullinj			
APK-10	Leje për shfrytëzimin e tokës për shtëpi bjeshkatarësh			
APK-11				

--	--	--	--	--	--

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË (AUV)					
	Nr.Kodi	Titulli i lejimit	Arsyeshmëria	Rekomandime	Çfarë duhet të ndryshojë për zbatimin e rekomandimeve
	AUV-1	Leje për importin e duhanit	<p>AUV edhe pse nuk është kërkesë ligjore, në regjistër elektronik kërkon dhe i ka paraqitur si kërkesë për kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve për aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese.</p> <p>AUV kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese. AUV</p> <p>nuk duhet të kërkojë kopje të vërtetuara apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja)</p>	Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të ndryshohet Rregullorja Nr. 17/2012 per caktimin e lartesisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Neni 21



			për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.		
AUV-2	Licencimi i subjekteve afariste për grumbullimin dhe tregtimin e leshit të deleve	<p>AUV edhe pse nuk është kërkesë ligjore, në regjistër elektronik kërkon dhe i ka paraqitur si kërkesë për kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve për aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese.</p> <p>AUV kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese. AUV</p> <p>nuk duhet të kërkojë kopje të vërtetuara apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.</p>	Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	<p>Të ndryshohet Rregullorja Nr. 17/2012 për caktimin e lartesisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.</p> <p>Të përditësohet Regjistri elektronik pasi që në Udhëzimin Administrativ Nr. 13/2007 për Licencimin e subjekteve afariste që kryejnë veprimtari të grumbullimit, deponimit dhe tregtimit të lëkurave me prejardhje nga kafshët e gjalla në Nenin 19 nuk kërkohej që dokumentet për aplikim të jenë origjinale ose të vërtetuara;</p>	
AUV-3	Licencimi i objekteve afariste veterinare	<p>AUV edhe pse nuk është kërkesë ligjore, në regjistër elektronik kërkon dhe i ka paraqitur si kërkesë për kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve</p>	Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2005 për licencimin e ambulancave, stacioneve, dhe klinikave veterinare.	

			<p>për aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese.</p> <p>AUV kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese. AUV</p> <p>nuk duhet të kërkojë kopje të vërtetuara apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.</p>		
	AUV-5	Licencimi i tregjeve të kafshëve	<p>AUV edhe pse nuk është kërkesë ligjore, në regjistër elektronik kërkon dhe i ka paraqitur si kërkesë për kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve për aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese.</p> <p>AUV kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto</p>	Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ ma-nr. 05/2007 për përcaktimin e kushteve të tregjeve të kafshëve. Të përcaktohen shprehimisht kushtet edhe kriteret për licencimin e tregjeve të kafshëve.

			<p>financiare dhe kohore për biznese. AUV</p> <p>nuk duhet të kërkojë kopje të vërtetuara apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.</p>		
AUV-6	Aprovimi i objekteve të operatorëve të biznesit me ushqim me prejardhje shtazore	<p>AUV edhe pse nuk është kërkesë ligjore, në regjistër elektronik kërkon dhe i ka paraqitur si kërkesë për kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve për aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese.</p> <p>AUV kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese. AUV</p> <p>nuk duhet të kërkojë kopje të vërtetuara apo origjinale</p>	Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të përditësohet Regjistri elektronik pasi që në Rregulloren (QRK) Nr.18./2016 për regjistrimin dhe aprovimin e operatorëve të biznesit me ushqim në Nenin 5, paragrafin 2.1 nuk kërkohet që dokumentet për aplikim të jenë origjinale ose të vërtetuara;	

			(pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.		
AUV-7	Regjistrimi i objekteve të operatorëve të biznesit me ushqim me prejardhje shtazore	AUV edhe pse nuk është kërkesë ligjore, në regjistër elektronik kërkon dhe i ka paraqitur si kërkesë për kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve për aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese.	AUV kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese. AUV nuk duhet të kërkojë kopje të vërtetuara apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.	Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të përditësohet Regjistri elektronik pasi që në Rregulloren (QRK) Nr.18./2016 për regjistrimin dhe aprovimin e operatorëve të biznesit me ushqim në Nenin 5, paragrafin 2.1 nuk kërkohet që dokumentet për aplikim të jenë origjinale ose të vërtetuara;
AUV-8	Leje importi për produkte me origjinë shtazore	AUV edhe pse nuk është kërkesë ligjore, në regjistër elektronik kërkon dhe i ka paraqitur si kërkesë për kopje të vërtetuara apo		Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të përditësohet Regjistri elektronik pasi që në Rregulloren (QRK) Nr.18./2016 për regjistrimin dhe aprovimin e operatorëve të biznesit me ushqim në Nenin 5, paragrafin 2.1

			<p>origjinale të dokumenteve për aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese.</p> <p>AUV kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese. AUV</p> <p>nuk duhet të kërkojë kopje të vërtetuara apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.</p>		<p>nuk kërkohet që dokumentet për aplikim të jenë origjinale ose të vërtetuara;</p>
AUV-9	<p>Licencë për objekte afariste për grumbullimin, tregtimin dhe eksportin e lëkurave me prejardhje nga kafshët e gjalla</p>	<p>AUV edhe pse nuk është kërkesë ligjore, në regjistër elektronik kërkon dhe i ka paraqitur si kërkesë për kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese.</p> <p>AUV kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve për aplikim duke shkaktuar kosoto</p>	<p>Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.</p>	<p>Të përditësohet Regjistri elektronik pasi që në Udhëzimin Administrativ Nr. 13/2007 për Licencimin e subjekteve afariste që kryejnë veprimtari të grumbullimit, deponimit dhe tregtimit të lëkurave me prejardhje nga kafshët e gjalla në Nenin 19 nuk kërkohet që dokumentet për aplikim të jenë origjinale ose të vërtetuara;</p>	

			<p>financiare dhe kohore për biznese. AUV</p> <p>nuk duhet të kërkojë kopje të vërtetuara apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.</p>		
AUV-13	Licencë për qarkullues të produkteve mjekësore veterinarë me shumicë	Bashkimi është i nevojshëm sepse lejetimet që propozohen të bashkohen kanë qëllim të njëjtë, kanë të bëjë me të njëjtat produkte dhe për të aplikuar për ato lejetime vlen procedurë dhe dokumente të njëjta të aplikimit. Për më tepër, ekzistimi i këtyre lejetimeve si të veçanta është kosto shtesë për sektorin privat pasi që ata duhet të paguajnë taksë për aplikim dhe shpenzime tjera të nevojshme gjatë përgatitjes së dokumenteve për secilin lejetim, në vend se të paguajnë vetëm njëherë.	Të bashkohen lejetimet në një licencë të vetme.	Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2005 për caktimin e kushteve për licencimin e subjekteve afarist që kryejnë veprimtari të qarkullimit, importimit të produkteve mjekësore veterinarë dhe pajisjeve mjekësore veterinarë me shumicë dhe pakicë.	
AUV-14	Licencë për qarkullues të produkteve mjekësore veterinarë me pakicë				
AUV-15	Licenca për importimin e produkteve mjekësore veterinarë - certifikata e distribuimit	AUV edhe pse nuk është kërkesë ligjore, në regjistër elektronik kërkon dhe i ka paraqitur si kërkesë për kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve	Të thjeshtësohet procedura e aplikimit.	Të përditësohet Regjistri elektronik pasi që në Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2005 për caktimin e kushteve për licencimin e subjekteve afarist që kryejnë veprimtari të qarkullimit, importimit të produkteve mjekësore	

			<p>për aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese.</p> <p>AUV kërkon kopje të vërtetuara apo origjinale të dokumenteve të aplikim duke shkaktuar kosoto financiare dhe kohore për biznese. AUV</p> <p>nuk duhet të kërkojë kopje të vërtetuara apo origjinale (pra mjafton vetëm kopja) për një dokument të lëshuar nga vetë institucionet publike.</p>		<p>veterinare dhe pajisjeve mjekësore veterinare me shumicë në Nenin 4 nuk kërkohet që dokumentet për aplikim të jenë origjinale ose të vërtetuara;</p>
--	--	--	--	--	---



***Raport për Thjeshtësimin e Lejeve dhe Licencave  
Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së  
Kosovës***

***Projekti i IFC për Përmirësimin e Klimës së Investimeve në Kosovë II***



## **Shkurtesat**

<b>AKK</b>	Agjencioni Kadastral i Kosovës
<b>AMK</b>	Agjencia e për Mbrojtjen e Mjedisit
<b>DMMU</b>	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave
<b>ARPL</b>	Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore
<b>DPHNB</b>	Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim
<b>IFC</b>	Korporata Ndërkombëtare Financiare, pjesë e Grupit të Bankës Botërore
<b>Lejim</b>	Njoftim, Regjistrim, Leje ose Licencë Profesionale
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>QRK</b>	Qeveria e Republikës së Kosovës
<b>Regjistri</b>	Regjistri i Lejeve dhe Licencave
<b>U.A.</b>	Udhëzim Administrativ

## 1. Hyrje

Reforma për thjeshtësimin e sistemit të lejimeve është një ndër faktorët kyç për krijimin e një kornizë për promovimin e cilësisë rregulluese, brenda një konteksti më të gjerë të përmirësimit të qeverisjes, duke përfshirë transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e shërbimit ndaj qytetareve duke krijuar një medis me te pershatshem afarist.

Reforma e sistemit të lejimeve në Kosovë ka filluar me aprovimin e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave në vitin 2013 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8967>). Ky ligj vendos parimet dhe rregullat kryesore për krijimin e lejeve dhe licencave të reja si dhe për lejet dhe licencat ekzistuese. Ligji përcakton që lejet dhe licencat do të krijohen vetëm në rastet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë publike, mjedisit dhe përdorimit të resurseve natyrore në republikën e Kosovës, duke parandaluar kështu krijimin e barrierave administrative për biznese në rastet tjera. Ligji gjithashtu kërkon shqyrtimin e të gjitha lejeve dhe licencave ekzistuese për të konstatuar përputhshmërinë me këto parime dhe rregulla.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave është krijuar edhe Regjistri i Lejeve dhe Licencave (Regjistri) në të cilin janë identifikuar lejimet që administrohen nga të gjitha organet e administratës shtetërore (<http://lejelicenca.rks-gov.net/>).

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në kuadrin e përgjegjësi të saj, ndër të tjera administron një sërë lejimesh që rregullojnë aktivitetin ekonomik, prodhues, shërbyes dhe shkencor.

Ky raport ka për qëllim studimin dhe analizën e kornizës ligjore për lëshimin e lejeve dhe licencave dhe implemetimin e kësaj kornize në praktikë si dhe dhënien e rekomandimeve për thjeshtësimin e tyre në kuadër të MMPH-se. Për shkak të numrit të madh të lejimeve që administrohen në kuadër të MMPH-së, raporti paraqet një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore.

Raporti në tërësi është organizuar në 3 Kapituj dhe 2 Shtojca. Aktiviteti është zhvilluar në 3 faza, si vijon:

- Faza e Parë:** Analiza preliminare ligjore e lejimeve që administrohen nga MMPH të identifikuar në Regjistër
- Faza e Dytë:** Zhvillimi i takimeve me departamentet brenda MMPH për diskutimin e analizës preliminare ligjore dhe takimet me përfaqësuesit e sektorit privat për mbledhjen e informatave plotësuese për gjendjen e zbatimit të lejimeve në praktikë
- Faza e Tretë :** Shqyrtimi përfundimtar i informacionit të mbledhur dhe hartimi i raportit

Gjatë Fazës së Parë, është bërë një analizë preliminare ligjore e lejimeve sipas të dhënave të përfshira në Regjistër. Gjatë kësaj analizë është bërë menjëherë evidente që lejimet e përfshira në Regjistër kanë nevojë për përditësim, për korrigjimin e informatave që janë përfshirë në Regjistër si dhe përfshirjen e lejimeve të reja që janë identifikuar gjatë analizës ose bashkimin e lejimeve ekzistuese. Për shkak të disa dallimevendërmjet lejimeve të përfshira në Regjistër dhe atyre të parapara në kornizën ligjore dhe të administruara në praktikë nga MMPH, është i nevojshëm rishikimi i të gjitha lejimeve të regjistruara në Regjistër.

Gjatë fazës së dytë janë zhvilluar takime dhe konsultime me departamentet dhe agjencitë përkatëse brenda MMPH-së si dhe përfaqësues nga sektori privat. Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar gjetjet e

fazës së parë dhe janë kërkuar mendimet e departamenteve dhe agjencive përkatëse për rekomandimet dhe ndryshimet potenciale në lejimet që administrohen nga ato.

Në Kapitullin 2 janë paraqitur detajet lidhur me nevojën e përditësimit të Regjistrit të Lejeve dhe Licencave pas identifikimit të lejimeve shtesë të cilat nuk janë të përfshira ende në Regjister. Në Kapitullin 3 është paraqitur analiza ligjore për të gjitha lejet dhe licencat e detajuara. Rekomandimet e përgjithshme janë paraqitur në Shtojcën 1. Rekomandimet specifike janë paraqitur në Shtojcën 2 dhe janë organizuar sipas kohës së përafërt për realizimin e tyre në rekomandime afat-mesme (portokalltë) dhe afat-gjata (kuqe) si vijon:

	<b>Rekomandimet afat-mesme</b>	Deri më 29 Shkurt 2020	Implementimi kërkon angazhim më të madh në kryerjen e analizave më të detajuara (si p.sh analizat e cost-recovery) ose kërkohen ndryshime më të konsiderueshme për ndryshimin e akteve nënligjore (Udhëzime Administrative (U.A.)
	<b>Rekomandimet afat-gjata</b>	Deri më 31 Maj 2020	Implementimi kërkon angazhim më afatgjatë pasi kërkohen ndryshime në ligjet primare.

Ky raport është rezultat i punës së një ekipi të përbashkët të përbërë nga këshilltarë të Projektit të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) për “Përmirësimin e Klimës së Investimeve në Kosovë II”, MMPH dhe përfaqësues nga Zyra Ligjore e Kryeministrit.

## 2. Përditësimi i Regjistrit të Lejeve dhe Licencave

Gjatë kësaj analizë është bërë menjëherë evidente që lejimet e përfshira në Regjister kanë nevojë për përditësim, për korrigjimin e informatave që janë përfshirë në Regjister si dhe përfshirjen e lejimeve të reja që janë identifikuar gjatë analizës ose bashkimin e lejimeve ekzistuese. Për shkak të dallimeve të konsiderueshme ndërmjet lejimeve të përfshira në Regjister dhe atyre të parapara në kornizën ligjore dhe të administruara në praktikë nga MMPH, është i nevojshëm rishikimi i të gjitha lejimeve të regjistruara në Regjister.

Përditësimi i të dhënave mbetet të kryhet në bazë të gjetjeve të paraqitura në këtë raport nga stafi përkatës i MMPH-së dhe verifikimit të mëtutjeshëm të të gjitha detajeve që gjenden në Regjister.

Për përditësimin e të dhënave për lejimet në kuadër të MMPH duhet ushtruar kujdes që të dhënat e përfshira në formularët e rinj të reflektojnë kriteret, procedurat, afatet, koston dhe elementet tjera të përcaktuara në ligjet ose aktet nënligjore përkatëse. Për shembull tek Leja ujore, si bazë ligjore në Regjister janë të vendosura Ligji për Ujërat i vitit 2004 dhe U.A. për Përmbajtjen, Formën, Kushtet dhe Mënyrën e Lëshuarjes dhe Ruajtjes së Lejes Ujore i vitit 2005 të cilat duhet të zëvendësohen me bazën e re ligjore të përbërë nga Ligji Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës dhe U.A Nr.03-2018 për Procedurat për Leje Ujore. Në këtë mënyrë në baze të legjislacionit në fuqi duhet të përditësohen edhe të dhënat tjera siq janë tarifat, kërkesat për dokumentacion etj. Njëkohësisht, në Regjister nuk janë vendosur formularët për aplikim për disa nga lejimet si për shembull për Licencën për menaxhimin e mbeturinave, Autorizimin mjedisor, Lejen për grumbullimin e bimëve të egra të mbrojtura etj. Verifikimi ligjor i të dhënave të

mbledhura nga departamentet ose agjencitë përkatëse është i rëndësishëm për shkak se në disa raste mund të ketë diskrepancë ndërmjet përcaktimeve ligjore dhe mënyrës së aplikimit të atyre përcaktimeve ligjore në praktikë nga ana e departamenteve ose agjencive përkatëse, gjë kjo që mund të ndikojë në numrin e lejimeve të identifikuar si dhe kriteret, procedurat, afatet, kostot ose elementet tjera të një lejimi që regjistrohen në Regjistër.

Në bazë të të analizës së paraqitur në këtë raport, përveç ndryshimit të të dhënave, bazës ligjore dhe elementeve tjera të lejimeve që administrohen nga MMPH, gjithashtu rezulton se duhet të shtohet një numër i lejimeve të cilat nuk janë aktualisht të përfshira në Regjistër. Për më shumë detaje shihni tabelën më poshtë:

Njësia Organizative	Lejimet në Regjistër	Lejimet pas <sup>269</sup> Rishikimit	Diferenca
Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave	33	37 <sup>270</sup>	+ 4
Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore	2	3 <sup>271</sup>	+ 1
Departamenti për Planifikimit Hapësinor, Banim dhe Ndërtim	2	5 <sup>272</sup>	+ 3
Agjencioni Kadastral i Kosovës	2	2	0
	<b>Total: 39</b>	<b>Total: 47</b>	<b>Total: + 8</b>

Gjatë analizës ligjore janë identifikuar disa mangësi të tjera në legjislacionin e aplikueshëm që ndërlidhen me procesin e administrimit të lejimeve përkatëse. Keto mangësi kryesisht konsistojnë në mos përputhshmëri të plotë në mes të numrit të lejimeve që permban Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe atyre që janë paraqitur në U.A. për Tarifat e Pelqimeve, Lejeve dhe Licencave, Certifikatave dhe Vertetimeve të Parapara me Legjislacionin e Natyrës dhe harmonizimi i këtij U.A me Ligjin është i domosdoshëm. Për shembull neni 49 i Ligjit parasheh Lejen për përdorimin e mjeteve kimike për mbrojtjen e bimëve dhe e cila nuk është e përfshirë në U.A. si pjesë e listës së lejimeve të cilat i parasheh U.A. me anë të të cilit caktohen edhe tarifatat përkatëse për secilin lejim. Mangësi të tjera paraqiten edhe në emërtimin e pa harmonizuar të lejimeve specifike si p.sh. Lejimi “Licencimi i personave fizik dhe juridik për hartimin e raportit për vlerësimin dhe kompenzimin e dëmit që shkaktohen nga llojet e egra të shtazëve strikt të mbrojtura”, sipas nenit 120 paragrafi 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, ndërsa emërtimi për këtë lejim në U.A. ipet si “Licencimi i personave fizik dhe juridik për hartimin e procesverbalit për përcaktimin dhe vlerësimin e dëmeve që shkaktohen nga llojet e egra të shtazëve inera të mbrojtura” Mangësi te tilla ne emërtime mund të paraqesin konfuzion në zbatueshmeri të lejimeve nga MMPH e sidomos nga aplikuesit

<sup>269</sup> Arsytimi i dhënë nga DMMU është se për këto lejime nuk ka pasë kërkesa deri tani dhe si rrjedhojë nuk janë përfshirë në Regjister.

<sup>270</sup> Lejimet shtesë të identifikuar pas rishikimit janë: 1) Leje për përdorimin e kimikateve, 2) Leje për shfrytëzimin e substancave tension-aktive në detergjente, 3) Leje e Vecantë e leshuar nga MMPH në bashkëpunim me Komisionin Europian për studime ose testime të reja të kimikateve të rrezikshme në shtazë që kanë për qëllim mbledhjen e të dhënave për klasifikimin e substancave ose përzjerjeve, 4) Licencimi i personave fizik dhe juridik për hartimin e raportit për vlerësimin dhe kompenzimin e dëmit që shkaktohen nga llojet e egra të shtazëve strikt të mbrojtura

<sup>271</sup> Lejimi shtesë i identifikuar pas rishikimit është: 1) Pëlqimi për Shfrytëzim të Pronës Ujore

<sup>272</sup> Lejimet shtesë të identifikuar pas rishikimit janë: 1) Certifikatë Legalizimi 2) Leje legalizimi për përfundim të ndërtimit dhe 3) Leje rrënimi

potencial. Për më tepër Ligji nuk parasheh ndonjë udhëzim se si percaktohet lartësia e tarifave të cilat janë të percaktuara në baze të U.A. pa ndonjë formulë të duhur e cila do të kishte parasyshë shpenzimet e procedurës për dhënien e këtyre lejimeve. Me këtë rast, plotësim ndryshimi i U.A. është i domosdoshëm në mënyrë që numri dhe emërtimi i lejimeve të jetë i harmonizuar me Ligjin.

### 3. Analiza Ligjore e Lejimeve në MMPH

Në këtë kapitull është paraqitur analiza ligjore e lejimeve në kompetencë të MMPH. Analiza është paraqitur sipas departamenteve dhe agjencive përkatëse, ndërsa rekomandimet specifike dhe afatet për implementimin e tyre janë dhënë në tabelën e bashkëngjitur në Shtojcën 2 të këtij Raporti.

#### 3.1 Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave në MMPH administron gjithsej tridhjetë e tetë (37) lejime si në vijim:

Nr.	Në Regjistër	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave
DMMU-1	Po	Leje për zbatimin e hulumtimeve shkencore në natyrë
DMMU-2	Po	Licenca për prodhimin dhe magazinimin e kimikateve
DMMU-3	Po	Licenca për menaxhimin e mbeturinave
DMMU-4	Po	Leja për vendosjen e produkteve biocide në treg
DMMU-5	Po	Autorizimi Mjedisor
DMMU-6	Po	Leja për grumbullimin e bimëve të egra të mbrojtura
DMMU-7	Po	Leje për import/eksport të llojeve të egra të bimëve
DMMU-8	Po	Leje për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim
DMMU-9	Po	Leje për futjen, ri-futjen e llojeve bimëve të egra
DMMU-10	Po	Leje për hulumtime dhe vizita arsimore në rezervatin strikt
DMMU-11	po	Pëlqim paraprak për shpalljen e monumentit të natyrës, peizazhit të mbrojtur ose monumentit të arkitekturës së parqeve
DMMU-12	Po	Leje për organizimin e vozitjes, vozitjen dhe parkimin e automjeteve motorike
DMMU-13	Po	Pëlqim për menaxhimin e të mirave të natyrës në zonat shkëmbore
DMMU-14	Po	Leje për aktivitetet në objektin speleologjik
DMMU-15	Po	Pëlqim për punën e bankave të gjeneve
DMMU-16	Po	Leje për eksport, import për qëllime shkencore të disa llojeve të shtazëve, kërpudhave dhe bimëve strikte të mbrojtura

DMMU-17	Po	Leje për mbajtjen në internim të llojeve të shtazëve të egra vendore ose të huaja për qëllim shfaqjeje për publikun në kopshte zoologjike, akuariume, terrariume ose në hapësira të ngjashme
DMMU-18	Po	Leje për hulumtimin e vend-gjetjes së mineraleve, fosileve dhe shtresimeve
DMMU-19	Po	Leje për eksport të mineraleve, shtresimeve ose fosileve
DMMU-20	Po	Lejen për ndërhyrjet dhe punët në rezervatin strikt, zonën e veçantë, parkun kombëtar, parkun e natyrës dhe monumentin e natyrës
DMMU-21	Po	Leje për grumbullimin e kërpudhave dhe pjesëve të tyre
DMMU-22	Po	Leje për kapjen ose vrasjen e shtazëve
DMMU-23	Po	Leje për mbajtje në internim, kultivim, shitje dhe blerje të llojeve të shtazëve të egra strikte të mbrojtura
DMMU-24	Po	Leje për import, eksport dhe transit të kimikateve të rrezikshme
DMMU-25	Po	Leje për importin e qeseve plastike
DMMU-26	Po	Licencimi i personave fizik hartues të raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
DMMU-27	Po	Licencimi i personave juridik që hartojnë raporte të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
DMMU-28	Po	Leje për eksport të mbeturinave
DMMU-29	Po	Leje për import të mbeturinave
DMMU-30	Po	Leje për tranzit të mbeturinave
DMMU-31	Jo	Licencimi i personave fizik dhe juridik për hartimin e raportit për vlerësimin dhe kompenzimin e dëmit që shkaktohen nga llojet e egra të shtazëve strikt të mbrojtura
DMMU-32	Jo	Leje për përdorimin e kimikateve
DMMU-33	Jo	Leje për shfrytëzimin e substancave tension-aktive në detergjente
DMMU-34	Jo	Leje e Vecante e leshuar nga MMPH ne bashkepunim me Komisionin European per studime ose testime të reja të kimikateve të rrezikshme në shtazë që kanë për qëllim mbledhjen e të dhënave për klasifikimin e substancave ose përzierjeve
DMMU-35	Po	Leje Mjedisore e Integruar
DMMU-36	Po	Pëlqim Mjedisor
DMMU-37	Po	Leje Mjedisore

Këto lejime administrohen në bazë të një numër ligjesh dhe aktesh nënligjore të cilat do të paraqiten në vijim. Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujerave është njësi organizative më e ngarkuar në MMPH sa i përket dhënies së lejimeve. Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (<https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2716>) dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 03-2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve dhe Licencave, Certifikatave dhe Vertetimeve te Parapara me

Legjislacionin e Natyrës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12803>) shërbejnë si baza kryesore ligjore për shumicën e lejimeve të listuara më latrë nga fusha e mbrojtjes së natyrës. Ndërsa sa u përket lejimeve në fushën e mbeturinave dhe kimikateve si baze ligjore shërbejnë: Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2829>), Ligji Nr. 03/L-119 për Produktet Biocide (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2640>), Ligji Nr. 04/L-197 për Kimikate (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9370>), Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>) si dhe legjislacioni sekondar që rrjedh nga legjislacioni i primar siq është përshkruar më sipër duke përfshirë si: Udhëzim Administrativ Nr. 11-2013 për Caktimin e Kerkesave Teknike dhe Kerkesave Tjera për Qeset e Plastikës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9942>) UA 09/2014 Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10259>), Udhëzim Administrativ Nr. 20/2012 për Ekport, Import dhe Tranzit të Mbeturinave (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10259>), si dhe Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 03/2015 për Autorizim Mjedisor (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10735>). Vlen të theksohet se legjislacioni i mësipërm është mjaft i gjërë dhe lejimet që administrohen janë mjaft komplekse.

Rrjedhimisht, në bazë të analizës vërehet se ka një dallim të theksuar në mes të lartësisë së tarifave për lejime të ndryshme, për shembull për disa nuk ka fare tarifë dhe për disa të tjera kërkohen tarifa të larta. Në përgjithësi, tarifat janë të vendosura pa ndonjë kriter që do të merrte për bazë parimin e shpenzimit të procedurës. Për shembull aplikuesi ngrakohet me tarifë të lartë për kushtet ujore ndërsa kushtet ndertimore lëshohen pa pagesë. Poashtu tarifat për Lejet Ujore dhe Pëlqimet Ujore janë të larta në studim të parë dhe përcaktohen në bazë të vlerës financiare të inverstit në vend të shpenzimit të procedurës. Një rast tjetër ka të bëjë me tarifa të larta dhe një dallim të theksuar në mes të tarifave për licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete, përkatësisht nga 150 EUR për gjeodetët dhe 300 EUR për kompanitë.

Vendosja në këtë mënyrë e tarifave është në shpërputhje me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht parimin se ngarkesa nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e procedurës administrative si dhe Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Si rrjedhojë, ka hapësirë të mjaftueshme për zvogëlimin dhe-ose eliminimin e disa tarifave që do të mund të bëhej me ndryshimin-plotësimin e Ligjeve apo Udhëzimeve Administrative përkatëse. Me këtë rast, rekomandohet kryerja e një analize për lartësinë e tarifave në bazë të parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative në të cilën mund të shqyrtohet ulja e këtyre tarifave.

Në komunikimet me stafin e DMMU-së janë identifikuar lejime që do të mund të fusionohen së bashku apo eliminohen në tërësi. Në bazë të rekomandimit të stafit të DMMU-së eliminimi ose fusionimi do të mund të bëhej për lejimet si në vijim: 1) Licenca për menaxhimin e mbeturinave do të mund të eliminohet ose fusionohet me Lejen mjedisore për shkak të tematikës së njejtë; 2) Pëlqimi për menaxhimin me të mirat të natyrës në zonat shkëmbore nuk ka gjet zbatim në praktikë dhe rekomandohet të eliminohet për arsye se në Kosovë nuk ka zona të tilla; 3) Leja për grumbullimin e bimëve të egra të mbrojtura dhe Leja për grumbullimin e kërpudhave dhe pjesëve të tyre mund të fusionohen në një leje të përbashkët, sepse tematika është e ngjajshme dhe në këtë mënyrë zvogëlohet numri i barrierave të bërit biznes dhe arrihet efekti i njejtë; 4) Leja për import/eksport të llojeve të egra dhe Leja për eksport, import për qëllime shkencore të disa llojeve të shtazëve, kërpudhave dhe bimëve strikte të mbrojtur mund të fusionohen në një leje të përbashkët, sepse tematika është e ngjajshme, në këtë mënyrë zvogëlohet numri i barrierave të bërit biznes dhe arrihet efekti i njejtë; 5) Leja për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim dhe Leja përmbajtjen në internim të llojeve të shtazëve

të egra vendore ose të huaja për qellim shfaqjeje për publikun në kopshte zoologjike, akuariume, terrariume ose në hapësira të ngjashme duhet të fuzionohen në një leje të përbashket, sepse tematika është e ngjashme. Bashkimi ose eliminimi i këtyre lejimeve kërkon plotësime e ndryshime ligjore në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe U.A. për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve dhe Licencave, Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me Legjislacionin e Natyrës. Për më shumë, koha e shqyrtimit të kërkesave deri të lëshimi lejeve-licencave nga MMPH do të mund të zvogelohej racionalisht për disa prej tyre. Për shembull, rekomandohet që potencialisht të behet shkurtimi i afateve për shqyrtimin dhe vendosjen në kërkesat e dorëzuara për 1) Licencën për menaxhimin e mbeturinave, 2) Leje për eksport të mbeturinave, 3) Lejen për import të mbeturinave, dhe 4) Lejen për tranzit të mbeturinave.

Rekomandimet specifike lidhur me DMMU, të ndara në formë të rekomandimeve afat-mesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 2 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

### 3.2. Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL) në MMPH administron gjithsej tri (3) lejime që nderlidhen me lejen ujore, pelqimin uJOR dhe shfrytëzimin e pronës ujore si në vijim:

Nr.	Në Regjistër	Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore
ARPL-1	Po	Leje ujore
ARPL-2	Po	Pëlqim uJOR
ARPL-3	Jo	Pëlqimi për Shfrytëzim të Pronës Ujore

Korniza ligjore që rregullon dhënien e lejes ujore nga ARPL përfshin Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8659>) dhe U.A. Nr.03 /2018 për Procedurat për Leje Ujore (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17824>). Nga vlerësimi i kësaj kornize ligjore dhe diskutimet me përfaqësuesit e ARPL-së është identifikuar posacërisht nevoja e zvogëlimit të numrit të dokumentacionit që kërkohet për procedurën e aplikimit për këto lejime. Për shembull, siq edhe është paraqitur në Shtojcën 2 të rekomandimeve vërtetimi i kopjes së ID ose Certifikatës së Biznesit (vetëm për personat juridik) dhe i certifikatës së numrit fiskal mund të eliminohej si kërkesa dhe palës t'i kërkohet vetëm kopje e këtyre kërkesave. Njëkohësisht gjatë diskutimeve me përfaqësuesit e ARPL-se është vërejtur se ka raste kur aplikimet për lejime u nënshtrohen vonesave të panevojshme, përkatesisht tejkallimit të afateve ligjore të përcaktuara për shqyrtimin e kërkesave, gjë që është në shpërputhje me parimin e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative për eliminimin e ngarkesave të panevojshme për palët në procesin e aplikimit.

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të ARPL-së, të ndara në formë të rekomandimeve afat-mesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 2 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

### 3.3. Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit (DPHNB) administron pesë (5) lejime që nderlidhen kryesisht me fushën e ndërtimit. Korniza ligjore relevante për lejimet e administruara nga DPHNB përbëhet nga Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2833>) dhe U.A. Nr. 02.2018-UA për Taksat Administrative për



Leje Ndertimore, dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16479>) dhe Ligji Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje (<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17767>). Aktet nënligjore që rrjedhin nga ky ligj dhe që rregullojnë lëshimin e certifikatës së legalizimit, lejes së rrënitimit dhe lejes së legalizimit për përfundim të ndërtimit janë në procedurë të miratimit brenda MMPH-së.

Nr.	Në Regjistër	Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
DPHNB-1	Po	Leje Ndërtimore për ndërtimet e kategorisë së tretë
DPHNB-2	Po	Certifikate e Përdorimit për ndërtimet e kategorisë së tretë
DPHNB-3	Jo	Certifikate Legalizimi
DPHNB-4	Jo	Leje legalizimi për përfundim të ndërtimit
DPHNB-5	Jo	Leje rrënimi

Vlen të theksohet se hapësira e thjeshtimit të lejimeve që administrohen nga DPHNB është mjaft e vogël. Tarifat e vendosura sipas legjislacionit të cekur më lartë janë të bazuara në koston reflektuese e cila është në përputhshmëri të plotë me parimin e caktimit të tarifës për aplikim në bazë të shpenzimeve administrative të procedurës sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nuk rekomandohet ndonjë shkrirje ose eliminim i ndonjëres nga këto lejime, ndërsa vërehet se edhe dokumentacioni i kërkuar për aplikim është përcaktuar në mënyrë racionale.

Në bazë të diskutimeve me përfaqësuesit nga DPHNB rekomandohet që në të ardhmen thjeshtimi i procedurës së aplikimit për leje ndërtimore dhe pajisje me kushte ndërtimore të bëhet përmes aplikimit online, E-Lejet. MMPH është në fazën fillestare të përgatitjes së termave të referencës për zhvillimin e aplikacionit për E-Lejet. Aktualisht, afati për lëshimin e lejeve dhe licencave është optimal, por me ndryshimet që do të behën në të ardhmen (funksionalizimi i E-Lejeve) atëherë afatet kohore për shqyrtimin dhe lëshimin e lejeve mund të shkurtohen në mënyrë racionale.

Po ashtu disa nga kërkesat e dokumentacionit mund të eliminohen apo të sigurohen përmes zyrës shërbyese One Stop Shop, si psh. Pëlqimet për Ujësjellës dhe Kanalizim, Pëlqimi për KEDS, për ngrohje, për Certifikatë të Pronësisë, Kopje të Planit etj.

Sa u përket Certifikatës së Legalizimit, Lejes së legalizimit për përfundim të ndërtimit, Lejes së rrënitimit për kategorinë III të ndërtimeve, MMPH është në procedurë të miratimit të akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje ku edhe do të caktohet lartësia e tarifave. Prandaj rekomandohet që në përcaktimin e ketyre tarifave të kihet parasyshë parimi i lartësise së tarifave në proporcion me shpenzimet e procedurës sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të DPHNB, të ndara në formë të rekomandimeve afatmesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 2 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

### 3.4. Agjencioni Kadastral i Kosovës

Agjencioni Kadastral i Kosovës në kuadër të MMPH-së administron dy (2) lejime, pëkatësisht bën licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete. Këto lejime administrohen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-

013 për Kadastrin (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2757>) dhe UA Nr. 01-2013 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodeteve (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9767>).

Nr.	Në Regjistër	Agjencioni Kadastral i Kosovës
AKK-1	Po	Licencë për kompanitë e gjeodetëve
AKK-2	Po	Licencë për gjeodet

Neni 10 paragrafi 4 i U.A. për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve i jep të drejtë AKK-së të caktoj shumën e taksës me vendim i cili mund të ndryshohet në afat të mesëm pasi të jetë bërë një analizë e kostos reflektive. Tarifa për kompani gjeodete është 300 euro ndërsa për gjeodetë është 150 euro.

Ne bazë të konsultimeve me sektorin privat, sa i përket lartësisë së tarifave për marrjen e këtyre lejimeve konsiderojmë se ka nevojë për një analizë të detajuar sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative, pasi që nuk është e qartë nëse tarifat me vendim nga AKK janë aktualisht të vendosura sipas nenit 30 paragrafi 7 i Ligjit për Kadastër sipas të cilit taksat duhet të reflektojnë koston e shpenzimeve. Vlen të theksohet se këto shqetësime nuk janë adresuar me projekt UA të ri i cili është në procedurë të aprovimit nga MMPH.

Në përgjigjen e AKK-së lidhur me përmbajtjen e këtij projekt UA, theksohet se këto shqetësime janë marrë parasysh nga AKK-ë gjatë hartimit të UA. Njëri nga arsyetimet e përmendura është rritja e afatit të vlefshmërisë së licencës nga 3 në 5 vite si parashikimi i trajnimeve të ndryshme për gjeodetë dhe kompani gjeodete. Po ashtu me projekt UA është paraparë që të gjitha punët gjeodezike të terrenit të realizohen vetëm nga gjeodetët e licencuar dhe Kompanitë gjeodete të licencuar, ndërsa kontrollimi dhe aprovimi i tyre do të bëhet nga zyrtarët e Zyrave Kadastrale Komunale. Trajnimet parashihet që të organizohen nga AKK për gjeodetët dhe Kompanitë gjeodete të licencuara, lidhur me avancimet në Regjistrin e të dhënave Kadastrale dhe në Hartën Kadastrale. Kjo është edhe ne pajtueshmëri edhe kërkesat e zbatimit të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje që ka paraparë që të gjitha punët gjeodezike të terrenit të kryhen nga gjeodetët dhe kompanitë gjeodete të licencuara. Bazuar në të gjitha këto, AKK-ë konsideron se tarifa e caktuar me UA i cili është për nënshkrim te Ministri nuk do të jetë barrë për gjeodetët e licencuar dhe kompanitë gjeodete të licencuara, për shkak të dhënies së kompetencave shtesë në raport me ato të cilat i kanë pasur deri më tani.

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të AKK-së, të ndara në formë të rekomandimeve afatmesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 2 - Tabela e Rekomandimeve Specifike

## Shtojca 1 – Tabela e Rekomandimeve të Përgjithshme për MMPH

Gjatë zbatimit të këtij aktiviteti është konstatuar se, megjithëse Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave merret parasysh në disa raste gjatë hartimit të akteve ligjore që hartohen në kuadër të MMPH, shkalla e respektimit të këtij ligji brenda MMPH ka ende hapësirë të konsiderueshme për përmirësim. Poashtu Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili rregullon punën e administratës shtetërore në dhënien e shërbimeve me sa me pak shpenzime dhe ngarkesa për qytetarët nuk gjen zbatueshmeri të plotë.

Për adresimin e këtyre mangësive në shkallën e zbatimit të këtyre dy ligjeve të rëndësishme për përmirësimin dhënies së shërbimeve që rezultojnë në një mjedis afarist më të favorshëm në Kosovë rekomandojmë që të ndërmerren disa veprime, të përshkruara në tabelën më poshtë.

REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME	
1.	<b>Përditësimi i Regjistrimit të Lejeve dhe Licencave:</b> Për të siguruar përditësimin e rregullt të Regjistrimit për lejimet që administrohen nga MMPH, ekziston nevoja për zbatimin e plotë të Rregullores Nr. 06/2015 për Regjistrin Qëndror të Llojeve të Lejeve dhe Licencave. Kjo mund të bëhet përmes krijimit të një procesi të qartë të njoftimit nga zyrtari ligjor i caktuar rishtazi në kuadër të Departamentit Ligjor në MMPH për zyrtarin/en përgjegjës në kuadër të zyrës ligjore të Kryeministrit për mirëmbajtjen e regjistrit (Pikën e Kontaktit) lidhur me të gjitha lejimet e reja që parashihen në legjislacionin e ri që hartohet në kuadër të MMPH. Një veprim tjetër me të cilin mund të ngarkohet zyrtari/ja përgjegjës nga MMPH për përditësimin e regjistrit është që të zhvillojë takime me të gjitha njësitë organizative brenda MMPH të paktën 2 herë në vit për mbledhjen e informatave lidhur me lejimet ekzistuese apo lejimet e reja të krijuara, verifikimin ligjor të tyre dhe përgatitjen e formularëve për dorëzim në Zyrën Ligjore të Kryeministrit.
2.	<b>Trajnimi i Zyrtarëve të MMPH lidhur me Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave:</b> Për të siguruar zbatimin e njëtrajtshëm dhe konsistent të parimeve të përcaktuara në Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave është i nevojshëm organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve gjithëpërfshirëse për të gjitha njësitë organizative brenda MMPH për rëndësinë dhe aplikimin e ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave gjatë hartimit të legjislacionit si dhe gjatë zbatimit.
3.	<b>Zbatimi efikas dhe Trajnimi i i Zyrtarëve të MMPH lidhur me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative:</b> Gjatë diskutimeve me përfaqësuesit e MMPH-së dhe sektorin privat, zbatimi adekuat dhe efikas i Ligjit për Procedurën Administrative, është identifikuar si sfidë. Në praktikë palëve që aplikojnë për lejime shpesh u pamundësohet marrja e vendimit nga organi kompetent në afatin e duhur ligjor. Prandaj rekomandohen trajnime për stafin relevant që trajtojnë kërkesat për lejime në mënyrë që trajtimi të jetë sa më shpejtë dhe pa ngarkesa të tepruara për palët.

DEPARTAMENTI PER MBROJTJEN E MJEDISIT DHE UJERAVE						
Nr.	Shpjegimi i Intervenimit	Lejimet ndikuara <sup>273</sup>	Veprimet Nevojshme	Aktet Kryesore të Ndikuara	Afati i Intervenimit	Komente
1.	Bashkimi i Licencës për Menaxhimin e Mbeturinave me Lejen Mjedisore	1 Lejim Fusionohet  (Po) DMMU-3  (PO) DMMU-37	1. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Mbeturina  2. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MMPH) Nr. 04/2016 për Lejen Mjedisore	1. Ligji per Mbeturina ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2829">https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2829</a> )  2. U.A. (MMPH) Nr. 04/2016 për Lejen Mjedisore ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14821">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14821</a> )	Afat-Gjatë  (Deri më 31 Maj 2020)	Ky rekomandim i përkrahur nga stafi i DMMU duhet të bëhet me kujdes në mënyrë që stadardet e <i>aque communitaire</i> per menaxhimin e meturinave mos të çënohen me bashkimin e kësaj leje me lejen mjedisore. Justifikimi për këtë rekomandim konsiston në qëllimin e njejtë për parandalimin dhe zvoglimin e ndikimeve negative në mjedis të Lejes

<sup>273</sup> Në këtë kolonë është shpjeguar numri i lejimeve të ndikuara nga secili rekomandim dhe është dhënë një indikacion nëse lejimet përkatëse janë aktualisht në Regjistër (PO) ose nuk janë aktualisht në Regjistër (JO).

						Mjedisore dhe Licencës për Menaxhimin e Mbeturinave
2.	Eliminimi i taksës së licencës për menaxhimin e mbeturinave	1 Lejim Thjeshtohet (Po) DMMU-3	Ndryshimi dhe Plotësimi i UA MMPH Nr. 09-2014 Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave	UA MMPH Nr. 09-2014 Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10259">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10259</a> )	Afat-Mesëm  (deri më 29 Shkurt 2020)	Arsyetimi është se kjo tarifë është vendosur pa ndonjë analizë ekonomike. Ky rekomandim të bëhet në konsultim me Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë.
3.	Eliminimi i taksës për lejen për eskport, lejen per import dhe lejen per tranzit të mbeturinave	3 Lejime Thjeshtohen (Po) DMMU-28 (PO) DMMU-29 (Po) DMMU-30	Ndryshimi dhe Plotësimi i UA MMPH Nr. 02/2019 për Eksport, Import dhe Tranzit të Mbeturinave	UA MMPH Nr. 02/2019 për Eksport, Import dhe Tranzit të Mbeturinave ( <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21124">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21124</a> )	Afat-Mesëm  (deri më 29 Shkurt 2020)	Arsyetimi është se kjo tarifë është vendosur pa ndonjë analizë ekonomike. Ky rekomandim të bëhet në konsultim e Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë

4.	Eliminimi i taksës për lejen për import, eksport dhe transit të kimikateve të rrezikshme	1 Lejim Thjeshtohet (Po) DMMU-24	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 04/L-197 për Kimikate	Ligjit 04/L-197 për Kimikate ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9370">https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9370</a> )	Afat-Gjatë  (deri më 31 Maj 2020)	Arsyetimi është se kjo tarifë është vendosur pa ndonjë analizë ekonomike.
5.	Eliminimi i taksës për lejen për importin e qeseve plastike	1 Lejim Thjeshtohet (PO) DMMU-25	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 04/L-197 për Kimikate	Ligjit 04/L-197 për Kimikate ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9370">https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9370</a> )	Afat-Gjatë  (deri më 31 Maj 2020)	Arsyetimi është se kjo tarifë është vendosur pa ndonjë analizë ekonomike.
6.	Zvoglimi i taksës për autorizim mjedisor	1 Lejim Thjeshtohet (Po) DMMU-5	Ndryshimi dhe Plotësimi i UA MMPH Nr. 03-2015 për Autorizim Mjedisor	UA MMPH Nr. 03-2015 për Autorizim Mjedisor ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10735">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10735</a> )	Afat-Mesëm  (deri më 29 Shkurt 2020)	Arsyetimi është se kjo tarifë është vendosur pa ndonjë analizë ekonomike. Ky rekomandim të bëhet në konsultim e Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë
7.	Eliminimi i pëlqimit për menaxhimin me të mirat e natyrës në zonat shkëmbore	1 Lejim Thjeshtohet (Po) DMMU-13	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	Ligji 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716</a> )	Afat-Gjatë  (deri me 31 Dhjetor 2020)	Arsyetimi është se ky lejim nuk ka gjetë zbatim në praktikë në mungesë të kërkesave nga

						palët dhe prandaj nuk është e logjikshme të mbetet në Regjister si i aplikueshëm.
8.	Bashkimi i Lejes për zbatimin e hulumtimeve shkencore në natyrë, Lejes për hulumtime dhe vizita arsimore në rezervatin strikt dhe Lejes për aktivitetet në objektin speleologjik në një leje të perbashkët me emertim “Leje për hulumtime shkencore”	2 Lejime Fusionohen  (Po) DMMU- 1, (Po) DMMU -10  (Po) DMMU-14	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 03/L-233 per Mbrojtjen e Natyrës	Ligji 03/L-233 per Mbrojtjen e Natyres ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716</a> )	Afat-Gjatë  (deri më 31 Maj 2020)	Objekti i lejimit për të tri lejet është i ngjashëm dhe për këtë arsye rekomandohet bashkimi në një lejim.
9.	Bashkimi i lejes për grumbullimin e bimëve të egra të mbrojtura me lejen me Lejen për grumbullimin e kërpudhave dhe pjesëve të tyre në një leje të perbashkët me emertim “Leje për grumbullimin e bimëve të egra të	1 Lejim Fusionohet  (Po) DMMU-6 me (Po) DMMU-21	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 03/L-233 per Mbrojtjen e Natyres  Ndryshimi dhe plotësimi UA 03-2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve dhe Licencave,	Ligji 03/L-233 per Mbrojtjen e Natyres ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716</a> )  UA 03-2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve dhe Licencave, Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me Legjislacionin e Natyrës ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12803">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12803</a> )	Afat-Gjatë  (deri më 31 Maj 2020)	Objekti i lejimit për të dy lejet është i ngjashëm dhe për këtë arsye rekomandohet bashkimi në një lejim.

	mbrojtura, kërpudhave dhe pjesëve të tyre		Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me Legjislacionin e Natyrës			
10	Bashkimi i lejes për import/eksport të llojeve të egra të bimëve me Lejen për eksport, import për qëllime shkencore të disa llojeve të shtazëve, kërpudhave dhe bimëve strikte të mbrojtura me emertim “Leje për import/eksport të llojeve të egra të bimëve dhe të disa llojeve të shtazëve, kërpudhave dhe bimëve strikte të mbrojtura”	1 Lejim Fusionohet  (Po) DMMU-7 me (Po) DMMU-16	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 03/L-233 per Mbrojtjen e Natyres  UA 03-2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve dhe Licencave, Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me Legjislacionin e Natyrës	Ligji 03/L-233 per Mbrojtjen e Natyres ( <a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716</a> )  UA 03-2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve dhe Licencave, Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me Legjislacionin e Natyrës ( <a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12803">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12803</a> )	Afat-Gjatë  (deri më 31 Maj 2020)	Objekti i lejimit për të dy lejet është i ngjashëm dhe për këtë arsye rekomandohet bashkimi në një lejim.
11	Bashkimi i lejes për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim me Lejen për mbajtjen në internim të llojeve të shtazëve të egra	2 Lejime Fusionohen  (Po) DMMU-8 me (Po) DMMU-17 (Po) DMMU-23	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 03/L-233 per Mbrojtjen e Natyres  UA 03-2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve	Ligji 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyres ( <a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716</a> )  UA 03-2016 për Caktimin e Tarifave për Lëshimin e Pëlqimeve, Lejeve dhe Licencave, Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me	Afat-Gjatë  (deri më 31 Maj 2020))	Arsyetimi për bashkimin e këtyre tri lejimeve është se janë të ngjashme për nga natyra dhe objekti.



	<p>vendore ose të huaja për qëllim shfaqjeje për publikun në kopshte zoologjike, akuariume, terrariume ose në hapësira të ngjashme dhe Leje për mbajtje në internim, kultivim, shitje dhe blerje të llojeve të shtazëve të egra strikte të mbrojtura me emertim “Leje për mbajtjen në internim të shtazëve të egra”</p>		<p>dhe Licencave, Certifikatave dhe Vërtetimeve të Parapara me Legjislacionin e Natyrës</p>	<p>Legjislacionin e Natyrës (<a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12803">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12803</a>)</p>		
12.	<p>Shkurtimi i afateve për shqyrtimin dhe vendosjen në kërkesat – aplikacionet e dorëzuar për Licencën për menaxhimin e mbeturinave, 2) Lejen për eksport të mbeturinave, 3) Lejen për import të mbeturinave, dhe 4) Lejen për tranzit të mbeturinave</p>	<p>4 Lejime Thjeshtohen  (PO) DMMU-3 (PO) DMMU-28 (PO) DMMU-29 (PO) DMMU-30</p>	<p>Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-060 Per Mbeturina</p>	<p>Ligji Nr. 04/L-060 Per Mbeturina (<a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2829">https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2829</a>)</p>	<p>Afat-Gjatë  (deri më 31 Maj 2020)</p>	<p>Secila nga këto lejime ka si afat të shqyrtimit të kërkesave dhe marrjes së vendimit nga organi kompetent brenda 60 ditëve. Në studim të parë këto afate duken mjaft të gjata prandaj rekomandohet që të shikohet mundësia e</p>

						shkurtimit të arsyueshëm të këtyre afateve.
<b>AUTORITETI RAJONAL I PELLGJEVE LUMORE</b>						
13.	Reduktimi i lartësisë së taksave administrative për pelqim ujq dhe leje ujq sipas kostos së shërbimeve të procedurës dhe eliminimi i takses për kushte ujq	2 Thjeshtohen  (Po) ARPL-1  (Po) ARPL-2	Lejime  Ndryshimi dhe plotësimi i UA MMPH Nr.03 /2018 për Procedurat për Leje Ujq	UA MMPH Nr.03 /2018 për Procedurat për Leje Ujq ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17824">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17824</a> )	Afat-Mesëm  (deri më 29 Shkurt 2020)	Në studim të parë këto tarifa paraqiten si të larta meqenëse UA nuk përmban ndonjë formulë llogaritjeje sipas shpenzimeve. Po të bëhet një krahasim me kushtet ndërtimore për të cilat MMPH nuk ngarkon asnjë lloj tarife, atëherë do të ishte rationale që fare të eliminohet taksa për kushte ujq.
14.	Eliminimi i kërkesës për vërtetim të kopjes së ID ose Certifikatës	2 Thjeshtohen	Lejime  Ndryshimi dhe plotësimi i UA .MMPH Nr.03 /2018 për	UA për Leje Ujq ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17824">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17824</a> )	Afat-Mesëm	Kërkesa për vërtetim të këtij dokumentacioni

	se Biznesit (vetëm për personat juridik) dhe i certifikatës së numrit fiskal palës t'i kërkohe vetem kopje e këtij dokumentacioni.	(Po) ARPL-1  (Po) ARPL-2	Procedurat për Leje Ujore		(deri më 29 Shkurt 2020)	është barrë shtesë për palën, prandaj rekomandohet që palës t'i kërkohe vetëm kopjet për këtë dokumentacion.
<b>DEPARTAMENTI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR, NDËRTIMIT DHE BANIMIT</b>						
15.	Reduktimi i taksës për certifikatën e legaliimit, lejen e legalizimit për përfundim të ndërtimit	2 Lejime  (Jo) DPHNB-3  (Jo) DPHNB-4	Vlerësimi i taksës prej 3.08 EUR per m2 sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative	Vendimi aktual i MMPH-së	Afat-Mesëm  (deri më 29 Shkurt 2020)	Të merren parasyshë shpenzimet procedurës me rastin e llogaritjes së kësaj takse.
16.	Thjeshtimi i procedurave, dhe shkurtimi i afateve kohore për aplikim për Lejen ndërtimore për ndërtimet e kategorisë së tretë	1 Lejim  (Po) DPHNB-1	Përgatitja e termave të referencës për zhvillimin e aplikacionit për E-Lejet.	Nuk ka nevojë për ndryshimin e ndonjë Ligji apo Udhëzimi Administrativ që do të duhet të ndryshohet apo plotësohet.	Afat-Mesëm  (deri më 29 Shkurt 2020)	MMPH është ne fazën fillestare të përgatitjes së termave të referencës për zhvillimin e aplikacionit për E-Lejet. Prandaj thjeshtimi i procedurave dhe shkurtimi i

						<p>afateve kohore do të bëhej përmes ofrimit të mundësisë për aplikim online për marrjen e kushteve dhe lejes ndërtimore, E-Lejet, pasi të jenë zhvilluar procedurat për pajisje me kushte dhe leje ndërtimore. Po ashtu disa kërkesa nga dokumentacioni mund të eliminohen apo të sigurohen përmes zyrës shërbyese One Stop Shop, si psh. Pëlqimet për Ujësjellës dhe Kanalizim, Pëlqimi për KEDS, për ngrohje, për Certifikatë të Pronësisë,</p>
--	--	--	--	--	--	--

						Kopje të Planit etj.
<b>AGJENCIONI KADASTRAL I KOSOVES</b>						
17.	Të shkurtohet afati për dhëniën e licencës për gjeodetë dhe licencës për kompani gjeodete	1 Lejim Thjeshtësohet  (Po) AKK-1 (Po) AKK 2	Ndryshimi dhe plotësimi i UA Per Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve	UA Për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9767">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9767</a> ).	Afat-Mesëm  (deri më 29 Shkurt 2020)	Një projekt UA për Licencimin e Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete është në procedurë të ndryshimit brenda MMPH-së dhe rekomandohet shkurtimi i këtij afati.  Me këtë projekt UA i cili është për nënshkrim te Ministri është bërë shkurtimi i afatit për shqyrtim të kërkesë nga 30 ditë në 15 ditë që është një hap pozitiv drejt thjeshtimit të procedurës së aplikimit.

18.	Reduktimi i taksave për licencimin e kompanive gjeodete dhe gjeodetëve	<p>2 Lejime Thjeshtësohen</p> <p>(Po) AKK-1</p> <p>(Po) AKK-2</p>	<p>Vlerësimi i taksave sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative</p>	Vendimi aktual i AKK-së	<p>Afat-Mesëm</p> <p>(deri 31 Dhjetor 2019)</p>	<p>Me projekt UA aktual i cili është në procedurë të nënshkrimit nga Ministri, parashihet që taksat aktuale për licencim të gjeodeteve prej 150 euro dhe asaj për licencim të kompanive gjeodete prej 300 euro të ngriten në 300 dhe 500 euro. Për më tepër projekt UA parasheh edhe një taksë prej 20 euro për aplikim që është barrë shtesë për aplikuesin.</p> <p>Pjesë taksës për licencim janë edhe trajnimet e ndryshme të gjeodetëve dhe</p>
-----	--	---	--	-------------------------	---	---

						<p>kompanive gjeodete.</p> <p>Një nga dispozitat tjera pozitive të këtij projekt UA është ajo e cila zgjate vlefshmërinë e licencës nga 3 në 5 vjet.</p>
--	--	--	--	--	--	--



***Raport për Thjeshtësimin e Lejeve dhe Licencave  
Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së  
Kosovës***

***Projekti i IFC për Përmirësimin e Klimës së Investimeve në Kosovë II***



## **Shkurtesat**

**AIPNK** Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë

**AMK** Agjencia e Metrologjisë e Kosovës në MTI

**API** Agjencia e Pronësisë Industriale në MTI

**ARBK** Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës

**AVUK** Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit e Kosovës

**DI** Departamenti i Industrisë në MTI

**DKTMS** Departamenti për Kontrollimin e Tregtisë me Mallra Strategjike në MTI

**DRRTN** Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës në MTI

**DTR** Departamenti i Tregtisë në MTI

**DTU** Departamenti i Turizmit në MTI

**GLN** Gazi i Lëngëzuar i Naftës

**IFC** Korporata Ndërkombëtare Financiare, pjesë e Grupit të Bankës Botërore

**Lejim** Njoftim, Regjistrim, Leje ose Licencë Profesionale

**MBPZHR** Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**MTI** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

**QRK** Qeveria e Republikës së Kosovës

**Regjistri** Regjistri i Lejeve dhe Licencave

**U.A.** Udhëzim Administrativ

## 1. Hyrje

Thjeshtësimi i sistemit të lejimeve është një ndër faktorët kyç për përmirësimin e mjedisit afarist dhe për tërheqjen e investimeve.

Reforma e sistemit të lejimeve në Kosovë ka filluar me aprovimin e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave në vitin 2013 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8967>). Ky ligj vendos parimet dhe rregullat kryesore për krijimin e lejeve dhe licencave të reja si dhe për lejet dhe licencat ekzistuese. Ligji përcakton që lejet dhe licencat do të krijohen vetëm në rastet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë publike, mjedisit dhe përdorimit të resurseve natyrore në republikën e Kosovës, duke parandaluar kështu krijimin e barrierave administrative për biznese në rastet tjera. Ligji gjithashtu kërkon shqyrtimin e të gjitha lejeve dhe licencave ekzistuese për të konstatuar përputhshmërinë me këto parime dhe rregulla.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave është krijuar edhe Regjistri i Lejeve dhe Licencave (Regjistri) në të cilin janë identifikuar lejimet që administrohen nga të gjitha organet e administratës shtetërore (<http://lejelicenca.rks-gov.net/>).

Si njëra nga Ministritë kryesore të përfshira në rregullimin e aktivitetit ekonomik në Republikën e Kosovës, thjeshtësimi i lejimeve që administrohen aktualisht nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) është me rëndësi jetike për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm afarist në Kosovë.

Qëllimi i këtij raporti është përmbledhja e analizës ligjore dhe dhënia e rekomandimeve për thjeshtësimin e lejimeve në kuadër të MTI. Megjithëse janë bërë përpjekje të konsiderueshme për analizimin e detajuar të kornizës ligjore që rregullon secilin lejim që administrohet nga MTI, për shkak të mandatit të gjerë të MTI dhe numrit të madh të lejimeve që administrohen nga kjo ministri, ka nevojë për analizë të mëtutjeshme të këtyre lejimeve në rastet e identifikuar në këtë raport.

Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se në këtë raport janë përmbledhur vetëm gjetjet dhe rekomandimet kryesore që ndërlidhen me procesin e administrimit të këtyre lejimeve. Gjatë analizës ligjore janë identifikuar disa mangësi të tjera në legjislacionin e aplikueshëm por që nuk ndërlidhen me procesin e administrimit të lejimeve përkatëse. Këto mangësi nuk janë përfshirë në këtë raport.

Raporti në tërësi është organizuar në 4 Kapituj dhe 3 Shtojca.

Në Kapitullin 2 janë shpjeguar fazat e implementimit të këtij aktiviteti. Në Kapitullin 3 janë paraqitur detalet lidhur me përditësimin e Regjistrit të Lejeve dhe Licencave që janë shtjelluar më tutje në Shtojcën 1. Në Kapitullin 4 është paraqitur analiza ligjore për të gjitha lejet dhe licencat e detajuara.

Rekomandimet e përgjithshme janë paraqitur në Shtojcën 2.

Rekomandimet specifike janë paraqitur në Shtojcën 3 dhe janë organizuar sipas kohës së përafërt për realizimin e tyre në rekomandime afat-shkurtra (gjelbër), afat-mesme (portokalli) dhe afat-gjata (kuqe) si vijon:

	<b>Rekomandimet afat-shkurtra</b>	Deri me 30 Qershor 2019	Ndryshimet e nevojshme mund të bëhen me vendim të Ministrit të MTI ose veprime tjera të brendshme si p.sh rishikimi i projektligjeve që aktualisht janë ende brenda Qeverisë.
	<b>Rekomandimet afat-mesme</b>	Deri me 31 Dhjetor 2019	Implementimi kërkon angazhim më të madh në kryerjen e analizave më të detajuara (si p.sh analizat e cost-recovery) ose kërkohen ndryshime më të konsiderueshme për ndryshimin e akteve nënligjore (Udhëzime Administrative (U.A.) ose Rregulloreve);
	<b>Rekomandimet afat-gjate</b>	Pas 31 Dhjetorit 2019	Implementimi kërkon angazhim më afatgjatë pasi kërkohen ndryshime në ligjet primare.

Ky raport është rezultat i punës së një ekipi të përbashkët të përbërë nga këshilltarë të Projektit të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) për “Përmirësimin e Klimës së Investimeve në Kosovë II”, Departamenti Ligjor i MTI dhe përfaqësues nga Zyra Ligjore e Kryeministrit.

## 2. Fazat e Implementimit të Aktivitetit

Aktiviteti është zhvilluar në 4 faza, si vijon:

**Faza e Parë:** Analiza preliminare ligjore e lejimeve që administrohen nga MTI të identifikuar në Regjistër

**Faza e Dytë:** Zhvillimi i takimeve me departamentet dhe agjencitë brenda MTI për diskutimin e analizës preliminare ligjore dhe mbledhjen e informatave plotësuese për administrimin e lejimeve në praktikë

**Faza e Tretë:** Zhvillimi i takimeve me përfaqësues të sektorit privat të cilët pajisjen me lejimet që lëshohen nga MTI në sektorë të ndryshëm ekonomik

**Faza e Katërtë:** Shqyrtimi përfundimtar i informacionit të mbledhur dhe hartimi i raportit

*Gjatë Fazës së Parë*, është bërë një analizë preliminare ligjore e lejimeve sipas të dhënave të përfshira në Regjistër. Gjatë kësaj analizë është bërë menjëherë evidente që lejimet e përfshira në Regjistër kanë nevojë për përditësim, për korrigjimin e informatave që janë përfshirë në Regjistër si dhe përfshirjen e lejimeve të reja që janë identifikuar gjatë analizës ose bashkimin e lejimeve ekzistuese. Për shkak të dallimeve të konsiderueshme ndërmjet lejimeve të përfshira në Regjistër dhe atyre të parapara në kornizën ligjore dhe të administruara në praktikë nga MTI, është bërë i nevojshëm rishikimi i të gjitha lejimeve të regjistruara në Regjistër.

*Gjatë fazës së dytë* janë zhvilluar takime me departamentet dhe agjencitë përkatëse brenda MTI. Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar gjetjet e fazës së parë dhe janë kërkuar mendimet e departamenteve dhe agjencive përkatëse për ndryshimet potenciale në lejimet që administrohen nga ato.

*Gjatë fazës së tretë*, janë zhvilluar takime me përfaqësues të sektorit privat të përfshirë në sektorët përkatës që ndërlidhen me lejimet që administrohen nga MTI, ku janë diskutuar gjetjet dhe janë kërkuar mendimet e tyre lidhur me thjeshtësimin e lejimeve në fushat përkatëse.

*Gjatë fazës së katërt* është shqyrtuar tërë informacioni i mbledhur dhe është hartuar ky raport.

### 3. Përditësimi i Regjistrimit të Lejeve dhe Licencave

Gjatë fazës së parë të implementimit të këtij aktiviteti është identifikuar nevoja për përditësimin e të dhënave në Regjistrim për lejimet e MTI me qëllim të sqarimit të gjendjes aktuale ligjore dhe përgatitjes së rekomandimeve për thjeshtësim në bazë të gjendjes aktuale ligjore.

Përditësimi i të dhënave është kryer në bashkëpunim me Departamentin Ligjor të MTI dhe në këtë proces janë angazhuar të gjitha departamentet dhe agjencitë përkatëse në MTI. Për monitorimin më të lehtë të ndryshimeve eventuale në të ardhmen sa i përket numrit të lejimeve ose kriteret, afatet ligjore ose elementet tjera, secilit lejim i është caktuar një kod numerik.

Gjatë përditësimit të të dhënave për lejimet në kuadër të MTI është ushtruar kujdes që të dhënat e përfshira në formularët e rinj të reflektojnë kriteret, procedurat, afatet, koston dhe elementet tjera të përcaktuara në ligjet ose aktet nënligjore përkatëse. Verifikimi ligjor i të dhënave të mbledhura nga departamentit ose agjencitë përkatëse është i rëndësishëm për shkak se në disa raste mund të ketë diskrepancë ndërmjet përcaktimeve ligjore dhe mënyrës së aplikimit të atyre përcaktimeve ligjore në praktikë nga ana e departamenteve ose agjencive përkatëse, gjë kjo që mund të ndikojë në numrin e lejimeve të identifikuara si dhe kriteret, procedurat, afatet, koston ose elementet tjera të një lejimi që regjistrohen në Regjistrim.

Nga ky aktivitet, përveç ndryshimit të të dhënave, bazës ligjore dhe elementeve tjera të lejimeve që administrohen nga MTI, gjithashtu rezulton se duhet të shtohet një numër i konsiderueshëm i lejimeve. Për më shumë detale shihni tabelën më poshtë, ndërsa një inventar më specifik që paraqet gjendjen aktuale në Regjistrim dhe gjendjen e re është bashkëngjitur në Shtojcën 1 të këtij Raporti. Së bashku me këtë raport do të sigurohen edhe të gjithë formularët e përditësuar për përfshirje në Regjistrim.

Njësia Organizative	Lejimet në Regjistrim	Lejimet pas Rishikimit	Diferenca
Departamenti i Tregtisë	3	8	+ 5
Departamenti i Industrisë	4	2	- 2
Departamenti i Turizmit	0	1	+ 1
Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës	19	20	+ 1
Departamenti për Kontrollimin e Tregtisë me Mallra Strategjike	0	10	+ 10
Agjencia e Pronësisë Industriale	4	1	- 3
Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë	6	10	+ 4
Agjencia e Metrologjisë e Kosovës	3	6	+ 3
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve	1	2	+ 1
	<b>Total: 40</b>	<b>Total: 60</b>	<b>Total: + 20</b>

#### 4. Analiza Ligjore e Lejimeve në MTI

Në këtë kapitull është paraqitur analiza ligjore e lejimeve në kompetencë të MTI. Analiza është paraqitur sipas departamenteve dhe agjencive përkatëse, ndërsa rekomandimet specifike dhe afatet për implementimin e tyre janë dhënë në tabelën e bashkëngjitur në Shtojcën 3 të këtij Raporti.

##### 4.1. Departamenti i Tregtisë

Departamenti i Tregtisë (DTR) në MTI administrohë gjithsej tetë (8) lejime që ndërlidhen me industrinë e duhanit. Këto lejime administrohen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit (<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2783#>) dhe akteve nënligjore përkatëse, posaçërisht U.A. (MTI) Nr. 04/2016 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kritereve për Subjektet që Merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të Tij (<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12340>).

Nr.	Në Regjistër	Departamenti i Tregtisë
DTR-1	Po	Licenca për eksport të produkteve të duhanit, përveç duhanit të pa fermentuar dhe të pa përpunuar
DTR-2	Po	Licenca për import dhe shitje me shumicë të cigareve
DTR-3	Jo	Licenca për shitje me shumicë cigareve
DTR-4	Po	Licenca për import dhe shitje me shumicë të cigareve puro, cigarellos, nargjile dhe duhan për pirje
DTR-5	Jo	Licenca për import të duhanit të papërpunuar
DTR-6	Jo	Licenca për import dhe shitje me shumicë të cigareve elektronike
DTR-7	Jo	Licenca për import dhe Licenca për shitje me shumicë të cigareve për përtpyje dhe nuhatje
DTR-8	Jo	Licenca për import të letrës për cigare dhe letrës në forme tubi me filtër

Megjithëse në U.A. Nr. 04/2016 janë të përcaktuara tetë (8) lejime që administrohen nga DTR, gjatë diskutimeve me përfaqësues të DTR është bërë e ditur se lejimi DTR-3 nuk administrohet në praktikë pasi që është konsideruar që lejimi DTR-2 e mbulon mjaftueshëm fushën përkatëse.

Autoritetet tjera shtetërore që janë të përfshira në administrimin e lejimeve për industrinë e duhanit janë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit e Kosovës (AVUK) dhe Doganat e Kosovës. Sa i përket lejimeve që lëshohen nga MBPZHR, këto lejime kryesisht kanë të bëjnë me grumbullimin dhe përpunimin e duhanit dhe mund të konsiderohen të veçanta nga lejimet që ndërlidhen me tregtimin e duhanit.

Lidhur me lejimet në fushën e tregtisë me duhan dhe produkte të duhanit, nga analiza ligjore dhe në bazë të diskutimeve me përfaqësues të sektorit privat, rezulton se ka trefishim të lejimeve ndërmjet DTR, AVUK dhe Doganave të Kosovës. Përderisa është evidente se kërkesat që parashtrihen nga këto tri institucione dallojnë deri në një masë të caktuar, kjo megjithatë nuk është arsye për të kërkuar lejime në tri institucione të ndryshme. Gjatë një takimi të zhvilluar me përfaqësues të sektorit privat është bërë e ditur se ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohen tregtuesit e duhanit në Kosovë sa i përket lejimeve kanë të bëjnë me numrin e lejimeve të kërkuara (DTR, AVUK dhe Doganat), dallimet në kohëzgjatjen e lejimeve që lëshohen nga këto tri institucione

DTR (5 vite), AVUK (1 vit) dhe Doganat e Kosovës (1 vit) si dhe disa nga kërkesat për lëshimin e lejimeve përkatëse.

Rrjedhimisht, në bazë të analizës dhe diskutimeve me sektorin privat, rekomandohet që të sqarohen kompetencat për lëshimin e lejimeve për tregtimin e duhanit dhe të krijohet një One-Stop-Shop ose një komision i përbashkët ndër-qeveritar për të gjitha lejimet që ndërlidhen me këtë fushë në kuadër të DTR në MTI.

Një gjetje tjetër më rëndësi që është diskutuar me përfaqësuesit e sektorit privat, ka të bëjë me lartësinë e taksave për lëshimin dhe vazhdimin e lejimeve që ndërlidhen me tregtimin e duhanit nga DTR, që në pamje të parë duket të jenë shumë të larta dhe jo në përputhje me parimin e mbulimit të shpenzimeve administrative të përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

Lidhur me lartësinë e taksave, rekomandohet kryerja e një analize për mbulimin e shpenzimeve administrative në të cilën mund të shqyrtohet ulja e këtyre taksave.

Rekomandimet specifike lidhur me DTR, të ndara në formë të rekomandimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 3 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

#### 4.2. Departamenti i Industrisë

Departamenti i Industrisë (DI) në MTI administron gjithsej dy (2) lejime që ndërlidhen me vlerësimin e konformitetit për produkte jo-ushqimore dhe derivate të naftës. Këto lejime administrohen në bazë të Ligjit Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit (<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388>) dhe akteve nënligjore përkatëse, posaçërisht U.A. (QRK) Nr. 12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit (<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388>).

Nr.	Në Regjistër	Departamenti i Industrisë
DI-1	Po	Emërim për Vlerësimin e Konformitetit (Përveç Derivateve të Lëngëta të Naftës)
DI-2	Po	Emërim për Vlerësimin e Konformitetit për Derivate të Lëngëta të Naftës

Gjatë shqyrtimit të kornizës ligjore që rregullon këto lejime është identifikuar nevoja për bashkimin e dy emërimeve për vlerësimin e konformitetit për sigurinë e lodrave dhe vlerësimin e konformitetit për ashensorë dhe kompetentët e tyre të sigurisë, në një emërim të vetëm DI-1 që mbulon më shumë produkte për të cilat kërkohet që të ketë emërim. Rrjedhimisht, numri i lejimeve që administrohen nga DI është reduktuar nga 3 në 2 lejime.

Gjatë shqyrtimit të kornizës ligjore që e rregullon këtë fushë, është evidente se baza ligjore ka pësuar ndryshime me kalimin e kohës, ndërsa së fundmi në vitin 2018 është ndryshuar edhe ligji primar që e rregullon fushën e vlerësimin të konformitetit Ligji Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit por edhe akti kryesor nënligjor U.A. (QRK) Nr. 12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit.

Gjithashtu është evidente se baza ligjore në këtë fushë është harmonizuar në masë të madhe me kërkesat e Acquis Communautaire të BE dhe rrjedhimisht ka pak hapësire për thjeshtësim të mëtutjeshëm të procedurave për këto lejime. Megjithëse janë shqyrtuar disa ligje dhe akte nënligjore të vendeve të BE-së gjatë kësaj analize, një shembull që është përdorur për qëllime të krahasimit është Ligji i Republikës së Kroacisë për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit

(<http://www.mvep.hr/files/file/dokumenti/prevodenje/zakoni/zakon-o-tehnickim-zahtjevima-za-proizvode-i-ocjenjivanju-sukladnosti-nn-80-13-eng.pdf>)

Një çështje në të cilën ka hapësire për thjeshtësim është tek taksat për aplikim dhe marrje të emërimit që janë të përcaktuara me Vendimin e Ministrit të MTI Nr. 53 të datës 29.10.2018 në të cilin përcaktohen taksat për aplikim dhe emërim për trupat e emëruar për vlerësim të konformitetit.

Një çështje tjetër që është ngritur gjatë diskutimeve me përfaqësuesit e sektorit privat të përfshirë në këtë fushë është përcaktimi i afateve maksimale për shqyrtimin e kërkesave për emërim të trupave të konformitetit nga komisionet vlerësuese si dhe afatet për nënshkrimin e emërimeve nga ministrat e ministrive përkatëse si dhe procedura e ankesës administrative në rast të refuzimit. U.A. (QRK) Nr. 12/2018 nuk i përcakton këto afate dhe procedurën e ankesës. Është e qartë që në mungesë të këtyre afateve dhe procedurës së ankesës vlejné dispozitat e ligjit në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>), mirëpo për sqarimin e mëtutjeshëm të këtyre procedurave dhe ofrimin e sigurisë juridike për aplikuesit do të ishte optimale që këto afate dhe procedura e ankesës të përcaktohen edhe në U.A. (QRK) Nr. 12/2018.

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të DI, të ndara në formë të rekomandimeve afat-shkurtra, afatmesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 3 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

### 4.3. Departamenti i Turizmit

Departamenti i Turizmit (DTU) është departament i ri në MTI që administron një (1) lejim që ndërlidhet me kategorizimin e objekteve hoteliere. Ky lejim më parë është administruar nga Departamenti i Industrisë. Ky lejim administrohet në bazë të Ligjit Nr. 04/L-176 për Turizmin (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8668>) dhe akteve nënligjore përkatëse.

Nr.	Në Regjistër	Departamenti i Turizmit
DTU-1	Po	Certifikim për kategorizimin e objekteve hoteliere

Gjatë analizës së lejimit DTU-1, është konstatuar se ky lejim potencialisht mund edhe të hiqet nga Regjistri pasi që aktualisht nuk paraqet parakusht për ushtrimin e veprimtarisë së objekteve hoteliere por i jep të drejtën objektit hotelier për vendosjen e yjeve të kategorizimit në baza vullnetare. Megjithatë, duke marrë parasysh që ky lejim aktualisht është në proces të rishikimit dhe të shndërrimit në lejim të detyrueshëm sipas projektligjit për turizmin që aktualisht është në shqyrtim brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) është vendosur që të mos rekomandohet fshirja nga regjistri.

Është me rëndësi të theksohet se projektligji i ri për turizmin që aktualisht është në shqyrtim brenda QRK parasheh krijimin e disa lejimeve shtesë, duke përfshirë potencialisht tri licenca profesionale për ciceronë turistik në tri kategori të ndryshme si dhe disa kërkesa për regjistrim në Regjistrin Qendror të Turizmit që do të krijohet në MTI (p.sh regjistrimi i agjencive turistike). Sa i përket kërkesave për regjistrim, nga shqyrtimi i projektligjit për turizëm nuk është plotësisht e qartë nëse këto kërkesa për regjistrim do të aplikohen për subjektet private në sektorin e turizmit apo të dhënat do të mbledhen nga burimet ekzistuese të të dhënave brenda QRK dhe të shtohen në regjistër. Procedurat e sakta të regjistrimeve të lartpërmendura janë paraparë të rregullohen me akte nënligjore.

Rekomandohet që MTI të shqyrtojë me kujdes lejimet e reja që parashihen të krijohen në fushën e turizmit dhe përputhshmërinë e tyre me parimin e proporcionalitetit dhe parimet tjera të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të DTU, të ndara në formë të rekomandimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 3 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

#### 4.4. Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës

Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës (DRRTN) në MTI administron gjithsej njëzet (20) lejime që ndërlidhen me industrinë e naftës. Këto lejime administrohen në bazë të Ligjit Nr. 2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2408#>), me ndryshime dhe plotësime, dhe akteve nënligjore përkatëse, posaçërisht U.A. (MTI) Nr. 07/2018 për Përcaktimin e Procedurës së Licencimit për Subjektet që Ushtrijnë Veprimtari në Sektorin e Naftës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17763>), me ndryshime dhe plotësime.

Nr.	Në Regjistër	Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës
DRRTN-1	Po	Licenca për import të dizelit dhe benzinës
DRRTN-2	Po	Licenca për deponim të dizelit, benzinës, dhe gazoilit
DRRTN-3	Po	Licenca për shitje me shumicë të dizelit, benzinës, dhe gazoilit
DRRTN-4	Po	Licenca për shitje me pakicë të dizelit, benzinës, dhe gazoilit
DRRTN-5	Po	Licenca për import të GLN-së
DRRTN-6	Po	Licenca për deponim të GLN-së
DRRTN-7	Po	Licenca për shitje me shumicë të GLN-së
DRRTN-8	Po	Licenca për shitje me pakicë të GLN-së
DRRTN-9	Po	Licenca për import të vajrave të rënda për ngrohje
DRRTN-10	Po	Licenca për shitje me shumicë të vajrave të rënda për ngrohje
DRRTN-11	Jo	Licenca për import të vajrave sipas produktit të caktuar (vajra bazike)
DRRTN-12	Po	Licenca për shitje me shumicë të vajrave sipas produktit të caktuar
DRRTN-13	Po	Licenca për import të koksit të naftës
DRRTN-14	Po	Licenca për import të vajrave sipas produktit të caktuar (vajrat për qëllime: lubrifikimi, hidraulike, përcjellje të nxehtësisë, kundër ndryshkjes, izolim elektrik, punim të metaleve, tretje, për qëllime të tjera të ngjashme)
DRRTN-15	Po	Licenca për import të karburantit Jet
DRRTN-16	Po	Licenca për deponim të karburantit Jet
DRRTN-17	Po	Licenca për shitje me shumicë të karburantit Jet
DRRTN-18	Po	Licenca për import të gazoilit



<b>DRRTN-19</b>	Po	Licenca për import të lëndës së parë me qëllim të prodhimit të karburanteve finale të naftës
<b>DRRTN-20</b>	Po	Licenca për import, shitje me shumicë, dhe pakicë të bombolave të gazit për amvisëri

Gjatë analizës së kornizës ligjore që rregullon lejimet që administrohen nga DRRTN është identifikuar edhe një lejim shtesë, DRRTN-11 që është krijuar sipas U.A. (MTI) Nr. 07/2018 duke e rritur numrin e lejimeve nga 19 lejime sa janë të shënuara në Regjistër aktualisht në 20 lejime.

Duhet të theksohet se Ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës është aktualisht në proces të ndryshimit dhe plotësimit. Projektligji i ri është dorëzuar një herë në Kuvendin e Kosovës në vitin 2018, por është kthyer sërish për rishqyrtim në MTI, ku ndodhet aktualisht. Gjetjet më poshtë dhe rekomandimet në Shtojcën 3 të këtij Raporti mund të konsiderohen gjatë shqyrtimit të Projektligjit për Tregtimin me Produktet e Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshme.

Nga analiza ligjore rezulton se ka nevojë për ndryshime në legjislacionin që rregullon lejimet në fushën e naftës për rishikimin e taksave administrative, procedurave, kërkesave dhe përgjegjësi për lëshimin e këtyre lejimeve. Në veçanti konsiderojmë se duhet të rishikohen kërkesat për dokumentacion për pajisje licencat e naftës, kohëzgjatja e licencave që aktualisht është dy (2) vite, kosto e pajisjes me lejim si dhe përgjegjësitë e Komisionit për Verifikimin e Kushteve të Veçanta Teknike. Këto çështje janë diskutuar në hollësi edhe më përfaqësuesit e sektorit privat të përfshirë në këtë fushë.

Sa i përket lartësisë së taksave për marrjen e lejimeve në sektorin e naftës, konsiderojmë se ka nevojë për një analizë të detajuar sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative, pasi që nuk është e qartë nëse taksat aktualisht të vendosura sipas U.A. 16/2010 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7936>) janë në përputhje me këtë parim. Një taksë në veçanti, taksa prej 100 Eurove për vizitat e Komisionit për Verifikimin e Kriteve Teknike konsiderojmë se duhet të eliminohet sa më parë që të jetë e mundur, pasi që edhe nga informacionet e mbledhura në MTI kjo taksë në fakt nuk është duke u aplikuar dhe nuk është i qartë qëllimi i kësaj takse.

Nga analiza e legjislacionit ekzistues, në veçanti U.A. (MTI) Nr. 07/2018 dhe në bazë të diskutimeve me përfaqësues brenda MTI dhe sektorit privat rezulton se në procesin e lëshimit të lejimeve për sektorin e naftës, përveç DRRTN është e përfshirë edhe një trupë tjetër, respektivisht Komisioni për Vlerësimin e Kushteve të Veçanta Teknike i krijuar sipas Nenit 13 të U.A. (MTI) Nr. 07/2018.

Ky Komision, që është përgjegjës për verifikimin e kushteve të veçanta teknike emërohet dhe i raporton Ministrit të MTI, mirëpo përgjegjësitë e tij, që janë ekskluzivisht të përcaktuara në Nenin 13 të U.A. (MTI) Nr. 07/2018 janë shumë të paqarta. Nga shqyrtimi i një vendimi për emërimin e këtij komisioni të Ministrit të MTI me numër 01. Ref. Nr. 89 të datës 22.07.2016, rezulton se ky Komision kryen vlerësimin e kushteve teknike para lëshimit të lejimeve në sektorin e naftës dhe e pasqyron vlerësimin në një raport (procesverbal) që i dorëzohet DRRTN para lëshimit të licencës. Gjithashtu nga shqyrtimi i vendimit të lartpërmendur rezulton se ky Komision përbëhet nga zyrtarë të MTI, në disa raste jashtë DRRTN.

Nuk është e qartë nga shqyrtimi i Ligjit Nr. 2004/5 dhe U.A. (MTI) Nr. 07/2018 cila saktësisht është saktësisht vlera e shtuar e këtij Komisioni në procesin e administrimit të lejeve për sektorin e naftës dhe përse këto detyra të vlerësimit nuk mund të kryhen nga vetë DRRTN si departamenti me ekspertizën më të madhe në kuadër të MTI në sektorin e naftës dhe departamenti përgjegjës për administrimin e këtyre lejimeve.

Sa i përket procedurave dhe kërkesave për dokumentacion për pajisje me lejim për sektorin e naftës, nuk duket të jetë e arsyeshme që të njëjtat kërkesa që aplikohen për marrjen e një lejimi për një periudhë dy (2) vjeçare të vlejnjë edhe për vazhdimin e atij lejimi pas skadimit të kësaj periudhe siç kërkohet në Nenin 4, paragrafi 4.5 të Ligjit Nr. 2004/5 dhe Nenin 11 dhe 12 të U.A. (MTI) Nr. 07/2018.

Gjatë takimeve të zhvilluara me përfaqësues të sektorit privat, një shqetësim që është ngritur ka të bëjë me kërkesën nga DRRTN për “vërtetimin” e dokumentacionit që dorëzohet për qëllime të aplikimit për lejimet që lëshohen nga DRRTN. Nga po këto diskutime është sqaruar se kjo kërkesë është interpretuar nga DRRTN si kërkesë për *noterizim* dhe është aplikuar edhe për autorizimet që lëshohen nga organet qeveritare si ARBK dhe ATK. Lidhur me këtë çështje është bërë një vlerësim i kornizës ligjore nga i cili rezulton se në fakt Ligjit Nr. 2004/5 në Nenin 5, paragrafi 5.6 kërkon që dokumentet e lëshuara nga disa organe shtetërore si ARBK dhe ATK të jenë “të vërtetuara”, mirëpo duke marrë parasysh kohën e aprovimit të këtij ligji kjo kërkesë nuk mund të interpretohet se krijon kërkesë për “noterizim” të dokumenteve. Gjithashtu, kjo çështje është trajtuar edhe në U.A. (MTI) Nr. 07/2018 në Nenin 3, paragrafi 9 ku përcaktohet se “*dokumentacioni i dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës duhet të jetë origjinal ose kopje e vërtetuar nga organet kompetente*”. Gjatë këtij aktiviteti nuk ka qenë e mundur të vërtetohet ky pretendim përmes shqyrtimit të ndonjë aplikacioni për licencë të dorëzuar nga aplikuesit, megjithatë rekomandohet që kjo çështje të shqyrtohet seriozisht dhe të bëhet e qartë që autorizimet që kërkohen nga institucione të tjera të QRK për pajisje me licencë në fushën e naftës nuk është e nevojshme të vërtetohen jashtë strukturave të QRK, pasi që autenticiteti i tyre vërtetohet në kohën e lëshimit nga organet kompetente.

Sa i përket kohëzgjatjes së vlefshmërisë së lejimeve për sektorin e naftës, vlen të theksohet se kohëzgjatja prej dy (2) viteve është shumë e shkurtër dhe nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit sipas Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Në versionin aktual të Projektligjit që ndodhet në MTI është propozuar ndryshimi i periudhës së vlefshmërisë nga dy (2) në pesë (5) vite, por konsiderojmë që kohëzgjatja e vlefshmërisë së këtyre lejimeve mund të vazhdohet edhe më tutje.

Gjatë shqyrtimit të Projektligjit të ri për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme në Kosovë vërehet se në Nenin 5 të këtij Projektligji janë përcaktuar pesë (5) lloje të lejeve që lëshohen sipas Projektligjit të ri, ndërsa aktualisht lëshohen 20 licenca. Gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji nga MTI këshillojmë që të merret parasysh Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave ku përcaktohet se lejet dhe licencat mund të përcaktohen vetëm me ligj që nënkupton se secili lejim duhet të përcaktohet shprehimisht me ligj në mënyrë individuale dhe jo sipas llojit.

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të DRRTN, të ndara në formë të rekomandimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 3 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

#### **4.5. Departamenti për Kontrollimin e Tregtisë me Mallra Strategjike**

Departamenti për Kontrollimin e Tregtisë me Mallra Strategjike (DKTMS) në MTI administron gjithsej dhjetë (10) lejime. Këto lejime administrohen në bazë të Ligji Nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8860>) dhe akteve nënligjore përkatëse, posaçërisht U.A. (MTI) Nr. 14/2013 për Regjistrimin, Licencimin dhe Zbatimin e Procedurave Administrative (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9971>).

Nr.	Në Regjistër	Departamenti për Kontrollimin e Tregtisë me Mallra Strategjike
-----	--------------	--

<b>DKTMS-1</b>	Jo	Regjistrimi në Regjistrin e Tregtarëve të Mallrave Strategjike
<b>DKTMS-2</b>	Jo	Licenca për Eksport të Mallrave Strategjike
<b>DKTMS-3</b>	Jo	Licenca për Ri-Eksport Jashtë Territorial ose Ri-Transfer të Mallrave Strategjike
<b>DKTMS-4</b>	Jo	Licenca për Import të Mallrave Strategjike
<b>DKTMS-5</b>	Jo	Licenca për Brokerët-Ndërmjetësuesit për Mallra Strategjike
<b>DKTMS-6</b>	Jo	Licenca për Transit apo Transngarkim të Mallrave Strategjike
<b>DKTMS-7</b>	Jo	Certifikata për Përdoruesin Fundor të Mallrave Strategjike
<b>DKTMS-8</b>	Jo	Certifikata Ndërkombëtare e Importit të Mallrave Strategjike
<b>DKTMS-9</b>	Jo	Certifikata për Verifikimin e Dorëzimit të Mallit Strategjik
<b>DKTMS-10</b>	Jo	Licenca për Ofrimin e Shërbimeve të Ndërlidhura me Mallrat Strategjike

Lejimet DKTMS-1 deri DKTMS-10 që administrohen nga DKTMS nuk kanë qenë të identifikuar në Regjistër dhe identifikimi i tyre është bërë gjatë implementimit të këtij aktiviteti.

Pas identifikimit të këtyre lejimeve është bërë një analizë e kornizës ligjore që rregullon këto lejime dhe nga kjo analizë rezulton se procedurat për administrimin e këtyre lejimeve janë kryesisht në përputhje me praktikën e shteteve të BE-së dhe rajonit. Gjatë analizës së kornizës ligjore janë shqyrtuar praktikën e Letonisë (<https://likumi.lv/ta/en/id/214394-procedures-for-issuing-or-refusal-to-issue-a-licence-for-goods-of-strategic-significance-and-other-documents-related-to-the-circulation-of-goods-of-strategic-significance>) Kroacisë (<http://gd.mvep.hr/hr/kontrola-izvoza/export-control/dual-use-items/application-forms/>), Estonisë (<https://vm.ee/en/applications-licenses-and-certificates-other-forms>) dhe Bullgarisë (<http://exportcontrol.bg/indexen.php>).

Nga kjo analizë krahasuese, rezulton se praktikën në këtë fushë janë relativisht të ngjashme dhe hapësira për thjeshtësim të mëtutjeshëm është e vogël.

Gjatë diskutimeve me përfaqësues të sektorit privat të përfshirë në fushën e tregtisë me mallra strategjike, një kërkesë e identifikuar ka qenë që në kuadër të DKTMS të krijohen kapacitetet e nevojshme për lëshimin e licencave të përgjithshme, që mund ta lehtësojnë në masë të konsiderueshme procesin e pajisjes me licenca dhe që të mos ketë nevojë për licenca individuale për çdo transaksion.

Një fushë në të cilën fillimisht ishte identifikuar një mundësi për thjeshtësim është tek çështja e taksave për regjistrim dhe lëshim të licencave për tregtinë me mallra strategjike. Megjithatë, pas analizës më të detajuar, rezulton se taksat për lëshimin e këtyre licencave janë ulur në mënyrë graduale dhe në vitin 2018 kanë arritur shumën prej pesë (5) Euro për regjistrim dhe lëshim të licencave përkatëse nga DKTMS sipas Vendimit të Ministrit të MTI Nr. 12 të datës 9 Janar 2018. Megjithatë, vlen të rishikohet mundësia e eliminimit të tërësisht të taksës prej 5 Euro për regjistrim në Regjistrin e Tregtarëve me Mallra Strategjike (për inkurajimin e regjistrimit sa më të madh, që është në interes të QRK).

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të DKTMS, të ndara në formë të rekomandimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 3 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

#### 4.6. Agjencia e Pronësisë Industriale

Agjencia e Pronësisë Industriale (API) në MTI administrojnë gjithsej një (1) lejim. Ky lejim administrohen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-029 për Patenta (<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2756#>) dhe akteve nënligjore përkatëse, posaçërisht U.A. (MTI) Nr. 06/2018 për Përfaqësues të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale (<https://kipa.rks-gov.net/desk/inc/media/19BC701B-0CDA-4030-A904-67142A27EA18.pdf>).

Nr.	Në Regjistër	Agjencia e Pronësisë Industriale
API-1	Po	Regjistrimi i Përfaqësuesve të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale

Lidhur me numrin e lejimeve që administrohen nga API të identifikuar në Regjistër, gjatë këtij aktiviteti është konstatuar se numri aktual prej katër (4) lejimeve të identifikuar në Regjistër duhet të reduktohet në një (1) lejim të vetëm API-1. Kjo është për shkak se regjistrimi i patentave, markave tregtare dhe dizajnit industrial nuk është konsideruar se i plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave për tu konsideruar lejim, pasi që këto regjistrime nuk paraqesin parakusht për angazhim në një aktivitet të caktuar por paraqesin mbrojtje plotësuese të një të drejte që më pas mund të mbrohet pranë gjykatës kompetente. Eliminimi i tri (3) lejimeve të tjera fillimisht është propozuar nga API dhe mbështetet edhe nga praktika në Republikën e Sllovenisë ku poashtu është identifikuar vetëm ky lejim në regjistrin përkatës (<http://eugo.gov.si/en/permits/>).

Sa i përket lejimit API-1, janë konsultuar praktikantët e disa shteteve të BE-së dhe të rajonit, duke përfshirë Slloveninë, Irlandën si dhe burimet nga Zyra Evropiane e Patentave (<https://www.epo.org/index.html>). Gjatë krahasimit të legjislacionit të Kosovës lidhur me pronësinë industriale me atë të disa shteteve të BE dhe burimeve nga Zyra Evropiane e Patentave, është menjëherë e evidente se legjislacioni është i harmonizuar në masë të madhe me atë të BE.

Megjithatë, dy çështje që vlen të rishikohen janë çështja e kohëzgjatjes së regjistrimit dhe lartësia e taksave për lejimin API-1.

Kohëzgjatja aktuale e regjistrimit prej një (1) viti duket të jetë shumë e shkurtër edhe mund të mos jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit sipas Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Kjo kohëzgjatje mund të rishikohet për zgjatje të paktën në tri (3) vite deri në fillimin e provimeve kualifikuese, me ç'rast kohëzgjatja duhet të rishikohet përsëri për zgjatje të mëtejshme, me mundësi dhe të caktimit të kohëzgjatjes në kohë të pacaktuar.

Taksat aktuale për aplikim, regjistrim dhe vazhdim të regjistrimit duket të jenë shumë të larta dhe nuk është e qartë nëse janë në përputhje me parimin e mbulimit të shpenzimeve administrative (në mungesë të provimit kualifikues) dhe konsiderojmë se duhet të rishikohen. Taksat aktuale sipas U.A. (MTI) Nr. 06/2018 janë si vijon: taksa për aplikim: 30 Euro, taksa për regjistrim: 300 Euro, taksa për vazhdim: 300 Euro, taksa për ndryshimin e të dhënave në regjistër: 20 Euro.

Taksat janë rritur në vitin 2018 përmes U.A. (MTI) Nr. 06/2018 në krahasim me taksat e mëparshme të përcaktuara në Nenin 16 të U.A. (MTI) Nr. 08/2013 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2756>), por arsyeja për rritjen e tyre nuk është e qartë.

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të API, të ndara në formë të rekomandimeve afat-shkurtra, afatmesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 3 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

#### 4.7. Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) në MTI administrohet gjithsej dhjetë (10) lejime. Këto lejime administrohen në bazë të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>).

Nr.	Në Regjistër	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ARBK-1	Po	Regjistrimi i Biznesit Individual
ARBK-2	Po	Regjistrimi i Ortakërisë së Përgjithshme
ARBK-3	Po	Regjistrimi i Ortakërisë së Kufizuar
ARBK-4	Po	Regjistrimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
ARBK-5	Po	Regjistrimi i Shoqërisë Aksionare
ARBK-6	Po	Regjistrimi i Degës së Kompanisë së Huaj në Kosovë
ARBK-7	Jo	Regjistrimi i Zyrës së Përfaqësisë së Shoqërisë Tregtare
ARBK-8	Jo	Regjistrimi i Kooperativës Bujqësore
ARBK-9	Jo	Regjistrimi i Ndërmarrjes në Pronësi Shoqërore
ARBK-10	Jo	Regjistrimi i Ndërmarrjes Publike

Gjatë analizës së kornizës ligjore që rregullon lejimet që administrohen nga ARBK janë identifikuar edhe 4 lejime shtesë, ARBK-7 deri ARBK-10, duke e rritur numrin e lejimeve nga 6 lejime sa janë të shënuara aktualisht në Regjistër në 10 lejime.

Procesi i regjistrimit të bizneseve në Kosovë rregullohet në bazë të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare të miratuar në vitin 2018 dhe nga analiza ligjore dhe shqyrtimi i raportit të përafrimit me Acquis Communautaire të përgatitur nga MTI rezulton se është kryesisht në përputhje me legjislacionin e BE-së që rregullon këtë fushë. Procesi i regjistrimit gjithashtu është mjaft efikas, siç dëshmohet edhe nga rangimi i Kosovës në vendin e 13-të në botë për fillimin e një biznesi në Raportin për të Bërit Biznes 2019 ([http://www.doingbusiness.org/en/data/exploreeconomies/kosovo#DB\\_sb](http://www.doingbusiness.org/en/data/exploreeconomies/kosovo#DB_sb)).

Gjithashtu, Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare ka hyrë në fuqi në Qershor 2018 dhe përmban në vete shumicën e thjeshtësimeve të nevojshme. Megjithatë, është e rëndësishme që ky efikasitet në ruhet në kuptim afat-gjatë duke ndërmarrë hapat e përgjithshëm të përshkruar më poshtë:

- Hartimi dhe aprovimi i akteve nënligjore sipas Ligjit të ri për Shoqëritë Tregtare, me theks të veçantë në aprovimin e aktit nënligjore për procedurat e regjistrimit të bizneseve sipas Nenit 17, paragrafi 12 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;

- Trajnimi i zyrtarëve të ARBK lidhur kërkesat dhe kushtet e Ligjit të ri për Shoqëritë Tregtare, i cili ka hyrë në fuqi në muajin Qershor 2018, për të siguruar që të gjitha Shoqëritë Tregtare pa përjashtim të regjistrohen brenda 2 ditëve sipas kërkesave të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Vazhdimi i përgatitjes dhe publikimit të Raporteve për Indikatorët Kryesor të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë që tashmë është edhe kërkesë ligjore sipas Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare (<https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,41>);
- Ndërmarrja e hapave për automatizimin e matjes së performancës në regjistrimin e shoqërive tregtare duke zhvilluar një mjet elektronik i cili prodhon informacionin e raportuar për indikatorët kryesor në mënyrë automatike dhe që i prezanton këto informata në uebfaqen e ARBK të gatshme për shqyrtim nga publiku;
- Intensifikimi i përpjekjeve për ndryshimin e uebfaqes së ARBK me qëllim të harmonizimit me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe kryerja e përgatitjeve të nevojshme për lansimin e e-regjistrimit.
- Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të ARBK, të ndara në formë të rekomandimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 3 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

#### 4.8. Agjencia e Metrologjisë e Kosovës

Agjencia e Metrologjisë e Kosovës (AMK) në MTI administron gjithsej gjashtë (6) lejime. Këto lejime administrohen në bazë të Ligji Nr. 06/L-037 për Metrologji <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16354> dhe Ligjit Nr. 04/L-154 për Punimet nga Metalet e Çmuara <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2869>.

Nr.	Në Regjistër	Agjencia e Metrologjisë e Kosovës
AMK-1	Po	Autorizimi i Subjekteve Juridike për Riparimin dhe Përgatitjen e Mjeteve Matëse për Verifikim
AMK-2	Po	Miratimi i Tipit të Mjeteve Matëse Ligjërish të Kontrolluara
AMK-3	Po	Emërimi i Subjekteve për Verifikimin e Mjeteve Matëse Ligjore
AMK-4	Jo	Regjistrimi i Prodhuesve dhe Importuesve të Mjeteve Matëse
AMK-5	Jo	Raporti i Ekzaminimit të Metaleve të Çmuara
AMK-6	Jo	Vendim për Shenjën e Prodhuesit, Importuesit ose Përfaqësuesit të Autorizuar të Punimeve nga Metalet e Çmuara

Gjatë analizës së kornizës ligjore që rregullon lejimet që administrohen nga AMK janë identifikuar edhe tri (3) lejime shtesë, AMK-4, AMK-5 dhe AMK-6, duke e rritur numrin nga 3 lejime sa janë të shënuara aktualisht në Regjistër në 6 lejime.

Legjislacioni në fushën e metrologjisë ka pësuar ndryshime të shumta ndër vite. Ligji i parë për metrologjinë, respektivisht Ligji Nr. 02/L-34 për Metrologji është aprovuar në vitin 2006 (*ligji i parë për metrologji*), ky ligj është shfuqizuar në vitin 2008 nga Ligji Nr. 03/L-203 për Metrologji (*ligji i dytë për metrologji*), i cili poashtu është shfuqizuar në vitin 2018 nga Ligji Nr. 06/L-037 për Metrologji (*ligji i ri për metrologji*).

Aktualisht, MTI është në proces të hartimit të akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit të ri për metrologjinë.

Megjithatë, për shkak që ligji i ri për metrologjinë nuk ka parashikuar vazhdimin e aplikimit të disa akteve nënligjore ekzistuese deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore, kjo ka rezultuar në një situatë në të cilën këto lejime kanë bazë ligjore në ligjin e ri për metrologjinë, mirëpo aktet nënligjore të cilat më parë kishin rregulluar administrimin e këtyre lejimeve nuk kanë mbetur në fuqi (p.sh. U.A (MTI) Nr. 13/2013, U.A. (MTI) Nr. 2006/23 dhe U.A. (MTI) Nr. 05/2015). Këto akte nënligjore kishin përcaktuar kriteret, afatet ligjore, procedurat dhe elementet tjera të këtyre lejimeve.

Për këtë arsye, hartimi dhe aprovimi sa më i shpejtë i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri për metrologjinë është jetik për administrimin e drejtë të këtyre lejimeve. Megjithëse aktualisht ka një zbrazëturë ligjore lidhur me administrimin e lejimeve nga AMK, kjo gjithashtu është një mundësi shumë e mirë që gjatë hartimit dhe shqyrtimit të akteve të reja nënligjore të shqyrtohen me kujdes kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave dhe që parimet e përcaktuara në atë ligj të përfshihen në këto akte nënligjore.

Një çështje tjetër e përgjithshme lidhur me lejimet AMK-1, AMK-2, AMK-3 dhe AMK-4 ka të bëjë me lartësinë e taksave për këto lejime që aplikohen nga AMK. Taksat janë përcaktuar në U.A. (MTI) Nr. 05/2018 për Lartësinë dhe Procedurën e Pagesës për Shërbimet në Metrologji (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16522>) që është aprovuar sipas ligjit të ri për metrologjinë dhe është e këshillueshme që taksat e përcaktuara në këtë U.A. të rishqyrtohen në bazë të parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative. Sa i përket AMK-3 në veçanti, gjatë një rishikimi të ardhshëm të U.A. (MTI) Nr. 05/2018 mund të shqyrtohet edhe çështja e përcaktimit të taksave për emërimin e trupave për vlerësimin e konformitetit në U.A. (MTI) Nr. 05/2018 kjo për shkak se nga analiza ligjore rezulton se mund të ketë konflikt ndërmjet U.A. (MTI) Nr. 05/2018 (Shtojca IV) dhe U.A. (QRK) 12/2018 që përcakton se taksat për emërimin e trupave për vlerësimin e konformitetit vendosen me akt të veçantë nga ministri i ministrisë përkatëse (që në rastin e DI është interpretuar si vendim i ministrit të MTI). Çështja e ndryshimit të mundshëm të U.A. (MTI) Nr. 05/2018 është diskutuar edhe në një takim të zhvilluar me Drejtorin e Përgjithshëm të AMK, në të cilin Drejtori i Përgjithshëm ka bërë të ditur se rishikimi i këtij U.A është në planet e AMK në të ardhmen e afërt.

Lejimi AMK-1 ka pësuar disa ndryshime sipas ligjit të ri për metrologjinë dhe disa nga procedurat dhe afatet për lëshimin e këtij lejimi janë të përcaktuara në nenet 36 deri 41 të këtij ligji. Aktet nënligjore të aprovuara sipas ligjit të dytë për metrologjinë, respektivisht U.A (MTI) Nr. 13/2013, U.A. (MTI) Nr. 2006/23 dhe U.A. (MTI) Nr. 05/2015 që paraprakisht kishin përcaktuar procedurat për lëshimin e këtij lejimi janë shfuqizuar me ligjin e ri për metrologjinë dhe aktet e reja nënligjore sipas Nenit 36 të ligjit të ri për metrologjinë nuk janë aprovuar ende.

Lejimi AMK-2 poashtu ka pësuar disa ndryshime sipas ligjit të ri për metrologjinë. Disa nga kërkesat e përgjithshme për këtë lejim janë të përcaktuara në Nenin 17 të ligjit të ri për metrologji, mirëpo akti nënligjor që duhet të aprovohet sipas këtij neni ende nuk është aprovuar dhe në këtë fazë është e këshillueshme që AMK të përcjellë me kujdes kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave gjatë hartimit të këtij akti nënligjor.

Lejimi AMK-3 është procedurë e emërimit të trupave për vlerësimin e konformitetit që rregullohet sipas U.A. (QRK) 12/2018 dhe vlej në të njëjtat komente sikurse ato të bëra për procedurat e emërimit të trupave për vlerësim të konformitetit nga DI, respektivisht se në këtë U.A (QRK) 12/2018 duhet të bëhet përcaktimi i afateve maksimale për shqyrtimin e kërkesave për emërim të trupave të konformitetit nga komisionet vlerësuese si dhe afatet për nënshkrimin e emërimeve nga ministrat e ministrive përkatëse si dhe procedura e ankesës administrative në rast të refuzimit. Është e qartë që në mungesë të këtyre afateve dhe procedurës së ankesës vlej në dispozitat e ligjit në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative, mirëpo me qëllim të sqarimit të



më tutjeshëm të këtyre procedurave dhe ofrimin e sigurisë juridike për aplikuesit është e këshillueshme që këto afate dhe procedura e ankesës të përcaktohen edhe në U.A. (QRK) Nr. 12/2018.

Lejimi AMK-4 ka bazë ligjore në Nenin 32 të ligjit të ri për metrologjinë që parasheh regjistrimin e të gjithë prodhuesve dhe importuesve të mjeteve matëse në një regjistër që mbahet nga AMK. Në nenin 46 të ligjit për metrologjinë gjithashtu parashihet vendosja e gjobave për prodhuesit dhe importuesit të cilët nuk e respektojnë këtë kërkesë për regjistrim. Megjithatë, nga analiza ligjore e kryer nuk rezulton se është aprovuar ende akti nënligjor që përcakton procedurat e regjistrimit të prodhuesve dhe importuesve në këtë regjistër. Gjatë kësaj analize gjithashtu është shqyrtuar edhe ligji i mëparshëm për metrologjinë i aprovuar në vitin 2010 (Neni 28) dhe megjithëse ky ligj kërkon miratimin e një akti nënligjor për regjistrimin e prodhuesve dhe importuesve, ky akt ligjor nuk ka mundur të gjendet në Gazetën Zyrtare, uebfaqen e AMK si dhe uebfaqen e MTI.

Lejimi AMK-5 ka bazë ligjore në Ligjin Nr. 04/L-154 për Punimet nga Metalet e Çmuara (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2869>) dhe qëllimi i këtij lejimi është obligimi i të gjithë prodhuesve dhe importuesve të metaleve të çmuara që ti dërgojnë produktet e tyre për analizë në laboratorët e metaleve të çmuara që funksionojnë në kuadër të AMK. Produktet nga metalet e çmuara nuk mund të plasohen në treg pa iu nënshtruar analizave përkatëse nga këta laboratorë që përfundojnë me nxjerrjen e një Raporti për Ekzaminimin e Metaleve të Çmuara. Nga analiza e kërkesave për këtë lejim të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-154 dhe U.A. (MTI) Nr. 12/2013 për Formën e Shenjës së Pastërtisë, Ekzaminimit të Punimeve nga Metalet e Çmuara dhe Formën e Shenjës së Harmonizimit (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2869>) rezulton se në ligjin dhe aktet nënligjore përkatëse nuk janë përcaktuar disa elemente shumë të rëndësishme për administrimin adekuat të këtij lejimi, duke përfshirë (i) listën e plotë të dokumenteve të duhet të dorëzohen së bashku me kërkesën me shkrim për ekzaminim dhe (ii) afatet kohore maksimale për përfundimin e ekzaminimit.

Lejimi AMK-6 ka bazë ligjore në nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-154 për Punimet nga Metalet e Çmuara. Në Nenin 8, paragrafi 7 të po të njëjtit ligj gjithashtu parashihet nxjerrja e një akti nënligjor që rregullon vendosjen e shenjës së pastërtisë, prodhuesit, dhe shenjës së harmonizimit në produktet nga metalet e çmuara. Megjithëse akti nënligjor i paraparë në Nenin 8, paragrafi 7 të Ligjit Nr. 04/L-154 është miratuar në vitin 2013, respektivisht U.A. (MTI) Nr. 12/2013, nga shqyrtimi i këtij U.A. rezulton se procedurat, dokumentacioni dhe kriteret për aplikimit për shenjë të prodhuesit, importuesit ose përfaqësuesit të autorizuar për produktet nga metalet e çmuara nuk janë përcaktuar në këtë U.A. Procedurat, dokumentacioni dhe kriteret për aplikim për këtë lejim në të kaluarën kanë qenë të përcaktuara në U.A. (MTI) Nr. 2008/06 për Shenjat e Prodhuesit, Punuesit dhe Shitësve të Punimeve nga Metalet e Çmuara (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7600>) të aprovuar në vitin 2008 në bazë të ligjit të parë për metrologji, mirëpo ky U.A. nuk është më në fuqi pasi që është shfuqizuar me aprovimin e ligjit të dytë për metrologjinë në vitin 2008. Në U.A. (MTI) 2008/06 Për konfirmimin e kësaj situatë ligjore nga AMK janë kërkuar disa shembuj të vendimeve të lëshuara në vitin 2018 dhe nga shqyrtimi i tyre është e qartë që këto vendime janë duke u thirrur në U.A. (MTI) Nr. 2008/06, që siç është theksuar më lartë nuk është më në fuqi. Në Shtojcën 3 – Tabela e Rekomandimeve është propozuar ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) 12/2013 për rregullimin e qartë të përmbajtjes së këtij vendimi. Nëse MTI vendos që të inicioj ndryshimin dhe plotësimin e U.A. (MTI) Nr. 12/2013 gjithashtu duhet të ketë parasysh se neni 21 i Ligjit Nr. 04/L-154 autorizon lëshimin e një *vendimi për shenjën e prodhuesit, importuesit ose përfaqësuesit të autorizuar dhe jo vendim për shitjen* siç është duke u aplikuar aktualisht.

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të AMK, të ndara në formë të rekomandimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 3 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.



#### 4.9. Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë

Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (AIPNK) në MTI administron gjithsej dy (2) lejime. Këto lejime administrohen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8654#>).

Nr.	Në Regjistër	Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë
AIPNK-1	Po	Pëlqim për Themelimin e Zonës së Lirë Ekonomike, Parkut Industrial ose Parkut Teknologjik
AIPNK-2	Jo	Pëlqim për Themelimin e Inkubatorit të Biznesit

Gjatë analizës së lejimeve që administrohen nga AIPNK është konstatuar nevoja për ndryshimin e Regjistrimit me qëllim të ndarjes së 1 lejimi të identifikuar aktualisht në regjistër në 2 lejime të veçanta, një për themelimin e tri formave të zonave ekonomike duke përfshirë zonën e lirë, parkun industrial dhe parkun teknologjik që i nënshtrohen të njëjtave kërkesa procedural në njërin anë dhe një lejim për inkubatorin e biznesit që i nënshtrohet kërkesave të ndryshme procedurale në anën tjetër.

Legjislacioni që rregullon krijimin e zonave ekonomike është aktualisht në proces të ndryshimit dhe plotësimit dhe Ligji që Rregullon Zonat Ekonomike është para aprovimit në QRK. Rekomandohet që MTI të shqyrtojë me kujdes Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave gjatë ndryshimit dhe plotësimit të akteve nënligjore përkatëse pas aprovimit të amendamenteve në ligjin ekzistues.

Rekomandimet specifike për lejimet në kuadër të AIPNK, të ndara në formë të rekomandimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata janë përfshirë në Shtojcën 3 - Tabela e Rekomandimeve Specifike.

### Shtojca 1 - Përditësimi i Regjistrimit të Lejeve dhe Licencave

Njësia Organizative	Lejimet në Regjistër	Lejimet pas Rishikimit
<b>Departamenti i Tregtisë</b>	1. Licencë për Importin dhe Shitjen me Shumicë të Duhanit	DTR-1 Licenca për eksport të produkteve të duhanit, përveç duhanit të pa fermentuar dhe të pa përpunuar
	2. Licencë për Eksport të Produkteve të Duhanit, Përveç Duhanit të Pafermentuar dhe Papërpunuar	DTR-2 Licenca për import dhe shitje me shumicë të cigareve
	3. Licencë për Import dhe Shitje me Shumicë të Cigareve Puro (Cigarillos) dhe Nargjile	DTR-3 Licenca për shitje me shumicë cigareve
		DTR-4 Licenca për import dhe shitje me shumicë të cigareve puro, cigarellos, nargjile dhe duhan për pirje
		DTR-5 Licenca për import të duhanit të papërpunuar
		DTR-6 Licenca për import dhe shitje me shumicë të cigareve elektronike
		DTR-7 Licenca për import dhe Licenca për shitje me shumicë cigareve shitje me shumicë të cigareve për përtpypje dhe nuhatje
		DTR-8 Licenca për import të letrës për cigare dhe letrës në forme tubi me filtër
<b>Departamenti i Industrisë</b>	1. Autorizim për Vlerësimin e Konformitetit për Sigurinë e Lodrave	DI-1 Emërim për Vlerësimin e Konformitetit (Përveç Derivateve të Lëngëta të Naftës)
	2. Autorizim për Vlerësimin e Konformitetit për Ashensorët dhe Komponentët e tyre të Sigurisë	DI-2 Emërim për Vlerësimin e Konformitetit për Derivate të Lëngëta të Naftës
	3. Autorizim për Vlerësimin e Konformitetit për Derivatet e Lëngëta të Naftës	
	4. Certifikatë për Kategorizimin e Objekteve Hoteliere	
<b>Departamenti i Turizmit</b>		DTU-1 Certifikim për kategorizimin e objekteve hoteliere
	1. Licencë për import të naftës dhe benzinës	DRRTN-1 Licenca për import të dizelit dhe benzinës

<b>Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës</b>	2. Licencë për deponim të dizelit dhe benzinës	DRRTN-2 Licenca për deponim të dizelit, benzinës, dhe gazoilit
	3. Licencë për shitje me shumicë të dizelit dhe benzinës	DRRTN-3 Licenca për shitje me shumicë të dizelit, benzinës, dhe gazoilit
	4. Licencë për shitje me pakicë të dizelit dhe benzinës	DRRTN-4 Licenca për shitje me pakicë të dizelit, benzinës, dhe gazoilit
	5 Licencë për import të gazit të lëngëzuar të naftës (LPG)	DRRTN-5 Licenca për import të GLN-së
	6. Licencë për deponim të gazit të lëngëzuar të naftës (LPG)	DRRTN-6 Licenca për deponim të GLN-së
	7. Licencë për shitje me shumicë të gazit të lëngëzuar të naftës	DRRTN-7 Licenca për shitje me shumicë të GLN-së
	8. Licencë për shitje me pakicë të gazit të lëngëzuar të naftës (LPG)	DRRTN-8 Licenca për shitje me pakicë të GLN-së
	9. Licencë për import të vajrave të rënda (mazut, solar, bitumen i lëngëzuar)	DRRTN-9 Licenca për import të vajrave të rënda për ngrohje
	10. Licencë për shitje me shumicë të vajrave të rënda për ngrohje dhe ose bitumoni	DRRTN-10 Licenca për shitje me shumicë të vajrave të rënda për ngrohje
	11. Licence për Shitje me shumice te Vajrave	DRRTN-11 Licenca për import të vajrave sipas produktit të caktuar (vajra bazike);
	12. Licencë për import të petrolkoksit-	DRRTN-12 Licenca për shitje me shumicë të vajrave sipas produktit të caktuar
	13. Licencë për import të vajrave sipas produktit të caktuar (lubrifikantë, motorikë dhe bazikë)	DRRTN-13 Licenca për import të koksit të naftës
	14. Licencë për import të kerozinës	DRRTN-14 Licenca për import të vajrave sipas produktit të caktuar (vajrat për qëllime: lubrifikimi, hidraulike, përcjellje të nxehtësisë, kundër ndryshkjes, izolim elektrik, punim të metaleve, tretje, për qëllime të tjera të ngjashme)
	15. Licencë për deponim të kerozinës	DRRTN-15 Licenca për import të karburantit Jet
	16. Licencë për shitje me shumicë të kerozinës	DRRTN-16 Licenca për deponim të karburantit Jet

	17. Licencë për import të naftës industriale (gasoil) për ngrohje	DRRTN-17 Licenca për shitje me shumicë të karburantit Jet
	18. Licencë për import të naftës dhe produkteve të naftës për përpunim të mëtejshëm	DRRTN-18 Licenca për import të gazoilit
	19. Licencë për import, shitje me shumicë dhe pakicë të bombolave të gazit për amvisëri	DRRTN-19 Licenca për import të lëndës së parë me qëllim të prodhimit të karburanteve finale të naftës
		DRRTN-20 Licenca për import, shitje me shumicë, dhe pakicë të bombolave të gazit për amvisëri
<b>Departamenti për Kontrollimin e Tregtisë me Mallra Strategjike</b>		DKTMS-1 Regjistrimi në Regjistrin e Tregtarëve me Mallra Strategjike
		DKTMS-2 Licenca për Eksport të Mallrave Strategjike
		DKTMS-3 Licenca për Ri-Eksport Jashtë Territorial apo Ri-Transfer të Mallrave Strategjike
		DKTMS-4 Licenca për Import të Mallrave Strategjike
		DKTMS-5 Licenca për Brokerët-Ndërmjetësuesit për Mallra Strategjike
		DKTMS-6 Licenca për Transit apo Transngarkim të Mallrave Strategjike
		DKTMS-7 Certifikata për Përdoruesin Fundor të Mallrave Strategjike
		DKTMS-8 Certifikata Ndërkombëtare e Importit të Mallrave Strategjike
		DKTMS-9 Certifikata për Verifikimin e Dorëzimit të Mallit Strategjik
		DKTMS-10 Licenca për Ofrimin e Shërbimeve të Ndërlidhura me Mallrat Strategjike
	1. Regjistrimi në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar	API-1 Regjistrimi i Përfaqësuesve të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale

<b>Agjencia e Pronësisë Industriale</b>	2. Regjistrimi i Patentës	
	3. Regjistrimi i Markës Tregtare	
	4. Regjistrimi i Dizajnit Industrial	
<b>Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës</b>	1. Regjistrimi i Biznesit Individual	ARBK-1 Regjistrimi i Biznesit Individual
	2. Regjistrimi i Ortakërisë së Përgjithshme	ARBK-2 Regjistrimi i Ortakërisë së Përgjithshme
	3. Regjistrimi i Ortakërisë së Kufizuar	ARBK-3 Regjistrimi i Ortakërisë së Kufizuar
	4. Regjistrimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar	ARBK-4 Regjistrimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
	5. Regjistrimi i Shoqërisë Aksionare	ARBK-5 Regjistrimi i Shoqërisë Aksionare
	6. Regjistrimi i Kompanisë së Huaj	ARBK-6 Regjistrimi i Degës së Kompanisë së Huaj në Kosovë
		ARBK-7 Regjistrimi i Zyrës së Përfaqësisë së Shoqërisë Tregtare
		ARBK-8 Regjistrimi i Kooperativës Bujqësore
		ARBK-9 Regjistrimi i Ndërmarrjes në Pronësi Shoqërore
		ARBK-10 Regjistrimi i Ndërmarrjes Publike
<b>Agjencia e Metrologjisë e Kosovës</b>	1. Autorizimi i subjekteve për përgatitjen e mjeteve matëse ligjore	AMK-1 Autorizimi i Subjekteve Juridike për Riparimin dhe Përgatitjen e Mjeteve Matëse për Verifikim
	2. Miratimi i tipit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara	AMK-2 Miratimi i Tipit të Mjeteve Matëse Ligjërisht të Kontrolluara
	3. Autorizimi i subjekteve për verifikimin e mjeteve matëse ligjore	AMK-3 Emërimi i Subjekteve për Verifikimin e Mjeteve Matëse Ligjore
		AMK-4 Regjistrimi i Prodhuesve dhe Importuesve të Mjeteve Matëse
		AMK-5 Raporti i Ekzaminimit të Metaleve të Çmuara
		AMK-6 Vendim për Shenjën e Prodhuesit, Importuesit ose Përfaqësuesit të Autorizuar të Punimeve nga Metalet e Çmuara

<b>Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë</b>	1. Pëlqim për Themelimin e Zonës Ekonomike	AIPNK -1 Pëlqim për Themelimin e Zonës së Lirë Ekonomike, Parkut Industrial ose Parkut Teknologjik
		AIPNK-2 Pëlqim për Themelimin e Inkubatorit të Biznesit

## Shtojca 2 – Tabela e Rekomandimeve të Përgjithshme për MTI

Gjatë zbatimit të këtij aktiviteti është konstatuar se, megjithëse Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave merret parasysh në disa raste gjatë hartimit të akteve ligjore që hartohen në kuadër të MTI, shkalla e respektimit të këtij ligji brenda MTI ende ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësim.

Për adresimin e këtyre mangësive në shkallën e zbatimit të këtij ligji të rëndësishëm për përmirësimin e mjedisit afarist në Kosovë rekomandojmë që të ndërmerren disa veprime, të përshkruara në tabelën më poshtë.

REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME	
1.	<b>Përditësimi i Regjistrimit të Lejeve dhe Licencave:</b> Për të siguruar përditësimin e rregullt të Regjistrimit për lejet që administrohen nga MTI, ekziston nevoja për vendosjen e disa rregullave brenda Departamentit Ligjor të MTI për mirëmbajtjen e Regjistrimit. Kjo mund të bëhet përmes krijimit të një procesi të qartë të njoftimit nga zyrtarët ligjor në kuadër të Departamentit Ligjor në MTI për zyrtarin/en përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrimit (Pikën e Kontaktit) lidhur me të gjitha lejet e reja që parashihen në legjislacionin e ri që hartohet në kuadër të MTI. Një veprim tjetër me të cilin mund të ngarkohet zyrtari/ja përgjegjës për përditësimin e regjistrimit është që të zhvillojë takime me të gjitha njësitë organizative brenda MTI të paktën 2 herë në vit për mbledhjen e informatave lidhur me lejet ekzistuese apo lejet e reja të krijuara, verifikimin ligjor të tyre dhe përgatitjen e formularëve për dorëzim në Zyrën Ligjore të Kryeministrit.
2.	<b>Përmirësimi i Monitorimit të Zbatimit të Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave:</b> Për të siguruar respektimin e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit dhe gjatë aplikimit të tyre brenda MTI, ekziston nevoja për krijimin e një procesi të qartë të punës brenda Departamentit për Integrim të Politikave dhe Koordinim të Politikave dhe Departamentit Ligjor për sigurimin e përputhshmërisë me Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Funksionimi efektiv i këtij procesi të punës varet në masë të madhe edhe nga krijimi i një linje të qartë të komunikimit ndërmjet këtyre dy Departamenteve, organizimi i trajnimeve të specializuara dhe krijimit të një udhëzuesi për parimet dhe kërkesat e ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave që mund të përdoren nga zyrtarët e këtyre dy departamenteve gjatë pjesëmarrjes në hartimin e politikave dhe legjislacionit.
3.	<b>Trajnimi i Zyrtarëve të MTI lidhur me Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave:</b> Për të siguruar zbatimin e njëtrajtshëm dhe konsistent të parimeve të përcaktuara në Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave është i nevojshëm organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve gjithëpërfshirëse për të gjitha njësitë organizative brenda MTI për rëndësinë dhe aplikimin e ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave gjatë hartimit të legjislacionit si dhe gjatë zbatimit.

**Shtojca 3 – Tabela e Rekomandimeve Specifike për MTI**

<b>DEPARTAMENTI I TREGTISË</b>						
<b>Nr.</b>	<b>Shpjegimi i Intervenimit</b>	<b>Lejimet e ndikuara<sup>274</sup></b>	<b>Veprimet e Nevojshme</b>	<b>Aktet Kryesore të Ndikuara</b>	<b>Afati i Intervenimit</b>	<b>Komente</b>
1.	Bashkimi i Licencës për Import dhe Shitje me Shumicë të Cigareve (DTR-2) me Licencën për Shitje me Shumicë të Cigareve (DTR-3)	1 Lejimi Eliminohet  (1 Jo) DTR-3	Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 04/2016 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kriteve për Subjektet që Merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të Tij	U.A. (MTI) Nr. 04/2016 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kriteve për Subjektet që Merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të Tij <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12340">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12340</a>	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Ky rekomandim mund të zbatohet ndaras ose bashkërisht me rekomandimin Nr. 2.
2.	Vlerësimi i lartësisë së taksave për lejimet për tregtinë me duhanin (DTR-1 deri DTR-8) në bazë të parimit për mbulimin e shpenzimeve administrative	7 Lejime Thjeshtësohen  (3 Po) DTR-1, DTR-2, DTR-4  (3 Jo) DTR-5, DTR-6, DTR-7	1. Vlerësimi i lartësisë së taksave për lejimet e duhanit në bazë të parimit për mbulimin e shpenzimeve administrative  2. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 04/2016 për Përcaktimin e	U.A. (MTI) Nr. 04/2016 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kriteve për Subjektet që Merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të Tij <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12340">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12340</a>	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Ky rekomandim mund të zbatohet ndaras ose bashkërisht me rekomandimin Nr. 1.

<sup>274</sup> Në këtë kolonë është shpjeguar numri i lejimeve të ndikuara nga secili rekomandim dhe është dhënë një indikacion nëse lejimet përkatëse janë aktualisht në Regjistër (PO) ose nuk janë aktualisht në Regjistër (JO).



			Kushteve dhe Kriteve për Subjektet që Merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të Tij			
3.	Eliminimi i Lejes për Importin e Duhanit që lëshohet nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit dhe Licencës për Importim dhe Eksportim të Produkteve të Duhanit që lëshohet nga Doganat e Kosovës dhe harmonizimi i kërkesave rregullatore për import dhe eksport në mes të MTI, AVUK dhe Doganave të Kosovës në mënyrë që Departamenti i Tregtisë të Shërbejë si One-Stop-Shop për të gjitha licencat lidhur me duhanin	2 Lejime Eliminohen  (2 Po) Nuk janë në seksionin e MTI por në AVUK dhe Dogana	1. Inicimi i procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit (Neni 17)  2. Inicimi i procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit (Neni 11)	Ligji Nr. 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit (Neni 17) <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2783">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2783</a>  Ligjit Nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit (Neni 11) <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2779">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2779</a>  U.A. (MF) Nr. 4/2012 për Lëshimin e Licencës, për Pagesën e Taksës së Akcizës dhe Shumës së Taksës Administrative <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8194#">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8194#</a>  Rregullore (QRK) Nr. 17/2012 për Caktimin e Lartësisë së Pagesës së Shërbimeve dhe Kontrolleve Zyrtare të AVUK me ndryshime dhe plotësime <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8383">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8383</a>	Afat-Gjatë  (pas 31 Dhjetor 2019)	Për implementimin e këtij rekomandimi kërkohen diskutime më të gjera me AVUK dhe Doganat e Kosovës para se të procedohet me iniciimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në ligjet përkatëse.

<b>DEPARTAMENTI I INDUSTRIË</b>						
4.	Reduktimi i lartësisë së taksave administrative për aplikim dhe emërim për vlerësim të konformitetit (DI-1 dhe DI-2) që aktualisht janë 50 Euro për aplikim dhe 100 Euro me rastin e emërimit	2 Lejime Thjeshtësohen  (2 Po) DI-1, DI-2	<p>1. Konfirmimi i informatave lidhur me të hyrat totale të MTI nga taksat për këto lejime në vitin 2018.</p> <p>2. Analiza e këtyre informatave nga DI dhe diskutimi me kabinetin e MTI për shkallën e reduktimit.</p> <p>3. Ndryshimi i vendimit të Ministrit të MTI Nr. 53 të datës 29.10.2018.</p>	Vendimi i Ministrit të MTI Nr. 53 të datës 29.10.2018	Afat-Shkurtër  (deri 30 Qershor 2019)	<p>Sipas të dhënave të siguruara nga DI:</p> <p>- në vitin 2018 nga këto taksa janë realizuar gjithsej 300 Euro.</p> <p>- në vitin 2016 nga këto taksa janë realizuar gjithsej 1,772 Euro.</p>
5.	Konsolidimi i taksave administrative për aplikim dhe emërim për vlerësim të konformitetit (DI-1 dhe DI-2) në një taksë të vetme. Plotësimi i afateve për vendim nga komisioni vlerësues	2 Lejime Thjeshtësohen  (2 Po) DI-1, DI-2	1. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (QRK) Nr. 12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit	U.A. (QRK) Nr. 12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388</a>	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Me konsolidim është menduar bashkimi i dy (2) taksave aktuale për aplikim dhe për emërim në një të vetme. Kjo nuk mund të bëhet me vendim sipas rekomandimit 1

	dhe afatit për nënshkrim nga ministri si dhe sqarimi i procedurave ankimore.					më lartë për shkak se në UA (QRK) Nr. 12/2018 kërkohet dorëzimi i fletëpagesës së taksës për aplikim me rastin e aplikimit për emërim
<b>DEPARTAMENTI I TURIZMIT</b>						
6.	Shqyrtimi i të gjitha akteve nënligjore që do të hartohen për implementimin e ligjit të ardhshëm për turizmin në raport me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave	N/A	1. Projektligji për Turizmin	1. Projektligji për Turizmin	Afat-Gjatë (pas 31 Dhjetor 2019)	Projektligji për Turizmin tashmë është në fazë mjaft të avancuar dhe është dorëzuar për vlerësim të përafrimit me Acquis Communautaire në MIE, rrjedhimisht mund të mos ketë kohë për rishikimin e këtij

						<p>Projektligji në raport me parimet dhe rregullat e përcaktuara në Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Megjithatë rekomandohet që një vlerësim i hollësishëm i kërkesave të reja për licencim të bëhet gjatë përgatitjes së akteve nënligjore.</p>
<b>DEPARTAMENTI PËR RREGULLIMIN E TREGUT TË NAFTËS</b>						
7.	<p>Eliminimi i taksës për verifikimin e objekteve, pajisjeve dhe personelit të subjekteve nga sektori i naftës dhe derivateve të naftës</p>	<p>20 Lejime Thjeshtësohen (19 Po) DRRTN-1 deri 10 dhe 12 deri 20.</p>	<p>1. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 16/2010 për Caktimin e Lartësisë së Taksave për Licencimin e Subjekteve nga Sektori i Naftës dhe Derivateve të Naftës</p>	<p>U.A. (MTI) Nr. 16/2010 për Caktimin e Lartësisë së Taksave për Licencimin e Subjekteve nga Sektori i Naftës dhe Derivateve të Naftës (<a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7936">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7936</a>)</p>	<p>Afat-Mesëm (deri 31 Dhjetor 2019)</p>	<p>Ky rekomandim mund të zbatohet ndaras ose bashkërisht me rekomandimin Nr. 8.</p>

		(1 Jo) DRRTN-11				
8.	Reduktimi potencial i taksave administrative për pajisje me lejimet në fushën e naftës, DRRTN-1 deri DRRTN-20 pas vlerësimit sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative	20 Lejime Thjeshtësohen  (19 Po) DRRTN-1 deri 10 dhe 12 deri 20.  (1 Jo) DRRTN-11	1. Vlerësimi i taksave sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative  2. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 16/2010 për Caktimin e Lartësisë së Taksave për Licencimin e Subjekteve nga Sektori i Naftës dhe Derivateve të Naftës	U.A. (MTI) Nr. 16/2010 për Caktimin e Lartësisë së Taksave për Licencimin e Subjekteve nga Sektori i Naftës dhe Derivateve të Naftës ( <a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7936">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7936</a> )	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Ky rekomandim mund të zbatohet ndaras ose bashkërisht me rekomandimin Nr. 7.
9.	Rishikimi i numrit të lejimeve për sektorin e naftës me qëllim të bashkimit potencial të procedurave të aplikimit për këto leje	20 Lejime Thjeshtësohen  (20 Po) DRRTN-1 deri 20	1. Shqyrtimi i mundësisë së bashkimit të procedurave të aplikimit për lejimet në sektorin e naftës nga DRRTN  2. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A (MTI) Nr. 07/2018 për Përcaktimin e Procedurës së Licencimit për	U.A. 07/2018 për Përcaktimin e Procedurës së Licencimit për Subjektet që Ushtrojnë Veprimtari në Sektorin e Naftës ( <a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17763">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17763</a> )	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Ky rekomandim mund të zbatohet ndaras ose bashkërisht me rekomandimin Nr. 10 dhe 11

			Subjektet që Ushtrajnë Veprimtari në Sektorin e Naftës			
10.	Sqarimi i kompetencave dhe procedurave të punës të Komisionit për Vlerësimin e Kushteve të Veçanta Teknike dhe potencialisht eliminimi i tërësishëm i këtij komisioni që detyrat të ushtrohen brenda DRRTN	20 Lejime Thjeshtësohen  (19 Po) DRRTN-1 deri 10 dhe 12 deri 20.  (1 Jo) DRRTN-11	1. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 07/2018 për Përcaktimin e Procedurës së Licencimit për Subjektet që Ushtrajnë Veprimtari në Sektorin e Naftës	1. U.A. (MTI) Nr. 07/2018 për Përcaktimin e Procedurës së Licencimit për Subjektet që Ushtrajnë Veprimtari në Sektorin e Naftës ( <a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17763">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17763</a> )	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Ky rekomandim mund të zbatohet ndaras ose bashkërisht me rekomandimin 9 dhe 11.
11.	Eliminimi i kërkesës për noterizimin e dokumenteve që lëshohen nga organet shtetërore për pajisje me licencë në fushën e naftës	20 Lejime Thjeshtësohen  (19 Po) DRRTN-1 deri 10 dhe 12 deri 20.  (1 Jo) DRRTN-11	1. Vërtetimi i pretendimit se kërkesa për “vërtetim” të dokumentacionit në tërësi është interpretuar si “noterizim” edhe për dokumentet që lëshohen nga organet shtetërore përmes shqyrtimit të aplikacioneve të lëshuara në vitet 2018/2019.	1. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 07/2018 për Përcaktimin e Procedurës së Licencimit për Subjektet që Ushtrajnë Veprimtari në Sektorin e Naftës ( <a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17763">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17763</a> )	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Ky rekomandim mund të zbatohet ndaras ose bashkërisht me rekomandimin 9 dhe 10.

			2. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 07/2018 për Përcaktimin e Procedurës së Licencimit për Subjektet që Ushtrojnë Veprimtari në Sektorin e Naftës			
12.	Rishikimi i Projektligjit për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme në Kosovë për inkorporimin e parimeve të përcaktuara në ligjin në fuqi për sistemin e lejeve dhe licencave	N/A	1. Rishikimi i Projektligjit për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme në Kosovë për:  (i) Në nenin 5 paragrafi 1, identifikimin individual dhe jo sipas llojit të të gjitha licencave që planifikohet të lëshohen nga Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës, reduktimin e numrit të tyre dhe/ose bashkimin e procedurës së aplikimit;	1. Projektligji për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme në Kosovë	Afat-Shkurtër  (deri 30 Qershor 2019)	Projektligji për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme në Kosovë aktualisht është në fazat finale të shqyrtimit brenda MTI, prandaj shqyrtimi i rekomandimeve të dhëna duhet të bëhet në afat-shkurtër.  Pika (ii) e këtij rekomandimi është pjesërisht e përfshirë në projektligjin e

		<p>(ii) Në nenin 5, paragrafi 4, obligimi i propozuesit të udhëzimit administrativ për taksa që së bashku me U.A. për taksa të dorëzojë edhe vlerësimin sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative tek Ministri i MTI;</p> <p>(iii) Në nenin 5, paragrafi 5 të shqyrtohet mundësia për periudhë të vlefshmërisë edhe më të gjatë se 5 vite për licencat;</p> <p>(iv) Rishikimin e Nenit 5, paragrafi 7 lidhur me Komisionin për Vlerësimin e Kushteve të Veçanta Teknike dhe nevojës për këtë komision. Cilat janë kompetencat e sakta dhe pse nuk mund të</p>			<p>publikuar nga MTI për konsultim publik, por propozimi është që të bëhet obligative dorëzimi i këtij vlerësimi tek Ministri i MTI së bashku me U.A-në përkatëse.</p> <p>Pika (vi) poashtu është përfshirë në projektligjin e publikuar për konsultim publik dhe është shumë me rëndësi që të mbahet në projektligjin përfundimtar që dorëzohet për aprovim në Kuvend.</p>
--	--	---	--	--	---



			<p>ushtrohen këto kompetenca nga DRRTN.</p> <p>(v) Në Nenin 5 të specifikohet se vërtetimi i dokumenteve që nevojiten për pajisje me licencë dhe që lëshohen nga institucionet shtetërore do të bëhet vetëm për dokumentet e lëshuara nga personat ose autoritet jashtë administratës shtetërore.</p> <p>(vi) Në nenin 7, specifikimi që në aktin nënligjor për procedurë të licencimit, të mos ketë nevojë për ri-parashtrimin e tërë dokumentacionit për licencë me rastin e përtëritjes së licencës;</p>		

DEPARTAMENTI PËR KONTROLLIMIN E TREGTISË ME MALLRA STRATEGJIKE						
13.	Eliminimi i taksës për regjistrim në Regjistrin e Tregtarëve me Mallra Strategjike (DKTMS-1)	1 Lejim Thjeshtësohet  (1 Jo) DKTMS 1	<p>1. Konfirmimi i informatave për të hyrat totale të MTI nga kjo taksë në vitin 2018.</p> <p>2. Analiza e këtyre informatave nga DKTMS dhe diskutimi me kabinetin e MTI për eliminimin e kësaj takse.</p> <p>3. Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit të Ministrit të MTI Nr. 12 të datës 9 Janar 2018.</p>	Vendimi i Ministrit të MTI Nr. 12 i datës 9 Janar 2018.	Afat-Shkurtër  (deri 30 Qershor 2019)	Taksa aktuale është 5 Euro.  Në vitin 2018 janë realizuar 7 regjistrime.
14.	Fillimi i lëshimit të licencave të përgjithshme me qëllim të reduktimit të barrierës administrative për bizneset private që të marrin licenca individuale për çdo transaksion	N/A	1. Vlerësimi i pengesave për lëshimin e licencave të përgjithshme.	<p>1. Ligji Nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike (<a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8860">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8860</a>)</p> <p>2. U.A. (MTI) Nr. 14/2013 për Regjistrimin, Licencimin dhe Zbatimin e Procedurave Administrative (<a href="https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9971">https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9971</a>).</p>	Afat-Gjatë  (pas 31 Dhjetor 2019)	Fillimi i lëshimit të licencave të përgjithshme ka qenë kërkesë e përfaqësuesve të sektorit privat, mirëpo kjo çështje duhet të hulumtohet më tutje dhe të

						konstatohen arsyet pse nuk janë lëshuar licenca të përgjithshme deri më tani.
<b>AGJENCIA E PRONËSISË INDUSTRIALE</b>						
15.	Reduktimi i taksave për aplikim, regjistrim, vazhdim të regjistrimit dhe ndryshim të të dhënave në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale (API-1) dhe zgjatja e vlefshmërisë së regjistrimit të paktën në tri (3) vite, deri në fillimin e testimit.	1 Lejimi Thjeshtësohet  (1 Po) API-1	1. Sigurimi i informatave për të hyrat totale për MTI nga këto taksa në vitin 2018.  2. Analiza e këtyre informatave nga API dhe diskutimi me kabinetin e MTI për reduktimin e këtyre taksave dhe zgjatjen e afatit të regjistrimit në tri (3) vite.  3. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 06/2018 për Përfaqësues të	Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 06/2018 për Përfaqësues të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale ( <a href="https://kipa.rks.gov.net/desk/inc/media/19BC701B-0CDA-4030-A904-67142A27EA18.pdf">https://kipa.rks.gov.net/desk/inc/media/19BC701B-0CDA-4030-A904-67142A27EA18.pdf</a> )	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Megjithëse propozimi për shkallën e reduktimit duhet të vijë nga API pas një analize të shkurtër, këtu ka potencial të paktën për përgjysmimin e taksave.

			Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale			
<b>AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS</b>						
16.	Rishikimi i kërkesës për regjistrimin e obligueshëm të të gjitha NACE kodeve si dhe ndryshimin e tyre në rast të ndryshimit të veprimtarisë së shoqërisë tregtare, pasi që këto kode sipas ligjit të ri mund të konsiderohen informata vullnetare që parashtrihen nga aplikuesit për regjistrim të bizneseve.	10 Lejime Thjeshtësohen  (6 Po) ARBK-1 deri 6  (4 Jo) ARBK-7 deri 10	1. Rishikimi i formularëve të rinj të regjistrimit për 10 lejimet e ARBK në të cilat sqarohet natyra vullnetare e NACE kodeve sipas Nenit 9, paragrafët 2 dhe 5 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.  2. Miratimi i formularëve nga Drejtori i Përgjithshëm i ARBK	1. Rishikimi i formularëve të rinj të regjistrimit për 10 lejimet e ARBK në të cilat sqarohet natyra vullnetare e NACE kodeve.	Afat-Shkurtër  (deri 30 Qershor 2019)	Hartimi dhe aprovimi i formularëve të rinj është aktivitet mjaft urgjent për implementimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare
17.	Reduktimi potencial i taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë sipas parimit të mbulimit të	10 Lejime Thjeshtësohen  (6 Po) ARBK 1 deri 6	1. Vlerësimi i taksave për shërbimet e ARBK sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative	Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 11/2018 për Përcaktimin e Taksave për Shërbimet e Ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426</a> )	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Taksat për shërbimet e ARBK aktualisht janë relativisht të ulëta, mirëpo volumi i regjistrimeve është shumë i madh. Vlen të

	shpenzimeve administrative.	(4 Jo) ARBK-7 deri 10	2. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. Nr. 11/2018 për Përcaktimin e Taksave për Shërbimet e Ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës			bëhet një vlerësim i shkurtër sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative për shqyrtimin e mundësisë për reduktim të mëtutjeshëm.
<b>AGJENCIA E METROLOGJISË E KOSOVËS</b>						
18.	Reduktimi potencial i taksave administrative për pajisje me lejimet që lëshohen nga AMK (AMK-1 deri AMK-6) pas kryerjes së një vlerësimi sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative si dhe sqarimi i konfliktit ndërmjet U.A. (MTI) Nr. 05/2018 dhe U.A. (QRK) 12/2018 sa i përket taksave administrative për emërimin e trupave	4 Lejime Thjeshtësohen  (3 Po) AMK-1, AMK-2, AMK-3  (1 Jo) AMK-4	1. Vlerësimi i taksave sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve administrative  2. Shqyrtimi i konfliktit të mundshëm sa i përket lartësisë së taksave administrative për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit ndërmjet U.A. (MTI) Nr. 05/2018 dhe U.A. (QRK) Nr. 12/2018	U.A. (MTI) Nr. 05/2018 për Lartësinë dhe Procedurën e Pagesës për Shërbimet në Metrologji ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16522">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16522</a> )	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	

	për vlerësimin e konformitetit		2. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (MTI) Nr. 05/2018 për Lartësinë dhe Procedurën e Pagesës për Shërbimet në Metrologji			
19.	Shqyrtimi i Draft U.A për Autorizimin e Subjekteve për Riparimin dhe Përgatitjen e Mjeteve Matëse për Verifikim sipas Nenit 36 të ligjit të ri për metrologjinë pas një analize të përfshirjes së parimeve dhe kërkesave të ligjit në fuqi për sistemin e lejeve dhe licencave	1 Lejim Thjeshtësohet  (1 Po) AMK-1	1. Shqyrtimi i Draft U.A. për Autorizimin e Subjekteve për Riparimin dhe Përgatitjen e Mjeteve Matëse për Verifikim	Draft U.A për Autorizimin e Subjekteve për Riparimin dhe Përgatitjen e Mjeteve Matëse për Verifikim	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Drafti/draftet fillestare janë hartuar por duhet të rishikohen në raport me kërkesat e ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave.
20.	Shqyrtimi i Draft U.A për Përcaktimin e Procedurave për Miratimin e Tipit për Mjetet Matëse Ligjërish të Kontrolluara sipas Nenit 17 të ligjit të ri për metrologjinë pas një analize të	1 Lejim Thjeshtësohet  (1 Po) AMK-2	1. Hartimi dhe/ose shqyrtimi i Draft U.A. për Autorizimin e Subjekteve për Riparimin dhe Përgatitjen e Mjeteve Matëse për Verifikim	Draft U.A. për Autorizimin e Subjekteve për Riparimin dhe Përgatitjen e Mjeteve Matëse për Verifikim	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Drafti fillestar është hartuar por duhet të rishikohet në raport me kërkesat e ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave.

	përfshirjes së parimeve dhe kërkesave të ligjit në fuqi për sistemin e lejeve dhe licencave					
21.	Konsolidimi i taksave administrative për aplikim dhe emërim të trupave për vlerësimin e konformitetit në një taksë të vetme, plotësimi i afateve për vendim nga komisioni vlerësues dhe afatit për nënshkrim nga ministri si dhe procedurave ankimore për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit	1 Lejimi Thjeshtësohet  (1 Po) AMK-3	1. Ndryshimi dhe plotësimi i U.A. (QRK) Nr. 12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit	U.A. (QRK) Nr. 12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit ( <a href="http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388">http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16388</a> )	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Ky rekomandim mund të zbatohet njëkohësisht me rekomandimin Nr. 5 në këtë tabelë pasi që mbulojnë të njëjtën fushë dhe kanë ndikim në të njëjtat akte.  Me konsolidim është menduar bashkimi i dy (2) taksave aktuale për aplikim dhe për emërim në një të vetme. Kjo nuk mund të bëhet me vendim sipas rekomandimit 1 më lartë për shkak se në UA

						(QRK) Nr. 12/2018 kërkohe dorëzimi i fletëpagesës së taksës për aplikim me rastin e aplikimit për emërim.
22.	Hartimi i Draft U.A për Mënyrën dhe Procedurat e Regjistrimit të Prodhuesve dhe Importuesve të Mjeteve Matëse sipas nenit 32 të ligjit të ri për metrologjinë pas një analize të përfshirjes së parimeve dhe kërkesave të ligjit në fuqi për sistemin e lejeve dhe licencave	1 Lejim Thjeshtësohet  (1 Po) AMK-4	1. Hartimi dhe/ose shqyrtimi i Draft U.A. për Mënyrën dhe Procedurat e Regjistrimit të Prodhuesve dhe Importuesve të Mjeteve Matëse	Draft U.A. për Mënyrën dhe Procedurat e Regjistrimit të Prodhuesve dhe Importuesve të Mjeteve Matëse	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Aktualisht MTI nuk ka iniciuar ende hartimin e këtij U.A.
23.	Shqyrtimi i U.A. (MTI) Nr. 12/2013 Formën e Shenjës së Pastërtisë, Ekzaminimit të Punimeve nga Metalet e Çmuara dhe Formën e	2 Lejime Thjeshtësohen  (2 Jo) AMK-5 dhe AMK-6	1. Rishikimi i U.A. (MTI) Nr. 12/2013	U.A. (MTI) Nr. 12/2013 për Formën e Shenjës së Pastërtisë, Ekzaminimit të Punimeve nga Metalet e Çmuara dhe Formën e Shenjës së Harmonizimit ( <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2869">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2869</a> )	Afat-Mesëm  (deri 31 Dhjetor 2019)	Gjatë shqyrtimit eventual të U.A. (MTI) Nr. 12/2013 duhet të jetë e qartë që Ligji për punimet nga metalet e



	<p>Shenjës së Harmonizimit për sqarimin e dokumentacionit të plotë që duhet dorëzuar së bashku me kërkesat për ekzaminim, afatet maksimale për kryerjen e analizave (nëse është e mundshme), si dhe për rregullimin e plotë të procedurave, afateve, kërkesave dhe formularëve për lëshimin e vendimit për shenjen e prodhuesit, importuesit ose përfaqësuesit të autorizuar për punimet nga metalet e çmuara</p>					<p>çmuara Neni 21, paragrafi 2 autorizon lëshimin e vendimit për shenjën e prodhuesit, importuesit ose përfaqësuesit të autorizuar dhe nuk flet për lëshimin e ndonjë vendimi për dhënien e të drejtës për shitje.</p>
<p><b>AGJENCIA PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJE TË NDËRMARRJEVE NË KOSOVË</b></p>						
<p>24.</p>	<p>Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri për zonat</p>	<p>2 Lejime Thjeshtësohen</p>	<p>1. Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri për zonat ekonomike</p>	<p>1. Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit të ri për zonat ekonomike (pas aprovimit nga Kuvendi)</p>	<p>Afat-Gjatë</p>	

	ekonomike (pas aprovimit nga Kuvendi) në përputhje me parimet dhe kërkesat e ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave	(2 Po) AIPNK-1 dhe AIPNK-2	(pas aprovimit nga Kuvendi) në përputhje me parimet dhe kërkesat e ligjit për sistemin e lejeve dhe licencave		(pas 31 Dhjetor 2019)	
--	---	----------------------------	---	--	-----------------------	--

## Kolofon

Ky Koncept Dokument është hartuar nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit me mbështetjen e "Projektit për Mbështetjen e Zhvillimit të Politikave", i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe zbatohet nga SKQ.

